



E
SHEETIT
ROKASTER



VITO KOÇI
NOVELA

BH-32

k77

396

396

396

VITO KOÇI

NOVELA

43.061



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I

— Edhe sa duam të arrijmë në Fushë-Bredh?, — e pyeta fqinjin, kur autobusi la rrugën e asfaltuar dhe nisi të ngjitej nëpër disa serpentina malore të forta.

— Rreth një orë!, — m'u përgjigj ai, pa i shqitur sytë nga faqja e parë e gazetës «Bashkimi».

Spartakjada e Parë Kombëtare, festa e forcës, bukurisë dhe shëndetit!, — lexova përsëri titullin me shkronja të mëdha në krye të faqes. Pastaj, i bindur se edhe orvatje për të çelur bisedë kishte dështuar, ktheva kokën nga dritarja dhe nisa të sodisja panoramat që parakalnin përtej saj. Udhëtonim buzë një lugine të thellë, së cilës nuk i shihej fundi. Mbi të ngriheshin faqe gjysmë të zhveshura, me shkurre të rralla bushi e dëllinje, bokërrima të kuqërreme, shkëmbinj të hirtë, ndonjë ngastër pylli me gjethe të zverdhura dhe tek-tuk ndonjë shtëpi e veçuar malësie, secila me një copë tokë përbri.

Në një udhëtim të gjatë, njeriut ia ka ënda të shkëmbejë ndonjë fjalë me bashkudhëtarët, por fqinji im kishte qëlluar burrë i heshtur, që përgjigjej shkurt në çdo pyetje, të shumtën e herës me një «po» ose «jo» të vetme dhe kështu ma mbyllte shtegun për muhabet. Në sediljen e përparme ndodheshin një i ri dhe një e re, ndoshta

të sapomartuar, që pëshpërisnin vazhdimisht njëri me tjetrin. Kështu që, doja s'doja, edhe unë heshtja e kridhesha në mendime, duke vështruar i shpërqëndruar jashtë.

Fqinji e palosi gazetën dhe e futi në xhep. Vështroi një hop drejt meje dhe kujtova se do ta thyente akullin, por ai u rehatua mirë e mirë në sedilje dhe pas pak nisi të dremiste. Ishte rreth të dyzetave, trupngjeshur, me fytyrë të ashpër, me flokë të shkurtër e pak të thijnjur, që i rrinin përpjetë si gjemba iriçi, por kishte ca sy të larmë, plot dritë e mirësi, që binin në kundërshtim me pamjen e tij të përgjithshme.

Tek e vështroja, më nxirrte mallin e tim eti, sepse atij duhet t'ia nxjerrësh fjalët me darë; ai edhe pamjen e ka po kështu, të rëndë e të ashpër, ama zemrën e ka flori. Unë gati-gati e çmoj më tepër se nënën, megjithëse ajo më ka trajtuar gjithmonë me përkëdheli.

Atë ditë që mora diplomën e mjekut, me vlerësimin «shkëlqyeshëm», nëna sa s'fluturonte dhe s'la njeri pa ia treguar gëzimin dhe krenarinë e vet, kurse babai u mjaftua me një «Të lumtë, more bir!» dhe me një të rrahur në sup, çka tregon shfaqjen më të lartë të dashurisë së tij.

Kur erdhi koha e shpalljes së emërimeve, nëna merakosej dhe më pyeste «Hë, ç'kemi?», sa herë kthehesha në shtëpi, kurse im atë asnjëherë.

«E ç'rëndësi ka kjo punë, brenda piramidave të kufirit do ta emërojnë!», — thoshte dhe e mbyllte me aq.

Këto fjalë, që i dëgjova shpeshherë ato ditë, ma kishin lehtësuar disi ankthin e pritjes por, në thellësinë time, shpresoja për një vend të mirë. Bile, ma kishte zënë veshi se katedra e patologjisë paskësh propozuar që të mbetesh asistent në fakultet. Por, në mos atje, përsëri...

Kur më njoftuan se isha emëruar në Fushë-Bredh, që s'ia kisha dëgjuar emrin gjer atë ditë, shtanga, po nuk bëra zë. Habinë time e shprehën disa shokë, të cilët kishin filluar të më thërrisnin me shaka «profesor». Kur shkova në shtëpi ndodhej aty vetëm babai, prandaj u mundova të shtiresha sa më i qetë.

Nëna erdhi më pas dhe, sapo dëgjoi lajmin, hapi sytë, pastaj pyeti e merakosur:

— Ku bie ky i uruar Fushë-Bredh?

Brenda piramidave!, — përsëriti im atë, duke e vështruar me qortim. — E di, kam qenë në ato anë gjatë Luftës, me Brigadën e Njëzetë!, — tha pastaj. — Atëherë ishte një fshat i vogël, por kam dëgjuar se tani është ngritur atje një qytezë sharrëxhinjsh. Janë të pasura me pyje ato anë!...

— Thua, ka spital atje?, — e pyeta.

Ai ngriti supet, pastaj tha:

— Edhe në mos pastë, nevojë për mjek me siguri ka... Spitalin njerëzit e bëjnë. Dëgjomë mua, djalë, ke për të dalë i fituar: më mirë në fillim vështirësitë, se të kalisin.

— Sigurisht, baba!, — u mundova të mos e jepja veten unë.

Pastaj im atë doli, me një pamje të shkujdesur, se kishte mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë atë ditë, kurse nëna mbeti një copë herë e heshtur në divan, me duart të lidhura në prehër, por nuk e shprehu ç'e brente e ç'mendonte. As unë nuk e pyeta. Kur kuturisi të çohej, më vështroi me dhembshuri dhe tha:

— Epo, me faqe të bardhë, more bir!

Më 4 tetor u nisa për në detyrë. Im atë nuk mundi të më përcillte. Ai është përgjegjës turni në një ofiçinë mekanike dhe s'mbaj mend të jetë vonuar ndonjëherë në punë. Në orën gjashtë e një çerek të mëngjesit, si zakonisht, ishte bërë gati për të dalë. Më zuri prej krahu, më mori me vete gjer te pragu i oborrit dhe atje u ndamë. Më shtrëngoi dorën, duke më vështruar ngultas në sy, pastaj më tha:

— Shiko të na nderosh, dëgjove?!... Hajt, udha mbarrë, atëherë!

Më rrahu shpatullat dhe u largua pa e kthyer kokën.

Te stacioni i autobusëve më përcollën nëna dhe vëllai i vogël. Ajo mundohej të tregohej e qeshur, por unë e ndieja se e brente disi meraku që po shkoja të punoja

në një qytezë aq të largët e të vockël, ku binte shumë dëborë, aq sa ndonjëherë bllokonte rrugën për disa ditë.

Edhe unë mundohesha të tregohesha i gëzuar, megjithëse ndieja një lëmsh mallëngjimi në gjoks dhe vështroja i përmallur rrugët, godinat, kalimtarët dhe gjithçka, që më ishte aq e njohur dhe e dashur në atë qytet, në gjirin e të cilit e mbaja mend veten kalama, nxënës, student dhe tani, mjek...

Me këto mendime dhe kujtime po mbushja kohën, ndërsa autobusi ngjitej e ngjitej drejt një qafe, as e para dhe as ndoshta e fundit derisa të arrinim në qytezën time të ardhshme.

— Ja, pothuaj arritëm në Fushë-Bredh, është mu përtej qafës!, — e theu heshtjen fqinji, i cili m'u duk befas i gjallëruar dhe i kënaqur nga ky fakt.

Vështrova orën e dorës. Dy e njëzet. Pothuaj shtatë orë nga Tirana! Pastaj nisa të përgatitesha, duke hedhur vështrime kureshtare jashtë.

— Këtu do të zbresësh edhe ti?, — më pyeti fqinji.

— Po!, — iu përgjigja, disi i hutuar me këtë interesim të vonuar.

— Me shërbim kështu?

— Jo, vij të punoj si mjek, jam emëruar këtu!

— Aha! — Ai më vështroi për të parën herë me vëmendje, bile disi zhbirues, çka më shtoi habinë. — Tiranas je?

Pohova me kokë.

— Bulkur fort!... Të prisnim!

Siç duket, fytyra ime u bë aq e habitur, sa për herë të parë e pashë fqinjin të buzëqeshte, bile në një mënyrë të përzemërt.

— Punoj në këshillin popullor të qytezës dhe më ka rënë në dorë urdhri i emërimit tënd!, — sqaroi ai. — Në mos gabohem, quhesh Fatos Nara.

— Jo, nuk gabohesh, ashtu quhem!, — i thashë.

Sakaq, përtej xhamave të autobusit u shfaqën disa baraka, të rreshtuara në të dyja anët e rrugës. Ishin të veshura me anie pishe dhe të mbuluara me fletë llamarinë të lyera me zift. Më tej u shfaqën disa godina të re-

ja dykatëshe, me mur guri të pasuvatuar, pastaj një oxhak i lartë llamarine, që nxirrte tym të bardhë. Pranë tij më zunë sytë një si kapanon të madh dhe disa radhë stivash me dërrasa.

— Ja edhe Fushë-Bredhi ynë, me stabilimentin e sharrave!, tha — fqinji. — Si të duket?

Unë s'dita ç'të përgjigjesha dhe preferova të heshtja.

— Helbete, Tiranë s'është!, — vërejti ai dhe unë ndjeva një thumb miqësor në timbrin e zërit të tij. — Megjithatë, edhe këtu jetojnë e punojnë njerëz, që s'bi-en më poshtë se ata të Tiranës. Do t'i njohësh. Besomë, s'do t'ia kalosh keq këtu, te ne.

— Fundi, njerëzit kanë rëndësi, ata e bëjnë qytetin!, — thashë.

Sa çel e mbyll sytë arritëm në qendër dhe autobusi qëndroi pranë një lulishteje të vogël, në mesin e së cilës ngrihej madhështor një bredh i moçëm, ndoshta kumbari i asaj qyteze. Jashtë prisnin një tufë njerëz. Disa iu sulën shoferit për ndonjë vend, por të shumtët vështronin me kureshtje pasagjerët që zbrisnin, sikur kërkonin ndonjë të njohur. Pastaj filluan të largoheshin bashkë me pasagjerët që nisën të shetisnin për t'u shpirë.

Fqinji im i çuditshëm më ndihmoi të zbrisja bagazhet, dy valixhe të rënda, një deng dhe një rrjetë me turli ushqimesh, që nëna nguli këmbë të m'i jepte për rrugë. I vendosëm mbi një stol të drunjtë të lulishtes, unë e falënderova bashkudhëtarin dhe hodha sytë me kureshtje rreth e qark. Përveç godinës së restorantit, në katin e sipërm të së cilës mendova se duhej të ishte edhe hoteli, vura re dhe dy godina të tjera dykatëshe, të suvatuara e të lyera freskët. Në fasadën me kolona të njëjës prej tyre, që vendosur një pllakat i madh, me parullën. *Ta presim përvjetorin e Çlirimit me detyra të realizuara.*

— Atje kemi kinoklubin!, — tregoi me dorë bashkudhëtarin, që s'po më ndahej. — Kurse në atë tjetrën ndodhet drejtoria e ndërmarrjes së sharrave. Tani ec të pimë një kafe.

Ai më fliste me dashmirësi dhe unë pata një provë të re se përshtypja e parë ndodh të jetë e gabuar.

— Falemnderit, mos u pengoni me mua, duhet të zë hotel dhe të sistemoj njëherë këto!, — thashë, duke treguar me dorë bagazhet.

— Punë e kollajtë, i rregullojmë!, — tha ai, pastaj u bëri zë dy të rinjve që ndodheshin aty pranë dhe iu lut që t'i çonin të gjitha te një farë Skënderi, pastaj të lajmëronin një farë Ademi që të vinte të na takonte te restoranti, se aty do të prisnim.

— Si urdhëron, shoku Thanas!, — u treguan të gatshëm ata.

Kështu, megjithëse kishim udhëtuar shtatë orë në të njëjtën sedilje, vetëm atë çast mësova se ai quhej Thanas ose, më saktë, shoku Thanas. Më zuri prej krahu dhe më çoi drejt restorantit.

Lokali ishte plot dhe gumëzhinte si një zgjua bletësh. Në krye të sallës shtrihej tej e tej një banak i gjatë, prapa të cilit vërtitej me nxitim një thatim i gjatë e pak i kërrusur.

— Xhemal, dy kafe të rënda!, — porositi Thanasi, duke më ftuar të ulesha në një tavolinë të lirë, pranë banakut. — Kështu pra, ja tek u njohëm edhe me doktorin tonë!, — buzëqeshi pastaj, duke zënë vend përballë meje.

— Do të ishim njohur me kohë, por ju s'para më latë shteg për muhabet gjatë udhëtimit!, — vërejta buza-gaz.

— Më zë makina, e marrtë e mira, dhe mezi e mbajta veten, prandaj!, — sqaroi ai. — Kur janë rrugë të shkurttra, më mirë i bëj në këmbë, por që nga Tirana...

— Ç'punë bëni në këshill?, — e pyeta i shtyrë më fort nga respekti që kishin njerëzit e atyshëm për të.

— Kryetar!, — m'u përgjigj thjesht.

— Pra, te ju u dashka të paraqitem!, — buzëqesha.

— Ja, zëre se u paraqite!, — tha ai.

— Sidoqoftë... hollësitë rreth detyrës, si i ri që jam...

— Kollaj ajo punë. Sistemohu njëherë me banesë, të

kemi ruajtur një dhomë në godinën që u dorëzua tani së fundi, njihi me qytezën dhe me spitalin, — këtu folësi më vështroi një copë herë në sy, — në fakt është një qendër shëndetësore e thjeshtë..., pastaj... këtu jemi. Do të të ndihmojmë, mos ki merak.

Xhemali na solli filxhanët dhe një copë herë heshtëm, duke gjerbur më ëndje kafënë e gatitur mirë. Sakaq ia behu me një frymë te tavolina jonë një burrë i gjatë e i thatë, me flokë të thinjur, të lëpirë me kujdes pas kokës, me sy bojë hiri të futur thellë në zgavra, me hundë të gjatë dhe gojë të madhe. Ai i shtrëngoi dorën me respekt shokut Thanas, pastaj u kthye nga unë si një pikëpyetëse.

— Njihuni! Ky është mjeku i ri, Fatos Nara, kurse ky, Adem Sopot, ndihmësmjeku. Ka dymbëdhjetë vjet që shërben në këto anë!, — na prezantoi Thanasi.

Në fjalët e tij të fundit dhe në mënyrën se si e vështroi Ademin, shqova një si mlllef.

— Gëzohem shumë, gëzohem shumë!, — tha Ademi, me një përzemërsi që kalonte caqet e mirësjelljes dhe zuri vend pranë meje.

— Të lutem, kujdesu që të sistemohet sa më shpejt doktor Fatosi, njihi me spitalin dhe me hallet tona, si të dish më mirë, pastaj... këtu jemi!, — e porositi kryetar Thanasi, pastaj m'u kthye mua: — Për gjithë ç'të kesh nevojë, as mos u druaj, as mos u kurse. E dimë që shëndetësia ka halle shumë, por në radhë të parë ju pastaj dhe së bashku do të mundohemi t'i kapërcejmë. Tani do të më falni, të shkoj të mbledh ca veten, se më ka trullor paq ai i uruar autobus!...

Thanasi na shtrëngoi dorën, pagoi kafetë dhe doli, duke më përshëndetur edhe një herë nga porta. Ademi, pa i përfillur kundërshtimet e mia, shkoi e solli nga banaku dy konjakë.

— Epo, që t'ju urojmë!, — tha. — Gëzuar, doktor, dhe të daltë mbarë!

— Falemnderit!

— Kam dëgjuar nga kryetari se ke mbaruar me di-

plomë nderi!, — vazhdoi, duke përfshirë gotën me gishtë-
rinjtë e tij të gjatë dhe eshtakë.

U detyrova të pohoja me kokë.

— Ç'të degdisën kaq larg, atëherë?

— Edhe kjo qytezë ka nevojë për mjek!, — vëreja
buzagaz.

— Po, po, iku koha e Ademëve me shokë!, — theksoi
ai me një farë hidhërimi.

— S'desha të thosha këtë!, — kundërshtova. — Ju keni
dhënë një kontribut të vlefshëm dhe do vazhdoni të jepni,
se keni përvojë të gjatë dhe...

— Përvoja është përvojë, po diploma është më e
fortë, ama!, — më ndërpreu ai.

Nga timbri i zërit dhe shprehja e fytyrës së tij, m'u
mbush mendja se ardhja ime e kishte lënduar.

— Nuk mbeti asnjë nga kursi juaj në Tiranë?, — pye-
ti me dinakëri Ademi.

— Mbetën disa, sidomos vajza.

— Hm, kurse juve ju ra llotaria këtu! — Ai fërkoj
mjekrën, duke buzëqeshur me keqardhje. — Si s'ju zuri
dora ndonjë numër më fatlum, more mik! Për shembull,
ndonjë Shkodër, Durrës Korçë... — Kishte një farë tall-
jeje në timbrin e zërit të tij.

— S'është çështje llotarie, as fati!, — vëreja.

— Po, po... Siç duket, s'pate ndonjë mik!

— As që më ka shkuar nëpër mend kjo!, — ia pre-
va. — Po s'qesh i zoti të çaj vetë në jetë, harram më qo-
ftë. Vetëm të pazotët dhe të dobëtit ndiejnë nevojën të
mbështeten te miqtë.

— Bravo, doktor, qenkeni parimon!, — buzëqeshi Ade-
mi. — Ju lumtë, për nder, ju lumtë... Fundi, kjo qyteza
jonë s'është e keqe për një vit, dy... Me shoqëri kalohet.
Dini të luani letrat? Ndonjë lojë për të qenë, sigurisht!...
Pastaj, në disa drejtime është mirë këtu. Ju sapo dolët
në rrogë, keni nevojë të visheni e të mbatheni se, helbete,
si student... Nga kjo anë qyteza të jep dorë. Në mensë
hahet pothuaj falas, për t'u veshur, e kalon edhe me

një kostum të dorës së dytë, pastaj, për doktorin, në mos rrjedhtë, pikon!

— I thua nga përvoja jote këto?, — pyeta, qesh e ngjesh.

— Eh, lermë mua, unë e hëngra çairin!, — dredhoi ai. — U plaka tani, po më bien edhe dhëmbët!

— Megjithatë, ia del për mrekulli asaj zogëzës që mban në kuvli!, — u hodh nga tavolina fqinjë një burrë i bëshëm, me treçerekëshe lëkure dhe me duar të përlyera me vaj.

Shokët e tij, siç duket shoferë, shpërthyen në gaz. Ademi shtrembëroi buzët me përçmim, duke ngritur supet dhe vetullat, sikur deshi të thoshte: «S'ke ç'u bën, njerëz të pagdhendur!».

— A keni pasur shumë punë gjatë kësaj stine?, — pyeta, sa për të ndërruar bisedë.

— Jo fort!

— Si kështu?!

— Njerëzit tanë, kur janë vërtet sëmurë, i hipin autobusit dhe shkojnë në spitalin e rrethit!, — sqaroi Ademi. — Ne merremi me ndonjë rast të thjeshtë, me mjekime të rëndomta dhe veçanërisht me ndihmën e parë, pastaj...

— Po problemet e higjienës, të profilaksisë?

— Po, xhanëm, probleme ka, qejf për punë të kesh!, — tha ai, në mënyrë të papërcaktuar dhe disi indiferent.

— Në të ardhmen do të përpiqemi së bashku t'ua kursejmë sa të jetë e mundur më shumë rrugën e qytetit të sëmurëve!, — thashë.

— S'e vlen barra qiranë, bileta bën vetëm dy lekë!, — bëri shaka Ademi.

Vendosa të mos e ngisja më tej muhabetin me atë njeri, i cili kishte filluar të mos më pëlqente. Iu luta të më çonte te banesa ime e ardhshme dhe ai u tregua i gatshëm. U çuam sakaq dhe e bëmë pothuaj në heshtje atë copë rrugë.

— Kjo është dhoma që kanë rezervuar për ju!, — tha ai, duke më treguar me dorë një portë bojëkafe, me tri këmbë shkallë.

Sapo shtyva dorezën e derës, u gjenda në një dhomë të vogël, të suvatuar disi trashë, të bojatisur me një ngjyrë të çelur, diçka midis bizeles dhe së përhimës. Në mesin e njërës faqe ndodhej një dritare me tri kanate, xhamat e së cilës ishin të përlyer me bojë vaji. Pllakat e dyshemesë kishin plot gjurmë llaçi. Ajri që i lagësht dhe kundërmonte erë gëlqere.

— Mund t'i kishin punuar më me kujdes!, — vëreja.

— Mirë edhe kaq!, — tha Ademi. — Ustallarët janë vendas dhe deri dje ishin me dhen.

— Nejse, dalëngadalë do të kualifikohen!

— Atëherë do të ikin që këtej!

— Pse?

Ndihmësmjeku buzëqeshi me njërën cep të gojës dhe unë i dallova një dhëmb të florinjhtë.

— Do të jetosh këtu dhe do ta kuptosh pse!, — ma priti, duke i hedhur sytë gjetkë.

Unë ngrita supet dhe heshta. M'u duk pa vend t'i kërkoja sqarime atë çast. Që të merresha me diçka, kontrollova funksionimin e çelësit të dritave dhe të bravës. U nder një heshtje shqetësuese për të dy. Ai tha se do të shkonte të interesohej që të më sillnin plaçkat. U nguta ta falënderoja dhe ai doli, duke më premtuar se do të shiheshim së shpejti.

Nuk dija ç'të bëja. Iu afrova dritares, çela njërën kanat dhe vështrova jashtë. Përballë shtrihej rruga kryesore dhe pothuaj e vetme e qytetit, me radhën e barakave, ndërmmjet të cilave shquheshin aty-këtu godinat e reja.

«Si të druajtura u dukërkkan këto!, — mendova. — Por, dalëngadalë do t'ua zënë vendin barakave dhe ndoshta mjeku që do të vijë kur të transferohem unë, as që do ta besojë se dikur kjo ishte një qytezë pothuaj e drunj-të!»

Në qiell nxitonin grupe resh të murme e të bardha, që ngatërroheshin njëra me tjetrën dhe zor se mund të përcaktoje në ç'drejtim shkonin. Ishte një ndër ato ditët e vjeshtës kur nuk e gjen dot nëse koha po çelet, apo qielli do të sterrohet edhe më keq do t'ia nisë shiu.

Duke vështruar qiellin, m'u duk se edhe mendimet e mia u ngjasonin reve. Mbresat, kujtimet, e ardhshmjat, më përziheshin tamam si ato. Ja, m'u kujtua befaz ajo salla e leksioneve ku gjëmonin bisedat tona të gëzuara. Ndjeva mall për atë kohë, për shokët dhe shoqet e kursit, për mbrëmjet tona të argëtimit, për ditët e punës vullnetare, për këngët me kitarë të Kiços, për të qeshurën kumbuese të Mirjanës, për ekskursionet dhe shakatë tona, bile edhe për leksionin monoton të pedagogut të patologjisë, të cilit i kishim vënë nofkën «gjinkalla». Kurse tani isha mjek. Më dukej si çudi. Sa e dëshiroja këtë kur isha student, kurse tani lakmoja atë kohë. Më kujtoheshin copëza jete dhe ndieja qysh po kridhesha gjithmonë e më thellë në nostalgjinë e atyre viteve.

«Mjaft, Fatos, se të jetosh qysh ditët e para me nostalgjinë e së kaluarës, nuk është punë e mirë!», — i thashë vetes, ngula vështrimin te një plep i vogël dhe u përpoqa të mos mendoja asgjë. Nuk ia dola. Gjersa je i vetëdijshëm, mendja punon, duke u endur me një shpejtësi të çuditshme nga njëri cak në tjetrin...

Ndërkaq, te kreu i rrugës pashë një njeri që shtynte një karrocë dore të ngarkuar me plaçka. Ndërmjet tyre njoha valixhet e mia. Karrocieri ishte i shëndoshë, me tiparet e një ngritësi peshash.

— T'i solla, shoku doktor!, — tha, me të arritur përballë dritares.

Nxitova jashtë. Karrocieri më buzëqeshte me dashamirësi, me krahët të kryqëzuar mbi gjoksin e vet të gjerë e të fuqishëm.

— Merr valixhet, të tjerat i sjell unë!, — tha me një ton gati urdhërues. Mbërtheu me duar një sustë krevati dhe, me një shkathtësi për t'u lakmuar, e hodhi mbi supë.

Në pak kohë karroca u boshatis, kurse në mesin e dhomës sime u bë një piring me plaçka.

— Sa të bën, të lutem?, — e pyeta karrocierin.

— Asgjë, asgjë!, — qeshi ai. — Unë jam magazinieri i ndërmarrjes së furnizimit të punëtorëve, ku çoi plaçkat

e tua shoku Thanas. Ademi m'u lut të t'i sillja bashkë me pajisjet e tjera të nevojshme. Nga ç'pata në magazinë, të zgjedha më të mirat, se na ke ardhur mik në qytezë.

— Falemnderit, shoku...

— Skënder Topi më quajnë. Tani, po deshe të rregullosh dhomën, ec ta rregullojmë bashkë.

— Mjaft u mundove për mua, ndoshta ke edhe punë.

— Mos ki merak, s'më mbeten punët pa bërë. — Ai s'priti më, shtriu dorën dhe lëvizi nga vendi njëren prej valixheve. — More, more, sa e rëndë qenka! Ç'ke në të, armë?, — buzëqeshi.

— Libra!

— Libra, hë? Të gjithë i ke lexuar?

— Janë librat e zanatit!

— More, more, si t'i ka nxënë koka, bre?! Por, vërtet, s'është kollaj të bëhesh doktor. Zanat, për kokë të zanatit.

— Çdo zanat është i mirë, po e pate me qejf, — vëreja.

— Pse, ky imi, zanat është?, — tha ai me përçmim.

— Mos ta kanë dhënë me zor?, — buzëqesha.

— Posi, ore, me zor!... S'e beson? Dëgjo këtu, atëherë: Isha sharrëxhi, lidhës trupash në gatra. Mrekulli. Po ja që magazinieri që ishte para meje qëlloi edepzës dhe vodhi. Mirëpo, më gjeti belaja mua. Më thirrën dhe më thanë: «Skënder, ti ke mbaruar tetëvjeçaren, lapsit ia thua disi, besimin ta kemi, prandaj do ta marrësh ti këtë punë!» Në fillim s'pranova, por më detyruan, se ma mblodhën me politikë. Kështu, më kanë futur si ariun në kafaz.

Ndërsa fliste, ai vërtitej dhe punonte me shkathtësi. Unë luaja më tepër rolin e ndihmësit. Brenda një ore dhoma ndërroi pamje. Dukej më e ngrohtë dhe më e bukur. Vetëm mungonin një palë perde, se nga rruga shihesh skaj më skaj.

— S'doli keq!, — vërejti Skënderi, duke marrë me dorë në zemër një cigare nga paqeta ime. — Veç, duhet pastruar ca. Po shkoj t'i them komshies, teto Zogës.

S'priti miratimin tim. Doli rëndë-rëndë dhe u kthye pas pak, bashkë me një plakë të shkurtër e të thatë. Ajo ecte serbes dhe dallohej që po vinte me qejf. Kur arriti përballë meje, mbështeti fshesën pas murit, vuri njërën dorë në mes dhe tjetrën strehë mbi vetulla dhe tha, duke më vështruar në bebe të syrit:

— Po ti qenke fare i ri, more doktor djali! Shkollë ke mbaruar?

— Po, Universitetin.

— Bukuri. Ja, u bë edhe vendi ynë të nxjerrë doktorë. Kujt ia priste mendja njëherë e një kohë!... Po nuse, a ke?

— Jam beqar!

— Mrekulli! Ç'të lipset belaja kaq i ri?! Ke kohë për martesë, se burrit s'i shkon koha. Ç't'u bësh leshprerave tona, që vyshken nëpër shkolla, pastaj na e mbajnë hundën përpjetë, gjersa të na mbeten në prag! — Pastaj, si vështroi dhomën me sy nikoqireje, tha: — Tani dilni e pijeni cigaren jashtë, se do të filloj fshesën.

— Të vumë në mundim, nënë!, — thashë.

— Ç'është ajo fjalë!, — kundërshtoi ajo. — Ti vjen nga anë e anës të na shërbesh neve dhe punë e madhe se do të të fshijmë një dhomë!

— S'i paska me sy të mirë vajzat me shkollë!, — i thashë Skënderit, kur dolëm jashtë.

— E, ku e ka hallin ajo, — foli ai. — Burri i ka vdekur me kohë dhe e ka lënë me një vajzë, që tani është mësuese në shtatëvjeçaren e këtushme. Deshi ta fejonte me një mekanik të sharrave, me mblesëri, por e bija nuk pranoi.

— Aha, tani e mora vesh!, — buzëqesha.

Nisi të frynte erë e lagësht dhe e ftohtë. Dielli po zbriste prapa një mali që ngrihej mu rrëzë qytezës dhe maja e tij flakëronte.

— Si quhet ky mal?, — e pyeta Skënderin.

— Mali i Bredhishtës!, — m'u përgjigj. — Ja, prapa atij e kam shtëpinë. Mban pesë orë të mira në këmbë. Ja shkoj, ja s' shkoj një herë në javë, sipas punës.

— Pse se merr familjen këtu?

— Po kooperativën kush do ta mbajë? Në qytezë banojnë vetëm të ardhurit. Ne, sharrëxhinjtë, shumica në fshat i kemi familjet.

«Kurse unë e kam në Tiranë!», — mendova.

Të ftohtët po më sillte mornica dhe u kopsita gjer në grykë.

— Malësi këtu!, — buzëqeshi Skënderi. — Veç është klimë e mirë, tamam për kamp pushimi.

— Lum si unë, atëherë!, — bëra shaka.

Te pragu doli plaka me fshesë në dorë.

— Ta bëra dritë!, — tha.

— Të lumshin duart, nënë!

— I lumur qofsh! Ty do të të kemi si djalë kimeti, se ke ardhur të na shërosh. Ja, ka disa vjet që po më ther mesi dhe s'më ka bërë njeri derman... Shiko, kur të kesh nevojë për gjë, më thuaj, more vesh?

— Mirë, nënë, falemnderit!

— Ashtu, biri i nënës! Tani shkova.

Iku bashkë me Skënderin. Unë hyra në dhomë, e cila nisi të më dukej më e ngrohtë. Rregullova disa cikërrima, pastaj vendosa të dilja nëpër qytezë. Kyça derën nga jashtë dhe zbrita në rrugë. Zhavorri filloi të kërciste nën këmbët e mia. Muzgu e kishte kredhur gjithçka në një dritë të mekët, kaltëroshe. Prej diku vinte zëri i një radioje, që transmetonte muzikë të lehtë.

Brenda pesë minutash arrita në qendër.

«Ja një e mirë e qytezës, arrin shpejt e shpejt ku të duash, pa pasur nevojë për autobus urban!», — bëra shaka me vete.

Të gjithë stolat e lulishtes ishin plot. Disa ishin ulur e po bënin muhabet edhe në shkallët e kinoklubit. Të tjerë shëtisnin aty pari. Ca fëmijë ndiqnin njëri-tjetrin dhe mbushnin sheshin me britmat e tyre të gëzuara. Njerëzit shkëmbenin ndonjë fjalë a përsëndetje kalimthi, diku bashkoheshin kokë më kokë, gjetiu shpërndaheshin dhe vazhdonin shëtitjen. Dukej sikur një familje e madhe kishte dalë për pushimin e mbrëmjes. Vura re se

mjaft prej tyre më vështronin me kureshtje, bile ndonjëri kthente kokën. Mendova se shumica e dinin tashmë cili isha dhe pse kisha vajtur. Për të parën herë po e shikoja veten në qendër të vëmendjes dhe ky mendim më bëri të buzëqeshja, ndoshta edhe të krenohesha disi. Nga ana tjetër, nuk ndihesha mirë ashtu, i vetmuar, dhe kërkova me sy ndonjë prej të njohurve të mi të paktë. Kur po i dilja sheshit në skaj, pashë Thanasin që po më buzëqeshte së largu dhe nxitova drejt tij, i kënaqur. Ai po shëtiste me një burrë të moshuar.

— Hë doktor, a u sistemove?, — më pyeti, duke më shtrënguar dorën.

— Po, fare mirë bile. Falemnderit për kujdesin!

— Ky është Andon Teli, ose xha Andoni, siç e thërresim të gjithë!, — ma prezantoi tjetrin. — E kam pasur mësues dhe tani e kam ballin e miqve. Kemi ç'mësojmë të gjithë prej tij.

— E, mirë, de, mirë!, — e ndërpreu me dashamirësi Andoni dhe më zgjati dorën, buzagaz. — Ty të kishim në gojë, kështu që të kam mësuar emrin, mbiemrin dhe profesionin!, — m'u drejtua me një të folur të shtruar e të qartë, prej mësuesi të vjetër.

Më bënë përshtypje sytë e tij të kaltër e të thellë, që i shndritnin plot mirësi pas xhamave të syzeve me rreth të hollë metalik. Kishte një ballë të lartë, me rru-dha të thella e të kurorëzuara me ca flokë të qethur shkurt dhe pothuaj krejt të thinjur. Duhej të ishte rreth të gjashtëdhjetave.

— Xha Andoni vazhdon të jetë mësues, ndonëse e ka mbushur prej vitesh moshën e pensionit!, — më tregoi Thanasi, ndërsa nisëm të shëtisnim të tre së bashku. — S'pranon kurrsesi t'i lërë orët e mësimit, megjithëse i jemi lutur kaq herë, si ne, si i biri.

— Ej, posi, rrihet duarkryq në një kohë të tillë!, — ndërhyri xha Andoni.

— I treguam me se të na ndihmonte si pensionist, por këtij s'i ndahet shpirti nga shkolla, kështu që tani u mëson aritmetikë edhe fëmijëve tanë!, — vazhdoi Thanasi.

— Ku ka më bukun! Në mes të ririsë s'e ndien kurrë pleqërinë!, — buzëqeshi xha Andoni.

Ndërsa po ecnim me nge rrugës kryesore Thanasin e lajmëruan të shkonte në zyrë për një problem.

— Kështu e ka kjo puna jonë, — rrudhi supet Thanasi ndërsa i zgjati dorën xha Vasilit e pastaj mua.

Shëtitem një copë herë dhe biseduam si të ishim miq të vjetër, me xha Andonin, pastaj ai tha se qe vonë dhe ishte ftohtë, prandaj propozoi ta mbyllnin me 'aq për atë mbrëmje.

— Ku do të shkoni tani?, — më pyeti xha Andoni, kur u mata t'i jepja dorën.

— Në restorant, të ha darkë!, — iu përgjigja.

— Vetëm?

Ngrita supet, se s'dita ç'të thosha.

— Në asnjë mënyrë! Do të vish tek unë. Bukë e kri-pë e zemër të mirë.

Nisa ta falënderoja, por ai, që e kuptoi ç'do të thosha pas falënderimeve, më ndërpreu në mënyrë autoritare, por me dashamirësi dhe më paralajmëroi se çdo kundërshtim ishte i kotë.

Kur hymë në shtëpinë e tij, ndjeva një kundërmim të lehtë borziloku. Më çoi në dhomën e zjarrit. Vura re një sergjen të madh e të lashtë, plot libra dhe fletore. Në njerin skaj të tij ndodhej një vazo e kristaltë me lule mali. Më tej ishte vendosur një raft me pasqyrë, gjithashtu i madh e i lashtë.

— Urdhëro e ulu, djalë!, — më ftoi xha Andoni, duke më treguar një minder të mbuluar me një velenxë flokëgjatë.

Ndjeva se u ula mbi një dyshek të trashë leshi. Më shkuan sytë te tavolina e mesit. Ishte prej dru panje, e gdhendur me shijë. Mbi të qe shtruar një mësallë mëndafshi e endur në vegjë dhe e qëndisur anash me lule të holla shumëgjyreshe. Gjithçka në atë shtëpi dukej e lashtë, por e bukur dhe e pastër. Të ngjante sikur ndodheshe në një familje qytetare të jugut, gati një shekull më parë.

Xha Andoni i futi një dru sobës, pastaj diç bëri pra-
pa derës së dollapit. Solli në tryezë dy gota, një pjatë
me copa djathi dhe një shishe raki. I mbushi gotat me
kujdes, më afroi njërën syresh, pastaj uroi:

— Për shëndetin tënd, Fatos! Suksese në punë e në
jetë!

— Falemnderit dhe me shëndet qofsh, xha Andon!

Unë vështrova disi i habitur rreth e qark. Nuk e
besoja se në një shtëpi aq të mirë, të shtruar e të rregu-
lluar mund të jetonte një plak i vetmuar. Ai ndoshta e
kuptoi dhe tha, duke buzëqeshur hidhur:

— Mos e prit të zonjën e shtëpisë, ka dhjetë vjet që
s'është më!, — Në sytë e tij të kthjellët kaloi një re tri-
shtimi. — Tani për tani jam vetëm. Në shtëpi, dua të
them, se njeriu s'mbetet kurrë vetëm, në mos e kërkoftë
vetminë. Një djalë që kam, është në Universitet. Mot
mbaron për inxhinier mekanik. U jam lutur të ma emë-
rojnë këtu, në sharra. Do ta martoj dhe do të pres ni-
përit e mbesat. Ndoshta, atëherë do të më mbushet
mendja t'i lë orët e mësimit.

— Ju jeni vendas?

— Pothuajse vendas u bëra. Me origjinë jam nga Gji-
rokastra, por kam ardhur këtu shumë vjet më parë, sapo
mbarova normalen. Ti atëherë as që kishe lindur!, — bu-
zëqeshi ai. — Këtu ishte një fshat fare i vockël dhe...

— Do ta keni pasur vështirë!

— Nuk ishte lehtë! — Xha Andoni uli qepallat i me-
nduar. — Ja, më kujtohen si tani ato kohë, megjithëse
kanë kaluar tridhjetë e ca vjet. Tek oborri mbledheshin
çdo mëngjes nja njëzet fëmijë e ndër ta rrallë të zinte
syri ndonjë që s'i kishte mishrat jashtë. Kur qe kohë e
bukur, luanin gjithë gaz në oborr dhe unë rrija i vështro-
ja. Nganjëherë më vinte keq t'i bija ziles, se do t'u
prishja lojën. Kur binte shi, vinin në klasë të qullur, me
nga një dru nën sjetull. Ndiznin sobën prej llamarine dhe
mbledheshin rreth saj. Duart e mërdhira i mbanin përpa-
ra fytyrës, që të mbroheshin nga afshi i llamarinës. Kë-
mbët e z bathura i përplasnin në dysHEME, që t'u ngro-

heshin e t'u shpiheshin. Fillonim mësimin mbasi qenë tharë. M'i ngulnin ata sytë e tyre të shndritshëm si xixëllonja dhe më dukej sikur përpinin çdo fjalë që dilte nga goja ime...

— I paske dashur shumë fëmijët, xha Andon!, — vëreja.

— Po. Në të vërtetë, s'ka mësues që të mos i dojë nxënësit e tij. Edhe për ata më çapkënët, që të ngjirin duke u thirrur, të merr malli kur s'i ke më pranë... Por sidomos ata nxënësit e atëhershëm i kam mu këtu! — Ai mbështeti pëllëmbën në zemër. — Ndoshta sepse kalova bashkë me ta kohë të vështira, ndoshta sepse janë të lidhur me rininë time... Më kujtohet si ndihesha i vetmuar kur mbaronin orët e mësimit dhe shkolla boshatisej. Mezi prisja të nesërmen. Me të dëgjuar zërin e të parit që vinte, çelja dritaren dhe i vështroja qysh vinin...

— I mban mend të gjithë, xha Andon?

— Ah, jo! Zakonisht mbahen mend më të mirët, ose ata më çapkënët. Shkojnë vitet, ata janë rritur, kanë ndryshuar, kurse unë... unë u plaka, megjithëse rrallë e pranoj këtë!, — Ai i tha fjalët e fundit si të më besonte ndonjë sekret të madh.

— Nxënësit me siguri ju kujtojnë të gjithë!

Mësuesi plak buzëqeshi ëmbël dhe plot krenari.

— Ehu, sa herë më ka qëlluar të më dalë përpara ndonjë i panjohur, të më zgjatë dorën dhe të më thotë: «Si je, xha Andon? S'më mban mend? Më ke pasur nxënës në aksh vit!»

— Kjo është një kënaqësi e madhe!

— Është shpërblimi më i bukur i jetës sime. Dhe s'jam aspak pishman që e kalova pothuaj gjithë këtë jetë në një qytezë të tillë, të largët. Kryesorja është që, kur të plakesh dhe të kthesh sytë nga e kaluara (dhe sa më shumë plaket njeriu, aq më shpesh e bën këtë), të mos të të skuqet faqja. Për t'ia arritur kësaj, nuk ka rëndësi në ke punuar në kryeqytet, apo në një qytezë të tillë... Hajd ta mbushim edhe nga një gotë. Është e

mirë, apo jo? Unë s'e vë fare në gojë po s'qe e mirë.
Kjo për qejf pihet!

Hëngrëm darkë, biseduam edhe një copë herë, pastaj kërkova lejë të çohesha. Xha Andoni më përcolli gjer te dera e kopshtit dhe ma përsëriti shumë herë që ta vizitoja sa më shpesh. U largova së andejmi me një ndjenjë të bukur e të ngrohtë.

Jashtë bënte goxha ftohtë dhe prandaj nxitova hapat. Nga krei i shtyllave të drunjta, llambat elektrike lëshonin tufa rrezesh verdhoshe, që rrethonin me një kurorë të ndritshme hijen time, e cila zgjatej dhe shkurtohej, zbehej dhe theksohej. Në muret e pasuvatuara të shtëpive të reja dhe në faqet e drunjta të barakave, dritaret shquanin si njolla të shndritshme.

U mundova të imagjinoja se ç'ndodhte atë çast pas atyre dritareve. Ata njerëz, krejt të panjohur tani, do të hynin dalngadalë në jetën time, me hallet dhe shqetësimet e tyre.

Kur hyra në dhomë dhe çela dritën, sytë më shkuan tek ora e komodinës. Tetë e gjysmë. Kur isha student, shpesh në këtë orë dilja për t'u argëtuar, kurse tani më dukej vonë, shumë vonë. Vendosa të futesha në shtrat dhe të lexoja. U detyrova të fikja dritën që të zhvishesha, se dukeshja nga jashtë.

«Qysh nesër do të blej kambrik për perde»!, — u zotova me vete.

Nuk më eci leximi. Ndiqja me sy radhët, por pak gjë përvetësoja. Një copë herë këmbëngula, duke iu rikthyer paragrafëve, por pastaj hoqa dorë. Ndihesha i shqetësuar, bile më fort se një natë më parë.

«S'kam faj, rruga e jetës që do të filloj nesër është më e gjata dhe më e vështira nga të gjitha!», — mendova.

2

Të nesërmen në mëngjes shkova në spital.

Gjatë vitit të fundit të fakultetit dhe sidomos kur prisja emërimin, shpeshherë kisha menduar për ditën e

parë të punës. Përfytyrimet e mia ushqeheshin sidomos nga mbresat e spitalit dhe të njësive të tjera shëndetësore të Tiranës, ku kishim zhvilluar praktikat. Veç tyre, kisha parë, kur isha vullnetar në hekurudhë, edhe ambulancën e kantierit, por, fundi, ajo s'ishte veçse një ambulancë provizore. Prandaj, kur përfytyroja spitalin ku do të punoja, më dilnin para syve ndërtesa të bukura, qofshin edhe jo me shumë kate, me pavione të gjera e të ndriçuar mirë, me pllaka që shkëlqenin dhe mure të lyera gjer në mes me bojë vaji, me shtretër të rreshtuar bukur, me nga një komodinë ndërmjet kokave dhe ngado të verbohin bardhësia e pastërtia. Mjeku që do të më shoqëronte, për të më dhënë në ngankim pacientët, do të ishte një koleg me përvojë, ndoshta i thinjur e me syze. Ai do të më jepte hollësira për çdo të sëmurë, ndoshta diku më shumë e diku më pak nga ç'më nevojitesh, sepse sigurisht ai e kishte harruar kohën kur kishte qenë vetë mjek fillstar. Aty-këtu unë do ta pyesja me takt, gjoja më fort për diskutim, që ai të mos kujtonte se isha i papërgatitur mirë...

Spitali ishte një godinë njëkatëshe prej guri, në trajtë paralelpipedi të gjatë, me çati të pjerrët, që sikur e ndrydhte nën vete, e sherbetosur me gëlqere dhe e rrethuar me një gardh prej listelash pishe. Nga jashtë s'dukej keq, por sa kalova pragun, mbeta i zhgënjyer.

Korridor, që ndriçohet dobët vetëm nga dritarja e vogël përmbi portë, ishte i ngushtë, i shtruar me çimento të lustruar shkel e shko dhe me mure të ngjyera gjer në brez me bojë vaji të errët, diçka midis jeshiles dhe blusë. Dyert, me të njëjtën bojë, ishin të gjitha të mbyllura, me përjashtim të njëjës, ku u shfaq Ademi, me bluzë të bardhë. Ai nxitoi drejt meje dhe më uroi mirëseardhjen me një buzëqeshje e përzemërsi të tepruar që, ndoshta për këtë arsye, m'u duk disi tallëse.

Në dhomën e mjekut më zuri syri një tavolinë të vjetër, të lyer dikur me bojë vaji të bardhë, një karrige të përforcuar me gozhdë, një raft të madh plot shishe, kuti dhe letra, një shtrat të thjeshtë vizitash, të mbu-

luar me batanije të murme dhe dy pllakate sanitare, të zverdhura nga dielli.

U ula pranë tavolinës dhe nisa të shfletoja kot regjistrin që m'u ndodh përpara. E ndieja se duhej të bëja diçka, të thosha diçka, por goja më qe kyçur dhe më kishte mbërthyer një ngathësi e çuditshme.

Ngrita sytë nga regjistri, ku s'lexova asgjë dhe fillova të vështroja dollapin e madh. Më ra në sy çrregullimi që zotëronte aty. Ademi që, siç dukej, e kishte kuptuar gjendjen time, qëndronte përballë dhe buzëqeshte lehtë, disi ironik. Kjo ma shtoi shqetësimin.

Sakaq krisi dera dhe u shfaq te pragu një grua e moshuar, me përparëse të bardhë dhe me flokë të lidhur me napë. Në dorë mbante një përparëse tjetër.

— Mirë se na erdhët, doktor!, — më uroi me buzëqeshje të çiltër dhe me një farë habie, që ndoshta ia diktonte pamja ime prej çunaku.

Brofa në këmbë, si i çliruar nga një peshë ndrydhëse dhe i shtrëngova dorën me përzemërsi.

— Të kam sjellë nga magazina një përparëse të re!, — tha ajo, duke ma zgjatur. — Nuk di si do të të rrijë, megjithëse u mundova të ta zgjidhja sipas trupit. Të pashë mbrëmë, në shëtitje. Sikur ta provoje njëherë.

— Paske sy të mpreshtë, ma ke zgjedhur mirë!, — i thashë, mbasi e vesha dhe e vështrova me kujdes.

Asaj iu bë qejfi. Më ndreqi një rrudhë, këputi disa fije penjsh, më tërhoqi njëren mëngë, pastaj u zmbrops dy hapa dhe më vështroi e kënaqur.

— E grissh me shëndet!, — uroi pastaj.

E falënderova, pastaj u ktheva nga Ademi dhe iu luta të më njihte me spitalin dhe me personelin.

— Si urdhëron, doktor, menjëherë!, — brofi i gatshëm ai.

Dolëm së bashku në korridor.

— Pse nuk kanë lënë një dritare në skajin tjetër të korridorit, që të kishte më shumë dritë?, — vërejta.

Ademi ngriti supet, sikur deshi të thoshte se kjo punë nuk i takonte atij.

— Thua, është vështirë për ta çelur?, — ngulmova.
— Si të dëshironi!, — tha ai dhe çeli derën e infermierisë.

Sakaq vura re një vajzë të gjatë dhe fare të re, që erdhi drejt nesh me një buzëqeshje disi të druajtur.

— Lina është punonjësja jonë më e re!, — ma paraqiti Ademi. — Vjet mbaroi shkollën unike, kurse sivjet kreu edhe kursin njëvjeçar të infermierëve. Është vendase, nga fshati i Fushë-Bredhit.

— Bukuri, kështu duhet!, — thashë. — Do të vijë koha që edhe mjekët të jenë vendas.

Hodha sytë rreth e qark. Edhe aty kishte pajisje të vjetra e të dalaboje, por vërehej puna e një dore të kujdesshme.

— Ia bëre injeksionet Ruzhdiut?, — pyeti Ademi.

— Ja, tani!, — iu përgjigj ajo, duke treguar me dorë enën ku po vlonte shiringën, mbi një furnelë elektrike.

Në dhomën e patologjisë ndodhej vetëm një i shtruar, pra Ruzhdiu. Iu drejtova me emër, e pyeta si ndihej, pastaj u interesova për diagnozën dhe për anamnezën.

— Shkoi në punë me bronkit, e në ç'punë se, lidhës trupash në stabilimentin e gatrave, dhe iu bë bronkopneumoni në të dyja anët!, — më sqaroi Ademi.

— Ishim keq me plan, bre!, — ndërhyri Ruzhdiu.

— Ej, posi, posi! Thuaj që kështu e keni zakon ju, e nënvleftësoni sëmundjen!, — ia preu Ademi.

E vizitova me kujdes. Dëgjoheshin vetëm disa rale të dobëta në mushkërinë e majtë.

— Paske përmirësim të madh, së shpejti bëhesh qiçër!, — i thashë.

— Hë, të lumtë goja!, — u gëzua ai.

Mora kartelën dhe këqyra mjekimin. Antibiotikë, injeksione me vitaminë dhe vaj peshku.

— Si shumë e keni rënduar me injeksione, vitaminat mund t'ia jepnit tableta!, — i thashë Ademit kur dolëm jashtë. — Pastaj, pse vaj peshku?

— Ma kërkoi vetë dhe, meqë na u ndodh... Këta, vendasit, e kanë ballin e ilaçeve vajin e peshkut. Sa dë-

gjojnë që ka ardhur në farmaci, na zënë derën. Kurse për injeksionet... kështu i do mushka drutë. Po s'i shpove, zëre se s'i ke mjekuar. Nuk kanë hiç besim te kokrrat.

— Mendoj se nuk duhet të udhëhiqemi nga paragjykimet e pacientëve në këto punë!, — thashë. — Përkundrazi, t'i sqarojmë, t'i bindim me durim.

— Ku u mbushet koka këtyre, doktor!

— Megjithatë, e kemi për detyrë...

— Edhe unë ashtu mendoja në fillim, por pastaj u lodha dhe hoqa dorë!, — tha Ademi, me një buzëqeshje të hidhur. — Ju vini me forca të reja dhe, ndoshta...

Në fjalët e tij të fundit, përveç mosbesimit, ndjeva edhe një ironi disi shpotitëse.

— Po kjo dhomë përse shërben?, — pyeta, duke vënë re se ai kapërceu një derë.

— Ah, po!, — bëri sikur u kujtua Ademi. — Është farmacia, që shërben si për spitalin, ashtu edhe për qytetarët, po farmacisti ndodhet me leje.

— Ka lejen e zakonshme?

— Jo, ka shkuar të çmallet me kalamajtë, me familjen, se i ka në Tiranë dhe, helbete...

— Po sot është mes jave!, — u habita. — Kush i jep këto leje të tilla?

— Shoku Thanas, por hollësitë i ndreqim midis nesh, zëvendësojmë njëri-tjetrin, kështu që kur të keni nevojë...

— Ai buzëqeshi në mënyrë konfidenciale, gjoja sikur nuk e kuptoi sensin e pyetjes sime.

— Kush e zëvendëson farmacistin, për shembull?

— Unë!

— Ti!?, — u habita.

— Kam pesëmbëdhjetë vjet në këtë profesion dhe besoj se jam në gjendje ta kryej këtë punë për disa ditë!, — ma priti ai, i prekur në sedër.

— Po mamia ku ndodhet, apo mos ke marrë për-sipër ta zëvendësosh edhe atë?, — pyeta, gjoja me shaka.

— Dhomat e shtëpisë së lindjes janë në këtë anë!, — tha ai, i pezmatuar, duke kaluar në krahun tjetër të

korridorit dhe i mëshoi me nervozizëm dorezës së një dere.

Mamia, e zënë në befasi, brofi, duke mbyllur me rrëmbim sirtarin e tavolinës.

— Nuk paskeni asnjë lindje, si duket!, — vëreja, pas paraqitjeve të rastit.

— Dhe as që presim gjë këto ditë!, — u përgjigj mamia, një grua e kolme, rreth të tridhjetave, me pamje autoritare. — I njohim një për një gratë e këtushme, se kaq është qyteza jonë! — Ajo mblodhi dorën grusht.

— Gjystinën e kemi të zonjën dhe me përvojë!, — theksoi Ademi.

— Gëzohem... Po në fshatrat rreth qytezës, nuk ka gra që presin të lindin?, — pyeta, duke vënë re me bisht të syrit se sirtari kishte zënë pisk cepin e një punëdo-reje.

Mamia ngriti supet, e zënë ngushtë.

— Dhe meqë s'presim ndonjë rast nga qyteza, pse të mos shkojmë në fshat, qoftë edhe për të zhvilluar ndonjë bisedë me gratë shtatzëna, ose me ato që kanë fëmijë në gji?, — vazhdova.

— Edhe kemi shkuar, por keni të drejtë; më shumë duhet të shkojmë, aq më tepër se në fshat ka gra që lindin pa ndihmë mjekësore!, — tha Gjystina. — Unë jam e gatshme, por kjo punë do programuar nga drejtorja e qendrës shëndetësore, se kështu, në mënyrë spontane... — Ajo ktheu një hop sytë nga Ademi, i cili nisi ta vështronte me qortim.

Në dhomën e sëmundjeve ngjitëse nuk kishte njeri, kështu që u rikthyem në dhomën e mjekut. Më shkuan përsëri sytë te rafti i ndihmës së shpejtë.

— Në ç'orë fillojnë vizitat?, — pyeta Ademin.

— Në dhjetë e gjysmë, por nuk i lëmë nevojtarët të presin, edhe kur vijnë më parë!

— Paskemi edhe dy orë e gjysmë kohë!, — vëreja, duke i hedhur sytë orës së dorës. — Që të bëjmë një punë të dobishme, a s'fillojmë me sistemimin dhe pastrim-

min e këtij rafti? Më fal, por s'e shoh dot në këtë holl që është!

— Epo, dihet, fshesa e re fshin gjithmonë më mirë!,
— tha Ademi me një buzëqeshje të shtirur.

— Bile, do të jetë mirë që edhe shoqet të mos rrinë duarlidhur, por t'i bëjnë një pastrim rrënjësor korridorit dhe të zëvendësojnë të gjitha parullat e pllakatet e vjetëruara, si kjo, — tregova me dorë njërin, ku shkruhej: *Pastërtia është shëndet*, — e cila diskrediton përmbajtjen e vet.

— Si të urdhëroni, po shkoj t'u them!

Ai doli, me sytë përdhe. Nuk arrinte ta fshihte zemërimin.

«Ca më keq për të, në s'i kupton drejt këto kërkesa», — thashë me vete dhe fillova të merresha me sistemimin e raftit. Ndërsa po nxirrja prej tij plot letra të kota, shishe dhe kuti ilaçesh bosh, krisi dera dhe dëgjova një zë femre që pyeti:

— S'është këtu Ademi? Ju lutem, ku mund ta gjej?

Ktheva kokën dhe pashë një grua të veshur me sqimë. Kishte sy të zinj, të mëdhenj, hundë të gjatë e të drejtë dhe një gojë me buzë të trasha.

— Urdhëroni brenda, tani vjen, — i thashë.

— Jam e shoqja, Liliana!, — u paraqit ajo, duke më zgjatur dorën me një buzëqeshje disi lozonjare. — Ju jeni mjeku i ri, Fatos Nara, apo jo?

— Po, unë jam.

Ajo më vështroi një hop me kureshtje dhe në mënyrë hetuese, pastaj tha:

— Më tregoi im shoq për ju. Ai është i gëzuar që do të punojë me një mjek që premtun.

«Kurse mua më duket e kundërta!», — mendova, ndërsa po i afroja një karrige.

— Të na urdhëroni edhe nga shtëpia, doktor!, — më ftoi ajo, me një ton të theksuar mirëdashës. — Ju siguroj se do të gjeni një qoshk të këndshëm, në këtë qytezë të mërzitshme.

— S'kam pasur kohë të mërzhitem, sapo erdha!, — buzëqesha.

— Vërtet, sapo erdhët... kurse unë, që kam dhjetë vjet në këtë humbëtirë..., — ajo uli sytë e hidhëruar, — jua qaj hallin, sidomos juve, që jeni i ri dhe kryeqytetas... Por, ishalla transferoheni shpejt.

— Puna mbi të tëra!, — thashë dhe, duke vërejtur hidhërimin e Lilianës, më shkoi mendja te xha Andoni, që dëshironte të emërohej edhe i biri aty. — Ndoshta, edhe këtu mund të kalohet mirë, varet se nga ç'kënd e vështron jetën!, — shtova pastaj.

— Më pëlqen optimizmi juaj!, — tha ajo dhe buzëqeshi, siç buzëqeshet me një naiv.

Ndërkohë u kthye Ademi. Vura re se nuk i pëlqeu aspak që e gjeti të shoqen pranë meje. Ajo brofi nga karrigia dhe i doli përpara. Duke i vërejtur pranë njëri-tjetrit, mendova se duhej të kishin diferencë të madhe moshe.

— Të lutem, porosit ndonjë shofer të më blejë tre metra stof si ky në qytet!, — i tha ajo, duke nxjerrë një mostër nga çanta e dorës.

Ademi e futi në xhep, pastaj m'u drejtua thatë dhe zyrtarisht:

— Ato filluan punën!

— Shumë mirë, falemnderit!

— Më falni, të përcjell pak shoqen.

— Ju lutem!

— Mos harroni, ju presim!, — tha Liliana dhe doli, duke u tundur lehtë.

Gjatë orarit të vizitave erdhën nga dhjetë vetë. Asnjëri s'kishte gjë të rëndësishme. Një nënë e re shqetësohej pse po i vonoheshin dhëmbët e parë foshnjës së vet. Një plak ndiente të therrura në vendin ku kishte pasur dikur një ftohje dhe m'u lut ta dëgjoja. Një i tretë nxori nga xhepi ilaçet që i kishte rekomanduar Ademi dhe më pyeti në ishin të mira. Mendova se shumica kishin ardhur më fort që të njiheshin dhe të konsultoheshin me mjekun e tyre të ardhshëm, dhe më erdhi mirë. I vizi-

tova me kujdes dhe u dhashë të gjithëve këshillat e duhura. M'u duk se ikën të kënaqur.

Me të mbaruar vizitat, bëra disa shënime të tjera në bllokun e xhepit dhe shkova në zyrën e kryetar Thanasit.

— E, doktor, ç'përshtypje dhe mendime ke për spitalin tonë? — u interesua ai.

— Ndoshta është herët për të shfaqur mendime!, — u përgjigja. — Po...

— Fol, fol, po të dëgjoj. Nganjëherë përshtypjet e para janë më të saktat, se pastaj ndodh që mësohesh me të metat..., megjithëse, uroj të mos jesh nga ata! — buzëqeshi Thanasi.

— Po... spitali mund të mbahet edhe më mirë!, — nisa të flisja, i matur.

— Pa dyshim, ashtu u kam thënë edhe unë, se kaq gjë mund ta vërej!

— Prandaj erdha, t'ju pyes a mund të na ndihmoni që ta përtërijmë ose ta riparojmë një pjesë të inventarit.

— Pa tjetër!

— Dhe, në pastë mundësi, të na jepni nja njëzet kile bojë vaji të bardhë, ose me ngjyrë të çelët, se me ato ngjyra të errëta që ka, spitali duket i zymtë, jo siç i ka hije një spitali. Ndoshta kjo s'është themelorja, por, gjersa të njihem me problemet e tjera...

— Drejt e ke, po s'dite të mbash shtëpinë tënde, qysh do të kujdesesh për shëndetin e tjetrit?!... Edhe ndonjë bojaxhi mund t'ju gjejnë, megjithëse jemi ca ngushtë për zanatçinj të mirë.

— Këtë punë e bëjmë vetë, me punë vullnetare. Bisedova me personelin dhe u treguan të gatshëm.

— Bukur fort, atëherë...

— Ja edhe lista e kërkesave! Mos janë shumë?

— Le të jenë, t'i dimë njëherë!, — tha ai, duke i hedhur një sy fletës që i dhashë. — Do të përpiqemi t'ju plotësojmë. Edhe në mos paçim në magazinë, do t'u lute mi atyre të ndërmarjes së sharrave të na ndihmojnë.

— Përveç kësaj, desha të më flisni diçka për bashkë-

punëtorët e mi!, — vazhdova. — U njoha sot me ta por, si të thuash, vetëm për fytyrë.

— Po, ke të drejtë!, — miratoi Thanasi, duke tundur kokën. — Unë me qëllim s'erdha vetë të të paraqitja. Thashë të marrësh njëherë kontakt vetë me gjithçka, thjesht, pa ceremoni... Dua të di, për shembull, ç'përshtypje të la Ademi?

Unë ula sytë, i zënë ngushtë. Të më kishte bërë përshtypje të mirë, ndoshta do ta thosha por, meqë ishte e kundërta, mendova se ishte e parakohshme të shpreheshja.

— E mora vesh!, — qeshi Thanasi, pastaj u mendua një hop dhe vazhdoi: — Ademi është i përgatitur si ndihmësmjek. Ai ka bërë disa vjet për mjek në Itali, ku e kishte çuar i ati, një tregtar i mesëm. Lufta ia ndërpreu studimet dhe pas Çlirimit punoi disa vjet si ndihmësmjek në Elbasan, pastaj u transferua këtu. Vitet e para, një e dy dhe kërkonte të largohej, por pastaj u martua dhe hodhi rrënjë këtu.

— Ç'punë i bën e shoqja?, — pyeta.

— Sa shpejt të paska dhënë të njohur!, — bëri shaka Thanasi.

— Erdhi sot në spital të kërkonte të shoqin!, — sqarova.

— Ajo, as ka qenë dhe as është në marrëdhënie pune, megjithëse nuk ka as fëmijë për të mbajtur!, — vazhdoi Thanasi. — I kemi thënë disa herë të futet në punë, por Ademi i bën bisht, se gjoja e paska të sëmurë, por njerëzit thonë se e ka nga xhelozia. Njeriu që s'ka punë, do të merret pastaj me...

— Nejse, pyeta thjesht për kureshtje!, — e ndërpreva.

— Sa për Ademin, ai sigurisht ka dhënë një farë kontributi, se u bë dymbëdhjetë vjet në këtë qytezë, por...

— Thanasi u mendua përsëri një hop, — por, kam përshtypjen se punon pa zemër, sa për të justifikuar rrogën dhe për të qenë në rregull, duke iu shmangur telasheve dhe përgjegjësisë. Ndokush thotë se i vjel nevojtarët, sigurisht me lezet, që të mos shkelë në dërrasë të

kalbur, po ndonjë rast flagrant s'ka pasur. Ndoshta as ne nuk jemi treguar vigjilentë... Sidoqoftë, ti ngarkoje mirë me punë, prishja ca qetësinë, dërgoje në terren, ai i bën bisht, duke ndikuar keq edhe te të tjerët, dhe kërkoi llogari. Sidomos kini kujdes sektorët e shfrytëzimit të pyjeve. Nëpër ta kemi pesëqind e ca punëtorë dhe pothuaj secili ka nga një familje të madhe në fshat, kështu që...

Biseduam shtruar me kryetar Thanasin dhe u habitam kur pashë se ora kishte shkuar tre pa një çerek.

3

Atë ditë pata pak vizita në ambulancë, ndoshta nga që ishte mot i keq dhe erdhën vetëm ata që kishin vërtet nevojë. Në pritje që të mbaronte orari, dola në dritare.

Nga qielli i murmë rigonin pikla të imta e të dendura shiu. Ato kërcisnin lehtë në çati, mbi xhama e në gjethet e zverdhura të drurëve dhe bënin rrathë në pellgje. Ngjyrat e natyrës dukeshin të shpëllara, me një shkëlqim të plumbtë. Ngaqë spitali ndodhej në një skaj të qetë, s'po dukej ndonjë kalimtar në rrugën e tij dhe vetëm tymi që dilte pareshtur nga oxhaku i stabilimentit të sharrave, duke marrë trajta nga më të ndryshmet, e prishte monotoninë e panoramës që më shtrihej para syve.

Ndieja një plogështi të pazakontë dhe, si gjithmonë kur pret, më dukej sikur koha ecte si breshkë. «Po mbushen tri javë!» Ditët e para kaluan shpejt, me përshtypjet dhe punët e para. Kryetar Thanasi e mbajti fjalën, na siguroi shpejt bojën e vajit, si dhe shumë nga pajisjet që kërkuam. Edhe ne e mbajtëm fjalën, iu përveshëm punës dhe brenda disa ditëve ia ndërruam faqen spitalit.

Në fillim Ademi buzëqeshte me skepticizëm dhe mendohej t'i bënte bisht punës, por kur pa që rrëmbeva furçën i pari, s'pati nga t'ia mbante. E vura të jepte dorën

e parë, se s'ia shkrepse fare, kurse dorën e dytë ia dhashë vetë. Shoqet lanë dhe pastruan gjithçka, qepën dhe vendosën perde të reja prej garze dhe siguruan disa vazo me lule. Nëpër muret e dhomave dhe të korridorit vendosëm disa kuadro me pamje nga vendi ynë dhe disa parulla të freskëta. Tani spitali dukej si të ishte tjetër.

Bashkë me urgjencat dhe me vizitat në ambulancë, pata mjaft punë ato ditë. Pothuaj s'më tepronte koha të shëtisja nëpër qytezë, bile edhe ushqimin e merrja ndonjëherë me vete në spital. Kthehesha në dhomë vonë, mjaft i lodhur, por i kënaqur.

Mbasi e përfunduam këtë aksion, e ndjeva veten disi bosh. Më dukej se puna nuk po ecte me ritmin e filluar. Në spital s'kishim asnjë të shtruar, se i patëm përcjellë në atë të rrethit gjatë riparimeve. Vizitat në ambulancë mbaronin zakonisht shpejt dhe kisha mjaft kohë të lirë. Kur u mata të organizoja një ekip, për të dalë nëpër fshatra dhe nëpër sektorët e shfrytëzimit të pyjeve, u sëmur Ademi, kështu që u gozhdova në qytezë. Tregohesha i gatshëm për vizita në çdo kohë, në ambulancë a nëpër shtëpi, ndiqja nga afër edhe zhvillimin e sëmundjeve të parëndësishme të pacientët e paktë, por të gjitha këto më dukeshin një rutinë e zakonshme profesionale. Mundohesha ta mbushja kohën e lirë duke lexuar, bëja ndonjë lojë shahu me të njohurit e rinj, organizonim ndonjë dëfrim të vogël, por të gjitha këto nuk më shijonin siç duhet. Veç të tjerave, ndieja edhe mall për familjen.

... Për këto mendoja, me ballin të mbështetur në xham, duke vështruar i shpërqëndruar jashtë. Piklat e shiut sajonin rathë të panumërt në pellgjet e rrugës. Rrathët zgjeroheshin, ndërpriteshin nga njëri-tjetri, shuheshin dhe prapë krijoheshin, me një shpejtësi të çuditshme. Kjo lëvizje më sugjeronte ecjen e shpejtë të kohës.

«Mua më duket sikur koha mezi kalon, kurse në të vërtetë ajo rend, rend asgjë s'e ndalon dhe, po s'ece me ritmin e saj, mbetesh mbrapa! — mendoja. — Kurse unë, përveç vizitave, s'po bëj ndonjë gjë për të qenë».

Më shkëputi nga mendimet pamja e një njeriu që po vinte drejt spitalit i përkulur, duke ecur me vështirësi dhe me pamje të vuajtur. Nxitova t'i dilja përpara dhe e ndihmova të futej në dhomën e ambulancës. Ishte një djalosh i dobët, me fytyrë të zbehur dhe me sy të rruður nga dhembja.

— Më dhemb shumë fundi i barkut, doktor, s'mundem!, — ankohej, ndërsa po e këshilloja t'i shtrinte mirë këmbët në shtratin e vizitave.

Ë perkutova me kujdes. Barkun e kishte të fortë dhe hovte e thërriste në çdo prekje të fortë. Ndërkohë ia behu Ademi, por qëndroi në skaj të dhomës, me një pamje indiferente dhe të ngurtë, si prej sfinksi.

— Dyshoj për apendicit akut!, — i pëshpërita, duke iu afruar.

— Ashtu?!, — tha Ademi, përsëri me indiferencë.

— Megjithatë, mund ta mbajmë një copë herë në observacion dhe t'i fillojmë një kurë energjike me antibiotikë!, — propozova.

— Si ta shihni të arsyeshme, por e kam për detyrë t'ju vë në dijeni se rruga gjer në spitalin e rrethit s'është fort e mirë dhe autoambulanca jonë është në pragun e riparimit kapital.

— Vdiqa, doktor, s'duroj dot më, bëmë derman!, — rënkonte i sëmuri, me gjunjët të mbledhur gjer afër mjekrës dhe i djersitur nga dhembjet.

Nuk isha i bindur plotësisht për diagnozën, por edhe kushte për ta operuar, në rast nevoje, nuk kisha.

Prandaj, më mirë një diagnozë e gabuar, sesa një rrezik sado i vogël për jetën e pacientit. U ktheva vrullshëm nga i sëmuri.

— Emrin?

— Spiro Leta.

Këputa një fletë nga blloku i recetave dhe shkrova:

Dyshohet për apendicit akut. Për kompetencë, kirurgut. Mjeku...

Ia zgjata letrën Ademit, por sakaq u kujtova se ai kishte qenë deri të djeshmen i sëmurë dhe i thashë:

— Le ta shoqërojë Lina.

— Po shkoj më mirë vetë, me këtë rast, po bëj edhe një herë analizat!, — tha ai.

— Mirë, atëherë...

Ktheva krahët dhe iu afrova dritares. Befas m'u duk vetja i dobët, kapitullues para rastit të parë të vështirë. Nuk e pata mendjen kur e nxorën të sëmurin, as kur u nis autoambulanca. Mendja më fluturonte gjatë.

...Ndodhesha në sallën e operacioneve. Rreth e qark bardhësi. Nga sipër vinte drita e fortë, e bardhë e projektorëve. Ajri ishte i ngrohtë, i ngopur me erën e klotingëllima e veglave të operacionit. Sa herë ngrija sytë, ndeshja vështrimin e tendosur, por mirëdashës dhe inkurajues të pedagogut të kirurgjisë, i cili më asistonte. E merrja me mend se edhe sytë e të tjerëve ishin përqëndruar te duart e mia. Pedagogu më jepte hera-herës ndonjë këshillë. Nga timbri i zërit e kuptoja se ishte i kënaqur me punën time. Kjo më nxiste të vazhdoja me guxim operacionin. Ishte një apendicit i zakonshëm por, sitë doqoftë, unë për herë të parë përdorja bisturinë. Një ditë mund të më takonte ta përdorja pa pasur mbi kokë pedagogun e kirurgjisë...

...«Dyshohet për apendicit akut. Për kompetencë, kirurgut. Mjeku, Fatos Nara». Këto fjalë, të shkruara me shkronja të mëdha, më lodronin vazhdimisht para syve, sikur më përqeshnin. Pse, për të mësuar që të shkruaja kaq gjë në një recetë ambulance kisha pritur radhën të ushtrohesh në sallën e kirurgjisë kur isha student?!...

Dikur u kujtova se orari i vizitave kishte mbaruar. Zhvesha me një farë nervozizmi përparësen e bardhë, rrëmbeva pardesynë dhe dola. Shiu kishte pushuar, por gjithçka ishte e lagur. Ajri që i freskët, pothuaj i ftohtë dhe plot kundërmime, si zakonisht pas shiut. Shquante kundërmimi i stivave të dërrasës, që zbardhnin në sheshin e stabilimentit të sharrave. Ula kokën dhe vështrova gurëçkat e lagura të rrugës, të cilat trazoheshin, kërcisnin dhe humbisnin pas majave të zeza të këpucëve të mia.

Eca dhe eca kokulur, me mendime të ngatërruara, gjersa më përmendën disa thirrje të forta e të gëzueshme kalamajsh.

Ngrita sytë dhe vura re se kisha arritur përbri shkollës. Në oborrin e saj fëmijët po luanin me top, duke vrapuar grumbull pas tij. I vështrova me nostalgji, sepse m'u kujtua përnjëherësh ai sheshi i lagjes sonë në Tiranë, ku kisha luajtur edhe unë gjatë fëmijërisë, si këta sot. Eh, ajo kohë e artë, pa telashe të tilla...

Rastësisht topi mori drejtimin tim. Nuk u përmbajta dot, vrapova drejt tij dhe ua riktheva fëmijëve me një goditje të saktë, që shkaktoi britma admirimi nga ana e tyre.

— Doktor, keni qenë futbollist?, — më pyeti një kuqalosh i vogël, i cili kishte numrin shtatë të qëndisur në fanellë.

— Me kë jeni, me «Partizantin», apo me «Dinamon»? — pyeti një tjetër, pa pritur përgjigjen e parë.

— Me «Partizantin»!

— Edhe unë!, — u mburr vogëlushi.

U ula rrëzë një bredhi që ndodhej në skaj të oborrit të shkollës dhe nisa të admiroja fëmijët, që e rifilluan lojën me zell të veçantë, kush e kush të tregonte mjeshtërinë e vet.

— Më kujdes, se mos thyeni xhamat!, — i këshilloi një zë i njohur.

Ktheva kokën dhe pashë xha Andonin që po dilte nga shtëpia.

— E, Fatos, si je?, — më pyeti buzagaz, ndërsa sytë e tij të kthjellët më vështronin me dashamirësi.

— Mirë duhet thënë!

— Pse «duhet»?

Duke shëtitur krah tij, i tregova ç'më kishte ngjarë.

— Obobo, sedërli i madh paske qenë, more djalë!, — më qortoi butë xha Andoni, mbasi më la të shfreta mirë e mirë.

— Njeriu pa sedër s'vlen as pesë qindarka!, — u mbrojta.

— Vërtet, po gjella me kripë dhe kripa me karar... A do të ishte me vend të rrezikoje sadopak të sëmurin për punë sedre?

— Sigurisht që jo!

— Atëherë?!... Pra, ke vepruar drejt. Sa për pajset dhe kushtet që duhen për raste ekstreme, plotësojini, ç'ju pengon?!...

— Xha Andon, ta bleva qumështin!, — na ndërpreu Kristina, e bija e teto Zogës dhe fqinja ime.

— Pra, u dashka kthyer në shtëpi, se nuk mund të shëtis me të në dorë!, — tha xha Andoni, duke treguar bidonin që mbante ajo. — A po vjen edhe ti, Fatos, të na bëjë nga një kafe Kristina, se e bën të mirë!

Pranova me qejf dhe pas pak u shtruam njëri pranë tjetrit në munderin e njohur, ndërsa Kristina nisi të merrej me qumështin dhe me kafënë, duke trazuar nëpër rafte si zonjë shtëpie.

— E kam si bijën time!, — tha xha Andoni, duke e përcjellë me sy gjithë dhembshuri, ndërsa ajo shkoi të vinte qumështin në zjarr. — Më janë gjendur, bashkë me Zogën, dhe në saje të tyre s'e kam ndier vetminë.

Kristina u kthye me nxitim, për të mbikëqyrur kafënë dhe u përkul me hijeshi mbi furnelën elektrike. Ajo kishte sy çuditërisht të mëdhenj, të kaltër e të kthjellët, si qielli pas shiut, dhe një gojë të vockël, me buzë si qershi. Flokët e zinj, të prerë shkurt, dhe hunda me majë, i jepnin një pamje disi fëmijërore dhe çapkëne.

Si fqinjë që ishim, takoheshim shpesh, sidomos kur dilja ose kthehesha në shtëpi, por të shumtën e herës kalimthi. Nga ato biseda që kishim zhvilluar, më kishte lënë mbresën e një vaje zemërmirë, të çiltër dhe më të pjekur nga ç'e tregonte pamja. Përshëndeteshim gjithmonë me përzemërsi dhe, kur rastiste të mos e takoja ndonjë ditë, më dukej sikur kisha lënë diçka mangut.

— Të kërkuam mbrëmë në dhomë, por s'të gjetëm!, — m'u drejtua Kristina, duke hequr xhezvenë nga

furnela. — Patëm për darkë Ibrahimin me Ritën dhe nëna erdhi të të ftonte edhe ty.

Ata ishin një çift arsimtarësh, me të cilët më kishte njohur Kristina. Ibrahimin qe nga Vlora, kurse e shoqja, Rita, nga Elbasani. Kishin pesë vjet në shkollën e Bregasit, një fshat i asaj zone. Aty qenë njohur dhe martuar.

— Vërtet, mbrëmë u vonova te një fëmijë i sëmurë!, — thashë.

— Ju, mjekët, e keni kollaj të justifikoheni!, — bëri shaka xha Andoni.

— Ke shumë të fala prej tyre!, — vazhdoi Kristina, duke derdhur kafënë nëpër filxhanë. — Kur të të çojë puna në Bregas, të lutem të shkosh tek ata.

— Eh, disa herë jam matur të dal fshatrave, por s'më ka ecur mbarë!, — u ankova. — Megjithatë, nesër do të shkoj në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve, sikur kiameti të bëhet!, — thashë.

Pas kafesë, dolëm dhe vazhduam shëtitjen me xha Andonin, buzë Përroit të Zi, që gjarpëronte ndanë qytezës. Mësova se në ujërat e tij gëlonin troftat. Ai dilte herë-herë për peshkim. Në kisha dëshirë, mund të shkoja edhe unë të dielën. Po të zinin gjë, do të na i skuqte Kristina për shtatë palë qejfe dhe do të hidhnim së bashku ndonjë kupë të vockël raki.

Kur u ndamë, retë në qiell qenë davaritur dhe natyra vezullonte me ngjyra të forta e të gëzueshme, edhe unë e ndieja veten të kthjelluar e të lehtësuar.

Mbasdite, ndërsa po kthehesha nga vizitat, pashë me habi Spiro Letën.

— Po ti?!, — i thirra.

— Nuk më mbajtën!, — ma priti ai, fare i qetë. — Vetëm më bënë një injeksion. Më trulloi ca, por baruku më shkoi. Kjo është për ju.

E rrëmbeva dhe e çela me ngut letrën që më zgjati. Ishte nga kirurgu i spitalit të rrethit.

«... Nuk ka apendicit, por një neurozë specifike. Kushdo në vendin tuaj mund të gabohej, por Ademi e di, se pacienti ka pasur edhe herë të tjera çrregullime

të kësaj natyre. Në rast përsëritjeje, siç e dini vetë, përcillen me ndonjë qetësues. Ju uroj gjithë të mirat...»

Megjithëse letra ishte shkruar me takt, më përcëllloi duart dhe nxitova ta rrasja në xhep. Më pushtoi dyshimi se Ademi kishte synuar të më diskreditonte karshi kolegëve, prandaj u shtir indiferent kur i thashë se dyshoja për apendicit akut, dhe për më tepër, më kujtoi rrugën e keqe dhe autoambulancën e pasigurtë, e as i zuri me gojë çrregullimet e mëparshme të pacientit. Për herë të parë ndjeva dëshirën ta kisha Ademin pranë.

Ndërkaq, Spiro Leta qëndronte në këmbë përballë meje dhe ndoshta habitej me shqetësimin tim. Gjaktfohtësia e tij më acaroi më keq.

— E mora vesh, tani shko, — i thirra.

— Ku të shkoj?

— Prapa diellit!

— Mirë, po raportin?

— Raportin?!

— Po, po, raportin! Qysh ta arsyetoj ndryshe ditën e sotme të punës?

— Lërmë, të lutem!.

I dyshuari për apendicit akut më vështroi një çast i habitur, pastaj ktheu krahët e iku.

— Ec nesër në ambulancë ta marrësh!, — i thirra që prapa, se u kujtova që ai s'më kishte ndonjë faj.

Shkova në shtëpi, por s'më nxinte vendi. Vloja nga inati. Më vinte plasje që Ademi s'kishte orar pune mbase, se do t'ia thosha flakë për flakë nja dy fjalë me piper. Por, të nesërmen s'kishte ku të më shpëtonte.

4.

Mbasi mbaruam takimin e mëngjesit me punonjësit e spitalit, e mora veç Ademin dhe, duke u munduar të ruaja gjaktfohtësinë, ia thashë troç ç'dyshoja për rastin e Spiro Letës. Atij i ndërronte fytyra, zverdhej, skuqej, herë shtirej i habitur dhe herë jepte shenja

revoltimi, por dukej që atje tej se e kishte mizën nën kësulë.

— S'është e vërtetë, doktor, për fjalën e nderit që s'pata ndonjë qëllim të keq!, — shpërtheu, me pamje prej viktime, mbasi u zbraza unë. — Vetë ia morët anamnezën, vetë e vizituat, unë u gjeta në përfundim e sipër, ku ta dija se ai s'ju kishte treguar! Pastaj, pse, nuk mund të ketë apendicit akut një njeri që vuan nga neuroza?!

— Mund të ketë, por, a e lexove se ç'shkruante kirurgu? Ta përsëris, ti e kishte më fort për detyrë të më tregoje si ishte puna e Spiros, sesa të më theksoje se rruga për në spitalin e rrethit s'është fort e mirë dhe se autoambulanca...

— U druajta se mos influencoheshit dhe e merrnit me lehtësi rastin!, — u ngut të justifikohesh ai. — Kanë ndodhur raste fatale me pacientë të këtij lloji, s'i kanë besuar dhe...

— Adem, mos u mundo të fshihesh prapa gishtit!, — e ndërpreva rreptë. — Nuk e kam aq fort hallin të dinjiteti im profesional, gabimet për njerëzit janë, megjithëse askujt s'i pëlqen të gabojë, por te diçka tjetër, më e madhe, më e rëndësishme: te marrëdhëniet tona, te bashkëpunimi ynë në interes të punës. Vaj halli për një qendër pune ku ka njerëz që mundohen të diskreditojnë shokun, ku në vend që ta mendosh dhe të shqetësohesh për punën, duhet të ruash se mos ta futin ujin nën rrogë. Ca më keq kur kjo qendër pune është një spital, se me shëndetin e njerëzve nuk bëhet shaka!

— Ju betohem, doktor, nuk e pata me qëllim të keq!, — tha ai, me një ton gati të përvajshëm.

— Ashtu do të dëshiroja edhe unë, e ardhshmeja do ta provojë këtë!, — vërejta. — Ne duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin sinqerisht, pa hile, përndryshe s'e kryejmë dot detyrën.

— E shikoj, ju s'po më besoni dhe do të ma mbani vath në vesh këtë ndodhi!, — psherëtiu ai.

— Qoftë keqkuptim, ashtu siç thua ti!, — theksova,

duke e vështruar ngultas në sy. — Veç, po e përsërite...

— Ç'është ajo fjalë, as këtë radhë... — Ademi e la frazën në mes dhe brofi, se jashtë u dëgjua një bori e fortë dhe këmbëngulëse makine.

— Mos u shqetëso, nuk është urgjencë!, — i thashë. — Do të ketë ardhur Azemi të na marrë, se e porosita qysh mëbrëmë. Siç duket, e ka humbur durimin duke na pritur. Të lutem, lajmëroje Linën të dalë.

— Vërtet do të shkosh me Linën në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve?, — u habit Ademi.

— Siç e dëgjove në mbledhjen e mëngjesit...

— Fundi, vij unë!, — u tregua i gatshëm ai.

— Jo, se nuk e ke marrë akoma veten mirë nga sëmundja, pastaj, njëri prej nesh duhet të ndodhet këtu, për çdo nevojë.

— Dakord, xhanëm, por thashë... meqë është vajzë dhe...

— S'prish punë, duhet t'i thyejmë disa koncepte të vjetra!, — theksova. Kam biseduar edhe me prindërit e saj, ma kanë lënë në besën time.

Përballë spitalit na priste një Skodë bosh.

— Shyqyr, bre!, — psherëtiu Azemi, shoferi ezmer e flokëshprishur, që zakonisht më mundte në domino.

— Hyni, se ma humbët një rrugë trupa sot! — Ai i futi marshin e parë dhe makina hovi përpara. — Po ti po shkoke në vendlindje, hë?, — iu drejtua pastaj Linës, së cilës i kishte lënë vendin pranë dritares.

— Ç'ti bësh doktorit!, — iu përgjigj ajo, pakëz e turpëruar.

— E pse të mos shkosh?!... Po shkon ky, që ka ardhur nga Tirana, jo ti, që atje i ke rrënjët. Ndryshe, pse e bërë shkollën?!

Pas një copë here, kamioni gulçonte nëpër gjarpërimet e përpjeta të rrugës pyjore, buzë honesh që nuk shihej fundi. Azemi këndonte nën hundë dhe manovronte i shpenguar timonin. Unë vështroja mjegullën që ngrihej nga luginat dhe më dukej vetja si në aeroplan. Kur shkëmbeheshim me ndonjë makinë tjetër, më ngjante

sikur njëra rrotë dilte jashtë trasesë dhe shtrëngoja pa-dashur mbajtësen. Kur më pikaste, Azemi buzëqeshte.

— Po sikur të udhëtonit me mua në ndonjë ditë ngrice?!, — tha dikur. — Shkon bishti i karrocërisë fësht-fësht, sa andej-këtej!

— Ku po na çon kështu, ngjitu e ngjitu, në qiell?, — bëra shaka.

— Te sharrëxhinjtë, doktor, dhe thuaj falmenderit, se nuk e besoj të kesh parë sharrëxhinj në bjeshkë, sa je bërë kaq!, — ma priti ai.

— Vërtet s'kam parë!, — buzëqesha, duke hedhur sytë nga pamjet që shkëmbeheshin në çdo kthesë.

Kisha qenë disa herë në malin e Dajtit, kisha kaluar edhe nëpër Llogara, por pyje të tilla s'më kishte zënë syri ndonjëherë. Ato shtriheshin sërë-sërë në luginë, shpate dhe kulme, gjer përtej, në horizont. Gjatë kontureve të maleve dhe bregoreve dalloheshin siluetat e drurëve me trajta nga më të ndryshmet. Vende-vende luginat qenë kredhur në mjegull dhe kreshtat dukeshin sikur lundronin nëpër të, si ndoca anije gjigante, fantastike.

Zbritëm në afërsi të vendit ku punonin brigadat e sharrëxhinjve. Azemi nisi të më tregonte me shenja se nga duhej të ngjiteshim, por sakaq u kujtua, e, duke i rënë ballit me dorë, tha:

— Hej, dreq, ç'lodhem kot unë! Ja tek e ke Linën, që e di rrugën symbyllur, se këtej kalohet për në fshatin e saj... Te korija e Gjergjit punojnë brigadat!, — iu kthye asaj, na përshëndeti me dorë dhe u nis, pa merak.

Lina priti që të kaloja unë përpara.

— Të takon ty, si udhërrëfyese!, — i thashë. — Apo nuk do që të shkelësh zakonin?

Kështu, fillova të ngjitesha pas Linës, nëpër shpatin e pjerrët të ahishtës. Legusha ndrydhej nën hapat e mi, si ndonjë sixhade e butë dhe e paanë, me ngjyra të kuqërreme. Ahet e moçme, me trungje të trasha e të përhimë, ngriheshin madhështore drejt qiellit, i cili dukej në copëza të panumërta midis degëve dhe degëzave

të tyre të kapërthyera. Së andejmi shkëputeshin herë-herë gjethe të verdha, që zbrisnin poshtë ngadalë e më dredha. Ndonjëra më binte në supe, ose ngecte në flokët e gjatë të Linës. Ajo e shkundte lehtë, me majat e gishtave dhe ngjitej e ngjitej plot siguri, me shkahtësinë e një sorkadheje.

— Vërtet e ditke mirë shtegun!, — vëreja, duke u ndalur të ngopesha me frymë dhe dihatja me ëndje ajrin e freskët të ahishtës, që kundërmonte erë gjethesh të rrëzuara, humusi e myshku.

— Kushedi sa herë kam kullotur dhitë këtej!, — u përgjigj ajo buzagaz.

— Keni kohë që jeni larguar nga fshati?

— Po bëhen katër vjet. Gjyshin dhe xhaxhallarët atje i kam, vetëm babai u shtrëngua të zbriste në qytezë, se e ka punën me turne në sharrë dhe s'ia dilte dot.

Ndërsa ngjiteshim përpjetë, dëgjoheshin përherë e më afër goditje sëpatash, zhurmë motosharre, krisje drurësh, thirrje të shkurtra dhe një këngë e lehtë popullore, që e këndonte dikush me zë të lartë.

Diku më ra përpara këmbëve një boçe e vjetër bredhi. Ngrita sytë dhe pashë një ketër që kërcente degë më degë. Më verboi drita e diellit, e cila copëtohej nga halat e gjelbra në rreze të panumërta, lodërtare.

— Mirë se vjen, shoku doktor!, — më përshëndeti me një farë habie sharrëxhiu i parë që takova, një burrë mustaqelli e shpatullgjerë, i veshur me një fanellë të leshtë fshati.

— Mirë se ju gjej e puna mbarë!, — iu përgjigja, duke i shtrënguar dorën, që e kishte sa një putër ariu.

— Po ti moj bija e Kiços, për në fshat kështu?, — iu kthye ai Linës.

— Jo, me doktorin, o Mete!, — ia priti ajo, duke mbështetur dorën, gjoja pa qëllim, në çantën sanitare.

— Aha!, — murruriti ai, me habi të përmbajtur.

Ca nga ca erdhën e u mblodhën rreth nësh edhe

sharrëxhinjtë e tjerë të brigadës. Na ftuan të zinim vend mbi një trung ahu të rrëzuar. Lina u mënjanua me lëzet dhe bëri të ulej andej nga skaji, por unë e thirra pranë me një gjest të rreptë dhe ajo m'u bind e turpëruar. Njëri prej sharrëxhinjve më zgjati një kuti duhani prej alumini, të zbukuruar me motive të krahinës dhe më pyeti:

— Ç'qenke munduar gjer këtu, doktor? S'di të ketë ndonjë të sëmurë në këto anë!

— Pse, duhet të pres të sëmureni, pa të vij?, — ia prita.

— Jo, xhanëm... s'është keq t'i njohësh këto anët tona, janë vende të bukura!, — vazhdoi ai, duke vështruar buzagaz, me bisht të syrit, qysh po rreksha të dridhja cigaren.

— Vërtet janë të bukura, po unë kam ardhur sidomos për ju!, — thashë dhe u nguta t'i shkoja gjuhën fletës së cigares.

— Të lumshin këmbët, na bëhet qejfi shumë, por me shëndet jemi top të gjithë!, — buzëqeshi një sharrëxhi i ri, të cilit bluza e leshtë s'ia humbiste dot trajtat e muskujve, për t'ia pasur zili.

— Po atë plagë në dorë, ç'e ke?, — pyeta, duke i treguar me gisht një gjurmë gjaku të mpiksur me duhan bashkë.

— Eh, një gërvishtje e vogël!, — tha ai me nënvlef-tësim.

— Nga e vogla bëhet e madhja!, — vërejta. — Sidomos nëse ai duhani që i ke vënë s'ka qenë fort i pastër...

— Eh, doktor, s'kanë qenë fare pa mend të parët tanë!, — më ndërpreu ai. — Jo gërvishtjet, por edhe plagët e plumbit ata i bënin me duhan!

— Sepse nuk e kishin çantën e ndihmës së shpejtë!, — ia prita.

Të tjerët qeshën.

— Prandaj, ca më vonë lërja Linës të ta mjekojë siç duhet!, — e këshillova.

— Linës, the?! — Ai s'e përmbajti dot një grimasë përçmimi.

— Kemi qenë bashkë në fillore!, — më pëshpëriti ajo.

— Linës, posi!, — ia prita, duke e vështruar me qortim. — Për punët e pyllit ti, pa dyshim, je më i zoti se ajo dhe se unë bashkë, por për këto të mjekësisë...

— Hajde hajde, je dhe i ri, pale!, — e thumboi mustaqelliu.

Sharrëxhinjtë qeshën përsëri dhe i riu ktheu kokën mënjanë, ca i zemëruar e ca i turpëruar.

— Ty sikur të kam parë diku!, — iu drejtova njërit.

— Isha për vizitë në ambulancën e qytezës para një javë!, — m'u përgjigj ai. — Por, sa hyjnë dhe sa dalin atje...

— Mos kishe një të ftohur në anën e djathtë?, — u kujtova.

— Tamam. Por tani jam mirë. Më bënë dobi ato kokrrat e tua. Të hidhura për dreq ishin, ama!

— Megjithatë, do të të vizitoj edhe një herë pas punës, si thua?

— Falemnderit, doktor!

— Që ta gëzoni shëndetin, lipset ta ruani, sado e fortë që t'ju duket vetja.

— Hë, më të lumtë ajo gojë!, — miratoi mustaqelliu.

— Se, nganjëherë, e pësojmë për mendtë e kokës. Do më mbetet gozhdë tërë jetën qysh më vdiq një djalë motak, tetë vjet të shkuara... I kishte rënë disa herë ajo e tokës, të gjorit. Nëna ime, që merrej më fort me të, jo vetëm që s'na kishte treguar, por ia mbulonte fytyrën me shami kur e zinte. Gjoja, kështu do të shërohej më shpejt. Përralla. Jo që s'u shërua, por shkoi e vajti... Ta kishim çuar te doktori, mbase... Thoni, s'e donte nëna ime nipin? E donte, ore, e donte mbase më shumë se unë, po ja që ashtu i qe mbushur mendja! Ai thithi fort cigaren e dredhur dhe nxori tymin me një ofshamje.

— Po ndërrojnë kohët, ore Mete!, — vërëjti një sha-

rëxhi flokëthinjur. — Deri dje vetëm Ademin kishim në këto anë dhe, kur na zinte halli, grisnim një palë opinga pas tij, kurse sot, ja, solli Partia doktor, që vjen e na sheh gjer këtu, në majë të Murranës!

Të tjerët miratuan me kokë. Pas një copë here një nga një na kërkuan të falur, morën sëpatat e capinat dhe u kthyen në punë. I fundit mbeti sharrëxhiu i ri. Iu afrua Linës rëndë-rëndë dhe i zgjati dorën që t'ia mjekonte. Pastaj rrëmbeu sëpatën, kërcëu mbi një ah të rrëzuar dhe nisi t'i qëronte degët duke goditur fort, si për të nxjerrë dufin.

Ai punonte ndërmjet meje dhe diellit. Silueta e tij e shkathët, e zhdërvjellët dhe e fuqishme, më kujtoi divat e legjendave. Kur ngrinte lart sëpatën, në tehun e saj shkrepnin rrezet. Kur e lëshonte vrik më të poshtë, e shoqëronte me një ofshamje të shkurtër dhe dukej sikur fishkëllente ajri. Degët rrëzoheshin njëra mbas tjetrës dhe në vendin e tyre mbeteshin në trung disa njolla të bardha, që ngjanin si plagë të freskëta. Dukej sikur trungu i ahut vinte duke u zgjatur e duke u holluar, i nënshtruar dhe i përvuajtur nën këmbët e sharrëxhiut të ri.

Më tej po transportonin trupa me krahë. Duke vështruar qysh i kthenin dhe i rrokullisnin ato trungje të rënda, nëpër atë shpat aq të rrëpirë e të vështirë, më shkoi mendja tek ato ndërtimet vigane të kohëve të lashta, të cilat duken kuriozitetë të pabesueshme. Ndoshta, sepse po shihja së afërmi forcën dhe shkathtësinë e njeriut.

Brodhëm bashkë me Linën grup më grup. Këtu një fjalë, atje një shaka, më tej një bisedë. Dhe koha kaloi pa u kuptuar. Arriti pushimi i drekës. Ata na futën me bujari të hanim bashkë. Ndërsa shijua bukë të thekur në prush, kërnacka e turshi dhe kthym me radhë nga një gllënjë raki, biseduam për ripërtëritjen e pyjeve dhe mekanizimin e shfrytëzimit të tyre, për mbjelljet e vjeshtës dhe cilësinë e opingave, biseduam edhe për problemet e shëndetit e të higjienës. Zor se mund të

bëhej një bisedë më e bukur dhe më e frytshme për këto çështje.

Mbasdite zbritëm në sektor dhe pritëm që të ktheheshin nga puna të gjitha brigadat. Atje Lina takoi edhe xhaxhanë. Ai u përshëndosh me të i përmbajtur dhe disi i vrenjtur, por s'e fshihte dot dhe një farë krenarie për mbesën.

Bëmë disa vizita mjekësore, kontrolluam bashkë me përgjegjësën e sektorit kuzhinën, mensën dhe fjetoret, bëmë ca vërejtje dhe përballuam ndonjë debat, por u ndamë të kënaqur të dyja palët. Në të perënduar të diellit u ngjitëm te rruga automobilistike, që të prisnim ndonjë makinë nga ato që ktheheshin në qytezë me lëndë druri. Atje takova rastësisht Viktorin, njërin prej shokëve të mi të ngushtë të shkollës së mesme. U puthëm e u përqaftuam fort, pastaj mbetëm të hutuar përballë njëri-tjetrit. Në takime të tilla s'di ç'të thuash e ç'të pyesësh më parë.

— Si, more, qenke në këto anë dhe s'ke ardhur të më takosh?!, — e qortova. — Apo s'ma gjete dot adresën?!

— Mos u bën bagëti, Fatos!, — bubulloi ai, me humorin e vet karakteristik. — Ne s'kemi ardhur këtu nga rruga e makinës, por mal më mal e shteg më shteg, kështu që s'kemi kaluar fare nga qyteza jote. Akoma s'e ke mësuar se rrugët çelen gjithmonë në gjurmët e gjeologëve dhe të pylltarëve?!

S'do mend, ai takim e ndryshoi programin tim. Linën e përcolla në fshat me xhaxhanë, i cili do ta sillte të nesërmen në mëngjes, kurse unë me Viktorin u nisëm drejt majës së Murranës, rrëzë së cilës gjeologët paskeshin ngritur çadrat e ekspeditës. Ndërsa po ngjiteshim, na u shkrep të kujtonim ndodhi të shkollës së mesme.

— A e mban mend, ç'pësonte e ngrata Leni në orën e historisë?, — pyeti buzagas Viktori.

— Si s'e mbaj mend! Ti ia ndukje fshehurazi bish-talecat, ajo këlthiste dhe hante qortimet e mësuesit.

— Por, s'guxonte të më padiste, ama!

— Ti gjithmonë i sherrit ke qenë!, — vërejta. — Vec në orën e fizikës nuk ta mbante, ama!

— Aha, me atë s'bëhej shaka, se të ngrinte menjëherë në dërrasë, të jepte një problem të vështirë dhe në fund të thoshte, me një buzëqeshje asgjësuese: «Mirë, mirë, po mësimin s'e ke mësuar. Bën edhe fjalë, pale! Ma jep librezën! Dysh!»

Viktori e përngjasoi aq bukur mësuesin e fizikës, sa mua m'u duk sikur ndodhesha përsëri në klasë.

I zumë në gojë pothuaj të gjithë shokët dhe shoket e klasës, duke pyetur njëri-tjetrin për fatin e secilit. E ku kanë fund kujtimet dhe bisedat e dy shokëve të vjetër, sidomos kur takohen pas shumë kohe! Kështu, e përpijeta m'u duk e lehtë dhe rruga gjer te çadrat e ekspeditës jo fort e gjatë.

— U shpërndamë kokrra-kokrra në të klasës!, — vërejta me një farë nostalgjie, ndërsa po arrinin.

— He, tani klasa jonë u bë gjithë Shqipëria!, — buzëqeshi Viktori. — Dhe, po japim ca provime më të forta se ato të fizikës. Po more dysh në këto, aha...

Çadrat i kishin ngritur në një pllajë të bukur, rrëzë majës shkëmbore të Murransës. Ishin gjithsej katër, dy të vogla e dy të mëdha, të rreshtuara nën disa bredha të moçëm. Rreth e qark, sa të hante syri, shtriheshin vargmale dhe lugina, të kredhura në dritën kaltëroshe të muzgut, e cila ua shtonte madhështinë e fshehtësinë.

Shokët e Viktorit më pritën me përzemërsi, si ndonjë të njohur të vjetër dhe më ftuan të çlodhesha në çadër, se jashtë bënte ftohtë, kurse në ishëm të djersitur nga ngjitja.

Viktori e kishte sistemuar për mrekulli çadrën e vet. Anash ndodheshin dy shtretër portativë dhe ndërmjet tyre një raft i sajuar me patavra bredhi, ku kishin rreshtuar me kujdes një mori sendesh të përdorimit vetjak. Në krye të çadrës varej një llambushkë me bateri dhe një radio portative. Gjithçka ishte në vendin e vet, e pastër, e rregullt.

— Pallat i vërtetë!, — i thashë, duke u rehatuar në njërin nga shtretërit.

— Ne, tre çerekë të jetës në të tilla pallate e kalojmë!,

— buzëqeshi Viktori, që zuri vend përballë meje.

Në trekëndëshin që formohej nga fletët e hyrjes së çadrës, dukej një copë e livadhit, me barin e gjelbër si furçë, disa degë bredhi dhe një copë qiell blu. Të dukej sikur pllaja bashkë me çadrën qëndronin pezull përmbi luginë.

— Sa bukur që është!, — thashë, i magjepsur.

— Ta merr mendja!, — u krenua ai, duke dihatuar enkas me ëndje. — Këtu s'bie erë ilaçe dhe kloroform.

— Ti s'qenke nga ata që pula e botës u duket më e majme!, — vërejta buzagaz.

— Aspak, vëllaçko! Po nuk e dashurove profesionin, s'ke gjë në torbë!

— Hej, sa mirë që u takuam!, — thashë. — Sa herë të kam kërkuar në Tiranë dhe s'të kam gjetur, kurse sot...

— S'kishe ku më gjeje, gjeolog hesapi, sot këtu, në sër gjetiu!, — ma priti ai. — Në Tiranë kam vetëm borderonë dhe një shtrat në një dhomë kolektive beqarësh, që e shfrytëzoj vetëm disa ditë në muaj.

— Vetëm kaq?, — e ngacmova.

— Zyrtarisht vetëm kaq!, — m'u përgjigj me një pamje enigmatike.

— Kjo «zyrtarisht» më shtyn të dyshoj se ke ndër mend ta prishësh beqarllëkun!, — thashë.

— Po. Ka më mirë sesa të kesh një njeri që mendon për ty, kur sillesh nëpër male, që të pret me ankth të kthehesh, që hidhërohet e gëzohet bashkë me ty?... Sidomos për një si unë, që s'kam njeri.

Viktori është jetim, i rritur në shtëpinë e fëmijës.

— Ke shokët!, — i thashë me mallëngjim.

— Po, po!, — miratoi ai, duke më vështruar ngrohtë.

— Por, familja është diçka tjetër... Ti nuk e kupton dot. Dëgjo këtu! Disa kohë më parë më zuri nata në një

shpat mali, bashkë me ndihmësin tim. Ishte verë, çadrat i kishim lënë shumë mbrapa, të nesërmen duhej të ktheheshim përsëri po në atë vend, prandaj vendosëm të flinim aty. Ndezëm një zjarr të madh dhe u strukëm pranë tij. Ndhimësin e zuri gjumi shpejt, mua jo. Ishte kthjellët dhe diku, larg, dalloheshin dritat e një qyteti. Mendova se njerëzit atje shëtisnin, hanin darkë, punonin u gëzohehin fëmijëve, dashuronin... «E, Viktor, e pyeta veten, kush mendon për ty tani, kush të pret të kthehesh, kë ka marrë malli për ty?...» Atë natë vendosa t'i jepja fund beqarllëkut.

— Përderisa flet kështu, do t'ia kesh vënë syrin ndonjëres.

— Më duket se e kam gjetur!, — buzëqeshi ai.

— Ç'pret, atëherë?!

— Jemi në periudhën e njohjes! S'bëhet shaka me këto punë, vëllaçko! — Ai tundi në mënyrë paralajmëruese shkopin e vet të gjeologut, që po e rrotullonte nëpër duar. — Familja është gjë e madhe, ja, i ngjan këtij shkopit, që të ndihmon të ngjitesh në shtigje të vështira. Po s'që i fortë, të lëshon atje ku s'duhet dhe thyen kokën pastaj!

— Jam i bindur se s'do gaboresh!, — i thashë. — Ti zbulon pasuritë e nëntokës, jo pastaj ato që ndodhen mbi tokë!

Ai qeshi me të madhe, duke më rrahur shpatullat me dorën e tij si putër ariu.

— Po ti, ke vënë gjë në vijë?, — pyeti pastaj.

— Asgjë. Tani që u emërova në këtë qytezë, ka rrezik të mbetem beqar.

— Pse, more?!

— Sepse edhe unë jam me mendimet e tua, por në këtë qytezë... Pastaj, në këto vendet e vogla ka shumë thashetheme, kështu që s'bën dot...

— Hajde bagëti, hajde!, — më ndërpreu ai. — Ku ka vend në Republikë që s'dashurohen njerëzit, more?!

Pastaj Viktori doli. Unë brofa nga shtrati dhe shko-va pas gjurmëve të tij. Atëherë zbulova se në buzë të

livadhit, në një vend të mbrojtur nga era, po piqnin një goxha mish në hell.

— Paskan rënë ujqërit në tufën e kooperativës bujqësore të Murranës!, — qesha.

— Sikur të paguanin dhe ata me lekë në dorë, do t'ua bënin hallall!, — ma priti gjeologu që vërtiste hellin, një djalosh i shkurtër e rrumbullak.

Unë buzëqesha.

— Se mos i jep fort rëndësi vetes dhe kujton se e bëjmë për nderin tënd!, — më tërhoqi vëmendjen Viktori. — Jo, more vëllaçko, por kemi rënë në gjurmët e një vendburimi të pasur, prandaj. Ti je vetëm si shkak ndihmës... Që mos të të rritet mendja, de!

Kur u err, gjithçka ishte gati. U mblodhëm rreth një tavoline prej dërrasash të çara me sëpatë, në njërën nga çadrat e mëdha. E ngulëm hellin me gjithë mish aty pranë dhe ia shtruam për shtatë palë qejfe.

— Hajde, hajde, ç'po hamë mish si ilirët e qëmotit!, — bënte shaka Viktori, duke këputur dhe shpërndarë me dorë copa të mëdha mishi të pjekur.

Ngritëm plot dolli, biseduam për lloj-lloj temash, bëmë shaka dhe kënduam sa u ngjirëm. E ndieja veten si ndërmjet shokësh të vjetër dhe ndjenjat më vibronin si ca tela të tendosur fort. Na erdhi keq të gjithëve kur u mbarua rakia.

— Më mirë kështu, tamam në kohë mbaroi!, — ngushëlloi veten dhe të tjerët Viktori. — U kënaqëm, por mendtë tona s'i pimë. U shtroftë sa më shpesh në raste të tilla!, — i vuri kapak dhe brofi në këmbë.

Kur dolëm të shkonim nëpër çadrat tona, qielli dukej i zi dhe yjet sikur do t'i kapje me dorë. Përmbi majën e Murranës qëndronte hëna, si ndonjë abazhur nate gjigant. Drita e saj derdhej honeve e luginave dhe reflektohej verdhacuke nëpër kreshtat shkëmbore. Era që frynte me gulshe, ngjante si një dihatje e bjeshkëve të përgjurmura. Ajo sillte valë mjegulle, që ngriheshin së poshtmi, si vello të ndritshme, kaltëroshe.

Diku në luginë vezullonin ca flakëza të kuqërrem-

ta, që dukeshin e zhdukeshin pas mjegullës. Ndërmjet gulsheve të erës dëgjohej një tam-tam ritmik dhe i vazhdueshëm. M'u duk një pamje e çuditshme, përrallore.

— Ç'eshtë kështu?, — pyeta, duke treguar me dorë andej.

— Asgjë e jashtëzakonshme!, — m'u përgjigj qetë-qetë Viktori. — Kooperativistët kanë ndezur zjarre dhe kanë vënë rraketake nëpër rrjedhat e ujit për të trembur derrat e egër që të mos u dëmtojnë të mbjellat.

— Është një natë që s'besoj ta harroj ndonjëherë!, — thashë.

— Eh, sa të tilla kam jetuar nëpër malet tona!, — foli Viktori me një zë të ngrohtë. — Dhe ç'njerëz të mirë kam njohur! S'të bëhet të kursesh veten, kur mendon se lodhesh për ta.

— E di, Viktor, nganjëherë i vështroj njerëzit tek shkojnë në punë, fëmijët tek nxitojnë për në shkollë, të vegjlit tek i çojnë në kopsht dhe ndiej dëshirë t'u them të gjithëve «mirëmëngjes», t'u shtrëngoj dorën, t'u përkëdhel faqen, t'i ndihmoj me ç'të mundem...

U kthyem në çadër. Llambushka me bateri ndriçoi milkpritëse. Viktori i ktheu çelësin radios portative dhe prej saj filluan të buronin tingujt e një melodie të njohur popullore. Kushedi sa njerëz po e dëgjonin atë çast! M'u duk sikur tingujt e saj na lidhnin me fije të pa-dukshme, por të fuqishme, me të gjithë bashkatdhetarët, me gjithë vendin dhe bash atje, në rrëzë të majës së Murranës, e ndjeva veten më fort se asnjëherë tjetër pjesëtar i asaj familjeje të madhe...

5.

Erdhën në spital kur dielli po rrëzohej drejt perëndimit. Hynë pa trokitur. Gruaja ishte e zbehtë dhe me sytë të zmadhuar nga ankthi. I mbante buzët të shtrënguara fort, si për të ndrydhur ngashërimet. Nuk foli as kur e

pyeta përse kishin ardhur. Vetëm ktheu sytë nga burri, që i vinte pas dhe u mënjanua për t'i lëshuar vend.

Ai që i thinjur dhe i rrudhur, ndoshta pesëdhjetë a ndoshta gjashtëdhjetë vjeç. Dukej i qetë, si ndonjë sfinks. Vështrimi i tij tradhtonte atë çka arrinte të fshihte fytyra. Mbante në duar një fëmijë të mbështjellë me batanije.

— E kemi keq këtë djalin, doktor!, — tha.

E uli me kujdes në shtratin që i tregova dhe u zmbrops.

— Kur u sëmur?, — pyeta.

— Ka disa ditë. Në fillim u ankua se i dhimbte gryka. Pastaj nuk përkulej dot. Sot u gdhi keq. Rri si i ngrirë.

Iu afrova shtratit dhe e zbulova djalin. Përmjeherë u drodh dhe u tendos. Nofullat nuk i çilesnin. Bashkë me të, u drodha dhe unë. Më pikoi në zemër për atë fëmijë.

«Pa dyshim tetanos!», — mendova.

— Ka gjë të rëndë?, — pyeti fshatari, dhe më pa në sy.

Befas m'u rrit përbrenda, dëshira t'i qortoja për pakujdesinë e tyre, për nënvleftësimin që kishin treguar ndaj rrezikut, për vonesën, por u përmbajta në kohë. M'u kujtua se për ta ishte shumë më e shtrenjtë sesa për mua jeta e asaj fëmije dhe ndjeva një keqardhje të thellë. Ula vështrimin. Pashë fytyrën e njomë të djalit dhe m'u duk sikur sytë e tij më vështronin me adhurim, sikur më luteshin për diçka. U drithërova. Më erdhi të dilja nga ajo dhomë dhe të vrapoja diku larg, larg atij vështrimi.

— Prisni në korridor, do të mundohemi ta mjekojmë!, — mezi foli.

Ai doli kokulur. Ajo u mat të thoshte diçka, por buzët iu drodhën dhe e gëlltiti fjalën bashkë me ngashërimin. Shkoi pas të moshuarit.

Thirra infermieren dhe e porosita të fillonte menjëherë serumin. I përcaktova dozën dhe dola te pragu. Fsha-

tari shtrëngonte në dhëmbët e nxirë bishtin e llullës. Ty-
moste dendur, si për të fshehur fytyrën, dhembjen, pas
resë së vogël që buronte nën mustaqet e thinjura.

— Të kujt e ke?, — e pyeta.

— Të djalit. Është minator në Murrizaj. Kjo është
nusia, — bëri me kokë në drejtim të gruas dhe heshti.
Ajo qëndronte e palëvizur, si ndonjë shtatore. Befas ngri-
ti kokën dhe pyeti me ngut, e tronditur:

— Thua do të shpëtojë?

— Si ta ketë të thënë!, — ia preu plaku.

— Do të bëjmë ç'është e mundur!, — thashë dhe
hyra brenda.

Bëmë ç'qe e mundur. Por sëmundja qe në fazën e
fundit dhe pothuaj s'kishte shpresë. Tek ngulej gjilpëra
në atë trup të njomë, drithëroheshja. Më dukej sikur
po ia shtonim vuajtjet vetëm për të qenë në rregull me
ndërgjegjjen mjekësore. Megjithatë, luftonim.

I sëmuri sikur u qetësua ca. M'u ndez një shkëndijë
shprese, por zgjati sa ndriçimi i një meteori. Spazmat e
sëmundjes filluan përsëri. Tani s'më mbetej gjë për të
bërë. Veç të prisja. Nganjëherë natyra bën çudira.

U lëshova mbi karrige. Ktheva kokën nga ana tjetër,
që të mos i shihja ato përpëlitje të llahtarshme. Më vaj-
tën sytë tek ora e murit. Më ngjasoi me një kronometër
gjigant, që pret të arrijë diçka në finish. Edhe unë prisja.
Njeriu s'e humbet kurrë shpresën.

Isha djersitur. Një djersë e ftohtë, drithëruese. I
thashë dhe Ademit t'i qëndronte te koka dhe vendosa
të dilja disa çaste. Jashtë e ndjeva veten si i mbyturi që
del mbi ujë. Ndeza cigaren me ngut dhe e thitha thellë.
Sa më panë te pragu, plaku dhe gruaja më vështruan në
sy. Sikur nuk kishin guxim të pyesnin. Sytë e tyre ishin
plot ankth.

Iu afrova plakut. I mbështeta dorën në sup. I rën-
doi tepër ajo dorë sepse sikur u gërmuq, u ndrydh nën
të. E kuptoi.

— S'paska më shpresë, domethënë!, — belbëzoi.

Unë ngrita supet. Gruaja kishte kuptuar gjithçka. Brofi dhe u sul drejt derës.

— Ku shkon, bijë?, — i thirri plaku.

— Te djali!

— Nuk bën të vesh, — i thashë butë, duke e zënë për dore si një motër. — Nuk ka kuptim të vesh. Është infermieri me të. Tani do të shkoj edhe unë.

— Jo, do të veta!, — klithi mbytur ajo. — Nuk e lë djalin të më vdesë vetëm. Dua t'i jem pranë. Ia kam bërë të gjitha deri më sot. Nuk mund ta braktis në kohën e fundit. Do t'i fshij djersën, do t'i mbaj dorën...

Ajo dridhej e tëra. Fjalët e fundit mezi i nxori nga goja.

— Po s'ka kuptim, moj motër! Ai nuk të shikon, nuk të ndien. Ne do t'ia bëjmë të gjitha. Ti atje vetëm do të shqetësohesh...

— S'ka gjë, ai vuan më shumë se unë. Lërmëni, lëshomëni!

Ajo u shkëput nga krahët e plakut, shtyu dorën time dhe u vërsul brenda.

— Shko bashkë me të!, — i thashë atij. — Do ta ketë më lehtë me ty pranë.

Mbeta një çast vetëm. Përtej, në rrugë, po kalonin ca njerëz. Bisedonin me zë të lartë, qeshnin. Në një shtëpi pranë dikush po ndërronte valët e radios dhe degjoheshin fragmente melodish, zërash, zhurmash. Pranë meje po zhuzhiste një bletë. U vërtit një copë herë, pastaj u ul mbi një lule të sapoçelur. Dielli vazhdonte rrugën e tij drejt perëndimit, indiferent dhe i sigurt se të nesërmen do të kthehej përsëri. Unë nxitova të kthehesha tek i sëmuri.

Ata ikën në të venitur të ditës. Plaku mbante në duar kufomën e mbështjellë me batanije. Sa i rëndonte ajo peshë mbi atë të viteve! Ecnin përkrah, të heshtur, kokulur. Përpara kishin diellin. Nga pas kishin hijet: dy hije të gjata, të gjata, që ata mezi i zvarrisnin, të mbërthyera te thembrat e tyre.

«Të mos ishte prapambetja, ndoshta ky djalë do të

kishte shpëtuar!, — mendova zemërvrarë. — E kaluara po zgjat thonjtë dhe shkakton viktima edhe në kohën tonë!»

U largova nga spitali me një plagë të dhimbshme në shpirt. Më ndiqnin prapa dhe më shkrepnin në kujtesë pamjet e asaj ndodhie, e para në jetën time si mjek. Vdekja kishte lënë një grimcë të frymës së saj të ftohtë edhe në brendinë time.

U enda pa qëllim nëpër qytezë. Më dukej sikur edhe zhavorri, që kërciste nën hapat e mi, rëndonte dhimbshëm për atë gjëmë. Më dukej sikur edhe qyteza, të cilën nata po e shndërronte në një siluetë të madhe, të errët, mbante zi për vdekjen e fëmijës; sikur edhe dritaret, që po ndriçoheshin një e nga një, vështronin trishtueshëm, si ca sy të çapëlyer e të skuqur nga dhembja. Thithja pa ndërprerje cigare, gjersa bishtat e tyre më digjnin gishtërinjtë dhe ecja e ecja, duke iu përgjigjur shkurt përhëndetjeve të kalimtarëve që po rralloheshin.

Një copë herë më vonë, dëgjova mbas vetes zëra dhe hapa të shumtë. Rruga po gjallërohej përsëri. Si dukej, po shkëmbeheshin turnet në stabilimentin e gatrave. Qyteza gjithmonë jeton me ritmikën e tyre.

— Doktor, doktor Fatosi!, — më thirri një zë i njohur.

Ktheva kokën dhe dallova Skënder Topin, bashkë me Kiçon, babanë e infermieres sonë, që po nxitonin drejt meje. Ishin të dy të veshur me kominoshe dhe të pluhurosor me tallash.

— Po ti, kështu?!, — u habita me Skënderin, të cilin nuk e kisha takuar prej disa ditësh.

— Përsëri sharrëxhi, lidhës trupash, bile!, — bubulloi ai gjithë qejf. — Më në fund ma plotësuan lutjen, sollën një invalid në magazinë. Sot fillova rishtazi në sharrë. Ia bëmë fora, bashkë me Kiçon, premë tridhjetë metër kub dërrasë. A e merr dot me mend se ç'do të thotë tridhjetë metër kub, more?!

— Urime, atëherë!, — i thashë.

— Po ti, more doktor, ç'qenke kaq i pikëlluar sonte? S'ke as gjemi, që të të jenë mbytur...

— Ca më keq akoma, na vdiq në spital një fëmijë!, — iu përgjigja.

— Mos, more! I kujt ishte? Nga se?, — u hodhën që të dy.

Ua tregova të gjitha.

— Sikur të mos e kishin nënvleftësuar rrezikun dhe ta kishin sjellë me kohë, ai do të rritej e do të bëhej burrë!, — përfundova.

— Po, po!, — tundi kokën me hidhërim Kiçoja. — Kur isha i vogël, më kanë vdekur dy vëllezër dhe një motër, të gjithë nën mua. Jo unë, po as prindërit nuk e dinë nga se vdiqën. Kështu e patën të shkruar, thoshin, dhe mori fund. Prapambetja, mor vëlla, s'ka brirë.

— Por, sot është ndryshe!, — vëreja. — Mjek po, spital po, të gjitha falas...

— Drejt e ke, po s'ndryshojnë kaq kollaj...!, — tha ai, duke rrahur lehtë me pëllëmbë kokën e vet. — Ja, për shembull, unë lexoj dhe dëgjoj përditë ç'thotë Partia dhe shoku Enver, megjithatë, vetë e di ç'siklet pata kur më the se do ta merrje Linën nëpër sektorë...

— Por, pengesë nuk u bëre, ama!, — vëreja.

— Po, mor, po, se fjala e Partisë e bën të vetën!, — tha Skënderi. — Edhe ajo nusja e minatorit me shoqe do të lindin fëmijë të tjerë dhe do të kujdesen më fort për ta. Ti, Lina, dhe plot të tjerë si ju, do t'i ndihmoni që t'u hapen mirë sytë. Ke hak që je mërziur, doktor, neve një trup na pritet keq në gatër dhe bëhemi pikë e vrer, jo të të vdesë një fëmijë nëpër duar. Por, ti bën luftë përditë me vdekjen dhe luftë pa kurban s'ka. Puna është që, në të rrëmbetë ajo një, ti t'i rrëmbesh dhjetë... Tani, ec ta pimë nga një kafe, se na bën mirë...

Kur u ktheva në shtëpi, qyteza kishte filluar të dremiste dhe dritaret po errësoheshin një nga një. Mendo-va një hop për njerëzit që flinin pas tyre dhe, në mënyrë të pavetëdijshme, shkela më lehtë në zhavorrin që kërciste nën këmbët e mia.

Dritarja e Kristinës kishte akoma dritë. E përfytyrova duke lexuar dhe më pëlqeu t'i uroja me mend natën e

mirë. Hyra në dhomën time dhe çela dritaren, që të ajro-
sej. Vura re se gjithçka rreth e qark po merrte një shkël-
qim të argjendtë. Gjethet e fundme të plepit përtej rru-
gës nisën të fërfërinin si të arta. Po dilte hëna. Nisa të
ndieja kundërmimet e natës. M'u duk sikur ndieja ku-
ndërmimin e vetë jetës dhe mbusha gjoksin me të.

6.

Atë mbasdite moti ishte i vrenjtur dhe bënte ftohtë,
prandaj vendosa të kthehesha në shtëpi, dhe të ndizja
zjarrin. Ndoshta, as për darkë s'do të dilja, por do të ga-
tuaja diçka vetë, për shembull nja dy vezë të skuqura me
djathë.

Ndërsa po ecja kokulur, me këto mendime, dikush
më çiku në bërryl. Hova, i zënë në befasi dhe pashë
Kristinën që po qeshte me hutimin tim.

— Perdet!, — tha duke më zgjatur një pako të mbë-
shtjellë me gazetë. — Nëna t'i lau, kurse unë u shtova
disa qëndisma të vogla. Më vrisnin sytë sa herë i shi-
koja nga jashtë ashtu, të bardha, si në spital.

— Ju lumshin duart dhe jua paça borxh!, — e falënde-
rova.

— Ju, mjekët, mendoni t'ua shpërbleni të tjerëve kur
të sëmuren, por unë s'kam ndër mend!, — buzëqeshi ajo.

— Ashtu qoftë. Do të ta shpërblej ndryshe.

Ndërkaq filluan të binin pikla të imta e të ftohta
shiu.

— Ia nisi, i mallkuari!, — trova, duke ngritur sytë nga
qielli i murmë.

— Edhe shiu ka bukurinë e vet!, — tha ajo.

— E ç'bukurizeza?! Baltë dhe ujë në të katër anët,
mërzi...

— Kurse mua më pëlqen. Sikur më ndjell mendime
dhe më nxit të ëndërroj!, — tha, duke afruar pakëz qer-
pikët e gjatë.

— Ç'ëndërron, kukulla?, — e ngacmova.

— Je i keq, — sytë e saj u zmadhuan dhe shndritën kërcënueshëm. — Kaq të thatë qenkeni ju, mjeçkët?!

— Realistë, do të thuash?!

— Në dreq të venë të tillë realistë!, — shpërtheu ajo. — Po s'ndjeu dhe po s'ëndërroi, njeriu s'është njeri, po robot!

— He, s'ma merrte mendja të dëgjoja prej teje fjalë të tilla!, — vazhdova ta ngacmoja.

— Po, sepse ti ndoshta më merr për fëmijë! — Ajo më vështroi me qortim, por në një mënyrë të çuditshme. — Natën e mirë!

E ndoqa me sy tek vraponte drejt hyrjes së vet, duke kapërcyer me shkathtësi pellgjet.

— Kujdes, shiu s'i mban me hatër as ata që e duan, njësoj i lag!, — i thirra që mbrapa.

Ajo ktheu kokën dhe ma bëri me dorë, pastaj u zhduk në hyrjen e vet. Ndjeva se ajo ndarje më la një farë zbrazësie dhe u çudita me vetveten. Dhoma m'u duk e ftohtë. Këtë e theksonin letrat që kisha vendosur provizorisht në xhama, të cilat e shëmtonin dhe e tregonin si një banesë të përkohshme Çmbështolla perdet, që t'i vendosja. Qëndisimat e Kristinës ishin të vockla, por shumë të bukura. I admirova me një farë përmallimi. Më dukej sikur e shihja Kristinën të përkulur përmbi to, ndërsa gishtat e saj të shkathët ngulnin dhe tërhiqnin gjilpërën, duke lënë pas petale lulesh të brishta. U çudita përsëri kur e zura veten duke përkëdhelur me majat e gishtave ato qëndisima.

Mbasi vendosa perdet dhe ndeza zjarrin, dhoma m'u duk mikpritëse dhe familjare. Hëngra darkë, i shkrova një letër të gjatë familjes, pastaj çela radion dhe nisa të dëgjoja muzikë, duke pirë me ëndje një cigare. Tymi i saj krijoi një re të vockël, që përkundej si me përtesë nën abazhurin e gjelbër. Kur vetëtinte, dalloja në xhamat e dritares bulëza vezulluese shiu. Dëgjohej qysh cikërinin hove-hove, ndërsa uji që rridhte nga çatia, çuçuriste në mënyrë monotone.

Dikur nga radioja nisën të buronin tingujt e një melodie që më pëlqente shumë. Ajo filloi e qetë, si një pui pranvere, pastaj u rrëmbye dhe buçiti e gëzueshme, si përrënjtë kur shkrihet bora. Hovet e melodisë më shkaktounin një kolovitje të këndshme ndjenjash. Më dukej sikur edhe gulshet e erës e të shiut, edhe flakët e zjarrit, hovnin me ritmin e saj. Më kishte pushtuar një ngazëllim i thellë dhe dëshiroja që kënga të mos mbaronte.

Diçka krisi lehtë në xham.

«Vallë, filloi breshri?», — mendova.

Krisma u përsërit. U ngrita me përtesë dhe çela dritaren. Një thëllim i ftohtë, i ngarkuar me pikla shiu, më fshiku fytyrën. Në fillim dallova në errësirë vetëm një hije të madhe, të zezë, pastaj, kur sytë m'u mësuan, pashë se pak përtej dritares qëndronte një njeri me kapuç të madh. Ai mbante prej kapistre një kalë. Kur u çel dritarja, njeriu bëri një hap përpara, por s'më foli.

— Kush është?, — pyeta me kureshtje dhe disi i habitur.

— Një nevojtar, doktor!, — u përgjigj një zë i druajtur dhe i shqetësuar.

— Urdhëro brenda!

I panjohuri ngjiti shkallët dhe qëndroi te pragu.

— Nuk po hyj, doktor, se jam i qullur!, — tha.

— S'prish punë, hajde!

Afrova karrigen pranë zjarrit dhe prita në këmbë të hynte vizitori i natës. Ai u zbath, u shkund, la gunën prej shajaku në korridor dhe erdhi e u ul me druajtje pranë meje. Qe i ri në moshë, me sy të larmë, të mëdhenj, me duar të ashpra. Binte erë stan.

— Më fal, doktor, se është vonë, por halli...

— Fol, bre, ç'të ka ndodhur?

— Gruaja, doktor, po më vdes gruaja, bashkë me fëmijën!

— Pse, si është puna?

— Nga lindja, doktor. S'po lind dot. Nëna thoshte

se kështu e kanë gratë që lindin për herë të parë dhe pritëm. Por në të ngrysur u keqësua shumë.

— Nga vjen?

— Nga Bregasi.

— Gjystina, mamia, në atë anë ndodhet. Nuk e gjetët dot?

— E gjetëm, doktor, te ne është, po thotë se ka nevojë për ndihmën tuaj! — Ai mundohej ta mbante veten, por herë-herë zëri i dridhej dhe sytë i mbusheshin me trishtim.

— S'të dha ndonjë porosi për mua?

— Po, më dha këtë! — Ai futi dorën në gji dhe nxori një letër.

Ia rrëmbeva dhe e lexova shpejt e shpejt.

— Sa mban që këtëj?, — e pyeta me ankth.

— Nja dy orë, sonte që bie shi, ndoshta më shumë. Por, kam sjellë kalin, doktor! — Ai më vështroi me druajtje.

— S'e kam për vete, ore, kam hall të arrijmë sa më shpejt!, — e qetësova dhe brofa në këmbë.

— Po shkoj të përgatis kalin!, — tha djaloshi dhe doli rrëmbyeshëm, duke lënë karrigen e lagur dhe ca peggje të vogla në dysheme.

Ndërsa nxitohesha të vishesha, mendoja rrugën e largët nëpër atë natë me shi dhe më dukej tepër e këndshme dhoma ime e ngrohtë, që kundërmonte erë duhan, çaj dhe dru të lagura. Por, nga ana tjetër, ndieja gëzim të madh, kureshtje dhe ankth për të panjohurat e asaj nate që unë, për të parën herë në jetën time si mjek, po shkoja të shpëtoja dy jetë.

— Hip, shoku doktor!, — më tha fshatari, sapo dola te shkallët, duke afruar kalin.

— Prit, njëherë, do të shkojmë në spital, të marrim ca ilaçe!, — i thashë dhe nisa të nxitoja nëpër shi.

Më ndoqi pas, duke tërhequr kalin për kapistre. Ademi, që kishte rojën atë natë, u çudit kur më pa te pragu i spitalit. M'i bëri shpejt gati gjithë ç'i kërkova, i sistemoi në një çantë sanitare dhe më përcolli një copë

udhë, duke më qarë hallin. Unë desha të ecja në këmbë, se s'kisha udhëtuar ndonjëherë me kalë dhe druhesha mos rrëzohesha. Më keq turpi. Por fshatari nguli këmbë.

— Hip, ndryshe do të vonohemi!, — tha. — Unë jam mësuar të eci natën, se jam bari dhe shtegun e di symbyllur, kurse ju...

Vura këmbën në yzengji dhe u hodha mbi samar, por i dhashë shumë hov trupit dhe sa s'u rrëzova. Djaloshi mbërtheu frerin me një dorë dhe u nisëm përmes qytezës. Potkonjtë kërcisnin në zhurin e rrugës, piklat e shiut cikërinin mbi mushamanë time, shala kolovitej lehtë dhe unë shtrëngoja fort këmbët pas brinjëve të kalit.

Ecëm gjatë pa folur. E lamë pas qytetin dhe rrugën e makinës. Tani potkonjtë zhyteshin në baltën e shumë të një shtegu gjarpërues. Kur vetëtinte, plot pëllgje të vogla llamburitnin gjatë tij. Djaloshi i binte drejt, duke pllaurisur çizmet në to.

Ca nga ca u mësova me kolovitjen e samarit dhe qëndroja më lirshëm. Dalloja në errësirë kokën e kalit me jele të gjata, supet e gjera të fshatarit dhe mbi to, kapuçin e madh prej shajaku. Përtej tyre nderej errësira. Më dukej sikur udhëtonim prej disa orësh. Ndeza një cigare dhe në dritën e saj vështrova orën. S'ishte mbushur akoma një orë.

Pas pak filluan të më fshiknin degë të lagura. Kali nderi qafën, samari rrëshqiti pak prapa dhe unë mbërtheva fort duart në të. Shtegu shkonte përpjetë. Ndieja mornica sa herë më preknin në fytyrë degëzat apo gjetet e lagura. Këmbët po më mpiheshin. Edhe sa duhej të ecnim?

— Fshati ynë është pas korijes!, — tha djaloshi, si ta kishte kuptuar mendimin tim.

Vetëtimat filluan të dendësoheshin. Tani po ecnim mes një pylli të moçëm. Sa herë qielli përçahet me zjarr, më shfaqej para syve një pamje mahnitëse. Drurët e mëdhenj, me degët e kapërthyera diku lart, dukej sikur donin të ndalonin piklat e dendura të shiut, që lëshoheshin

më të poshtë, duke rrahur egër gjithçka. Rrëke uji zvarriteshin si gjarpërinj nëpër legushë, bashkoheshin, rriteshin dhe dukej sikur kërkonin njëra-tjetrën. Mbi trungete e gurë myshku vezullonte në të gjelbër, në të hirtë, si të qe i spërkatur me gur të çmuar. Hera-herës era shtohje dhe si një përbindësh i padukshëm nxitonte mes pyllit, duke përkulur degët me zemërim e duke lënë pas një gjëmim të mbytur.

E kisha harruar dhembjen e këmbëve, nuk i ndieja rrëqezat e vogla që depërtonin nëpër të çarat e mushamasë, sepse herë mahnitësja me ato pamje që më kujtonin përrallat e fëmijnisë, herë më mundonin mendimet për lehonën.

Dikur kali qëndroi në vend. Kthente kokën andej-këtej, i shqetësuar, dhe turfullonte. Fshatari shtrëngoi frerën dhe priti. Vallë, ujçit?!

— Të çlodhet një hop, se ishte e përpjetë e madhe. Tani arritëm!, — tha djaloshi, pastaj nxiti me një thirrje.

Ndërsa potkonjtë e kalit nisën të trokëllinin në kalldrëm dhe dallova siluetat e shtëpive të para të fshatit, më pushtoi ankthi, si para një provimi të vështirë. Për një çast m'u kujtua ndodhia me fëmijën e minatorit, por e largova me një rrëqethje atë fanitje dhe nisa të mendoja mbështetur në ato pak gjëra që më shkruante Gjystina se si duhej vepruar në atë çast.

Hymë në një oborr të madh. Në fund të tij dallohej silueta katrore e shtëpisë. Diku afër lehu një qen, por pushoi sakaq. Krisi një derë dhe në mes të shtëpisë u shfaq drejtkëndëshi i saj, i ndriçuar zbehtë.

— Sotir, ti je?, — pyeti një zë i shqetësuar gruaje, ndërsa silueta e saj po vinte drejt nesh. — Erdhi doktori?

— Si është lehona?, — pyeta me zë të lartë.

— Mbahet, po mezi, e gjora!, — Ajo zgjati kokën, sikur kjo do ta ndihmonte të më shquante në errësirë. — Doktori je ti?

— Doktori jam!, — iu përgjigja, ndërsa fshatari afroi kalin pranë një guri dhe më ndihmoi të zbrisja.

— Të lumshin këmbët, or bin! — tha gruaja, diçi më

e çelur dhe unë mendova se duhej të ishte plaka e shtëpisë.

Sa kalova prapun e dhomës ku më drejtuan, më mbështolli një afsh ngrohtësie dhe vura re një zjarr të madh që bubullonte dhe kërciste në vatër. Pranë saj dallova lehonën dhe Gjystinën, e cila brofi sakaq dhe erdhi drejt meje me një ofshamje lehtësimi, duke e bërë dyshtënë e vjetër të kërciste nën hapat e saj të nxituar.

— Akoma nuk po fiksohet koka e foshnjës!, — pëshpëriti, duke rrëmbyer nga dora ime çantën sanitare.

— Solla gjithçka munda!, — i thashë, hoqa çizmet, vara mushamanë dhe xhaketën në njërën nga gozhdët e shumta që ishin mbërthyer në një dërrasë të gjatë mbra-pa derës dhe iu afrova lehonës.

Fshatari kishte mbetur si i hutuar dhe hezitues te pragu.

— Ti shko!, — i thashë butë. — Mos ki merak, do të bëjmë ç'është e mundur që gjithçka të shkojë mirë.

Ai uli kokën, sikur desh të fshihte nga sytë tanë ankthin, dhe doli me nxitim.

Kur u përkula përmbi lehonën, ajo bëri një përpjekje të lëvizte, por nuk mundi. Flakët e zjarrit ia tregonin fytyrën të kuqe, por sytë i kishte të venitur dhe shtrëngonte me dhëmbë buzën e poshme, që të mbante rënkimet.

E vizitova me kujdes. Rrahjet e zezës së foshnjës ishin të dobëta dhe shumë të shpeshta.

— Mendoj se duhet bërë sa më parë perforimi i membranës së ujërave!, — i thashë Gjystinës.

— Ashtu është, bile kam vënë gërshërët e shtëpisë të vlojnë aty! — Ajo më tregoi me dorë një kusi që gurullonte, e varur në çengel e vatrës. — Po të ishte vonuar edhe ca...

— Ke atje gërshërët kirurgjikale, në garzë sterile!, — i thashë, duke kthyer kokën nga çanta sanitare. — Kam sjellë edhe glukozë, folikulinë, bile edhe kompletin e kyretazhit, për çdo të papritur... Forca, të bëjmë perforimin sa më parë!

Gjystina më hodhi një vështrim miratues dhe nxitoi të çelte çantën.

— Nënë, sillna disa çarçafë të pastër, nja dy llamba të tjera dhe vër të vlojë ujë në një enë të madhe, shpjet! — iu ktheva plakës.

Ajo, që kishte qëndruar si e mpirë te këmbët e lehonës, brofi më nxitim me një shkathtësi të pazakontë për moshën e saj.

— Bëji një glukozë!, — i thashë Gjystinës dhe në pritje të plakës, hodha një herë sytë rreth e qark.

Dhoma ishte e gjerë, e vjetër, e sherbetisur mirë me gëlqere dhe e tavanosur me dërrasa të nxira nga koha. Në të dyja anët e vatrës shtriheshin shilte të gjata, të mbuluara me velenxa fshati, me një sërë jastëkësh për t'u mbështetur. Më tej dallohej një sergjen, një sënduk i moçëm dhe një raft i ri, të cilët lëshonin përmbi faqet e mureve ca hije të gjata që lodronin sipas hoveve të flakës.

Plaka u kthye shpejt me çarçafët dhe nxitoi të merite llambat që dikush, ndoshta Sotiri, ia kishte sjellë gjer prapa derës. Unë lava mirë e mirë duart, i thashë plakës të na mbante karshi dy llamba, një në secilën dorë dhe i bëra shenjë Gjystinës të fillonim...

Nuk e di sa orë zgjati, por, kur shpërthyen ty qarat e të sapolindurit dhe në fytyrën e vuajtur të lehonës u ravijëzua një buzëqeshje, nga dritaret kishte filluar të hynte një dritë e mekët kaltëroshe. Vetëm atëherë e ndjeva sa i lodhur isha. Lashë Gjystinën të përkujdesej më tej dhe dola në hajat.

— Të të rrojë djali!, — i thashë Sotirit, që priste te pragu i portës së jashtme, duke thithur fort cigaren.

Në dritën e kuqërremtë të saj, i pashë fytyrën. Mundohet të tregohej i përmbajtur, por në zë i ndjeva një gëzim dhe lumturi të paanë.

— Sotir, Sotir, more, ku e ke çiften, se do ta zbraz një herë!, — thirri mbas pak plaka.

— Jo, nënë, se bëhet alarm!, — kundërshtoi ai, duke i dalë përpara.

— Le të bëhet, bre, se na shpëtuan dy jetë!, — ngulte këmbë ajo.

— Jo, jo nënë, s'bën!

I lashë në gëzimin e tyre dhe dola vjedhurazi në oborr. U mbështeta në trungun e një peme. Nga shtëpia vinin zhurma të gëzuara.

«Çudi, edhe zhurmat janë të gëzuara ose të trishtuara!», — mendova, duke nuhatur me ëndje ajrin e ftohtë që kundërmonte erë dheu të lagur, erë sane, kallamishtesh, grazhdi dhe plot të tjera, që përbëjnë atë aromën karakteristike të fshatit.

Lodhja dhe kënaqësia më qenë tretur në një ndjenjë të vetme, të papërcaktuar mirë, por që më kishte pushuar krejtësisht. Më dukej sikur era më përkëdhelte, sikur siluetat e agimit më vështronin plot dashuri me sytë e tyre të panumërt.

Ngrita sytë përperjetë. Shiu kishte pushuar dhe retë nxitonin drejt jugut, duke lënë pas yje të rralla, që po veniteshin në qiellin e kthjelluar e të ndriçuar zbehtë.

— Doktor, shoku doktor!, — thirri një zë i njohur nëpër oborr.

U shkëputa nga mendimet, si të isha zgjuar nga një ëndërr e bukur. U drejtova nga shtëpia.

— Urdhëro, doktor, urdhëro dhe na fal, se u hutuam fare nga gëzimi!, — tha Sotiri, duke më drejtuar te dhoma e miqve.

— Uh, korba unë, ti i paske këmbët të lagura! Çupë, çupë moj, sill shpejt një legen me ujë të nxehtë...

Vështroja atë plakë të thinjur, aq të shpejtë e të shkathët, vështroja sytë laramanë të moshatarit tim, që shkëlqenin me një gëzim të përmbajtur dhe ndieja një ngazëllim të thellë.

7.

Po afronte Viti i Ri. Në vigjilje të kësaj feste, krahas gëzimit, gjithmonë kam ndier një farë nostalgjie. Ndoshta, është nostalgjia e ndarjes nga një vit jete dhe

pune; është gëzimi që të sjellin shpresat, dëshirat, planet dhe ëndërrimet e së ardhmes. Por, këtë herë kisha edhe diçka tjetër që ma ndillte nostalgjinë: për herë të parë në jetën time do ta kaloja natën e Vitit të Ri larg familjes.

Disa ditë më parë Ademi ma kishte sjellë fjalën se ai, për hir të detyrës, pothuaj çdo vit kishte qenë i detyruar ta bënte festën aty, kurse sivjet kishte shumë dëshirë të shkonte te të afërmit, bashkë me të shoqen. Ishte një kërkesë e drejtë, aq më tepër se ai më kishte zëvendësuar ato ditë që shkova në shtëpi, me rastin e festës së Çlirimit. Prandaj, i rekomandova kryetar Thanasit t'i jepte leje, se do të qëndroja vetë në qytezë.

Çdo ditë më vinin kartolina. Megjithëse urimet ishin të ngjashme njëri me tjetrin, ato më sillnin para syve të mendjes fytyra të ndryshme njerëzish dhe lloj-lloj kujtimesh që lidheshin me ta. I renditja urimet në sirtar dhe u përgjigjesha me radhë të gjithëve. Asnjëherë nuk kisha shkruar kaq shumë kartolina.

Gjer ditën e parafundit nuk e dija se qysh dhe me kë do ta kaloja mbrëmjen e fundit të vitit. Shumë nga shokët e mi po bëheshin gati të shkonin nëpër shtëpi dhe, si në çdo festë, do të mbeteshin në qytezë pothuaj vetëm ata që kishin familjet e tyre aty. Pyetja «kur do të nisesh?» ishte bërë ato ditë si një «tungjatjeta».

«Fundi, edhe në e kalofsha në spital, s'bëhet kiameti; plot të tjerë, në të katër anët e vendit, do ta kalojnë në krye të detyrës!», — i dhashë karar dikur dhe vendosa të mos e vrisja fort mendjen për atë punë.

Ditët e fundit filluan të më vinin ftesat si breshër. Paraditen e 30 dhjetorit ia behu në spital xha Andoni. Kur më dalloj te pragu, ai ndaloi menjëherë, vuri dorën strehë mbi vetulla dhe më vështroi një hop me qortim.

— Po mirë, more djalë, ç'borxh ta pata këtë të për-pjetë?!, — turfulloi pastaj. — Ku je, more, që humbe si sëpata pa bisht?

— Na kanë dalë shumë punë këto ditë, xha Andon...

— Pse nuk më tregove se do ta kalosh këtu Vitin e Ri,

hë? — Ai i ra tokës me bastun, por dallohej se nuk e kishte me gjithë mend.

— Po nuk jemi takuar...

— Hm... Meriton një të fortë ti, por s'ta kam ngenë, se do të dal të pres Miçon... Dëgjo këtu: më 31 dhjetor mbasdite, lër adresën time në spital, vëri drynin dhomës dhe thuaj «mirë të gjetsha më 3 janar», more vesh?!

Për herë të parë ai m'u duk si një mësues i rreptë aritmetike dhe vetja, si një nxënës që duhej të bindej.

Andej nga dreka erdhi të më ftonte Kiçoja. I erdhi keq kur mori vesh se e kisha dhënë fjalën gjetiu.

— I thashë Linës të të ftonte, por asaj iu duk më me vend të vija vetë. Ja tek erdha, por vonë, ta marrë e mira! — tha, i pezmatuar. — Jo se do të kaloje më mirë tek unë, por ma donte zemra.

— Zemra e mirë vlen më shumë se gjithçka, Kiço!, — i thashë, mirënjohës. — Do t'ju vij pa tjetër për urim.

— Makar për drekën e vitit!, — m'u lut ai. — Ç'ke ti, me xha Andonin flas vetë!

— Atëherë, po!, — buzëqesha.

Deri të nesërmen pata edhe tri-katër ftesa të tjera. Më erdhi mirë që, brenda një kohe aq të shkurtër, genkësja bërë aq i afërt për banorët e qytezës. Pyeta veten e meritoja vërtet këtë, apo mos ishte thjesht një shprehje e bujarisë dhe e mikpritjes së tyre.

Mbasditen e 31 dhjetorit shkova të bisedoja në telefon me familjen. Centralistja bëri çmos dhe më lidhi shpejt. Dëgjova zërin e ngrohtë të nënës, që më bëri gjithë ato pyetje dhe më dha plot porosi, pastaj m'u desh të pajtoja vëllanë e vogël, duke i premtuar se do të shkoja brenda janarit, kurse në fund u përshëndeta me babanë. Dëgjohej qartë, më dukej sikur ata i kisha aty pranë dhe nuk më bëhej ta mbyllja bisedën, gjersa ndërhyri një centraliste e panjohur, «më shpejt, shok, kemi shumë kërkesa»! Dola nga postë-telegrafi disi i çmallur.

Në të ngrysur trokita në shtëpinë e xha Andonit.

Ai doli e më priti buzagaz bashkë me të birin, Miçon, i cili dukej si një shëmbëlltyrë e rinisë së të atit. Sapo hyra në korridor, u dha te pragu i dhomës së pritjes edhe Kristina, me një përparëse të bardhë.

— Oho, jemi fort të nderuar që denjuat, fort i larti doktor!, — tha ajo, duke bërë një përkulje të thellë e duke shtrirë duart anash, si në komeditë mesjetare.

— Mos i bjer në qafë djalit, se e qortova një herë unë!, — më doli krah xha Andoni, — Borxhi s'lahet dy herë!

Vura re, me një farë habie, se orenditë e korridorit ishin rralluar dhe ai dukej më i gjerë se zakonisht.

— Rinia ka menduar për vallëzim!, — më sqaroi i zoti i shtëpisë, duke ia bërë me kokë nga Kristina dhe i biri.

Pastaj hyra në dhomën e njohur e të dashur dhe zura vend në minderin me velenxë të kuqe. Një bredh, që ishte i bukur edhe pa stolitë e rastit, ngrihej kokorog në njërin cep të dhomës, duke sjellë aty vizionin dhe aromën e bjeshkëve. Nga kuzhina erdhi teto Zoga me pjata në duar. Më përqafoi sikur të kishim kohë pa u parë dhe vazhdoi të shtronte tavolinën, më e gëzuar se asnjëherë. Miçoja nxitoi të më jepte cigare dhe m'u lut të ndihesha si në familjen time. I thashë se unë ashtu ndihesha te xha Andoni dhe i moshuari më falënderoi me një vështrim.

Pas pak erdhën edhe pjesëtarët e tjerë të mbrëmjes, Ibrahimimi me të shoqen, Ritën dhe Vjollca, e cila ishte mësuese gjuhe në të njëjtin fshat. Ato të dyja kishin ti-pare të kundërta dhe sikur plotësonin njëra-tjetrën. Ndërsa Rita ishte flokëverdhe, sykaltër, lëkurhollë dhe me lëvizje të shtruara, Vjollca ishte flokëzezë e syzezë, me lëkurë si cipë pjeshke dhe me lëvizje të shkathta.

Si u përshëndetëm me njëri-tjetrin, ato të dyja kërkuan të falur, rrëmbyen çantat e udhëtimit dhe dolën pas Kristinës. Ibrahimimi zuri vend pranë meje. Mbas pak xha Andoni diçka e pyeti për shkollën dhe ata nisën

një bisedë profesionale. Kështu, ngela një hop me veten.

Vështroja teto Zogën, që sillej rreth tavolinës, e shqetësuar se mos kishte lënë gjë mangut, dhe Miçon që po mundohej të vinte mirë në stacion, radion. Dëgjoja zërin e kumbueshëm të xha Andonit, që diçka kundërshtonte; çuçuritjet e gëzuara të atyre të triave në dhomën tjetër dhe gulshet e erës që fishkëllente në çati. Nuhasja kundërmimin e mishit të pjekur dhe aromën e brendhit. Ndieja afshin e zjarrtë që bubullinte në sobë. Më dukej sikur prindërit dhe vëllai ndodheshin në dhomën tjetër...

Ato të tria hynë si me druajtje, duke tërhequr për dore shoqja-shoqen. Tani që ishin ndërruar dhe rregulluar, dukeshin më të freskëta dhe më të bukura. Mua më mbetën sytë te Kristina. Ajo më qe dukur e bukur me çdo lloj veshjeje, por fustani i trikotuar ngjyrë vishnje i shkonte vërtet shumë. Vetëm kur Kristina uli kokën, disi e turpëruar, e kuptova se do ta kisha tepruar me vështrimin tim dhe nxitova të lavdëroja pamjen e dy të tjerave.

Mbasi dëgjuan me kënaqësi lavdërimet tona, ato iu qepën Ibrahimit që të shkonte të ndërrohej, se nuk kishte fare lezet me atë kostum të zhubrosur dhe gjithë pluhur. Ai s'pati nga t'ia mbante dhe doli, duke ngritur supet. Ndërkohë, Miçoja u hoqi tapat shisheve dhe mbushi gotat.

Me t'u kthyer Ibrahimimi, të cilin sikur e kishte ngathtësuar disi kostumi i ri, xha Andoni ngriti dollinë e parë, duke na uruar ta kalonim gëzuar. Çukitëm gotat, kryqëzuan urimet dhe cimbisëm mezetë. Me të pësuar cungimet e para, pjatat e mezeve, që ishin stolitur me lajlelule si s'ka më mirë, e humbën bukurinë. Ndërsa ngulja pirunin në petalet prej riskash sallami të një luleje, mendova buzagaz se edhe të rriturve u pëlqen nganjëherë të luajnë, njësoj si fëmijët.

— Ibrahim, ua nise telegramin familjeve?, — u kujtua Rita.

— Posi, me shenjën «urgjent», bile!, — iu përgjigj ai.
— Nuk mundëm të shkonim, se jemi larg, njëri në një krah e tjetri në tjetrin!, — buzëqeshi, duke u kthyer nga ne.

— Se mos vetëm ju!, — vëreja.

— E kam të qartë. Ja, edhe Vjollca, edhe ti, si dhe plot të tjerë. Por ja tek po e kalojmë së bashku, për-bukuri!

Radioja po transmetonte një tango të bukur. Kristina propozoi të vallëzonim. E përkrahëm njëzëri dhe brofëm në këmbë. Por, unë mbeta thatë, se hyri në pjesë edhe xha Andoni. Kristina nisi të kërcente me Miçon dhe ma bëri me kokë në drejtim të teto Zogës. Të tjerët qeshën. Unë ndeza një cigare dhe u shtira i zemëruar.

Melodia pasardhëse ishte ritëm, kështu që xha Andoni u mënjanua vullnetarisht dhe u rivendos ballancimi midis palëve. Për t'u hakmarrë, nuk e ftova për vallëzim Kristinën. Kërceva me Vjollcën. Ajo kërcente lehtë dhe bukur.

— Besoj se do të keni mërdhirë dhe do të jeni lodhur nga rruga!, — i thashë, duke vënë re se duart i kishte akoma të ftohta dhe në flokë i vezullonin ca pikla shiu.

— Oh, jo!, — buzëqeshi ajo. — Ne jemi mësuar të ecim në këmbë. Pastaj, mezi e kam pritur këtë mbrëmje. Më kishte marrë malli të kërceja me shokët...

Ndërkohë, na u afruan duke vallëzuar Ibrahimimi me Ritën. Vura re se ishin harruar në sytë e njëri-tjetrit dhe buzëqesha me dhembshuri.

— Sa të rinj që janë martuar!, — i thashë Vjollcës, duke ia bërë me shenjë në drejtim të tyre. — Ngjajnë më tepër si dashnorë.

— Ashtu, vërtet!, — buzëqeshi Vjollca. — Duhet shumë dhe janë të lumtur!

Një hije e lehtë trishtimi kaloi në sytë e saj. E dija se kishte pësuar një zhgënjim në dashuri.

— Pse, ne të tjerët nuk jemi?, — thashë, duke i hedhur një vështrim inkurajues.

Ajo uli sytë dhe heshti një hop e menduar.

— Po, çdo njeri mund të jetë i lumtur, po të dojë!, — tha pastaj. — Mjafton të ketë një qëllim në jetë dhe të luftojë për të.

Ajo kishte ngritur kokën dhe më vështronte me guxim në sy. Vështrimi i qe kthjelluar. Unë i buzëqesha dhe i shtrëngova dorën shoqërisht.

Radhën tjetër erdhi e më ftoi Kristina.

— Refuzimi ndalohet, kështu thotë rregullorja e mbrëmjes!, — më paralajmëroi, nga frika se mos ia punoja.

Qesha, brofa në këmbë dhe e përfshiva për beli. Ajo më tërhoqi lehtë-lehtë drejt korridorit. Çdo gjymtyrë e trupit të saj lëvizte me ritmin e melodisë. Herë më dukej sikur do të më shpëtonte nga duart, herë e ndieja fare pranë dhe nuhasja një aromë të papërcaktuar, por që ishte aroma e saj.

— Të pëlqen mbrëmja jonë?, — pyeti ajo.

— Shumë.

— E thua për të më bërë qejfin?

— Për kokën tënde që jo!, — bëra shaka.

— Aq të bën ty për kokën time!, — vërejti ajo mosbesuese.

— Pse flet kështu?

— Sepse, kur t'u luta të merrnim pjesë bashkë në grupin e estradës, nuk pranove.

— Qysh të pranoja, kur s'kam pikë talenti?!

— Ej, posi! Thuaj më mirë që nuk deshe, se e nënvleftëson këtë punë!

— Po më nxjerr edhe me koncepte, pale!

— Sipas sëmundjes, diagnozën!, — buzëqeshi ajo.

— Prandaj më bën bisht kohët e fundit, ke frikë mos të t'i ngjis këto koncepte?, — pyeta duke e mbërthyer me sy.

Ajo ngriti supet dhe më pa gjoja e habitur, por s'i qëndroi dot vështrimit tim dhe uli kokën.

— Edhe kur takohemi rastësisht, shtiresht sikur të pret

një punë e ngutshme diku dhe bëhesh erë!, — vazhdova me qortim. — Pse kështu, Kristinë?

— Ka qëlluar!, — u mundua të justifikohesha ajo pa i ngritur sytë.

— Kaq shpesh?!... Apo ke frikë nga thashethemet?

— Pse të kem frikë, kur s'bëj asgjë të keqe?!

— Atëherë?!...

— Sa kavalier i ngathët që je!, — u ankua ajo, duke i bërë bisht përgjigjes. — Më shpejt, më shpejt...

Qesha dhe nisa ta vërtisja me shpejtësi, ndërsa muret e korridorit, orenditë dhe bustet e vallëzuesve më rrotulloheshin marramenthi para syve. Kristina bëhej gjithmonë më e lehtë në krahët e mi dhe qeshte, qeshte me një kumbim të kristaltë.

«Vërtet, pse më shmanget kur është e qartë se të dyve na pëlqen shoqëria e njëri-tjetrit?!», — pyeta veten, ndërsa e vështroja me ngulm në sy. — «E kanë fajin thashethemet, apo e kam fajin vetë unë, që e trajtoj nganjëherë si fëmijë?!...»

— Ej, rini, mjaft me vallëzim, se na e latë gurmazin thatë!, — thirri xha Andoni.

— Të pimë për të gjithë ne!, — tha Ibrahimimi, duke e përfunduar vërtitjen e fundit bash pranë tryezës. — Gëzuar!

— Gëzuar!

— Gëzuar!...

E ktheva pa frymë gotën. Miçoja nxitoi të mambushte përsëri.

— Kristina e paska pjekur mirë mishin kësaj radhe, vjet e kishte djegur!, — vërejti Ibrahimimi, duke kollofitur një copë të madhe.

— Kristina di vetëm të hedhë valle!, — kërceu teto Zoga. — Mishin e ka pjekur tjetërkush.

— Të lumshin duart, nëne!, — buzëqeshi Rita.

Miçoja diçka i tregoi Vjollcës dhe ajo qeshi me të madhe. Ritës i qenë skuqur faqet dhe sytë i shkëlqenin si thëngjij të ndezur. Ibrahimimi i vërtitej tavolinës si ndonjë skifter që kërkon gjah. Xha Andoni na përqafonte

me vështrimin e tij plot mirësi. Me pjatat e boshatisura, të vendosura njëra mbi tjetrën, me gotat e përgjysmuara, me enët plot fruta, tavolina i ngjante një tabloje të madhe natyre të qetë.

Ndieja një ngazëllim të paanë, që sikur po më përhapej bashkë me gjakun në çdo pjesë të qenies sime, pastaj më mblidhej lëmsh në gjoks dhe më bënte të ndieja nevojën që të merrja frymë thellë.

A s'ia marrim një kënge?, — thashë aq fort, sa të tjerët kthyen menjëherë sytë nga unë.

— Të këndojmë, posi!

— Merrjani, pra!

Kënga nisi ngadalë, u zvarrit ca, stonoi aty-këtu, por pastaj filloi të rridhte e gjallë, e bukur, plot ndjenjë. Më dukej sikur zëri më buronte pikërisht nga ai vend i gjoksit, ku më qe mbledhur lëmsh ngazëllimi dhe, si një përrua i fryrë prej ujërave të pranverës, shkonte e bashkohej me lumën e zërave të tjerë, i cili buçiste e shkumëzonte, me shtërkala të bardha, kaltëroshe, rozë, ngjyrë vjollce...

Vështroja ballin rinor të Ibrahimit, fytyrën e ndezur prush të Ritës, buzëqeshjen e çiltër të Vjollcës, sytë plot mirësi të xha Andonit, shpatullat djaloshare të Miços, thijnjat e teto Zogës, pamjen ëndërrimetare të Kristinës, i vështroja të gjithë dhe ndieja një dashuri të madhe për ta. Do të dëshiroja t'i kisha krahët aq të gjatë dhe gjoksin aq të gjerë, sa të mund t'i përqafoja të gjithë bashkë.

Ibrahimi më hodhi krahun. Në anën tjetër, Kristina kishte mbështetur kokën në supin e Ritës. Sytë e xha Andonit, tek na vështronin me dhembshuri, dukeshin më të thellë e më të kthjellët se zakonisht. Teto Zoga përkëdhelte me majat e gishtërinjve flokët e Vjollcës. Kënga dhe ndjenjat na kishin lidhur me fije të padukshme. Bashkë me këngën, vibronin edhe zemrat tona.

U fikën dritat. Një hop u bë heshtje, sa u dëgjua fishkëllima e erës përjashta, bubullitja e zjarrit në sobë dhe frymëmarrja e Kristinës afër meje. Pastaj, dritat er-

dhën përsëri, të pritura me thirrje të gëzueshme. U dëgjua zëri familjar i spikeres së Radio-Tiranës:

— Ju urojmë të gjithëve, gëzuar Vitin e Ri, suksesese në punë, shëndet dhe lumturi në familje! Nën udhëheqjen e Partisë, përpara për ta kthyer vitin e fundit të pesëvjeçarit të dytë në një vit fitoresh të reja për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

— Gëzuar, shoqe dhe shokë!

— Qofshi të lumtur, bij e bija!

— Bashkë me ju, të na rroni!

— Beqarëve, dasmën!

— Mbushini përsëri gotat! Hajde, gëzuar!...

8.

Atë të premtë pasdite orari i vizitave mjekësore po më dukej fort i gjatë, ndoshta pse vizitat qëlluan të pakta dhe me intervale pritjeje ndërmjet tyre, apo ndoshta sepse po i afrohej fundi javës së parë të janarit dhe më shqetësonte mendimi se, për pakujdesinë time, s'do ta mbaja dot fjalën që i kisha dhënë vëllait të vogël në telefon. Kur u kujtova t'i kërkoja leje për të hënë paradite kryetar Thanasit, mësova se ai qenkësh nisur me shërbim diku larg dhe s'dihej kur kthehej. Të paktën, t'i bëja ndonjë lajmthirrje familjes, përndryshe nëna do të shqetësohej.

Për këtë mendoja kur erdhi Skënder Topi, bashkë me një burrë që i ngjante fort, por që dukej më i ri dhe më i dobët se ai.

— Ky është im vëlla, Hasani!, — ma paraqiti Skënderi. — Është i vetmi që nuk e njeh, se zbret rrallë e për mall nga fshati. Kohët e fundit s'ka qenë mirë me shëndet, por mezi u kandis të vinte për vizitë. Mbante shpresë në ca barishte dhe ca melheme që ia këshilluan disa fshatarë të moçëm, por... aha!

— Edhe mjekimet popullore janë të dobishme, kur përdoren me vend!, — vëreja, duke i buzëqeshur Hasa-

nit, i cili priste në këmbë, i heshtur dhe me një pamje të përvuajtur.

— Kur përdoren me vend, ama!, — theksoi Skënderi. — Se, fjala vjen, kripa i shkon turshisë, jo oshafit!... Kurse ky, akoma nuk e di se ç'ka, prandaj e solla. Pritëm enkas në fund, që të jesh më nge dhe ta vizitosh mirë.

I thashë Hasanit të zinte vend në shtratin e vizitave. Ai u ul me një ofshamje lehtësimi dhe nisi t'u përgjigjej pyetjeve të mia me ndërprerje, se i mbahej fryma. Përveç kësaj, ankohej se i dhimbnin mesi dhe kyçet.

— Dyshoj për reumatizëm dhe astmë!, — thashë, mbasi e vizitova me kujdes. — Mendoj ta shtrojmë disa ditë, t'i bëjmë ca mjekime dhe të vërejmë se ç'rrugë do të marrë sëmundja. Si thua, Hasan?

Si duket, Hasanit s'ia kishte ënda të shtrohej, se më pyeti a mund të bëheshin mjekimet në shtëpi por Skënderi i dha karar dhe unë nisa t'i plotësoja menjëherë kartelën e shtrimit. Në të mbaruar të kësaj pune, trokiti dera dhe u shfaq prapa kanateve të saj koka e Thanasit.

— Urdhëroni, shoku kryetar!, — e ftova, i gëzuar.

— Mbaroni njëherë me ta! — ma priti ai dhe mbylli me kujdes derën.

Si përfundova kartelën, ia zgjata Linës, duke i dhënë udhëzime plotësuese, pastaj dola në korridor, pas atyre të dyve. Vura re se Thanasi po priste në stolin e gjatë prapa derës, bashkë me një fshatar të moshuar dhe që të dy po pinin cigare të dredhura me duhan të fortë fshati. Në cepin e stolit qëndronte kokulur një nuse e re.

— Urdhëroni!, — u thashë.

Për çudinë time, hyri vetëm Thanasi.

— E, shoku doktor, punë shumë, hë?, — pyeti.

— Sot, jo edhe aq!, — iu përgjigja.

— Bukur fort, sa më pak të sëmurë, aq më mirë!, — tha ai, duke fërkuar duart, shenjë kjo se kishte një bisedë me rëndësi.

— Ndonjë nga farefisi juaj?, — pyeta, duke ia bërë me kokë nga korridori.

— Jo, bre, deri dje as që i njihja. Janë nga Skapatina, fshati më i largët i krahinës. Isha atje i deleguar në një mbledhje partie dhe ma kërkoi puna t'i sjell me vete. Mezi ua mbusha mendjen. Një mesele e ngatërruar, që ishalla zgjidhet, me ndihmën tënde, sigurisht.

— Si është puna?, — pyeta, kureshtar.

— Punë dreqi... — Ai fërkoj përsëri duart me zhurmë.

Ajo është nusja e të birit. Kanë pesë vjet martuar dhe s'po lind fëmijë. Këndej, nga anët tona, kjo është e rëndë fort. Rrezik ta ndajnë gruan. Por, puna e këtyre është më keq akoma. Ai, Bakoja, — kryetari bëri me kokë nga korridori, — që i kripsha mendjen, e paska çuar vjet nusen në një vend gjoja të shenjtë, që bëka mrekullira për këto punë. Këto ditë po matej ta çonte përsëri. Doli në mbledhjen e partisë. Atëherë, mbrëmë i shkova mik në shtëpi dhe s'ia zura me dorë gotën e rakisë, pa më dhënë fjalën se do ta sillte nusen për vizitë mjekësore. U zungushtë dhe pranoi. Ti e kupton vetë ç'do të thotë sikur ajo të bëhet e zonja të lindë: po vendi i shenjtë, po shkenca...

— E qartë, por unë s'jam specialist, kurse Gjystina...

— Tani që e solla deri këtu, s'e lëshoj pa e çuar ku të jetë nevoja, sikur nga xhepi t'ia heq shpenzimet!, — më ndërpreu kryetar Thanasi. — Por, vizitojeni njëherë.

— Pa tjetër!

Thirra Gjystinën dhe e ftova nusen të hynte brenda. Ajo vështroi me bisht të syrit të vjehrrin dhe priti miratimin e tij. Ai brofi në këmbë, ngurroi një hop, pastaj u mat të hynte bashkë me nusen.

— Ti, xha Bako, bëji shoqëri shokut Thanas!, — e ndalova buzagaz, kurse Gjystina shkoi e mori nusen për krahu dhe e shoqëroi brenda.

E patëm pisk me të. U mblodh kruspull në një skaj, hezitonte të vizitohej dhe, kur e pyesnim, më fort Gjystina sesa unë, bëhej prush në fytyrë, ulte kokën dhe heshte. Na u desh t'ia nxirrnim përgjigjet si me darë.

— Duket e shëndetshme dhe e zhvilluar normalisht!,

— tha Gjystja, kur u hoqëm mënjanë të bisedonim. — Megjithatë, dyshoj për një aneksit.

— Mundet, por nuk duhet të ngutemi!, — i pëshpërita. — Mendoj se është e domosdoshme t'i bëjmë një vizitë të specializuar në Tiranë, por ta shtrojmë njëherë, mos të na shpëtojë nga dora. Është rast i veçantë, ta them pastaj.

— Mirë atëherë!

Kur dola te pragu dhe u thashë se nusen do ta mbanim në spital dhe se shpresonim ta shëronim, xha Bakoja më hodhi një vështrim të zemëruar e disi përgmues. Si duket, ai s'e priste t'i dilte kaq e gjatë dhe nga ana tjetër, s'i mbushej fare mendja se një femër flokëshkurtër dhe një djalosh si unë, mund të bënim atë që s'po e bënte dot vendi i shenjtë.

— Ta mbani, ore, posi!, — u ngut të thoshte kryetar Thanasi. — Xha Bakoja e ka lënë këtë punë në dorën time, prandaj... Është burrë i fjalës ky!

— Do ta mbani shumë?, — bubulloi xha Bakoja me sytë përdhe.

— Nja dhjetë ditë!, — u përgjigja. — Sidoqoftë, ju çojmë fjalë me shokun Thanas.

— Posi, ore, brenda ditës, me korrierin e fshatit, që vjen për postën dhe gazetat!, — u hodh përsëri kryetari.

— Po ajo ka ardhur vetëm me rrobat e trupit!, — vërejti plaku. — Sikur ta sjellim një ditë tjetër, se ma merr mendja që pret kjo punë.

— Mos u bën merak, i kemi ne të gjitha!, — ndërhyri Gjystina.

Plaku u vrenjt dhe e vështroi shtrembër, sikur deshi t'i thoshte: «Pusho ti, moj leshprerë!»

— Epo.. ç'ti bësh Thanasit!, — psherëtiu pastaj. U përshëndosh thatë me nusen, na zgjati dorën me një vështrim të ngrysur dhe doli si me dy mendje, i përcjellë nga Thanasi

— Doktor, desh harrova të të jap sihariqin!, — më thirri ai që nga pragu i daljes. — Është miratuar në planin e këtij viti ndërtimi i spitalit të ri.

— Të lumtë goja!, — thashë i gëzuar.

— Takomë më vonë, të të jap hollësira, sa të përcjell xha Bakon njëherë. Të më takosh pa tjetër, more vesh?
— Ai më shkeli syrin me nënkuptim dhe nxitoi pas plakut.

Mbas ndonjë ore, si u binda se me të rishtuarit çdo gjë shkonte në rregull, bile, Gjystina kishte filluar të miqësohej me nusen dhe po bisedonin për qëndisimat e jeklekut të saj, u nisa në kërkim të Thanasit. Si zakonisht në qytezat e vogla, nuk e pata të vështirë për ta gjetur. Po pinte kafe me ca shokë në lokalin e vogël të kinoklubit. Brofi kur më pa, më tregoi një karrige pranë vetes dhe porositi një ekspres tjetër.

— A s'më thoni, vërtet u miratua ndërtimi i spitalit të ri?, — pyeta duke zënë vend pranë tij.

— Vërtet, pse, ç'ka për t'u çuditur këtu?!, — buzëqeshi ai.

— Jo, por ngaqë e kemi dëshiruar kaq shumë...

— Bile, zyra e urbanistikës paska filluar të bëjë projektidenë qysh në dhjetor. Duhet të shkosh e ta shikosh ndonjë ditë, që të na dalë spital për të qenë.

— Pa tjetër!

— Tani, më trego hollë-hollë për atë nusen!, — u tregua i padurueshëm kryetari.

Ia thashë mendimet tona dhe theksova se, pa humbur kohë, ajo duhej çuar për një vizitë të specializuar në Tiranë. Shpresoja se ish-pedagogu im i gjinekologjisë do të na ndihmonte të kryenim punë brenda ditës dhe, ç'ishte kryesorja, të qëllonim në shenjë, sigurisht, po të ishte diçka e shërueshme.

— Bukur fort, qysh nesër, atëherë!, — vendosi kryetari. — Vër nusen dhe maminë në autoambulancë dhe nis!

— Po nesër është e shtunë!, — thashë më dyzaj.

— E pastaj, s'mbaroni dot punë?

— Jo për këtë, por mos kujtojë ndokush se e bëra për të shkuar rehat në shtëpi!

— Eh, përralla!, — qeshi kryetari, duke bërë një gjest

nënvleftësimi me dorë. — Tymi i punës të shkojë drejt, pa të tjerat... Kur të përfundosh vizitën, ato të dyja nisi përpjetë me autoambulancë, kurse ti qëndro ndonjë ditë në familje, se ke qysh në nëntor pa shkuar. Kthehu të martën.

— Të hënën pasdite jam këtu!, — thashë.

— Si ta shohësh vetë të arsyeshme!... Tani, merr kafënë, se tu ftoh!

E gjerba ekspresin me ngut dhe i kërkova të falur Thanasit, që të merrja masat e nevojshme.

— Edhe unë po dal, s'kam ç'bëj këtu, ty të prita!, — tha ai. — Të shkoj njëherë me kohë në shtëpi, se po bëhem mysafir në familje dhe s'ka lezet kjo punë...

U ndamë te shkallët e kinoklubit, mbasi më uroi sukses dhe më porositi t'u bëja të fala në familje nga ana e tij. Kur mbeta vetëm, mendova të njoftoja së pari shoferin e autoambulancës dhe u nisa drejt shtëpisë së tij përmes godinave, që t'i bija shkurt, por më doli gjatë, se më mbiu përpara dhe m'u bë ferrë Liliana.

— Oh, doktori!, — u shtir e gëzuar, si ndonjë fëmijë ajo. — Po ku je, more doktor, na humbe fare, s'na e ke shkelur pragun qysh kur ishte sëmurë Ademi!, — më qortoi pastaj, me një mirësjellje dhe delikatesë të kërkuar. — Makar, për të na uruar Vitin e Ri...

— Por ju ishit në Tiranë, s'ka tri ditë që jeni kthyer!, — vëreja.

— Vërtet, s'ka tri ditë, po mua më duken si tri javë!, — tha ajo, këtë herë e sinqertë në hidhërimin e vet.

— Iku si një ëndërr...

— E paskeni kaluar bukur, hë?

— Mbrëmjen e vitit... diçka. Bollëk ushqimesh e pijesh, biseda, shaka, lojë letrash, por, si të thuash... pleqërishte.

«Se mos ti je kaq e re, sa ç'kërkon të dukesh!», — mendova.

— Megjithatë, të nesërmen shkuam me një rreth të zgjedhur në lokal dhe e morëm shpagimin, kërcyem sa na u mpinë këmbët!, — vazhdoi ajo, buzagaz. — Pastaj, ambi-

enti, Fatos... Të kenaqet syri ngado që ta kthesh. Të kujtova disa herë dhe më erdhi keq që për hatrin tonë...

— Edhe ne e kaluam shumë bukur!, — thashë.

— Diçka dëgjova!, — buzëqeshi ajo me një farë nënkuptimi. — Ishte edhe Kristina, hë?

— Ishim plot! — theksova.

— Po, po... Rini, mor mik, rini! — Ajo psherëtiu me nostalgji.

— Tani do të më falni, se ngutem!, — thashë. — Duhet të nisemi që pa gdhirë me një paciente për në Tiranë dhe...

— Oh, sa mirë!, — më ndërpreu ajo. — Pra nesër në mëngjes s'passe për ta parë këtë mal të neveritshëm!, — shtoi, duke shtrembëruar buzët...

— Nejse, rruga e mbarë dhe kur të kthehesh, të na urdhërosh pa tjetër. Kam përgatitur një kek dhe ca vov që... ç'të të them, ke për t'i provuar vetë...

Të nesërmen, kur filloi të dilte drita, malet i kishim lënë mbrapa dhe tani dukeshin si ca valëzime vigane blu në horizontin kaltërosh. Autoambulanca nxitonte me zhurmën e vet monotone në brezin e murmë të asfaltit, buzë fushash dhe rrëzë kodrash që po ravijëzoheshin përherë e më qartë në dritën e agimit.

Hymë në Tiranë në orët e para të mëngjesit. Rrugët e saj plot gjallëri, aq të njohura dhe aq të dashura për mua, shullëheshin e llamburisnin gëzueshëm në diell. Nusia vështronte si e shastisur nga dritarja dhe unë mendoja se ajo s'do të kishte qenë asnjëherë në kryeqytet.

Me të arritur te hyrja e spitalit dhe sapo doli te sporteli fytyra e portierit të vjetër, që më njohu kur më pa, e ndjeva veten të pushtuar nga nostalgjia e takimit të parë me atë vend aq të njohur. Kjo ndjenjë m'u bë edhe më e fortë kur hyra brenda dhe nisa të përshkoja korridoret e gjata. Gjithçka ishte e njohur për mua, qysh nga pllakat llamburitëse të dyshemesë dhe deri te kundërmi-

mi karakteristik i pavioneve, qysh nga mbishkrimet e dyerve dhe deri te ngjyra e mureve, qysh nga kërkëllitja e rrotëzave të barelave dhe deri te saksitë me lule. M'u desh të ndalesha shpesh, për t'u përshëndetur me shokë të viteve më të ulëta, me infermiere dhe mjekë, me sanitarë dhe pedagogë, diku shkurt, diku më gjatë; m'u desh t'i përgjigjesha plot pyetjeve, disa të bëra fluturimthi e disa me nge dhe kureshtje; m'u desh të pyesja edhe unë për diçka a për dikë. Mbas një copë here m'u duk sikur nuk po vija atë çast nga qyteza e largët, sikur nuk kisha qënë asnjëherë atje, por sikur isha përsëri student dhe prisja të hyja në orën e praktikës. Por, kjo dukuri zgjati pak, se m'u kujtuan nusja me Gjystinën, të cilat më prisnin në një stol të lulishtes së spitalit, dhe nxitova hapat drejt kabinetit të pedagogut të gjinekologjisë. Mora frymë i lehtësuar, kur dëgjova atë «hyr» të njohur.

Pedagogu brofi në këmbë dhe më doli përpara krahëhapur. Më detyroi të ulesha në kolltukun e vetëm të kabinetit të tij, më ofroi cigare, më bëri një mori pyetjesh dhe më dha disa këshilla, me tonin e vet didaktik. Në fund u kujtua të më pyeste pse kisha ardhur dhe në kisha ndonjë nevojë. I tregova si qëndronte puna dhe ai tha se ishte i gatshëm të na ndihmonte, aq më tepër se atë ditë s'kishte më leksione.

Nxitova të sillja nusen me Gjystinën. Ndërsa përshkonim bashkë labirintin e korridoreve, nusja vështronte rreth e qark me bisht të syrit dhe fytyra e saj tregonte njëherësh admirim dhe druajtje, shpresë dhe shqetësim. Sidoqoftë, këtë radhë ajo u tregua më e arsyeshme, dhe, megjithëse me turp, iu përgjigj shpejt dhe qartë pyetjeve të profesorit. Vetëm kur e çuan tek aparati i specializuar i vizitës, vura re se e vështroi me frikë, u zbeh pakëz, por s'e dha veten.

— Nuse, po të tregohesh e dëgjueshme dhe t'i bësh të gjitha ato që do të të thotë doktor Fatosi, ti së shpejti do të bëhesh nënë!, — i tha në përfundim profesori, duke i rrahur supin buzagaz e me dashamirësi.

Ajo uli kokën, e turpëruar, por të kuqtë që i vërshu në fytyrë, nuk ia mbuloi dot atë buzëqeshje shprese që iu ravijëzua buzëve të holla.

— Tani shoqja mami, mund të dilni, se gjithë këto aparate shastisin këdo!, — iu kthye profesori Gjystinës.

Mbasi i përcolli ato të dyja, pedagogu zuri vend pranë tavolinës dhe parashtrori hollësisht se ç'mjekime mendonte që duheshin bërë, bile, duke folur dhe argumentuar, i shënoi të gjitha në mënyrë sistematike në një fletë të bardhë, ashtu siç vepronte në dërrasë të zezë gjatë leksioneve. Në mbyllje, nuk harroi edhe përsëritjen përmbledhëse.

— Për pesë pare punë, kjo nuse mund të mbetëj tërë jetën pa fëmijë!, — përfundoi.

— Pra, ju mendoni se..

— Po, po, mendoj se do të lindë!, — më ndërpreu ai. — Por, siç ju kam thënë shpeshherë, në mjekësi nuk ekziston qind për qindshi, prandaj..

Në fund, pedagogu nuk pranoi kurrsesi të më lëshonte pa pirë së bashku nga një kafe në lokalin më të afërt.

Pak mbas mesdite e kisha përcjellë autoambulancën me ato të dyja drejt qytezës dhe u nisa për në shtëpi. Kur u futa në rrugën tonë, m'u duk edhe një herë vetja student. Por këtë radhë, në vend të çantës së vogël të zezë, kisha një çantë të rëndë sportive, të mbushur dinga me ndërresa të palara dhe me arra sa grushti nga malësia.

— Urraaa, erdhi vëllaçkoja!, — dha lajmin i pari vëllai i vogël, duke m'u hedhur në qafë. — E, ju thashë unë se Fatosi do ta mbajë fjalën?!...

Nëna, si u çmall mirë e mirë, nxitoi të çonte në furrë lakrorin me mish, që e kishte përgatitur enkas, se më pëlqente shumë, kurse babai, i cili e kishte turnin pasdite, priti sa të qetësohej gjendja, pastaj më ftoi të ulesha pranë tij dhe më pyeti:

— E, more djalë, ç'kemi nga malësia?! — Kryqëzoi duart në prehër dhe priti fjalët e mia, duke më vështruar serioz, por me dashuri.

Ditën e hënë, rreth orës dy e gjysmë pasdite, arrita në Fushë-Bredh me autobusin e linjës. Drekën e kishim ngrënë në stacionin e mëparshëm, kështu që hyra në restorant sa për të pirë një ekspres në këmbë dhe ia mbajta drejt e në banesë. Lëshova mbi karrige çantën e udhëtimit dhe rrytetën dhe nxitova të çilja dritaren. Pastaj u lava dhe u freskova, po nuk u zhvesha, se më hante merakun të shkoja njëherë andej nga spitali. Pushova ca, i shtrirë përmbi shtresat e shtratit, pastaj dola.

Mua nuk më zë makina dhe i përballoj mjaft mirë udhëtimet e gjata, por, sidoqoftë, shtatë orë e gjysmë me autobus, kur ke rreth e qark edhe njerëz që i zë makina, nuk kalojnë pa lënë gjurmë. Shpresoja se në spital gjithçka do të ishte në rregull dhe do të rikthehesha shpejt në dhomë, për t'i ripërtërirë forcat me një gjumë të mirë, por ja që hesapet s'dolën kështu. Mbas përshëndetjeve të rastit, Lina më njoftoi se Hasani ishte keqësuar.

— Mirë që erdhe, doktor!, — psherëtiu ai, me një pamje të vuajtur, sa më pa te pragu.

— Pse?, — pyeta, i shqetësuar.

— S'ndihem hiç mirë. Po më shtohen dhimbjet e mesit, aq sa mezi i duroj. Bile, iu luta Ademit të më jepte ndonjë ilaç për qetësim, por nuk desh. Kur të vijë doktori, më tha.

— Do të të japim gjithë ç'duhet, që të qetësohesh dhe, bile, të shërohesh sa më parë!, — i dhashë kurajë dhe u mundova t'i buzëqeshja.

E vizitova përsëri me kujdes dhe më lindi një dyshim. Thirra Linën, e porosita t'i jepte një qetësues dhe t'i merrte menjëherë provat për analiza, se do të shkoja që atë çast në laboratorin e spitalit të rrethit.

— Por ju sa zbritët nga autobusi!, — vërejti ajo me keqardhje.

— S'prish punë, kështu duhet!, — thashë.

Dy orë më vonë, arrita me një makinë të rastit në qendër të rrethit dhe ia mbajta drejt e në laborator.

— E di që vajti ora për ta mbyllur laboratorin, por të lutem shumë të m'i kryesh sonte këto analiza! — i thashë laborantes. — Dyshoj se kam gabuar diagnozë dhe më duhen pa tjetër. Do të pres t'i marr vetë.

— Do t'jua bëjmë, doktor! — u tregua e gatshme ajo. — Kthehuni mbas nja dy orësh të merrni rezultatet.

— Shikoni veçanërisht azoteminë!, — e porosita, ndërsa po dilja.

Meqenëse ishte e hënë dhe kishte orar zyrtar pasdite, vendosa t'i shfrytëzoja ato dy orë duke shkuar në zyrën e urbanistikës, që të interesohesha për projektin e spitalit të ri. Arkitektin, me të cilin isha prezantuar kalimthi diku, e gjeta të kërrusur përmbi tavolinën e vizatimit, ku ishte mbërthyer me pineska pikërisht projekti i spitalit.

— Ja, pothuaj e përfunduam!, — tha Hajriu, një djalos i gjatë dhe kuqalosh, me sy të larmë. — Kjo është planimetria. Ja, këtu është hyrja...

Ai nisi të më shpjegonte gjithçka me hollësi dhe pasion, thuajse po mbronte projektin e diplomës. Projekti s'qe i keq, por mund t'i bëhej edhe ndonjë vërejtje. Kështu, nyja e dezinfektimit nuk qe vendosur në krye, kuzhina s'ishte fort e volitshme, mungonte një vend i përshtatshëm për radiologjinë, si dhe një dhomë e vogël për të sëmuret rëndë. Ia bëra këto vërejtje me shumë takt.

Arkitekt Hajriu, që ishte moshatari im, më dëgjoi duke më vështruar së larti, si ndonjë profesor. Pastaj, u mundua të më provonte me fjalë dhe me gjeste se ai i kishte peshuar mirë këto punë, por s'mund të pajtoheshin plotësisht të gjitha kërkesat funksionale, konstruktive, arkitekturale, ekonomike...

Ndërsa përballoja këtë breshëri argumentesh, buzëqesha me mendimin se ne, specialistët e rinj, bëhemi ndonjëherë qesharakë sepse, nga frika mos na marrin për bylmezë, përpiqemi t'i vëmë në pah aftësitë tona më shumë nga ç'ka lezet.

— Mos ngulni këmbë dhe mos hezitoni fare, gjith-

çka është në rregull!, — mundahej të më bindte Hajriu.
= Ehu, sa të vijë koha që në qytezën tuaj të vendoset
radiologjia, laboratorë i zgjeruar...

— Unë mendoj se koha do të vijë shpejt!, — thashë
me bindje. — Pastaj, do të ishte më e drejtë që krahasimi
të bëhej me të ardhmen. Qyteza jonë po rritet si fëmija
dhe rrobaqepësit e zgjuar, kur u presin rroba fëmijëve,
lënë ca rezervë nga brenda.

— He, kush të lë të projektosh me rezerva, se?!, —
kërceu Hajriu.

— Kur është e arsyeshme, s'të pengon njeri. Nga ana
tjetër, ne mund të kursejmë diçka gjetiu. Për shembull,
pavioni infektiv mund të jetë më i vogël...

Moshatari im u përkul mbi projekt, si ndonjë ushtarak
mbi hartën e betejës. Rrudhi ballin e vet ende të
lëmuar dhe më bëri një sërë pyetjesh. Përgjigjet dhe
vërejtjet e mia i konkretizonte me disa vija e disa shënime
mbi projekt.

— A mundesh të ma vizatosh në një farë mënyre,
qysh ju duhet ajo salla e radiologjisë?, — tha diku ai, i
pakënaqur nga shpjegimet e mia gojore.

— Ndoshta do të mundem!, — iu përgjigja.
I kërkova një fletë të bardhë, rigë, laps dhe iu vura
punës. Për të përgënjeshtuar dyshimin e tij, derdha gjithë
aftësitë e mia në atë skicë.

— Hej, ti vizatoke bukur, bre!, — tha, i habitur Hajriu,
që më rrinte mbi kokë, si ndonjë mbikëqyrës i
rreptë.

— Kur isha nxënës vizatoja gazetën e murit dhe,
ndoshta, qysh atëherë më ka mbetur kjo aftësi!, — thashë.
— Kështu që edhe ne, mjekët...

— Ah, qenke fyer nga mënyra se si të pyeta!, — vërejt
ai. — Por, s'pata faj; zakonisht, ju, mjekët, edhe
shkrimin e keni të palexueshëm!

— Jo të gjithë! Për fat të keq, disa e bëjnë me qëllim
të palexueshëm, që t'i përmbahen traditës. Harrojnë se
kjo është një traditë e keqe.

Hajriu buzëqeshi dhe më pyeti për nyjen e dezinfek-

timit. Kështu, vazhduam të bashkëpunonim, gjersa i rrafshuam të gjitha mospërputhjet. Projekti u bë si harta e një shtabi gjatë betejës: plot vija të drejta e të lakuara kuq e blu, plot korigjime dhe shifra të shkruara shtrembër pranë kuotave të vjetra, bile edhe me hi, që ishte shkundur padashur nga cigaret tona.

— Me këto ndryshime, ju plotësohen të gjitha kërkesat?, — pyeti më në fund Hajriu.

— Po, por të doli shumë punë, duhet t'ia fillosh nga e para!, — vërejta duke treguar projektin.

— S'ka gjë!, — buzëqeshi çiltër ai. — Kur e do puna...

Pastaj nisëm një bisedë të larme. Ai më pyeti ç'mendoja për rezultatin e një ndeshjeje futbollit, unë i kërkova mendimin për një kostum që do të qepja, me një kopsë, apo me tri, pastaj ai më propozoi të pinim kafe. Vështrova orën, se më hante meraku i analizave, por kisha kohë dhe pranova. Rrugës mora vesh se qysh në vegjëli Hajriut i kishte pëlqyer ndërtimi. Ëndërronte të projektonte godina të mëdha, por tani për tani ishte i detyruar të merrej më fort me përshtatjen e projekteve tip. Kjo nuk i pëlqente, por ishte një punë që duhej bërë. Ramë dakord se dëshira për të kryer punë të mëdha është diçka e mirë, por nuk duhen lënë pas dore ato të përditshmet, qofshin edhe të vogla.

Kafeja na shijoi së tepërmi, më fort për hir të bisedës, të cilën u shtrënguam ta ndërprisnim kur më vajti ora për të marrë rezultatet e analizave. Hajriu më premtoi se do ta përfundonte shpejt projektin dhe m'u lut ta takoja, sa herë të veja për ndonjë punë në qendër të rrethit. U ndamë si miq dhe unë nxitova në laboratorin e spitalit.

— Dyshimi juaj që i drejtë, azotemia doli e lartë!, — tha laborantja, duke më zgjatur pusullën me rezultatet.

E mora pusullën me po atë ndjenjë që kisha marrë dikur librezën me një notë të dobët. Megjithëse e prisja atë rezultat, u turbullova aq shumë, sa mend harrova ta

falënderoja laboranten. Ajo e kuptoi gjendjen time dhe buzëqeshi me keqardhje.

Unë e di si e bëra rrugën e kthimit. Pavarësisht se shenjat e sëmundjeve ishin të ngjashme dhe se Hasani kishte vuajtur nga astma e reumatizmi në të kaluarën, haja veten me dhëmbë që nuk ia kisha çuar analizat qysh në fillim.

Megjithëse arrita në qytezë shumë vonë, shkova drejt e në spital, që të bëja menjëherë ndryshimet e duhura në mjekimin e pacientit. Sapo hyra në korridor, më ranë në vesh zëra të acaruar, që vinin nga dhoma e të shtruarit. Nxitova i shqetësuar dhe çela derën me vrull.

— Ç'është kjo zhurmë?!, — pyeta rreptë kur pashë se s'ishte gjë tjetër, veçse një grindje ndërmjet Hasanit dhe të vëllait, Skënder Topit, i cili, sapo hyra, brofi në këmbë dhe e la fjalën përgjysmë, i zënë ngushtë. — Po ju, si e lejoni diçka të tillë në spital, ca më tepër në një orë kaq të vonë?, — iu ktheva Linës, e cila kishte shtangur në këmbë, përballë burrave.

Ajo u skuq në fytyrë, uli kokën dhe ngriti supet, në shenjë pafuqie.

— Na fal, doktor, ke të drejtë, por ajo s'ka faj!, — tha Skënderi.

— Po juve, ç'ju gjeti?, — pyeta, duke ua hedhur sytë si njërit, ashtu edhe tjetrit.

— Im vëlla ka luajtur mendsh, do të dalë nga spitali!, — m'u përgjigj Skënderi duke vështruar të vëllanë me mllëf.

— Hasan, ç'janë këto?!, — iu ktheva qortues atij.

Ai uli sytë, heshti një hop, pastaj tha shtruar, por zymtë e me vendosmëri:

— Unë s'po shoh ndonjë fajde këtu, atëherë, pse...?

— Ti ke vetëm tri ditë i shtruar. Pse, kaq shpejt u shëroka njeriu?, — thashë.

— Ashtu vërtet, s'thonë kot se sëmundja hyn me thes e del me gjilpërë!, — ma përforcoi Skënderi.

— Kam frikë se ju akoma s'ma keni gjetur sëmundjen!, — tha dyshues Hasani, duke ulur përsëri sytë.

— Kush të tha?, — u vrenjta unë, se më shkrepri një dyshim.

— Asnjëri... por, ja,,, e vura re që dyshove, kur më vizitove sot... Pastaj, pse m'i çuat me ngut analizat në spitalin e rrethit?

— Këto janë punët tona, Hasan!, — i thashë me të urtë. — Analizat t'i bëjmë sot dhe do të t'i bëjmë përsëri, se ti s'je prej qelqi, që të shohim se ç'bëhet në trupin tënd. Ato, analizat, do të na ndihmojnë të qëllojmë në shenjë. Ti duhet të kesh besim te ne, se do të bëjmë ç'është e mundur të të shërojmë sa më parë. Apo s'ke besim?

— Jo, xhanëm, jo për këtë..., — tha zvarrisur, i zënë ngushtë. — Por, meqë u dashkan analiza, pse s'më çoni më mirë në spitalin e rrethit, që të mos silleni ju poshtë e përpjetë...

— Mos na e qaj hallin neve, se kështu bëjmë për të gjithë, sa të krijojmë laboratorin tonë. Po të jetë nevoja, të çojmë vetë në spitalin e rrethit, bile edhe në Tiranë, por s'e besoj të jetë!

— E, të thashë unë?, — iu kthye Skënderi. — Kurse ty s'të mbushej koka, do dal që do dal, më nxore nga turni në mes të natës, hm...

— Mos i bjer në qafë, Skënder, sëmundja ia prish ndonjëherë terezinë njeriut!, — i doli krah Hasanit, duke buzëqeshur. — Mua s'më ngelet hatri, goftë e shkuar, e harruar!

— Mirë, more doktor, të dalë ku të dalë, kështu le të mbetet!, — tha Hasani, duke tërhequr mbulesat gjer nën sqetulla, por jo fort i bindur.

— Tani, merr ilaçet që do të të japë Lina dhe bjer e fli, se është vonë dhe sëmundja do prehje!, — i thashë, duke brofur në këmbë. — Natën e mirë!

— Të mirë e bëfsh, doktor, dhe mos ma vër re!, — ma ktheu ai, disi i qetësuar.

— Lina, mbasi ika unë, ka qenë kush te Hasani?, — e pyeta infermieren, kur dolëm në korridor.

— Përveç nesh, të spitalit, asnjëri!, — m'u përgjigj ajo.

— Po nga ju, përveç teje, kush ka qenë?
— Ademi ishte një copë herë, mbas orarit! — Ajo më hodhi një vështrim hetues, ndoshta sepse e kuptoi dyshimin tim.

— Mirë, falemnderit!, — i vura kapak. Hyra në dhomën e mjekut, bëra ndryshimet e duhura në kartelë; pastaj ia zgjata asaj dhe e porosita: — Qysh sonte fillojani këtë mjekim!

— Si urdhëroni!

— Thua t'ia këtë ngritur mendjen ai qerrata?!, — më pyeti Skënderi, sapo dolëm nga spitali. — Se, edhe unë bëra çudi me Hasanin, ai s'e ka për zakon...

— Kryesorja është ta mjekojmë siç duhet dhe ta shërojmë sa më parë!, — i dredhova përgjigjes. — Endiej për detyrë të ta them se diagnoza e parë s'qe e saktë por, jo gjithmonë i biem në shenjë me të parën, aq më tepër kur janë disa sëmundje me shenja të ngjashme, si në rastin e Hasanit.

— Ta merr mer tja, se mos ishe brenda në trupin e tij, që t'ia shihje ku e kishte të keqen!, — tha Skënderi, me një shqetësim të përmbajtur. — Siç duket, i paskan dalë keq analizat, hë?

— Del se është i sëmurë nga veshkat.

— Rëndë?

— Jo edhe aq. Shpresoj se brenda dy javësh do të përmirësohet. Siç e dëgjove, ia filluam mjekimin e ri qysh sonte. Por më vjen plasje pse...

— Gjëra që ngjasin, doktor!, — më ndërpreu Skënderi, me mirëkuptim. — Edhe sikur të ishte vëllai yt, s'do të kishe bërë më shumë, apo jo?

Unë miratova me kokë.

— Atëherë, pse e fut veten në siklet? Siç the dhe vetë, kryesorja është që të shërohet.

— Pa dyshim!

— U bëre copë sot!, — tha Skënderi. — Gjithë ditën rrugëve. Edhe tekat e Hasanit të mungonin!

Unë u shpreha me një gjest se s'kishte rëndësi ajo

punë dhe vazhdoja të bluaja me vete dyshimin për Adem.
— Po nusja, ç'bëhet?, — pyeta Gjystinën.

— Mirë është!, — m'u përgjigj ajo. — Pak e lodhur e pak e hutuar, por do të mësohet.

Atë natë bëra një gjumë të shqetësuar dhe u zgjova pa zbardhur drita. Përgatita vetë një kafe dhe ia mbajta drejt e në spital. U qetësova disi kur mora vesh se Hasani i kishte marrë në rregull mjekimet dhe se ndihej *diçka më mirë*. E vizitova para mbledhjes së mëngjesit. Ai më priti buzagas, me pamje të penduar dhe nisi të më kërkonte përsëri të falur, por unë iu shmanga me takt asaj bisede dhe ia ktheva me shaka.

Gjatë mbledhjes së mëngjesit me personelin, bëra autokritikë se kisha gabuar diagnozën e Hasanit, se analizat duheshin çuar qysh ditën e parë dhe thashë se duhej të nxirrnim mësim nga ky rast. Pastaj, theksova se duhej të tregoheshim më të kujdesshëm ndaj të sëmurëve, mbasi edhe një fjalë e lëshuar pa kujdes, mund t'u ngjallë dyshime dhe shqetësime të dëmshme, siç kishte ndodhur të djeshmen mbrëma me Hasanin. Nuk e cilësova me emër Adem, se isha i bindur që do të mohonte gjithçka, por s'e lashë pa i hedhur disa vështrime me nënkuptim. Mbas mbledhjes, iu luta të qëndronte.

— Adem, ç'bisedove dje mbasdite me Hasanin?, — i rashë drejt, sapo mbetëm vetëm.

Ai ngriti supet me indiferentizëm dhe u përgjigj thashtë:

— Gjëra të rëndomta. Po, pse pyesni, doktor?

— Sepse, mbasi dole ti, ai nxori të vëllanë nga puna dhe dësh të dilte nga spitali.

— Gjëra që ngjasin!, — vërejti ai, përsëri me indiferentizëm. — Por, ç'lidhje ka kjo me mua?, — pyeti pastaj sikur kërkonte llogari.

— Dysjoj se i është ngritur mendja nga ndonjë fjalë që mund t'i kesh thënë ti!, — thashë troç.

— Prandaj m'i hodhët sytë aq shpesh gjatë mbledhjes?, — buzëqeshi ai me ironi. — Së mos vetëm unë isha

te pacienti?! Apo, kush i bën kuleçët e shtrembër, po nusja! E pësova si nusja, tani në pleçëri!

— Vetëm mbas bisedës me ty dhe jo me Linën e me ndokënd tjetër, atij i shkrepiti të dilte nga spitali!, — theksova.

— E ç'mund t'i thosha unë?!, — ngriti supet Ademi.

— Për shembull, se do të ishte mirë të shtrohej në spitalin e rrethit, ku ka laborator dhe mjekë me eksperiencë...

— Ç'janë këto, doktor?!, — u shtir i revoltuar ai, por s'e fshehu dot një farë paniku.

— Këto kuptova nga fjalët e tij!, — thashë.

— Të kujt, të Hasanit? Ai të tha të tilla gjëra?

— Për atë po bisedojmë!, — iu përgjigja më dyzaj.

— S'është e vërtetë!, — shpërtheu Ademi, si kusudo që orvatet të shkarkohet nga faji. — Do t'i ketë marrë së prapthi fjalët e mia, ose është burrë i lig dhe do të ma shpërblejë të mirën me të keqe!

— Pse, ç'të mirë i ke bërë, apo llogarit këshillat që i dhe mbrëmë?, — pyeta me shpoti.

— Ju i merrni gjithmonë ters fjalët e mia, doktor!, — kundërshtoi ai, duke u skuqur gjer në majë të veshëve.

— E pata fjalën për kujdesin që po tregojmë ndaj tij.

— E di, prandaj, nuk i dhe ndonjë qetësues kur t'u lut, në mungesën time!?, — vërejta. — Nejse, a të kujtohen me saktësi ato që i the?

Ai u mendua një hop, sikur deshi kohë të kujtohej, pastaj u përgjigj zvarritur:

— M'u ankua se nuk ndihej mirë... Më tha se ju kishit një pamje të shqetësuar dhe disi dyshuese mbas vizitës së djeshme... Pastaj, më pyeti se si do t'i shkonte filli...

— Po ti, ç'iu përgjigje?, — ngula këmbë.

— I thashë se këto lloj sëmundjesh kështu e kanë, se duan durim dhe...

— Mjek me përvojë, hë?, — e plotësova.

— S'i kam thënë diçka të tillë!, — kërceu ai.

— Ose, se spitali ynë s'është për të tilla sëmundje?

— As këtë.

— Atëherë, pse iu ngrit mendja të dilte? Kot?

— Ku ta di unë? Gjëra që ndodhin, doktor!

— Shiko, Adem, unë jam i bindur se ti je shkaktari dhe, që të jem plotësisht i sigurtë, dyshoj se e ka bërë me qëllim, që të më diskreditosh.

— Doktor!, — brofi ai.

— Dëgjomë deri në fund!, — I bëra shenjë me dorë të ulej përsëri. — Ky është rasti i dytë, mbas atij të Spiro Letës. Unë premtova se do ta harroja atë rast, por me kusht që të mos përsëritej. Kurse ti...

— Doktor, ju e keni zënë ters me mua dhe kërkonim qime në vezë!

— Kjo s'është qime në vezë, po tra në sy, dhe ti shtiresht sikur nuk e sheh!, — thashë duke u munduar të ruaja gjakftohtësinë.

— Unë s'mund t'ju ndaloj të dyshoni, por ju theksoj se më bini kot në qafë. Ndoshta, ju vjen thartë se gabuat *diagnozë* dhe kërkonim të më shkarkoheni mua, por unë s'jam rrufepritëse...

— Adem, lëri këto, se s'të shkojnë! — e qortova, pa ia ndarë sytë. Ta kam thënë edhe herën tjetër, të pëlqej a s'të pëlqej unë, puna dhe të sëmurët s'na kanë ndonjë borxh, prandaj i duhet dhënë fund.

— Ta merr mendja që i duhet dhënë fund, kështu s'kalohet!, — foli më me ton ai. — Ju keni krijuar opinion të keq për mua dhe s'jua ndryshon as topi, prandaj kërkonim që të më heqin që këtej, përndryshe do të kërkoj vetë që...

— Jo, s'është kjo zgjidhja!, — e ndërpreva. — Nëse shkoj unë me opinion, apo shkon ti me hile, këtë do ta nxjerrë në pah vetë jeta dhe do ta zgjidhë kolektivi ynë. S'thotë kot populli «vete-vjen shtëmba në krua, pa thyhet». Dëshirë s'kam që të thyhet, prandaj t'i them gjërat troç dhe nuk rri të t'i mbledh rastet kapicë në bllokun e shënimeve. More vesh?!...

Në krye të tri javëve, Ademiti i dolën lakrat në shesh. Dhe, ja se si ndodhi:

Ca nga ca Hasani u përmirësua dhe erdhi duke u shëndoshur e duke u çelur në fytyrë, thujse ishte tjetër njeri, prandaj vendosëm që të shtunën e fundit të janarit ta nxirrnim nga spitali.

Në mëngjesin e asaj dite e gjeta tek na priste, bashkë me të vëllanë, Skënderin, gati për të na lënë shëndetin, i rruar e i veshur me rrobat e ditëve të mira. I rrezëllente fytyra nga gëzimi dhe dukej i freskët, kokoroç, si një gjeth i posaçelur.

Një nga një, u bashkuam të gjithë ne të spitalit, dhe ia nisëm një bisede të gëzueshme, sepse dalja shëndoshë e çdo pacienti ishte rast gëzimi për kolektivin tonë të vogël. Ndërsa hidhte e priste fjalë e shaka, herë me njërin e herë me tjetrin, Hasani përgjonte me bisht të syrit rrugën, thujse priste dikë.

I fundit erdhi Ademi. Vështroi orën dhe u mat të hynte në spital, se kishte vajtur koha për mbledhjen e mëngjesit, po kur pa se asnjëri nga ne s'po luante vendit, erdhi atje. Që atë çast Hasani nuk vështroi më nga rruga. Mbas pak Skënder Topi ia kujtoi të vëllait, si me shaka, ndodhinë e asaj mbrëmjeje.

— Eh, ma bëni hallall, se kaq ma priti!, — tha Hasani me keqardhje, duke i rënë tëmthit me gisht. — Megjithatë... Ai heshti një çast, duke ia ngulur sytë Ademiti në mënyrë qortuese, pastaj vazhdoi: — Megjithatë, s'ma mban ndërgegjja të largohem, pa ia thënë Ademiti dy fjalë, faqe jush.

Sytë e të gjithë u kthyen nga Ademi, ca me habi e ca me kureshtje. Atij i ndërroi fytyra, por u mundua të shtirej i habitur dhe i qetë.

— S'të ka hije, Adem, të flasësh keq për shokët e punës, siç bëre atë mbrëmje me mua!, — tha Hasani shkëqur, pa ia ndarë sytë. — Vërtet që doktor Fatosi është i ri dhe mbase ndonjë gjë s'e di si ata të vjetrit, po ja që

më shëroi, pa qenë nevoja të shkoja në spitalin e rrethit a gjetiu, siç më këshillove ti. Nuk dua të shfajësohem që flas kështu, se ndokush mund të të thotë edhe «hidhu në lumë», por ama s'më bën zemra të largohem, pa jua thënë këto fjalë. Ka tri javë që luftoj me vete, t'i them a të mos t'i them. Ju e kuptoni pse. Por, më në fund vendosa të t'i them. M'u duk më e ndershme kështu.

— Më paske keqkuptuar!, — kundërshtoi Ademi, flakë i kuq në fytyrë.

— S'të kam keqkuptuar hiç fare!, — tha prerë Hasani. — Bile, po ngule këmbë t'i them një për një fjalët e tua, se i kam sjellë nëpër mend kushedi sa herë gjatë këtyre javëve. Por, mbase është mjaft sa thashë. Unë s'kam gjë kundër teje, bile të njoh para doktor Fatosit. Thashë qëparë që më shëroi ky, po në të vërtetë më shëroi bashkë me ju. Trimi i mirë me shokë shumë. Me shokë të mirë, ama! Ti je burrë i vjetër, të takon t'u japësh mend dhe të tjerëve, jo të veprosh kështu... — Hasani psherëtiu me keqardhje, pastaj u mundua të buzëqeshte. — Falmëni, shokë dhe shoqe, po mbase është më për hajr kështu. Tani, mos u pengoni më për mua, se kenë plot punë. Ja paça borxh Partisë, pastaj edhe juve. Jua shpërblefsha në të mira dhe gëzime!, — Hasani na shtrengoi dorën dhe na përqafoi të gjithë me radhë.

— Fjalët e atij fshatari le të na bëhen mësim të gjithëve, por veçanërisht ty, Adem!, — thashë, sapo filluam mbledhjen e mëngjesit.

— E di që s'do të më besoni, por ju betohem se është vetëm keqkuptim!, — u përgjërua Ademi, duke u orvatur të merrte pamjen e një viktime. — Unë s'ia thashë me qëllim të fyeja doktorin, por meqë ishte rast i vështirë, me përgjegjësi...

— Adem, mos u fut më thellë në baltë!, — e ndërpreva i përmbajtur, po rreptë. — Ka ardhur çasti t'i vësh gishtin kokës. Këtu s'ka asnjë keqkuptim, as ndonjë opinion timin, siç the dikur, por një qëndrim thellësisht të gabuar nga ana jote, për të mos u shprehur më rreptë. Me-

që bëhet fjalë për mua, është më e drejtë të flasim pjesëtarët e tjerë të kolektivit njëherë.

— Pse i bën dredha së vërtetës, Adem?, — e mori fjalën Gjystina. — Ti edhe mua më ke folur në fillim me tallje për doktor Fatosin. Bile, i kishje vënë nofkën «doktor buzëqumështi». Pastaj e mbledhe gojën. Unë kujtova se hoqe dorë dhe i vura kapak. «Kështu e ka Ademi, i përflet të gjithë, mendova, por siç duket e pa që doktor Fatosi është djalë i mirë dhe i vuri fre gjuhës. Prandaj lëre këtë punë, i thashë vetes, që të mos ia nisim me fjalë dhe me grindje qysh në fillim». Kështu thashë me vete, por qënkam gënjyer. Ti, Adem, e paske mbledhur gojën me ne, se e pe që shkonim mirë me doktorin, por e paske hapur sa një çorap me të tjerët. Derisa u gjend Hasani, që t'i nxori lakrat sheshit, më i lumtë. Unë e ndiej veten fajtores para kolektivit dhe bëj autokritikë që s'fola qysh me të parën. Nga ana tjetër, i dënoj rëndë qëndrimin e Ademit, si një qëndrim të lig, shumë të dëmshëm për punën. I them këtij shoku të mbledh mendtë, sa s'është vonë.

— Ty, Adem, vetëm vetja të pëlqen!, — tha Lina. — Edhe unë kam duruar shumë prej teje. Helbete, e re jam, ndonjë punë s'e bëj ashtu siç duhet, por ti, në vend që të më ndihmosh e të më mësosh, rri e tallsh me mua. Ç't'u desh ky zamat, më thua, pse nuk shkon të pastrosh tallash në stabiliment, apo ke hall të gjesh ndonjë burrë me shkollë?!... Gabim kam bërë që të kam duruar, por helbete, vajzë e re, bija jote nga moshë... Tani paske filluar të vjellësh vrer edhe kundër doktor Fatosit. Dashke të na kafshosh të gjithë me radhë, hë? Po kush të lë, se?! S'të kemi ndonjë borxh, të të durojmë. Prandaj, ngrehu e bëj autokritikë të fortë dhe zotohu se do të ndërrosh rrugë, përndryshe, nga majat, thembrat!

— Ç'pate me doktorin, bre, apo t'u duk se të zuri vendin dhe të vuri në hije?, — u hodh sanitarja. — Të prishi terezinë, hë? Se ishe mësuar të kapardiseshe si gjel, ngaqë ta kishin nevojën njerëzit. Adem, tutje, Adem,

tëhu,... Shporta me vezë, enët me gjalpë e me mjaltë, trëstat me arra dhe me mollë...

— E kanë fajin ata që ia çojnë, — ndërhyri Lina.

— Eh, moj motër, nevojtarë, të shkretët!, — tha sanitarja.

— Këto janë shpifje!, — kërcëu Ademi.

— Rri aty dhe mbylle gojën!, — u hakërrye sanitarja. — Shpifje janë ato të tuat. Unë them të vërtetën, se dyert e apartamenteve i kemi karshi dhe sytë s'na kanë plasur. Mban dhe zonjën Lilianë pa punë, në shtëpi!, — u kthye nga ne.

— E kemi fjalën për Ademin, mos na nxirr gjetiu!, — i ndërhyra.

— Hajt, se nuk i priset erzi asaj!, — vazhdoi me duf sanitarja. — Të dy njëloj janë, si tenxherja me kapakun. Si të zhvasin e si të përflasin të tjerët. Prandaj, vëri gishtin kokës dhe ndërro rrugë, Adem, ja po do të kërkohmë të të çojnë në ndonjë punë tjetër, që të të djersijë kurrizi njëherë...

Duke dëgjuar këto dhe plot të tjera, Ademi erdhi e t'u mblodh sa një grusht. Qëndronte kokëvarur, dyllë i verdhë në fytyrë, fshinte pareshtur djersët që i bulonin edhe në shogë dhe nuk guxonte të ngrinte sytë. Në fund u detyrua të çohet, se e pyetëm në kishte gjë për të thënë. Atëherë, sytë e tij, që kishin pamjen e pellgjeve të një baltovine, vërtiteshin plot ankth e s'dinin ku të qëndronin. I qe tharë pështyma, se fjalët mezi i dilnin, të trashura e të mekëta. Belbëzoi një autokritikë të shkurtër pastaj u lëshua si i këputur në karrigen e vet, gjerësa u ndanë detyrat e ditës dhe u mbyll mbledhja.

Po atë ditë, andej nga mesdita, erdhi edhe xha Bakoja me kalë, që të merrte nusen e të birit. Ishte hera e dytë që vinte. Këtë radhë ia dhamë, se ia kishim mbaruar kurat. Na erdhi keq të gjithëve kur u ndamë prej saj, se na ishte bërë si pjestare e kolektivit, bile na kishte ndihmuar në disa punë, me aq sa e lejonim, që të mos mërzhitej. Para se të niseshin, i thashë xha

Bakos në vesh se do të më ngelej hatri po të mos më thërriste për nun, kur të bëhej gjysh.

— Të vijë ajo ditë, pa kollaj!, — tha ai, duke tundur kokën me dyshim, po jo pa një farë shprese.

Mbasi shkoi edhe nusja, në spital mbeti vetëm një djalë dhjetëvjeçar, i shtruar me bronkopneumoni, por që ishte në prag të shërimit, prandaj njoftova personelin se po shkoja te Thanasi për disa punë.

Kur dëgjoi këto fjalë, Ademi u skuq gjer në majë të veshëve dhe më hodhi me bisht të syrit një vështrim të trembur.

— Jo, s'do të shkoj për çështjen tënde!, — i thashë. — Në dijeni mund ta vë, se prandaj e kemi kryetar, por vetëm kaq. Të tjerat do t'i ndreqim brenda kolektivit. Sigurisht, në daç ta zësh dorën që po të shtrijmë. Te shoku Thanas do të shkoj për problemet e ndërtimit të spitalit të ri.

Projekti ishte gati. Inxhinier Hajriu e mbajti fjalën dhe e përfundoi në kohë. Siç më tregoi, mbas punës së diplomës, ishte i pari projekt krejtësisht i veti dhe që munduar të shtrydhte në të gjitha aftësitë. Dhe, si pas mendimit të përgjithshëm, projekti që goxha i mirë, jo vetëm për anën funksionale të spitalit, por edhe për paraqitjen arkitekturale.

Se ku duhej të ndërtohej spitali i ri, pati shumë mendime dhe diskutime, si nga ne të shëndetësisë, ashtu edhe nga banorët e qytezës. Më në fund u gjet një vend i bukur, në një skaj të qetë dhe të gjelbëruar. Tani kishte mbetur të fillonin punimet. Herë shoku Thanas dhe herë unë, ishim bërë rrodhe në ndërmarrjen e ndërtimit. Drejtori, sa na shikonte te pragu, rrudhte fytyrën, si të kishte ngrënë një thelë limoni.

— Përsëri ju?!, — tha ai, kur i hymë në zyrë atë ditë së bashku me shokun Thanas. — Ora është dy pa një çerek dhe unë kam një mbledhje...

— Sprish punë, presim ne!, — tha buzagaz dhe i qetë shoku Thanas.

— Pse të prisni, bre, ne e kemi diskutuar kaq herë këtë çështje, është punë që s'bëhet!, — deshi të na mbushte mendjen ai.

— Se e diskutojmë edhe një herë, s'priset gjë!, — thashë unë. — Ndoshta, arrini të kuptoni se ndërtimi i spitalit është i ngutshëm.

— Po ju kam thënë, bre, plani e parashikon për tremujorin tjetër dhe s'e shkelim dot disiplinën!, — ia nisi avazit të zakonshëm ai.

— Tejkalimi është nder, prandaj s'ju thotë kush gjë, po ta filloni para afatit, përkundrazi!, — tha kryetar Thanasi.

— Po objektet e tjera?, — kërceu drejtori.

— Eh, shoku drejtor, edhe ju keni rezerva të brendshme, prandaj... — Dhe unë përdora gjithë njohuritë e mia mbi rezervat e brendshme të ndërmarrjeve ekonomike, të përvetësuara kryesisht nga shtypi.

Drejtori përpëlitej si i zënë në çark, u mundua të na hiqte qafe me lloj-lloj mënyrash, na foli në konfidencë për vështirësitë që kishte ndërmarrja, e ktheu hierë me të butë dhe herë me të rreptë, bëri sikur kishte një bisedë të ngutshme telefonike dhe sa s'e këputi manivelin e aparatit duke e vërtitur, por ne s'iu ndamë, gjerësa na dha një gjysmë premtimi.

— Ti e le në bisht këtë punë, por dije se s'na shpëton, edhe sikur prapa diellit të fshihesh!, — bëri shaka Thanasi. — Qysh sot do të jap urdhër ta shpallim me shkronja të mëdha në qytezë se spitali do të inaugurohet me rastin e 1 Majit. Ec e luaj ti, atëherë! Dhe tani, hajde të pimë nga një kafe, se e ke hallall!

— Kafe e hidhur mjaft!, — buzëqeshi drejtori.

— Përkundrazi, e ëmbël sa s'bëhet!, — ia prita unë.

11

Punimet për ndërtimin e spitalit të ri filluan në pesëmbëdhjetëditëshin e dytë të shkurtit. Nuk u zvarris as gjetja e specialistëve, që ndërmarrja e ndërtimit

i kishte me pakicë, as furnizimi me material, as edhe ngritja e barakës së kantierit. Kudo mund të kishte çrregullime, por jo te objekti i spitalit. Si kryetar Thanasi, ashtu edhe unë, interesoheshim dita me ditë për këto punë.

Shkoja pothuaj përditë në objekt, aq sa ustallarët interesoheshin ku ndodhesha, kur mungoja. Një pjesë të mirë të kohës së lirë e kaloja atje dhe, kur dilte ndonjë urgjencë, në objekt vinin e më kërkonin së pari.

Atë pasdite të shtune organizuam aksion. Ndërsa i kalonim tullat dorë më dorë, bashkë me Gjystinën dhe Ademin, admiroja qysh punonte kryemjeshtri, usta Pandi.

Ai ishte i moshuar, por mbahej mirë. Kishte një fytyrë të gjerë dhe të qetë, ku sytë e vegjël, të kredhur në lëkurën e rrudhur si të kumbullave të thata, shkëlqenin plot mirësi. Duart e tij ishin të mëdha, me lëkurë të regjur nga llaçi dhe dukeshin të ngathëta kur s'punonin, por në punë e sipër, fitonin një shkathtësi prej zhongleri. Tullat sikur i ngjiteshin në to, si gozhdët në magnetin e këpucarit, pastaj renditeshin me shpejtësi të çuditshme përgjatë spangos dhe muri rritej e rritej.

— Ndize një herë, se u lodhe goxha!, — më tha dikur usta Pandi, duke më hedhur paqetën «Partizani».

— E, si të duket muri?, — pyeti pastaj.

— Ti s'nxjerr punë të keqe nga duart!, — iu përgjigja dhe ndeza cigaren.

— Veç në m'u dridhshin nga pleqëria se, ndryshe, kam tridhjetë vjet në këtë zanat.

«Para se të lindja unë!», — mendova.

— A është e vështirë të bësh mur?, — pyeta pastaj, se në vështrimin e parë nuk më dukej fort e zorshme t'i vije tullat radhë-radhë.

— A e ke provuar ndonjëherë?, — ma priti ai.

— Jo.

— Pije atë cigare, pastaj merr mistrinë time dhe provoje një herë. Ndërkohë, po e djeg edhe unë një.

U ngjita në skelë me dëshirën që të mos turpëro-

hesha. Nisa të punoja ngadalë dhe me kujdes. Mjeshtri thithte me lakmi cigaren dhe më vështronte, duke buzëqeshur lehtë.

Mbasi mbarova radhën e parë, lëvizta spangon, kontrollova me kujdes nivelin e saj dhe vazhdova po me ngadalë radhën e dytë. Kur mbarova të tretën, pyeta usta Pandin.

— E, si të duket?

— Zbrit dhe shikoje vetë, se e ke syrin goxha të mprehtë!, — buzëqeshi ai.

Ashtu bëra. Tri radhët e mia dukeshin si ndonjë arnë. Siç duket, u vrenjta në fytyrë, se mjeshtri qeshi me dashamirësi.

— Mos u pezmato, nuk është aq kollaj sa ç'duket!, — tha, duke u rënë me çekiç aty-këtu tullave të mia.

— Eh, more djalë, duart e usta Pandit kanë bërë qindra godina, sa u mësuan. Tani, bile, s'ia kanë fort nevojën syrit, ecin vetë...

I vështrova duart tona. Të muratorit dukeshin sikur e përkëdhelnin murin dhe kishin diçka prej ashpërsisë tij. Të miat stononin, siç do të stononin të atij në tryezën e operacioneve. Mendova se duhet të punojnë ende shumë duart tona, që të zhduket dallimi ndërmjet tyre.

— Është bukur të ndërtosh!, — thashë.

— Po!, — usta Pandi tundi ngadale kokën në shenjë miratimi. — Kur le punën dhe vështron atë që ke bërë, sikur të hiqet lodhja. Kënaqesh, siç kënaqesh kur sheh që rriten fëmijët.

— Pale pastaj, kur e përrundon veprën!, — e nxita më tej.

— Ta merr mendja! Veç, të vjen edhe pakëz keq. E ke parë si është rritur ca nga ca, që nga guri i parë i themelit, deri te dora e fundit. Je mësuar me të, të është bërë si një shok. Pastaj, duhet të ndahesh. Do të shkosh gjetiu, do të zësh një shok të ri... Por, nga ana tjetër, gëzohesh se le diçka pas. Në paç punuar mirë, njerëzit do të të kujtojnë për të mirë, do të thonë «i lumshin duart atij, mjeshtrit».

— Besoj, ke punuar në shumë vende?, — pyeta pastaj.

— Ohu... Sa s'mbahen mend. Ne kështu e kalojmë jetën, nga një objekt, në tjetrin. Kur kaloj para ndonjëres nga godinat ku kam punuar, ndalem dhe e vështroj. Ja, them me vete, këtu punoja kur u martova, këtu kur më lindi djali i parë, këtu kur mora taserën e Partisë...

Tregoi me mistri godinat që i shihte vetëm ai.

— E ke të rritur djalin?

— Njëzet vjeç. Mëson për inxhinier ndërtimi. Prite kur të vijë ndonjë ditë dhe të më mësojë qysh ndërtohet!, — qeshi.

Mjeshtri fliste ngadalë dhe i ngjiste fjalët si tullat në llaç. Por, nëpër ato fjalë të thjeshta, bulonin mendime të mëdha dhe ndjenja të pastra, si sytë e tij.

Mbas një copë here ia behën në objekt një grup sharrëxhinjsh. Ndërmjet tyre ishin Skënder Topi, Kiçoja dhe të njohur të tjerë.

— Po ju?, — pyeta, gjoja si i habitur.

— Kemi ardhur t'ju bëjmë sehir!, — bëri shaka Kiçoja. — Dëgjuam se t'u mërzit doktorllëku dhe ke hyrë si nxënës te usta Pandi, prandaj!

— Po neve, ç'punë do të na japësh, usta?, — pyeti Skënder Topi. — Duam punë për krahë sharrëxhinjsh, ama! — Ai tregoi me shaka muskujt e krahëve.

— Qysh kështu, ju paskan nxjerrë nga sharra?!, — desha të laja hakun. — Mirë kanë bërë, ç'i duhen ca dembelë dhe biçimszë, si ju!

— Pse, more doktor, vetëm juaji është spitali?, — u hodh një sharrëxhi i moshuar. — Ti je i ri, akoma s'të dhembin kyçet nga reumatizmi dhe as fëmijë që t'u enjten bajamet nuk ke, prandaj....

— Usta Pandi, punën, se fjalët janë fukarallëk!, — ndërhyri Kiçoja. — Jemi në garë me turnin tjetër, se kush do t'ju ndihmojë më shumë dhe duam ta fitojmë.

— Veç qejf të keni!, — buzëqeshi usta Pandi. — Ja, afroni gurët rrëzë skelës...

Punuan bashkë me sharrëxhinjtë gjer në të ngrysur

dhe nuk e kuptuam si na kaloi koha. Ndërsa po mblidh-
nim veglat, vështrova murin që ishte ngritur atë ditë
dhe lodhja sikur më rrodhi nga thembrat, drejt e në to-
kë. Sakaq, m'u kujtuan fjalët e xha Pandit.

Gjystinës dhe Mejremes, si gra me fëmijë që ishin,
u kishim thënë ta linin punën më herët; sharrëxhinjtë
shkuan grup të çonin veglat në magazinën e stabilimen-
tit, kështu që zbrita në qytezë vetëm me Ademin.

Kohët e fundit ai tregohej i zellshëm dhe korrekt.
Respektonte me përpikmëri orarin, nuk largohej asnjë-
herë nga puna pa leje, tregohej i gatshëm për të plo-
tësuar çdo urdhër a porosi dhe sillej urtë e butë me të
gjithë. Ndoshta, ngaqë i kishte hyrë frika, se nuk ma
merrte mendja të ndërronte kaq kollaj, por, në fund të
fundit, vetëm ai e dinte se ç'bëhej në ndërgjegjen e vet
dhe koha do të tregonte se sa e sinqertë ishte kjo kthesë.

Pak pa u ndarë, na mbiu përpara Liliana. Ajo vu-
ri dorën strehë mbi vetulla dhe vështroi me habi rrobat
tona, goxha të përlyera.

— Si qenkeni bërë kështu, more derëzinj!, — tha
duke rrahur shuplakat. — Duket që s'e keni zanat, pa
jeni zhyer kaq shumë. Ecni t'ju bëj nga një kafe, se do
të jeni lodhur.

— Falemnderit, po do të shkoj të ndërrohem njëhe-
rë, se vërtet që jemi bërë për të mos u parë!, — iu shman-
ga ftesës me takt.

— M'i sill mua të t'i pastroj, po deshe!, — u tregua
e gatshme ajo.

— S'është nevoja t'ju shtie në bezdi, kam ndërresa
boll!, — thashë.

— T'i pastron Kristina, si duket!, — vërejti ajo, bu-
zagaz.

— Ju e dini që shkoj hera-herë në familje!, — thek-
sova disi qortues.

— Thashë për Kristinën, se kam dëgjuar që ajo me
të ëmën çoku të bëjnë ndonjë shërbim!, — vazhdoi Lili-
ana, pa i vënë re shenjat e dëshpëruara të të shoqit. —
Helbete, si beqar, ke nevoja. Dhomën për të shkundur e

pastruar, një këmishë për të larë dhe hekurosur, një kopsë... Kurse e shkreta teto Zogë, jo aq, po një ushtri të tërë lan e pastron, mjaft që t'i hapë rrugë së bijës. S'ia pëlqeu atë mekanikun e sharrës, e ka syrin lart çupka!

— Kristina është vajzë e mirë!, — ia preva.

— Liliana, lëri këto!, — s'iu durua më Ademit, që ndërkohë kishte marrë një pamje të trembur e të shqetësuar.

— S'e shava!, — tha ajo pa ia varur të shoqit. — Veç, e mat veten me hijen e mëngjesit dhe harron se kafshata e madhe të ngec në fyt.

— Askush nuk e di më mirë se vetë i zoti sa i nxë fyti!, — e ktheva me shaka.

— Po, po, xhanëm, gjithçka mund të ndodhë!, — tundi kokën ajo, me nënkuptim.

— Kështu e kanë gratë, s'u rri gjuha rehat, por ju mos u pengoni më, doktor, se jeni i lodhur!, — ndërhyri Ademi, duke më zgjatur dorën.

Mbasi u ndamë dhe u larguam disa hapa vura re se si ai po i fliste me ca gjeste të zemëruara, kurse ajo ecte me mospërfillje kokëpërpjetë, duke u përkundur lehtë, si zakonisht.

Me të mbërritur në dhomë, u zhvesha, i hodha rrobat e ndotura mbi një karrige dhe shkova të lahesha. Uji ishte i ftohtë dhe ndërsa e hidhja me grushte në fytyrë dhe në krahë, s'i përmbajta dot disa pasthirrma. U fërkova fort me peshqir, sa më dogji lëkura, pastaj nxitova të vishja ndërresat e pastra.

Kur po mbërtheja kopsat e mëngëve të këmishës, dëgjova një trokitje të lehtë në xham. Çela dritaren dhe hetova jashtë, duke hapur fort sytë nëpër muzg. Sakaq njoha siluetën e Kristinës dhe të Ritës.

— Oh, kush na qenka!, — thirra i gëzuar dhe nxitova t'u dilja përpara. — Urdhëroni, pra, urdhëroni brenda!

Ato ngjitën me shkathtësi tri këmbëzat e shkallës dhe hynë në dhomë, duke picërruar sytë nga drita e fortë.

— Sapo u ktheva nga puna vullnetare dhe m'u desh të ndërrohesha, prandaj do të më falni për çrregullimin!, — thashë.

— Kjo s'është dhomë-muze, por dhomë banimi, ca më tepër e një beqari!, — buzëqeshi Rita. — Ne erdhëm të të njoftojmë se sonte, rreth orës shtatë, xha Andoni shtron një darkë me rastin e gjashtëdhjetëvjetorit të vet dhe je i ftuar.

— Përvjetorin e dija dhe për atje po përgatitesha!, — thashë. — Për darkën e mora vesh tani.

— E vendosëm çastin e fundit, meqë erdhi edhe Miçoja nga Tirana!, — tha Kristina.

— Qysh të mos vinte!, — vërejta. — Po kjo si ju duket për dhuratë?, — i pyeta pastaj, duke nxjerrë nga rafti një vazo prej druri të gdhendur.

— Oh, sa e bukur!, — tha Kristina dhe zgjati dorën ta merrte.

— Që të mos thoni pastaj se mjekët janë njerëz pa shije!, — buzëqesha.

— Sa për atë, ti ke dhënë mjaft prova!, — bëri shaka Rita, duke hedhur një vështrim fluturak nga shoqja.

— Kam ditë pa të parë!, — iu drejtova Kristinës, me një timbër qortues.

— Po, kam qenë e zënë me punët e shkollës!, — belbëzoi ajo. — Duheshin ndihmuar ca nxënës të dobët... Kisha edhe një relacion për të përgatitur... Edhe ti ke pasur plot telashe, sidomos qysh kur filloi ndërtimi i spitalit të ri.

— Megjithatë..., — vërejta, përsëri qortues.

Ajo u hutua dhe u skuq. Që të merrej me diçka, nisi të trazonte një këmishë që unë, në nxitim e sipër, e kisha lëshuar mbi tryezë. Ngriti një hop sytë dhe më vështroi në mënyrë të çuditshme, sikur deshi të më thoshte diçka dhe s'guxonte. Në vështrimin e saj kishte mall dhe druajtje. Me majat e gishtave nisi të vërtiste një kopsë të këmishës.

— Do ta këputësh!, — e ngacmova,

— Gati është, — tha ajo, e gëzuar që i gjeti një shteg vetvetes. — Më jep gjilpërë dhe pe, të ta forcoj.

Mezi i gjeta dhe ia dhashë. Ajo e përforcoi kopsën, këputi fillin me dhëmbë, pastaj e vendosi këmishën me kujdes në raft. U vonua një hop përballë të ndarave të tij, përkëdheli me vështrim plaçkat e renditura në to, i mbylli me ngadalë kapakët dhe u rikthye pranë tavolinës me hapa hezitues. Shëtiti sytë nëpër dhomë, sikur diç kërkonte, pastaj i përqëndroi tek abazhuri i vogël i komodinës, me mbulesë prej mëndafshi të qëndisur.

— Sa i bukur që është!, — tha, duke buzëqeshur me një farë dhembshurie.

— E kam prej kohe!

— Atëherë, e do shumë!... Pse qesh?! Edhe sendet mund të duhen, sidomos kur me to lidhen kujtime të bukura. — Ajo përkëdheli me mollëzat e gishtave mbulesën e mëndafshit të abazhurit, pastaj mbështeti lehtë gishtin tregues mbi sumbullën e bardhë të çelësit dhe drita u drodh. — Rita, duhet të shkojmë!, — brofi pastaj, si e trembur.

— Mirë, shkojmë, moj xhanë!, — tha tjetra, që deri atëherë ishte shtirur si e përqëndruar në shfletimin e një reviste të ilustruar.

— Pritni njëherë, t'ju qeras makar me një karamelë, se për herë të parë më shkëlqi në dhomë!, — thashë, duke nxituar drejt raftit të ushqimeve.

— Jo, faleminderit, s'është nevoja, u vonuam!, — nguli këmbë Kristina.

— Ç'tu kujtua, që u shqetësove kështu, papritur e pakujtuar, apo mos të ka thënë kush se unë ha vajza?, — bëra shaka.

— Do t'i ketë thënë Liliana!, — bëri shaka Rita.

— Përderisa janë thashetheme...

— Sidoqoftë, vajzë është!, — më ndërpreu Rita.

— Por, kjo dikur thoshte se nuk u trembet thashe-

themeve, kur e ka ndërgjegjen të pastër!, — vëreja, duke e mbërthyer Kristinën me një vështrim qortues.

Ajo u skuq dhe uli kokën, e zënë ngushtë. Që ta kapërcenin atë moment delikat, unë nxitova t'u ofroja karamеле. Ato morën nga një dhe bënë urimin e rastit. I përçolla me përzemërsi, duke i siguruar se nuk do të vonohesha.

E rregullova si munda dhomën, vesha xhaketën dhe po matesha të dilja, kur dera trokiti përsëri.

«Obobo, ndonjë urgjencë!», — mendova, — «Po tani, si t'ia bëj për festën e xha Andonit?!»

Kur çela derën, u gjenda përballë një fshatari disi të njohur, që mbante një trastë në dorë. E ftova të hyn-te dhe ndërkaq m'u kujtua se ishte i ati i djalit me bronkopneumoni, që e kishim nxjerrë para disa kohe nga spitali. E pyeta për shëndetin e të birit dhe atij iu bë qejfi. Tha se Ndini i vogël më kujtonte me dashuri dhe mirënjohje. E porosita nishtas ta ruanin nga djersa dhe nga të ftohtët dhe ta ushqenin mirë, sidomos me bulmet dhe fruta. Edhe mjalti do t'i sillte dobi. Më siguroi se po m'i zbatonte këshillat dhe se djali po forcohej dita-ditës. Pastaj, biseda shteroi dhe mbetëm një hop të heshtur përballë njëri-tjetrit. Unë prisja të thoshte hallin; kurse ai hezitonte.

Më në fund, ndrydhi në tavllë bishin e cigares dhe nisi të rrëmonte i ngatërruar në trastën e vet. Nxori që andej një pako të madhe, të mbështjellë me gazetë.

— Ju kam sjellë diçka të vogël, në shenjë mirënjohjeje!, — tha, duke u matur, i druajtur, ta vendoste pakon mbi tryezë.

Ajo pako më ngjau si një copë akulli, që e ftohu menjëherë atmosferën miqësore që ishte krijuar ndërmjet nesh.

— Ju lutem, futeni në trastë përsëri!, — i thashë butë, po prërë.

— Pse?!, — u habit ai dhe pakoja i mbeti pezull në dorë.

- Fute një herë, pastaj bisedojmë!

Ai hezitoi një çast, pastaj u bind, me një pamje disi të fyer. Pakoja ra në fundin e trastës, si diçka pa vlerë. Ai ngriti drejt meje ca sy pyetës, të vrenjtur.

— Nëpunësve të pushtetit, që ju zgjidhin ndonjë hall, u çoni dhurata?, — e pyeta.

— Ç'është ajo fjalë, doktor?!, — u vrenjt ai.

— Atëherë, pse ma solle mua?!

— Por, ti më shërove djalin!

— Unë marr rrogë, si dhe nëpunësit, për detyrën që kryej. Nëse ndihmova që të shërohej Ndini, këtë e kam për detyrë. Tjetër kujt duhet t'i jeni mirënjohës për mjekimin falas.

— E dimë këtë, doktor, por sidoqoftë...

— Pastaj, a ka shpërblim më të madh për mua sesa mirënjohja e Ndinit të vogël dhe juaja?!, — i thashë buzagaz, duke i vënë dorën në sup.

— Ashtu është, ke të drejtë!, — miratoi fshatari, tashmë i çelur në fytyrë. — Megjithatë, në të ardhhtë ndonjëherë për mbarë, na urdhëro nga shtëpia!, — tha dhe u çua të dilte. — S'e merr dot me mend sa do të gëzohehim, sidomos Ndini i vogël.

— Do të vij!, — i premtova. — Kur të ketë ditëlindjen Ndini, më çu fjalë.

— Vërtet do të vish?

— Të jap fjalën. Veç, në mos më pengoftë ndonjë arsye e fortë pune.

Ai rrëmbeu me përbuzje e me turp trastën dhe u drejtua nga dera. Te pragu më shtrëngoi fort dhe gjahtë dorën.

— Të lutem, mos ma merr për keq, s'e pata me të keq!, — tha. — Ndonjë tjetër ka pranuar.

— Shumë keq ka bërë!, — vërejta.

— Nejse, ma bën hallall!

— Bëni shumë të fala Ndinit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes!, — i thashë, duke e përcjellë deri te shkallët e jashtme.

Me t'u larguar ai, fika dritën, kyça derën dhe ia mbajta drejt e te shtëpia e xha Andonit. Doli e më pritë

Miçoja, me të cilin u përqafoam si dy shokë të vjetër. Ai më udhëhoqi në dhomën e njohur, ku ndodheshin edhe plot mysafirë të tjerë.

Xha Andoni, i veshur me një kostum të zi me vija, të prerë qëmoti, por të mbajtur mirë, që e tregonte më të moçëm dhe disi solemn, ishte ulur në krye të vendit dhe diçka po tregonte. Sa më pa, e la fjalën në mes, brofi në këmbë dhe më përqafoi me dashuri.

— Falënderit, ta shpërblefsha në dasmë!, — buzëqeshi i mallëngjyer, duke marrë vazën prej druri të gdhendur, të cilën e vendosi me kujdes përmbi bufe. Pastaj u rikthye në vendin e vet dhe vazhdoi tregimin. — Prandaj, sot nuk e kisha fort mendjen të përgjigjet e nxënësve. E, ç'nuk më kujtohej! Kujtoja kohën kur erdhëm së pari këtu; atë shkollën e vjetër prej druri së cilës, bashkë me Sofinë e ngratë, mundoheshim t'ia zinin vrimat me baltë; ata nxënësit zbatarakë, që na dhimbeshin dhe i donim si fëmijët tanë; ato netët e kohës së luftës, kur shkruanim gjer vonë trakte dhe parulla; atë ditë kur në fshat hynë partizanët dhe nisëm këtë jetë... Pastaj, pa shë me sytë e mendjes qysh lindi dhe u rrit kjo qytezë, bashkë me Miçon tonë; qysh u ngrit kjo shkollë e re; qysh kaluan breza nxënësish... Kujtova edhe ditën kur Sofia gjeti thinjën e parë në flokët e mi, pastaj...

Xha Andoni e ndërpreu tregimin, duke ulur sytë, që të fshihte pikëllimin e atij kujtimi. Mori një cigare, e ndezi me lëvizje të ngadaltë, pastaj ia nisi përsëri:

— E, ç'nuk kujton njeriu në një përvjetor të tillë! Bën, si të thuash, një bilanc të jetës së vet dhe lum ai, të cilit i del bilanci për të qenë. Ja, këto kujtoja, o miq, dhe s'e kisha fort mendjen të përgjigjet e nxënësve. Orën e pestë vura re se ata s'po rrinin të qetë, si zakonisht. «Lëri për herë tjetër kujtimet dhe merru me ta!», — i thashë vetes. Në orën e mësimi s'më kanë bërë kurrë zhurmë. Ndoshta për shkak të aritmetikës, ndoshta se kam qenë i rreptë a ndoshta se më donin, nxënësit e dinë... Sidoqoftë, ngrita njërin në dërrasë të zezë dhe u thashë të tjerëve që të kishin mendjen, se do t'i pyesja

nga vendi për vazhdimin e problemit. Për ca kohë u bë qetësi, pastaj prapë filluan të lëviznin. «Aha, Andon, kaq e pate, — i thashë vetes, — si duket, u plake dhe s'je më për këtë punë, prandaj më mirë hiq mënjanë!» T'ju them të drejtën, më erdhi keq. E, kush do që të plakët, kujt s'i vjen keq të hiqet mënjanë?!... «Me leje, mësues, — ngriti dorën Samiu, i biri i Halimit, — a mund të dal pak jashtë?». I dhashë leje. Një hop sikur u qetësuan. Por, pastaj, përsëri filluan të pëshpërisnin andej nga reshti i dytë. «Po kjo, Lena, që është nxënëse shembullore, ç'paska sot?!», — u habita në vetvete. «Me leje, të dal pak jashtë?», — kërceu mbas pak ajo. «Dil edhe ti!», — i thashë, duke psherëtirë dhe se si m'u mblodh një lësh në gjoks. «Iku vapa me gushtin, o Andon, s'ke ç'i bën!», — mendova. Mezi e prisja zilen. S'më kishte ndodhur kurrë kjo. Ra, më në fund. «Eh, shyqyr!», — thashë me vete. Nxënësit u çuan përnjëherë në këmbë, por s'lëvizën nga vendi. Befas, ishin bërë fare të urtë dhe prisnin, me sytë nga dera. Sakaq ajo u çel dhe hynë ata që kishin dalë. Lena kishte në dorë këtë tufë, — xha Andoni tregoi tufën e madhe me lule mali, që ishte vendosur në vazon e mesit, të lidhur me fjongo të kuqe. Sakaq, nxënësit i kthyen sytë nga unë dhe buzëqeshnin. Ah, ata sy!... «Me rastin e gjashtëdhjetëvjetorit...», — nisi Lena, duke më zgjatur tufën. Vura re se bishtalecave të saj u mungonte fjongoja e kuqe, pashë përsëri sytë e nxënësve dhe nuk dëgjova më tutje. Ndoshta asaj iu lidh gjuha, a ndoshta më pengoi mallëngjimi. Vetëm di që zgjata duart dhe mora dhuratën më të bukur të jetës sime. Nuk më erdhi turp që nxënësit po më shihnin me lotë në sy...

Kristina priste para meje me tabaka në dorë. Mora gotën e pijes dhe mbeta me të në dorë. Vështroja tufën e luleve dhe më dukej sikur ajo flakëronte përmbi tavolinë, si një simbol i mirësisë dhe i mirënjohjes së njerëzve ndaj punës së ndershme.

Vizitat e urimeve vazhduan deri vonë. Ai priti dhe përcolli plot miq dhe pothuaj me secilin pati diçka për të kujtuar, sepse shumica kishin qenë nxënës të tij. Kështu,

nga ato copëza ngjarjesh dhe kujtimeësh admirova të kaluarën e bukur të atij njeriu, sytë e të cilit me të drejtë shkelqenin nga lumturia dhe krenaria. Atëherë ndjeva thellë se mozaikut të jetës sime i duheshin akoma shumë e shumë copëza të atilla dhe se ato copëza mund të gjendeshin edhe në atë qytezë, të cilën një ditë s'e kisha gjetur dot në hartë.

12

Po zbrisja më të poshtë pishnajës, duke fishkëllyer gjithë hare një melodi. Adem mundohet të mbahej mbas meje, me çantën e ndihmës së parë të varur krahaqafë. Kishim kaluar nëpër disa brigada, kishim vizituar një bari të sëmurë te stanet e Bulinës, ku na gostitën me bukë të pjekur në saç dhe djathë të njomë, dhe tanë po zbrisnim drejt brigadave të tjera, që punonin rrëzë shpatit.

Tashmë isha bërë mik i sharrëxhinjve të pyllit. Shkoka tek ata, me dëshirë, sepse përveç që kryeja detyrën, kënaqesha dhe çlodhesha. Po të kalonin disa javë pa dalë në sektorin e shfrytëzimit, më merrte malli. Ndieja mall për sharrëxhinjtë bujarë e zemërbardhë, për bisedat e tyre të urta e të zgjuara, për atë karakterin e tyre të fortë e të përmbajtur, që kishte diçka nga madhështia e pyllit. Më merrte malli për bjeshkët; më pëlqente të shkelja mbi legushën si sfungjer të ahishtëve; të përkëdhelja gëzofin prej myshku të drurëve të moçëm; të dëgjoja gurgullimën e ujërave të përrenjve, që rrezoheshin përmes shkëmbinjsh të hirtë, të vështroja fluturimin e reve nëpër gryka dhe maja malesh, të nuhasja kundërmimin e veçantë të drurit të porsaçarë, të djersija duke iu ngjitur shpateve dhe të më dhambnin pulpët duke zbritur honeve dhe rrëpirave...

— Më ngadalë, doktor, se s'të ndjek dot!, — thirri Adem, që kishte mbetur goxha prapa.

— Po të pres te burimi, — iu përgjigja. — Atje bëjmë një pushim.

Sapo arrita te Burimi i Zanave, mbështeta njërin gju mbi plloçë dhe vura dorën si kupë nën currilin e ftohtë të ujit. Ai më rrodhi nëpër gishta, më giciloi buzët, më freskoi gojën dhe e ndjeva qysh më shkante poshtë, duke më sjellë kënaqësi. Pastaj u ula mbi një gur aty pranë dhe ndeza një cigare. Megjithëse kishim ecur shumë, ndieja të gjallë, të gatshme, bile të dëshiruar për lëvizje dhe veprim, çdo peyzë të muskujve. Asnjëherë s'e kisha ndier veten në pyll të flashkët, apo të mërzitur. Përkundrazi, sa shkoja atje, sikur ma hiqte njeri me dorë çdo mërzë dhe plogështi.

Dihata me ëndje ajrin e freskët dhe plot kundërmim të pishnajës, ndërmjet të cilit shquante duhma e fortë e rrëshirës. Ngrita sytë nga qielli dhe pashë plot re të hirta, që nxitonin drejt veriut, duke mbuluar herë-herë diellin. Drita e tij tërhiqej dhe vërshente valë-valë.

Ndërkaq, arriti Ademi dhe u ul të pushonte pranë meje. Dihaste shpesh, dhe djersa i vezullonte në të gjitha porët e fytyrës e të shogës.

— Na këpute, doktor!, — tha. — Helbete, ti je në lule të moshës dhe s'e ndien, kurse unë...

— S'ka gjë, edhe ty të bën mirë!, — buzëqesha. — Makar të mos na zërë shiu!

— Po, vërtet!, — vërejti ai, duke çuar sytë përpjetë.

Dielli qe fshehur dhe s'po dilte më. Qielli po sterro-sej përherë e më shumë. Të gjitha ngjyrat sikur huajtën diçka nga ngjyra dhe ftohtësia e plumbit. Kundërmimeve të zakonshme po u shtohej një kundërmim i ri, i veçantë, i papërcaktuar mirë, por që paralajmëronte ardhjen e shiut.

Shova me kujdes bishtin e cigares dhe brofa në këmbë.

— Ndoshta mund të arrijmë deri në sektor pa filluar shiun!, — i thashë Ademit dhe u nisa më të poshtë.

Pikat e para filluan pak pa mbërritur te brigada e sharrëxhiut mustaqelli e shpatullgjerë Mete, me të cilin

më lidhte kujtimi i takimit të parë me sharrëxhinjtë dhe që ndërkohë ishim bërë miq. Ai punonte nja njëzet minuta përmbi sektor. Ishin pika të rralla, të mëdha, që kërcënisnin fort nëpër gjethë, formonin sumbulla të shndritshme në halat e pishave dhe gjurmëza të rrumbullakëta, ngjyrë kafe të errët, në dheun e rrahur të shtegut. I ndieja me një farë bezdie qysfi më pikonin në kokë e përmbi shpatulla dhe nxitoja përherë e më shumë, pothuaj rëndja më të poshtë. Ademi rrekej me të gjitha fuqitë të mos mbetej prapa.

Kur arritëm në vendin ku punonin ata të Metës, shiu ia kishte filluar paq dhe ne ishim lagur goxha. Flokët më ishin bërë qull dhe më pikonte ujë nga mjekra dhe nga maja e hundës. Nxituam të strukeshim në strehish-tën e brigadës, të sajuar me hunj dhe degë bredhi. Aty ishin Metja më dy të tjerë. Fshiva flokët dhe fytyrën me shami, u kopsita dhe u mbështolla sa munda, pastaj zura vend mbi një kërcu.

— E ka zënë rrëmbyer!, — vërejti Metja. — Nuk do të zgjasë shumë, por për të lagur do të na lagë.

Strehishtja filloi të pikonte. S'paska gjë më të bezdisshme se pikat që të bien papritur në zverk. Veprova si sharrëxhinjtë: hoqa xhakëtën dhe e hodha përmbi kokë.

— Më mirë borë, sesa shi!, — tha një sharrëxhi. — Në borë mund të punosh, shkundesh herë pas here dhe m'ori fund. Bora është e paqme. Kurse shiu s'të lë, të hyn gjer në palcë. Le të jetë ftohtë sa të dojë, unë s'pyes, po u laga, ama!...

— Po shokët e tjerë, ku janë?, — pyeta.

— Ja, nën atë drurin, atje! — Metja tregoi me dorë një bërth të moçëm që ngrihej si gjigant përmbi drurët e tjerë.

Tani gjithçka ishte lagur dhe kishte marrë një shkëlqim të mugët. Drita ishte e pakët, gjelbëroshe. Ndihej fort duhma e legushës dhe e tokës së njomur të pyllit. Filloi të shkrepinte dhe të bubullinte, në fillim larg, pastaj gjithmonë e më afër. Qielli përqahej me zjarr, duke sikur thyhej në copa, gjithësia llamburinte me një

-shkëlqim të bardhë, verbues, pastaj gjëmonte sa dridhej dheu dhe dukej sikur shkëmbinjtë e majave hëhë do të shembeshin dhe do të rrokulliseshin më të poshtë shpatit. Era sa vinte egërsohej. Valët e saj kalonin nëpër pyll duke përkulur dhe përplasur degët e drurëve, me një kërcëllitje të frikshme.

— Sot nuk bëhet më për punë. Lagur se lagur, a nuk ia marrim vrapit për në sektor?, — propozoi njëri nga sharrëxhinjtë.

— Prit të nxjerrë dufin një herë, se mund të na bëjë rrugës ndonjë dru përsipër!, — ia priti Metja. — Makar, këtu është vend i mbrojtur.

Sakaq u bë një dritë dhe një krismë, sikur shpërthyen qiejt. Një çast më pas u bë errësi dhe furtuna vazhdonte njësoj. Binte erë shkrumb.

— Paska shkrepur te bredhi!, — gati sa s'klithi Metja dhe u lëshua vrap në atë drejtim, pa iu ruajtur rrebeshit dhe degëzave që i fshikullonin fytyrën.

Mbas tij u lëshuan edhe dy sharrëxhinjtë e tjerë. Unë shtanga një çast pa kuptuar gjë. Vështrova në atë anë dhe pashë se trangu i bredhit gjigant që çarë nga lart-poshtë me një brazdë të bardhë, spirale. Disa nga degët e tij të trasha qenë këputur, si prej një dore përbindshi.

«Sa afër na paska rënë!», — mendova dhe sakaq u kujtova se nën bredh kishin qenë strehuar disa nga të brigadës.

Brofa dhe u sula nga shkuan shokët. Rrugës u ndëshua me njërin nga sharrëxhinjtë e bredhit që vraponte drejt meje, i çakërdisur.

— Gjergji, doktor, na ka goditur Gjergjin!, — thirrri ai.

Arrita me një frymë. Sharrëxhinjtë, të zhveshur në këmishë e në triko, më lëshuan rrugë. Gjergjin e kishin shtrirë mbi peliçet e tyre, nën degët e shëndosha të bredhit të goditur dhe Metja po i luante krahët, në mënyrë të çrregullt,

— Shikoje, doktor!, — tha ai me një dhimbje të paanë.

Gjergji ishte i zbehtë, me buzë të mavijosura, me qepallë paksa të mbyllura, poshtë të cilave sytë i duke-shin si prej qelqi. Gjoksi nuk i lëvizte.

I çela me të shpejtë nofullat, i tërhoqa gjuhën me shami dhe fillova menjëherë frymëmarrjen artificiale. Një, dy, dhjetë, njëqind herë. Në kokë dhe në zverk më binin pika të mëdha uji, gjunjët e mbështetur në dhe më ishin lagur, era më fshikullonte fytyrën, por nuk ndieja aspak të ftohtë. Ai s'jepte asnjë shenjë jete. Ia lëvizja ritmikisht krahët, lart-poshtë, lart-poshtë dhe numërova përsënjëzaj, me shpresën e çuditshme se kur të arrija njëqind, ai do të përmendej. Ndërkohë para syve të mendjes më kalonin lloj-lloj pamjesh, më vetëtinin mendime nga më të ndryshmet.

«...Dymbëdhjetë, trembëdhjetë... Sa të rëndë që i ka krahët, këta krahë që e ngrinin sëpatën si pupël dhe e bënin të shkrepinte zjarr!...»

«...Njëzet e shtatë, njëzet e tetë... Kur godiste me sëpatë, ngjante si ndonjë div i legjendave...»

«...Tridhjetë e pesë, tridhjetë e gjashtë... Sa ftohtë dhe lahtarshëm i shkëlqejnë sytë, këta sy nga ku buronin dikur dritë dhe ngrohtësi... Thua, do të gjallërohen përsëri?...»

«...Pesëdhjetë e tetë, pesëdhjetë e nëntë... Si i çenkan nxirë dhe ngurtësuar buzët. Këto buzë që qeshnin aq ngrohtë, aq çiltër!...»

«...Gjashtëdhjetë e dy gjashtëdhjetë e tre... Qeshte me gjithë zemër, këndonte me gjithë zemër. E dontë jetën. Ç'them kështu, pse «e donte»? Ai e do jetën dhe do ta gëzojë... Ai është kaq i ri!...»

«Shtatëdhjetë, shtatëdhjetë e një... Ai do të jetojë, patjetër që do të jetojë... Ja, edhe pak e do të japë shenjën e parë!...»

«Nëntëdhjetë e tre, nëntëdhjetë e katër... Asnjë shenjë, asnjë shenjë, asnjë shenjë... nëntëdhjetë e tetë...»

— Më kot e trazon kufomën doktor!, — dëgjova një zë plot dhimbje.

— Pusho!, — ia preu një tjetër.

Nuk e ktheva kokën asnjëherë t'i vështroja, por i ndieja vështrimet e tyre të ngulitura tek unë, sikur më shponin zverkun.

«Duhet bërë prova e fundit, duhet bërë menjëherë!», — më vetëtiu ndër mend.

U përkula mbi fytyrën e tij. Mbështeta buzët e mia në të tijat. U shtrëngova fort përmbi to. Ishin akull të ftohta. Ndjeva një shijë të hidhur. U drithërova, por nuk u zmbropsa. Fillova të merrja frymë me forcë, duke thithur e shtyrë ajrin në mushkëritë e tij.

— Po shkëmben frymën me të vdekurin, ky qoftë!, — pëshpëriti dikush.

— Hesht!, — e qortoi një tjetër.

«Jo, nuk është i vdekur, nuk është!», — mendova, me një shpresë dhe këmbëngulje të çuditshme.

Fryja dhe thithja me sa fuqi kisha dhe ndërkohë i lëvizja ritmikiisht krahet. Në tëmtha sikur më rrihnin dy çekiçë. Më dukej sikur gjithçka ndodhte jashtë realitetit. Më buçisnin veshët, Më mungonte ajri. Duhej të largohesha një çast, vetëm një çast, që të merrja një herë frymë lirisht, por nuk bënte, nuk duhej. Edhe pesë herë, edhe katër, edhe tri...

U largova, duke e vështruar atë plot ankth. Gjoksi i tij vazhdonte të lëvizte. Lëvizte vetë. Lehtë, në mënyrë të çrregullt, por lëvizte, lëvizte, lëvizte...

Ademi kishte përgatitur një injeksion me kardiotonik dhe m'u afrua. Ia miratova veprimin me sy dhe i bëra vend. Kraharori i të ringjallurit nisi të lëvizte më shpesh. Ktheva kokën nga shokët e tij.

— Shpëtoi, është gjallë, e paska pasur të gjatë!, — dëgjoheshin disa zëra.

U lëshova mbi djaloshin dhe vazhdova t'i bëja frymëmarrje artificiale me kujdes, ritmikiisht, sikur trembesha mos lëndoja frymëmarrjen e vet atij. I kisha ngulur

sytë në fytyrën e Gjergjit, e cila po skuqej dalngadalë. Sytë e tij filluan të gjallëroheshin dhe nuk dukeshin më si prej qelqi. Dikur i lëvizën lehtë buzët. Më vonë iu përpëlitën edhe qepallat. Frymëmarrja filloi t'i bëhej ritmike. I ndjeva pulsën. Ai sikur më vështronte me një habi të thellë. Jo, nuk më dukej, vërtet iu gjallërua vështrimi. Sytë e tij lëvizën ngadalë dhe u kthyen gjithashtu të habitur drejt shokëve.

— Ku, jam?, — doli si një ofashmje nga buzët e tij.

— Mes nesh, Gjergj, mes nesh, vëlla!, — thirri Metja dhe u lëshua drejt tij.

— Mos e shqetëso!, — e ndalova. — Ai ka nevojë për qetësi, ta marrë ca veten. Duhet ndezur zjarr.

Metja më rrëmbeu dorën me të cilën e ndalova, ma shtëngoi fort, fort, më vështroi ashtu siç nuk më kishte vështruar njeri deri atëherë, pastaj mbështeti lehtë ballin në supin tim, si për një përqaftim të dashur e të përmbajtur.

— Na shpëtove shokun, shok!, — tha pastaj dhe u çua në këmbë.

Asnjëherë s'më qe dukur aq e ngrohtë dhe e fuqishme fjala shok.

Disa duar të ashpra mbanin të nderur sipër nesh një pelice, që të na mbronin nga shiu. Disa të tjerë po sillnin degëza dhe dru për të ndezur zjarrin. Dikush u vuri flakën dhe nuhata erën e njohur të tymit të kërcave.

— I dha frymën e vet!, — pëshpëriti dikush, me admirim.

Gjergji ulte dhe çonte ngadalë qepallat. Vështrimi i tij bëhej përherë e më i qartë. Zemra e tij po e rifitonte ritmin. Rrihte ende dobët, por megjithatë dukej më e fortë se bubullimat që shkonin duke u larguar, si të mundura.

Mbasi mbaruam bisedat me nënat fshatare mbi kujdesin që duhej të tregonin për fëmijët e gjirit, kryetari i

këshillit popullor na ftoi bashkë me Gjystinën, të pinim nga një kafe në klubin e kooperativës bujqësore.

— Ju lumshin këmbët që na erdhët, na bëtë një punë të mirë fort!, — tha kryetari i këshillit. — Se e kemi problem të madh uljen e vdekjeve të fëmijët e gjirit.

— Edhe ne jemi shumë të kënaqur, jo vetëm për punën, por edhe nga mikpritja juaj!, — u përgjigja.

— Kjo as që duhet zënë në gojë!, — vërejti ai, si për diçka të zakonshme.

Vërtet që isha i kënaqur me të gjitha. Përveç bisedës me nënat, kishim bërë mjaft vizita, si nëpër shtëpi, ashtu edhe në ambulancën e kooperativës. Pastaj, kisha qenë i ftuar në një darkë fejese, ku veç bisedave interesante dhe shakave me kripë, dëgjova plot këngë të bukura dhe pashë ca valle të moçme burrash, që më lanë përshtypje të thellë me lëvizjet e tyre të kursyera e të ngadalta, por shprehëse dhe energjike.

— Do të kisha qëndruar me dëshirë edhe ndonjë ditë, por duhet të zbres në qytezë, se jemi akoma të paktë dhe ndodh që, pikërisht kur mungon, shkojnë e dalin lloj-lloj nevojash dhe urgjencash!, — thashë.

— Neve qejfi na e ka të qëndroni sa më shumë, por ju shikoni terezinë tuaj!, — ma priti kryetari.

— Gjystina do të qëndrojë edhe sot, që të shkojë në të gjitha shtëpitë ku ka gra shtatzëna, ose me fëmijë në gji!, — vazhdova.

— Bukur fort!

— Nesër, ju lutem, përcillenit me dikë për në qytezë!

— Ta merr mendja që do ta përcjellim!, — buzëqeshi kryetari. — Edhe juve, bile. Ja, po çoj të thërras dikë nga tanët.

— Jo, nuk është nevoja — e ndalova. — Do të zbres vetë, se shtegu është i qartë dhe qyteza shihet në shumë pika, kështu që se kam të zorshme të ruaj drejtimin.

— Por, në bredhishtë edhe mund të ngatërrohesh, se shtegu është i fshehur dhe plot leqe!, — më paralajmëroi kryetari.

— Edhe atje besoj se do t'ia dal mbanë!, — buzëqesha.

— Si të duash...

Mbas një copë here u nisa më të poshtë rrugës këmbësore. Ndihesha i lehtë si pupël dhe i fuqishëm si ndonjë ortek. Ndoshta sepse ishte pranverë dhe ajo ndihej në gjithçka: në sythet e fryra të drurëve, në lulet e para, në kundërmimet e ajrit, në begatinë e ujërave malore, në gjakun dhe ndjesitë e mia...

Dita ishte e kthjellët, plot dritë dhe ngjyra vezulluese. Një copë të mirë, shtegu dredhonte pranë shtëpive të fshatit dhe oborreve kooperativiste, ndanë të cilave lulëzonin pjeshkët, qershitë dhe kumbullat. Aty-këtu, takoja ndonjë grua që sillte ujë nga burimi, pleq që barisnin ngadalë, duke trokëllitur shkopin në gurët e shtegut dhe fëmijë, shumë fëmijë, zërat e gëzuar të të cilëve sikur haheshin me cicërimat e zogjve. Ata i kishin gjymtyrët të përlyera me dheun e ugareve dhe të gërvishtur prej ferrave e trëndafilave të egër, por faqet u skuqnin dhe sytë u xixëllonin.

Të gjithë sa takoja, më përshëndesnin dhe më urojnë rrugë të mbarë, megjithëse shumë s'më njihnin. Eshfë një zakon i bukur ky, që të bën ta ndiesh më fort veten në truallin tënd, mes njerëzve të tu. U përgjigjesha gjallërisht dhe vazhdoja më të poshtë, duke fishkëllyer lehtë e lehtë një melodi.

Më në fund lashë pas edhe shtëpinë e fundit të fshatit. Tani shtegu dredhonte nëpër disa brezare të mbjella me grurë, që zgjateshin në faqen e malit si ca shkallare gjigante. Gruri që rritur nja një pëllëmbë dhe të kënaqte syrin me jeshillëkum e vet të shëndetshëm e të freskët. Që andej dukej edhe qyteza e vogël sa një gogël, e strukur buzë përroit, që shënonte me një vijë të shndritshme fundin e luginës.

Ndërsa po e vështroja, se si m'u ngjall një mall e dhembshuri për të. Megjithëse nuk e kisha mbaruar vitin atje më dukej sikur isha një banor i vjetër i saj. Dë-

shiroja të arrija sa më shpejt dhe në mënyrë të pavetëdijshme nxitova hapat.

Pastaj shtegu më futi në bredhishten e moçme, që vishte pjesën më të rrëpirtë të faqes së malit. Dukej çudi si kishte shpëtuar ai pyll pa u dëmtuar gjatë shekujve, aty, mes arave dhe kullotave të fshatit. Ndoshta e kishte shpëtuar ndonjë legjendë a bestytini, por, ndoshta më fort se gjithçka e kishte mbrojtur logjika e brezave, sepse pa të tokat e bukës që shtriheshin përfund do t'i kishte gërryer uji me kohë.

Bredhat e moçëm ndernin rreth e qark degë të gjata e të mëdha, pak të varura poshtë, si ca gjymtyrë të rënduara nga vitet, por kokën e mbanin drejt e përpjetë, si të krenoheshin me madhështinë dhe lashtësinë e tyre. Aty-këtu dukeshin bredha të rinj, me trajta të bukura konike, me degë të dendura, plot halëza të shëndetshme, mbi të cilat vezullonin me të gjitha ngjyrat e ylberit bulëza vese, me maja të gjata shtizore, që sikur çanin përpjetë.

Në bredhishtë ishte qetësi dhe dukej sikur asgjë nuk lëvizte, por, ndërkohë, unë ndieja me të gjitha shqisat qysh gëlonte jeta rreth e qark, qysh dridhëronte ajo mori gjethesh e degësh, qysh ecnin, zvarriseshin apo fluturonin gjallesat e panumërta të pyllit, qysh çanin koren e dheut fijëzat e barit, qysh shpërthenin burbuqëzet e luleve të egra.

Megjithatë, ajo qetësi e rreme, pamja e rëndë dhe solemne e drurëve, jeshillëku me reflekse të zeza i bredhave, kundërmimet e vjetra të pyllit, të ngjallnin padashur një druajtje dhe shqetësim të çuditshëm. Ndoshta për këtë arsye më pëlqeu të thërrisja dhe të dëgjoja jehonën e zërit tim.

Thirra përsëri, me kureshtjen dhe gëzimin e një femije dhe mendova buzagaz se ndoshta nuk i isha larguar aq shumë asaj moshe. Për çudi, jehona më ktheu herën e fundit një zë femre.

Qëndrova në vend dhe vështrova i habitur rreth e qark. Mbas pak dallova Kristinën që nxitonte buzagaz në

gjurmët e mia, e shoqëruar prej një djaloshi rreth të katërbëdhjetave.

— Po, ti, kur na pe, pse nuk prite?, — më qortoi ajo, duke më zgjatur dorën, ndërsa gjoksi i hovte dendur nga të nxituarit.

— Kush të tha që ju pashë?!, — kundërshtova.

— Derisa thirre...

— Thirra ashtu, kot, për qejf. Bile, u habita shumë që jehona më ktheu një zë femre.

— Ishte edhe kthjellët, kështu që s'pate ku e si ta kapërceje ylberin!, — bëri shaka Kristina.

Pastaj, ajo e falënderoi nxënësin që e shoqëronte dhe i tha të kthehej në shtëpi. Ndërsa nisëm të ecnim krah njëri-tjetrit, më tregoi se vinte nga shkolla e Bregasit, ku Vjollca kishte zhvilluar një orë mësim të hapur dhe kishte dalë shumë mirë. Si Vjollca, ashtu edhe Ibrahim me Ritën, më çonin shumë të fala. Që të tre do të zbrisnin të shtunën mbrëma në qytezë, prandaj, në s'kisha për të shkuar në Tiranë, të mos ia mbathja gjetiu. Ibrahim me Ritën paskëshin marrë edhe shtëpi të re — një dhomë e një kuzhinë, por të mira fort, mu në qendër të Murrizit.

— Ta shikoje Ritën, sa e gëzuar që dukej, tek rregullonte shtëpinë!, — tha Kristina duke buzëqeshur me dhembshuri e me një farë zillie. — S'lodhej duke i lëvizur sendet nga njëri vend i dhomës, në tjetrin, që t'u gjetiu. Ibrahim me Ritën paskëshin marrë edhe shtëpi në i kishte mirë apo jo.

— Kështu që do të jesh lodhur duke dhënë mendime!, — vërejta buzagaz.

— Posi, por edhe ty do të të vijë radha. Rita ka hartuar një listë të gjatë porosish, që do t'ia kryesh kur të shkosh në Tiranë.

— Mos ka vënë në listë që t'i sjell edhe mobiljet e dhomës së gjumit?, — bëra shaka.

— Ato jo, por, të tjera, sa të duash!, — qeshi Kristina.

Ndërkohë, po ecnim në zemrën e bredhishtes. Drurët

me degët e stërmëdha e kishin copëtuar qiellin në pjesë-za të panumërta shumëtrajtëshe. Trungjet e bredhave, me lëvore të ashpër, të hirtë në të kuqërremtë, ngriheshin drejt e përpjetë, si ndoca kolona vigane që mbanin sipër kupolën gjigante të blertë. Drita e diellit depërtonte nëpër të e shpërthyer në tufëza rrezesh, që projektonin ngado lara të ndritshme, lëvizëse. Zhurmat e pyllit ishin një-kohësisht të lehta dhe çjerrëse, të vazhdueshme dhe të befta, të afërta dhe të largëta. Halëzat dhe degëzat ngjyrë ndryshku, të rrëzuara prej shumë vjetësh, që po kalbeshin në legushë, lëshonin një kundërmim të athët. Krahas tij, silleshin në ajër aromat dehëse të pranverës.

— Sa herë kaloj këtu, më duket sikur ndodhem në ndonjë tempull të lashtësisë, më pëlqen ta admiroj, por edhe më pëlqen të largohem sa më parë!, — tha Kristina, duke shpejtuar në mënyrë të pavetëdijshme hapat.

Një copë herë ecëm pranë njëri-tjetrit të heshtur. Qysh nga ajo mbrëmje, kur pat ardhur bashkë me Ritën në dhomën time dhe unë e kisha qortuar se po më shmangej, ishim takuar më shpesh. Si zakonisht në qytezë, rastet nuk na mungonin dhe as që ishte nevoja t'i kërkoje. Shpesh ndodhte që takoheshim te xha Andoni. Një herë në javë merrnim pjesë së bashku në provat e grupit artistik të qytezës. Ajo ma mbushi mendjen të hyja në këtë grup. Meqë s'dola i aftë për tjetër punë, më caktuan spiker. Megjithëse për këtë rol nuk duhej kushedi ç'përgatitje, nuk mungoja në prova, veçse kur më pengonte detyra e mjekut. Megjithatë, rrallë dhe shkurt na kishte takuar të mbeteshim vetëm me njëri-tjetrin. Në këto raste Kristina bëhej çuditërisht e druajtur dhe e heshitur, thujse nuk ishte ajo. Të dy e kishim të qartë se shoqëria jonë kishte kaluar caqet e një shoqërie të zakonshme, por asnjëherë s'ia kishim pohuar këtë shoku-shokut veçse me sy.

Ndërsa mendoja për këto, i ishim afruar çeltinës ku ndodhej Kroi i Bardhë, burimi më me nam në atë anë.

— Ke etje?, — pyeta Kristinën, sapo dolëm buzë tij.

— Edhe në mos paça, s'kalohet këtej pa pirë ujë!, — buzëqeshi ajo dhe u kthye në drejtim të kroit.

Ndërsa ecnim nëpër livadh, bari i dendur e i shëndetshëm, që shkëlqente si mëndafsh, ndrydhej butë nën këmbët tona, duke bërë «fësht-fësht». Rreth e qark ngrihej, si ndonjë kurorë e gjelbër, profili i dhëmbëzuar i bredhishtës. Përmbi të shquheshin disa re të bardha, që po treteshin dalngadalë në kaltërsinë e shndritshme.

Kristina ecte nëpër livadh me krahët të lëshuar dhe pak të hapur anash, si e dehur nga drita, ngjyrat dhe kundërmimet pranverore. Unë e vështroja dhe mendimi se ajo ishte aq pranë meje dhe vetëm me mua në atë skutë pylli, më turbullonte. Provoja një ndjesi të çuditshme: sikur gjaku më çonte në çdo skaj të qenies sime tërësinë e ngacmimeve pranverore dhe bashkë me to, një drithërimë të ngrohtë e shqetësuese.

Arritëm të kroi. Ai buronte rrëzë një shkëmbi të hirtë, me një si bërruc të madh myshku përsipër. Shkëmbi ngjante si ndonjë vigan i përgjumur dhe fjolla e ndritshme e drithëruese e ujit dukej tepër e brishtë përballë tij. Ajo rridhte si e druajtur dhe duke çuçuritur, shkante e humbiste nën barin e livadhit.

Kristina mbështeti gjurin mbi një plloçë dhe zgjati gojën te burimi. Ndërsa gëlltitej me ëndje, uji i rridhte në faqe dhe i pikonte nga mjekra mu te rrëza e veshit. Kur u çua, ajo i hodhi fytyrës nja dy grushtë ujë, duke klithur nga të ftohtët dhe kënaqësia. Qeshi dhe erdhi drejt meje, pa u fshirë. Bulëzat e ujit i vezullonin në fytyrë, si vesa përmbi lëkurën e një pjeshke të arrirë. E vështrova me lakmi, pastaj mezi ia shqita sytë dhe shko-va të shuaja etjen te burimi.

Pastaj vendosëm të pushonim pak. Ajo mblodhi fustanin rreth gjunjëve dhe u lëshua mbi bar. Zura vend pranë saj. Ajo përkëdhelte barin me pëllëmbë.

— Sa i njomë, sa i dashur që është!, — tha. — Të vjen të shtrihesh e të bësh kollotumba nëpër të.

— Bëj!, — i thashë.

Ajo qeshi dhe më vështroi si ndonjë fëmijë çapkën.

Pranë nesh po vërtitej një flutur. Afrohej dhe largohet, gjithë dredha. U mata ta kapja, po Kristina më zuri dorën.

— Lëre të gëzojë pranverën, nuk shikon sa e lumtur që duket?, — tha.

Ajo buzëqeshte me dhembshuri. Vështrova sytë e saj tek ndiqnin fluturën. Prej tyre buronte diçka e ngrohtë, e dashur, joshëse. Më dukej sikur në ta shikoja pafundësinë e qiellit dhe dritën e pranverës.

— E ndien pranverën, Kristinë?, — pyeta, me zë të dridhëruar.

— Ëhë!

Ajo tundi kokën dhe flokët iu përpëlitën në krahët e dritës, njësoj si krahët e fluturës.

— Të pëlqen këtu?

— Shumë, aq shumë sa s'ta tregoj dot.

Ajo përpinte me të gjitha shqisat e saj pamjet, kundërmimet, zhurmat dhe ndjesitë e pranverës. Vështrimin e kishte tretur diku larg. Flegrat i hapeshin fort. Gjoksi i çohet dhe i ulej dendur. Shtrengonte barin në pëllëmbët e saj të vogla.

— Ç'mendon, Kristinë?, — e pyeta ngadalë, butë, si të druhesha se mos e zgjoja nga ndonjë ëndërr e bukur.

— E shikon atë majën atje tej?, — pyeti ajo duke zgjatur krahun drejt një mali të largët, që shtrihej madhështor në horizont.

— E shikoj!

— Do të dëshiroja të isha atje... Të kisha krahë dhe të fluturoja deri atje... Që atje shikon larg, larg dhe të duket vetja e madhe, e madhe...

— Do të të pëlqente të ishe vetëm?, — pyeta, duke e hetuar me bisht të syrit.

— Jo!, — u përgjigj menjëherë ajo, pastaj u turpërua dhe uli kokën.

Një mollëkuqe e vogël fluturoi pranë nesh dhe u lëshua mbi bar. Ajo më tërhoqi vështrimin drejt një luleje të imtë. Zgjata gishtat, mezi ia kapa bishtin e hollë dhe e këputa.

— Sa e bukur, pse e këpute?, — tha Kristina.

— Për ty!

Ajo e mori, i përkëdheli petalëzat me majat e gishtave dhe tha:

— Sa e vocërr, sa e bukur që është! E shkreta, tani do të vyshket.

— Ajo është e lumtur, se do të vyshket në flokët e tu!, — i thashë, duke ia marrë nga dora.

Iu afrova t'ia vendosja në flokë. Aromat e tjera të pranverës u fashitën dhe unë ndjeva vetëm arömën e flokëve të saj. Ata flokë sikur m'u ngatërruan në gishta. I shtrëngova lehtë, butë, pastaj e lëviza dorën ngadalë, gjersa fytyra e saj u detyrua të kthehej drejt meje. Sytë e saj më vështruan një çast me habi, pastaj u pulitën. Buzët iu çelën dhe mua më përvëlloi afshi i tyre. Dëshiroja të mos mbaronte kurrë ai çast...

...Ajo u shkëput nga krahët e mi dhe e pushë tek vraponte nëpër livadh.

— Kristinë!, — thirra.

Ajo s'e ktheu kokën. Vraponte. Qëndroi si e shtangur buzë pyllit, në skajet e livadhit, pastaj ra në gjunjë përmbi bar, më fytyrën në pëllëmbë. Shkova drejt saj. Tek qëndronte mes barit dhe luleve, m'u duk si trupëzim i vetë pranverës.

U përkula pranë saj. Ngadalë, sikur desha të mos e lëndoja, ia largova pëllëmbët nga fytyra. Ajo më hodhi një vështrim vetëtimë, pastaj deshi t'i fshihte përsëri sytë në pëllëmbë. Unë e pengova.

— Kristinë, nuk bëra ndonjë faj, unë të dua shumë!, — i thashë, duke u munduar të ndesh vështrimin e saj.

Ajo mbeti një hop e hutuar, pastaj një buzëqeshje ia çeli fytyrën. Ishte një buzëqeshje e druajtur, por, më atë shkëndijëzë që iu ndes në sy, tregonin një lumturi të madhe.

— Vërtet më do shumë?, — pyeti, kësaj radhe duke m'i ngulur sytë në mënyrë hetuese.

— Kaq sa!..., — thashë, dhe zura të hapja krahët duke buzëqeshur me përkëdheli. — Po ti, a më do ndopak?

— Ëhë! — Ajo uli kokën, ndërsa një të kuq i lehtë i hijeshoi fytyrën.

— Sa?

Kristina duke qeshur, tha me një ton fëmijëror:

— Unë të dua që këtu e gjer në qiell!

— Unë ngrita kokën andej nga tregonte gishti i saj. Ca re të bardha po i afroreshin diellit dhe sikur u përflakën prej tij. Një tufë shpendësh shtegtarë fluturonin në lartësi të madhe. Të lëbyrte sytë kaltërsia e shndritshme e qiellit.

E shtrëngova në krahë Kristinën. E ndjeva të ngroh-të, të butë dhe të zhdërvjellët pranë vetes. Zemra e saj rrihte pranë simes. Në flokët e saj dallova atë lulen e vocërr. Tani e përkëdhela unë atë lule. Përkëdhela lulen dhe flokët e saj.

Një fllad i freskët vërshoi në lëndinë. Pylli u drodh. M'u duk sikur prej tij doli vetë fshehtësia dhe na pushtoi në krahët e saj.

14.

Megjithëse duheshin edhe dy orë që të fillonte mbrëmja e organizuar me rastin e 1 Majit, nisa të vishesha me një farë padurimi. Vazhdoja të jetoja me ritmin e tendosur të ngjarjeve dhe të emocioneve të asaj dite. Përgatitjet e fundit për inaugurimin e spitalit të ri, (gjithmonë ngelet diçka për t'u kryer çastin e fundit) ceremonia e thjeshtë, por e bukur dhe mallëngjyese, e prerjes së shiritit, përshëndetjet dhe përqafimet e rastit, kujdesi që, mbas përfundimit të vizitës së inaugurimit, spitali të vihej menjëherë në gatishmëri, bisedat dhe urimet e panumërta, në rrugë, në klub e kudo, të gjitha këto më silleshin nëpër mend si në një film të shpejtuar e më mbanin në një tendosje dhe ngazëllim të vazhdueshëm.

Mbasi u vesha, vura re se kishte kaluar vetëm një çerek ore dhe një hop s'dita ç'të bëja. Pastaj më shkuan

sytë te ftesa me shkronja të praruara e martesës së Viktorit, që qe në një cep të tavolinës dhe vendosa t'i shkruaja menjëherë, mbasi në telegramin që i kisha nisur një ditë më parë, s'ia tregova dot arsyen e mungesës sime dhe atij kishte mundësi t'i mbetej hatri.

I dashur Viktor,

S'e merr dot me mend sa keq më erdhi që s'mora dot pjesë në dasmë, por pata një arsye të fortë: sot inauguruam spitalin e ri. E kupton vetë sa punë dhe mund na u desh që t'ia arrinim kësaj, por ia vلente. Dita e sotme ka qenë një ndër ditët më të bukura të jetës sime. S'ma kishte marrë mendja se do të emocionohesha dhe ngazëlleshsha kaq shumë, bile, edhe tani që po të shkruaj këto radhë, vloj përbrenda nga emocioni. Tani besoj se më fale që s'të erdha.

U gëzova shumë që «bankoprova» juaj përfundoi me dasmë. Tani, kur të të zërë nata në ndonjë shpat mali — të kujtohet ai rasti që më tregove atëherë? — do ta ndiesh veten më ngrohtë, sepse do të kesh dikë pranë me mend dhe me zemër, që do të presë me mall të kthehesh. Por, mos harro edhe shokët, që të duan gjithashtu fort.

Nuk e di ç'të të uroj më parë. Kjo letër është e ngushtë për gjithë ç'kam në zemër, prandaj, që të mos përsëris disa urime të stërthëna, po i lë të t'i shpreh kur të vij vetë. Pa tjetër që do të vij, shpejt, bile. Veç, porositë Pranverën të vërë mënjanë ndonjë shishe raki, fshehurazi teje.

Dhe tani, diçka për mua: më duket se e hoqe këmbën zvarrë dhe po fejohe. Pres të më vijnë prindërit, që ta kërkojnë zyrtarisht... Mos qesh, të marrtë dreqi! E pranoj, kishte të drejtë kur më the se s'ka vend në Republikë ku s'dashurohen njerëzit...

Atë e quajnë Kristinë dhe është mësuese gjuhe në shkollën e qytezës. Jemi njohur qysh ditët e para që erdha këtu. Në fillim u bëmë shokë të ngushtë, por një ditë e kuptuam se kishim rënë brenda që të dy. Tani na

është mbushur mendja top se jemi bërë për njëri-tjetrin. Mua ajo më duket më e mira nga të gjitha.

Kristina, sido që ju njeh vetëm nga tregimet e mia, ju çon urimet e saj më të mira. Shpresoj dhe uroj që ajo dhe Pranvera të bëhen shoqe të ngushta. Në na dalshin planet, shpresoj se andej nga korriku do të shkojmë për pushime në plazhin e Durrësit. Të dyve na pëlqen shumë deti. Ç'mrekulli do të ishte sikur ta kombinonim të dy palët! Si thoni?

Dhe tani, boll të shkrova. Ti e di që s'shkruaj dot gjatë. Pastaj, kryesoret t'i thashë, kurse ti s'ma ke fort ngenë se, helbete, dhëndër i ri... Kur të vij, do të bisedojmë e do të çmallemi ashtu siç duhet. Gjer atëherë, ju urojmë gjithë ç'ju do e bardha zemër dhe ju përqafojmë me dashuri së largu...

E palosa letrën më dysh dhe e futa në zarf, shkrova me kujdes adresën, pastaj e futa në xhep, që ta postoja menjëherë. Duke menduar me dashamirësi për lumturinë e Viktorit, dola në dritare, u mbështeta me bërryla në parvazin e saj dhe e treta vështrimin jashtë. Nuhata me ëndje kundërmimet e freskëta të asaj mbrëmjeje pranverore dhe shëtita sytë nëpër konturet e njohura të qytezës sonë.

Tek-tuk llamburisnin dritaret. Pas tyre gëlonte jeta, e atyre njerëzve aq të njohur, aq të mirë, me të cilët përshëndeteshja përditë, me të cilët po bëheshja përherë e më i afërt. Pas një dritareje të tillë ndodhej tani edhe Kristina. Ndoshta, edhe ajo mendonte për mua. Për një çast e ndjeva pranë, m'u duk sikur ndodhej aty, në dhomë dhe padashur ktheva sytë. Pashë orenditë aq të njohura e familjare, abazhurin e vockël që i pëlqente asaj, mendova sa mirë do të jetë kur ajo të ndodhet këtu përgjithmonë dhe diçka e ngrohtë dhe e ëmbël përshkoi qenien time.

Hyra në sallën e mbrëmjes gjysmë ore para kohës së caktuar. Megjithatë, mensa e punëtorëve, salla më e madhe e qytezës, gumëzhinte hareshëm nga njerëzit që po mbushnin me shpejtësi tavolinat: sharrëxhinj, ndër-

tues, arsimtarë, punonjës të shëndetësisë, familjarë dhe plot të tjerë. Kishte edhe fëmijë, që vinin bashkë me prindërit.

Thashë të zija vend me grupin e arsimtarëve, ku sigurisht do të vinte edhe Kristina, por kryetar Thanasi ma bëri me dorë së largu dhe u detyrova të shkoja e të ulesha pranë tij.

— E, a u çlodhe, ndopak?, — më pyeti. — Se, sonte do t'ia bëjmë fora, de!

— Do t'ia bëjmë që ç'ke me të!, — ia prita.

— E kemi hak, bre!, — buzëqeshi ai. — Një Maji, po, spitali i ri, po...

Mbas pak ai u çua dhe e hapi mbrëmjen, me ca fjalë të thjeshta, por të dala nga zemra dhe ngriti dollinë e parë për Partinë dhe shokun Enver. Njerëzit brofën në këmbë dhe një copë herë salla ushtoi nga brohoritjet dhe duartrokritjet. Pastaj filloi muzika.

Ca nga ca, atmosfera e mbrëmjes erdhi e u ndez e t'u bë prush. Ngado dëgjoheshin urime, tingëllima gotash, të qeshura. Disa hiqnin valle në mes të sallës. Vargani i kërcimtarëve rritej dhe zgjatej, sillej e vërtitej dhe, sikur e ndiente veten përherë e më ngushtë në mesin e sallës.

Muzikantët qenë ndezur flakë dhe loznin gjithnjë e më shpejt. Plaku me violinë lëkundej mbi këmbët e tij të gjata, si kallami kur fryn erë dhe përpigjej t'u bënte udhë tingujve të vegjël së vet të brishtë, duke lëvizur, si ndonjë zhongler, harkun përmbi tela. Burri rrumbullak me gërnëtë, e cila dukej si një zgjatim i natyrshëm i buzëve të tij, e vërtiste majën e saj në të gjitha anët, duke lëshuar ca tinguj të fortë e ngacmues. Daullja buçiste dhe gjëmonte disi e përmbajtur, si e vetëdijshme për forcën e vet.

Këmbët e njerëzve godisnin fort mbi dysheme, por sakaq, si të kishin shkelur mbi prush, hovnin përpjetë. Supet lëkundeshin, fytyrat skuqeshin dhe djersinin, flokët hovnin përmbi ballë, sytë shkëlqenin, duart shtrëngonin njëra-tjetrën dhe vargu lëvizte hareshëm nëpër sa-

llë. Kishte diçka të ashpër, por edhe të bukur e të fuqishme në atë valle të vjetër.

— Ej, doktor, ec e tregoje zotësinë këtu, se në ato vallet e tjera e dimë që na e kalon!, — thirri Thanasi, i cili atë çast kishte dalë në krye të valles.

— Ec, doktor, ec!, — thirrën disa të tjerë.

Nuk prita ftesa të tjera. Brofa, hyra në varg dhe, sa çel e mbyll sytë, më rrëmbeu hovi e gjallëria e valles. Kërceva si dija dhe si mundja, por me gjithë zemër. Pastaj, u kthyem përsëri në vendet tona, të etur për birrë e për duhan. Thanasi më hodhi dorën në sup dhe më nxiti të pinim bashkë një gotë.

— More, harrova të të them, ke të fala prej xha Bakos!, — u kujtua pastaj. — Përgatitu t'i bëhesh nun: nusja është shtatzënë.

— Atëherë, përgatitu edhe ti për konferencën!, — buzëqesha.

— Do ta bëjmë që ç'ke me të, bile, jo vetëm në Skapatinë, por edhe në fshatra të tjera, po prit të lindë njëherë!, — tha kryetar Thanasi, duke i nënvizuar fjalët me një gjest energjik. — Po na bën ca punë të mira fort, ti, doktor vëllai!, — vazhdoi pastaj. — Të them të drejtën, në fillim s'ma mbushe syrin. S'di se si m'u duke... si i hutuar. «Pse, ky çunak do të na i zgjidhë hallet e shëndetësisë?!», thashë me vete. Por, e paskam pasur gabim... Ç'është e vërteta, ju, njerëzit me shkollë, jeni ca të ngatërruar dhe s'njiheni kollaj, por tani e vë dorën në zjarr për ty, të kemi deli...

— Tani do të bëhesh edhe ti me shkollë!, — e ndërpreva buzagaz.

— Vërtet, ma mblodhën keq, ja në shkollë të Partisë, ja s'ka! — psherëtiu Thanasi. — Hem ma ka ënda, hem i trembem. Thua, do t'ia dal dot me faqe të bardhë?! Se, s'ka lezet të të nxihet faqja në këtë moshë!

— Me vullnet gjithçka arrihet!

— Po kjo mendja jonë ka zënë ndryshk, more vëlla! S'është kollaj të bëhesh nxënës në pleqëri. Lum ju, që

e bëtë shkollën me vakt. Tani jeni me mendje të mbledhur.

— Jo edhe aq!, — vëreja. — Se, provat e jetës janë më të vështira sesa provimet e shkollës.

— Ke hak, ashtu është. Ky njeriu, s'paska karar në këtë botë. Jeta është luftë. Dhe, në luftë duhet të jesh trim...

— Doktor, dëgjo ç'thotë usta Pandi, që na e lëvdon kaq shumë!, — thirri nga tavolina fqinjë njëri nga ustallarët e rinj. — Thotë se do ta fejojë vajzën sa të mbushë të gjashtëmbëdhjetat!

— Kur të të rritet jotja, mbaje, në daç ta bësh pastërma! — bubulloi i ngacmuar usta Pandi. — Unë, vetëm në mos më daltë ndonjë dhëndër i mirë, se e jap me të dyja duart. Vajza është si ajo fruta, që, kur piqet, duhet vjelur. Ndryshe, ja e hanë galat, ja rrëzohet dhe shkon dëm.

— Mos e fut veten në siklet, se tani vajzat rregullohen vetë!, — u hodh me të qeshur xha Andoni.

— Posi, le ta provojë, pa i përdredh kokën si të zogut!, — u hakërrua kryemjeshtri.

— Jo, ore Pandi, se s'bëhemi gazi i botës ne!, — e këshilloi Thanasi. — Duam apo s'duam, e reja do ta çajë rrugën e saj, bre. Në paçim dy para mend, jo vetëm që s'do t'i bëhemi pengesë, por do ta ndihmojmë. Përndryshe, ajo do të na shtyjë me bërryla, do të na flakë tutje dhe do ta bëjë punën e saj. Por, ti e ke akoma të vogël vajzën dhe pret ajo punë. Hëpërhë duhet të mendojmë për këta që kanë radhën. Ja, — ai më vështroi me nënkuptim, — më duket se doktorin do ta bëjmë dhëndër në qytezë dhe ka nevojë për apartament.

— Le t'ia bëjë bam doktori, pa natën, me pishë do t'ia mbarojmë apartamentin!, — u zotua usta Pandi.

— Bën gati pishën, atëherë!, — qeshi xha Andoni.

Disa kthyen sytë nga Kristina dhe i buzëqeshën me dashamirësi. Ajo uli kokën dhe u bë lulëkuqe në fytyrë.

Orkestra ia nisi një vals të lashtë. S'm'u durua gjatë, brofa dhe nxitova drejt Kristinës, se mos e ftonte ndo-

një tjetër. Ajo u ngrit disi e druajtur, por shpejt u çel dhe u lëshua me ëndje në vorbujt e valsit.

— U bënë disa ditë që s'jemi takuar!, — më qortoi.

— Ç'flet kështu?!, — u habita. — A s'u pamë dje, kur erdhët bashkë me nxënësit dhe ndihmuat për pastrimin e spitalit të ri?

— Por, vetëm u pamë!, — buzëqeshi ajo. — Ah, jo, edhe biseduam!, — korrigjoi veten pastaj. — Ti na qortove se s'i kishim kruar mirë xhamat prej bojës së vajit dhe na ktheve mbrapsht... Mjerë infermieret që punojnë me ty!

— Dhe mjerë gruaja që do të më marrë!, — shtova, buzagaz.

— Ishalla mbetesh beqar!

— Nuk e besoj, këto ditë vijnë prindërit për të kërkuar atë që dua.

Befas, ajo u bë përsëri e druajtur dhe e ngathët.

— Ç'pate, moj?

— Kushedi, si do t'u dukem?!, — pëshpëriti ajo e shqetësuar.

— Ashtu siç je, e mirë fort. Pastaj, gjersa të pëlqeva unë, edhe ata...

— Sidoqoftë, unë do t'i respektoj dhe do t'i dua.

— Kështu thonë të gjitha në fillim!, — bëra shaka.

— Atëherë, më mirë s'po flas, jeta do ta tregojë.

Orkestra e ktheu në tango. Ndërruam sakaq ritmin e hapave dhe vazhduam të vallëzonim shtruar. Në pëllëmbën e djathtë ndieja lëvizjet e shkathëta të belit të saj elastik, kurse në të majtën, prekjen e butë dhe përkëdhelëse të gishtërinjve të saj të gjatë.

— E nisa kërkesën për dy vende në hotel turizmin e plazhit të Durrësit!, — e njoftova.

— Vërtet?, — u gëzua ajo, duke më shtrënguar dorën me dashuri. — Sa mirë do të jetë...! Për se mendon, Fatos?, — më pyeti mbas pak.

— Për ne të dy, kur do të jemi përgjithmonë bashkë!, — iu përgjigja buzagaz e me dashuri.

— Më duket e pabesueshme, si një ëndërr!, — tha

ajo, me një dritë të pafundme lumturie në vështrim. —
— Të jemi gjithmonë bashkë, gjithmonë?!...

— Po, për gjithë jetën!

Muzikantët e mbyllën melodinë me një finale të fortë, pastaj lëshuan veglat që të çlodheshin. E përcolla Kristinën te shoqet e saj. Ndërsa po kthehesha në vendin tim, vura re Lilianën, që më ndiqte me një vështrim të thartë kureshtar. Pranë saj Ademi po tymoste një cigare, i shpërqëndruar dhe apatik.

«Vallë, si do t'u shkojë filli këtyre njerëzve?!, — mendova. — Do të dinë ta gjejnë rrugën, apo vala do t'i nxjerrë ndanë, si sendet pa vlerë?!...»

— Tani e ka radhën një valle popullore!, — po thoshte kryetar Thanasi kur arrita pranë tij. — Do kërcejmë, që të tundet dheu...

Piva me ëndje disa hurpa birrë, ndeza cigaren dhe sodita sallën që gumëzhinte gëzueshëm. Befas, u habita dhe u shqetësova: më zunë sytë Astritin, infermierin e ri, që kishte shërbimin e natës në spital.

— Hë, ndonjë urgjencë?, — pyeta, me ankth.

— Asgjë e jashtëzakonshme, doktor!, — u nxitua të më qetësonte infermieri. — Një lindje, bile, më duket një lindje normale, por mamia druhet se, helbete, është lindja e parë në spitalin e ri... Në s'ju vjen rëndë, ju lutet të vini ndonjë gjysmë ore, vetëm sa për t'u ndodhur aty. Lehona duhet të lindë nga çasti në çast.

— Posi!

U kërkova të falur shokëve dhe dola vjedhurazi, që të mos bija në sy dhe të mos ngjallej ndonjë shqetësim. Jashtë bënte freskët. Qyteza dukej e qetë, sikur gjithë gjallëria e saj të ishte shtrydhur në mbrëmjen e argëtimit. Më arritën tingujt e një melodie të gëzueshme popullore. Përfytyrova Thanasin tek udhëhiqte vallen dhe buzëqesha me vete. Ca nga ca melodia po largohej dhe dëgjoheshin fort hapat tanë, që kërcisnin në zhavorr.

Hymë në spital. Korridori ishte i qetë. Qetësi prej spitali. Ajri akoma nuk binte erë ilaçe, por kutërbonte

gëlqere dhe bojë vaji. Pllakat shkëlqenin ftohtë nën dritën verdhacuke të abazhurit. U dëgjua krisma e derës së maternitetit dhe Gjystina u dha te pragu. Më vështroi me një buzëqeshje të druajtur dhe pëshpëriti:

— Ju lutem, më falni që ju shqetësova, por...

— S'ka gjë!, — e ndërpreva. — Si është lehona?

— Mirë. I janë shpeshtuar dhe forcuar dhimbjet, por e mban veten, si malësore që është. Ja! Së shpejti duhet të lindë.

— Ka nevojë për gjëkafshë?

— Tani për tani jo. Vetëm...

— E qartë!, — buzëqesha. — Por, gjithçka do të shkojë në rregull, ke për të parë. Dhe, do t'u propozojmë prindërve që ta quajnë Majlinda, ose Majlind.

Gjystina buzëqeshi dhe u rikthye te lehona.

Eca nëpër korridor dhe dola te pragu i derës së jashtme. Mbusha kraharorin me kundërmimet e natës dhe shëtitë rreth e qark. Sodita siluetat e njohura të qytetës dhe të stabilimentit të gatrave, që dergjej i heshtur, nën dritën e verdhë të projektorëve. Në qiellin e errët, me një risk hënë, vezullonin yje të panumërta. Era pushtoi një hop. Gjethet e ndaluan dridhjen e tyre. Zërat e natës u fashitën dhe heshtën. Qetësi.

Qetësi vetëm për një çast. Se jeta nuk pajtohej me qetësinë. Dëgjova përsëri fëshfërimën e gjetheve, pipëtimat e panumërta të natës, zhurmën e largët të një makine, fragmentin e një melodie, pastaj, papritmas, të qarët e foshnjës në maternitet dhe hapat e mi që nxitonin andej...

Jetë!

VËSHTRIM I KTHJELLËT

*Botuar për herë të parë më 1968.
Ka fituar çmim të dytë në Kon-
kursin Kombëtar të Letërsisë dhe
Arteve me rastin e 25-Vjetorit të
Çlirimit.*

VERBODEN TOEGANG

Alleen met toestemming van de
Directie van de Dienst voor
de Volksgezondheid is het
gebruik van deze afbeelding
toegestaan.

1.

Kryeinxhinieri i uzinës, Petro Lisi, kishte shumë punë atë pasdite. Derën e zyrës e mbante të kyçur dhe telefonin e kishte hequr nga prizat. I përkulur mbi tryezën e vet të punës, të mbuluar me xham të trashë të gjelbër shfletonte dosje pas dosjesh, bënte anëshkrime në shkresa; mbante shënime në bllokun-kalendar duke mos ndarë cigaren nga buzët.

Kur mbaroi, e ndiente kokën të rëndë dhe sytë i digjnin por ishte i kënaqur dhe u dha rrugë gjithë atyre problemeve. U shtriq, fërkoj sytë me pëllëmbë, u end disa herë nëpër zyrë, pastaj iu afrua dritares. Çeli kanatet e saj dhe dihati me ëndje ajrin e freskët e të lagësht të asaj pasditeje vjeshtë. Befas pa veten të pasqyruar në xham. Kishte një fytyrë energjike, me sy të mëdhenj e të mprehtë, që shkëlqenin disi krenarë nën ca vetulla të trasha e bishtgjata. Hunda e drejtë i dukej pakëz e vogël në krahasim me fytyrën e gjatë dhe gojën disi të madhe, me buzë të holla, të futura si mes kllapash nga çifti i rrudhave anash tyre. Mbi ballin e gjerë i fillonin ca krela të zeza e të dendura, por të thinjura, sidomos në tëmth. Ai ishte tridhjetë e dy vjeç.

«Këtu u dukërkam më i ri, se nuk dallohen as rru-

dhat e as thinjat!», — mendoi Petroja duke vënë buzën në gaz dhe e kaloi vështrimin jashtë. Shiu sapo kishte pushuar. Qielli kishte filluar të çelej dhe perëndimi flakëronte me ngjyra të purpurta. Asfalti i sheshit të madh që shtrihej përpara uzinës kishte një shkëlqim të murgët.

Petros i pëlqeu ajo pamje, e cila kishte marrë trajtë dalngadalë para syve të tij e që materializonte edhe përpjekjet, shqetësimet dhe idetë e veta. Iu duk sikur iu derdh në brendësi një farë freskie dhe gjallërie. U largua nga dritarja, por u vrenjt me të vështruar tryezën plot dosje dhe shkresa.

«Duhet futur në kasafortë!», — mendoi dhe iu vu punës.

I renditi nëpër dosje kontratat, evidencat e realizimit të planit, raportet dhe shkresat e tjera, që i kishin shkaktuar aq mund gjithë pasditen. E mbajti një çast në dorë vendimin e dhënë në favor të uzinës së tyre nga arbitrazhi, pastaj e vuri bashkë me të tjerat.

Kur çeli kasafortën, i vajtën sytë te një dosje e vjetër jeshile që dergjej në raftin e fundit. E shfletoi me një farë nostalgjie; vështroi skicat, fletët e mbushura me llogaritje, pastaj e mbylli dhe e vendosi tek ishte, me keqardhje. Ishte projekti i papërfunduar i një shpikjeje, për të cilën kishte punuar me zell kohë më parë, kur nuk ishte kryeinxhinier.

Mbylli kasafortën, e dyllosi dhe u ndie i lehtësuar, duke vështruar syprinën e boshatisur të tryezës. Pastaj i shëtiti sytë pa qëllim nëpër zyrën e vet të pajisur më së miri, vështroi orën e dorës dhe vendosi që ta kalonte nëpër reparte atë gjysmë ore që i kishte mbetur.

Me të hyrë në repartin kryesor, i buçiti në veshë zhurma e tornove dhe e makinave të tjera metalprerëse. Dridhmat e ajrit, nëpërmjet timpaneve, i përshkuan gjithë trupin dhe sikur e shkundën nga plogështia e zyrës. Iu afrua një tornitori të ri. Ai e përshëndeti me kokë, pa i shqitur sytë nga tehu i thikës së çeliktë. Ajo

qëronte nga detali spirale të ndritshme metalike, që përdridheshin me shpejtësi, ngriheshin përpjetë, pastaj ngatërroheshin dhe këputeshin.

Petroja vështrroi duart e punëtorit, që manovronin me shkathtësi e shpejtësi, të sigurta. Ndjeu dëshirën të punonte edhe ai. Vallë, nuk do të turpërohej? Prej kohësh nuk e kishte zënë tornon me dorë.

Vite më parë, kur uzina që në fillimin e saj dhe i mungonin punëtorët e specializuar, ai shpesh u qëndronte mbi kokë punëtorëve të rinj, sidomos kur prodhoheshin pjesë të vështira. Ndodhte që dilte edhe në të dy turnet.

«Kanë ndryshuar kohërat!, — mendoj ai. — Tani kemi mjeshtra të zotë, inxhinierë në çdo repart dhe plot punëtorë të specializuar. Hej, si u rrit uzina jonë!...»

Kaloi më tej, duke u ruajtur se mos njolloste pardsynë bezhë. Shkëmbeu pak fjalë me inxhinierin e ri të repartit. Pothuaj nuk i dëgjoi treguesit mbi realizimin e planit, se e dinte që puna shkonte mbarë.

«Sidoqoftë, nesër do të m'i sjellin të dhënat në zyrë!», — mendoj.

I pëlqente ta ndiente veten të rrëmbyer në atë valë zhurme, ku nuk ndihej zilja e bezdisshme e telefonit dhe fëshfëritja e shkresave. Duke vështruar atë mori makinerish dhe punëtorësh të përkulur pranë tyre, duke dëgjuar zhurmat dhe tingëllimat e panumërta metalike, kujtoi sa e vogël dhe primitive kishte qenë kjo uzinë dikur, atëherë kur ai ishte inxhinieri i parë e i vetëm i saj.

Duke përsëndetur majtas e djathtas, kaloi në repartin e dytë. E kishte projektuar dhe ngritur vetë atë repart, në fillim me makineri të pakta, pastaj duke e plotësuar ca e nga ca. Ai që rritur dhe kishte marrë trajtë në sytë e tij, si një fëmijë. Ishte puna për të cilën krenohesh më tepër në vetvete.

— Mirë se na erdhe, shoku Petro!, — e përsëndeti inxhinier Andrea, përgjegjësi i repartit, duke i dalë përpara. — Kushedi sa herë të kam trokitur në zyrë sot!

Provova edhe me telefon, por më kot. Kurse ti erdhe vetë...

— Më qenë grumbulluar shumë probleme dhe m'u desh të kyçesha disa orë!, — u justifikua Petroja. — Kjo rutina e punëve të përditshme s'të lëshon asnjë çast, kurse kërkesat, informacionet, relacionet vazhdojnë rrjedhën e tyre dhe, po s'u çele rrugë, të mbysin.

— Të them të drejtën, dyshova se ishe brenda, por... — tha Andrea.

— Pate ndonjë problem të ngutshëm?

— Të ngutshëm fort jo, por edhe për t'u lënë pas dore nuk është!, — buzëqeshi me nënkuptim Andrea.

— Për se është fjala?

— Për riorganizimin e repartit tonë!

— Riorganizimin e këtij reparti?!, — u habit Petroja, duke e vështruar shokun së larti.

Inxhinier Andrea ishte pothuaj një pëllëmbë më i shkurtër se ai. Flokët ngjyrë kalliri i kishte, si gjithmonë të shpupurishura. Nën vetullat e holla i shkëlqenin dy sy të zgjuar ngjyrë qielli. Lëkurën e fytyrës e kishte të kuqërreme, pa rrudha të dukshme dhe qimet e rralla të mjekrës mezi i dalloheshin.

«Duket më i ri se unë, megjithëse jemi pothuaj moshatarë!», — i shkoi nëpër mend Petros.

Inxhinier Andrea kishte ardhur në uzinë pak vjet pas tij dhe, kur Petroja u emërua kryeinxhinier, i zuri vendin si përgjegjës i repartit të dytë.

— Ti ishe vetë në kolektiv kur u propozua riorganizimi i repartit!, — vërejti Andrea.

— Nuk më kujtohet!, — u ngrys Petroja, disi i pickuar nga ajo buzëqeshje. — Ehu, sa propozime bëhen!...

— Por ky është një propozim i drejtë kryeinxhinier!, — u mëshoi fjalëve Andrea si me qortim. — Organizimi i sotëm po na bëhet pengesë për realizimin e planit, ti e di fort mirë këtë!

«Ç'i shkrepni sot këtij!», — mendoi Petroja, duke ndier në thellësi një keqardhje të dhimbshme që dikush donte të vinte dorë në pjellën e vet.

— Ndaj desha të bisedonim për projektimin e riorganizimit, si projektuesi i parë i këtij reparti që je!, — vazhdoi Andrea, si t'ia kishte kuptuar mendimet.

— Akoma s'kemi marrë frymë nga ngritja e repartit special, dhe s'mund t'i futemi tani për tani një pune të tillë!, — tha Petroja, duke ulur sytë, si i zënë në faj. — Aq më tepër tani që është fundi i vitit dhe duhet menduar në radhë të parë për realizimin e planit.

— Edhe ne e kishim parasysh këtë!, — nguli këmbë Andrea. — Realizimi i planit nuk do të pengohet, i kemi bërë llogaritë dhe kolektivi është zotuar për këtë.

— Ta studiojmë njëherë. Andej nga tremujori i parë, ose i dytë...

— Nevojat e prodhimit nuk presin.

— Nevojat e prodhimit mund t'i plotësojmë edhe me këtë organizim që është, ashtu siç i kemi plotësuar gjer tani!, — ia ktheu Petroja disi i nevrikosur.

— Me kosto të lartë, me cilësi jo fort të mirë dhe me shumë përpjekje!, — vërejti Andrea. — Pas riorganizimit mund të japim rreth tridhjetë për qind më shumë nga ç'japim, duke përmirësuar treguesit teknikë dhe ekonomikë. Kjo është gjë e madhe, po të marrim parasysh sa janë rritur kërkesat ndaj prodhimeve të repartit tonë. Ja, kërkesat e fundit për pjesë ndërrimi nuk e plotësuam dot.

— S'është faji ynë!, — kërceu Petroja. — Edhe arbitrazhi na dha të drejtë. — E fituam padinë.

— E pastaj, ç'doli nga kjo?, — tha Andrea. — Që iu shtëmangëm përgjegjësisë, që shpëtuam uzinën dhe xhepin tonë nga gjoba?! Kryesorja, pjesët e ndërrimit nuk u prodhuan!

— Ata nuk na e siguruan me kohë lëndën e parë!

— Petro, të mos përpiqemi të fshihemi prapa gishtit! Ti e ke të qartë se, edhe po të na e kishin siguruar, nuk do t'ia dilnim dot. Kësaj radhe, ua latë në dorë dopio-gjashtë në saje të akrobacive të shefit të shpërndarjes, shokut Selim, po, tjetër herë...

— Prodhimi ka vështirësitë e vetat, — vërejti Petroja, disi i bezdisur, duke shpejtuar hapin drejt daljes së repartit.

— Si t'i them kolektivit për riorganizimin?, — s'iu nda Andrea.

— E di ç'ke ti, inxhinier, — ia ktheu me të mirë Petroja, — hiq dorë tani për tani nga ky propozim. Po na vjen mendja vërdallë për të tjera çështje, kurse ti...

— Jo unë, por kolektivi!, — ë korrigjoi tjetri.

— Në rregull atëherë!, — ia preu Petroja, duke i zgjatur dorën. — Bëni gati relacionin, që ta shtrojmë për diskutim në këshillin teknik. Këto s'janë gjëra të vogla, që t'i vendosim këtu, në këmbë.

Ata u përshëndetën ftohtë dhe Petroja nxitoi të dilte në sheshin kryesor të uzinës. Ai dukej i qetë. Zhurmat e reparteve vinin atje të fashitura, të largëta. Në rrugën përballë kalonin pareshtur makina. Nga lindja qielli kishte filluar të errësohej. Te dalja, portieri po thithte çibukun. Ai e përshëndeti me respekt.

Petros, propozimi i riorganizimit të repartit të dytë i vërtitej në tru si një mizë e bezdisshme. Shpresonte se në këshillin teknik do ta hidhte poshtë ose, të paktën do ta shtynte për më vonë.

Kur doli në rrugë, e rrëmbeu gjallëria karakteristike e qytetit në mbrëmje. Njerëzit që mbushnin trotuarët, që hynin e dilnin nëpër dyqane ose qëndronin para vitrinave të ndriçuara, siluetat e klientëve pas xhamave të lokaleve, makinat që kalonin rrugës, fëshfëritjet e gjeitheve të panjave ndanë trotuareve, të gjitha këto iu dukën të bukura, plot gjallëri dhe optimizëm.

— Shumë po nxiton, shoku kryeinxhinier!, — dëgjoi një zë të njohur nga mbrapa.

Petroja ktheu kokën, por sakaq ai që i thirri e arriti dhe nisi të ecte në të majtë të tij. Ishte shefi i shpërndarjes, një shulak disi i kërrusur, me një hundë që sikur ia ndante më dysh fytyrën e gjatë eshtake dhe me ca sy të vegjël, të shqetësuar dhe zhbirues.

— Të njoha që larg dhe nxitova të të propozoj për një ekspres!, — tha Selimi.

— S'thua keq, pikërisht për një kafe më kishte vajtur mendja edhe mua!, — iu përgjigj Petroja dhe buzëqeshi, duke menduar se Selimi gjithmonë i binte pikës.

— Sot, veç kafesë në shtëpi, s'kam pirë tjetër!, — tha tjetri. — Ajo turkja e klubit të uzinës nuk më zë vend aspak.

— Çudi!, — e ngacmoi Petroja. — Ti vazhdimisht rrugeve je! Njerëzit thonë se vetëm me çarqe mund të të zësh.

— Po s'i luajte këmbët, s'luajnë punët!, — ia priti Selimi, duke ngritur gishtin përpjetë, sikur thoshte ndonjë fjalë të çmuar. — Ec e dëgjo kritika pastaj, jo mungojnë çeliqet, jo s'ka vidium, jo u krijuan mbinormativat... Ja, ajo çështja e fundit me arbitrazhin...

— Ua hodhe më duket!, — vërejti Petroja, duke e vështruar me bisht të syrit.

— Ata qenë të parët që nuk e respektuan kontratën!, — ngriti supet shefi i shpërndarjes.

— Po ti mund t'ua kërkoje me kohë lëndën e parë që na detyroheshin!

— Që të bëja autogol?! ... Inxhinier Andrea më pat thënë se s'i prodhonin dot në afat.

— Ah, ah, ti, dhelpër e vjetër!, — e qortoi me shaka Petroja.

Selimi buzëqeshi i kënaqur dhe fërkoj me vrull duart.. Pastaj e drejtoi në një lokal vetëshërbimi dhe porositi me nojma, duke i buzëqeshur si një i njohur i vjetër banakieres.

— Maria do të na bëjë dy të freskëta dhe të forta, se e kemi tonën!, — tha.

«Edhe drejtin njëh ky Selimi!», — mendoi Petroja, ndërsa tjetri shkoi të merrte filxhanët me kafe.

Ekspresit ishte vërtet i mirë, me shkumë të errët dhe me shije të theksuar kafeje.

— Po t'i bënte të gjitha kështu, do të dilte deficit!, — vërejti Petroja, duke e gjerbur me ëndje.

— E di ç'thotë Maria?, — buzëqeshi Selimi. — Unë e di kush është merakli e e meriton kafënë e mirë. Atyre u hedh kullësën e parë, kurse të tjerëve, që e marrin kafënë sa për t'u gjendur në punë, varda, nga ibriku!... Ja, kështu thotë. Ligji i kompensimit, more vëlla!

Petroja qeshi, rrufiti gllënjken e fundit dhe përplasi buzët nga kënaqësia.

— Ohoho, sikur më solli në vete!... Isha kaq i lodhur!

— S'ke faj, po bëhen tre muaj që drejtori ka zënë shtratin dhe gjithë puna ka rënë mbi shpatullat e tua!, — ia qau hallin Selimi. — Thonë se nuk i ka punët mirë, i ngrati. Të dielën do të shkoj ta vizitoj.

— Pije, të shkretën, se t'u ftoh fare!, — tha Petroja, duke pritur me padurim që tjetri të mbaronte kafënë.

— Ta paska mbledhur gruaja më duket!, — vërejti me shaka Selimi.

— Sot kthehet motra nga aksioni dhe më ka marrë malli për të!, — u justifikua Petroja.

— Flora, hë?... Më kujtohet kur vinte e të priste me durim te qoshku i portierit. Ishte çupërlinë atëherë. Tani do të jetë rritur.

— Vazhdon kursin e dytë në inxhinierinë e ndërtimit!

— Eh, si kalojnë vitet, more vëlla!, — psherëtiu Selimi.

— Dhe ne plakemi!, — vërejti Petroja.

— Ti je akoma i ri, por unë vërtet u plaka, i arrita të pesëdhjetat!, — tundi kokën Selimi. — Sigurisht, në shtëpi e mban motrën?

— Ta merr mendja! Kur erdhi në fakultet, ajo dëshoi të banonte në konvikt. Jeni të sapomartuar dhe s'dua t'ju bezdis thoshte, por unë s'e lashë. I lëshova dhomën e pritjes. Mund të bëjmë edhe pa të disa vjet. Boll jetoi nëpër konvikte shkollash e kantieresh. Dëshiroj të mos i mungojë ngrohtësia familjare, gjersa të krijojë të sajën.

— Shumë mirë ke vepruar!, — miratoi Selimi. —

— Atë motër ke! Pastaj, femër është, më mirë ta kesh nën kujdes. Ishalla i gjen ndonjë burrë të mirë dhe pastaj rehatohesh tamam.

— Ndoshta e gjen vetë!, — buzëqeshi Petroja.

— Bën vaki, por ty të takon t'i hapësh sytë mirë. Unë e kam më të vogël time bijë, sivjet bën të dhjetën, por ka filluar të më hajë meraku për të...

Ata të dy dolën dhe u bashkuan me rrjedhën e njerëzve në trotuar. Petroja ecte me nxitim dhe mendonte për Florën. Vërtet e kishte marrë malli për të.

2

Autobusi me studentët aksionistë la mbrapa Ndroqin dhe po shpejtonte drejt Tiranës. Studentët ia kishin marrë aq fort këngës, sa zhurma e motorit pothuaj nuk dëgjohej dhe dukej sikur autobusi rrëshqiste lehtë mbi brezin e murmë të asfaltit.

Një student kuqal që ulur mbi motor, me fytyrë nga të tjerët dhe mendohej ta shoqëronte këngën me fizarmonikë. Herë-herë ia dilte mirë, por aty-këtu stononte, nevríkosej dhe nga shprehja e fytyrës linte të kuptohej se ia hidhte fajin tronditjes së makinës. Sapo arrinte ta korrigjonte stonaturën, goja e madhe i shkonte vesh më vesh nga kënaqësia dhe niste të mbante ritmin duke tundur kokën, ndërsa flokët e kuqërremë i hovnin mbi ballë.

Flora këndonte dhe vështronte pamjet që parakalnin përtej dritareve: toka të sapopluguara, me plisa të errët; një përrua gjarpërues, mes zallishtes së hirtë; kodra ku zbardhnin disa shtëpi dhe dukeshin ullinj të rrallë; një zëtor që mbarte pleh; disa kooperativistë, që nxitonin buzë rrugës me veglat e punës në sup; një tufë dhensh që kërcenin hendekun anësor dhe përmbi të gjitha këto, qielli i plumbtë i muzgut, disi i përflakur andej nga perëndimi.

«Ishalla mban kohë e mirë!, — mendoi Flora. — Son-te do të çmallem me vëllanë, kurse nesër do ta bëja me gjithë qejf një shëtitje nëpër Tiranë. Është kaq e bukur vjeshta në kryeqytet!...»

Në çiftin e karrigeve të anës tjetër që ulur Arbeni, një shok kursi. Vinte ezmer, me tipare të rregullta e të zakonshme, por kishte diçka të ngrohtë e tërheqëse në pamjen e tij. Veçanërisht sytë e larmë me bisht dukeshin si të përflakur nga një zjarr i brendshëm. Herë-herë ai vështronte vjedhurazi e me ngulm Florën.

Vija e profilit të saj, e ndriçuar lehtë prej dritës së muzgut, fillonte me një ballë të vogël, nën baluket ngjyrë kalliri, vazhdonte me hundën e drejtë e të shkurtër, me buzët e plota e të njoma dhe përtej mjekrës së imtë formonte një hark elegant, që mbyllej rrëzë veshit, të cilit i dukej vetëm llapa e vockël, midis flokëve të prerë shkurt.

Befas, ajo ktheu kokën dhe, kur sytë e saj të mëdhenj e të hirtë u ndeshën me të tijtë, u pulitën me druajtje.

— Po i afrohem i Tiranës!, — tha ai, si i zënë në faj.

— Një e vërtetë e njohur!, — bëri shaka Flora.

«Çark i ngrehur, si përherë!», — mendoi Arbeni për të dhe sakaq iu ngjall në kujtesë çasti kur e pa për të parën herë.

... Atëherë ai ishte teknik ndërtimi në hidrocentralin e Ulëzës. Një ditë të lagësht tetori iu desh të shkonte në kantierin fqinj, për të kërkuar disa materiale. Brodhi gjithë ditën nëpër shi, dhe më në fund arriti t'i ngarkonte ato që i duheshin. Para se të niseshin, i lagur gjer në palcë, u fut në klub të hante diçka. Nuk gjeti veçse «ingranazhe», siç i quanin gurabijet pesëdhjetë-qindarkëshe. Ndërsa po paguante, vuri re një vajzë me çizme dhe pambukore, që erdhi drejt banakut me hap të sigurtë, porositi një kakao, dhe si bleu një pako biskota, shkoi e u ul në një tryezë të lirë. Dukej fare e ré dhe këtë përshtypje ta përforconin bishtalecat e lagur, që i dilnin jashtë beretës blu. Ajo hante qetë-qetë, pa ia bërë syri tërr në atë rrëmet punëtorësh dhe shoferësh. Disa prej tyre, që deri atëherë kishin bërë shaka të kri-pura në tryezën fqinje, u përmbajtën sakaq, madje e përshëndetën dhe e vështruan me një farë respekti vajzën.

Arbeni pyeti me sy banakierin.

— Është teknike ndërtimi në kantierin e tretë!, — e sqaroi ai me zë të ulët. — Duket çupërlinë, por është e shkathët, s'ia ha qeni shkopin. Ua ka mbledhur paq brigadierëve.

Arbeni u largua me një mbresë të çuditshme. Imazhi i vajzës me bishtaleca të lagur nën beretën blu dhe me ata sy të hirtë, plot siguri, e shoqëroi gjatë.

Më pas e kishte parë dhe herë të tjera duke derdhur beton, duke çmontuar disa armatura të bëra keq... Dhe kishte dëgjuar të flitej shpesh për të. Tregonin se, kur qenë kacafytur dy punëtorë të sektorit të vet, ajo qe hedhur pa ngurruar mes tyre dhe ata, që s'i patën ndarë dot shokët, u zbrapsën për hir të saj.

Arbeni kishte dashur të njihej me të, por s'iu dha rasti në atë rrëmet punëtorësh, gjersa një ditë u ndodh në autobus krah saj. I pat dalë e drejta e studimit në degën e ndërtimit të Fakultetit të Inxhinierisë dhe po nisej për Tiranë. Mezi e njohu. Ajo ishte veshur me fustan, mbante një triko të leshtë ngjyrë lejla dhe flokët i kishte lidhur tufë prapa kokës. Tani dukej një vajzë simpatike, por atij iu duk më pak interesante sesa me pambukore, çizme dhe beretë blu.

— Domethënë, do të jemi shokë fakulteti?!, — tha ajo, pasi u prezantuan.

— Do të kemi rast të kujtojmë së bashku jetën e kantierit!, — buzëqeshi ai. — Kam dëgjuar se në qytetin e studentëve kalohet shumë bukur.

— Do të më pëlqente të jetoja atje, por s'besoj të më lërë vëllai!, — tha ajo e menduar.

— Paskeni ndonjë vëlla në Tiranë?

— Atë kam gjithë e gjithë. Prindërit na kanë lënë jetimë qysh të mitur. E duam shumë njëri-tjetrin, po përsëri mua do të më pëlqente të banoja në konvikt. Vëllai është i martuar, ata kanë mënyrën e tyre të jetesës dhe nuk dua t'i bezdis, sadopak. Por, s'e besoj të pranojë.

— As unë nuk do të pranoja, të isha në vend të tij!,

- vërejtë Arbeni. - Një motër të vetme, rritur jetimë, pas dy vjet jete në kantier...

Një copë herë heshtën, secili me mendimet e veta.

- Do ta kemi të vështirë fillimin!, - tha pastaj ai.

- U bënë kaq kohë që jemi larguar nga mësimet.

- Ne kemi përvojën e jetës, që vlen më shumë!, - theksoi ajo. - Kjo s'fitohet dot në bibliotekë, kurse mësimet... S'e besoj të jetë më vështirë se në kantier!

Ata biseduan si dy të njohur të vjetër dhe qysh atë ditë gjetën shumë gjëra të përbashkëta te njëri-tjetri...

Arbeni s'ia ndante sytë Florës, ndërsa përtej profilit të saj kalonin me shpejtësi trunget e plepave buzë rrugës. Shoqja e ulur në krah të Florës, një studente e kolme, fytyrërrumbullake, me një hundë të vockël të kthyer përprjetë dhe me ca sy të mëdhenj e të bukur, por të ftohtë, ua pikasi vështrimet, buzëqeshi dhe i pëshpëriti shoqes në vesh:

- Më duket se gabova që zura vendin pranë teje, Flora!

- Për mua s'ke gabuar, moj Hajrije!, - ia priti ajo, që e ndjeu sakaq thumbin.

- Eh, ç'po e luan pjesën!, - vazhdoi me shpoti Hajrija. - Nuk e shikon qysh iu përdrodh qafa Arbenit të ngratë?!

- Arbeni më ka parë dy vjet rresht në kantier dhe një në fakultet, s'mbeti keq të më vështrojë këtë!, - ia fazanel!, - mendoi.

Jashtë rigonte një shi i imtë. Xhamat e autobusit u mbushën me cirka uji. Buzë rrugës nxitonin dy fshatarka të shëndetshme, me xhaketa të hedhura mbi kokë. Ato vështruan me kureshtje aksionistët dhe njëra i përshëndeti me dorë.

«Një mot i tillë ishte edhe kur betonuam urën, atë ditë që Arbeni arriti në aksion!». - mendoi Flora me nostalgji.

...Pushimet e asaj vere patën qenë më të shqetësuarat e jetës së saj. Ndërsa shoqet ankoheshin se po kalonin shpejt, asaj i dukeshin ditët tërkuzë të gjata dhe i hiqte me kënaqësi të veçantë fletët e kalendarit. Nga fundi i pesëmbëdhjetëditëshit të dytë të gushtit e humbi durimin. E qortonte me vete Arbenin pse nuk i kishte shkruar se kur do të vinte dhe shëtiste çdo pasdite andej nga angjencia e pasagjerëve. Më në fund, një bashkëqytetar i tij i solli lajmin se ai do të bashkohej me shkël dhe shoqet e kursit në aksion, pasi kishte një dasmë në rrethin familjar. Ajo u hidhërua fort, po s'e bëri veten. Ditën që u nisën për në aksion, ishte më e gëzuar se të gjitha.

— S'ke faj, ti ke një arsye më shumë!, — e pat ngacmuar Hajrija.

Florën e zgjodhën komandante të brigadës. Ditën e tretë të aksionit ata, si të ndërtimit që ishin, i caktuan në betonimin e një ure.

Ishte një ditë e lagësht shtatori. Në qiell nxitonin rë të murme. Ngjyrat e natyrës ishin të zbehta, drita e paktë. Në luginë po rrokullisej një mjegull e bardhë, që merrte trajta të çuditshme.

Përvoja e kantierit e ndihmoi Florën në organizimin e punës dhe rreth orës tetë karrocet me beton derdheshin njëra pas tjetrës në armaturat e urës. Ajo vetë fluturonte nëpër shtegun prej dërrase me një karrocë metalike, së cilës ia kishte vajosur mirë bucelën e rrotës. E ndiente veten të lehtë dhe të gëzuar. Heraherë kthente sytë nga rruga, gjoja sikur shqetësohej për furnizimin me zhavorr, por në të vërtetë priste Arbenin. Sot duhej të vinte pa tjetër, bile shumë ishte vonuar, ai s'e kishte zakon ta shkelte.

Kaloi edhe pushimi i drekës, por ai s'u duk. Flora mbeti disi e zhgënjyer, por e mblodhi mendjen për atë ditë dhe vështroi punën. Aq më tepër se filloi shiu dhe dolën disa pengesa.

Dërrasat e shtegut të karrocave u lagën dhe u bënë të rrëshqitshme prej baltës. Disa aksionistë u rrëzuan,

por pa ndonjë dëm. Nja dy djem u zbathën. Thanë se ashtu rrëshqisnin më pak. Flora, e para nga vajzat, ndoqi shembullin e tyre. Pastaj edhe shumë të tjerë. Megjithatë, ritmi i punës ra. Disa nga shoqet mezi e mbanin drejtpeshimin, duke penguar edhe të tjerët që vinin varg pas tyre.

Shtabi i brigadës, që u mblodh aty për aty, në shi, vendosi t'i hiqte nga transporti dhe t'i kalonte te vendi i ngarkimit ose nyja e betonit. Karrocet që mbetën e shtuan shpejtësinë. Shiu po dendësohej, të gjithë u lagën gjer në mish, por asnjeri s'u tërhoq në strehishtë. E kishin të qartë më mirë se kushdo që betonimi s'mund të ndërpritej.

Dëgjoheshin thirrje nxitëse, pllaqurisjet e këmbëve të zbathura në dërrasa, kërkëllimat e rrotave të karrocave, zhurma e mbytur e betonit që derdhej në armaturë dhe cikëritja monotone e shiut.

Arbeni arriti në orën dy të pasdites, me riportabilin që sillte zhavorr. Sapo zbriti nga kabina, thirri një «mirë se ju gjeta» të përgjithshme dhe pyeti se kush i ndante detyrat.

— Komandantja, shoqja Flora!, — e sqaroi me djallëzi Hajrija, e cila kishte kaluar te nyja e betonit.

Ai iu paraqit komandantes, që po priste radhën të mbushte karrocën me beton. Qëndroi gatitu përpara saj, me një seriozitet të shtirur.

— Më lejoni të marr pjesë, shoqja komandante?

Ajo u mundua të dukej e rreptë, por sytë i shkëlqenin plot lumturi.

— Me vonesë!, — e qortoi. — Tani rrëmbe një karrocë dhe lagu sa më shpejt, se dukesh qesharak kështu, i thatë, siç je!

Asaj i rrëshqisnin bulëza uji nëpër fytyrë, i pikonin flokët, i kullonin rrobat.

— Si urdhëron!, — buçiti Arbeni dhe rrëmbeu një karrocë që kishte pranë. — Ju lutem, më lejoni jashtë radhe, të plotësoj makar një thërrime të deficitit, se kush e dëgjon komandanten pastaj!, — iu drejtua atyre

që prisnin radhën dhe doli në krye, pa pritur miratimin.

Në ndajnatë betonimi i urës kishte marrë fund. Brigada u rreshtua dhe u nis për në sektor, me këngë në gojë. Shiu vazhdonte, por ata ecnin të shkujdesur. S'kishin si lageshin më shumë.

Pasdarke që organizuar një mbrëmje argëtimi. Sa çel e mbyll sytë, tryezat e mensës u mënjanuan, u lexua komunikata e ditës, pastaj filloi vallëzimi. Radhën e parë Flora nuk arriti të kërcente me Arbenin se e ftoi më parë një shok tjetër. Prandaj, ajo melodi iu duk tërkuzë. Me të filluar tingujt e së dytës, Arbeni, që i kishte ardhur pranë, e kapi shpejt për dore dhe e tërhoqi drejt mesit të sallës. Ajo u mbështet me ëndje në supin e tij dhe nisi të vallëzonte e lehtë, si pendë. Sa herë ndiente në bel shtytjen e dorës së tij, e përshkonin mornica. I vështronte gjoksin muskuloz dhe kishte mall të mbështetej në të.

— Qenke akoma i lagur!, — i tha, duke e vështruar në sy.

— Zbatova urdhrin tënd!, — buzëqeshi ai. — Edhe ty s'të janë tharë flokët. Sikur mbajnë erë shi!

— Neve na thahen me vështirësi, se i mbajmë të gjatë!

— Mezi prisja të takoheshim, më kishte marrë malli!, — tha ai.

— Posi, prandaj u vonove kaq shumë!, — e qortoi ajo.

— Ç't'i bësh, ka detyrime njeriu!

Melodia e dytë përfundoi.

— Sa shkurt i ra këtë herë!, — vërejti Flora, duke vështruar me qortim nga orkestra.

— Tani s'të lëshoj kollaj!, — buzëqeshi ai, duke ia ngulur sytë me mall.

Nëpërmjet vështrimit, një fluks i padukshëm, shqetësues, kaloi nga njëri te tjetri. Filloi melodia e tretë dhe ata rregulluan hapin me ritmin e saj.

— Çudi, njihemi vetëm prej një viti, kurse mua më

duket se të kam njohur gjithmonë!, — vazhdoi ai me zë të ngrohtë.

— Ti më njeh prej tre vjetësh, qysh atë ditë që më pe në klub!, — e korrigjoi ajo buzagaz. — Kushedi si ke menduar për mua atëherë?!

— Mirë kam menduar, ta kam thënë!

— Brigadier Hamiti thoshte se isha nisur për djalë!, — qeshi ajo.

— Ia mblihdje paq, si duket!

— Jo, s'qe nevoja. Ai dhe tërë brigada e tij punonte mirë, por s'donte ta pranonte se femrat mund të jenë edhe ndryshe nga ç'i mendonte.

— Ty njerëzit të donin dhe të respektonin, i kam dëgjuar me këta veshë kushedi sa herë!

— Ky është shpërblimi më i madh për punën dhe djersën e ndokujt!, — tha ajo. — E di, Arben, më ka marrë malli për shokët e kantierit.

— Edhe mua.

— Ky, ambient i hekurudhës, nyjet e betonit, skelet, vinçat, riportablant dhe këto baraka të ngjashme sikur ma ndezën më fort mallin.

Muzika u ndërpre. Të tria meloditë e asaj dore kishin përfunduar. Ata shkuan drejt stolave, ndërsa një studente e kolme nisi të recitonte diçka.

— Më vjen keq, por s'të mbaj më dot të bllokuar!, — i pëshpëriti Arbeni buzagaz. — Nuk bën, ti je komandantja e të gjithëve.

Ajo e kërcënoi me gisht.

— Sidoqoftë, përcjelljen ma rezervoj mua!, — vazhdoi ai.

Mbrëmja vazhdoi gëzueshëm deri në orën dhjetë të natës, bile u dëgjuan kundërshtime kur u lajmërua mbyllja. Te dera e mensës u bënë grumbull për të dalë. Flo-ra priti Arbenin.

Jashtë bënte disi freskët. Shi nuk binte dhe në qiell ishin shfaqur yjet. Ato dukeshin më të afërta dhe më xixëlluese se zakonisht. Si gjithmonë pas shiut, ajri qe i

mbushur me kundërmime. Shquante aroma e dheut të lagur, e gjelbërimit dhe e dërrasave të barakave.

Ata mbetën me dashje prapa të tjerëve, duke iu mënjeluar disi shtegut. Ecnin të heshtur nëpër një livadh. Ndienin se si shtrydhej bari nën këmbët e tyre.

— Flora, gjatë pushimeve kam menduar shumë për ty!, — tha Arbeni, duke i shtrënguar lehtë dorën. — Flora, unë dua të të them sonte se...

Atij iu shterrën fjalët. E kapi atë për duarsh dhe e ktheu përballë vetes, sikur deshi t'i kërkonte ndihmë. Ajo e vështroi në sy me një shprehje që tregonte se kishte kuptuar gjithçka. Pëllëmbët e tij i përkëdhelën me butësi flokët, pastaj i përfshinë fytyrën dhe ia çuan kokën ngadalë. Ajo i pa nga afër sytë plot dritë dhe dashuri...

— Më së fundi po arrijmë!, — tha Hajrija dhe nisi të rregullonte flokët.

Flora u përmend dhe vuri ré dritat e Kombinatit «Stalin». Ashtu siç ndodh në çdo arritje, në autobus pushuan bisedat dhe secili merrej me diçka. Dikush fuste librin në çantë, dikush tjetër kontrollonte në ishte mbyllur mirë valixhja, një i tretë vështronte me kureshtje jashtë. U duk një autobus urban, i mbushur plot e përplot me pasagjerë.

— Kaloi si pa kuptuar ky udhëtim!, — vërejti Flora.

— Kurse mua më turbulloi!, — tha Hajrija. — Uf, sa të vete në shtëpi të bëj një banjë të mirë!

— Pasesër fillojmë leksionet!, — tha Flora.

— Kurse të dielën unë kam një provim!, — buzëqeshi Hajrija.

— Provim?!

— Do të pihen kafetë e mëdha të fejesës... Me atë doktorin që të pata treguar...!

— Ashtu?, — u ngut të thoshte Flora.

— Ç'pate?, — e pyeti hetuese Hajrija.

— S'di se si më ra ky lajm. Ti para disa kohe mendoje për një tjetër!, — ia priti troç Flora.

— Eh, mendime fluturake!, — ia bëri me dorë Hajrija. — Fundja, kur ke mundësi, pse të mos zgjedhësh?!

— Secili ka mendimin e vet, por a mund të zgjidhet shoku i jetës si një fustan, që sot të pëlqen kështu dhe nesër ashtu?!, — vërejti Flora. — Sidoqoftë, të dal të për mbarë! — Ajo u shtir se po kontrollonte plaçkat, për t'i dhënë fund asaj bisede.

Hajrija ktheu kokën në anën tjetër, me një gjest kryeneç dhe disi përcmues.

Në krye të rrugës u duk kulla e sahatit. Nën dritën e bardhë të llambave të neonit dhe përbri vitrinave të shumta gëlonin njerëzit. Parakaloi një Gaz, pastaj një veturë e kuqe. Mbrapa vinte urbani i Kombinatit, dritat e të cilit futeshin në kabinë nga xhami i pasmë. Aksionistët, me fytyra të afruara te dritaret e autobusit, vështronin jashtë me kureshtje dhe mall.

Autobusi përshkoi sheshin «Skënderbej», çau rrjedhën e dendur të shëtitorëve dhe arriti te agjencia. Porta pneumatike u çel me tërsëllëmë dhe disa djem kërcyen jashtë.

— Uf, ju vajzat ç'merrni gjithë këto rraqe nëpër akcione?, — i shfryu njëri Hajrijes, e cila kishte zënë rrugën, duke zvarrisur valixhen e saj të rëndë.

Flora rrëmbeu plaçkat e veta dhe iu afrua Arbenit që po e priste jashtë. Pastaj, si u ndanë nga shoqët e shoqet, ata nxituan nëpër asfaltin ende të lagur, ku reflektoheshin dritat dhe siluetat e godinave të larta, që dukeshin sikur vështronin njëra-tjetrën me sy të panumërt, të zjarrtë. Diku krisën kanatet e një dritareje dhe për një çast u dëgjua fragmenti i një melodie. Era mori hov dhe degët e gështenjave të egra të trotuarit nisën të përkundeshin. U shkundën disa gjethe të zverdhura, duke shtuar numrin e atyre që dergjeshin si njolla ndryshku mbi asfalt. Njëra prej tyre ra mbi supin e Florës, iu zvarris mbi gjoks dhe treti pas çapeve të saj.

— Pse thonë që vjeshta është e trishtuar?, — tha Flora. — Mua më duket kaq e ëmbël, kaq e dashur, si një teto zemërbardhë!

Ai qeshi me krahasimin e saj.

U erdhi keq të dyve kur arritën pranë apartamentit ku banonte vëllai i Florës dhe ngadalësuan hapat.

— Sa larg e ke konviktin prej këtej!, — tha ajo me keqardhje, ndërsa po ngjitnin shkallët.

— Do të mendoj për ty dhe do të më duket afër!, — i pëshpëriti ai buzagaz dhe i zgjati dorën i nxituar.

— Mos ki frikë, vëllai im s'ha njerëz!, — bëri shaka ajo.

— S'është rasti, më mirë një herë tjetër. Natën e mirë!, — tha ai dhe iku.

Flora i mëshoi sumbullës së bardhë të ziles, ndërsa dëgjonte si largoheshin hapat e tij të njohur. Ndërkaq u çel porta e apartamentit karshi dhe u shfaq te pragu koka e një gruaje që përpiquej të tregohej e mbajtur, me një stampë buzëqeshjeje në fytyrë dhe me ca sy të vegjël, hetues.

— Aha, qenke ti, Flora? Mirë se erdhe!

— Mirë se ju gjeta, shoqja Ksanthipi!, — iu përgjigj Flora, thatë.

— Çudi, të paska prirë aksioni!, — vërejti fqinja.

— Ooo, motërza!, — buçiti sakaq zëri i Petros.

Ajo hyri me nxitim në korridor, mbylli me një farë nervozizmi portën, pastaj u përqaftua me të vëllanë.

— Kam një copë herë që po të pres!, — tha ai, duke ia çuar plaçkat në dhomën e saj.

Hynë në dhomën e bukës dhe ajo ndjeu afshin e ngrohtë të sobës së madhe, të bardhë dhe aromën e tuftës me lule që zhukuronte tryezën.

Petroja u ul në divan.

— Po Ani ku është?, — pyeti Flora.

— Në ambulancë. Tani duhet të vijë!, — iu përgjigj ai, duke shikuar orën e dorës.

Doktoresha Ani hoqi fonendoskopin nga veshët, e mbledhi dhe e futi në çantën e vogël prej lëkure.

— Fëmija s'ka gjë!, — i tha së ëmës. — Visheni!

— Po, pse grindet kaq shumë, doktoreshë?

— Ndoshta po i del ndonjë dhëmb. Është tamam moshë. Kontrollojeni herë pas here.

— Po recetë, nuk do të më jepni?

— S'ka nevojë. Mos harroni t'i bëni sa më shpesh pure molle dhe supë me barishte.

Ani vështroi orën, e bezdisur. Ora sapo kishte kaluar nga gjashtë e gjysma.

— Obobo, u vonova. Kam për të bërë provën e kostumit!, — i tha infermieres dhe shkopsiti bluzën e bardhë.

Nëna e veshi fëmijën disi e pakënaqur. E mori në krahë dhe vonoi të dilte.

— Të jeni e sigurtë që s'ka gjë!, — i tha Ani, me një buzëqeshje profesionale. — Shkoni pa merak.

Sapo u çel dera, u dëgjuan disa zëra në korridor.

— Doktoreshë, kanë mbetur edhe dy pacientë, luten që t'i pranoni!, — tha infermierja, duke mbajtur me dorë dorezën e derës.

— Nuk mundem, të tregova si e kam hallin, — u bezdis Ani. — Të lutem, në paçin urgjencë, drejtoi te mjeku i rojës. S'mund të rri këtu gjer në mesnatë!

Ajo shkoi te lavamani dhe nisi të lante duart. Ndërkaq vështrohej me vëmendje në pasqyrë. Nën sytë e mëdhenj e të hirtë, me qerpikë të gjatë e të ngjyer me të zezë, i dalloheshin dy harqe mavi, kurse në cepat e tyre, disa rrudha të imta, si këmbë pate. Fytyrën e kishte ende të mbajtur e si të kadifenjtë, por që nga rrëza e hundës e gjer te cepat e buzëve i zbrisnin dy rrudha të qarta, që kremi dhe pudra s'i fshihnin dot.

«Jam tepër e lodhur!, — mendoi. — Pastaj, mirë edhe kaq, se po u afrohem të tridhjetave; iku rinia, si va-

pa me gushtin! Ja, ime kunatë, që s'tregon asnjë kujdes për fytyrën, e ka lëkurën si cipa e pjeshkës... Ajo sonte duhet të kthehet nga aksioni...»

Ani i bëri pak masazh fytyrës, përtëriu kremin dhe pudrën, forcoi të kuqtë e buzëve dhe rregulloi flokët, ndërsa dëgjonte tek bënin fjalë pacientët me infermieren mbrapa derës.

— ... Ajo duhet të jetë vetë nënë dhe e di ç'domethënë ta kesh fëmijën me temperaturë... Se mos e di unë është urgjente apo jo?, — dëgjohej një zë gruaja.

— Një kat më poshtë keni mjekun e rojës. Dhoma njëzet e dy, ju çoj unë, po deshët!, — thoshte infermiera. — Doktoresha e tejkaloj orarin, s'mund të vonohet akoma, ka një punë të ngutshme.

— Sa bëmë fjalë ma kishte vizituar!, — ngulte këmbë gruaja.

«U shërbej me ndërgjegje ditë për ditë dhe përsëri nuk kënaqen!, — mendoj Ani. «Ajo duhet të jetë vetë nënë», tha... Nuk jam, jo, s'e kam atë fat!... Si është kjo botë, disa s'duan të lindin më, disa zhuriten për një fëmijë!...»

Iu mblodh një lëmsh në gjoks, hidhërimin sikur e ndjeu edhe në gojë dhe veshi me rrëmbim pardesyne, si të donte t'u ikte atyre mendimeve të trishtuara. Doli si plumb nga dera dhe gjersa arriti te fundi i shkallëve nuk e ktheu kokën as majtas as djathtas. Në rrugë mori frymë e lehtësuar. Sikur e përtëriu fladi i freskët e i lagësht i mbrëmjes. Vështroi përsëri orën dhe nxitoi hapat.

«Flora ndoshta ka ardhur!, — mendoj. — Sidoqoftë, ka të vëllanë që e pret. Ai sonte me siguri do të jetë kthyer me kohë në shtëpi. Kurse për provën e kostumit tim, s'gjente që s'gjente kohë. Megjithëse, s'kam ndonjë dëm, ai s'para merr vesh nga kjo anë. Shyqyr që kujdesem unë për veshmbathjen e tij se ai s'ia thotë fare. Të ma dijë për nder, se e bëra njeri. Ma di vallë?!... Të ma dinte, do të tregonte më tepër vëmendje ndaj meje. Kemi tri javë pa dalë gjëkund ba-

shkë. «Është bërë mysafir në shtëpi, thuajse uzinën vetëm ai e mban... Në vitet e para të martesës, ndonëse ishte më i zënë, nganjëherë punonte gjithë natën, gjente kohë të shëtiste edhe me mua. Helbete, tani...»

Trotuari i Rrugës së Barrikadave ishte plot me kalimtarë. Sado që mundohej të dredhonte midis tyre, e bezdiste hera-herë e ndonjë bërryli. Dëgjonte fragmente bisedash, zvarrisje e trokitje këpucësh, zhurmë automjetesh, vështronte vajtje-ardhjen e pandërprerë të njerëzve dhe ndiente një shqetësim të thellë e një marrje mendsh të lehtë.

Së largu vuri re dy kolegë të vjetër, që s'i kishte takuar prej kohe. Një herë iu shkrep të përshëndoshej me ta, ndoshta i harronte ato mendime shqetësuese, po, kur kaloi pranë tyre, i përshëndeti shkurt, e menjëherë ktheu kokën nga reklamat e kinemasë.

«Ç'më duhet të ndaloj me ta në mes të rrugës!, — mendoi.

Ndërsa mori kthesën drejt rrobaqepësisë «Moda», ndeshi një shoqe të vjetër të gjimnazit, e cila po dilte nga dyqani i fruta-zarzavateve me një rrjetë me mollë.

— Ku je, moj Ani, se u harruam fare?!, — i thirri ajo, e tërhoqi për dore në anë të rrjedhës së kalimtarëve dhe u puthën.

— Punë shumë, moj motër, më këputi ajo ambulanca!, — tha Ani. — Pastaj, edhe punët e shtëpisë nëna presin, se burrat... Paskan dalë starkinge të mira!

— Bleva nja dy kile, se m'i hanë shumë fëmijët!

— Edhe unë do të blej, në e arritsha çelur, se tani ngutem të bëj provën e një kostumi këtu, te «Moda». Vjen të ma shohësh pak?

— Me gjithë qejf, kemi kaq kohë pa këmbyer dy fjalë bashkë!

Në sallonin e rrobaqepësisë kishte plot klientë dhe mjeshtri, që të mos humbisnin durimin, i merrte me të mirë, duke i drejtuar kujt një fjalë, kujt një pyetje e kujt një buzëqeshje.

Ato zunë vend në qoshkun e pritjes dhe shfletu-

an një revistë modelesh, duke shkëmbyer mendime me njëra-tjetrën. Kur i erdhi radha Anit, shqyrtuan bashkë çdo hollësi, bënë vërejtje dhe diskutuan goxha për gjatësinë e fundit. Mjeshtri dëgjonte me një buzëqeshje profesionale, ngulte e shkulte gjilpëra dhe bënte vija me sapunin e rrobaqepësit.

— Stof i bukur, — vërejti shoqja.

— Mezi e gjeta!, — tha Ani. — Stofrat e Mapos nuk janë të këqija, por ç'e do, prej tyre kanë të gjithë, kurse kjo është diçka e veçantë.

— Dhe të shkon për mrekulli!

Mjeshtri uroi «me shëndet» dhe u kthye me nxitim nga klienti tjetër.

— A po kthehesh nga shtëpia, të pimë një kafe bashkë?, — i propozoi shoqja, sapo dolën nga lokali.
— Ja, dy çape e kemi!

— Falemnderit, por do të shoh për mollë, siç të thashë!, — i përgjigj Ani me dashamirësi. — Pastaj, s'mund të vonohem; sonte më kthehet kunata nga aksioni dhe helbete...

— Me ç'kam dëgjuar, ju përshtatet ajo kënga «Ishin dy kunata, shkonin pors motra»! — buzëqeshi shoqja dhe pastaj shtoi:

— Është gjynah të mos shkojë njeriu me ty!

— Që t'i japim hakun, edhe ajo sillet mirë!, — tha Ani.

— Ishalla i del ndonjë fat i mirë dhe rehatoheni të dy palët!, — tha tjetra.

— Atë uroj edhe unë, se, të them të drejtën, ia kam një çikë frikën. Helbete, është rritur disi pa fre, si nëpër konvikte, më! S'e ka për gjë të shëtisë në bulevard edhe me djemtë, kurse unë, në moshën e saj, s'guxoja të ktheja kokën, se më pinte e zeza nga babai.

— Më kujtohet, kur kishim ndonjë mbrëmje argëtimi ose aktivitet tjetër vinte ndonjëri nga të familjes dhe të priste te porta!, — buzëqeshi shoqja. — Edhe ashtu s'është gjë veç!

— Ç'e keqe më gjeti nga kjo?, — vërejti Ani. — Ja, u martova përbukuri dhe shkova te burri e pastër, si vesa. Siç thotë im atë: «Vajza është si qelqi, po u thye, s'ngjitet»...

Shoqja e përcolli Anin deri te dyqani i fruta-zar-zavateve, pastaj u ndanë, duke i premtuar njëra-tjetrës se do të shkëmbejnë vizita.

«Ama edhe unë, ç'lëvdohem me jetën time të dikurshme, — i dëshmoi vetes Ani, ndërsa po kthehej në shtëpi, me qesen e mollëve në dorë. Në të vërtetë qysh atëherë më neveriteshin kufizimet, sidomos kur qeshë studente. Më vinte turp nga shoqet kur im atë nxori raport mjekësor që të mos shkoja në orët e fizkulturës, se s'më paskësh hije të dilja me kostum sportiv. Ua kisha zili atyre që ishin më të lira e më të pavarura se unë, bile edhe atyre që dashuronin, megjithëse im atë s'lodhej duke ma përsëritur se vajza është si qelqi... Ama, ç'rini që kam kaluar! Dhe për të gjitha këto prisja shpërblim nga martesë. Të bukur shpërblim që po marr! Këputem gjithë ditën së punuari në ambulancë e në shtëpi dhe, kur vjen mbrëmja, ai mezi shkëmbeu dy fjalë me mua. Gjoja lodhet shumë në uzinë! Për të lexuar libra s'është i lodhur!... Ç'humbeu shoqet e mia që, sa ishin vajza, jetuan ndryshe?! Shumë prej tyre janë më të lumtura, ose të paktën ashtu duken... Se, edhe unë e lumtur dukem nga jashtë... Atëherë, pse s'më pëlqen qëndrimi i Florës? Thua e kam zili, apo jam mësuar si ai kali i karrocës me rruqën e vjetër? Eh, jetë, o jetë, sa e ngatërruar qenke!...»

Si për t'ia theksuar më fort ato dyshime, pranë saj kaluan një tufë të rinj e të reja të gëzuara. Ajo i vështrroi një hop si e hutuar, iu duk vetja tepër larg asaj moshe dhe nxitoi hapin. Kur u kthye në rrugën që e çonte drejt banesës së tyre, e cila ishte më e qetë, u ndie më mirë. Dëgjonte trokitjen e hapave të vet në trotuar dhe i pëlqente të besonte se ato mendime të zymta ia sillte lodhja e asaj dite.

Petro Lisi e lexoi për herë të dytë relacionin « Mbi gjendjen e repartit të dytë dhe domosdoshmërinë e riorganizimit të tij». Hera-herë e ndërpriste leximin dhe plotësonte shënimet që kishte nxjerrë në bllokun e vet, sidomos për pikat që i dukeshin të paargumentuara mirë dhe që mund t'i shërbenin për ta shtyrë zbatimin e propozimit. Poshtë nuk mund të hidhej se leverdia dilte qartë. Bile, edhe që të shtynte s'do ta kishte të lehtë. Ndërsa lexonte, i dukej sikur argumentet e relacionit goditnin si çekiçi pneumatik mbi ato kundraprova të dobëta që kishte shënuar në bllok.

Kur arriti te firmat, profi në këmbë dhe, siç e kishte zakon kur shqetësohej, filloi të endej nëpër zyrë, duke thithur shpesh cigaren. Një hop iu duk e padrejtë t'i kundërvihej propozimit, por pastaj u rikthye në mendimin e parë, me një farë kompromisi.

«Fundja, nuk them që të lihet fare, them që të shtyhet për disa kohë, sa të mbyllet plani. Megjithatë ta diskutojmë. Debati është gjithmonë i dobishëm. Këshilli teknik do të vendosë si të jetë më mirë!», — tha me vete dhe u rikthye në tryezë.

Mori relacionin dhe shënoi në anë të tij: «Të shqyrtohet në mbledhjen e këshillit teknik të muajit..., — këtu hezitoi një çast, — nëntor».

«Mbledhjen e tetorit e kemi goxha të ngarkuar me probleme!», — deshi të justifikojë ndaj vetvetes.

Futi relacionin me ngut në dosje, si t'i digjte duart, dhe mori frymë disi i lehtësuar. Befas zyra iu duk e ftohtë. Vuri në prizë reflektorin, pastaj mori me përtesë dosjen «Çështje që presin zgjidhje».

«Si nuk mbeti një herë bosh. kjo!», — mendoi, duke e shfletuar me bezdi.

Duhej t'u përgjigjej disa shkresave, kishte për të përgatitur edhe një informacion për dikasterin. Nuk i bëhej të fillonte dhe, që të kalonte koha, nisi të mprhihte me një kujdes të tepruar, majat e lapsave. Pastaj rregulloi takëmin e bojës, shpërdroddhi kordonin e telefo-

nit, zbrazi në kosh tavllën e cigareve, dhe së fundi e detyroi veten të punonte.

Nuk i ecte kalem. Frazat dilnin të gjata, të ndërlikuara, përsëriteshin. Më shumë prishte me gomë, se sa shkruante, e kështu s'po nxirrte gjë në dritë. Për një çast i doli para syve punëtorja e shërbimit, Aspasia tek digjte shkresat e vjetra mbrapa uzinës dhe iu neverit puna që po bënte. Megjithatë, duhej bërë.

Sapo kishte mbaruar hyrjen dhe, pikërisht kur po i goditeshin më mirë frazat, e ndërpreu një trokitje në portë. Petroja çoi sytë i nevrikosur. Hyri Selimi, duke u kolovitur mbi këmbët e tij të gjata.

— Më fal që të ndërpreva, por kam një problem të cilit s'i jap dot zgjidhje vetë!, — tha ai.

Petroja i bëri shenjë të fliste.

— Ndërmarrja tregtare po na bën presion për artikujt e kontraktuar!, — sqaroi Selimi. — Gjatë këtij tremujori s'i kemi prodhuar asgjë. U mundova të justifikohesha, të premtoja, t'i merrja me të mirë, por s'më eci këtë radhë. Ata kanë përgatitur një letër për «Zërin e Popullit».

— T'ua prodhojmë!, — tha Petroja.

— He, këtu është e keqja! Reparti i dytë, që ua ka marrë dorën këtyre prodhimeve, është zënë me pjesët e ndërrimit të Oficinës së Riparimit të Automjeteve.

— Sa ua kemi plotësuar kontratën atyre?

— Rreth gjashtëdhjetë për qind.

— Atëherë t'i ndërpresim pjesët e tyre të ndërrimit dhe të hedhim në prodhim artikujt e tregtisë. Kontratat duhet t'i plotësojmë proporcionalisht.

— Kjo s'është në kompetencën time, shoku kryeinzhinier!, — buzëqeshi tjetri, duke u mëshuar fort fjalëve të fundit.

— Mirë, mirë, do ta urdhëroj unë degën e planit!
Petroja mbajti shënim në bllokun-kalendar dhe

uli sytë mbi relacion, ndërsa Selimi u zbraps dhe doli pa u ndier.

Kur doli nga uzina, Petroja vuri re se ora elektrike e hyrjes tregonte katër e dhjetë.

«Si s'dola një herë në orar!», — mendoi, duke buzëqeshur me vete.

Ndihej disi i lodhur, por edhe i kënaqur, se hoqi qafe disa nga problemet që pritnin zgjidhje, sidomos atë relacionin për ministrinë, i cili ishte mjaft delikat. Nuk e priti autobusin urban. I pëlqeu të ecte në këmbë, që të shpihej. U përgjigjej me qejf përshëndetjeve të shumta dhe ndiente një farë krenarie, që ishte aq i njohur. Kur kaloi para birrarisë më të afërt, ku gjithashtu ishte i njohur, vendosi të kthehej sa për të shuar etjen me një gotë.

Me të hyrë në lokal, e goditi një re tymi që kundërmonte yndyrë të djegur dhe tym duhani. Dëgjoheshin bisedat e klientëve dhe çërcëritja e vazhdueshme e bër-xollave që piqeshin në skarë. Pranë banakut ndeshi xha Vasilin. Kishin punuar shumë vjet bashkë për montimin e makinerive, sidomos gjatë ngritjes së reparatit të dytë.

— Ku je, bre xha Vasil?! Kemi kohë pa shkëmbyer dy fjalë, — iu drejtua, duke i zgjatur dorën.

— Ti e di ku jam... Por, s'thonë kot, puna të bashkon, puna të ndan!, — ia priti ai me një farë keqardheje.

— Puna përsëri na bashkon, mjeshtër!, — e korri-gjoi buzagaz Petroja.

— Por, jo si atëherë kur ishte në repart, ama!, — tundi kokën xha Vasil. — Mbase nuk të kam vënë re se, helbete, mosha bën të sajën, po sikur rrallë dukesh andej nga ne. Je kryeinxhinier tani... Thonë se ato zyrrat tuaja janë si të shtruara me zift të shkrirë, të ngjiten këmbët atje...

— Hej, xha Vasil, s'hoqe dorë nga romuzet ti!, — vërejti si me shaka Petroja, që ndjeu një farë qortimi pas atyre fjalëve të thëna urtë e butë.

— Pandi, një birrë dhe një meze të përzier për mikun!, — porositi mjeshtri.

— Si urdhëron!, — bëçiti banakieri, një burrë tullac e rrumbullak, që jepte dhe merrte me klientët.

— Urdhëroni!, — tha, duke u vënë porosinë përpara. — Po ti, usta, nuk do ta mbushësh edhe një?

— U bëftë!, — miratoi xha Vasili.

— Me banakierin jemi miq të vjetër!, — tha Petroja.

— El kemi pasur kuzhinier kur ishim vullnetarë në hekurudhë. Të kujtohet, Pandi?

— Si s'më kujtohet, vëllaçko! Më duket sikur ishte dje. Kisha gjetur belanë me ju, m'i bënit copë xhamat e kuzhinës, duke luajtur me top. Të fortë ishit, bre! Bartnit gjithë ditën dhe me tezga, e përsëri kishit takat edhe për futboll... Rini, more vëlla!... Urdhëroni, gati birra!... Dhe nuk i bënit hiç naze asaj gjellës sime, sado që atje e mësova zanaatin dhe, helbete... Obobo, m'u dogjën bërçollat!, — Pandi rrëmbeu mashën dhe u kthye nga skara.

— Sa e bukur më duket tani ajo kohë!, — tha Petroja me nostalgji. Heshti një çast, sikur deshi kohë që të kthehej pesëmbëdhjetë vjet prapa, piu një gllënj-kë birtë, pastaj vazhdoi:

— Më kujtohet së si mbrëmjeve, i këputur nga puna dhe nga lojë, shtrihesha në dyshekun me kashtë dhe ëndërrojë syhapur, gjersa më mundte gjumi... Për ç'nuk ëndërrojë atëherë!... Eh, rinia, rinia!...

— Se mos tani u plake!, — vërejti xha Vasili, duke prerë me biçakun e vet një copë bërçollë.

— Sidoqoftë, ndryshe është. Ja, tani, shumë nga ato që ëndërtojë, i kam arritur. Inxhinier u bëra, familjë krijova, motra më vazhdon fakultetin, gjithçka si jo më mirë... Megjithatë, sikur ishte më bukur atëherë!

— Çdo kohë dhe çdo moshë ka bukurinë e saj, more bir!, — tha mjeshtri, duke fshirë mustaqet e thijnjura me shami. — Ja, edhe mua, që jam në këtë moshë, s'para më pëlqen të rroj me të shkuarën, siç

bëjnë disa. Kur më del gjumi që pa gdhirë, s'luaj nga shtrati, që të mos zgjoj të tjerët dhe rri e thur plane për të ardhmen. Jo do modifikoj filan makinë, jo do ndihmoj filan mekanik të bëhet zanatçi i mirë, jo do fejoj filan mbesë... Mendja rend përpara, veprat nga pas. Kështu, ditët mbushen dhe zbukurohen. Ndryshe, si mund të jetohet?!... Kryesorja është të mos plakët kjo, more bir! — Ai mbështeti gishtin tregues mbi zemër. — Se, po u plak kjo, aha, e humbe davanë. Prandaj, mos e lër të të zërë myk. Dëgjon? Se, të dua si birin tim, ashtu, të pastë xha Vasili!

— Për shëndetin tënd, mjeshtër!, — uroi Petroja i shkujdesur, pa u thelluar në domethënien e fjalëve të mjeshtrit.

— Shëndet paç!, — ia ktheu tjetri, pa e lëvizur gotën dhe pa ia ndarë sytë, që ta tërhiqte në brazdë. — Shyqyr që u takuam një herë. Dikur shiheshim përditë, apo ke harruar?

— Harrohet ajo kohë, xha Vasil?!, — ia priti Petroja me nostalgji. — Ehu, sa herë e kemi gdhirë bashkë në uzinë! Sa herë na ka nxjerrë nga sikleti përvoja jote dhe kjo qesja e duhanit, që s'e paske ndërruar!... Të kujtohet ç'hoqëm me ngritjen e repartit të dytë?... Atëherë unë isha akoma beqar, flija në shtëpinë e beqarëve dhe ndodhte që bija pa ngrënë, se i gjeja restorantet në mbyllura kur dilnin nga puna... Më kujtohet se një herë nuk më zinte gjumi nga uria, sa u shtrëngova t'i kërkoja një copë bukë rojës së natës...

— Po, po, atëherë punoje në një radhë me ne!, — vërejti xha Vasili.

— Kurse tani kanë dalë ca të zgjuar, me inxhinier Andrenë në krye, që thonë se organizimi i këtij reparti s'qenka i përshtatshëm!, — vazhdoi me të veten Petroja.

— Kushedi, mund të kenë të drejtë!, — tha mjeshtri, duke rrëmuar me gishta në qesen e duhanit. — E mira s'ka fund.

— Ej, posi, erdhën e i gjetën të gjitha gati dhe tani duan të shesin mend!, — shtoi me qesëndi.

— Në i paçim të mira, le t'ua blejmë, — tha urtë xha Vasili. — Ne e ngritëm repartin ashtu siç na u duk më mirë dhe ai e bëri punën e vet, por koha s'qëndron në vend. Atëherë përvoja ime dukej kushedi se çfarë, kurse tani ka plot mjeshtra në uzinë që dinë më shumë se unë, se kanë edhe shkollë. Ti ishe atëherë i vetmi inxhinier, sot janë edhe pesë të tjerë. Shumë kokë mendojnë më mirë se një e vetme, mos e harro këtë... Ndoshta, vërtet do ndryshuar organizimi i atij reparti. Unë s'i kam hyrë thellë kësaj pune, por nga ç'kam parë e dëgjuar...

— Dakord, xhanëm, po do parë mirë kjo punë, s'i thonë shaka!, — e mbylli Petroja duke, dyshuar se mos edhe mjeshtri ishte përkrahës i atij propozimi. — Dhe tani, le ta ngremë me fund, se na presin në shtëpi!, — vazhdoi duke marrë gotën e birrës. — Gëzuar, xha Vasili!

— Gëzuar qofsh!

Petroja iu afrua banakut dhe pagoi pa përfillur kundërshtimin e mjeshtrit.

— S'e ke mirë, s'bën kështu, unë porosita!, — u zemërua ai. — Këtu je Petro, s'je kryeinxhinier, prandaj...

— Lëre, s'ka rëndësi, një herë tjetër!, — tha Petroja dhe u largua nga banaku.

— Falemnderit dhe na urdhëroni përsëri!, — bëri shaka Pandi.

Ata ecën një copë rrugë bashkë. Mjeshtri çapitej rëndë-rëndë, me një pamje të menduar e disi të zymtë. Mënyra me të cilën kishte ngulur këmbë Petroja të paguante nuk i kishte pëlqyer. I qe dukur si e një njeriu që mbahet me të madh, që do më tepër t'i bëjë nder vetes, sesa shokut. Edhe për zemërsia që kishte treguar gjatë takimit, i qe dukur disi e tepëruar. Këto ia përforcuan mendimin se Petroja kishte filluar të largohet nga njerëzit. Jo vetëm nga ai, por nga të gjithë. Nuk e dinte ç'e pengonte t'ia thoshte të gjitha këto dhe inatosej më vetveten.

— Ishalla takohemi më shpesh në të ardhmen!, — tha, ndërsa po i afroheshin vendit ku rrugët e tyre ndaheshin.

— Pa tjetër që do të takohemi!, — ia priti Petroja, i shkujdesur.

Xha Vasili ngriti supet me mosbesim.

— Pse, dyshon?, — buzëqeshi Petroja.

— Do të përgjigjem edhe unë si ai i përrallës, me ç'më dëgjojnë veshët, lum si unë; me ç'më shohin sytë...

— Pse, ç'të shohin sytë?! — u vrenjt tjetri.

— Një kryeinxhinier fort të zënë me punë, — këtu xha Vasili i mësoi me qëllim zërit, — që s'para gjen kohë të rrijë me ne, si Petroja dikur.

— Ç'faj kam unë, ju më bëtë kryeinxhinier!, — u mundua të buzëqeshte tjetri.

— Po, po, xhanëm, ne të bëmë, por...

— Por, çfarë?

— Vërtet je kaq i zënë?, — ia priti xha Vasili, duke e mbërthyer me një vështrim mosbesues.

— Ti e the vetë qëparë, është rritur goxha, repartet janë shtuar...

— Ashtu është, por... të gjitha këto në një hektar tokë ndodhen. Ne nuk jemi kooperativë e bashkuar bujqësore!

— Pa ardhur s'kam qëndruar, de!, — hovi Petroja, me një buzëqeshje pajtuese.

— Vërtet, vjen ndonjëherë, por edhe atëherë se si më dukesh... si ndonjë mysafir!, — tha xha Vasili, i kënaqur për krahasimin që gjeti. — I pyet njerëzit për punën, për shëndetin, edhe për ndonjë hall, por i dëgjon me gjysmë veshi dhe mezi pret të shkosh më tej, që të veprosch njësoj me të dytin, me të tretin.... Ke harruar edhe të zemërohesh, pale!

— Epo, as moshës dhe as detyrës nuk i shkon që...

— Dikur shkrepitje dhe bubulloje, kur vëreje ndonjë paudhësi, kurse tani vetëm rrudh vetullat dhe thërrret përgjegjësit e reparteve në raport atje lart, në

zyrë. U ranë këmbët të ngratëve, ec e ja në zyrën tënde!

— Me ç'dëgjoj, të paskam prishur qejfin, xha Vasil!, — vërejti Petroja, duke u shtirur më i hidhëruar nga ç'qe.

— Qejfi im s'ka rëndësi, ndreqet kollaj, veç ju, bijtë tanë, të mos prisheni as kaq!, — tha mjeshtri, duke treguar majën e thoit. — Prandaj të fola kështu. Shyqyr që të takova, se më vlonin përbrenda. Shoshiti mirë; ç'të të duken të drejta mbaji, të tjerat hidhi mënjane. Ishalla, kur të takohemi përsëri, s'do të jetë nevoja të flasim më për këto gjëra. Kështu ma do zemra. Ja, erdhëm te udhëkryqi, këtu lipset të ndahemi. Ndoshta na takon më shpesh të pimë ndonjë birrë bashkë.

— Pa dyshim, xha Vasil!

— Veç, me konditë që të paguaj unë. Marr goxha rrogë dhe kam sa për të qerasur një shok.

— Kush tha jo, mjeshtrë?!

— Se neve, të vjetërve, na pëlqen t'i qerasim ndonjëherë bijtë, ja kështu!, — bubulloi xha Vasilj me qortim. — Tani shko, se të presin. Natën e mirë!. — I shtrëngoi dorën me nxitim dhe iku pa e kthyer këkën.

Petroja e ndoqi një copë me sy dhe, nga mënyra se si ecte, e kuptoi se ai ishte i shqetësuar.

«Ç'shtë e vërteta, s'para jemi takuar këto kohët e fundit!, — tha me vete. — Po s'kam pasur fare nge. Kam pasur kaq shumë punë, sa dhe në shtëpi s'rri fare. Mirëpo duhet treguar kujdes, sepse këtyre të vjetërve u ngelet hatri menjëherë. T'i them Anit të më kujtojë që t'i shkojmë për vizitë me rastin e festave...»

Kur arriti në shtëpi, Petroja bëri së pari një banjë dhe e ndjeu veten të çlodhur, të lehtë dhe me humor. Bisedoi një copë herë me të shoqen dhe motrën, pastaj u shtruan që të tre rreth tryezës.

Pas buke u rehatua në divan, ndezi cigaren dhe

nisi të shfletonte revistën «Ylli». E kishte pushtuar një plogështi e këndshme, sa as të lexonte nuk i bëhej. Lëshoi revistën mbi komodinën e divanit dhe ndoqi me sy dredhat e tymit të cigares.

Ani thurte fanellë në kolltukun pranë sobës, kurse Flora po lexonte e përqëndruar një dispensë të trashë. Në dhomë ishte pothuaj qetësi. Meloditë që transmetonte radioja, e ulur në minimum, dëgjoheshin si prej së largu. Lavjerësi i sahatit të vjetër të murit lëshonte një «tik-tak» monoton. Binte erë gjellë. Mbi sobë po vlon-te dreka për të nesërmen.

«Sa mirë, sa mirë që është!», — tha me vete Petro-roja, duke lëshuar një shtëllungë të madhe tymi. I vajtën sytë te korniza që ndodhej mbi kreun e divanit, në të cilën që vënë një fotografi e zverdhur nga koha. Ishte e vetmja fotografi e prindërve.

«Të shkretët, nuk patën fatin t'i arrinin këto di-të!», — mendoi, dhe nisën t'i parakalonin në kujtesë, si në një film të përshpejtuar, fragmente të së kaluarës.

...Fshati shtrihej në një shpat mali me drurë të rrallë dhe të moçëm. Shtëpia e tyre ndodhej diku lart, në kreun e shpatit dhe ishte e vjetër, me trarë të nxirë, që dukeshin sikur do të të shembeshin mbi kokë. Brenda vinte gjithmonë era tym. Megjithatë, në dimër mërdhinin. Ata kishin një qen të madh, të zi, me veshë të varur dhe bisht të gjatë...

...Sa vjeç ishte kur zbritën në qytet?!.. Rrugët e tij ishin me kalldrëm. Edhe kur ecje zbatshur nuk të çirreshin këmbët, si në fshat. Po shtëpia ishte përsëri e vogël, me mure të trasha qerpiçi. Kur binte shi, ishte çudi po të mos pikonte çatia. I ati ngutej t'i zinte pikat se, po të lagej qerpiçi, ai muri që kishte lëshuar bark rrezik të shembej dhe ata do të ngeleshin në mes të katër rrugëve. I ati bënte lloj-lloj punësh, ç'gjente. Ndërsa e ëma tërë ditën lante, lante rrobat e botës. Atij i vinte inat kur sillnin ato bohçet e mëdha, se e ëma lodhej shumë me to. Por edhe kur nuk i sillnin, mërzitej, sepse vinte ré që ajo pezmatohet...

...Kur shkoi në shkollë, ai mbante rrobat më të vjetra, me arna të panumërta dhe në pushimin e madh hante vetëm bukë me presh ose me qepë. Megjithëse merrte nota të mira, drejtori i shkollës nuk e nxirrte asnjëherë si të dalluar përpara klasës. Ishte në klasën e tretë kur u bë me motër. Ajo e pengonte të mësonte me të qarat e saj, por ai e donte shumë dhe gëzohej kur nëna ia jepte ta mbante...

...Flora ishte dy vjeç kur iu vra i ati. Në mëngjes doli nga shtëpia shëndoshë e mirë, po s'u kthye i gjallë. Afër drekës dikush erdhi e ia tha mynxyrën s'emës. Ajo lëshoi një klithmë, pastaj e mblodhi veten. Veç, u zbeh dhe i vështronte të dy fëmijët me ca sy të dhimbshëm. Pastaj gjetën një shkak dhe i çuan te shtëpia e fqinjit. Ai dyshoi, doli fshehurazi dhe e pa kur e sollën të atin. Katër burra e mbanin në një vig. E kishte kokën të lidhur me fasha të bardha dhe fytyrën të verdhë, të verdhë. Tani, sa herë donte ta sillte ndër mend, ashtu i dilte para sysh...

...Ai i vështronte me lakmi shokët që vazhdonin shkollën. Vetë endej gjer vonë rrugëve dhe nëpër lokale, duke shitur, sipas stinës, kikirikë, gështenja të pjekura ose bajame të qëruara. Nëna e priste përnatë me ankth, e përqaftonte me të kaluar pragun dhe e pyeste në ishte lodhur shumë. Kurrë s'e pyeti sa shiti. Ai ndiente kënaqësi të madhe kur bënin llogarinë dhe ndanin veç fitimet e pakta...

...Disa ditë pasi u çlirua qyteti, një partizan i tha se këtej e tutje ata s'do të ishin më të varfër dhe se ai do të vazhdonte shkollën. Partizani ishte aq i ri, sa ai s'e besoi kollaj. Pak kohë më vonë nënën e futën në punë. Rrogën e kishte të vogël, por ajo ia dilte mbanë me nikoqirllëk dhe ai u kthye përsëri në bankat e shkollës. Në fillim i vinte zor, se ishte më i madhi i klasës, por pastaj u mësua. Se mos e kishte ai fajin që ishte prapambetës!...

...Kur i doli bursë për shkollën e mesme politeknike, ai u largua për të parën herë nga familja. S'e

pat të lehtë, por u mësua shpejt me jetën e re. I pëlqenin klasat me dritare të larta, laboratorët me rafet sa faqja e murit dhe salla e studimit, ku dëgjohej vetëm fëshfëritja e fletëve, hapat e kujdestarit dhe ndonjë pëshpëritje e druajtur. I pëlqente mensa e madhe, me atë kundërmimin e saj të veçantë. I pëlqente edhe fjetorja me krevatet marinare njëri sipër tjetrit, ku bëhej shumë zhurmë. Nganjëherë edhe zhurma e bukur dhe e gëzueshme...

...Në konvikt ndodhnin edhe çapkënllëqe, por ai s'pat qenë kurrë pjesëtar në to. Kur kujtonte me sa vështirësi ia kishte arritur asaj dite dhe premtimin që i kishte dhënë nënës, dridhej vetëm nga mendimi se mund të dënohej për thyerje të disiplinës. Gjatë katër vjetëve, vetëm një herë vajti në konvikt pas orës së mbylljes. Do të kishte fjetur jashtë, sikur një shok i dhomës të mos i kishte hapur dritaren e korridorit. Atë mbrëmje që vonuar duke përcjellë në shtëpi Valën, të cilën e kishte njohur gjatë verës, në aksionin e hekurudhës...

...Sa të bukura ishin ato mbrëmjet e gjata të dimrit, kur cikërrinte shiu në dritare dhe bubullonte zjarri në sobë, ndërsa nëna gatuante darkën, Flora përgatiste mësimet e së nesërmes, kurse ai përgatitej për provimet e ardhshme! Ishte regjistruar në degën e inxhinierisë mekanike me korrespondencë. Nëna kishte vendosur ta festonte ditën kur ai do të merrte diplomën. Do të ftonin edhe shokët e të atit...

...Nëna s'e jepte veten, thoshte se do të mbahej me dhëmbë gjersa të martonte edhe Florën, por ligëj e zverdhej nga dita në ditë. Fjalët e saj u jepnin zemër dhe ata shpresonin, edhe kur mjekët tundnin kokën me keqardhje. Pas vdekjes së nënës, ata e ndien veten si zogjtë pa kllaçkë. Flora u trondit aq shumë, sa u detyruan ta çonin te një kushëri, ku qëndroi gjersa i doli bursë për teknikumin e ndërtimit, në Tiranë. Ai vetë shkoi vullnetarisht në një kantier të madh ndërtimi. Atje ndihej mirë, veç e merrte malli për Florën. Sa herë merrte

rogën, nisej drejt e në postë dhe i çonte asaj pjesën që i duhej. Asnjëherë s'kishte shkuar ta takonte pa ndonjë dhuratë...

...Vendosi të martohej, se iu mërzit jeta në shtëpinë e beqarëve dhe restoranteve. Anin e njohu në një mbrëmje shoqërore për Vit të Ri. Qysh më parë kishte dëgjuar fjalë të mira për të. Të atin e kishte jurist, ndërsa ajo vetë ishte në vitin e fundit të Fakultetit të Mjekësisë. Që në njohjen e parë i la përshtypje të mira. Iu duk jo vetëm e pashme, por edhe e pjekur, e përmbajtur dhe e sjellshme. Më pas u takuan disa herë. Më në fund ai vendosi dhe i propozoi të fejojeshin. Ajo e priti mirë propozimin, por e drejtoi te prindërit. Ata hezituan ca, por pastaj pranuan. Fejesën nuk e zgjatën. U martuan disa muaj pasi ajo mbaroi fakultetin. Ndërkohë ai kishte marrë apartament. Nuk e patën fort të vështira ta pajisnin, se Ani solli mjaft. Tani s'u mungon gjë...

«Sikur të jetonin prindërit e shkretë, sa do të gëzoheshin!», — tha me vete Petroja, duke shëtitur edhe një herë vështrimin nga e shoqja, tek e motra. Ato iu dukën më të afërta dhe më të dashura se zakonisht. Atë çast iu kujtua xha Vasili dhe vendimi që pat marrë pasi qe ndarë me të.

— Ani, — i thirri së shoqes, — të lutem, të më kujtosh që t'i shkojmë për vizitë xha Vasilit për festat që kemi përpara.

— Mirë, mirë, veç s'duhet të lëmë pa shkuar edhe tek Andrea!, — tha ajo pa ia ndarë sytë të shoqit. — Pse i mbloodhe buzët ashtu?, — e pyeti ajo duke vënë ré grimasën që bëri ai.

— Asgjë, asgjë, po më ka nxjerrë ca telashe si askush deri sot!

Flora ngriti kokën dhe të dyja me Anin e vështuan në mënyrë pyetëse.

— Ngul këmbë si mushka që të bëhet sa më parë riorganizimi i repartit të vet. Pikërisht tani, kur kemi telasht e mbylljes së planit vjetor!, — sqaroi Petroja.

— Mos u prish me shokët për çështjet e punës!, — e këshilloi Ani. — Fundja, ai është përgjegjës i reparatit, ti kërkoi planin.

— Ej, posi! Atë s'e thërret njeri në raport përtej mureve të uzinës. Në kurrizin tim thyhen shkopinj të.

— Unë s'i njoh punët tuaja, por në qoftë propozim jo i drejtë, do t'ia hedhë poshtë kolektivit!, — vërejti Flora.

— Këtu është e keqja, se ai ka bërë për vete punëtorët e reparatit!, — tha Petroja.

— Atëherë, shikoje me gjakftohtësi këtë punë, vëlla, se sot s'të përkrah njeri po s'pate të drejtë!, — i tërhoqi vëmendjen Flora.

— Mirë, mirë, i di vetë unë punët e mia!, — e mbylli atë kapitull ai.

Ani kontrolloi edhe një herë gjellën, i shtoi ca erëza dhe e mënjanoi nga zjarri. Në kuzhinë u ndie një kundërmim ngacmues.

— Po filmin e ri kur do ta shikojmë, Petro?, — pyeti Ani, duke u rikthyer në kolltuk. — Më ke dhënë fjalën!

— Këto ditë jam i zënë, të thashë!, — u përgjigj ai. — Shkoni me Florën.

— S'dolëm një herë bashkë, xhanëm! Do të kujtojnë bota se jemi zënë..., — tha Ani me një farë pezmatimi.

— Ama, hallin e botës ke ti?!, — e qesëndisi ai.

— Unë nesër kam ndër mend të shkoj!, — tha Flora. — Ne, studentët, e kemi si traditë që i shohim të parët filmat e rinj, prandaj, Ani, po deshe...

— Jo, falemnderit do të pres kur t'i mbushet mendja Petros!, — nguli këmbë ajo. — Ishalla të dielën s'ka për të qenë i zënë!

— Do ta kryejmë edhe atë punë, po vëri një dru sobës, se pas banjës e pas bukës mërdhin njeriu!, — tha Petroja.

Flora po punonte për projektin e gjeodezisë në një-rën nga sallat e Fakultetit. Kishte dy orë përmbys mbi lagritjet, dhe shifrat filluan t'i ngatërroheshin para syve.

— Të lutem, ma kontrollo këtë mbledhje, se e bëra për të tretën herë dhe përsëri nuk më kuadron!, — iu drejtua Arbenit, që punonte pranë saj.

Ai zgjati dorën, mori fletën dhe u përkul mbi shifrat e vockla e të dendura, të renditura njëra nën tjetrën, me një kujdes prej femre. Flora u mundua ta ndiqte në llogaritje, duke shoqëruar me sy majën e lapsit të tij, që përshkonte kolonat e shifrave.

— Kjo këtu është tresh, apo tetë?, — pyeti Arbeni, duke treguar një shifër.

— Tresh.

— E ke mbledhur për tetë, prandaj ke gabuar. Merre, tani të kuadron!

— Falemnderit. Vetë s'do ta kisha gjetur, se jam turbulluar fare.

— Dukesh. E lëmë me kaq për sonte?

— E lëmë!

Ata mblodhën fletët e llogaritjeve. Hapat e tyre e prishën për një çast qetësinë e sallës, ku dëgjoheshin vetëm fëshfëritje fletësh. Zbritën shkallët dhe u gjendën në sheshin e asfaltuar. Pranë u kaloi një studente me biçikletë, që po e mësonte atë me ndihmën e një shoku, i cili vraponte pas saj. Në godinën e konservatorit dikush bënte vokalizma. Një tjetër i binte pianos me pushime të vogla, duke përsëritur të njëjtin fragment.

— Secili me hallin e vet!, — buzëqeshi Flora.

— Atyre ua kam lakmi!, — tha Arbeni, duke treguar me dorë nga salla e palestrës, prej ku dëgjoheshin të rrahurat e topit në dysheme. — Sa do të më pëlqente të luaja basketboll tani!

— Më mirë ec e bëjmë një shëtitje nga bregu i liqenit!, — propozoi ajo.

Ide gjeniale!
— Ide gjeniale!, — buçiti gëzueshëm ai.

E përpjeta që të çonte te parku i madh kishte pak shëtitore. Dy gra po zbrisnin ngadalë, duke frenuar një karrocë fëmijësh. Foshnja luante duart dhe guiste. Më tej po ngjitej një çift tjetër. Ajri që i freskët dhe i pastër. Gjithçka dallohej me një qartësi të pazakontë. Degët lakurige të drurëve ndereshin drejt qiellit. Drita e butë e perëndimit i jepte një nuancë rozë çdo gjëje.

— Nuk më pëlqeu përgjigjja që dhe sot në seminar, nuk ishe në lartësinë e duhur!, — tha Arbeni me një ton qortimi të ëmbël duke ngjitur kodrën përpjetë.

— Ke të drejtë!, — pranoi Flora dhe uli kokën. — Por, dje pasdite, kumatës iu shkrep të pastronte shtëpinë. Të mos e ndihmoja?!... Mbaruam në mesnatë. S'munda të përgatitesha më mirë. Më zinte gjumi mbi dispensë.

— Ti ke pasur arsye, por unë dyshova se mos...

Arbeni s'e shfaqti gjer në fund mendimin, por Flora e kuptoi se ai kishte pasur dyshimin se mos ishin lidhjet me të shkaku.

— Në të vërtetë, ndodh e kundërta!, — tha Flora me një ton si e si ta bindte sa më shumë. — Unë tani mësoj më shumë. Qe vetëm një rastësi.

Ata e lanë rrugën kryesore dhe hynë në shtigjet dredharake të parkut. Dielli kishte perënduar dhe gjithçka po kridhej në një dritë të mjegullt, kaltëroshe. Konturet e godinave, të drunjve dhe të shtigjeve, dalngadalë po e humbisnin qartësinë. Sipërfaqja e liqenit kish të marrë një shkëlqim të mugët, të plumbtë.

— Sa po më pëlqen kjo mbrëmje!, — tha Flora dhe çiku lehtë me kokë supin e Arbenit. — Më shijon së tepërmi pushimi pas një dite të ngarkuar.

— Edhe mua. Kur e kalon ditën bosh, asgjë s'të shijon.... Pastaj, kur jemi bashkë, gjithçka na duket e bukur!, — buzëqeshi ai.

Nga liqeni erdhi një pui e lagësht. Përtej u ndez një dritë që u dyfishua në sipërfaqen e ujit. Dikush

thirri me zë të lartë. Vikatja jehoi thellë në qetësinë e mbrëmjes. Pas pak iu përgjigj një vikatje tjetër, më e largët. Pastaj pllakosi rishtazi qetësia e trazuar paksa prej pipëtimave të natës, ndërsa trokitjet e hapave të tyre në asfaltin e shtegut ndiheshin qartë.

Florës i dukej sikur vikatjet, pipëtimat dhe hapat jehonin thellë në qenien e saj.

Arbenit i dukej sikur tërë qenia e tij që grimcuar dhe tretur në atë gjithësi të mrekullueshme, në gjethet, në drurët, në dritat, në sytë e Florës dhe në tokën kundërmuese.

— Flora ime, e shtrenjta ime!, — pëshpëriti ai dhe i përkëdheli flokët.

Përmbi kreshtat e kodrinave po ngrihej hëna e madhe, e bardhë. Nga rrëza e gjithçkaje u zgjatën hije të zbehta, plot fshehtësi. Një si tis shumë i hollë, i ndritshëm, kaltërosh po nderej tejendanë.

Ata pushuan një copë herë te bisedka, që e quanin me shaka «shtëpia jonë». Arbeni i shtrëngonte lehtë dorën dhe nëpërmjet të asaj prekjeje, ndienin t'u kalonte ngrohtësia dhe drithma e ndjenjës së tyre.

Kur kaluan pranë bar-bufesë «Liçeni», Arbeni propozoi të ktheheshin sa për të pirë ndonjë birrë. Nëpër skajet e lokalit kishin zënë vend disa çifte të tjera që kishin vajtur përpara tyre. Ata zunë tryezën ku qëndronin zakonisht. Arbeni bëri porosinë dhe kamerieri u solli shpejt dy shishet e birrës, mezetë e ua vuri përpara; pastaj u habit duke vështruar Florën.

— A më mban mend kush jam?, — e pyeti buzagaz.

Flora e vështroi me vëmendje dhe ngriti supet.

— Më dukeni tepër i njohur, po se nga?!...

— Të pëlqejnë ende kasatat?, — pyeti kamerieri, gjithmonë buzagaz.

— Aaa!, — u kujtua ajo, duke i rënë ballit. — Jeni akulloreshitësi ku blinim gjithmonë kasata!

— Dora vetë. E shikon, të mbajta mend, megjithëse atëherë mbaje bishtaleca dhe ishe ende çupërlinë. Tani

qenke bërë nuse. I fejuari? — Ai u kthye nga Arbeni.

— Zëre se!, — ia priti tjetri duke buzëqeshur.

— Ishte klientja më e rregullt, sidomos të shtunave dhe të dielave nuk mungonte kurrë!, — e sqaroi kamerieri. — Shpesh të shoqëronte një djalosh që të ngjiste!, — iu kthye Florës.

— Vëllail!, — tha ajo. — Sa herë vinte në Tiranë, më gostiste me kasata. Ju i përgatisnit aq mirë!...

— Urdhëroni në verë në lokalin tonë dhe do të keni rastin t'i shijoni përsëri!, — premtoi ai. — Po vëllanë ku e ke tani?, — e pyeti Florën.

— Këtu, bashkë jetojmë!

— Bëni të fala. S'është dukur ndonjëherë këtej, se do ta kisha njohur. Kam kujtesë të fortë unë!

— Epo, është i martuar tani!, — bëri shaka Arbeni. — Muhabetet që ka me të shoqen, i bën në kuzhinë, pranë zjarrit.

— Eh, more djalë, ku ka më bukur se të përtërish kujtimet e vjetra!, — tha kamerieri.

— Në paç ç'të përtërish!, — vërejti Flora.

Kamerieri buzëqeshi, bëri një përkulje profesionale dhe u largua, duke vështruar përreth, i gatshëm për t'u plotësuar çdo kërkesë klientëve.

— Ne do të vijmë edhe në dimër këtu, se kemi ç'të kujtojmë, apo jo, Florë?, — pyeti Arbeni, duke mbushur gotat me birra.

— Gjatë këtyre vjetëve të fakultetit shpresoj se po!, — iu përgjigj ajo. — Pastaj...

— Pastaj në ndonjë bar-bufe kantieri!, — plotësoi ai buzgaz.

— Si ajo ku më pe herën e parë!, — qeshi Flora. — Edhe ato kanë bukurinë e tyre. Të duket vetja si në një familje të madhe, se shumica e njohin njëri-tjetrin.

— E bukura ndodhet kudo, veç të dish ta gjesh!, — vërejti Arbeni.

Ah, sikur të emërohemi të dy në një kantier!, — tha ajo, duke përplasur gëzueshëm pëllëmbët.

- Pse, dyshon për këtë?!, — brofi ai.
- Ajo rrudhi supet dhe uli kokën.
- Dyshon tek unë, apo te vetja?, — nguli këmbë Arbeni.
- Tek asnjëri!, — tha ajo, duke çuar kokën me vrull. — Përndryshe, s'do të isha sonte këtu, me ty.
- Në mëngjes do të dalim bashkë në punë!, — i shprehu ëndërrimet Arbeni, duke tretur vështrimin diku larg. — Tek objekti im ose yti, cili të jetë i pari, do t'i japim dorën njëri-tjetrit. Pastaj do të ngjitemi në skelë...
- Sa më pëlqejnë skelat e larta!, — e ndërpreu Flora. — Shikon gjithë kantierin si në pëllëmbë të dorës dhe mbushesh me krenari që ti me shokë keni ngritur gjithë ato objekte. Njerëzit poshtë duken sa një gisht, makinat si lodra fëmijësh, kurse shtëpitë si kuti. Atje lart e ndien veten më të fortë e më të guximshme...
- Nuk të merren mendtë?
- Tani, jo, jam mësuar. Herën e parë u turbullova aq shumë, sa do të isha rrëzuar, po të mos më kishte mbajtur një mjeshtër që e kuptoi. Ai më këshilloi të stërvitesha dalngadalë. Fillova qysh atë pasdite, kur ikën punëtorët, se më vinte turp. Pas ca kohe ngjitesha me aq shkathësi, sa çuditeshin të gjithë. Madje më vunë nofkën «ketri».
- Oh, sa bukur ta paskan gjetur!, — qeshi Arbeni.
- Se mos e përhapësh! Këtu s'ma di njeri, po në kantier rrallëkush më thërriste ndryshe.
- Për shëndetin e «ketrit»!, — bëri shaka ai, duke ngritur gotën.
- Ah, ç'm'u desh që fola!, — u pendua ajo. Tringëllinë gotat. Në banak shfryu aparati i ekspresit. Nga skaji i sallës u dëgjua e qeshura e shkujdesur e një vajze. Kamerieri, me tabaka në dorë, shkoi të çonte porositë diku. Arbeni e ndoqi me sy. Ndërkohë Flora i vuri në pjatë copën e saj të mishit që i kishte mbetur, duke i thënë:
- Merre këtë. Unë nuk dua më.

— Mos na bëj naze tani!, — e ngacmoi Arbeni.
— Ti e di sa nazelie jam unë në të ngrënë, po duhet të lë pakëz vend edhe për darkën që më pret në shtëpi!, — iu përgjigj ajo.

— Siç duket, gatuan mirë kunata jote dhe nuk do të prishësh oreksin!.

— Për atë punë, shoqe veten ka!

— Ishalla ke mësuar diçka prej saj!, — qeshi ai.

— Mos je edhe ti qejfli gjellësh, si Petroja?

— Qëllim në vetvete s'e kam, por kush është ai që s'i preferon gjellët e shijshme?! Tani e kuptoj pse yt vëlla ka filluar të majmet!

— Nga ajo anë s'është keq, por ç'e do..., — tha Flora, duke tundur kokën e pezmatuar.

— Çfarë?

— Ai ka ndryshuar, Arben, dhe më duket sikur po ndryshon dita-ditës!

— Helbete, ndryshojnë njerëzit!

— Puna është që të ndryshojnë për mirë, kurse ai...

Flora heshti e menduar. Arbeni nuk e ngau më tej atë bisedë. Vështroi orën dhe tha se duhej të çoheshin.

— Sa është?, — pyeti ajo.

— Po shkon tetë!

— Vërtet?! Unë kujtoja se nuk do të ishte më shumë se shtatë. Si na fluturoi koha!

— Si gjithmonë kur jemi bashkë!, — buzëqeshi ai.

— E di ç'më tha dje një shoqe?, — u kujtua ajo.

— «Si nuk mërziteni ju të dy, duke qëndruar kaq shumë me njëri-tjetrin?».

— Ajo nuk e ditka ç'është dashuria!, — vërejti ai.

Pas pak ata zbrisnin në shtegun që dredhonte mes plepave. Dëgjonin si thërrmoheshin gjethet e thata nën hapat e tyre. Nuhatnin me ëndje kundërmimet e freskëta të natës. Ndienin frymëmarrjen e njohur të njëri-tjetrit. Vështronin panoramën e ndriçuar të qytetit që shtrihej përballë.

— Sa shumë dritare!, — tha Flora, duke shëtitur dorën si me përkëdheli mbi qytet. — Pas secilës prej tyre ka njerëz, ka jetë, mendime, dashuri, shqetësime, gëzim...

Ai e afroi pranë vetes dhe iu duk sikur ndjeu qysh rrihte jeta në trupin e saj. Sytë e tyre ishin plot dritë. Rreth e qark kryqëzoheshin hijet e natës. Përballë tyre vezullonin drita të panumërta.

6

Kur u afruan te shtëpia, Flora u përshëndet me Arbenin dhe ngjiti me shkathtësinë e zakonshme shkallët e apartamentit. Në katin e dytë, pa disa fëmijë që luanin ende. Njëri prej tyre kishte në dorë një copë qymyr dhe po shkarraviste muret. Flora ia hoqi nga duart qymyrin dhe e qortoi rreptë.

Me të arritur në katin e tyre, ndërsa po hapte derën e apartamentit, krisi dera kundruall.

— Mirëmbërëma, shoqja Ksanthipi!, — e përshëndeti enkas me zë të lartë Flora.

— Oh, ti qenke?!, — Ksanthipi nxori kokën. — Kujtova se ishte Ani.

— Ajo ka ardhur, besoj. Dëgjohen që këtu hapat e saj nëpër shtëpi. Keni ndonjë nevojë, doni ta thërrres?

— Jo, falemnderit, desha vetëm t'i uroj mirëseardhjen!, — tha komshia dhe u mat të futej brenda.

— Shoqja Ksanthipi!, — e ndaloi Flora.

— Urdhëroni?!

— Djali juaj po shkarraviste muret e shkallës. Edhe vetë ishte nxirë, si mos më keq.

— Ah, shejtani, sa i prapë që është!

Flora mbylli derën, la çantën dhe pardesynë në korridor dhe hyri në dhomën e bukës. Anin e gjeti duke përgatitur darkën.

— Si shkove sot?, — e pyeti, duke vënë përparësen që ta ndihmonte.

— Lëre mos e nga!, — u ankua ajo. — Pata shumë vizita. Ma morën shpirtin. Vijnë kot, për hiçgjë. Njëra ankohet se nuk i ka oreks fëmija, tjetra se i kollet natën e kështu me radhë.

— Mirë bëjnë që vijnë. Sëmundja duhet luftuar që në shenjat e para, apo jo?, — vërejti Flora duke qeruar një patate.

— Ashtu është. Por ama, kur mbaron orari i vizitave, më merren mendtë nga lodhja.

— Çdo punë ka lodhje, moj Ani. Sidoqoftë, profesioni juaj është i bukur.

— Ej, posi! Të jesh një ditë tek unë dhe të shikosh se ç'bëhet! S'ta dinë as për falemnderit, pale! U mbetet hatri kot së koti. Më mirë të kisha mbaruar ekonomkun, kot e bëri im atë...

— Pse, nuk hyre me dëshirën tënde në mjekësi?!, — u habit Flora.

— Jo, unë fillova ekonomkun, por babai nguli këmbë të kaloja në mjekësi, se qenkësh zanat më i mirë. Plasi, sa ma ndërroi. Ta dija kështu...

— Po ty vetë, ç'do të të pëlqente?, — u bë kuresh-tare Flora.

Ani ngriti supet dhe mendoi një hop.

— Ndoshta kimiste... Edhe ekonomistë s'është keq. S'ke punë me njerëzit, që, sidomos kur janë të sëmurë, bëhen grindavecë... Sidoqoftë, do të doja një punë më të lehtë, që të më linte më shumë kohë për punët e shtëpisë.

— Ç'flet kështu, Ani?!, — e qortoi Flora. — Pse, punët e shtëpisë qenkan kryesoret, nga këto varet profesioni dhe qëllimi i jetës?!

— Ke hak ti, se nuk e di ç'është familja!, — tha Ani, duke buzëqeshur me ironi. — Pa e bërë këtë, ç'do hanim për darkë? — Ajo tregoi kokrrën e patates, të qeruar përgjysmë. — Apo të shkonim në restorant, si disa? Dëgjo mua, Flora, shtëpia ka nevojë për amvisë,

që ta presë dhe ta përcjellë burrin me buzë në gaz, që t'ia shtrojë dreqën dhe darkën të ngrohtë dhe të gatuar mirë, që të rritë dhe të edukojë fëmijët...

— Ky problem nuk është i pazgjdhshëm!

— Qysh, duke u robtuar kështu?!, — Ani hapi krahët duke vështruar veten me keqardhje.

— Të punojnë të dy palët edhe në shtëpi, secili për atë që i vjen më tepër ndoresh!, — tha Flora.

— Ha-ha!, — qeshi Ani me shpoti. — Këto thuhën nëpër mbledhje, por nuk ndodhin në jetë. E ke parë tët vëlla sa bëhet merak për punët e shtëpisë?

— Vetë e ke mësuar kështu. Po që dashuria dhe mirëkuptimi në një familje, të gjitha bëhen, çdo vësh-tirësi kapërcehet!, — tha Flora.

— Dashuria?!... Gjepura! Dashuria është si vesa e mëngjesit, ndrit pakëz dhe... Me kohë, fjalët e bukura, vështrimet e zjarra dhe premtimet i merr era. Jeta është ndryshe nga ç'e mendon ti, Florë.

— Më vjen keq, po në asnjë mënyrë nuk pajtohem me mendimet e tua!, — tha vajza.

— Pajtohesh, s'pajtohesh ti, jeta s'pyet!, — vërejti Ani duke ngritur supet.

Një copë herë ato heshtën. Dëgjoheshin vetëm zjarri që kërciste në sobë dhe zhurma e patateve që hidhnin në kusi.

— Ani, ti e dashuroje Petron para martesës?, — pyeti dikur Flora.

— Më pëlqente!, — u përgjigj ajo.

— Po sikur ndërkohë të të kishte dalë një rast tjetër, më i mirë, do ta kishe shkëmbyer?

Ani ngriti sytë dhe e vështroi në një mënyrë, sikur deshi t'i thoshte: «Ç'janë këto pyetje?!».

— Mundet!, — tha pastaj.

— Si do ta dalloje një rast tjetër, më të mirë, nga pamja, nga pozita, nga kamja, apo nga gjykimi i të tjerëve?, — pyeti Flora, me një farë ironie.

— Ama edhe ti, ç'ia paske ngenë!, — u acarua tjet-
ra.

— Më trego të drejtën, a ke dashuruar ndonjëherë?,
— nguli këmbë Flora.

Ani e vështroi shtrembër, pastaj shkoi të merrte kripën.

«A kam dashuruar ndonjëherë?, — pyeti veten, duke kripur patatet. — Ka rastisur të më pëlqejë edhe mua ndonjë djalë, po kurrë nuk kam shkuar më tej se një vështrim ose një bisedë e shkurtër, si edhe me Petron. Vetëm kur isha në vitin e tretë, sa s'rashë brenda me Agronin. Sytë e tij sikur më shponin tejte; prekja e tij më shkaktonte mornica të ëmbla; kur s'e shikoja disa ditë, më bëhej një humbëtirë përbrenda, por megjithatë, kurrë s'pranova t'i shkoja në takim... Mirë kam bërë, vallë?»

— Pashë ç'fituan ato që dashuruan!, — tha pastaj, sikur deshi t'i përgjigjej edhe vetes. — Dhe, martesë, me dashuri ose njohje qoftë, është çështje fati. Madje, martesat me njohje janë më të qëndrueshme, se nuk fillojnë me iluzione të mëdha, pra s'kanë as deziluzione të tilla.

— Zhgënjimi mund të vijë pas një pasioni kalimtar, ndoshta!, — tha Flora. — Mendoj se dashuria që mbështetet sa në ndjenjë, aq edhe në njohjen e thellë të njeri-tjetrit, nuk shuhet dhe nuk sjell zhgënjime.

— Gjepura, punë librash!, — vërejti Ani me mosbesim. — E si mund ta dallosh dashurinë nga pasioni kalimtar, ka ndonjë termometër për këtë?!

— Jeta sjell plot rrethana, në të cilat kjo provohet!, — tha Flora.

— Po në dalsh e gënjer?

— Kryesorja është që njeriu të niset me qëllime të pastra, të ndershme. Në ndodhtë, keq është, e dhimbshme është, por s'ke ç'i bën, edhe dashuria ka rreziqet e saj.

— Mua s'më ka pëlqyer kurrë të rrezikoj!, — tha Ani.

— Po të arsyetonim kështu, s'duhej të dilnim as në rrugë, se mund të na ndodhte ndonjë aksident!, — ia priti Flora.

Ani buzëqeshi, siç buzëqeshet me papjekurinë e një kalamani.

— Dashuria është si loja me zjarrin!, — tha pastaj. — Mendja e kthjellët gjykon kurdoherë më mirë se mendja e turbulluar nga pasioni.

Ajo fliste së larti, me një farë shkujdesjeje, sikur deshi të nënvizonte se këto gjëra ishin aq të njohura dhe të vërtetuara nga jeta, sa ishte e tepërt t'i diskutoje.

— Sidoqoftë, unë s'do ta lidhja kurrë jetën me një njeri që s'e dashuroj!, — përfundoi Flora, duke i vënë kapakun kuisë së gjellës.

«I ka marrë koka erë!», — mendoi Ani dhe vendosi të mos ia zgjaste.

— Na gjej ndonjë muzikë të bukur, — i tha, — se këto biseda janë pesë me hiç. — Pastaj zuri vend në divan.

Flora ndezi radion dhe nisi të vërtiste rrotëzën e valëve, por mendjen s'e kishte aty. Ndiante një farë zemërimi të papërcaktuar dhe i dukej sikur nuk i kishte thënë të gjitha. E vështroi të kumatën me bishtin e syrit. Flokët gjatë e të zinj i kishin rënë pak përmbi sy. Nën mjekër i qe formuar një gushë e vockël, e kolme. Gjithë qenia e saj rrezatonte vetëkënaqësi.

«Flet përçart kjo vajzë!, — vazhdonte të mendonte Ani duke shfletuar revistën «Ylli». — Me kokën që ka do ta marrë lumi».

Flora, me bërrylat mbi tryezë dhe kokën në pëllëmbë, vështronte orenditë aq të njohura të kuzhinës dhe mendonte për jetën monotonte të familjes. Ajo e merrte me mend se ç'do të ndodhte më tej. Ja, do të kërciste brava e derës së jashtme dhe do të hynte Petroja, ndoshta me një pamje disi të lodhur. Ani do t'i uronte mirëseardhjen me buzë në gaz dhe do të ngutej të tregon-te ndonjë shenjë kujdesi për të. Dhe mbrëmja do të vazhdonte si të djeshmen, si të pardjeshmen...

Duke menduar kështu, asaj iu duk sikur muret e kuzhinës u afruan së tepërmi dhe po e ndrydhnin mi-dis tyre. Brofi në këmbë.

— Ç'pate?!, — e pyeti Ani.

— Asgjë, më pihet ujë!

Ndërkohë mbërriti Petroja dhe gjithëcka rrodhi ashtu siç e pat menduar Flora. Biseduan një copë herë për cikërrimat e ditës, pastaj u shtruan në tryezë dhe hëngrën në heshtje. Pasdarke ai zuri qoshen e tij të zakonshme dhe ndezi cigaren. Ato të dyja ngritën tryezën dhe lanë enët.

— Pse je kështu, i menduar, Petro?, — pyeti Ani dikur.

— Hë, si the, i hutuar?, — u përmend ai.

— I menduar, thashë!

Petroja vuri re kafënë që po ftohej dhe e rrufiti gjer në fund, pastaj thithi me afsh cigaren.

— Sot patëm një mbledhje në ministri!, — tha. —

— Gjatë pushimit, ministri ma hodhi fjalën larg e larg, nëse dëshiroj të transferohem në uzinën e re që po ndërtohet.

— Ku?, — e ndërpreu Ani, që iu duk sikur i ndaloj zemra.

— Këtu, në Tiranë!

— Gjene mirë!, — Ani mori frymë e lehtësuar. — Thua ta kenë vendosur?

— Nuk e besoj.

— Po ti, ç'i the?

— Se jemi të gjithë ushtarë!, — buzëqeshi ai. — E ç'do t'i thosha tjetër?...

— Më e madhe është rroga atje?

— Nuk e di, kjo s'ka rëndësi, por uzina është më e rëndësishme. Sigurisht, në fillim do të ketë disa telashe...

— Ç'je i marrë!, — e ndërpreu Ani. — Harrove sa u rropate për t'i vënë punët në vijë këtu ku je, tani u dashka t'ia fillosh përsënjëzaj gjetkë! Të ishte fjala për ndonjë vend më të mirë, në Universitet për shembull, hajde de, por të biesh nga shiu në breshër!... Rri, more burrë, vështro shëndetin dhe hallet e familjes sate!

— Mirë, mirë, se mos u vendos gjë!, — tha Petroja duke marrë gazetën.

Flora e vështroi me ngulm të vëllanë. Fytyra e tij iu duk e ftohtë, e vetëkënaqur, krenare. Ajo ndjeu se i theri diçka përbrenda.

Lavjerësi i sahatit të murit lëkundej sa majtas-djathtas, dhe tiktaku i tij sikur i theksonte heshtjen e monotoninë.

— Natën e mirë!, — tha Flora dhe doli nga dhoma. Ani u çua dhe vendosi pjatat e kulluara në raft.

— Sot ishte Ksanthipi për vizitë!, — tha dikur ajo.

— Ajo llafazania?, — vërejtj Petroja, pa e ndërprerë leximin.

— Llafazane, llafazane, por të tillat të marrin në qafë. Diç më tha për Florën.

— Çfarë?, — u shqetësua Petroja, duke flakur gaze-tën.

— E paskësh parë njëditëzaj në kinema me një djalë, shtatë gjer më nëntë!

— E pastaj, ç'të keqe ka?!, — u qetësua ai.

— Jo, s'është gjë e madhe, por ajo më tha se e ka parë edhe herë të tjera me të. Bile, disa herë ai e paska shoqëruar deri këtu, te hyrja e apartamentit.

— Ashtu?!, — u vrenjt Petroja. — Flora nuk është e mitur, as vajzë pa mend!, — theksoi ai, duke u shtirë sikur nuk u dha rëndësi atyre fjalëve.

— Sidoqoftë, duhet këshilluar nganjëherë, se vajzë është!

— Mirë, mirë!, — ia preu ai. — I mbarove punët?

— Ja, edhe pak. Po deshe, shko e bjer.

— Po shkoj.

Ai fiku cigaren dhe u ngrit.

7

Petro Lisi brofi i habitur kur dëgjoi atë trokitje të fortë. S'pati kohë të thoshte «hyr», se dera u çel sakaq me vrull dhe ai pa inxhinier Andrenë që iu afrua tryezës së tij, me një pamje të acaruar. E shoqëroi me sy dhe priti që ai të fliste.

— Sot morëm urdhër që të pezullojmë prodhimin e pjesëve të ndërrimit të automjeteve dhe të fillojmë disa artikuj për tregtinë!, — tha Andrea, pa e fshehur dot nervozizmin.

— E pastaj?!, — u shtir fare i qetë Petroja, sikur bëhej fjalë për diçka të logjikshme.

— Si, qenkeni në dijeni të këtij urdhri?!, — u habit Andrea. — Kurse unë kujtova se ata të degës së planit, duke mos i ditur mirë pasojat...

— Të tilla çështje nuk janë në kompetencat e degës së planit!, — vërejti Petroja.

— S'po më bëhet t'u besoj veshëve!, — u mundua të buzëqeshte Andrea, siç buzëqeshet për një absurditet.

— Pse, të lutem?!

— Sepse ju, si inxhinier, e dini fort mirë ç'pasoja sjell kjo ndërprerje e beftë e procesit, për të filluar një tjetër, krejt të ri. Një sasi e madhe e pjesëve të ndërrimit janë pothuaj të gatshme, u ka mbetur vetëm procesi i fundit. T'i lësh në mes do të thotë...

— Ne s'prodhojmë sallam, që të prishen!, — vuri buzën në gaz Petroja.

— Por kjo do të sjellë shumë ndërlikime!, — nguli këmbë Andrea. — Reparti do të dalë me plan mujor të porealizuar do të ulet në mënyrë fiktive realizimi mesatar i normave të punëtorëve, paga e tyre...

— S'kanë për të humbur asnjë qindarkë, do t'i marrin pesëmbëdhjetëditëshin tjetër!, — tha Petroja.

— Sidoqoftë, kjo...

— A e di ti sa për qind e kemi plotësuar kontratën me tregtinë?, — e ndërpreu Petroja, me shpresë se kjo pyetje do ta vinte tjetrin me shpatulla për muri.

Andrea u step një çast dhe ngriti supet.

— Këto punë i di Selimi dhe ju të drejtorisë!

— Ta them unë!, — vazhdoi Petroja. — Zero për qind. Kurse pjesët e ndërrimit të automjeteve, shtatëdhjetë për qind. A është e drejtë kjo, disa të nënës e disa të njerësisë?!

— Pse e kemi lejuar këtë shpërpjesëtim, shoku krye-inxhinier? Ne zbatojmë ato porosi që na planifikohen!

— Si i zbatoni, se?, — rrudhi vetullat me qortim krye-inxhinieri.

— Mundohemi sa më mirë. Ju e dini, kolektivi i re-partit tonë ka disa muaj që punon i sforcuar që t'ia dalë ndanë me nder, megjithëse...

— Nuk ia ka arritur!, — plotësoi Petroja, me një buzëqeshje të lehtë ironike.

— ...megjithëse ju vazhdoni të na ngarkoni prodhimin e artikujve më të vështirë!, — shtoi Andrea, i zymtë.

— Epo, helbete, ju keni punëtorët më të kualifikuar!

— Por edhe teknologjinë më të prapambetur!

— Përsëri do ta nxjerrësh te riorganizimi, ë?, — ia bëri Petroja, me një ton tallës.

— E pse jo?

— Aman, more vëlla, si nuk u lodhët duke i rënë kësaj këmbane?!, — buzëqeshi Petroja. — Mos bre, mos e bëni çështjen e riorganizimit gozhdë për të varur përgjegjësinë. Unë e kam projektuar dhe ngritur vetë atë re-part, e kam ndjekur vazhdimisht dhe ia di si të mirat, ashtu edhe të metat. Mund t'i duhet ndonjë axhustim, quajeni riorganizim në daçi, por kjo s'është kaq e ngutshme sa ç'e bëni. Megjithatë, do t'jua bëjmë qejfin!

— S'është punë qejfi!, — u vrenjt Andrea.

— Mirë, mirë, do t'jua plotësojmë kërkesën, atëherë!, — pranoi duke buzëqeshur Petroja. — Ja, e kemi planifikuar për shqyrtim në këshillin teknik dhe do të vendosim si të jetë më mirë. Të shohim se ç'histori tjetër do të na nxirri pastaj...

— E planifikuat në nëntor, *shtyhu pa të të arrij!*, — vërejti Andrea.

— E kuptoj padurimin tuaj, por problemet që do të shqyrtojmë në tetor, s'janë më pak të rëndësishme, më beso. Me një të shtënë s'do t'i rrëzojmë të gjitha!

— Ne mendojmë se ky problem s'duhet zvarrisur, bile mund të thirrej një mbledhje e veçantë e këshillit teknik.

— Ju gjykoni duke pasur parasysh vetëm hallet e repartit tuaj!, — tha Petroja disi i nervozuar. — Na e lini neve të gjykojmë për të gjithë uzinën, përderisa e kemi këtë detyrë.

— Po, po, ju e keni këtë kompetencë, s'jua mohojmë!, — vërejti Andrea disi ironik. — Megjithatë, se themi edhe ne mendimin tonë, nuk bëjmë gabim, bile e kemi për detyrë... Por, le të kthehemi te çështja për të cilën kam ardhur. Do të ishte mirë që ato pjesë ndërrimi, të cilat janë gjysmë të gatshme...

— Të lutem, s'do të bëjmë pazarllëk me urdhrat!, — e ndërpreu kryeinxhinieri disi rreptë.

— S'është fjala për pazarllëk, po për arsyetim!

— Ç'arsyetim, të lëmë nevojat e popullit pa plotësuar?

— S'them këtë, por ka mundësi që disa prej artikujve të tregtisë t'u ngarkohen reparteve të tjera, të cilat kanë disa kapacitete të lira, kurse ne të përfundojmë njëherë pjesët e ndërrimit që kemi në dorë, pastaj...

— Punë që s'bëhet, zbatoni urdhrin!, — tha Petroja dhe u ngrit më këmbë, duke dashur të tregonte se bisedën e quante të mbyllur.

— Atëherë, ju lutem, të vini vetë e t'i sqaroni punëtorët!, — kërkoi Andrea, duke përballuar vështrimin e zemëruar të kryeinxhinierit.

— Sqaroi ti, s'je kot përgjegjës reparti!, — bubulloi Petroja. — Apo do t'i nxjerrësh me dorën e tjetrit gështenjat nga zjarri?

— Përderisa nuk jam i bindur vetë, s'kam si bind të tjerët!, — arsyetoi Andrea, pa luajtur nga vendi.

— Mirë, do të vij vetë ta kryej këtë detyrë tënden, veç kur të kem kohë, se s'jemi vetëm me repartin tuaj!, — tha Petroja me shpoti. — Ju merrni të gjitha masat tekniko-organizative që urdhri të zbatohet siç duhet. Nesër në orën dhjetë do të më raportoni.

— Jua përsëris edhe një herë se është një urdhër i padrejtë!, — nguli këmbë Andrea, duke u muduar ta përmbante zemërimin në kufijt e mirësjelljes.

— Zbatojeni, pastaj kundërshtojeni ku dhe si të doni!,

— ia priti Petroja, duke u mëshuar fjalëve gjithë inat. Andrea doli me hap të rëndë, i ngrysur dhe kërcënues, si një rë para furtunës.

Me t'u mbyllur dera, Petroja u lëshua në karrigen e vet dhe mbeti një copë herë i stepur, me mendime të turbullta. Ndërsa zemërimi po i fashitej iu rritën hezitimi dhe dyshimet shqetësuese për vendimin që kishte marrë. Por tani s'mund të tërhiqej, përndryshe do të bëhej qesharak. Brofi nga karrigia, nisi të vërtitej nëpër zyrë, piu dy cigare njëren pas tjetrës, pastaj kërkoi në telefon shefin e shpërndarjes. I thanë se ndodhej në qytet. Ai e përfytyroi duke pirë një ekspres të fortë të Maria dhe ndjeu një farë inati kundrejt tij, sikur ai të ishte shkaktari i gjithë atij pështjellimi. Mori pardesynë, doli rrëmbyeshëm nga zyra dhe zbriti me nxitim shkallët. Iu mënjanua repartit të dytë dhe hyri në repartet e tjera, duke u shtirur sikur bënte një vizitë të zakonshme pune.

Pyeti për realizimin e detyrave, për nevojat dhe kërkesat që kishin, pastaj e sollti fjalën rreth mundësisë së ndonjë tejkalimi. U bind se çdo repart kishte rezerva dhe kapacitete të lira.

«Duhet t'ua ngarkojmë të gjithëve prodhimet për tregtinë!, — vendosi me vete. — Kështu garantohet realizimi i planit, si edhe i kontratës. Megjithatë, atyre të repartit të dytë s'do t'ua ndryshojmë urdhrin, e as s'do t'u zbrezim detyrën. T'u mblidhen ca rripat, se na nxorën sytë!...»

Ndërsa po kalonte nëpër repartin e fundit, i zunë sytë xha Vasilin, i cili diç po punonte në banakun e axhusterisë, fort i kredhur në punë.

«Akoma s'i kemi shkuar për vizitë!», — qortoi veten, duke kujtuar bisedën e fundit me të.

Më fort për t'i bërë qejfin, iu afrua, e përshëndeti me përzemërsi dhe e pyeti gjatë për shëndetin e tij dhe të familjes. Pastaj u interesua se çfarë po bënte, aq i përqëndruar.

Xha Vasili u gjallërua dhe nisi t'i tregonte me hollësi se po prodhonte një pajisje të re, e cila e ngrinte

mjaft rendimentin në repartin e tyre. Petroja e dëgjonte me mirësjellje dhe goja me interesim, por në të vërtetë mendjen e kishte gjetiu. Dikur mjeshtri e vuri re këtë dhe heshti menjëherë.

— Hë, më tej?, — u përmend Petroja.

— Ec e shihe kur ta përfundojmë, po deshe, se sot s'ia paske ngenë!, — tha xha Vasili i vrenjtur.

— Jo, jo, kam kohë, trego më tej!, — iu lut Petroja.

Mjeshtri u ul në banakun e axhusterisë dhe filloi punën përsëri.

«Hej, ç'plak i zorshëm!», — tha me vete Petroja, mbasi u nda prej tij.

Para se të kthehej në zyrë, u ngjit në sallën e byrosë konstruktive. Përgjegjësi i byrosë u çua dhe iu afrua në majë të gishtave.

— Gati e keni, kryeinxhinier!, — iu përgjigj ai, duke i çmbështjellë para syve një fletë vizatimi. — Gjendjen e repartit të dytë e keni të pasqyruar me të gjitha imtësitë, asgjë s'ju mungon.

— Falemnderit!, — tha Petroja, e mbështolli vizatimin dhe doli.

Me të arritur në zyrën e vet, mbylli derën nga brenda, shtroi mbi tryezën e madhe të mbledhjeve vizatimin dhe iu vu punës.

«Ta shohin ata bilmezë se si bëhet studimi i riorganizimit!, — tha me vete, ndërsa një buzëqeshje krenare i çeli fytyrën. — Kot s'u thinjëm në këtë uzinë!... Do t'ua djeg letrat në dorë!...»

Punoi me ngulm, me frymëzim, bile harroi të zbrishte në mensë për drekë. Goja iu bë shkrumb nga cigaret e shumta që piu, i dhimbte mesi duke qëndruar i përkulur mbi vizatim, por s'iu nda punës gjersa dëgjoi sinjalin e shkëmbimit të turneve. Atëherë iu kujtua se e kishte lënë që të takoheshin me Anin.

Të shoqen e gjeti duke pritur para vitrinave të Mapos. Që larg shquhej se e kishte humbur durimin.

— Si s'erdhe një herë në orar, xhanëm!, — e qortoi Ani.

— Eh, moj grua, akoma s'u mësove me punët e mia!
— tha ai, me një ton pajtues. — Se mos e kam veten në dorë! Ja, në minutën e fundit të del një ngatërrësë a një punë që duhet zgjidhur dhe...

— Je vonuar pothuaj gjysmë ore!, — u ankua ajo.
— Një grua e ka të vështirë të presë kaq. Ndonjë gojëlig...

— Ama për këtë bëhesh merak?!, — buzëqeshi Petroja dhe i propozoi të shkonin në një pasticeri. — Më është tekur, për një ekspres, — tha.

Lokali ishte i qetë dhe kamerierja u vajti menjëherë. Petroja porositi, ndezi një cigare dhe ia nguli sytë një tabloje të madhe që ndodhej në murin përballë. Ishte një pamje nga parku i madh i kryeqytetit: një djalosh që peshkonte buzë liqenit plot reflekse të purpurta dhe përtej kodrinat e gjelbëruara, pastaj mali i Dajtit, gjithçka e kredhur në dritën e kuqërreme të perëndimit. Ndjeu mall për çaste të atilla prehjeje dhe qetësie.

«Kemi kohë pa shëtitur andej, duhet të shkojmë ndonjë të diel!», — mendoi.

Kamerierja solli porosinë.

— Këtu mbajnë gjithmonë torta të freskëta!, — vërejti Ani.

— Ëhë!, — miratoi Petroja i shkujdesur.

Klientët filluan të shtoheshin. Bashkë me ta shtoheshin bisedat, tringëllimat e qelqurinave, lëvizjet e karrigeve dhe tymi i duhanit. Në tri tryezat aty pranë, të vendosura njëra pranë tjetrës, po festohej një fejesë. E sapofejtuara, që pikasej se ishte e vetmja femër e re dhe me buzë të paskuqura, rrinte me turp dhe mezi hante diçka prej ëmbëlsirës që kishte përpara.

Anit iu kujtua fejesa e saj. Pastaj i tërhoqi vëmendjen dikush që iu afrua banakut për të kërkuar cigare.

— Petro, e shikon atë djaloshin atje?, — tha, duke i rënë të shoqit lehtë me bërryl. — Ja, atë me flokë të zinj dhe pardsy gri.

Ai ktheu kokën dhe e vështroi me indiferentizëm.

— E pashë. E pastaj?

— Është Arbeni, ai studenti që shoqërohet me Florën.

— Ku e njeh ti? Ta ka treguar Ksanthipi?, — pyeti ai duke buzëqeshur.

— Unë i kam parë vetë. Dje i ndesha ballë për ballë. Kujtova se mos u vinte rëndë dhe ktheva kokën, po motra jote s'deshi t'ia dinte, bile më foli.

— Pa shiko, pa shiko!, — tha Petroja, duke tundur kokën disi i habitur. — Ndoshta i ka dhënë fjalën se do ta marrë!

— Posi, në atë krah fli ti! Ti s'bën aspak mirë që s'e këshillon.

— Flora është e rritur tashmë dhe s'mund të ndërhyj vend e pa vend në jetën e saj!, — tha Petroja. — Megjithatë, do ta bisedoj.

— Të bisedosh, posi!, — nguli këmbë Ani. — Kanë qenë më të pjekura se ajo dhe kanë bërë proçka. Ai fare lehtë mund t'i kthejë krahët ndonjë ditë, se djalë është dhe s'njolloset, kurse jot motër... Turpi të zë edhe ty, pastaj.

— Mirë, mirë!, — ia preu ai dhe ktheu kokën në anën tjetër, për ta mbyllur atë bisedë.

Thirri kamerieren, pagoi dhe e ftoi Anin të dilnin. Ajo e kuptoi se i shoqi ishte i shqetësuar.

«Fundja, për të mirën e saj fo!a!», — mendoi.

— Ku do të shkojmë së pari, te Zenuni, apo te Hajredini, që ka dhjetëvjetorin e djalit?, — e pyeti të shoqin, sapo dolën jashtë.

Petroja bëri një grimasë padurimi.

— Po më deshe fort, mos më detyro të bëjmë vizita sot!, — tha ai, sikur i lutej t'i falte një dënim. — Jam kaq i lodhur... Sikur të shëtisnim pak.

— Ne kështu vendosëm, unë kam blerë edhe një dhuratë për djalin e Hajredinit, por, nëse vërtet je kaq i lodhur... — belbëzoi ajo e prekur.

— Vërtet jam, më buçasin veshët dhe më bëjnë sytë miza!, — u justifikua ai.

— Si të duash...

Ajo uli kokën dhe eci pranë tij, pa nxjerrë fjalë nga goja.

«Sa ka ndryshuar», — mendoi dhe një buzëqeshje e hidhur iu vizatua në cepat e gojës.

Hetoi me bisht të syrit të shoqin dhe vërejti se ai vështronte andej-këtej, i papërqëndruar dhe indiferent, sikur të mos kishte njeri në krah.

«Jo, jo s'është Petroja i parë, — tha Ani me vete e trishtuar. — Pse, vallë? Në fejesë dhe vitin e parë të martesës tregohej aq i dashur me mua. Shëtisnim ngado, s'linim shfaqje pa parë, shkonim në plazh, nëpër lokale dhe ishim përherë të gëzuar. Madje, ai më ndihmonte edhe në punët e shtëpisë, megjithëse nuk i vinte fare ndoresh... Mbrëmjeve bisedonte gjatë me mua, llogarisnim kursimet dhe bënim plane për ato që do të blenim për shtëpinë e re... Pa dyshim që ai më donte atëherë!...»

Ajo ndjeu se si trishtimi po i mbliidhej lëmsh në grykë. Duart i qenë ftohur dhe në trup i kalonin dallgë mornicash.

— Meqë s'po shkojmë për vizita, më mirë kthehemi në shtëpi, bën freskët!, — i tha Petros.

— Mirë, ti kthehu, ndërsa unë do të shëtis edhe pak, ndoshta takoj ndonjë shok, — tha ai. — Po të përcjell deri te stacioni.

Ajo e priti me padurim ardhjen e autobusit urban. Tani dëshironte të ikte ta më parë. Të paktën, të çlirohej nga përpjekja që bënte për të fshehur shqetësimin.

— Mirë ardhsh!, — i tha Petros dhe i ngjiti me ngut shkallinat e autobusit.

Lëshoi monedhat në tryezën e vogël të faturinos, zuri vend pranë xhamit dhe mbështeti ballin në të. Në krah të saj u ul një plakë e trashë, e cila vuri pranë këmbëve një torbë të madhe. Plaka dhe torba përhapnin një erë të veçantë, si prej sënduku. Ani u kuspullos në vendin

e saj, vështronte pa interes parakalimin e shpejtë të vitrinave të kalimtarëve dhe mendonte...

«...Edhe sivjet në plazh e vura re se Petros i pëlqente më tepër të bridhte me shokë; luante gjithë ditën letra me ta dhe, kur shëtiste me mua, sikur e bënte për detyrim. Mendova se do që diçka e përkohshme, por ja që s'doli ashtu. Ai po bëhet gjithmonë më i ftohtë, më i largët... Mos ka gisht ndonjë femër në këtë mes? Nuk e besoj, Petroja s'është nga ata. Megjithatë, kush ua di burrave!... Apo nuk më do më? Po pse?! Nuk i kam dhënë asnjë shkak për këtë. I kam qëndruar besnike, jo vetëm me vepra, por edhe me zemër. Asnjë fjalë e keqe s'është dëgjuar për mua. Shtëpinë ia kam mbajtur si s'ka më mirë. Nga hiçi, arritëm që s'na mungon gjë. Atij s'i kam lënë asgjë mangut. Farefisnin dhe shokët ia kam pritur dhe përcjellë si jo më mirë; motrën jo vetëm që ia pranova pa varur buzët, por kujdesem edhe për sjelljen e saj; fjalë e hidhur s'ka dalë kurrë nga goja ime. Atëherë, pse kështu?!... Ndoshta ngaqë s'kemi fëmijë. Thonë se ata i lidhin më tepër bashkëshortët. Po, ç'faj kam unë për këtë?! Ndoshta ai...»

Me këto mendime desh e kaloi stacionin e vet. Zbriti me ngut në çastin e fundit, kapërceu pa kujdes rrugën dhe i ngjiti me një frymë shkallët e apartamentit.

Hyri në apartament duke përplasur derën. Shkoi drejt e në kuzhinë. Ajo që e ftohtë dhe e lagësht. Tani ndihej më tepër kundërmimi i saj i veçantë. Çeli dritën. Edhe ndriçimi iu duk i ftohtë dhe i trishtuar. Zhveshi pallton dhe mbeti si e hutuar në mes të dhomës. Nuk dinte ç'të bënte.

Çeli deriçkën e sobës. E rrëqethi prekja e ftohtë e metalit të dorezës.

«Përsëri harrova të blej pishë!», — mendoi.

Ndezi zjarrin me vështirësi. Vuri gjellën mbi të. Lëmshi që i qe mbledhur në grykë u shndërrua në një trishtim të thellë, i cili po i përhapej në të gjithë trupin. I ndjeu gjymtyrët të ngathëta. U lëshua mbi divan. Duart

iu dergjën mbi prehër. Sytë i nguli në diçka të paqenë. Shtëpia i dukej bosh, fare bosh.

«Meqë s'kemi dashurinë, të paktën të kisha fëmijë!», — mendoi dhe ndjeu një keqardhje të thellë për vetveten, ndërsa lotët po i mjegullonin sytë.

8

Atë mbrëmje Ani tha se nuk ndihej mirë dhe shkoi të binte herët. Në dhomën e bukës kishin mbetur motër e vëlla, njëri përballë tjetrit. Flora rrinte në tryezë, me dispencën e rezistencës së materialeve të çelur përpara, por dukej që nuk e kishte mendjen aty.

Petroja, që po shfletonte «Hostenin», e vështronte herë-herë me bisht të syrit dhe mendonte se ishte një rast i volitshëm për të biseduar me të rreth fjalëve që kishte dëgjuar. U habit me vetveten kur kuptoi se druhej, i vinte zor ta fillonte bisedën.

«Vallë, ngaqë ajo është rritur, apo sepse jemi larguar nga njëri-tjetri?» — mendoi.

Dikur vendosi, ndezi një cigare dhe tha si shkarazi:

— Motër, më dukesh e shqetësuar këto kohët e fundit!

— Si the, e shqetësuar?!, — u çudit ajo, dhe ngriti sytë.

— Po, diç bluan përbrenda, diç ke!

— Ashtu është!, — psherëtiu ajo.

— Hë, si është puna?, — pyeti ai, me shpresë se ajo do të hapej vetë.

— Për ne shqetësohem, vëlla!

Heshti një çast, e vështrroi të vëllanë në sy dhe nuk diti nga t'ia fillonte.

— Për ne?!, — u habit Petroja. — Nuk të kuptoj!

— Petro, të kujtohet qysh vije të shtunave dhe më merrje nga konvikti i politeknikës?, — pyeti ajo, me një shkëndijë nostalgjie në sy.

— Si s'më kujtohet!

E çuditi kjo pyetje, por vendosi të priste se ku do ta nxirrte e motra.

— Po qysh e kalonim kohën bashkë, të kujtohet?

— Posi.

— Shëtisnim gjatë nëpër rrugët dhe parqet e Tiranës, bisëdonim bashkë për gjithçka shkëmbenim mendime për gjithçka... — Flora e kishte tretur vështrimi diku larg, sikur donte të shihte ato ngjarje. — Ti më qerasje me kasata, se më pëlqenin shumë, shkonim në kinema, i tregonim njëri-tjetrit çdo gjë dhe koha na fluturonte pa e kuptuar. Sa keq më vinte kur do të ndaheshim... Sa mirë ishte atëherë, Petro!, — tha Flora më në fund dhe pshe-
rëtiu thellë.

— Pse, tani nuk është?!, — u çudit ai. — Të mungon gjë?

— Jo, vëlla, asgjë nuk më mungon; madje kam më tepër nga ç'janë të domosdoshme, por...

— Por, çfarë? Ai e vështroi me kureshtje të motrën.

— Sikur kemi humbur diçka nga ajo lidhja jonë e dikurshme!

Petroja u mendua një copë herë, pastaj ngriti supet me çudi.

— Mua më duket se edhe tani kuptohemi përbukur!, — tha.

— Po, ne s'kemi bërë kurrë fjalë me njëri-tjetrin, por më mirë të grindeshim ndonjëherë sesa kështu, në këtë qetësi kaq të ftohtë dhe indiferente, që më sjell një farë ankthi.

— Ç'janë këto që thua, Florë?!

— Janë të vërteta, vëlla, të vërteta, megjithëse të hidhura. Prej kohe e ndiej këtë, por nuk ta kam thënë sé nuk isha e bindur plotësisht. Edhe sepse ti s'më jepje rast, më dukeshë i mbyllur, i larguar...

— Qysh kështu?!, — u vrenjt Petroja.

— Ja, kështu!, — Flora heshti, u përqëndrua një copë herë në mendimet e saj, pastaj nisi të fliste shtruar, qetë, por me dhembje: — Të kujtohet, Petro, se dikur ne i tregonim njëri-tjetrit gjithçka, duke filluar nga çësh-

tjet më të rëndomta e gjer te hallet e mëdha të punës e të jetës sonë? Ti dije ç'nota kisha marrë gjatë javës, ç'ndodhte në konviktin tonë, ç'më kishte thënë mësuesi kujdestar; kurse unë dija në sa ditë u bë montimi i tornove, si e riparuat vinçin brenda një nate, ç'gjellë gatuheshin në mensën tuaj... Dhe për të gjitha i kërkonim mendimin njëri-tjetrit. Kurse tani... tani bisedojmë vetëm për drutë që duhen blerë, për xhaketën që duhet çuar në pastërti, për fejesën e filanit apo të filanes ose për ndonjë çikërrimë tjetër të tillë. Ti edhe kur më pyet mua si shkoj me mësim ose Anin si shkon në ambulancë, e bën sa për të kaluar radhën. Kurse për punët e tua pothuaj s'flet fare, bile mërzitësh kur të pyesim. Ma preve shkurt kur të pyeta për atë çështjen e riorganizimit të repartit të dytë. «S'do ta bëjmë edhe shtëpinë zyrë!», — më the. Ndoshta të dukemi të paafta për të të ndihmuar ose këshilluar, megjithëse unë jam sot diçka më e pjekur nga ajo nxënësja e atëhershme, mendimet e së cilës i dëgjoje me kujdes... Tani kemi harruar edhe të ëndërrojmë, thujse kemi arritur gjithë ç'mund të arrihet... Heshtja, që sundon tani kaq dendur në familjen tonë, ka diçka të zyrtë, të ftohtë. Ne, jo sikur jemi pjesëtarë të së njëjtës familje, po sikur ndodhemi rastësisht nën një çati, sa për të lehtësuar mirëqenien e njëri-tjetrit. Jeta e secilit prej nesh, jashtë mureve të apartamentit, ngelet rreptësisht personale, përderisa nuk cënon direkt njërin apo tjetrin.

— Flora, ti ndoshta harron se ne jemi të rritur, të pjekur dhe e kemi fituar të drejtën për një farë pavarësie në jetë!, — vërejti Petroja, me një pamje të menduar. — Unë nuk shikoj ndonjë të keqe këtu, përderisa...

— Përderisa në pamjen e jashtme gjithçka shkon në rregull, ë?, — e ndërpreu Flora. — Por, ajo që ti e quan pavarësi, vëlla mua më duket ftohtësi, indiferentizëm.

— Motër, ma thuaj troç, mos ke ndonjë pakënaqësi që flet kështu?, — ndërhyri rreptë Petroja. — Mos je zënë gjë me Anin? Apo ke ndonjë hall tjetër?

— Jo Petro! — Ajo buzëqeshi hidhur. — Më vjen keq që s'po më kupton.

— Përralla!, — tha Petroja, duke thithur me nervozizëm cigaren.

I vinte inat që biseda kishte marrë një kthesë të tillë dhe që ai s'e kishte kthyer dot atje ku kishte synuar. U mendua një hop dhe ia gjeti anën.

— Mirë, moj motër, këto të meta vetëm unë i kam, ti vetë në rregull je? — pyeti, duke i ngulur sytë.

Flora ngriti supet, pa e kuptuar se ku deshi të dilte ai.

— Ja, për shembull, kur më ke qarë ndonjë hall dhe unë s'të kam dëgjuar?, — vazhdoi ai.

— Nuk kam pasur ndonjë çështje të rëndësishme, përndryshe s'do të kisha heshtur!, — tha Flora. — Ja, sot që pata...

— Pse, çështjet që lidhen me fatin tënd, me emrin tënd të mirë, të vogla janë?, — pyeti ai pa ia ndarë sytë.

Flora e kapi domethënien e atyre fjalëve dhe ndjeu të skuqej. I erdhi inat me vetveten dhe ngriti sakaq sytë.

— Të lutem, fol më qartë!, — tha.

— Kam dëgjuar se shoqërohesh me një djalë!

Ai i lëshoi këto fjalë si predha dhe heshti të hetonte se ç'përshtypje do t'i bënin asaj.

Flora e vonoi një hop përgjigjen. Megjithëse që e pjekur, prapëseprapë ndjeu një farë druajtjeje nga vëllai e një farë turbullimi. Pastaj tha:

— Unë shoqërohem me plot shokë të fakultetit!

— E kam fjalën për njërin, me të cilin ke rënë shumë në sy për një farë Arbeni.

— Me atë kam më shumë shoqëri. Vijnë të dy nga i njëjti kantier, se edhe ai ka punuar disa vjet teknik ndërtimi.

— Vetëm kaq, vetëm shok e ke?, — nguli këmbë Petroja.

Nga timbri i zërit të tij kuptohej qartë dyshimi dhe mosbesimi.

Ajo e ndjeu veten më pak të druajtur.

— Diçka më tepër!, — u përgjigj, e vendosur t'i hapaj si motra vëllait.

— Ç'do të thotë kjo?

— Qysh në fillim na pëlqeu të shoqëroheshim bashkë, se na lidhnin kujtimet e jetës së kantierit, të njëjtat shqetësime dhe vështirësi për mësimet, me sa duket edhe mendimet!, — sqaroi ajo. — Por, gjatë vitit të parë mbetëm vetëm shokë. Kurse tani, këto kohët e fundit...

Asaj i erdhi rëndë ta thoshte troç dhe e la të nënkuptohej.

— Çfarë, këto kohët e fundit?, — s'iu nda ai.

— E duam njëri-tjetrin!, — mori guxim ajo.

— Je e sigurtë se edhe ai të do?

— Po!

— Nga e ke këtë siguri?

— Nuk ka ndonjë mjet për të matur ndjenjat e tjetrit, por kështu besoj.

— Po sikur ai të shtiret? Ke ndonjë fakt, ndonjë premtim, apo beson qorrazi, e dehur nga pasioni?

— Ti, vëlla, duhet ta dish se ka një mori rrethnash, një mori rastesh të vogla e të mëdha që e provojnë më së miri ndjenjën e tjetrit.

— Unë di që ka edhe djem mashtrues, ka edhe vajza që merren në qafë prej tyre! — theksoi Petroja. — Prandaj, nuk duhet të besosh lehtë, se mund të digjesh.

— Një njeri që s'e beson, s'mund ta duash!, — tha Flora, pasi u mendua një çast.

— Megjithatë, në daç të mos rrezikosh veten, duhet të tregohesh e matur, shumë e matur!, — e këshilloi Petroja. — Nuk bën të ekspozohesh kështu, ke rënë shumë në sy.

— Mos duhet të takohemi fshehurazi?!, — tha Flora, me një ton që donte të tregonte se ajo nuk do ta bënte kurrë një gjë të tillë.

— Po edhe kështu haptazi, ama!, — ndërhyri Petroja i revoltuar. — Ku jemi këtu? Harroni se opinioni ynë shoqëror...

— Varet se cilin opinion shoqëror ke parasysh!, — e ndërpreu ajo.

— Flora, mos kërko ta bësh hapin më të madh nga ç'duhet, se rrëzohesh!, — vërejti Petroja duke tundur kokën në shenjë qortimi.

— Sipas teje u ndashka zgjedhur një rrugë e mesme!, — buzëqeshi ajo mendueshëm. — Po, ti dikur më thöshe se njeriu duhet t'i përmbahet një rruge të vetme, të drejtë, pa bërë lëshime, as nga njëra anë dhe as nga tjetra. Apo ke ndryshuar mendim?

— Varet se ç'quan ti rrugë të drejtë! — dredhoi ai.

— Atë që pajtohet me moralin tonë!, — ia priti ajo.

— Me ty s'u flitka, e paske marrë revan!, — u nervikos Petroja i zënë ngushtë. — Sidoqoftë unë për të mirën tënde e kam. Përsëri ta them, se nuk e ke mbarë!

— Bindmë, atëherë! Ti je më i pjekur në moshë, ke më shumë përvojë jete, dhe në paç të drejtë, s'e ke vështirë të ma provosh.

— Ehu, përralla!, — ia bëri ai, pa ditur ç'të thoshte.

— Si thua ti, mos është e udhës që unë ta sakrifikoj ndjenjën time dhe të pres që ju të më gjeni një burrë, me të cilin të takohem disa herë, për t'u bindur se pazarllëku është i leverdishëm dhe pastaj të bëj një fejesë zyrtare në pasticerinë «Tirana?!», — buzëqeshi hidhur ajo.

Petroja i nguli sytë diku në faqen e murit përkundrejt për një çast, pastaj iu drejtua së motrës:

— Sidoqoftë, unë besoj se më takon të interesohem për ty, ajo jo?

— Posi, bile shumë!, — miratoi ajo singërisht. — Madje, mua do të më pëlqente që ti ta njihje Arbenin.

Petroja u mendua një hop, i zënë në befasi.

— Tani për tani nuk e shoh të arsyeshme!, — i dha karar. — Por, do të pyes për të.

— Do t'u besosh më shumë të tjerëve, se vetes sate?, — buzëqeshi ajo.

— Që të arrish në shkallën e dytë, duhet të ngjitetsh të parën!, — u justifikua ai.

— Mirë, si të duash.

— Veç, kërkoj prej teje të jesh me mend në kokë!, — tha pas pak ai.

Flora ndjeu fytyrën t'i digjte.

Petroja i dha fund me aq bisedës. Mori «Hostenin» dhe vazhdoi leximin, duke u munduar të tregohet i qetë.

Flora u çua dhe çeli kanatin e sipërm të dritares, që të dilte tymi i duhanit. Matej t'i thoshte diçka vëllait, por hezitonte.

— Mos të ka mbetur gjë pa thënë?, — e pyeti ai, që e kishte hetuar me bisht të syrit.

— Më bëri përshtypje diçka në bisedën tonë!, — tha ajo, duke fshirë duart me peshqir.

— Çfarë?

— Mendimet tona nuk janë të njëjta, si dikur. Pse vallë?!

Ai ngriti supet disi mospërfillës.

— Cili prej nesh të jetë mënjanuar nga ato që thoshim dikur?, — pyeti ajo e menduar.

— Koha do ta tregojë se kush ka të drejtë!, — tha ai.

— Pse, në mëshirën e kohës do ta lëmë?

Petroja nuk u përgjigj.

9

Mbledhja e këshillit teknik të uzinës po vazhdonte pa ndërprerje prej më se dy orësh dhe asnjëri s'propozonte për pushim. Nga dritaret e mëdha të sallës hynte dritë e bollshme, sepse jashtë ishte një ditë e kthjellët nëntori dhe gjithçka shullëhej nën një diell të fortë. Megjithatë, asnjë s'e kishte mendjen te kjo ditë e bukur. Sytë e të gjithëve ishin përqëndruar te disku-

tantët, të cilët po përforconin me prova të reja domosdoshmërinë e riorganizimit të repartit të tyre.

Petro Lisi, që drejtonte mbledhjen, mundahej të tregohej i qetë, por e tradhtonin rrudhat e thelluara të fytyrës, vetullat e rënduara dhe qepallat që i përpëliteshin me nervozizëm. Ai dëgjonte me vëmendje, mbante ndonjë shënim dhe herë-herë bënte ndonjë grimasë mosmiratimi apo dyshimi.

«Hajde, pa të shikoni po s'jua dogja letrat në dorë!», — thoshte me vete dhe vlonte nga padurimi sa t'i vinte radha të shpërthente me diskutimin e vet, që e kishte përgatitur me aq kujdes gjatë atyre ditëve.

Me t'u ulur diskutanti i fundit, brofi në këmbë, rrafshoi me dorë fletët e çelura të bllokut, preku vizatimet, si për t'u siguruar që i kishte aty dhe nisi të fliste, duke përfshirë me vështrim sallën.

— Shumica e atyre që diskutuan, përkrahën propozimin e shokëve të repartit të dytë, për të bërë sa më parë riorganizimin e repartit të tyre, pa u thelluar dhe pa u kushtuar rëndësi fjalëve që thanë disa të tjerë, si për shembull shoku Selim, i cili na tregoi qartë sa ngushtë jemi me plotësimin e kontratave dhe sa vështirësi na dalin që ta mbyllim këtë vit me faqe të bardhë. Mjaft shokë e kritikuan drejtorinë e ndërmarrjes se ka mbajtur qëndrim konservator ndaj këtij propozimi. Jemi për kritikën por, që të mos e pranojmë formalisht, lipset të vëmë disa pika mbi i. Të jetë e qartë, shokë, ne nuk ishëm dhe nuk jemi kundër riorganizimit, por jemi kundër ngutjes dhe punëve të përcipta. Për afër dhjetë vjet ky repart i ka plotësuar më së miri detyrat e veta. Nuk mund t'i plotësojë edhe disa kohë kështu siç është, gjersa të krijohen kushte të tjera dhe të jetë siguruar një farë rezerve? E dimë, kjo kërkon mobilizim të madh nga shokët e repartit të dytë, kërkon që të zbulohen prej tyre dhe prej nesh rezervat e brendshme dhe jo t'i fshehim këto prapa nevojës së riorganizimit, siç bën ndonjëri. Të plotësojmë njëherë detyrat e vitit, të marrim masa të forta përgatitore, ta studiojmë mirë

e mirë projektin, pastaj ta zbatojmë. Sepse edhe pak kohë na ndajnë nga fundi i vitit. Po plani?... Le që, pastaj, varianti që propozohet këtu mendoj se ka shumë të meta. Dhe, — këtu heshti paksa, — që të jemi konkretë, ja cilat janë vërejtjet dhe mendimet tona...

«Tani keni për ta parë ç'do të thotë studim!», — mendoi Petroja, duke rrëmbyer vizatimet.

Shkoi e mbërtheu skicën kryesore në një stendë në krye të sallës dhe nisi të parashtronte me pasion projektin e tij. Rrallë në jetën e vet qe treguar aq gojëtar dhe energjik. I zgjidhte fjalët, shqiptonte qartë, me zë të lartë, duke bërë pushime pas ndonjë mendimi a prove kryesore. Shëtiste vështrimin nëpër sallë, herë duke i përfshirë të gjithë, herë duke ia ngulur ndonjërit, sikur donte ta bindte dhe ta bënte për vete. Një herë i vajtën sytë te xha Vasili, që rrinte në radhët e para. Ai po e vështronte me qortim, duke kafshuar me nervozizëm bishtin e cigarishtes, ndërsa fytyra e tij e parruar, me qime të ashpra, i ngjante një iriçi kërcënues. Petroja u habit, u step një çast, pastaj e kaloi vështrimin te një tjetër.

Kur mbaroi, u kthye në vendin e vet i nxituar, kokulur, gjoja modest, por në lëvizjet energjike i dallohej vetësiguria dhe krenaria. Ai çeli një fletë të re të bllokut dhe priti, i bindur se kishte përmbysur situatën.

— Me lejë?, — brofi xha Vasili rëndë-rëndë e i zymtë.

— Urdhëro, mjeshtër!, — i buzëqeshi Petroja.

— Këto mendime a ua ke thënë shokëve të reparitit, kryeinxhinier?

Ai e theksoi fort, e si me qortim fjalën «kryeinxhinier».

— Jo!, — u përgjigj Petroja, i zënë në befasi.

— Pse vallë, ç'të ka penguar? Propozimi ka disa muaj që është bërë!

Petroja u bukosi. Në sallë u nder një heshtje e rëndë. Dikush u mundua të përmbante kollën. Jashtë kaloi me shpejtësi një makinë, duke i rënë vazhdimisht borisë,

por asnjëri s'e ktheu kokën andej. Sytë e të gjithëve qenë mbërthyer te kryeinxhinieri. Ai e ndjeu veten shumë ngushtë, bile iu duk se disa po buzëqeshnin me nënkuptim dhe mendoi se duhej përgjigjur menjëherë, ndryshe do të bëhej qesharak.

— Nuk desha t'u ndërhyja shokëve të repartit, se mos ma merrnin për ndrydhje të iniciativës!, — tha i pa sigurte.

— Ç'janë këto fjalë?!, — buzëqeshi hidhur e me qortim xha Vasili. — Po ti je kryeinxhinieri ynë, bre!... T'ua kishë thënë dhe të mos i kishin marrë parasysh, hajde de, përndryshe s'duhej t'i ruaje për t'i lëshuar këtu, si ndonjë bombë. Mua s'më duken të mbara këto gjëra...

— A ke ndonjë mendim tjetër, veç atyre që the në diskutimin e parë?, — e ktheu Petroja, si i zënë në çark.

— Tani duhet t'ia fillojmë përsënjëzaj, se bëre disa vërejtje të drejta për projektin!, — tha xha Vasili mendueshëm. — Helbete, s'të kemi vënë kot kryeinxhinier... por jo kështu, ama! — Ai u bë përsëri i zymtë dhe qortues. — Megjithatë, le të flasë njëherë inxhinier Andrea, se e pat ngritur dorën para meje.

Mjeshtri u lëshua sakaq në vendin e vet dhe vazhdoi të brente me dhëmbë bishtin e cigarishtes, ndërsa sytë i pasqyronin një shqetësim të thellë.

— Urdhëroni, shoku Andrea!, — i bëri shenjë Petroja dhe befas u ndie i plogët, sikur gjithë enegjia t'i ishte derdhur, si prej një ene që thyhet. Dëshironte që mbledhja të mbaronte sa më parë, pavarësisht nga vendimi që do të merrej.

Andrea foli vetëm për projektin e riorganizimit. Ai vlerësoi shumë disa nga mendimet e Petros dhe tha se këto duheshin mbajtur doemos parasysh në hartimin e variantit përfundimtar. Në fund ai bëri autokritikë pse nuk ia kishin marrë qysh më parë vërejtjet kryeinxhinierit. Kjo i thërri Petros më fort se një kritikë e drejt-përdrejtë.

Pas inxhinier Andresë, e mori fjalën shoku Selim,

i cili u orvat të përkrahte variantin e kryeinxhinierit, duke përsëritur ato që kishte thënë më parë, por e ndërpre në disa herë nga salla. As vetë Petroja nuk e përkrahu dhe ai e pa të udhës ta linte diskutimin në mes, duke u ulur me një pamje të zemëruar e të fyer.

Mbledhja vazhdoi edhe ndonjë orë. Në përfundim, u vendos që riorganizimi të bëhej pa u zvarrisur, kryesisht sipas variantit të paraqitur nga kolektivi i repartit, i plotësuar aty-këtu me disa nga propozimet e kryeinxhinierit.

Ndërsa anëtarët e këshillit teknik po shpërndahehin, duke diskutuar me gjallëri me njëri-tjetrin, Petro Lisi ndezi me ngut cigaren, rrëmbeu vizatimet, bllokun e shënimeve dhe nxitoi në zyrën e vet, pa shkëmbyer fjalë me njeri. I siguroi dokumentet në kasafortë, pastaj iu afrua dritares.

Sheshi i uzinës reflektonte dritën e butë të diellit të pasdites. Dy punëtorë me kominoshe blu nxitonin përmes tij. Te hyrja, pa portierin. Boria e një kamionçine sikur e zgjoi. Porta e madhe metalike rrëshqiti mbi shina me atë kërkëllitjen e saj karakteristike. Gjithçka rridhte si zakonisht.

Petros iu duk sikur jeta s'e përfillte shqetësimin e tij dhe ndjeu një humbëtirë të madhe përbrenda. Sakaq, dëgjoi trokitje në derë dhe ktheu kokën. Vuri re me habi Andrenë te pragu.

— Erdha të të marr të dalim bashkë!, — i tha ai miqësisht.

— Jo, falemnderit, do të vonohem ca!, — ia priti Petroja dhe uli sytë.

Tjetri kaloi pragun dhe mbylli derën pas vetes. Petroja ngriti sytë dhe e vështroi në mënyrë pyetëse.

— Si duket, s'të mjaftoi mbledhja, ke akoma për të thënë?, — buzëqeshi hidhur.

— Erdha si shoku te shoku!, — tha Andrea, butë.

— Tani që e fituat davanë, hë?... Zemërgjerësi prej ngadhnjimtar!

— Petro, ç'flet kështu?! Këshilli teknik vendosi siç

është më mirë. S'ka kuptim t'i mbajmë mëri njëri-tjetrit. S'kemi gjë për të ndarë. Për një qëllim punojmë.

Petroja buzëqeshi hidhur e tallës.

— Po më flet si ndonjë të sëmurë, hə? ... Më thuaj të drejtën, pse erdhe këtu?, — u zemërua pastaj.

— Thjesht që të të marr, të dalim bashkë!, — ia priti Andrea, gjithmonë me të butë. — Të vura ré kur dole, ishe shumë i tronditur.

Petroja ngriti supet dhe ktheu kokën nga dritarja me nervozizëm.

— Apo u tronditë se s'të shkoi fjala këtë radhë, hə?, — Andrea iu afrua me një buzëqeshje miqësore dhe qortuese njëkohësisht.

«Vërtet, kjo është kryesorja!, — tha me vete Petroja. — Për të parën herë shumica nuk më përkrahën. Pse vallë? ...»

— Je mësuar të të shkojë gjithmonë fjala!, — tha Andrea, sikur t'ia kishte hetuar mendimet. — Por, kjo ka ndodhur jo sepse je kryeinxhinier, as sepse je më i zoti nga të gjithë, por sepse ke menduar dhe punuar për të mirën e prodhimit. Ndryshe...

— Pse, tani paskam filluar të mendoj për të keqen e punës?, — brofi Petroja.

— S'them këtë, por askush nuk duhet të kujtojë se vetëm ai është dhe s'ka të tjerë, se vetëm mendimet e tij janë të drejta.

— Si duket, më qenka rritur mendja, hə?, — vërejti me hidhërim Petroja.

— Vëri vath në vesh fjalët e kolektivit, Petro! Dëgjo ç'të këshillojnë xha Vasili me shokë, se ata të duan dhe të çmojnë aq, sa as ti s'e mendon. Mos dëgjo ç'thote Selimi. Ai s'është për vete në rregull. Përpiqet si e si t'ua hedhë ndërmarrjeve konsumatore, sikur qëllimi ynë të ishte plotësimi formal i planit, për të korrur lëvdata. Ne duhet të vazhdojmë rrugën që fillove ti me shokë, pa iu trembur vështirësive të rritjes. Ca më tepër ty s'të ka hije t'u trembesh.

— Nuk di t'u jem trembur ndonjëherë! — tha Petroja.

— Ti duhet t'i dish sa vështirësi na janë dashur të përballojmë, gjersa uzina arriti ku është sot.

— E di fort mirë!, — tha Andrea. — S'ta kam thënë ndonjëherë, se nuk lëvdohet tjetri në sy, por dije se kjo është arsyeja kryesore që të kam çmuar dhe dashur gjithmonë. Bile, kam synuar të ndjek shembullin tënd. Prandaj, më therr në zemër kur vërej se po të zbehen disa nga cilësitë e mira, Petro. Pse ndodh kështu, akoma s'e di fort mirë. Por, të lutem, besomë si shok, ke ndryshuar, ka filluar të të pëlqejë vetja, lavdia. Ja, si the në mbledhjen e këshillit teknik! «Askush nuk është lodhur sa unë për të mirën e punës». Sikur vetëm ti! Po të tjerët, jo!... E propozove Ruzhdiun për brigadier, megjithëse nuk e meriton, sepse të lan e të lyen. Nuk e sheh dot me sy Kastriotin, sepse nuk të thotë «amin» për çdo gjë. Ja tani edhe çështja e riorganizimit... Nuk dua të kthehem përsëri te kjo temë, por ti duhet ta kuptosh vetë...

Andrea i nënvizonte fjalët, duke i rënë lehtë tryezës me gishtin tregues. Rrudhat e ballit i qenë thelluar. Vështrimin e kishte të rreptë, por miqësor. Në timbrin e zërit ndihej qortim dhe mirëdashje.

Petroja uli vështrimin në xhamin e tryezës, nderi dorën drejt paqetës së cigareve dhe ndezi një me nervozizëm.

— Unë gjithmonë i kam dashur dhe respektuar shokët!, — tha, duke thithur me afsh cigaren. — Jam munduar të jem korrekt me secilin.

— Ashtu të duket, por ti je larguar prej tyre, Petro. Vetën e kujton diku lart, kurse ata, poshtë, nën urdhrat e tua të pagabueshme. Këtë e vërejnë të gjithë.

Petroja brofi dhe nisi të shëtiste nëpër zyrë. I buçisnin veshët. Kokën e ndiente të rëndë dhe gojën të hidhur. I dukej sikur fjalët e Andresë vinin që larg. Vërviti bishtin e cigares dhe fërkoj sytë me pëllëmbë.

— Tani jam shumë i lodhur!, — iu kthye me sinqeritet Andresë.

— Mirë, ke të drejtë!, — tha ai. — Tani, merr par-

desynë dhe ec të dalim, të pimë një kafe. Unë e di se s'ke asnjë punë këtu.

— Jo, do të qëndroj edhe pak! — kundërshtoi Petroja, duke iu shmangur vështrimit të shokut.

— Si të duash!

Andrea qëndroi përballë shokut dhe e vështroi me ngulm. I vuri ré fytyrën e zbehtë, sytë e skuqur e të zvogëluar, rrudhat e thelluara ndanë buzëve, shqetësimin që ai më kot mundahej ta fshihte dhe ndjeu një keqardhje prej shoku. I zgjati dorën, ia shtrëngoi fort dhe doli, pa e kthyer kokën.

Petroja doli në dritare dhe e ndoqi me sy, gjersa përshkoi sheshin e uzinës, kapërceu portën metalike dhe humbi mes kalimtarëve.

«Çudi, si janë njerëzit!, — mendoi. — Për Andrenë isha i mirë kur e propozova për dekorim, për Anin isha i mirë kur e shëtisja, për Florën isha i mirë kur e përkëdhelja, por, sa ramë pak ndesh, doli se paskam ndryshuar, se qenkam në rrugë të shtrembër... Si ndryshoka kështu, menjëherë, njeriu?! Pastaj, pse, ç'do të më shtynte?! Para vetes fshihesh dot, e pra, s'di ta kem pasur ndonjëherë me hile, si në punë, ashtu edhe në familje. Për mirë jam munduar... Kur qe nevoja, e kam bërë natën ditë. Mos u dashka të sfilitem së punuari akoma, edhe tani, që jemi gjashtë inxhinierë?!... Po si kështu, xhanëm, të tërë më kanë marrë inat: edhe Flora, edhe Andrea, edhe të tjerët?!... Edhe xha Vasili, për shembull? Ai më ka dashur gjithmonë si birin e vet. Sa i zemëruar dukej në mbledhje!... Mos, vërtet unë... S'po kuptoj ç'po ndodh me mua...» E ndiente veten të dërrmuar. Të shkoj të pi një ekspres të fortë. Ndoshta më kthjellon disi!»

Rrëmbeu pardesynë, mbylli zyrën dhe zbriti me nxitim shkallët. Sapo doli në ajrin e freskët, sikur shpëtoi nga zagushia dhe u ndie më mirë. Portieri nxitoi t'i çelte derën metalike dhe e përshëndeti me respekt.

«Po ky, thua ta ketë marrë vesh?», — i shkrepri në mend Petros.

Eci drejt qendrës së qytetit me hap të ngadaltë duke u përpjekur të kujtonte gjëra të bukura nga jeta e tij, po qe e pamundur, nuk u shpëtonte dot mendimeve, ato i riktheheshin dhe i vërtiteshin në kokë, si ndoca miza të bezdisshme.

«... Sa ngushtë që u ndjeva në mbledhjen e këshillit teknik! Sidomos ajo pyetja e xha Vasilit... Vërtet, ç'më pengoi t'ua bëja përpara vërejtjet? Atëherë, s'do të kishite ndodhur e gjithë kjo... Nuk ma merrte mendja të ishin aq të përgatitur dhe të aftë. Më gozhduan me argumente... Dikur e kisha gjendjen e reparteve në pëllëmbë të dorës, kurse tani... Të jetë e vërtetë se jam larguar nga puna e gjallë?... Eh, s'është kjo e gjitha. Uzina është rritur kaq shumë, problemet janë shtuar dhe s'ka mundësi që një kokë e vetme... Atëherë, pse ngula këmbë në timen? Šedra? Të jetë vërtet kështu?... Hej, dreq, si s'po më ndahen këto mendime!»

Ndërkaq, kishte arritur në qendër dhe po i afrohej lokalit të vet të preferuar. I tërhoqi vëmendjen një djalosh me valixhe dërrase në dorë, i cili po largohej nga stacioni i autobusëve me një pamje të hutuar. Iu kujtua vetja, kur erdhj së pari në kryeqytet.

... Ishte një pasdite vjeshte. Ndërsa autobusi nxitonte mbi brezin e murmë të asfaltit, ai jetonte akoma me nostalgjinë e ndarjes. I kujtohej ai mëngjes i shqetësuar: përgatitjet e fundit të plaçkave; ecja nëpër rrugicën e tyre me kalldrëm, së cilës i njihte çdo skutë, ndërsa fqinjët dhe të njohurit i uronin suksese në mësim; porositë e fundit të nënës, mu te porta e autobusit; një lot tinzar në faqet e së motrës; pastaj, ato të dyja që e përshëndetnin me dorë, ndërsa largoheshin, largoheshin, bashkë me pamjet e qytetit të fëmijërisë... Por ja, përtej xhamave të autobusit u dukën konturet e kryeqytetit dhe ai u shkëput përnjëherësh nga këto kujtime. Ndjeu zemrën t'i rrihte në kraharor. U magjeps nga rrugët e gjera, fasadat e godinave shumëkatëshe, kalimtarët e shumtë dhe u mbush me gëzim e optimizëm për jetën e ré që po fillonte. Pastaj, me valixhen prej dërrase në

dorë dhe plot shpresa e dëshira të mëdha, zbriti në këtë stacion, që tani i dukej kaq i njohur dhe i rëndomtë dhe ndoshta kishte një pamje të hutuar, si ai djaloshi që ia ndolli ato kujtime, i cili po zhdukej në kthesë...

«Njeriu qenka më i lumtur kur ëndërron dhe përpiqet për diçka, sesa mbasi i arrin! — mendoj Petroja. — Po kush më pengon të ëndërroj dhe të përpiqem më tej? Qëllimet e njeriut s'kanë të sosur. Por, ka qëllime dhe qëllime. Unë ç'qëllime kam tani? Mos vallë, që të ruaj dhe të plotësoj ato që kam arritur? ... Hej, përsëri me këto mendime! ...»

Hyri në kafene. Tryezat qenë plot. Në disa prej tyre klientët ishin ngjeshur pranë e pranë, në formë rrethi. Mbi kokët e tyre ngriheshin pareshtur shtëllunga tymi. Kamerierja mundohej t'u bënte ballë porosive të shumta, duke nxitur përmes tryezave.

Petroja nuk u ul. Iu duk i mërztishëm dhe plot kotësi ai mjedis. Porositi një ekspres dhe e piu më këmbë, pranë banakut. Me ta zbrazur filxhanin, pagoi dhe iku.

Me cigaren të varur në buzë dhe me duart të rrasura në xhepat e pardesysë, ecte rëndë-rëndë mbi asfalt, vështronte reflekset e mjegullta në të dhe dëgjonte hapat e vet të ngjeshur, ndërsa hija dhe mendimet e ndiqnin pas.

10

Edhe atë pasdite Petroja që kthyer herët në shtëpi dhe po pushonte në divanin e dhomës së bukës.

— Ora s'ka vajtur ende katër dhe duket sikur u ngrys!, — tha Flora, ndërsa po merrte nga rafti xhezvenë e kafesë.

Petroja vështroi nga dritarja. Përtej xhamave të saj, të veshur me cirka uji, dukej një copë qiell i murmë, prej të cilit rigonte shi i imtë. Dukej se si pikat e tij lagnin fasadat e pallateve kundruall, lëpiheshin nëpër degët e trungjet e drurëve, pickonin sipërfaqen e pellgje-

ve dhe thërrmoheshin në asfaltin e rrugës. Buzë tro-
tuareve rridhnin rrëkera të turbullta. Gjithçka ishte e
lagur, me ngjyra të shuara, me shkëlqim të mugët.

— E ka zënë shtruar!, — tha Petroja, duke i hequr
sytë nga dritarja. — Ky mot m'i acaron nervat.

— S'punoka kjo!, — tha Flora, duke treguar me dorë
furnelën elektrike dhe shkoi në banjë për të nderur
furnelën me vajguri.

Petroja u çua nga divani dhe kontrollloi telin e re-
zistencës. Nuk ishte gjëkundi i këputur.

Pas një hezitimi të vogël, vendosi ta riparonte. Mori
kompletin e veglave nga aneksi dhe iu vu punës, me te
për për t'u marrë me diçka

Atë ditë kishte qenë në një mbledhje jashtë uzinës
dhe që andej ishte kthyer drejt e në shtëpi. Mendoi se
nuk do të ishte shfaqur ndonjë nevojë e ngutshme për
të, ndryshe do ta kishin thirrur me telefon.

Kohët e fundit, pasi mbaronte punët e ditës, mezi
priste të lindte ndonjë nevojë që të dilte nga uzina, se-
pse kështu justifikonte, në sytë e të tjerëve, mosvajtjen
në repartin e dytë, ku vazhdonin punimet e riorganizimi,
pa ndërprerë prodhimin. Ai tregohej se e bënte
të vetën, interesohej çdo ditë për zbatimin e grafikut të
punimeve. I kishte dhënë urdhër të prerë degës së fur-
nizim-shpërndarjes që të siguronte me parësi çdo mate-
rial të nevojshëm dhe bënte namin kur vërtetoheshin
mungesa. Krahas këtyre, ndiqte përditë plotësimin e
detyrave të prodhimit nga ky repart, por nuk kishte
pasur raste të shqetësohej, as të thërriste njeri në ra-
port, sepse këto plotësoheshin më së miri.

«Ç'mund të kërkohet më shumë se kaq prej meje?!,
— mendonte, duke shtrënguar vidat e furnelës. — Unë,
si kryeinxhinier i një uzine me shtatë reparte, s'mund
ta mbaj kokën, si struci, në një repart. Ai ka kolektivin
e vet, përgjegjësin e vet... Helbete, në më kërkofshin
ndihmë...»

Ndërkaq, u çel dera e jashtme e apartamentit dhe
Petroja njohu hapat dhe lëvizjet e së shoqes.

— Oh, ç'të përmbysim?! — u habit ajo, duke hyrë në dhomë.

— Vendosa të bëj kthesë, mjaft më kritikuat që s'merrem me punët e shtëpisë!, — buzëqeshi ai.

— Paske bërë gjithë këto plehra!, — vërejt i Ani, duke treguar disa copa telash që dergjeshin mbi qilim.

— He, ku ka punë, ka edhe mbeturina!, — ia priti Petroja.

— Pastrimi i vendit të punës është detyrë e secilit, apo jo, shoku kryeinxhinier?, — bëri shaka Flora, duke sjellë kafënë. — Mirë se erdhe, Ani!, — iu kthye pastaj së kumatës. — Të ta bëj edhe ty një, zjarrin e kam të ndezur.

— Jo, falemnderit, më mirë na jep nga një llokum, të ëmbëlsohem ca, se jam e hidhëruar!, — tha ajo, gjoja me shaka.

— Pse qenke e hidhëruar?, — pyeti Petroja.

— Se do t'ju lë vetëm nja një muaj. Më kanë caktuar në një ekip shëndetësor, që do të shëtisë nëpër fshatrat e Tiranës për inspektim në çerdhet e kopshtet e fëmijëve. Ato me fëmijë të vegjël nuk i caktuan.

— Ama, këtë hidhërim paske?!, — i tha Petroja.

— S'është edhe për të mos u hidhëruar. Një muaj pa amvisë shtëpia, s'është shaka.

— Ja, është Flora. Bile, ajo ka nevojë të stërvitet, ca, se helbete...!, — buzëqeshi ai me nënkuptim.

— Eh, ajo ka mësimet!

— Mos ki merak, do bëjmë si do bëjmë një muaj pa ty!, — tha ai.

— Po për mua nuk mendon, e lehtë të duket?, — e qortoi ajo. — Sidomos me këto shira... Të të zërë një herë në mal, të lagesh mirë e mirë dhe pastaj... drejt e në spital.

— Mos e merr me frikë!, — i tha Flora. — Kushedi sa herë jam lagur gjer në palcë dhe ja tek më ke, mirë e shëndoshë, pa parë kurrë spital me sy.

— Ti je kalitur në kantier!, — ia priti Ani me një farë ironie.

- Edhe ti do të kalitësh!, — tha Petroja.
- Unë dhe nja dy të tjera mbetëm në rrjetë!, — psherëtiu Ani. — Disa me fëmijë të vegjël, nja dy me raport... S'kam ç'bëj, do të vete.
- Do të vesh, ta merr mendja!, — tha Petroja. — Dhe kur të kthehesh, do shikosh po s'qe e kënaqur. Sikur të më thoshte njeri mua... .
- E shikoj se s't'u bëka vonë!, — e ndërpreu Ani. — Helbete... Të paktën, më gjej një palë çizme të mira, nga ato me qafë të shkurtër, thuajti atij Selimit tuaj, që nxjerr edhe të vdekurin nga varri. Lili kishte gjetur. Meqë ra fjala, keni të fala prej saj.
- Kur e takove?, — u interesua Petroja.
- Sot, kur po shkoja në ambulancë. S'dija qysh të justifikohesha që s'u kemi shkuar akoma për vizitë. Ajo m'u ankua se Andrea s'u mblidhka në shtëpi veçse natën vonë. Deri dje s'mblidhej Petroja, tani Andrea, i zënka me radhë kjo epidemi burrat tanë, i thashë!, — buzëqeshi ajo.
- S'thonë kot, flokëgjata, mendjeshkurtra!, — u zemërua Petroja.
- Pse?!, — u habit Ani.
- Si, moj, pse?! Do të thonë, ja, kryeinxhinieri po i shmanget riorganizimit, po hiqet mënjanë, edhe vetë gruaja e tij e pohon.
- Të vërtetën thashë, ku t'i di unë ngatërresat që keni ju në uzinë!, — ia priti ajo, e prekur. — Ç'faj të kam kur s'na tregon gjë?!
- Mirë, mirë!, — i dha fund ai, pajtues.
- Po u bëka riorganizimi?, — ndërhyri Flora.
- Po, këshilli teknik vendosi të bëhet, megjithëse unë isha kundër!, — ia priti shkurt Petroja.
- Fol sinqerisht, prandaj hiqesh mënjanë, ngaqë ishe kundër?, — vazhdoi Flora.
- Pse, mos duhet t'i bjerë bretku në punë, për të zbatuar propozimet e të tjerëve?!, — kërceu Ani.
- Shokët nuk lihen në baltë!, — tha Flora. — Ata do ta kryejnë edhe pa Petron, por kjo s'do ta nderojë.

— Ej, posi, nga kjo mbeti t'i çmohet vlera Petros!,
— foli përsëri Ani, që po sistemonte sirtarët e bufesë.
— Megjithëse... — Ajo hezitoi një çast, e menduar, pas-
taj u kthye nga i shoqi. — S'thotë keq, Petro, mos u
hiq mënjanë, mund të ta vënë ré!

— Kush ju tha se po i lë shokët në baltë, se po hiqem
mënjanë e këso dokrrash?!, — u acarua ai. — Mjaft,
s'ka mbetur t'i zgjidhni ju punët e mia. Vështroni tua-
jat, se ju dalin e ju teprojnë!

— Obobo, s'paskemi bukë për darkë!, — vërejti Ani,
sapo çeli sirtarin përkatës.

— Shkoj unë!, — tha Flora.

— Lëre, shkoj vetë, se jam e veshur, gati!, — brofi
Ani, duke hequr përparësen.

Petroja u rehatua në divan, me gazetë në dorë. Në
korridor u dëgjuan lëvizjet e Anit, pastaj dera që u çel
dhe u mbyll. Flora vështrroi atë copë qiell me ré që du-
kej nga dritarja dhe iu duk sikur pështjellimi i reve
të ngarkuara me shi po shtrihej edhe në brendësinë e
saj. Nuk iu durua më.

— Petro, më duket se ti po pajtohesh me disa mendi-
me të gabuara të Anit!, — iu drejtua të vëllait.

— Çfarë, të grindemi, thua ti?, — foli ai, pa i shkë-
putur sytë nga gazeta.

— Jo, por t'ia vësh në dukje me durim, ta qortosh
kur shfaq të tilla mendime.

— Ku hiqni dorë kollaj nga juaja ju, femrat?, — bu-
zëqeshi me nënkuptim ai.

— Po qe nevoja, edhe të grindeni, pastaj!, — vazhdoi
Flora.

— S'ka kuptim, njeriu do të prehet në familje!,
— tha ai qetësisht dhe vazhdoi leximin e faqes së katërt.

— Pse, prehja qenka kryesorja?!, — vërejti ajo, e
revoltuar nga indiferentizmi i të vëllait. — Për hir të
qetësisë paske vendosur ta bësh një sy qorr dhe një vesh
shurdh, hé?!

— Në këtë botë s'ka gjë të përkryer!, — filozofoi

Petroja. — Çdo familje ka të metat e saj. Ke për t'u bindur kur të martohesh. Pa lëshime reciproke nuk i dilet.

— Po këto nuk janë çështje të vogla, për të cilat mund të bëhen lëshime!, — vërejtí Flora. — Ti nganjëherë kërcen përpjetë për hiçgjë, për shembull dje bëre fjalë pse nuk ishin zier mirë makaronat, kurse sot s'hape gojë për gjithë ato proçka që dëgjove!

— Eh, djalli nuk është kaq i zi sa ç'e bën ti!, — ia bëri me dorë Petroja. — Por, si duket ty të është bërë ferrë në sy Ani.

— S'është e vërtetë!, — kërcëu Flora. — Ani s'më ka bërë ndonjë të keqe, ajo është treguar shumë korrekte karshi meje. Bile, të kam thënë, ia çmoj disa veti të mira. Ajo është e sjellshme, e përmbajtur dhe e matur.

— Epo, ashtu kot nuk e zgjodha për grua!, — buzëqeshi Petroja.

— Grua për shtëpi, apo shoqe jete?, — pyeti Flora.

— Këto s'ndahen dot nga njëra-tjetra!, — tha ai.

— Sidoqoftë, njëra është kryesore!, — vërejtí ajo.

— Vërtet që Ani ka ndonjë mendim të gabuar, unë hera-herë ia vë në dukje, por cili prej nesh është pa to?!, — tha Petroja.

— Ti bën fare pak për ta ndihmuar!, — e qortoi vëllazërisht Flora. — Me ç'kam vënë ré, bisedat tuaja mbeten zakonisht brenda caqeve të problemeve familjare, ose për t'u argëtuar me ndonjë nga ato ngjarjet që ti i quan «kronika e pabotueshme e ditës». Si duket, kjo bën pjesë në programin e prehjes?!... Rrallë e tek çelen te ne biseda të gjera, por edhe këto mbeten shpesh pezull. Një mospajtim mendimesh me Anin dhe ti, mbas ndonjë kundërshtimi të zbehtë, hesht. Ndoshta, sepse nuk do të grindesh, nuk do të prishësh qetësinë, hé?! Më duket se ka filluar të të pëlqejë mendja e saj!

— Mos do ta kthejmë kuzhinën në sallë mbledhjesh?!, — tha Petroja me shpoti. — Jeta do t'ia korrigjojë Anin ndonjë mendim të gabuar që ka më mirë se fjalët e mia. Ajo nuk është ndonjë shtëpiake e mbyllur brenda katër

mureve, po mjeke, me një jetë të pasur shoqërore. Me kohë, do të korrigojohet.

— Sikur Ani të mos dinte të gatuante, për shembull, do të tregoheshë kaq zemërgjerë, a do t'ia lije kohës në dorë?, — pyeti Flora, me një buzëqeshje të hidhur.

Krisi dera e jashtme dhe ata e ndërprejnë bisedën.

— Vetëm bukë të zezë kishte!, — tha Ani disi e pakënaqur. — Prandaj, mora vetëm sa për sonte.

— Ju, mjekët, na e këshilloni më fort sesa të bardhën!, — buzëqeshi Petroja dhe u shtrua sakaq në tryezë, se e kishte marrë uria.

Pasi hëngrën, Flora u largua në dhomën e vet, që të vazhdonte detyrën e vizatimit teknik.

— Tani shumicën e mbrëmjeve ajo i kalon në shtëpi!, — tha Petroja, sapo doli e motra. — Si duket, ua ka vënë veshin këshillave të mia.

— Ej, posi!, — ia bëri Ani, me mosbesim të hapur. — Me gjithë mend kujton se e ka lënë?

— Në mos e pastë lënë, e ka mbledhur ca!, — tha ai.

— Ju, burrat, në përgjithësi jeni syleshë për këto punë, jua hedh femra kur të dojë!, — buzëqeshi me tallje Ani. — E, pra, ja ku po ta them unë, ajo vazhdon njësoj me të, në mos pastë shkuar më tej!

— Më duket se e tepron ca ti, Ani!, — u ngrys Petroja.

— Makar, syve të mi u besoj!, — nguli këmbë ajo. — Pale që një herë ai guxoi të trokiste në portë.

— Pse, erdhi e kërkoi këtu?, — kërcëu Petroja.

— Se mos do të të gënjej?!

— Kur?

— Të shtunën pasdite.

— Pse nuk më the?

— Kam vënë re se nuk të vjen mirë kur të flas për tët motër. Pse të grindemi për shkak të saj?...

— Mirë, mirë!, — ia priti Petroja, i zymtë.

Para se të dilte nga uzina, Petroja vendosi të dukej njëherë andej nga reparti i dytë, se kishte ditë pa shkuar dhe kjo mund të binte në sy për keq.

Me të hyrë, vërejti një gërshetim të çuditshëm rregulli dhe rrëmuje. Disa nga makineritë punonin, disa ishin në montim e sipër, të tjerat po i çmontonin. Mbi dysheme kishte detale të sapoproduhuara, pjesë të çmontuara, dado, çelësa, llaç, lopata. Ngado të zinte syri fytyra të djersitura, muskuj të tendosur, vështrime të përqëndruara, lëvizje. Ishte një vajtje-ardhje e pandërprerë, dëgjoheshin thirrje, zhurma dhe krisma metalike, por në të gjitha këto kishte një farë harmonie, që e mundte përshtypjen e rrëmujes.

Petroja vuri ré Andrenë, që punonte në një cep, së bashku me punëtorët. Ishte me kominoshe, i zhyer me vajra dhe llaç gjër në të bardhën e syrit, me fytyrën të dursur. Iu afrua, e përshëndeti me mirësjellje dhe e pyeti si shkonin punët dhe në kishin ndonjë nevojë.

Andrea i raportoi se riorganizimi shkonte mirë, sipas grafikut, se prodhimi vërtet kishte një rënie ditët e fundit, mbasi u lëvizën disa nga makineritë kryesore, por nuk rrezikohej plani mujor. Nevoja sigurisht që kishin, por jo kushedi se çfarë. Do t'i zgjidhnin me forcat e veta.

Petroja e dëgjoi duke e vështruar në bebe të syrit dhe duke tundur kokën në shenjë miratimi, por tjetri ndiente një farë formalizmi dhe indiferentizmi prapa këtij qëndrimi tepër të vëmendshëm.

Andrea ishte munduar mjaft të afrohej dhe ta përtërinte shoqërinë e vjetër, por Petroja i qe shtëmangur, megjithëse me takt. Edhe atë radhë, si dëgjoi përgjigjet e Andresë, u ngut të thoshte «ju lumshin krahët» dhe shkoi më tej.

Tjetri e përcolli me sy, duke tundur kokën me keqardhje.

«Vallë, s'e lë sedra, apo s'ka kuptuar akoma gjë prej gjëje»? — pyeti veten, dhe vazhdoi punën.

Petroja ecte nëpër repart, duke i drejtuar kujt një përshëndetje, kujt një pyetje e kujt një buzëqeshje. Diku sa nuk u përplas me xha Vasilin, që vullnetarisht ndihmonte për riorganizimin. Ai iu përgjigj shkurt përshëndetjes dhe shikoi punën e vet.

Petros i erdhi të flakte xhaketen, të përvishte mëngët dhe t'i vihej punës bashkë me të, si atëherë kur punonin për ngritjen e atij reparti.

— Xha Vasil, ke nevojë për ndihmë?, — iu drejtua buzagaz.

— Për ndihmën e shokëve gjithmonë kemi nevojë!, — ia priti ai, pa i hequr sytë nga puna.

— Si thua, nuk do të ishte më mirë që kjo makineri të montohej diçka më afër asaj tjetrës?, — vërejti Petroja. — Kështu nuk do të dilte nevoja të transportoheshin detalet nga njëra, te tjetra dhe procesi do të shkonte zinxhir.

Xha Vasili vuri duart në ije e vështroi me keqardhje punën e kryer, dhe murmuriti:

— Hej, dreq, si s'më ra ndër mend! Do ta çmontoj përsëri ja kështu! — Pastaj iu kthye Petros: — Eh, more bir, sikur të ma kishe bërë ca më parë këtë vërejtje!...

Megjithëse i foli shtruar, ato fjalë i tingëlluan Petros si një qortim dhe si një përsëritje e kritikës që i kishte bërë në mbledhjen e këshillit teknik. Këtë mendim ia përforcoi qëndrimi i mjeshtrit, i cili, pa ia zgjatur dhe pa i kërkuar të falur, iu rikthye punës.

Pa ç'pa, Petroja tha nëpër dhëmbë një «puna mbarë» dhe bëri përpara. Vendosi t'i binte shkurt dhe të largohej sa më parë nga repart.

Jashtë u ndie më mirë, por i kishte mbetur një ndjenjë e papëlqyer dhe brejtëse nga ajo vizitë. Ndoshta i vinte keq që nuk i qe përveshur punës bashkë me shokët.

«Ç'ma preu hovin, qortimi i xha Vasilit, apo druajtja se mos njerëzit kujtojnë që e bëj për oportunizëm?, — pyeti veten Petroja. — Fundi, ata janë shokët e mi, s'kanë pse mendojnë keq, aq më tepër se unë edhe

më parë... Pastaj, nëse ndonjëri do të mendonte keq, punë e madhe!»

Arriti në postbllokun e uzinës, përshëndeti përzemërsisht portierin e vjetër, nguli këmbë t'i jepte një cigare, megjithëse ai e kishte të nderur dhe mezi i bënë këmbët të kalonte prapun.

«Pse nuk u bëra burrë të kthehesha?, — qortonte veten. — Fare lehtë mund të isha kthyer. Mund të punoja me xhà Vasilin, për shembull. Kjo do të qe autokritika më e mirë për vërejtjen, që ia bëra me vonesë. Kurse mjeshtrit do t'i ishte bërë zemra mal... Por, tani iku kjo punë. Fundi, se mos përfundoi riorganizimi!»

Hipi në autobusin urban në çastin e fundit. Dy nxënës në ekonomi të uzinës e përshëndetën me respekt dhe i liruan vend të ulej por ai s'deshi dhe bëri përpara. Atje takoi Selimin.

— Oooo, kryeinxhinier, sa gëzohem!, — thirri ai. — Tani s'të lëshoj, drejt e të Maria, të më japësh një eks-pres.

— Të jap dy, por një ditë tjetër, sot jam i zënë!, — u justifikua Petroja disi i bezdisur.

— Si të duash, por nuk shpëton pa më qerasur!, — buzëqeshi Selimi, duke e kërcënuar miqësisht me gisht.

— Bile, kafe me bisht, me dopio bisht, e meriton...

— Për çfarë e ke fjalën?, — u habit Petroja.

— Hajt, mos luaj pjesën, e kam marrë vesh unë!, — tha Selimi.

— Me cilin po e fejon?

— Kë?!, — pyeti Petroja, gjithmonë i habitur.

— Si, kë? Florën!

— Vajzat fejesë dhe martesë kanë përpara, por akoma s'kemi dhënë ndonjë fjalë!, — ia ktheu Petroja, që e përmbloodhi sakaq veten.

— Ashtu?!... Ksanthipi na e bëri punë të kryer, pra!

— Epo, disa gra kështu e kanë, o nga dëshira e mirë, o nga zakoni i keq, i fejojnë dhe i martojnë njerëzit para kohe!, — vërejti Petroja.

— Po, po, xhanëm!, — tha i hutuar Selimi. — Në të vërtetë, është ca llafazane ajo!

«Si edhe ti!», — mendoi Petroja.
— Sidoqoftë, uroj nga zemra që të bëhet e vërtetë sa më parë, ishalla me një djalë të mirë!, — u mundua ta riparonte gabimin Selimi.

Petroja nuk e pa të udhës ta falënderonte. U shtir sikur e kishte mendjen gjetiu.

«Edhe kjo na duhej!, — thoshte me vete. — Nuk arrijnë të telashet e punës, por të dëgjosh fjalë edhe për proçkat e motrës!... Do t'i japim karar kësaj pune se s'bën!»

Me të zbritur nga autobusi, ia mbajti drejt e në shtëpi. I mëshoi gjatë e me nervozizëm sumbullës së ziles dhe, sa ia çeli derën Ani, pyeti:

— Flora brenda është?

— Këtu e ke, mos u bën merak, s'të humbet!, — ia priti ajo, gjoja me shaka, por mjaft ironike. — Ja, po bën vizatimet e projektit në dhomën e saj.

Petroja u mat të shkonte tek ajo.

— Kaq të paska marrë malli?, — i foli Ani. — Ti ec e pusho pak, të të bëj një kafe të mirë, se tani e blova, pastaj shko e çmally.

Atij mezi iu durua gjersa zjeu kafeja dhe e rrufiti të nxehtë, aq sa iu përvëluan buzët. Hurbën e fundit e piu në këmbë, lëshoi me ngut filxhanin mbi tryezë dhe shkoi e trokiti në dhomën e Florës.

— Mirë se erdhe, Petro!, — e përshëndeti buzagaz ajo, sido që pak e habitur nga kjo vizitë dhe nga pamja e vrenjtur që kishte.

— Flora, ti s'po e mban fjalën!, — ia nisi rreptë ai, pa u ulur akoma.

— Për çfarë?, — s'e kuptoi ajo.

— Po vazhdon përsëri me atë!, — Petroja e shqiptoi me përcnim dhe urrejtje fjalën e fundit.

— Unë s'të kam premtuar se do të prishemi!, — tha ajo kokulur.

— Ç'më ke premtuar atëherë, që të shkosh më thellë?!, — shtoi ai me shpoti.

— Vëlla, ç'flet kështu?!, — e qortoi ajo, e prekur.

— Si të mos flas, kur njerëzit më urojnë për fejesën tënde dhe unë s'di ç't'u them!, — shpërtheu Petroja.

— Ç'faj kam unë?, — ngriti supet Flora. — S'ua lidh dot gjuhën llafazanëve.

— Ti ke faj që po bëhesh gazi i botës, duke harbuar me atë!, — gati sa s'ulëriu Petroja.

— Pse më fyen?, — kërceu ajo, por e përmbajti veten sakaq dhe vazhdoi me të urtë: — Unë jam treguar krejt e sigurtë ndaj teje. Duhet të më besosh, se marrëdhëniet tona janë krejt të pastërta dhe të tilla do të mbeten. Për këtë të kam dhënë fjalën dhe të jesh i sigurtë se do ta mbaj. Bile, edhe po të mos ta kisha dhënë, po kështu do të sillesha.

— Njerëzit nuk gjykojnë sipas fjalëve të tua, por nga ç'shohin!, — vërejti Petroja.

— Por, pse iu dashka dhënë kaq shumë rëndësi fjalëve të ndonjërit?, — pyeti ajo.

Petroja nuk iu përgjigj. U mendua një hop si ta zinte, pastaj vazhdoi me të urtë:

— Sipas teje, ju e doni njëri-tjetrin, apo jo?

— Po.

— Pse s'bëni celebrimin, atëherë, dhe kështu u vihet kapak të gjithëve?!

— Unë mendoj se do të vijë ajo ditë, bile jo vonë, por edhe një kokërr mollë nuk këputet pa u pjekur, jo më...

— Kush t'i jep këto mend, ai?, — u zemërua përsëri Petroja. — Sigurisht, atij kështu i vjen për mbarë.

— Me të s'e kemi çelur akoma këtë bisedë!, — u vrenjt ajo.

— Pse, mos prisni të rriteni?!, — u tall ai.

— Presim që të rritet ndjenja jonë, besimi reciprok, bindja reciproke!, — tha ajo, duke e vështruar të vëllanë me guxim në sy. — Atëherë, biseda për celebrimin dhe vetë celebrimi do të vijë vetiu.

— Po në të ktheftë krahët ndonjë ditë, ku do të mbytesh pastaj?, — e paralajmëroi Petroja.

— S'kam pse të mbytem!, — tha Flora. — Në nuk mendojmë të ndahemi, kam shumë besim tek ai.

— Tek ai birko!, — u shkreh Petroja.

— Të lutem, mos e fyej, ai nesër mund të jetë burri im!, — u vrenjt ajo. — Aq më tepër, kur s'e njuh.

— Ç'nevojë kam ta njoh?! Fshati që duket, s'do kallauz. Ç'mund të presësh nga një njeri që kompromenton pa të keq vajzën e botës?! Mua s'më kanë pëlqyer kurrë tipa të tillë.

— Ai është djalë i ndershëm!, — nguli këmbë Flora. — Këtë s'e them vetëm unë. Bile, edhe ty të kanë folur mirë për të, kështu po i thoshe një mbrëmje Anit, të dëgjova rastësisht.

— Profka, kush u beson?!, — thirri Petroja.

— Në rregull, njihe vetë, atëherë!, — i propozoi Flora. — Ma merr mendja se ai është i gatshëm. Përndryshe, s'do kishte ardhur pambrëmë të më kërkonte këtu.

— Ha-ha-ha!, — e ndërpreu ai, duke qeshur me shpotti. — Edhe kjo na duhet, vëllai që shoqërohet me dashnorin e motrës, ha-ha-ha!... Meqë e solle vetë fjalën, thuaji të mos ma shkelë herë tjetër pragun!

— Unë i them, por më vjen rëndë për llogari tënde.

— Në qofsh vërtet kaq cipëhollë, jepi fund kësaj historie!, — iu shkreh ai. — Të jap dy javë afat, ja celebrimin, ja mos të të shoh më me të!

— Ti sikur fole keq për të, si më kërkon të bëj celebrimin, atëherë?!

— Bëj si të duash, ti do të jetosh me të, veç të marrë fund ky turp!

— Ashtu?, — buzëqeshi hidhur ajo. — Pra, për ty s'paska rëndësi me kë e lidh jetën unë, s'paska rëndësi lumturia ime, por vetëm dukja e jashtme, që të mos dëgjosh ndonjë thashetheme. Vallë, nuk e di sa vuajtje dhe fatkeqësi, sa ndërlikime shpesh të vështira për t'u zgjidhur, ç'jetë e shpëlarë dhe ndrydhëse mund të fshihen pas një martese të vendosur me ngut?

— Dokrra, të gjitha këto janë dokrra! — tha Petroja,

duke bërë një gjest përçmues me dorë. — Ju dashkeni të dilni më të zgjuar dhe më përparimtarë se ne, të tjerët. Posi! Ky nuk është përparim, po shthurje!

— Nuk është e vërtetë!, — kërceu Flora, e revoltuar. — I urrej ndoshta më shumë se ti ata ose ato që e përlyejnë fjalën «dashuri» duke bredhur lule më lule, por nuk mund ta pranoj kurrsesi që një dashuri si jona është shthurje. Mbi çfarë u dashka ngritur familja, atëherë? Meqë ne e ndiejmë veten të pastër karshi shoqërisë, gjithçka e kemi hapur, pa prapamendime dhe rezerva. Ata që janë mësuar të merren me thashetheme, le të flasin sa të ngjiren, do t'u shkurtohet një ditë gjuha.

Florës i qenë skuqur faqet dhe i ndritnin sytë. Ajo fliste qartë, duke u mëshuar fjalëve me pasion.

— Ne nuk e nënvleftësojmë aspak celebrimin, as edhe çdo normë tjetër të shoqërisë, por duam t'i respektojmë ato jo formalisht, jo për t'iu ruajtur thashethemeve, jo me hezitime dhe me shpresë te fati, por me bindje dhe besim të plotë. Pa këto të fundit, celebrimi është shpesh një garanci e dobët. Prandaj, unë do ta vë firmën në regjistrin e celebrimeve vetëm kur të bindem se kam gjetur shokun e vërtetë të jetës dhe jo thjesht për të pasur një burrë, as për të siguruar Tiranën, as për të krijuar një jetesë të rehatshme, siç bëjnë disa.

— Ti, prapa këtyre fjalëve të bukura, po ngul këmbë në tënden, si mushka!, — tha Petroja. — Por, unë s'të lë të bësh si të të thotë koka, more vesh?!

— Ty, Petro, të përket të interesohesh për sjelljet e mia!, — u mundua të arsyetonte Flora. — Ti je më i pjekur dhe e ke për detyrë të më ndihmosh, të më ruash nga gabimet, por jo kështu. Ti nuk bën mirë që shqetësohesh më fort për thashethemet, sesa për lumturinë time. Dëgjoje lutjen time, njihe Arbenin, pastaj do të kemi një bazë bisedimi...

— Kurrën e kurrës!, — e ndërpreu ai. — Ja, e paske njohur ti edhe për mua, ç'nevojë është?... Siç të thashë, brenda dy javësh, ose...

— Petro, nuk është mirë kështu!, — iu drejtua Flora, lutëse, por krenare njëkohësisht.

— Nuk bëj asnjë lëshim!

— S'është fjala për lëshime, po për arsyetim. Unë sot jam njëzet e tre vjeç dhe askush nuk mund të më detyrojë të veproj në kundërshtim me bindjet e mia, pa më bindur se ato janë të shtrembra!

— Sa të jemi nën një çati, do të veprosht si të them unë, përndryshe...!

Petroja, i zemëruar, bëri një gjest të vrullshëm me dorë duke treguar derën.

— Nuk e besoj të arrish gjer atje!, — tha Flora, që i ra si rrufe ky gjest. — Në arritsh, do të dëmtosh rëndë familjen tonë dhe, në radhë të parë, veten. Unë, megjithëse do të më dhimbe shumë, jam në gjendje t'i bëj ballë jetës edhe larg teje.

— Mbrapa diellit!, — bubulloi ai.

Doli nga dhoma me rrëmbim dhe përplasi fort derën pas vetes. Në korridor ndeshi Anin, e cila bëri sikur çirrte faqet dhe tha:

— Obobo, na dëgjuan komshinjtë!

— Le të dëgjojnë!, — shfryu Petroja. — Njeriu në shtëpinë e vet edhe do të zihet ndonjëherë.

— Por, ti kalove nga njëri ekstrem në tjetrin!, — e qortoi me druajtje ajo.

— Kështu i do mushka drutë, ia di unë kokën asaj!

— I ngjan të vëllait!, — i shpëtoi Anit dhe kafshoi sakaq buzën, e trembur që i rrëshqitën këto fjalë.

— Duhet t'ia shtrëngosh frerët shumë, që t'ia presësh pak revanin!, — vazhdoi ai.

Ani mori një jastëk, romanin dhe, duke kaluar nëpër dhomën e Florës, doli në ballkon. Rregulloi jastëkun në kolltukun prej kashte, u rehatua në të dhe çeli librin mbi prehër.

Posa i kishte mbaruar punët e mëngjesit. Meqë shërbimin e fillonte vonë, mendoi t'i gëzohej një copë herë diellit, që mezi u shfaq, pas gjithë atyre ditëve të murme e të lagështa.

Çeli librin në prehër dhe bëri të lexonte, po hoqi dorë shpejt. I pëlqeu më shumë të kundronte ambientin e jash-tëm rreth e qark të kredhur në atë dritë të gëzueshme mëngjesore. Në lulishten karshi kishin çelur mimozat dhe kurorët e tyre formonin njolla të mëdha verdhoshe, të cilat sikur i gjallëronin fasadat laramane të godinave përtej. Që poshtë vinin britmat e hareshme të fëmijëve. Rrallë kalonte ndonjë automjet, por zhurma e tij humbiste shpejt në hapësirë. Në degët e panjave buzë trotuarit lodronin dhe cicërinin disa harabela.

Ani mbylli një çast sytë dhe nderi me ëndje fytyrën drejt diellit. Ndjeu se si ngrohtësia e tij po sillte një plogështi të këndshme. I pëlqeu të rrinte ashtu, pa menduar asgjë. Kishte nevojë për prehje pas ditëve plot stuhi jo vetëm në natyrë, por edhe në jetën e tyre familjare.

Kohët e fundit Petroja vinte në familje si një re e ngarkuar. Ishte gjithmonë i zymtë, i padurueshëm dhe shpërthente për asgjë. Si dukej, kishte shumë telashe dhe ngatërresa në uzinë. Çfarë konkretisht, ajo nuk e dinte, se ai nuk qante hall dhe as guxonin ta pyesnin por, me sa dukej, ishte ajo çështja e riorganizimit të repartit të dytë. Nuk ia dëgjoji këshillën asaj, që të mos dilte kundër rrymës dhe tani po ia shihte sherrin. Mbi këto, qe shtuar edhe çështja e Florës.

Disa ditë më parë Petroja i kishte bërë titur përsëri asaj. Dëgjoheshin gjer në kuzhinë fjalët e tij. Ngulte këmbë që Flora të mos shkonte tek Arbeni, i cili qenktësh sëmurë me bronkopneumoni. Ajo u tregua e durueshme, e dëgjoji deri në fund dhe s'e ngriti asnjëherë zërin, por s'hoqi dorë nga e saja, shkoi që shkoi. Vallë, ku e gjente tërë atë vendosmëri? Ajo vetë s'do të kishte guxuar të vepronte ashtu. Në gjithë jetën e saj nuk mbante mend të kishte ngritur ndonjëherë krye. Por, s'kishte pasur pse, ndoshta, po të kishte dashuruar... Në një farë mënyrë ia kishte

lakmi së kumatës, megjithëse nuk donte t'ia pohonte as vetes këtë.

Ani i hodhi sytë përsëri mbi faqet e librit. E verboi bardhësia e tyre, prandaj u kthye kundër dritës dhe vazhdoi të lexonte. Moti i bukur dhe qetësia e atij mëngjesi e bënin të shpresonte se edhe shtrëngata në familjen e tyre do të kalonte së shpejti.

Dikur iu duk se kërciti dera e jashtme e apartamentit. Përtoi të luante nga vendi.

«Ndoshta më bënë veshët!», — mendoi.

Sakaq u dëgjuan hapa në korridor dhe te pragu ia behu Flora.

— Oj, ti qenke?, — tha Ani, që ndërkohë kishte brofur në këmbë. — Kujtova mos kisha harruar derën çelur. S'paskeni pasur leksione sot?

— Nuk shkova!, — iu përgjigj Flora shkurt.

Ajo lëshoi çantën mbi shtrat dhe vështroi si e hutuar përreth. Dukej shumë e shqetësuar. Sytë i kishin zënë rrahthë mavi dhe buzët i mbante të shtrënguara. Fytyrën e kishte të zbehtë dhe vështrimin të acaruar.

Atë natë Flora pothuaj s'kishte mbyllur sy. I duhej të merrte pa tjetër një vendim. Qysh atë ditë që shkoi në spital, tek Arbeni, i vëllai s'i fliste me gojë. Jo vetëm kaq por, kur kthehej në shtëpi dhe e gjente atë në kuzhinë, shkonte në dhomën e vet dhe priste atje, gjersa të largohej ajo. Atëherë largohej Flora pa ngrënë e mbyllej në dhomën e saj. Disa herë Ani ia kishte çuar darkën në dhomë, por ajo s'e prekte me dorë. Kështu që mbushur kupa, ajo e ndiente veten të tepërt në atë shtëpi, prandaj i duhej pa tjetër një rrugëdalje. Arbenin s'e kishte që të këshillohej, kështu që i duhej të vendoste vetë. U përpallit gjithë natën me lloj-lloj mendimesh, herë vendoste kështu e herë ashtu, por më në fund i dha karar të transferohej në konvikt. I vinte keq, por s'kishte rrugëdalje tjetër...

Flora zbriti nga mbirafti valixhen e saj të vjetër, i shkundi pluhurin dhe e vendosi të çelur në dysheme. Hezitoi një çast, duke menduar nga t'ia fillonte, pastaj çeli të

dy kanatet e dollapit dhe nisi të nxirrte plaçkat e saj. I paloste dhe i rendiste ngjeshur në valixhe.

«Vallë, ç'i ka shkrepur kësaj?», — mendoi Ani, duke ndjekur me bisht të syrit veprimet e së kumatës.

— Për ku kështu?, — pyeti pas pak.

— Në konvikt.

— Në konvikt, the?!, — brofi ajo.

— Po.

— Pse, nuk je mirë këtu?, — Ani shkoi pranë saj dhe e vështroi së larti, me krahët të lidhur mbi krahavor.

— Jam e detyruar të veproj kështu, — tha Flora disi e nevrikosur.

— Nuk të përzuri njeri.

— Ashtu?! Mos duhet të pres që të më nxjerrin për krahu jashtë?... Megjithëse, ashtu do të ishte më e lehtë për mua. Më vjen shumë keq që ndodhi kështu, por s'mund ta pranoj kushtin që më është vënë dhe as mund të shkel mbi dinjitetin tim.

— Petroja për të mirën tënde e ka!, — tha Ani.

— Fatkeqësisht, ka ardhur dita që e mira e tij nuk pajtohet me të mirën time!, — ia priti Flora.

— Mos u ngut, ndoshta i bie inati, ti e di si e ka ai!, — e këshilloi e kunata.

— Jo, s'kam ç'pres; s'është punë inati, por botëkuptimi!, — tha Flora.

— Eh, i ziu Petro, nuk i mjaftojnë ngatërresat e punës, por na edhe kjo tani!, — i qau hallin Ani. — Ç'po i nxihet faqja, të ngratit!

— Prej meje jo, s'kam bërë ndonjë turp!, — kërceu Flora, duke çuar kokën me krenari.

— Ja, kjo që po bën, ç'është? E ke menduar ç'do të thonë bota?

— Ama edhe ti, bota-bota!, — shpërtheu Flora. — Pa më trego, qysh të bëj? Të pranoj që të ma sjellësh ti darkën, si ndonjë geni? Të dorëzohem pa kushte? Pse, ç'jam unë? Jo, moj Ani, nuk dal në mes të katër udhëve, kam ku shkoj, kam me se jetoj. Të drejtat e mia, personalitetin tim, s'm'i shkel dot njeri.

«Kije inat, por jepi hakun; vajzë trimëreshë!», — tha me vete Ani.

— Ti qofsh, unë s'do ta bëja dot këtë!, — iu drejtua pastaj tjetrës.

— Ti s'e ke atë guxim, për fat të keq, se je brumosur ndryshe!, — vërejti Flora.

— Po, dhe jam krenare për këtë!, — u krekos Ani. — Njeriu për një nder jeton në këtë botë, përndryshe, rro sa të duash!

— Varet si e kupton secili nderin!, — tha Flora, duke palosur një bluzë.

— Nderi është një për të gjithë.

— Jo. Dashuria është turp për ty, kurse për mua jo. Unë, ndryshe nga ti, nuk e quaj aspak të ndershme një femër që, në prag të fejesës me njërin, do të ishte gati të përfundonte me një tjetër, po të qe një rast më i leverdisshëm.

— Flet kështu se nuk e njeh jetën, moj vajzë!, — tha Ani, së larti. — Nuk dua të digjesh, se e mira e tëndit s'të zë, kurse e keqja të zë, por duhet të digjesh një herë, që ta mësosh ç'është zjarri.

— Më kollaj kapërcej njëqind rrathë të zjarrtë, le të digjem, po s'qeshë e zonja, sesa të pranoj përkëdhelitë e një njeriu që e ka fituar këtë të drejtë vetëm në bazë të një aktmarrëveshjeja!, — theksoi Flora.

— Ti, si gjithmonë, i tepron gjërat!, — vërejti Ani. — Edhe ata që martohen me njohje, fitojnë një farë simpatie reciproke, pa vendosin. Pastaj lind edhe dashuria...

— Më thuaj të vërtetën, ti, a e ke dashuruar Petron, a e dashuron sot?, — e pyeti Flora, duke e mbërthyer me sy.

Ani ngriti supet.

— Ta merr mendja që e dua. E kam burrë.

— E qartë, por unë të pyeta në e dashuron. Se ashtu the, «pastaj lind dashuria...»

Ani mbeti e hutuar, si një nxënëse që nuk e di mësimin. Flora s'ia ndau sytë dhe vazhdoi plot zjarr:

— Thuajmë, a ke ndier ndonjëherë mornica mallën-

gjimi vetëm duke dëgjuar zërin e Petros, a ke dëshiruar të vijë rasti që të bësh një sakrificë të madhe për të?...

— Këto janë shfaqje patologjike të pasionit!, — buzëqeshi Ani, e cila e kishte përmbledhur sakaq veten. — Jeta kërkon të tjera gjëra. Unë e bëj ç'duhet bërë, bile me të tepërt. Për të kujdesem më shumë se për vete, nderin ia ruaj, shtëpinë ia mbaj, shokët dhe farefisnin ia pres dhe ia përcjell. Ç'i mungon, pra?

— Ju mungon që të dyve një shok i vërtetë jete, që të bëhet krah, jo vetëm për të përballuar nevojat e rëndomta të jetës së përditshme, po për të çarë përpara në jetë.

— Fjalë të mëdha!, — Ani bëri me dorë një gjest përmues.

— Kujton ashtu, se ti synon një lumturi të vockël, brenda mureve të këtij apartamenti dhe nuk arrin ta kuptosh se lumturia e vërtetë është një tjetër, më e gjerë, më e madhe. Kam parë shkëndijëza lumturie në sytë e tu kur bleve frigoriferin, sixhaden, kur bëre me porosi bufenë, kur ke blerë ndonjë fustan apo plaçkurinë tjetër, por të gjitha këto janë fikur si shkëndijëza të dobëta. Sa të varfra janë gëzimet e vockla pa ato të tjerat, të mëdhatë! Kurse ti ke një profesion që t'i ofron me bollëk e megjithatë...

— Gjer më sot s'më ka thënë njeri as kaq për punën!, — e ndërpreu Ani, duke treguar majën e thoit.

— Mundet. Ti ndoshta e respekton rregulloren e brenshme të ambulancës me atë përpikmëri që zbaton rregullat familjare, veç, më duket se për të gjitha këto nuk të shtyn zjarri i brendshëm, pasioni, por dëshira e ftohtë për të qenë në rregull, për të ruajtur situatën e krijuar dhe emrin e mirë karshi botës. Ti nuk i dashuron njerëzit, Ani. Po s'dashurove njerëzit dhe punën, sado korrekte qofsh, s'arrin gjë. Ti u bëre doktoreshë më fort që të kënaqje egon tënde dhe të familjes, që të gjeje një burrë sa më të përshatshëm, që të siguroje mirëqenien, sesa që t'u shërbeje njerëzve. Në mos daç ta pohosh karshi të tjerëve, tregohu e sinqertë karshi vetvetes, a s'mendove kështu kur hyre në mjekësi?

— Tepër kam bërë për njerëzit!, — tha Ani, duke bu-

zëqeshur hidhur. — E ç't'u shërbesh atyre, që të ta shpërblejnë kështu, si ti?! Hëngre e pive kaq kohë këtu, bano ve si jo më mirë, s'dëgjove kurrë fjalë të hidhura nga goja ime dhe, ja shpërblimi. Ti gjithmonë këto mendime ke pasur për mua, të zeza si nata.

— Më vjen keq që e merr kështu, Ani!, — tha Flora mirëdashëse. — Të lutem, besomë, s'kam qëllim të të fyej, por të të ndihmoj. S'jua dua të keqen se, siç e the vetë, e keqja e tëndit të zë. Ka diçka që s'shkon te ju të dy, ia kam thënë edhe tim vëllai. S'je vetëm ti fajtoje jo, por edhe ai, bile ca më shumë.

— S'kam ndonjë ankim ndaj tij, përkundrazi!, — tha Ani. — Petroja është burrë i pjekur, që...

— S'është nevoja të më numërosh cilësitë e tij!, — e ndërpreu Flora, duke buzëqeshur hidhur. — Si motër, jam e prirur t'i shikoj më fort anët e mira, por, megjithatë, ai s'është në binarë. Jo për çështjen time, këtë do ta përjashtoj më nga biseda, po për vete, për ju të dy.

— Nga e nxore këtë?, — u vrenjt Ani.

— Nga ato që po ndodhin në uzinë dhe këtu, në shtëpi!, — ia priti Flora.

— Ke marrë vesh gjë për andej, nga uzina?, — u shqetësua Ani.

— E shikon ç'pyetje bën? Pse, normale të duket që ne presim t'i mësojmë nga të tjerët hallet e Petros?

— Këtu ke të drejtë!, — tha Ani dhe uli kokën. — Por, ti ia di karakterin të vëllai.

— S'është punë karakteri, ai s'ka qenë i tillë, i ka fituar kohët e fundit këto veti!, — vërejti me keqardhje Flora.

— Mos do të thuash se edhe për këtë unë e kam fajin?!, — u vu në mbrojtje Ani.

— Aspak. Mendoj se ka arsye të tjera. Ai na përçmon ne të dyja, s'na quan të denja për të rrahur hallet e tij. Nga ana tjetër, s'e lë sedra.

— Megjithatë, s'më tregove si i ka punët andej, nga uzina!, — nguli këmbë Ani.

— Nuk di ndonjë gjë të madhe. Rastësisht kam bise-

duar me disa nga shokët e tij të punës, por, ç'mund të më-sosh nga një bisedë në rrugë?! Pastaj, njerëzve u vjen rën-dë të ta thonë troç. Por, një gjë është e qartë: Petros i është rritur mendja, e kujton veten shquar nga të tjerët dhe s'heq dorë kollaj nga e vetja.

— Me atë kokë që ka, druhem se do ta pësojë!, — u shqetësua Ani. — Do t'i këputin ndonjë transferim, pikërisht tani që zëmë karar...

— Kjo s'do të ishte gjë fare!, — tha Flora.

— Pse, çfarë tjetër?, — u tremb Ani.

— Kur nis të rrëshqasësh, po s'e kuptove në kohë dhe po nuk u mbajte te duart që të zgjatin shokët, mund të përfundosh edhe në greminë!

— Po, po, ke të drejtë, gjithçka mund të ndodhë...

— Por, besoj se puna nuk do të shkojë gjer atje!, — vazhdoi Flora. — Jam e sigurtë se shokët s'do ta lëshojnë, edhe ti duhet ta ndihmosh, ndërsa unë...

Ajo uli kokën dhe psherëtiu me keqardhje.

— E si mund ta ndihmoj, përderisa ai..., — ngriti supet Ani.

Flora u mendua një hop.

— Ndoshta është mirë ta fillosh duke ngritur krye kundër tij!, — tha pastaj.

Ani e vështroi me ca sy thellësisht të habitur dhe të hutuar.

— Të ngresh krye me të drejtë, — vazhdoi Flora. — Pak herë ta ka marrë fytyrën për hijgjë, për një gjellë të pagoditur a për një këmishë të pakollarisur mirë? Pak herë s'e ka mbajtur fjalën karshi teje dhe s'ta ka varur edhe kur ke pasur ndonjë kërkesë të drejtë? Të ishte fjala për ndonjë të metë tënden, hajdede, po për ato që duhet ai s'e prish qetësinë. Unë ia kam thënë troç këto edhe Petros.

— Ndoshtin këto në familje!, — tha Ani dhe uli kokën e prekur. — Njëri duhet të lëshojë rrugë dhe më shpesh i takon gruas ta bëjë këtë. Përndryshe, vjen grindja dhe prej saj s'ka parë kush dobi.

— Pse, për hir të qetësisë, do t'ia falim njëri-tjetrit të metat dhe gabimet? Për hir të qetësisë do të lëmë ndo-

kë të na tundë këmbët në qafë? Në asnjë mënyrë! Unë nuk dua t'ju fus në grindje, por një qetësi e tillë është e dëmshme për familjen.

— Eh, moj motër, mos të zëntë, se nuk është kaq e lehtë, jo!, — psherëtiu Ani.

Ajo e kishte humbur tani atë pamjen krenare dhe plot siguri në vetvete; kishte harruar se u nis t'i jepte një mësim të mirë asaj çupërlinë dhe në mënyrë të pavetëdijshme qe shndërruar në një grua që është bërë për të qarë hallin. Qëndronte akoma në këmbë, por disi e kërrusur dhe me duart të lëshuara përgjatë trupit, ndërsa vështrimin e kishte të shqetësuar, të lodhur, me hijen e një brenge të thellë.

— Se mos unë e kam të lehtë!, — tha Flora dhe një rë kaloi në vështrimin e saj. — Megjithatë, duhet luftuar, në radhë të parë me vetveten. Kjo është më e vështira...

Ajo mbylli valixhen, e nxori në korridor, u kthye dhe vështroi hezituese rreth e qark, sikur deshi të bindej që s'kishte harruar gjë. Përveç abazhurit të saj të vockël, gjithë orenditë ishin në vendet e tyre e megjithatë dhoma dukej tani e ftohtë, pa jetë. Kujtoi, si në një film të përshpejtuar, ditët dhe netët që kishte kaluar aty, mendimet dhe ëndrrat që kishte thurur. I erdhi keq që po ikte në këtë mënyrë. Një lëmsh mallëngjimi iu mblodh në grykë. Kishte frikë se do t'i mbusheshin, hë-hë, sytë me lotë dhe kafshoi buzën, gjersa i dhembti.

— Ç't'i them Petros?, — pyeti Ani, me sytë perdhe.

— I kam lënë një letër!, — tha, duke treguar me gisht një zarf mbi tryezë. Flora u mendua të buzëqeshte dhe i zgjati dorën.

— Të daltë mbarë!, — e uroi Ani dhe psherëtiu.

Ato mbetën një çast përballë njëra-tjetrës, secila me shqetësimin e vet, pastaj Flora rrëmbeu valixhen dhe iku me nxitim, pa kthyer kokën. Kur u kujtua Ani që ta përcillte, u mbyll dera e jashtme dhe u dëgjuan hapa të shpejtë nëpër shkallë. Ajo doli me hapa të plogët në ballkon dhe priti që Flora të dukej poshtë.

Tani i vinte keq që Flora po ikte. Në mënyrë të tur-

bullt, ë kuptonte se nuk ishte vetëm lidhja familjare që ia shkaktonte këtë keqardhje. Në thellësinë e vetvetes ajo gjithmonë ia kishte admiruar çiltërsinë dhe guximin. Në ato që thoshte ajo kishte pa dyshim edhe gjëra të vërteta.

Në stacionin e autobusëve kishte fare pak njerëz. Ishte ora në të cilën dyqanet mbylleshin, fëmijët akoma s'kishin dalë nga shkolla, të rriturit ishin në punë, kurse gjyshet përgatishnin drekën nëpër shtëpi, prandaj rruga dukej e qetë. Edhe autobusi arriti pothuaj bosh.

Flora rregulloi valixhen në një qoshe, pagoi biletën dhe zuri vend pranë xhamit. Vështroi stacionin, godinat pranë të cilave kalonte përditë dhe e pushtoi përsëri nostalgjia.

Arriti në konviktin e vajzave para se të mbaronin leksionet, prandaj edhe oborri i tij ishte më i qetë se kurdoherë. Në shkallët e hyrjes qenë ulur e po shullëheshin në diell dy studente. Një tjetër, e veshur me tuta vishnje, po ndërte rrobat e lara në degët e pemëve. Ndërkaq doli dhe u vërsul drejt Florës një vajzë e imtë, që çalonte pak. Ishte Rina, një nga shoqet e kursit.

— Ku je, moj, se plasa duke të prituri!, — i thirri ajo, me një pamje të gëzueshme. — E di? E rregulluam me administratën që të vish në dhomën tonë.

— Do t'ju ngushtoj tepër, moj Rinë!, — i tha Flora, e prekur nga përkujdesja e tyre.

— Punë e madhe, se mos do hedhim valle! Jemi për-bukuri. Shtratin ta vendosa pranë timit. Mirë? Bile, ta kam shtruar. I mora unë pajisjet në dorëzim.

— Nuk paske shkuar në leksion?

— Mora lejë dy orët e fundit.

Flora e vështroi shoqen me dashuri dhe mirënjohje. Ndërkaq, hynë në dhomë dhe ajo lëshoi valixhen. Nxori shaminë, fshiu bulëzat e djersës nga balli dhe vështroi për-reth me kureshtje, ashtu siç e vështron kushdo vendin e ri të banimit.

Shtretërit metalikë, të renditur pranë e pranë, ishin të shtruar me kujdes prej femre. Në qoshen afër portës ndodhej një raft i madh kompensatoje, kurse në qoshen

tjetër, përballë dritares, një tryezë dhe dy karrige. Në shpinëzën e njërës prej tyre qenë vendosur një fund dhe një bluzë lejla. Mbi tryezë ishte një çentro e thurur me grep dhe mbi të një vazo me lule mimoze. Dhoma, si çdo dhomë, kishte kundërmimin e saj të veçante, që ishte i ri për Florën, Megjithatë, ky ambient i ngjalli asaj kujtimet e jetës së kaluar në konvikte dhe nostalgjia e saj e ngushëlloi disi.

— Budallaqe, mos u mërzit, do t'ia kalojmë përbukuri bashkë!, — i tha shoqja. — Unë do isha e lumtur sikur të kisha për kë ta bëja një sakrificë të tillë!

Ajo buzëqeshi, por kishte diçka të trishtuar në buzëqeshjen e saj.

— Sa e mirë që je!, — i tha Flora dhe i shtrëngoi dorën me dashuri.

Në oborr u dëgjuan zëra dhe thirrje të hareshme.

— Po kthehen shoqet nga leksionet!, — tha Rina.

Flora ktheu kokën nga dritarja. Vuri rë një degë molle që varej në cepin e sipërm të saj.

«Në pranverë, kur të çelë lule, do të duket shumë bukur!», — mendoi, ndërsa ndiqte me sy studentet, që afroreshin plot gjallëri.

Befas, ai ambient lu bë i dashur, i ngrohtë dhe familjar.

13

Arbenit i kishin thënë se ndoshta atë ditë do të dilte nga spitali. Pritej radiografia që kishte bërë të djeshmen. Por, kaloi dreka dhe përgjigjja s'po vinte. Ai ia hoqi fillin asaj pune dhe vazhdoi leximin e romanit. Ca nga ca e rrëmbyen aq fort ngjarjet e tij, sa harroi gjithçka.

Atij gjithmonë i kishin pëlqyer veprat për njerëzit e fortë. E kishte bërë zakon që, pasi i lexonte, të gjykonte me vete nëse ai, po të ndodhej në të njëjtat vështirësi, do të ishte i zoti t'i përballonte si heroi, apo jo. I pëlqente të arrinte në përfundimin se po dhe inatosej me vetveten

kur dyshonte. Nganjëherë i vinte keq që s'kishte pasur rast të vihej në provë, sepse jeta e tij i dukej fare e thjeshtë.

Ai, bir i një muratori të ndershëm me shtatë fëmijë, mbahej si djalë i urtë, kishte qenë një nxënës i mirë dhe një teknik ndërtimi i zellshëm, që s'e kishte kursyer asnjëherë veten në punë, por të gjitha këto i dukeshin krejt të rëndomta.

— Hej, akoma po ngrohke vezë ti, këtu?, — dëgjoi një zë të njohur, gazmor.

Ngriti sytë dhe pa një shok nga ata të Fakultetit të Mjekësisë, që bënë praktikën në atë pavijon.

— Mos rëntë njeriu në duart tuaja, se nuk e lëshoni kollaj!, — buzëqeshi Arbeni, duke fërkuar sytë me pëllëmbë, se i digjnin nga leximi.

— Se mos t'u lut kush të vijë!, — ia priti tjetri. — Po mos u mërzit, sot do të dalësh, dëgjova shefin e pavijonit dhe erdha të të jap sihariqin.

— Hë, të lumtë goja!, — kërceu përpjetë Arbeni, duke flakur mbulesat.

— Ngadalë, lum miku, se mos kujtojnë që lajthite dhe të çojnë në atë pavijonin tjetër!, — bëri shaka shoku.

Me ndihmën e tij, Arbeni i kreu të gjitha formalitetet në më pak se një orë, u vesh me nxitim, u përshëndet me personelin dhe të njohurit dhe ia mbathi. Ndërsa përshkonte korridoret e gjata, i bëhej sikur ndonjëri nga ata me bluzë të bardhë, që dukeshin e zhdukeshin nëpër dyert e shumta, do ta zinte për krahu dhe do t'i thoshte: «Shoku pacient, dalja u prapësua, ju duhet të qëndroni në spital edhe disa ditë!» Prandaj, shpejtonte dhe dredhonte midis tyre e mezi priste t'u gjente fundin korridoreve.

Iku nga spitali si zogu nga kafazi dhe vetëm kur u gjend në rrugë, mori frymë thellë, i gëzuar. Hipi në autobusin urban, zuri një qoshe dhe bëri sehir me ëndje pamjet që parakalonin përtej xhamave, sikur t'i shihte për të parën herë.

Me të zbritur, ia mbajti drejt e në konvikt, të linte ato pak plaçka që kishte pasur në spital dhe të takohej me ndonjërin nga shokët. I dukej sikur kishte një jetë të tërë

që mungonte dhe u gëzua, bile, u mallëngjye, kur pa të shfaqej konvikti para tij.

Ndryshe nga ç'e kujtonte, konviktin e gjeti plot. Shokët kishin qenë atë ditë në punë vullnetare, sapo ishin kthyer dhe po bëheshin gati të dilnin shëtitje në qytet. Në korridorin e konviktit vërehej një vajtje-ardhje e pandërprerë. Dëgjoheshin krisje dyersh, hapa, thirrje, fragmente bisedash dhe gjithfarë zhurmash, që ishin të njohura dhe familjare për të.

Kur hyri në dhomën e vet, dikush po këndonte një melodi të festivalit të fundit të këngës në radio, ndërsa një tjetër i mbante ritmin në tryezë. Shokët brofën të gëzuar dhe iu vërsulën ta përqafojnë, sikur kishin një vit pa e parë, megjithëse secili e kishte vizituar të paktën dy herë gjatë atyre dy javëve.

— He, pikërisht sot, që kishim menduar dredhinë më të bukur, për t'ia lagur portierit të spitalit!, — bëri shaka Ibrahim, duke goditur pëllëmbën e majtë me kurrizin e dorës së djathtë.

— Tani do të gjejë paqe doktor Hysniu, që tërbohej sa herë na gjente në pavijon!, — tha një tjetër.

— Hë, a ndihesh i fortë tani?, — e pyeti një i tretë.

— Hata, betonarme i markës katërqind!, — iu përgjigj buzagaz Arbeni, duke vështruar rreth e qark me një farë malli.

Dhoma e tyre, si zakonisht para shëtitjes së mbrëmjes, qe trazuar nga tallazi i përgatitjeve. Rrobat dhe ndërresat e përditshme lëshoheshin aty-këtu, pa ndonjë respekt, kurse rrobat e reja dhe këmishët e pastra, prisnin të krekosura në shpinoret e karrigeve ose në varëse. Mbi tryezë dergjeshin, si në tablötë e natyrave të qeta, furçe dhëmbësh, sapunë rroje tubete kolodonti, lëvozhga portokalli dhe cikërrima të tjera. Në cep të tryezës, njëri po shkruante letër.

— Si lum prindërit që të kanë!, — e ngacmoi Arbeni. — Mezi u kujtove t'u shkruash, dhe tani ngutësh, sikur të ndjek mortaja.

— Ore, ti, magazinë shëtitëse e Profarmës, më lër të qetë!, — iu shkreh, ai, pa e çuar kokën.

Arbeni brofi në këmbë, iu afrua në majë të gishtave, u përkul mbi supin e tij dhe bëri sikur lexonte:

— Të dashur prindër, me shëndet jam top, veç kam mbetur ca hollë nga xhepi, prandaj...

— Hiqmu qafe, djall!, — bubulloi tjetri, duke u kthyer ndaj tij i xhindosur. — Më mirë shko e rruhu, të është bërë faqja si lëkurë iriqi! Kështu s'të do as Flora.

— A të erdhi në spital këto ditë ajo?, — pyeti Ibrahimimi.

— Qysh të martën, jo!, — u përgjigj Arbeni.

— S'ditke gjë, pra!, — tha nëpër dhëmbë Ibrahimimi.

— Ç'farë?, — u shqetësua Arbeni.

— Ajo ka shkuar të banojë në konviktin e vajzave.

— Pse?

Arbeni e kuptoi sakaq kotësinë e pyetjes dhe nuk priti përgjigje. Rrëmbeu peshqirin, veglat e rrojës dhe nxitoi te lavamanët. Atje mbahej radhë. Priti sa prit, vështroi nja dy herë orën, pastaj e humbi durimin.

— Boll, se e rrope lëkurën!, — iu shkreh atij që kishte përpara, i cili po lahej dhe fërkohej me nge.

— Mos u ngut, vogëlush, se, në të dashtë, të pret, ndryshe s'ke ç'e do!, — ia prit ai me shaka. — Megjithatë, po tërhiqem. Fjala e urtë popullore duhet plotësuar kështu: «Të marrit, të dehurit dhe të dashuruarit, bëji udhë».

Të tjerët e pritën me të qeshura të bujshme shakanë, po Arbeni s'ua vuri veshin. Mbaroi punë shpejt e shpejt dhe u kthye në dhomë. Lëshoi në sirtarin e komodinës veglat e rrojës, rrëmbeu pardesynë dhe shkoi drejt derës me nxitim.

— Ore, mos e merr me të pestin, sepse sapa dole nga riparimi dhe duhet të shtrosh motorin njëherë!, — i thirri që prapa, për t'u hakmarrë, studentit që shkruante letër.

Arbeni qeshi dhe fluturoi jashtë. Rruga ishte plot me studentë që zbrisnin në qytet, duke formuar një rrjedhë të gëzueshme.

Ajri që i freskët, i pastër dhe i qetë. Degët lakurice të drurëve ndereshin të palëvizura drejt qiellit. Drita e

butë e perëndimit kishte nuanca rozë në të purpurt. Nga Liceu Artistik vinin fragmente të përziera melodish. Gjithçka dukej e bukur dhe optimiste. Megjithatë, Arbeni nxitonte kokulur dhe mundohej të gjente me mend se ç'i kishte ndodhur Florës.

Disa ditë para se të shtrohej në spital, ajo i kishte thënë shkarazi se Petroja nuk e shikonte me sy të mirë miqësinë e tyre dhe se i kishte vënë disa kushte që ajo nuk do t'i pranonte kurrën e kurrës, por nuk deshi t'ia tregonte çfarë, megjithëse ai kishte ngulur këmbë shumë.

Ai që treguar i gatshëm të njihej dhe të bisedonte me Petroën, por ajo i kishte dhënë të kuptonte, larg e larg, se s'pranonte i vëllai. Ai që habitur dhe kishte rrudhur supet disi i fyer. Atë mbrëmje që e bënë këtë bisedë, ajo ishte treguar më e dashur dhe më e kthjellët se asnjëherë, por i mbajti hapat dhe iu lut të mos e përcillte më tej, sapo arritën karshi pallatit të tyre.

— Mos më keqkupto, nuk trembem, as lëshoj pe, por s'dua të jap unë shkas për grindje!, — i kishte thënë...

Arbeni shqetësohej për ç'mund t'i kishte ngjarë Florës, por nuk trembej. Ai ishte kaq i sigurtë në ndjenjat e tij, sa çdo dyshim i dukej një absurditet i madh.

Dashuria për Florën ishte për të diçka e re dhe krejt e ndryshme nga ato pak simpati që kishte pasur, prej të cilave s'i kishte mbetur asnjë mbresë. Kjo dashuri nuk i kishte ardhur si ujërat e rrëmbyera të një përroi pas shiut, por i qe rritur si një lis, që lëshon rrënjë përherë e më të thella.

Flora ishte e pranishme në të gjithë planet dhe ëndërrimet e tij të guximshme. Jo duke gatuar gjellë në kuzhinën e ngrohtë, as duke qëndisur, apo duke e pritur buza-gaz te pragu i shtëpisë, por gjithmonë krah tij, mbi skelat e ndërtimit, në pushimet buzë detit, në inaugurimin e një objekti të sapopërfunduar, në ditën e parë të shkollës për fëmijën e tyre. Ai po kuptonte me një farë habie se Flora, dikur një e panjohur, i qe bërë tani më e afërt se më të afërmit e tij.

Më parë, martesë e trembte me të panjohurën e saj, i

dukej si një prag i madh e i vështirë për t'u kapërcyer. Kishte marrë pjesë dikur në fejesën e një kushëriri. Paskë-taj, sa herë vinte fjala për martesë, i kujtohej pamja e tronditur e kushërinit gjatë ceremonisë, fytyra e tij e dirsur, duart që ai s'dinte ku t'i fuste dhe përgjigjet çapraz që jepte gjatë bisedës. Tmerrohej, kur e përfityronte veten në një situatë të atillë. Tani, të gjitha këto i dukeshin qesharake. Sepse ai me Florën ishin bashkuar në mënyrë të natyrshme me njëri-tjetrin, për ta vazhduar bashkërisht gjithë pjesën tjetër të rrugës.

Në qiell po shuheshin flakërimat e perëndimit, por në sytë e Arbenit qenë ndezur flakërima të tjera. Ndërsa mendonte për jetën, për të ardhmen, ai ndiente një ngazëllim të parrëfyeshëm.

Të parën studente që takoi te hyrja e konviktit të vajzave e luti t'i thërriste Florën.

— Kë, atë që erdhi këto ditë?, — pyeti ajo, me djallëzi.

— Po, atë!, — iu përgjigj ai, pa e vënë re djallëzinë e saj. E brente padurimi dhe i erdhi inat me studenten që po ecte aq ngadalë drejt konviktit. Pas një copë here njohu siluetën e Florës, që doli nga porta e xhamtë, dhe diç u qetësua, kur vuri re se ajo po i buzëqeshte.

— Oh, Arben, paske dalë nga spitali?!, — u gëzua ajo, sapo ndali vrapin pranë tij. — Si ndihesh tani?

— Mirë, fare mirë!, — iu përgjigj ai buzagaz. — Po ti, ç'që kjo që bëre?

— Durim, do të ta tregoj. Eja të shëtisim pak.

Ajo tregoi me dorë nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe priu. Ia tha të gjitha, me hollësi.

— Pse nuk m'i ke treguar kështu më parë?, — e qortoi ai.

— Më vinte rëndë!, — tha Flora, duke ulur kokën.

— Prej meje?!

— Më dukej sikur edhe unë do të kërkoja të njëjtën gjë.

— Fundja, për t'u bërë është!, — tha Arbeni i menduar.

— Kur të vijë vetvetiu, jo kur të thonë të tjerët!, — vërejtí ajo. — Përndryshe, do të ishte fyese për ne dhe për miqësinë tonë.

Ai s'foli, por me vete i dha të drejtë.

— Megjithatë, më vjen keq!, — vazhdoi Flora, — Jo dhe aq ngaqë u ndava me të vetmin njeri të afërt që kam, por, sepse ndodhi në një kohë që Petroja ka nevojë për ndihmë, që të gjejë vetveten. Nganjëherë, çuditëm si ndryshoi kështu im vëlla.

— Këto janë gjëra që ndodhin në jetë!. — tha Arbëni. — Kur fillon e rrëshqet nga rruga e drejtë, nuk gjëmojnë as topat, as nuk bien trumbetat. Kjo vjen dalngadalë, pa e kuptuar as vetë i zoti. Një lëshim sot, një tjetër nesër; i pari më i vogël, i dyti më i madh; kështu, vjen një ditë që gjendesh në anën tjetër. Sigurisht, kjo ka arsyet e saj. Nuk e di cilat janë në rastin e vëllait tënd, ato që the, apo të tjera, por ty të përket t'i zbulosh dhe ta ndihmosh, pa qenë vonë.

— Ashtu është, por ç'mund të bëj unë, që jam dhjetë vjet më e re se ai? Aq më tepër tani, që s'më flet me gojë!

— Ç'nuk mund të bëjë shoqja për shokun, ç'nuk mund të bëjë motra për vëllanë?! Të kujtohet legjenda e Mujit dhe e Halilit?

Ajo uli kokën dhe ra në mendime.

— Po sikur të bisedoj me shokët e tij?, — pyeti pastaj.

— Mendim i mirë!, — tha Arbëni.

Ata e kishin lënë pas Fakultetin e Gjeologjisë dhe po i ngjiteshin përpjetë shtegut të asfaltuar. Ecnin të heshitur dhe të menduar. Mbi koka u gërshetoheshin kurorët e drurëve, ndërmjet të cilave filluan të dukeshin yjet.

— A u sistemove mirë në konvikt?, — pyeti Arbëni.

— Po, fare mirë. Në fillim deshën të më vinin me studentët e vitit të parë, por pastaj më bënë vend shoqet e kursit në dhomën e tyre, sigurisht duke u ngushtuar ca.

Ata vazhduan rrugën të heshtur. Flora e kuptoi se ai po vriste mendjen për gjendjen e saj. E zuri për dore dhe tha, me një pamje të gëzuar:

— Jam mirë në konvikt, Arben! Sa e dashur dhe optimistë m'u duk gjallëria e konviktit!

— Bllokun e mensës, e more?

— Po, Të gjitha në rregull i kam. Ja, do të mbarojmë vitin, pastaj do të shkojmë së bashku në aksion...

— Pastaj?, — e ndërpreu ai, duke e vështruar me ngulm.

— Edhe këtë e kam zgjidhur!, — buzëqeshi ajo, duke e kuptuar domethënien e pyetjes së tij. — Do të shkoj të punoj në kantierin tim. Jam e sigurtë se do të më presin krahëhapur. Dy javë çlodhje më mjaftojnë; tek e fundit, gjithë punonjësit aq pushojnë, apo jo?

— Ç'punë do të bësh atje?, — e pyeti ai, duke e vështruar me dashuri.

— Ç'të jetë, muratore, për shembull. Pse qesh?! Ta shikosh se ç'punë nxjerr! Besoj se ta kaloj, megjithëse je bir muratori.

— Mos u lavdëro kaq shumë!

— Me gjithë mend e kam! Mësova kur isha në kantier. Po nuk dite vetë, s'je ballëhapur kur i kritikon punën tjetrit. Punoj ngadalë, por atë që bëj, e bëj!

— Prandaj i ke duart kështu, të ashpra!, — vërejti Arbeni, duke i ledhatuar pëllëmbët.

— Pse, nuk të pëlqejnë, i do të buta?, — Ajo i hodhi një vështrim çapkën.

— Përkundrazi!, — Ai ia shtrëngoi duart me dashuri në pëllëmbë, pastaj tha: — Mirë, kemi kohë; të mbarojmë njëherë vitin, pastaj aksionin, pastaj... shohim e bëjmë!

Kishin arritur në majën e kodrinës. Hëna s'kishte dalë ende dhe liqeni nuk dukej, por ndihej prania e tij nga puhia e lagësht që frynte. Dëgjoheshin fëshfëritjet e gjetheve dhe lëvizjet e befta të gjallesave nëpër bar e kaçuba, që ia shtonin fshehtësinë natës.

— Zbriti vesa!, — tha Flora, duke përkëdhelur me pëllëmbë barin e dendur e të njomë të lëndinës, përmes së cilës kalonin; pastaj i shkoi mbi fytyrë pëllëmbët e lagura dhe lëshoi një klithmë kënaqësie.

Arbeni vështroi orën.

«Flora e bëri të vetën, tani më takon mua!, — mendoi. — Megjithatë, do të shkoj të bisedoj me të, do të shkoj qysh sonte, bile!»

— Sa është?, — pyeti ajo.

— Shtatë e dhjetë.

— Duhet të kthehem.

— Kaq shpejt?!

— Harrove se sot ke dalë nga spitali?, — e qortoi ajo, dhe u kthye menjëherë.

Ai e përcolli deri te hyrja e oborrit të madh të konviktit, pastaj ua dha këmbëve në drejtim të banesës së Petros. Ishte e para herë që shkante andej pa Florën dhe ky mendim e bëri të buzëqeshte me vete, megjithëse ndihej disi i shqetësuar.

«Ma merr mendja se do të më besojë!, — i dha zemër vetes. — Ai që s'do të kishte qëllime të ndershme, s'do të shkante të bisedonte me të!»

Pas një copë here arriti përballë pallatit të njohur, ngjiti me një frymë shkallët e hyrjes përkatëse dhe i mëshoi tri herë sumbullës së ziles që ndodhej përbri pllakës me mbishkrimin «Familja Inxh. Petro Lisi».

Ndërsa u dëgjuan hapa në korridor, atij nisi t'i rrihte zemra.

«Kot shqetësohem!», — e qortoi veten, duke marrë frymë thellë.

Portën e çeli Ani. Sa e pa, ajo sikur ngriu në këmbë. Nga lëvizja e buzëve u kuptua se diçka deshi të pyeste, por zëri nuk iu dëgjua.

— Desha të takohem pak me shokun Petro!, — tha Arbëni.

— Më falni një minutë!, — tha ajo, afroi derën gati për ta mbyllur dhe iku me nxitim.

U kthye me vonesë, Kishte një pamje të shqetësuar, si prej fajtojeje.

— Më tha t'i shkoni në zyrë, në paçi ndonjë punë zyrtare, kurse për tjetër gjë s'pranon të...

Ajo uli kokën dhe e la frazën në mes, e zënë ngushtë.

Job — Më falni!, — tha Arbeni, që ndjeu se po i ngjitej gjaku në fytyrë prej zemërimit.

Ktheu krahët dhe iku.

«Sidoqoftë, e kisha për detyrë të veja!» — tha me vete.

14

Megjithëse nuk ishte në Parti, kryeinxhinierin e kishin ftuar në mbledhjen e organizatës-bazë, sepse shqyrtoheshin disa çështje të metodës së drejtimit në uzinë, që lidheshin drejtpërsëdrejti me punën e tij. Sapo mbaroi mbledhja, Petro Lisi u orvat të largohej shpejt e shpejt dhe pa rënë në sy, por sakaq dalja ishte e dyndur me njerëz dhe iu desh të prisë radhën. I ndiente vështrimet e të tjerëve, por ai, që ishte mësuar të dilte gjithmonë kokë-lart nga mbledhjet, këtë radhë s'guxonte të ngrinte kokën dhe të vështronte shokët në sy. E kishin kritikuar rëndë, aq rëndë, sa i patën shkuar shtatë palë djersë.

Dhe ja, tani po e trajtonin me mirëdashje, dikush i thoshte ndonjë fjalë inkurajuese, ndonjë tjetër i rrihte shpatullat ose e zinte për krahu miqësisht. Ai mundahej t'ua kthente gjithashtu miqësisht, por s'ia arrinte dot, e ndiente se buzëqeshja ishte e sforcuar dhe kjo e shqetësonte akoma më shumë.

Sapo kapërceu pragun, me nxitim të matur, që të mos binte në sy, iu shtëmang të tjerëve dhe bëri për nga zyra. E kishte të domosdoshme të mbetej vetëm, që ta përmblidhte ca veten.

Hyri në zyrë dhe e mbylli derën përbrenda me çelës. U lëshua në karrigen e tij, mbështeti kokën mbi pëllëmbë dhe vështroi si i hutuar rreth e qark. Zyra, aq e njohur, iu duk e ftohtë. Orenditë e saj, që i kishin shërbyer për kaq e kaq vjet me radhë dhe me të cilat ishte mësuar, si me të shtëpisë, iu dukën të huaja. E ndiente veten si në zyrën e tjetërkujt.

Brofi në këmbë dhe nisi ecejakën e tij të zakonshme.

Një hop u ndal pranë dritares dhe ndoqi me sy shokët që po dilnin. Kurse ai kishte mbetur aty, i vetmuar...

«Jo, nuk më lanë ata vetëm, më ftuan të dilnim bashkë, vetë s'desha!», — e korrigjoi veten.

Ndërkaq, i ra në vesh zhurma e njohur e uzinës, e cila arrinte gjer aty mbyturazi, si një bubullimë e largët, e pandërprerë.

«Janë ata të turnit të dytë!, — mendoi Petroja. — Uzi-na s'mbetet kurrë vetëm. Mendoi të shkonte te ata por u step. «Mua nuk ma mban të shkoj. Pse, vallë, më vjen rëndë t'u dal përpara, apo më mundon akoma sedra?... As vetë nuk jam në gjendje ta dalloj. Po nesër, pasnesër, si do t'ia bëj? Nuk do të qëndroj i mbyllur këtu!... Duhet bërë lutja, pa tjetër që duhet bërë!»

Ai shkoi dhe u ul përsëri në vendin e vet. Në ato çaste, i shkrepri në kujtesë një rast i largët nga jeta shkollore, kur mësuesi e pat nxjerrë përpara klasës dhe e pat qortuar rëndë për një gjest të keq dhe ai qe kthyer në vendin e vet i dërrmuar nga turpi.

«Po, qenka shumë më e rëndë kur të qortojnë pesëmbëdhjetë shokë!,» — mendoi Petroja, duke zgjatur dorën nga blloku i shënimeve.

E çeli dhe shfletoi faqet e fundit, ku ishin shënime nga mbledhja. Gjashtë faqe me kritika për të. Leksioni më i fortë, më i madh i jetës së vet. Ai nisi të lexonte dhe ndërkohë i dukej sikur dëgjonte rishtas zërin e folësve.

«...Në mbledhjen e këshillit teknik ra çanga për ty. Ne kujtuam se e dëgjove dhe na u bë qejfi. Po ti e paske pasur sa për sy e faqe. Vërtet, zbrisje ndonjëherë në repart gjatë riorganizimit, interesoheshe për furnizimin, por asnjëherë nuk u shqetësove me zemër për pengesat që na dilnin, asnjëherë nuk e lodhe kokën të na jepje një mendim të vlefshëm. Vije dhe shkoje si ndonjë vizitor i jash-tëm. Si duket, doje të mbeteshe në rolin e arbitrit, që t'i fryje bilbilit kur të çalonte puna!...»

«Kështu ka qenë!, — i pohoi vetes Petroja. — Por, për fat të mirë, riorganizimi përfundoi më së miri, bile edhe detyrat e planit ata i plotësuan!»

Ktheu fletën.

«...Ti, shoku Petro, i nxore shtatë lekurë Skënder Tates në provat e kualifikimit, që të mos e merrte kategorinë, sepse foli kundër teje në mbledhjen e këshillit teknik...».

«Edhe kjo është e vërtetë!»

«Nuk të ndahet shpirti nga Selimi, sepse ai të lan e të lyen. Nuk e kupton se ai e bën këtë për vete, sepse ka nevojë për mbështetjen tënde? Bile, unë jam i mendimit që të shikohet mirë kjo, puna e Selimit...»

Ja edhe shënimet nga diskutimi i xha Vasilit, që foli i fundit, duke iu dridhur zëri nga hidhërimi.

«...Shokët të kritikuan rëndë, e Petro Lisi, por unë përsëri nuk jam i kënaqur. Të duhet një kopaçe e fortë, që të të sjellë në vete, bile të ishe ca më i ri, edhe veshët do të t'i shkulja!... Ku të shpie mushka, more djalë?! S'është për ty ajo rrugë që ke zënë! Mua më dhemb në zemër kur të shoh në të tilla gjurmë, se të dua si bir e shkuar birit, prandaj vëri vath në vesh këto që të thonë shokët dhe mblihd veten!»

Unë... jo vetëm unë, por të gjithë ne, krenoheshim me ty. Bir mekaniku, i rritur me një mijë mundime, i mësuar, i papërtuar, gjithë të mirat i kishe. Njëherë në një kohë punoje me projekte gjithë ditën, pastaj vije dhe u futje shpatullat arkave të makinerive dhe shtrëngoje dado bashkë me ne. Të kam parë me sy të skuqur dhe me qepalla të fryra nga pagjumësia, por me bebëzat pishë. Ti ishe yni me të gjitha. Prandaj ta dëgjonim fjalën, prandaj të vumë kryeinxhinier.

Për shumë kohë ti i tillë ishe, por pastaj... pastaj more ca nga ca tatëpjetën. Kemi edhe ne faj që të lamë. Harruam se edhe një birit tonë mund t'i rritet grami në kokë. Këshitu, ti u largove dalngadalë prej nesh, se e pandehe veten më të zgjuar nga të tjerët, se kujtove që asgjë s'bëhet dot pa ty, se ishe lodhur boll dhe paskëtaj u përkiste të tjerëve ta kërrusnin shpinën, kurse ti vetëm të urdhëroje, të komandoje dhe të korrije lëvdata. S'e kuptove se, kur të bëmë kryeinxhinier, s'të dhamë kolltuk të kapardisesh, por të

ngarkuam një barrë më shumë. Kurse ti e kujtove veten lart dhe t'u morën mendtë!

Ajo që të rëndon më tepër është qëndrimi që mbajte pas mbledhjes së këshillit teknik. Shokët treguan plot raste dhe unë s'kam ç'të shtoj. Ty s'të kishte hije të shtireshe, s'të takonte të mbaje atë qëndrim. Ti s'je në binarë. Petro, prandaj ec në vete sa s'është vonë, zëre dorën që po të zgjartin shokët dhe dil nga ajo llucë!...»

Pas këtyre shënimeve fletët ishin të bardha. Atje duhej të vazhdonte autokritika e tij. Ai foli gjatë, u mundua ta hapte zemrën përpara shokëve, por kishte qenë shumë i tronditur dhe nuk i kujtoheshin qartë ç'kishte thënë.

Petroja e mbylli bllokun e shënimeve, e futi në kasa-fortë dhe vendosi të dilte. Nuk donte të takonte njeri, prandaj e përshkoi me nxitim korridorin e gjatë, i zbriti dy e nga dy shkallët, kaloi kokulur nëpër sheshin e uzinës dhe doli në rrugë. Vetëm kur u përfshi në vorbullën e kalimtarëve, e ndjeu veten më të qetë.

U kujtua t'i hipte urbanit në stacionin e dytë. U mblodh kruspull në një stol dhe mbështeti ballin në xhamin e freskët. Kokën e ndiente të turbullt, kapakët e syve të rëndë. Zërat e pasagjerëve i dukeshin të largët, bota që vështronte ireale, sikur gjithçka ndodhte në film.

Dëshironte që autobusi të ecte sa më shpejt dhe ta çonte diku, në një kantier të largët, ku të mos e njihte asnjëri. Të punonte atje, gjersa ta ndiente veten përsëri ballëlart, pastaj të kthehej mes shokëve dhe të njohurve. Por, për fat të keq, kjo ishte vetëm një ëndërr, një dëshirë. Ja, autobusi do të arrinte në stacionin e njohur, ai do të zbriste dhe do të shkonte në shtëpi. Në stacion, rrugës, në shkallë ai do të takonte të njohur.

«Si je, shoku Petro?... Ja, ky është ai kryeinxhinieri që e kritikuan rëndë!... Tungjatjeta, shoku Petro!... Aka ma s'e kanë shkarkuar këtë?... Si i keni nga shtëpia, shoku Petro?... Ka nxjerrë motrën jashtë, si ndonjë prapanik i mykur!... Mirëmbërëma, shoku Petro!... Thonë se ka birë lutje të shkojë në prodhim...».

Petroja brofi nga stoli dhe iu afrua derës së përparme. Priti me padurim që të arrinte te stacioni vet, zbriti i pari atje dhe u turr drejt shtëpisë, me kokën të rrasur ndërmjet supeve. Ecte i hutuar, pa vështruar as majtas, as djathtas.

Arriti shpejt në shtëpi. Pothuaj nuk iu përgjigj përshëndetjes së Anit, shkoi u lëshua në divan dhe i nguli sytë në tavan.

— Ç'të ka ndodhur?, — e pyeti Ani, e merakosur.

Ai nuk iu përgjigj.

— Do një kafe?

— Ma bëj!, — tha ai, pa ia hedhur sytë.

Ajo mori xhezvenë njëshe, tereziti sasinë e kafesë dhe të sheqerit, se ai e donte të rëndë dhe me pak, pastaj e vuri të zientë mbi furnelën elektrike.

— Si dole në mbledhje?, — pyeti me druajtje, duke përzier kafënë.

— Më kritikuan rëndë!, — u përgjigj Petroja, ndezi një cigare dhe e thithi me afsh.

— Ashtu, ë?!, — Ajo e lëshoi lugën dhe u lëshua në karrige.

— Më dhanë një dajak, që ta mbaj mend gjithë jetën!, — vazhdoi ai.

— Kaq shumë e kishe prishur me shokët?

— Po, shumë... me shokët dhe me punën!

Në ato çaste, më fort se kurdoherë, Petroja ndiente nevojën për dikë të afërt, që të ndante hallet dhe shqetësimet, që ta ndihmonte për të gjetur vetveten. Por, a ishte ajo njeriu që i duhej? Për herë të parë pas aq vjetësh martese, ai e dalloj qartë gardhin që e ndante prej së shoqes dhe i erdhi keq. Se, në mënyrë të vagëlluar e kuptonte që, edhe për këtë, ai ishte fajtori kryesor.

— S'do të më tregosh asgjë më tepër?, — pyeti ajo, lutëse.

Ai heshti një copë herë, dyshues, por pastaj nisi t'i tregonte diçka, më fort i shtyrë nga nevoja që të shfrente. Fliste me zë të zvargur, me ndërprerje të gjata, si ta kish-

te të vështirë t'i rendiste e t'i shoshiste ngjarjet dhe mendimet e veta.

Ajo i përpinte e tronditur fjalët e tij. Nuk vuri re kafënë që u fry dhe u derdh. Tek deshi ta shpëtonte, e derdhi më keq dhe kuzhina u mbysh me tym. Me duar të dridhura, çeli dritaren, pastaj mbushi xhezvenë dyshe. I qe krijuar një si boshllëk në lukth dhe mendoi se kafeja do t'i bënte mirë.

— E kujt t'i ndodhë kjo, ty, që për kaq vjet me radhë ke bërë haram familjen, bile edhe shëndetin, për atë uzinë!?, — shfryu ajo me duf.

— S'ma ka njeri fajin!, — ia priti ai mendueshëm.

— Si kështu?!, — shtangu ajo.

— Po, unë s'jam në rregull!, — tha ai, prerë. — Si e qysh, s'ta shpjegoj dot mirë se i kam akoma të turbullta, por që s'jam në binarë, është e qartë si drita e diellit.

Ajo mbeti si e ngrirë, me duar të kryqëzuara në prehër dhe me pamje të tronditur e të përvuajtur.

— Po tani?, — pyeti, me një fije zëri.

Ai ngriti supet.

— Duhet filluar nga e para!, — tha pastaj.

— Pse, do të të heqin nga kryeinxhinier?

— Them ta kërkoj vetë, — u përgjigj ai.

— Atëherë, mos të të transferojnë!, — tha ajo, me zë të dridhur.

— Mundet, por kjo s'është kryesorja!, — ia priti ai i zymtë dhe mospërfillës.

Ajo heshti një copë herë. I pikonte zemra, kur mendonte se mund t'i prishej terezia e arritur me aq mund dhe përkujdesje, sidomos nga ana e saj, por ndjenja e detyrës ndaj të shoqit dhe dëshira që t'i provonte se i ndodhej pranë në vështirësi, siç i kishte hije një bashkëshorteje si ajo, i dha forca ta mposhte këtë ndjenjë dhe ta përmblihte veten.

— Ke të drejtë, s'është kryesorja!, — tha dhe psherëtiu. — Fundi, jeta familjare kudo njëlloj është, mjaft që ti të ndihesh mirë. Do të kemi ca vështirësi sa të sistemo-hemi përsëri por... Sa për mua, mos u bëj merak. Kur u

martova, mora Petron, jo Tiranën, prandaj... Mbi të gjitha shëndeti!

— As shëndetin s'ke ç'e do pa faqen e bardhë!

— Po, ashtu është, por ti s'ma merr mendja të kesh bërë ndonjë faj. Edhe në paç gabuar, njeri je...

— Zjeu kafeja?, — pyeti ai.

Ajo e arriti në kohë, se desh iu derdh përsëri. Mbu-shi filxhanët, me lëvizje të pasigurta, ia vuri njërin përpara dhe me tjetrin në dorë, u ul përballë tij. Rrufiti me dëshirë një hurbë dhe iu duk sikur iu përmbloodh bar-ku.

— Po ti, fole?, — pyeti pastaj.

— Fola.

— Ç'the?

— Ato që mendova se duheshin thënë.

— Makar, bërë autokritikë?

Ai nuk e kapi dot qëllimin e pyetjes. Hezitoi një hop.

— Bëra, si ma priti mendja atë çast!, — u përgjigj pastaj.

Ajo shtyu mënjane filxhanët dhe mbështeti bërrylat mbi tryezë.

— Mos u mërzit, se do të dëmtosh shëndetin!, — e këshilloi me dhembshuri.

Ai nuk foli. Kishte filluar të errej dhe ata e shquanin gjithmonë e më dobët njëri-tjetrin, por ajo vazhdonte ta ndiente shqetësimin e të shoqit nga ecejaket e shpeshta të majës xixëlluese të cigares dhe nga lëvizjet nervoze të buzëve të gishtave të tij, që i ndriçoheshin sa herë e thith-te me afsh. Nuk i bëhej të çohet, që të ndizte dritën.

— Pse, si mendon ti, jam i zoti t'ia filloj përsëri nga e para?, — pyeti dikur ai.

— Pa dyshim që po!, — u përgjigj menjëherë ajo.

— Ama, ç'pyes edhe unë!, — e qesëndisi veten ai. — Se mos do të thuash ndryshe ti, sidomos në këtë gjendje që jam!

— Megjithatë, unë fola sinqerisht!, tha ajo. — Gjithmonë të kam mbajtur për njeri të zotin dhe të fortë.

— Hm, të tillë e kam kujtuar edhe unë veten, por

mbase këtu është fara e së keqes, se e kam kujtuar më shumë nga ç'duhet!, — vërejt ai me zë të hidhur.

«Por, as që të mendosh të kundërtën tani e tutje, nuk është mirë!», — tha ajo. — Unë do të të ndihmoj, sa të mundem dhe me atë që mundem. Jo vetëm që s'do të kesh asnjë telash për mua dhe për shtëpinë por edhe ndonjë mendim do të të jap, sigurisht, në ma përfillsh.

«Mirë, Ani!», — tha ai, disi i mallëngjyer.

«Ja pra, kjo paska filluar t'i kuptojë drejt disa gjëra, kurse unë, që mbahesha me të madh...!», — mendoi.

«Ai prej kohe s'më ka folur kështu, me kaq ngrohtësi!, — tha me vete ajo. — Ndoshta, duhej një trënditje e tillë, që të çahet akulli».

«Ti ke të drejtë, pak ju kam përfillur!, — tha ai.

«Ajo e kuptoi se kë tjetër kishte parasysh i shoqi, që foli në shumë».

«Florë pati të drejtë kur më tha se unë... Bile ju kam përçmuar!, — vazhdoi ai.

«Kije inat, por jepi hakun: vajzë e guximshme, ç'ka, ta thotë bram, në sy!», — mendoi Ani.

— Edhe për çështjen e motrës më kritikuan, e kishin marrë vesh!, — tha ai.

— Doemos që do ta merrnin vesh, u bë me bujë!, — vërejt ai, me një timbër të lehtë qortimi. — S'ishte e udhës të bëhej kështu, s'na ka lezet, po i hapim nam të lig edhe asaj, edhe vetes.

— S'është puna te nami!, — ia bëri ai.

— Epo, s'thonë kot, më mirë syri, sesa nami!, — arsyetoi ajo. — Pastaj, kur s'i flet me gojë, s'ke as mundësi ta këshillosh ndonjëherë, se helbete...

— Vërtet, nuk veprova mirë!, — tha ai. — Sapo lexova letrën e saj, u pendova, por atëherë kishte marrë fund puna.

Tani ishte errësuar tamam. Orenditë dukeshin si njolla të mëdha, të zeza dhe ata e shquanin njëri-tjetrin si silueta. Në murin kundruall dritares dukej gjurma e saj, e ndriçuar zbehtë, në trajtën e një drejtkëndshi kaltërosh.

— Duhet çelur drita!, — tha Petroja.

Petro Lisi u kthye në zyrën e vet rreth orës dy. Gjithë kohën e kishte kaluar nëpër reparte dhe orët i kishin fluturuar pa e kuptuar.

...Herën e parë që shkoi në mes të punëtorëve, pas mbledhjes së Partisë, u ndie shumë ngushtë, por shpejt e kuptoi se e kishte pasur gabim. Askush s'i hodhi romuze, asnjëri s'i shfaqti shenjën më të vogël të përçmimit apo të mosbindjes, përkundrazi, kudo e mirëpritën dhe e dëgjuan me vëmendje gjatë debateve që lindën aty-këtu për probleme të prodhimit.

«S'i paskam njohur mirë këta njerëz, megjithëse prej kaq kohësh ndodhem midis tyre!», — pat menduar Petroja.

Qysh atë ditë, kohën më të madhe e kalonte nëpër reparte dhe ngjitej në zyrë vetëm kur ishte e domosdoshme. Shumë probleme ia linte për ndjekje shefit të planit...

Atë ditë u ngjit në zyrë për një çështje personale. Iu lut shefit të administratës t'i huante një copë herë makinën e shkrimit, mbylli derën nga brenda dhe nisi të daktilografonte, duke u mëshuar shkronjave me një gisht. Megjithëse puna shkonte ngadalë, brenda një ore e përfundoi lutjen, e rilexoi dhe e firmosi në fund. Pastaj, me të në dorë, shkoi dhe gjeti sekretarin e Partisë.

— Ju kam sjellë këtë lutje për organizatën-bazë! — i tha, duke i zgjatur fletën e daktilografuar. — E ndjej të domosdoshme të kaloj drejtpërdrejt në prodhim. Lutem që kjo punë të bëhet sa më shpejt!

Sekretari e lexoi lutjen me vëmendje, ndërsa një buzëqeshje e lehtë ia ndriçoi fytyrën.

— Do ta shqyrtojmë në mbledhjen e parë!, — premtoi, duke e futur lutjen në xhup. — Vendimin përfundimtar do ta marrë nomenklatura përkatëse, ti e di. Deri atëherë...

— Sigurisht, puna nuk do të çalojë!, — tha Petroja, — Megjithatë, sa më parë, aq më mirë...

— E kuptoj padurimin tënd, shoku Petro!, — buzëqeshi sekretari. — Dhe, si shok të vjetër që të kam, gëzohem shumë.

Petroja doli atë ditë nga uzinat i lehtësuar prej një barre të rëndë. Megjithëse ishte lodhur nga të sjellurit nëpër repartë, i pëlqeu të ecte në këmbë drejt qendrës. Piu një ekspres, pastaj këmbët e çuan në shëtitoren «Dëshmorët e Kombit».

Ishte një pasdite e kthjellët. Dielli po perëndonte dhe gjithçka qe kredhur në një dritë të kuqërreme. Pishat ndanë rrugës, çadrat e hotel «Dajtit», drurët dhe shkurret e parkut «Rinia» kishin një të blertë të praruar. Radhët e plepave buzë Lanës ndernin degët lakuriqe përmbi shiritin e ndritshëm të përroit. Në bulevard rrëshqisnin herë-herë vetura me ngjyra të ndryshme dhe ndonjë Gaz. Trotuareve po shtoheshin kalimtarët, shumica të rinj, që vinin ose shkonin drejt godinës së Universitetit, i cili zbardhonte në fundin e shëtitores.

Petroja shikoi se mos dallonte ndërmjet tyre Florën. Ai kishte vendosur të pajtohej me të, t'i kërkonte të falur, por e shtynte nga dita në ditë vajtjen në konvikt, tek ajo. Do ta kishte më të lehtë po ta takonte rastësisht.

«Eh, kokë, o kokë, sa mbrapsht i solle punët!, — e qortoi veten Petroja. — Dikur bëja qindra kilometra për ta takuar, kurse tani, në një qytet dhe... Atëherë ishim aq të dashur dhe të afërt me njëri-tjetrin, për gjithçka bisedonim, këshilloheshim bashkë. Nuk ishim vetëm motër e vëlla, por edhe shokë. Kurse tani... Prandaj kjo gjendje duhet të marrë fund sa më parë. Pse e kërkoj rrugëve? Do të shkoj drejt e në konvikt dhe do t'i kërkoj të falur. Nuk më bie hunda. Vetë e kam fajin që ndodhi kështu. Jam sjellë keq me të. Me të dy. Ai erdhi të bisedonte në shtëpi, kurse unë s'e pranova. Do të jetë vërtet djalë i ndershëm. Ç'desha tjetër unë? Hë, sedërli i madh paskam qenë...»

Si e mori këtë vendim, filloi të nxitonte hapat për nga rruga e Elbasanit.

Përbri tij ecte një trumbë e gëzueshme studentësh. Ata bisedonin për sportin, bënin shaka, ngacmonin njëri-tjetrin dhe qeshnin me të madhe. Petroja kujtoi me nostalgji kohën kur edhe ai qeshte kështu, i shkujdesur. Duke pritur

në udhëkryq që të kalonte një makinë, u bashkua me trumbën e studentëve dhe për një çast, vetëm për një çast, provoi një ndjenjë të çuditshme. Iu duk sikur koha u kthye menjëherë prapa dhe ai po rijetonte diçka të njohur.

Te porta e jashtme e konviktit të vajzave, si gjithmonë, kishte vizitorë, shumica djem. Petroja lajmëroi me dikë Florën dhe priti. Pas një copë here doli një studente e imtë, me syze.

— Kush e kërkon Florën?, — pyeti ajo, duke vështruar përreth.

Petroja doli nga errësira dhe iu afrua.

— Ah, ju?!

«Si duket më njeh», — mendoi ai.

— Më vjen keq, por nuk ndodhet në konvikt!, — tha ajo. — Ka më se një orë që ka dalë.

— Ju lutem, mund t'ia jepni këto?, — tha Petroja, duke i treguar pakot.

— Më gjithë qejf!

— I thoni se e kërkoja, jam...

— I vëllai, në mos gabohem!, — e plotësoi ajo.

— Pikërisht. I thoni se kam nevojë ta takoj. Po deshi, le të vijë.

— Mos kini merak, do t'i them. Më vjen keq që nuk e gjetët!, — tha ajo me sinqeritet.

— Falemnderit dhe tungjatjeta!, — tha Petroja, duke i zgjatur ç'kishte në dorë dhe iku.

I shteri edhe ajo fije gëzimi që pati. U ndie përsëri i vetmuar, sa i erdhi keq për veten. Filluan t'i vërtiteshin mendime shqetësuese. Mundohej t'i largonte, por ato i dyn-deshin përsëri, të bezdisshme dhe këmbëngulëse, si laras-kat që rikthehen në pemët e oborrit, mbasi i ke përzënë di-sa herë.

Hyri në një birrari të vogël, ajri i së cilës qe rënduar nga frymët e klientëve, tymi i duhanit dhe erërat e kuzhinës. Qëndroi në këmbë pranë banakut dhe kërkoj një gotë birrë. Kur e vuri në buzë, kuptoi se kishte etje. E piu me fund dhe porositi një tjetër. Ndezi cigaren, e thithi me afsh

dhe nisi të pinte me gllënjka gotën e dytë. Pastaj pagoi, doli dhe u end pa qëllim nëpër rrugët e qytetit.

Ishte vonë kur arriti pranë pallatit ku banonte. Te hyrja pa dy silueta, njëra prej të cilave iu duk e njohur.

«Motra!, — tha me vete dhe nxitoi hapin. — Po, ajo genka!»

Njëra nga siluetat u largua, kurse tjetra erdhi drejt tij. Flora ia zgjati e para dorën.

— Mirëmbërëma, vëlla!

— Erdhe?, — tha ai dhe nuk diti ç'të thoshte tjetër. Ia shtrëngoi fort dorën dhe u ndie i mallëngjyer.

— Kemi kohë pa u parë, motër!

Ai vazhdonte t'ia mbante dorën në të tijën.

— Po, kemi!

— Si ke qenë?

— Mirë, po ti?

— Hiç mirë, për të mos thënë keq!

— Pse kështu, vëlla?!

— As unë nuk e di mirë pse. Do të bisedojmë. Ec të ngjitemi lart.

— Është vonë dhe më mbyllet konvikti, po vij tjetër herë!, — tha Flora. — Po deshe, ec e më përcill. Rruga është e gjatë dhe kemi kohë të bisedojmë.

— Mirë, si të duash. Ke kohë që më pret?

— Jo dhe aq. Nja gjysmë ore.

— Vetëm ishe?

— Jo.

— Kush të përcolli, Arbeni?

Flora u çudit. Për herë të parë e dëgjonte emrin e tij nga goja e të vëllait.

— Po!, — tha pastaj.

— Ai që iku ishte, apo jo?

— Po. S'të prisja dot vetëm, në këtë orë.

— Ashtu është. Erdhët e më pritët, megjithëse unë jam sjellë keq me ju!, — tha ai, me një pamje fajtori.

Ajo u çudit akoma më shumë.

Petroja e zuri për krahu dhe dolën në rrugën kryesore, që ishte tani pothuaj e shkretë.

— Ç'të ka ndodhur, vëlla?, — pyeti Flora, sa për të celur bisedë, sepse ajo i kishte marrë vesh të gjitha.

— Vërtet, ç'më ndodhi kështu?, — tha ai, sikur pyeste vetveten.

Kërkoj në xhep paqetën e cigareve, ndezi një dhe, mbasi e thithi fort, nisi të fliste. Rrëfeu gjithë ç'i kishte ndodhur, gjithë mendimet, ndjenjat, dyshimet, shqetësimet që i vlonin përbrenda, pa i zgjedhur, pa i renditur, disa të qarta e disa të turbullta, ashtu siç i vinin.

Fliste ngadalë dhe me zë të ulët. Shpesh vinte dorën mbi gjoks, me gishtërinjtë të kthyer në trajtë kthettrash, sikur donte të arrinte zemrën dhe të shkulte së andejmi diçka të ligë, që e mundonte. Duke treguar, ai ndiente se po lehtësohej, siç lehtësohet dhimbja e një plage të mahisur, kur shpërthen.

Flora e dëgjonte, duke e vështruar me ngulm. I vinte keq, por edhe gëzohej, sepse në vend të atij, vëllait të vetë-kënaqur, me dukje krenare e të sigurtë, por që e brente vazhdimisht e keqja, tani kishte pranë një vëlla që vuante dhe përpëlitej dhe ishte ngritur kundër saj. Gëzohej edhe sepse po shembej ai mur që i kishte ndarë këto kohët e fundit dhe ata po bëheshin përsëri miq, shokë.

Ajo e ndiqte me vëmendje e dhembshuri tregimin e tij dhe mendohej ta ndihmonte, ku me një pyetje, ku me një fjalë, ku me një mendim.

Mbasi i derdhi gjithë ç'kishte përbrenda, Petroja heshiti, duke e vështruar të motrën me ankth. Ajo e kuptoi ç'priste ai, e kuptoi sa rëndësi kishin fjalët që do të thoshte ajo prandaj u mendua një hop. Pastaj ngriti sytë, dy sy plot dritë e besim dhe i tha:

— E mban mend, vëlla, kur të theva padashur make-tin prej xhami, që përgatite gjatë pushimeve të klasës së dytë të politeknikut?

— Ç't'u kujtua pikërisht tani?, — u habit ai.

— Qava sa plasa atë ditë, megjithëse ti s'më rrahe!, — vazhdoi ajo. — Më vinte keq, se kishe punuar një muaj të tërë. Por, ti e fillove nga e para dhe e bëre më të mirë

akoma. I tillë ke genë, Petro. Dhe i tillë ke mbetur. Prandaj unë kam besim të plotë te ti.

Atij iu mbushën sytë plot dritë.

16

Dëgjohej si gulçonte toka nga goditjet e kazmave dhe si fërfërinte dheu kur flakej nga lopatat, përtej piketave të bardha. Tarraca merrte trajtë dalngadalë. Një pluhur i imtë ngrihej vazhdimisht së poshtmi, ngjitej në trupat dhe fytyrat e dirsura të aksionistëve, duke sajuar vraga, zbardhte vetullat, qepallat dhe u kërciste në gojë.

Dielli i korrikut derdhte me bollëk dritë dhe ngrohtësi mbi tokën e thatë, mbi bustet lakuriq të djemve, mbi bluzat e lehta të vajzave, mbi kapelet prej kashte, me spretthe të gjera dhe mbi detin që shkëlqente madhërisht përfund kodrave.

Arbeni ngriti kazmën sa mundi dhe goditi fort me majën e saj. Ajo u ngul me një zhurmë të mbytur dhe ngeci.

— E marrtë dreqi, përsëri zuri në rrënjë!, — mallkoi ai, duke u munduar ta nxirrte.

— S'e shkul dot vetëm!, — tha Ibrahim. — Nuk e shikon ç'rrënjë e madhe që është? Ec ta provojmë së bashku.

Ata rrokën kazmat dhe iu përveshën punës. Pranë tyre Flora dhe Rina qëronin dheun me lopata.

— Hiquni më tej, se mos ju godasim!, — tha Ibrahim. — Pritni të gërmojmë ca!

Ato u bindën. Flora përfitoi nga rasti dhe rregulloi në kokë shaminë e aksionistëve, kurse Rina u mbështet në bishtin e lopatës dhe fshiu djersët me kurrizin e dorës. Dukej e lodhur.

— Ti punon më shumë nga ç'ke fuqi, Rinë!, — e qortoi Flora.

— E ç'punoj unë!, — tha ajo, me buzëqeshje. — Ja, këta punojnë!, — Dhe tregoi me kokë nga shokët.

Flora ktheu vështrimin andej. Ata gërmonin me duf. Tek ngrinin dhe lëshonin kazmat, muskujt u ndereshin dhe u tkurreshin, duke marrë trajta të hijshme. Lëkura e nxirë

dhe e njomur nga djersa u shkëlqente si kadife. Fytyra u qe veshur me bulëza djerse, që bashkoheshin me njëra-tjetrën, u rridhnin nga rrëza e vetullave nëpër faqe, u pikonin nga maja e hundës, u lëpiheshin në qafë, në zverk dhe mbi gjoks.

— Të heqim dheun njëherë!, — ndërhyri Flora, duke u afruar me lopatën. — Ju çlodhuni pak, shikoni si jeni bërë!

Ata u bindën dhe u mënjanuan. Vajzat filluan të punonin me shpejtësi.

— Ç'etje që kam!, — tha Arbeni. — Ka mbetur ujë në pagure?

— Jo, por tani duhet të arrijë «këmbëshpejti»!, — tha Flora, pa e çuar kokën.

— Akulloreee!, — bërtiti dikush me shaka.

— Kasataa!, — ia priti një tjetër.

— Plaçi!, — mallkoi një i tretë.

Arbeni lëshoi kazmën, fshiu djersët me llërë dhe u ul në pjesën e pagërmuar. Soditi me ëndje Florën tek punonte. Ajo shkelte zbathur mbi plisa, ngjeshte lopatën në dheun e gërmuar, pastaj e flakte përtej piketave, me ritëm të shpejtë dhe të barabartë. Pluhuri i qe ngjitur në pulpë, në llërë dhe në fytyrë, duke ia errësuar edhe më tepër ngjyrën e bronzit të lëkurës. Nga shamia i dilnin ca baluke rrebele ngjyrë kalliri, që hovnin me ritmin e lëvizjes së lopatës. Buzët e njomura, në ngjyrën e qershive të pjekura mirë, i mbante gjysmë të çelura. Për një çast ajo drejtoi trupin dhe fshiu ballin me gishtin tregues, të kthyer si kosore. Ca pikëla djerse ranë mbi plisa, duke krijuar gjurmëza bojë kafe.

Arbeni do të dëshironte t'ia fshinte me pëllëmbët e veta djersën dhe t'ia përkëdhelte ato cullufet e arta, rrebele. Buzëqeshi me këtë mendim, se u kujtua që pëllëmbët i kishte të ndotura. Pastaj i shkoi mendja te letra që priste nga prindërit.

— Urraaa, arriti «këmbëshpejti»!, — brohoriti Ibrahim. Një djalosh i gjatë, i ngarkuar me bidona, po i ngjitej me shkathtësi kodrës. Ai ndalej pranë çdo grupi dhe së

largu dukej uji tek rridhte, si një fjollë e ndritshme, në paguret e aksionistëve. Duke e vështruar, Arbeni lëpiu buzët.

Pas pak «këmbëshpejti» arriti edhe tek ata. Rina dhe Flora nxituan me të katër pagurët.

— Me kujdes, mos derdhet!, — thirri ai, duke anuar bidonin.

Mbasi shuan etjen, ata iu përveshën rishtazi punës.

«Uh-uh, uh-uh!» — filluan të ofshanin djemtë, duke goditur me kazma.

Nga rrënja shkëputeshin copa dheu, të mpleksura me fije të holla.

— Mjaft u gërmua, hajde ta provojmë me leva!, — propozoi Arbeni.

— E provojmë!, — tha Ibrahimimi. — Çupa, futini edhe ju lopatat. Ashtu. Prisni shenjën. Gati!

«Ho-hop, ho-hop!»

U dëgjua një kërcitje dhe blloku i madh u shemb mënjane, duke u çarë vende-vende.

— Urraaa!, — brohoritën që të katër.

Lëshuan një hop veglat dhe soditën rrënjën e shkukur. Në të çarat e bllokut dukeshin një mori fijëzash e rrënjëzash të këputura.

— Kushedi sa vjet ka qëndruar në tokë, pa është bërë kaq!, — tha Arbeni.

— Ç'pyet!

I futën përsëri kazmat e lopatat përfund rrënjës dhe pas pak ajo u rrokullis mëtëposhtë, duke lënë pas një gropë të madhe.

— Tani, forca, të sheshojmë vendin!, — tha Flora.

Pas pak gropa u bë një me sipërfaqen e tarracës.

Ndërkohë u dëgjua shenja e mbarimit të kohës së punës. Për një hop u bë qetësi. Pastaj një mërmëritje përshkoi kodrën. Aksionistët mblidhnin plaçkat, hidhnin veglat e punës në sup dhe zbrisnin mëtëposhtë, grupe-grupe.

Grupet bashkoheshin me njëri-tjetrin, duke formuar një rrjedhë të fuqishme, të gjallë, të gëzuar. Trupat ngjyrë bronzi, bluzat shumëngjyrëshe, kapelet e kashtës, shamitë

laramanë të aksionit, tehet e kazmave e të lopatave, ndritnin hareshëm nën diellin e fortë. Buçiti kënga, vërsnike me ata që e këndonin:

*Hajde të punojmë,
djersët le të kullojnë,
se ndërtojmë
njeriun e ri...*

Kjo këngë, duke u bashkuar me muzikën e qendrës së zërit të kampit, llapashitjen e valëve të detit, thirrjet entuziaste dhe zërat e panumërt të asaj dite vere, ngjanin si një himn ngazëllyes.

— Unë po shkoj drejt e në det!, — tha Arbeni sa arritën pranë çadrave.

— Edhe unë!, — tha Ibrahim. — Zhvishemi në breg.

— Më prisni edhe mua!, — i luti Flora. — Ja, erdha, sa të vesh rrobat e banjës.

Pas pak u ndalën që të tre në breg të detit, ku ishin dhjetëra aksionistë të tjerë.

Flora bëri disa hapa dhe ra me not. Godiste fort me krahë ujin, sikur donte ta mposhte, vështronte bulëzat që krijoheshin nën pëllëmbët e saj dhe ndiente qysh çante përpara, ndërsa vorbujt e ujit i rrëshqisnin përgjatë trupit, duke i sjellë freski të këndshme.

Dikur mori hov dhe u zhyt. Pa gurët e mëdhenj të fundit, të mbuluar me leshterikë, që sikur donin ta kapnin me fijëzat e tyre të blerta transparente, një peshk të vogël që dredhoi mes tyre, pa ca molusqe të qullëta, një njollë të errët dhe, me gjithë druajtjen që i ngjallte kjo botë e panjohur, nuk u shkëput prej saj, veçse kur pati nevojë për ajër. Doli në sipërfaqe dhe u ngop me frymë. Vështroi nga bregu. Shkëmbinjtë e hirtë, çadrat dhe njerëzit që lëvrinin ndanë tyre dukeshin të vegjël.

— Ej, unë po kthehem!, — u thirri shokëve.

Notonte me kënaqësi, duke u rrëkëllyer nëpër valë. Kur doli në breg, ndeshi Hajrijen që vërtitej aty, ec e jak, fuste pak këmbët në ujë, pastaj tërhiqej.

— S'ma mban, kam frikë nga iriqët e detit!, — i tha Florës.

— Sa më shumë të kesh frikë, aq më keq e gjen!, — qeshi ajo dhe rendi drejt çadrës.

Ndërsa po krihej, sodiste ambientin e çadrës, që i dukej aq i dashur dhe familjar. Shoqet ndërroreshin, bisedonin, qepnin, lexonin ose çlodheshin në ato shtrojet e sajura me batanije mbi kashtë dhe të renditura varg, përgjatë anës së çadrës. Në faqet e saj ishin varur një mori laramane bluzash, fustanesh, ndërresash e peshqirësh; diku qe kapur me gjilpëra një fotografi e nxjerrë nga revista «Ylli»; diku gjetkë, mbí një valixhe, qe vendosur një gotë plástike me një tufë lule të egra. Gjithçka ishte kredhur në dritën verdhacuke që depërtonte nëpërmjet dokut të çadrës.

Flora ndiente një mpirje të ëmbël të gjymtyrëve, por nuk u shtri, se aty bënte vapë. Doli përsëri në bregdet, u ul nën strehishten e mensës dhe mbështeti shpinën te njëra nga shtyllat e drunjtja të saj.

Përballë dukeshin çadrat, rreth të cilave lëvrinin akcionistët. Në një cep, disa po lanin. Më tej, disa të tjerë qenë mbledhur grumbull dhe po lexonin gazetën.

Qendra e zërit ndërpreu muzikën dhe lajmëroi emrat e atyre që u kishin ardhur letra. Flora nuk ia vuri veshin. Dy ditë më parë kishte marrë një kartolinë nga vëllai dhe s'priste letër nga tjetërkush.

Duke kujtuar kartolinën, ajo filloi të mendonte për Petron.

Pas asaj dite që e kishte kërkuar në konvik, qenë takuar shpesh dhe kishin biseduar gjatë me njëri-tjetrin. Ajo shkonte dëndur edhe për vizitë tek ata. Nuk pranoi të rikthehej, jo për kapriçio, por sepse mendonte që ata të dy kishin nevojë të mbeteshin përballë njëri-tjetrit.

Në fillim Petroja e pati shumë të vështirë. U dobësua shumë, aq sa mori trajta fëmijnore. E kishte humbur sigurinë e dikurshme, madje dukej i druajtur herë-herë, po ndërkohë ajo vërente me kënaqësi qysh i kthjelloheshin mendimet, qysh i shkoqeshin ato vetija të huajtura, qysh

ai po gjente vetveten. Një ditë Petroja i tha se ia kishin aprovuar lutjen për të kaluar në prodhim. Ai dukej singërisht i gëzuar. Kishte mjaft plane për repartin ku e kishin caktuar dhe, kur fliste për to, i ndritnin sytë.

Edhe Ani kishte ndryshuar disi. Ajo e priti me korrektesë dhe iu soll mirë, por ndihej një farë ftohtësie në qëndrimin e saj. Ishte shumë e shqetësuar për Petron dhe, me mënyrën e vet, përpiquej t'ia lehtësonte gjendjen. Flora mendoi se ky ishte një fillim i mirë. Megjithatë, duke gjetur përsëri vetveten, Petroja pa tjetër që do të ndeshej me ato botëkuptime të së shoqes, të cilat deri atëherë nuk i kishte vënë re ose i kishte nënvleftësuar. A do të mundej ai ta bënte atë një shoqe të vërtetë, apo do të duronte pranë vetes një bashkudhëtare të thjeshtë? Koha do ta zgjidhte këtë problem. Flora shpresonte për mirë.

Një hije që u afrua dhe ndaloi pranë saj, e shkëputi Florën nga mendimet. Ngriti kokën dhe pa Arbenin që po e vështronte me buzë në gaz.

— Paskë gjetur vend të mirë!, — tha ai dhe u ul pranë saj.

— Nuk rrihej në çadër, bënte shumë vapë!, — tha ajo. Arbeni futi dorën në xhep dhe nxori një zarf.

— Mora letër nga prindërit!, — tha.

— Sa mirë!, — u gëzua ajo. — Janë shëndoshë, besoj.

Do t'i ketë marrë malli!

I sëmboi, duke menduar se atë s'kishte kush ta priste me një mall të atillë.

— Na presin të dy!, — tha ai, duke e vështruar me dashuri.

Florës iu duk sikur nuk dëgjoji mirë dhe ktheu kokën nga ai, e habitur. Atëherë i njohu në sy një gëzim të madh dhe e kuptoi se kishte dëgjuar saktë. Sakaq iu mblodh një lëmsh në gjoks dhe riktheu përnjëherësh vështrimin nga deti, për të fshehur mallëngjimin.

— Prindërit dëshirojnë të të njohin sa më parë, — vazhdoi ai. — Dhe të luten që t'i kalosh në familjen tonë pushimet e verës.

Ajo kishte picërruar sytë dhe vështronte atje tek bash-

kohej kaltërsia e lëvizshme e detit me kaltërsinë e qetë të horizontit. Në ato çaste i dukej vetja si një pjesë e asaj kaltërsie të ndritshme.

— Pranon, apo jo?, — e pyeti Arbeni me ankth, sado që ishte i bindur se ajo do të pranonte.

— Më parë duhet të bisedoni me Petron!, — tha.

— E ka marrë përsipër babai atë punë!, — iu përgjigj ai. Flora ndjeu se po i njomeshin sytë.

— Do të ngelesh e kënaqur, ke për të parë!, — vazhdoi ai i ngazëllyer. — Prindërit e mi janë njerëz të dashur. Shiko ç'më shkruajnë!, — Nxori letrën nga zarfi dhe lexoi: — «Thuaj asaj, i dashur djalë, se ne do ta presim me krahë hapët dhe se do ta duam baraz me ty...».

Flora vështroi një hop ato radhë të shkruara me shkronja të mëdha e të pasigurta, por sakaq shkronjat iu mjegulluan dhe mbylli sytë. Mbështeti kokën në shtyllën e drunjtë, shtriu dorën, gjeti atë të Arbenit dhe ia shtrëngoi fort. Ai e kuptoi dhe heshti.

Pas pak Flora i çeli sytë e qetësuar dhe soditi kodrat.

— Megjithatë, më vjen keq që do të ndahemi nga akcioni!, — tha pastaj. — Vështro sa bukur që duken! — Shtriu dorën në drejtim të kodrave, faqet e të cilave ishin të brazduara nga tarraca, që nga larg dukeshin si breza të kafenj-të, paralelë.

— Ne i bëmë!, — tha ai, me një farë krenarie. — Atje ku derdhëm djersë, do të lulëzojnë një ditë portokallet.

Ajo soditi një copë herë kodrinat dhe i përfytyroi ashtu siç do të ishin në të ardhmen. Pastaj mbështeti rishtazi kokën te shtylla dhe u lëshua në vorbullën e ndjesive.

Dëgjonte një larmi gazmore tingujsh e zërash, të cilët sikur i kumbonin në thellësinë e vetvetes. Nuhaste me ëndje aromën e kripur të detit, kundërmimin e athët të strehishtes prej fieri, të dheut të thatë dhe erën e gjellës që po e ndanin në pjata. Vështronte kreshtat e ndritshme të valëve dhe i dukej sikur ato përkëdhelnin plot dritë e vezullime edhe atë.

BORË NË BJESHKË

*Botuar për herë të parë më 1974.
Ka fituar çmim të parë në Kon-
kursin Kombëtar të Letërsisë dhe
Arteve me rastin e 30-vjetorit të
Çlirimit.*

BORE NE BUESHKE

Bohner për herë të parë më 1974.
Ka fituar çmim të parë në Kon-
kursin Kombëtar të Letërsisë dhe
Atëherë me vendlin e 30-cjlorit të
Gjithmilit.

Vjeshta sapo kishte arritur në bjeshkë dhe gjethet e aheve të dendura të pyllit e kishin humbur gjelbërimin e zakonshëm. Ato rrihnin në të verdhë ndryshku dhe dukeshin të brishta, tepër të brishta. Puhia e lagësht mëngjesore i shkundte me lehtësi dhe, si i përkundte e i përdridhte një copë herë në ajër, i shtronte mbi legushën e kuqërreme të pyllit.

Qielli ishte pothuaj i kthjellët, me disa shtëllunga resh të bardha, që si të përgjumura ndereshin mbi kreshtat e maleve. Dielli shkëlqente pastër, por ngrohte pak.

Në pyll oshëtinte sëpata. Vukë Marashi, brigadieri i sharrëxhinjve, po kllaposte një ah shekullor. Tehu i çeliktë vezullonte kërcënueshëm, ndërsa përshkonte një hark të gjatë dhe godiste e godiste në trung. Pas çdo goditjeje kllapa zmadhohej, kurse mbi legushë shtoheshin ashklat verdhoshe, të pastra, që lëshonin një kundërmim të freskët druri.

Aty pranë, një sharrëxhi i ri e trupgjatë, po përgatiste motosharrën për punë. Tutje, përtej shpatullave të tij, kuqëlonte mes trungjeve të hirta kabina e një traktori. Dy vetë po lidhnin me kavo çeliku disa trupa pas tij.

Sharrëxhiu i ri ktheu sytë nga Vuka, të shihte në e

përfundoi kllapën. Që andej, në sfondin e kurorave të kapërthyera të aheve, ai dukej si një div i legjendave.

Me këmbët e gjata, pak të hapura anësh dhe të mbështetura fort në tokën e pyllit, ai dukej si të kishte mbirë e të qe rritur aty, bashkë me drurët e pyllit. Fytyra e tij, me atë ballë të lartë, me atë hundë të gjatë e të drejtë dhe me ato nofulla të gjera, dukej si e gdhendur me sëpatë. Krahët e tij të fuqishëm, si degë lisi, lëviznin ritmikisht dhe sëpata godiste e godiste.

— I fortë je, o Vukë Marashi, — tha djaloshi me admirim.

— I fortë kam qenë dikur!, — u përgjigj Vuka, duke u mbështetur me pëllëmbët kryq mbi bishtin e sëpatës, ndërsa gjoksi i tij i gjerë, i mbështjellë me një fanellë leshi të hirtë, thithte ajrin e freskët të ahishtes. — S'janë të lehtë pesëdhjetë vjet mbi këto supe, o Frrok Gjoni! Sikur kot t'i mbash sëpatën dhe cepinën në sup kaq kohë, ta bëjnë gropë...

— Qofsha dhe unë i fortë sa ti, kur të arrij atë moshë!, — uroi Frroku, buzgaz.

— Ti ke për të qenë më i fortë. Ne kemi vuajtur shumë!, — ia priti Vuka, duke rifilluar punën. Kaq e pat!, — tha, pas disa goditjesh. — Prej me kujdes, që të mos rrëzohet mbi filiza.

— Pa sjellë Lleshi benzinën s'e pres dot!, — vërejti Frroku.

Ndërkaq buçiti zhurma e motorit të traktorit dhe pas pak ai ia behu aty pranë, duke tërhequr dy trungje të gjata ahu. Traktoristi, një djalosh i pashëm, me flokë të zinj kaçurrelë, i përshëndeti me dorë në kalim. Sharrëxhiu tjetër, që e kishte ndihmuar të lidhte trupat, mbeti te shokët. Ishte rreth të pesëdhjetave, me shpatulla të kërrusura, por të fuqishme.

— Hej, ç'kemi hequr dikur!, — iu drejtua Vuka, ndërsa ndiqte me sy traktorin, që linte pas një vrragë të errët. — Kurse sot, o Mirash...

— Lehtësim i madh Vukë!... A e dredhim nga një?, — i propozoi Mirashi, duke nxjerrë nga xhepi një kuti alumini.

Ata të dy zunë të ecnin krah njëri-tjetrit, duke kërkuar një vend të përshtatshëm ku të pushonin, ndërsa sytë e Frrokut, mbërthyer nga shtegu nëpër të cilin do të vinte shoku me benzinë, shprehin nervozizëm. Traktori humbi mes trungjeve. Zhurma e tij sa vinte bëhej më e largët. Pastaj, befasi, heshti.

...Traktori kishte arritur te skela e shkarkimit të trupave, buzë rrugës automobilistike. Ishte një platformë e gjerë, prej trungjesh të stivosura, të lidhura me ganxa të mëdha.

Buzë skelës tre punëtorë po ngarkonin me palla e cepina një Skodë. Shoferi, një ezmer i bëshëm, rreth të dyzetave, me pamje babaxhani, vështronte nga dritarja. Pak më tej, mbi stom, ndodhej një burrë i ri, i gjatë e i hollë; por me trup të lidhur. Dukej që sapo kishte arritur se gjoksi i hovte dendur nën fanellën e trashë, të thurur me lesh të tjerrur.

— A ka më trupa te të Vukës, Lulash?, — e pyeti ai traktoriistin.

— Kjo që rruga e fundit për sot!, — iu përgjigj Lulashi, duke zgjidhur kavon që shtrëngonte trupat. — Do të shkoj te brigada e Gjinit, gjersa të prodhojnë të tjerë.

— Ka sjellë boll, Ndrecë!, — tha shoferi, duke treguar me dorë skelën plot.

— Këtij përgjegjësit tonë s'i ngopet syri kurrë me trupa!, — vërejti me shaka njëri nga punëtorët e ngarkesës.

— Atëherë, s'po vijmë shpesh të ngarkojmë!, — tha shoferi. — Të mbetet gjithmonë skela plot, që të kënaqet syri i Ndrecës...

— Trarët e shtëpisë i kam hedhur, kaheërë, o Sulë!, — iu kthye Ndreca. — Trupat s'i kërkoj unë, por plani!

— E di, bre Ndrecë, e di, por dita pa shaka është si gjella pa kripë!, — qeshi Sula.

Ndërkohë traktoristi, që e kishte përfunduar shkarkimin e trupave, po përgatitej të nisej.

— Drejt e te brigada e Gjinit dhe mos lër asnjë shkop pa transportuar, se është fund pesëmbëdhjetëditëshi!, — e porositi Ndreca.

— Mos ki merak, shoku Ndrecë, veç të kenë prodhuar!.. — Lulashi kërceu mbi zinxhir, u fut në kabinë dhe e lëshoi traktorin përpara, duke i përshëndetur: — Mirë mbetshi, burra, e ju lumshin krahët!

Traktori zbriti në rrugë dhe e shtoi shpejtësinë. Ai dukej përherë e më i vogël nën kubënë e drurëve viganë, të cilët kishin kryqëzuar degët mbi trase.

Pas një kthese Lulashi shqoi një vajzë shtatlartë, që nxitonte buzë rrugës. Mbante një pambukore ngjyrë blu, pantallona të trasha, të zeza dhe në kokë kishte lidhur një shami të leshtë, ngjyrë vishnje. Në sup i varej një çantë e ndihmës së shpejtë. Ecte lehtë, duke e mbajtur trupin drejt. Ajo nuk e ktheu kokën as kur traktori iu afrua. Lulashi e parakaloi dhe frenoi. Vetëm atëherë ajo e vështroi dhe buzëqeshi.

Kishte ballë të gjerë, hundë të drejtë e sy të mëdhenj me një shkëlqim të kadifenjtë. Sytë i buzëqeshnin më fort se goja pak e madhe, me buzë të holla e të rrepta.

— Paskemi të njëjtën rrugë, me sa duket!, — vërejti Lulashi. — A po vjen ta bëjmë bashkë, Bardhë?

Ajo hezitoi, me sytë përdhé.

— Apo qysh kur u bëre ndihmësmjeke s'begenis të hipësh në traktor, se mos ndyheshe me vaj?!, — e ngacmoi ai kur vuri ré hezitimin e saj.

Vajza kërceu me shkathtësi mbi zinxhir dhe u fut në kabinë. Sakaq Lulashi e nisi traktorin.

— Pse më ngacmon, Lulash, ti e di punën time!, — e qortoi ajo butë.

— Pylli s'ka sy!, — ia priti ai, duke i hedhur një vështrim të gëzueshëm e çapkën.

— Por ka njerëz, gjithfarë njerëzish!, — vërejti ajo.

— Ti s'po bën kurr gjë të keqe!

— Ashtu është, por jo gjithkush mendon kështu!

Ndërsa traktori gllabëronte brezin e murmë të rrugës, në të dyja anët e tij parakalonin trungjet e hirta e të dendura të aheve. Degët e tyre ndereshin drejt qiellit, të kapërthyera me njëra-tjetrën, të ngarkuara me gjethe verdhoshe, që dridheshin gëzueshëm, sikur i gëzoheshin diellit

vjeshtak. Tek-tuk ngrihej madhështor ndonjë bredh i moçëm, me kurorë koniçe, ngjyrë jeshile të errët dhe me degë të gjata e të varura, si të rënduara nga vitet.

Ja edhe një çelthinë plot dritë. Vesa shndriste mbi barin ende të gjelbër dhe mbi halat e dëllinjave të rralla. Më tej u shfaqën disa shkëmbinj të hirtë, me njolla myshku. Rrëzë tyre shkumbëzonte një përrua, që rrëzohej aty-këtu, duke çuar stërkala të shndritshme. Poshtë shtrihej lugina, e përtej saj ngriheshin kreshtat kaltëroshe të maleve.

— Ç'po i kundron me aq përmallim, thua se s'je rritur në këto bjeshkë?!, — i tha Lulashi buzagaz.

Bardha kishte mbështetur krahun në dritare dhe vështronte me ëndje përreth.

— Bash pse jam rritur këtu, më ka marrë malli, se shkolla më largoi mjaft kohë prej tyre!, — iu përgjigj ajo.

— Pastaj do të të marrë malli për qytetin!, — vazhdoi Lulashi, me hile. — Besoj se ke mjaft kujtime të bukura prej tij!

— Ti ndoshta do përsëri të më ngacmosh, po vërtet kam kujtime të bukura!, — ia priti ajo, qetë-qetë. — S'harrohet kollaj koha e shkollës, as shoqet e shokët e katër viteve...

— Më thuaj të vërtetën, a ta ka ënda të martohesh me një qytetar?

— Ç'po flet edhe ti, Lulash! — Ajo ktheu sytë dhe, sa ndeshi vështrimin e tij, i uli — Sikur s'e di!, — vazhdoi, duke u skuqur lehtë.

— Makar, të jetoje në qytet?!, — këmbënguli ai.

— Guri është i rëndë në vendin e vet!... Mandej, kur po vijnë nga Gjirokastra e Tirana për të shërbyer në bjeshkët tona, qysh të na shkojë në mendje të zbresim në qytet?

Ndërkohë nga pylli nën rrugë doli një sharrëxhi me mustaqe të gjata, të varura poshtë, i kërrusur nën peshën e një bidoni, që e mbante me njëren dorë mbi sup. Ai priti buzë rrugës të kalonte traktori, duke vështruar me kuresh-tje në kabinën e tij. Sapo dalloi Bardhën, u zymtua në fytyrë dhe iu përgjigj thatë përsëritjes së tyre.

— E pe si u thartua në fytyrë Lleshi?, — vërejtí Bardha, disi e shqetësuar.

— Është burrë zakonesh dhe s'i pëlqen kur i shikon cucat bashkë me burrat!, — sqaroi Lulashi.

— Të ishte vetëm kjo!... Kam dëgjuar se e ka gjuhën e hidhur!, — tha Bardha.

Ndërkohë traktori mori një kthesë dhe Lleshi mbeti përtej saj.

2

Kur traktori u zhduk pas kthesës, Lleshi, që e kishte ndjekur me sy, tundi kokën, diçka mërmëriti me vete, pastaj kapërceu rrugën dhe nisi t'i ngjitej shpatit me hap të ngadaltë e disi të ngathët.

Pas një cope arriti tek punonte brigada e Vukës. Leshoi bidonin pranë Frrokut, drejtoi mesin që të shpihej dhe tha i ngrysur:

— Herë tjetër shko e merrë vetë!

— Nuk e kursyem Frrokun, por e lamë t'i bënte shërbimin motosharrës!, — ndërhyri Vuka.

Frroku e falënderoi Lleshin, pastaj rrëmbeu bidonin dhe nisi të mbushte serbatorin e motosharrës.

Lleshi kaloi më tej, duke kërkuar me sy një vend të përshtatshëm që të çlodhej. Gjeti një cung, u ul mbi të dhe nxori sakaq kutinë e duhanit.

— U lodhe, Llesh?, — e pyeti Mirashi, i cili po shkurtonte me sëpatë disa degë aty pranë.

— Më lodhi më fort kjo dhimbja e mesit, Mirash!, — iu përgjigj ai, duke dredhur cigaren. — Mandej, si të mos lodhem?! Punë këtu e punë në shtëpi! Ti e di, qysh kur më shkoi djali ushtar kam mbetur i vetmi burrë në kullë.

— Pa halle s'është askush!, — tha Mirashi, duke vazhduar punën me ngulm.

— Po, po, ashtu është!, — foli zvarrisur Lleshi, duke tundur kokën me një farë nënkuptimi. — Ja, edhe ti ke për të përgatitur dasmën e Bardhës. E keni caktuar se kur?

— Ende jo!, — ia priti Mirashi thatë.

— Bijat e fejuara janë më rëndë se gjithçka në shtëpinë e babës!, — theksoi Lleshi, duke nderur cigaren.

Ndërkohë Frroku e nderi motosharrën dhe iu afrua drurit të kllaposur prej Vukës. Pas pak zinxhiri prerës nisi të kafshonte drurin dhe të futej thellë e më thellë në trung, duke spërkatur tallash, i cili shquante përherë e më i bollshëm mbi legushë.

Pak më tej Vuka, me krahët e kryqëzuar mbi kraharor, ndiqte me vëmendje punën e djalit e, kur dalloj fytyrën e tij të freskët e të tendosur bulëza të imta djerse, buzëqeshi me dashmirësi.

«Po e lodhka motosharra më shumë se sharra e krahut!, — mendoj. — Por, ka për ta mësuar shpejt, se është djalë i shkathët. I shkathët si ai Frroku tjetër. Veç i shkof-të më mbarë se atij!»

Vetullat e dendura e të kuqërreme iu vrenjtën, sytë iu trishtuan. Iu kujtua një ish-shok i brigadës. Frrok Gjelo-shi, të cilin dhjetë vjet më parë e kishin zënë trupat dhe kishte mbaruar në krahët e tij. Ishte më i riu ndërmjet tyre dhe e kishte dashur si djalin e vet.

— Ruajuuu!, — ushtoi nëpër pyll zëri i Frrokut.

Legusha u trazua nga hapa që rendnin. Pasi një heshtje e shkurtër. Pisha u hepua pak nga ana e kllapës, qëndroi një çast pezull, cungu krisi, pastaj druri vazhdoi gjithnjë e më shpejt hepimin, i shoqëruar me një krisje që rritej, gjersa u përplas me rrapëllimë në tokë.

Vuka u afrua i pari dhe vërejti me një farë krenarie se druri që rrëzuar pikërisht nga e kishte terezitur ai kllapën. Ngriti vështrimin nga kurorat e drurëve përreth. Ato nuk qenë dëmtuar, po ndërmjet tyre ishte sajuar një boshllëk, si dritare nga qielli..

«Edhe druri lë vend bosh kur bie!, — mendoj Vuka. — Por dalngadalë kurorat e të tjerëve do ta mbushin».

Ndërkaq u afruan edhe të tjerët.

— Të lumtë, mirë paska shkuar!, — i tha Vuka Frrokut.

— E rrëzuar edhe një, hë?, — u dëgjua një zë mbrapa sharrëxhinjve.

— Mirë se vjen, inxhinier Bledari!, — e përshëndetën sharrëxhinjtë, duke i shtrënguar dorën.

Bledari ishte rreth të njëzetepesave, me trup mesatar, por të lidhur mirë. Vinte pak i imtë e fëmijnor në fytyrë, por me sy të pjekur e të zgjuar.

— I madh paska qenë! —, — tha inxhinieri me një farë keqardhjeje në zë, duke iu afruar drurit të rrëzuar. Mbështeti pëllëmbën në lëvoren e ashpër të trungut, pastaj e kaloi më sipër, te një degë, këputi ca hala, i ndrydhi ndërmjet gishtave dhe u mori erë.

— A po të dhimbset?, — e pyeti Frroku, duke buzëqeshur.

Bledari ktheu kokën nga ai.

— A ke qenë ndonjëherë bari, o Frrok Gjoni?

— Posi!

— A të janë dhimbsur deshtë kur i ke therur?

Frroku uli kokën i penduar.

— Njëqind e njëzet-vjeçar!, — vazhdoi Bledari, duke treguar rrathët e cungut. — Kurse ju në një çerek ore e përmbysët. Ju lumshin krahët, se i duhet druri vendit.

— Të lumtë goja, inxhinier!, — tha Vuka.

Të tjerët miratuan me kokë.

— Jot shoqe është ajo që erdhi me Sulën, inxhinier?, — e pyeti Lleshi, ndërsa po largoheshin nga druri i rrëzuar.

— Po. Ka ardhur të punojë për mbrojtjen e diplomës! Bën stazhin.

— Një rrugë e dy punë!, — buzëqeshi Frroku.

— Po bëka shkollë të madhe, si ti!, — vërejti Lleshi.

— Ç'do të dalë kur të mbarojë?

— Piktore.

— Aha, s'paska zgjedhur zanat!, — ia ktheu Lleshi, i pakënaqur.

Të tjerët qeshën.

— Po kaloj edhe nga ata të brigadës së Gjinit!, — tha Bledari, duke u përshëndetur me sharrëxhinjtë.

— Më mirë shko e bëni pak shoqëri sat shoqeje, se na ka ardhur mike!, — e këshilloi Vuka, duke i shtrënguar dorën. — Se nga ne edhe nga ata të Martinit ishe dje!

— Është zakon i malësisë që miku të mos lihet vetëm!, — e përforcoi Mirashi. — E ti, që tashmë u bërë yni, mos na e korit shtëpinë!

Bledari u largua duke buzëqeshur. Ia nisi shtegut të pyllit me hap të lehtë e të shkathët. Ecja e tij kishte diçka nga ecja e kafshëve të pyllit. Kur vinte këmbën, guri nuk luante nga vendi, degët nuk kërcisnin, legusha nuk trazohej. Vidhej midis degëve e shkurreve, thujt zgjerohej e ngushtohej bashkë me shtegun.

— Më ka hyrë në zemër ky djalë!, — tha Vuka, duke e ndjekur me sy.

— Thua se është rritur në këto bjeshkë!, — plotësoi Mirashi.

3

Pylli bëhej përherë e më i ndriçuar, kurse trungjet e drurëve dukeshin më të lehtë e më bardhoshe. Nga kjo Bledari e kuptoi se po arrinte te Livadhi i Lopëve. Dhe vërtet, pas pak u gjend buzë tij.

Ishte një lirishtë e gjerë, e veshur me bar të dendur e lule mali, e rrethuar me një kurorë pyjesh. Në njërin krah jeshilonin bredhat, me kurorat e tyre shtizore. Në anë tjetër verdhonin gjethet e dendura të ahishtes, mes së cilës disa pisha të rralla e të mçqme dukeshin si flakëza të gjelbra. Përtej dukeshin kreshtat e hirta-kaltëroshe të maleve e mbi to, kaltërsia e kristaltë e qiellit. Ajri ishte i pastër, i tejdukshëm dhe të dukej sikur malet do t'i kapje me dorë. Gjithçka ishte kredhur në një dritë rozë, të gëzueshme.

Bledari dalloi të shoqen, në skajin tjetër të livadhit, tek pikturonte, përpara një kavaleti. Eci drejt saj buzagaz, duke u munduar të shkelte lehtë, që ajo mos ta ndiente. Po dikur ajo ktheu kokën, brofi sakaq dhe u lëshua me vrap

drejt tij. Nxitonte me lëvizje të shkathta e të hijshme. Mbante një palë pantallona të leshta bojë b'u dhe një triko të bardhë, me qafore të lartë, që ia nxirrte bukur në pah bustin dhe belin e hollë.

Ai i doli përpara dhe e priti në krahë.

— Vjollcë!, — i pëshpëriti me dashuri, duke e shtrënguar lehtë në gjoks.

— Sa mirë që erdhe, Bledar!, — Ai ngriti drejt tij sytë në trajtë bajameje, që i kishte plot dritë dhe dashuri.

Fytyra e saj, e skuqur lehtë nga vrapimi, i ngjante asaj të një fëmije të gëzuar. Buzët, në ngjyrën e qershive të pjekura mirë, i kishte disi të trasha dhe të lëngshme. Flokët e gjatë e të zinj, i derdheshin lirshëm mbi supet.

Bledari e kapi për dore dhe nisën të ecnin nëpër livadh me hapa të lehtë rinorë. Pamja e tyre e hareshme përkonte më së miri me harenë e bjeshkëve plot drita dhe ngjyra.

— Si të duken bjeshkët tona?, — e pyeti ai.

— Të mrekullueshme!, — sa s'thirri Vjollca. — Më vjen ta përqafoj këtë pamje dhe ta shtrëngoj fort, fort në kraharor.

Ajo shtriu krahët përpara, sikur vërtet donte ta rrokte gjithësinë, pastaj mbushi gjoksin me ajrin e pastër e plot kundërmime.

Ndërkohë ata po i afroreshin kavaletit. Bledari shkante drejt tij me kureshtje, duke e tërhequr Vjollcën pas. Ajo, befas u bë e druajtur, si një nxënëse në provim.

— Është e zbehtë në krahasim me realitetin!, — vërejti singërisht, ndërsa ai po vështronte pikturën.

— Kurse mua më pëlqen!, — tha Bledari.

— Vërtet?! — Ajo përplasi duart me një gëzim fëmijor. — Se mos tallesh me mua?!, — dyshoi pastaj, duke vrenjtur vetullat.

— Aspak, më duket vërtet e bukur!

— Megjithatë, do të kesh ndonjë vërejtje?!

— Do të më pëlqente të kishte njerëz!, — u përgjigj ai, pasi u mendua pak.

— Ke të drejtë!, — tha ajo, duke e vështruar veprën

me sy të picërruar. — Peisazhi pa njerëz, sado i bukur qoftë, duket i varfër.

— Siç do të dukej ky livadh pa ty!, — buzëqeshi Bledari.

— Pa ne të dy!, — plotësoi ajo. — Megjithatë, ky është vetëm fillimi. Sa të tilla do të më duhen gjersa të arrij te vepra e diplomës!... Është një punë e mundimshme kjo jona, Bledar, megjithëse ndokujt mund t'i duket ndryshe.

— Çdo punë ka vështirësitë e saj, sidomos kur mundohesh ta bësh mirë!, — tha Bledari. — Veç, juve artistëve kjo ju shpërblehet më tepër se kujtdo. Me një vepër të goditur mund të bëheni të pavdekshëm!

— Kurse ju të ngratët, punoni gjithë jetën dhe në fund s'mund të thoni makar për një ngastër pylli se e keni krijuar vetë, apo jo?, — buzëqeshi Vjollca.

— S'më ha fort meraku për këtë!, — tha ai. — Përndryshe, s'do të isha bërë inxhinier pyjesh...

Vjollca u shtri në bar aty pranë, duke mbështetur mjekrën mbi pëlëmbë. Vështroi me kureshtje fijëzat e brishta të barit dhe lëvizjet e një mollëkuqeje që andej nëpër to. Nuhaste me ëndje aromën e livadhit dhe ndiente një prehe ngazëlluese.

— Në verë duhet të ketë luleshtrydhe këtej!, — tha.

— Në korrik kjo lirishtë kuqëlon prej tyre!, — iu përgjigj Bledari, duke zënë vend pranë saj.

— Oh, sa më pëlqejnë!... Apo s'kanë një aromë!...

— Do të vijë edhe korriku!, — buzëqeshi ai.

— Po arinj a ka këtej?, — pyeti ajo, me një kureshtje fëmijnore.

— M'i kanë treguar gjurmë e tyre, por s'më ka rastiur t'i ndesh ndonjëherë... për fat të mirë!, — qeshi ai. — Veç, bjeshkët kanë gjëra më interesante se këto, Vjollcë!

— A do të m'i tregosh të gjitha?

— Sigurisht! Veç të kesh dëshirë dhe... këmbë të forta. Që nesër, po deshe, ec me mua atje lart, te sharrëxhinjtë...

— Bledar!, — e thirri ajo, me zë të ulët, të ngrohtë e të thellë.

Ai ktheu kokën dhe sytë e tyre u ndeshën. Ai shihte në ninëzat e saj qiellin dhe imazhin e fytyrës së vet. Prej tyre sikur buronte një ngrohtësi e butë, që i vërshente atij në brendësi, duke i sjellë mornica lumturie.

— Vjollca ime!...

Sytë e saj u afruan, u afruan dhe pastaj u pulitën ngadalë...

Pas pak ata e lanë livadhin dhe u nisën drejt sektorit, nëpër shtegun që gjarpëronte mes ahishtes. Herë printe ai, herë ajo dhe aty ku shtegu zgjerohej, ecnin krahas, të zënë për dore. Dukej sikur fluturonin mëtëposhtë, ndërsa kurorat e aheve lëshonin mbi ta gjethe verdhoshe.

— Teta Vjollcë, teta Vjollcë!, — u dëgjua një zë fëmi-je dhe ata panë tek po rendte drejt tyre një djalë dhjetë-vjeçar, fytyrërrumbullak, me flokë të qethur shkurt, me sy të shndritshëm e të zgjuar.

— Qenke miqësuar me Bardhokun?!, — buzëqeshi Bledari.

— Ai më solli te Livadhi i Lopëve!, — iu përgjigj ajo.

— Merri, për ty i kam mbledhur!, — tha Bardhoku, duke ndalur vrapin pranë tyre, ndërsa gjoksi i hovte dendur nënë fanellën e leshtë, ngjyer me lëvozhgë arrash.

Ai i zgjati Vjollcës një tufë lule vjeshtake.

— Falemnderit, Bardhok!, — u gëzua ajo, duke i vënë dorën në sup me përkëdheli.

— Tani do të mbledh edhe për nënën!, — tha ai dhe sakaq u largua me vrap.

— Si kërcen krep më krep, si një kec!, — vërejti Vjollca me admirim.

— Ai në këto shtigje i ka hedhur hapat e parë!, — tha Bledari.

— Më tregoi se të atin ia kanë vrrarë trupat!, — tha Vjollca me keqardhje. — As që e paska njohur!... Sharrë-xhi Vukën dhe ty ju dashka më fort se të tjerët... Ndoshta më tha për të më bërë qejfin?!

— Jo, është treguar i singertë, si janë zakonisht fëmijët!, — tha Bledari. — Vuka s'ka njeri, përveç një vajze që e ka martuar larg dhe është dhënë shumë pas Bardhokut.

Pastaj, babai i tij në brigadën e Vukës ka qenë... Kurse unë e kam ndihmuar shpesh në mësim. Është djalë i zgjuar. Makar t'i bëhet i hajrit së ngratës Mrikë, që i lidhi jetën me të.

— Mrika është kamerierja e mensës, apo jo?

Bledari pohoi me kokë.

Ata dolën në një shpat të zhveshur, nga ku sektori dukej si në pëllëmbë të dorës. Ndërtesat ngjanin si kuti të rreshtuara buzë një përroi që gjarpëronte si një shirit i ndritshëm në fundin e luginës. Rreth e qark shtrihej pishnaja, si një det me dallgë të gjelbra.

— Më duket sikur qëndroj pezull në ajër e do të më rriten krahët të fluturoj!, — tha Vjollca, duke admiruar atë pamje.

— Bukur është, po ec, se po më gërryen uria!, — e nxiti ai, duke vazhduar rrugën.

— Sa prozaik!, — u vrenjt ajo.

— S'jam i atillë, por më janë mësuar sytë me këto pamje!, — u shfajësua ai. — Ka edhe më të bukura.

Sektori fshihej e shfaqej mbas pishave, ndërsa godinat e tij dukeshin përherë e më të mëdha. Së fundi, kapërcyen një urë të varur mbi rrjedhën shkumëzuese të Prroit të Kuq dhe arritën në sheshin e sektorit.

Ai ishte pothuaj i shkretë. Qyteza e vockël dukej sikur dremiste nën diellin e vakët vjeshtak. Nga oxhaku i lartë i mensës ngrihej përpjetë një fjollë blu tymi.

— Kam përgatitur unë diçka për drekë!, — tha Vjollca, kur vuri re se Bledari po drejtohej për në mensë.

— Dreka e parë familjare!, — buzëqeshi ai, duke fërkuar duart. Sigurisht që do të kesh bërë diçka të mirë?!

Ajo nuk iu përgjigj, por eci drejt fjetores së sharrëxhinjve. Fjetorja ishte një godinë e madhe prej guri, me çati të pjerrët llamarine, në të cilën dukeshin si baxha dritaret e katit të sipërm.

Dhoma e tyre ishte një e ndarë e vogël nën çati. Dritarja e vetme vështronte sheshin e sektorit. Kishte dy shtretër, një komodinë mes tyre, një raft, një tavolinë të vogël dhe dy karrige, të gjitha këto nga inventari i sekto-

rit. Megjithatë, nuk dukej si një dhomë e zakonshme fjetoreje. Në gjithçka dallohej një dorë e kujdesshme gruaje.

Mbi komodinë shquante një çentro e bukur, e thurur me grep. Në dritare ishin vendosur perde garze, të bardha e të hekurosura përbukuri. Tavalina që mbuluar me një mësallë të qëndisur, me xhufka anash, Çarçafët e hekurosur qenë kthyer me kujdes mbi batanije. Në mure ishin vendosur disa piktura me karbon dhe bojra vaji. Shquante ndërmjet tyre një fotografi në kornizë druri të gdhendur.

Bledari flaku xhaketën mbi shtrat dhe iu afrua raftit.

— Ah, jo!, — ia zuri rrugën Vjollca. — Ulu e prit ta shtroj për së mbari!

— E ke rregulluar si një çerdhe pëllumbash!, — bëri shaka ai, duke admiruar dhomën.

— Por ti ke qëlluar pëllumb i egër!, — e qortoi ajo. — Të lutem, vare xhaketën në vendin e vet!

— Si urdhëron!, — iu bind ai duke buzëqeshur. — Veç do të më pëlqente të «egërsoheshe» edhe ti ca!

Ndërsa Vjollca po mundohej ta shtronte sa më bukur tavolinën, Bledari vështronte pikturat dhe vizatimet që zbukuronin murin. Qëndroi më gjatë përballë kornizës prej druri të gdhendur. Në fotografi ishin katër të rinj, ndërmjet tyre ata të dy, tek bisedonin gëzueshëm në bregdetin e plazhit të Durrësit.

— Ç'kujtim i bukur!, — tha ai. — Sikur ta dinte fotografi se ajo ditë do të ishte zanafilla e bashkimit tonë!

— Pas disa ditësh mbushen plot tre vjet!, — tha Vjollca me nostalgji. — Do ta festojmë, Bledar?

— Si të duash, e festojmë!, — u përgjigj ai.

— Do të merrem unë me përgatitjet!, — u gjallërua ajo. — Veç, edhe ti do të më ndihmosh!

Vjollca përshkoi sheshin e sektorit dhe hyri në mensë. Ajo ishte një sallë e gjatë, me dy radhë tavolinash të për-

gatitura për shërbim, në njërin ballë të së cilës ndodheshin sportelet e kuzhinës, kurse në ballin karshi, banaku. Pra-pa tij një burrë i paktë, thatim, por me pamje të shkathët, diçka rregullonte nëpër rafte.

Vetëm në dy tavolina kishte njerëz. Mrika, një malësore e gjatë, e hollë, e veshur me bluzë të bardhë, të pastër e të kopsitur gjer sipër, po mblidhte pjatat e boshatisura. Ecte me hapa të matur e krenarë.

Vjollca shkoi drejt banakut me një farë hezitimi dhe disi e pezmatuar.

— Edhe sot s'paske dalë lart me Bledarin?, — e pyeti banakieri.

— Është e lodhshme përditë, Stakë!, — iu përgjigj ajo. — Pastaj, lamë një punë për ta kryer së bashku këtu. Më premtoi se do të kthehej shpejt, por s'po duket gjëkund.

— Burrat e këtyre anëve kështu e kanë, moj motër!, — ndërhyri Mrika, duke u afruar. — Kur jepen pas punës, harrojnë gjithçka. Kështu bënte edhe Frroku i ngratë, qysh në javën e parë të martesës. Inxhinier Bledari s'dallon prej tyre.

Mrika kishte tipare të rregullta dhe sy të mëdhenj e të butë, që binin disi në kundërshtim me buzët e holla e të shtrënguara. Nga shamia e bardhë me të cilën kishte lidhur kokën, i dilnin dy bishtaleca të gjatë. Pamja e saj rrezatonte diçka të ngurtë e të rreptë.

— A i kreve ato vizatimet me sharrëxhinj?, — e pyeti Staka mysafiren.

— Disa!, — u përgjigj ajo dhe zgjati dorën drejt një gote.

— Prit të të sjell një gotë qumësht të freskët!, — e ndaloi Mrika.

— Kur ju paska ardhur?! Unë kujtoja se ju gatuan vetëm qumësht pluhur!, — tha Vjollca.

— Ma kanë sjellë sharrëxhinjtë për Bardhokun!, — sqaroi Mrika. — Bile, kur ishte i vogël, shkonin enkas në shtëpi, që t'i sillnin qumësht të freskët! — Ajo doli me nxitim.

— Të isha në vendin tënd unë s'rrija asnjë ditë pa da-

lë lart!, — vazhdoi Staka. — Atje është jeta! Kurse këtu, veç darkave dhe mëngjeseve, kur janë sharrëxhinjtë, pastaj... — Ai bëri një gjest përgmues me dorë. — Ç'tu bëj trupave që më gjymtuan, se s'mbërthehesha në banak unë, jo!

— Si të ka ndodhur, Stakë?, — pyeti me kureshtje Vjollca.

— Atëherë isha sharrëxhi në brigadën e Vukës!... — Staka doli nga deriçka e banakut dhe erdhi në tavolinë, pranë Vjollcës. — Dhjetë vjet më parë, në mes të nëntorit mbushen plot dhjetë, po stivoja trupa bashkë me të shoqin e Mrikës, Frrokun...

— Bashkë paskeni qenë atë ditë?!, — u habit ajo.

— Po. Ai s'e kishte shokun në capinë, i fortë si div e i shkathët si ketër... Por koha qëlloi e lagësht dhe stiva e trupave u shemb përnjëherë. Dëgjova piskamën e shokëve dhe kërceva sa munda, por s'dola pa u dëmtuar...

— Si s'shpëtoi edhe Frroku!, — tha Vjollca me kaqardhje.

— Ah, sikur të kishte shpëtuar! Por ai ndodhi në mes të stivës dhe u godit më rëndë. U shua në krahët e Vukës. «Amanet djalit dhe Mrikën!», u tha shokëve. Një vit mërtësë kishin dhe sapo u pat lindur Bardhoku.

— E ngrata Mrikë!, — psherëtiu Vjollca.

— Ajo u mbajt si burrneshë!, — vazhdoi Staka. — Kur e sollën në vig këtu, shokët që e mbanin, qanin. Kurse Mrika as nuk briti e as nuk qau, sido që zemra e saj e dinte.... «Mbahuni, bre burra!, — u pat thënë shokëve. — Vdekja për njerëzit është e lum kush vdes kështu, me nder!»

— Si arrini të jeni kaq të përmbajtur ju, malësorët, Stakë?!, — tha ajo me admirim.

— Na ka mësuar jeta, moj motër! Ndryshe s'do të kishim qëndruar dot në këto bjeshkë të rrepta.

— Pse ngeli Mrika këtu, s'pati prindër e të afërm?, — u interesua më tej Vjollca.

— Ka, si s'ka, por qe prishur me ta qysh kur u martua. Ata të dy qenë rritur bashkë, se i kishin kullat fqinjë. Si-

pas zakonit, prindërit i patën fejuar gjetiu, jashtë fshatit, por ata që e donin njëri-tjetrin, e thyen zakonin dhe u rrëmbyen. U bë bujë e madhe, madje sa s'krisi pushka, por ndërhyri Partia dhe ata u vendosën këtu. Disa kohë pas vdekjes së Frrokut, njerëzit e tij erdhën ta merrnin djalin, por ajo s'e lëshoi. Kishte vendosur ta lidhte jetën me të. Kështu mbeti në sektor dhe na u bë si motër. Ti e dëgjove Mriken...

Sakaq hyri Mrika me gotën e qumështit në dorë. Gota kishte dërsirë nga jashtë.

— Është akull i ftohtë! E kisha futur shishen në ujin e burimit!, — tha Mrika, duke ia zgjatur Vjollcës.

Ajo piu me ëndje, duke e vështruar tjetrën me dashuri dhe respekt.

— S'e paska shokun, kundërmon lule mali!, — tha pastaj, duke fshirë buzët me kurrizin e dorës.

— Ka edhe bjeshka të mirat e saj, moj nuse!, — u krenua Mrika, duke buzëqeshur lehtë.

— A mund t'ju ndihmojmë ne?, — pyeti Staka.

— Nesër, meqë është e diel, kemi vendosur të festojmë me ju përvjetorin e bashkimit tonë!, — iu përgjigj Vjollca. — Besoi se ju ka ftuar?!

— Po, falemnderit, por unë s'do të vij dot se, helbete, s'lihet mensa pa banakier!, — tha Staka me keqardhje. — Po Mrika le të vijë, i marr unë përsipër punët e saj...

— Prandaj më duhet të pres të zotin e shtëpisë. Ndosh-ta do të kujtohet për detyrimet që ka!, — vazhdoi Vjollca me një buzëqeshje qortuese.

— Pa tjetër që do t'i ketë dalë ndonjë punë, se ai është burrë i fjalës!, — tha Staka. — Por, mos u mërzit, duhet të vijë...

Ndërkaq Mrika doli vjedhurazi nga mensa, u largua disa hapa dhe thirri me zë të lartë:

— Bardhok, o Bardhoku i nënës!...

Pas pak djali doli nga buza e pyllit dhe erdhi me nxitim pranë saj. Ajo diç i tha me zë të ulët, pastaj i ra supeve me dashuri dhe sakaq ai u nis përperjetë, nëpër shtegun që të çonte lart, te sharrëxhinjtë.

Nuk ndaloi asgjekundi, bile as për të vështruar një këter që i kaloi mbi kokë, duke kërcyer nga njëra degë në tjetrën, as për të pirë ujë te Kroj i Bardhë, as për të këputur makar një lule. Ngjitej me hap të shpejtë e të shkathët, vende-vende vraponte, me pamjen e një njeriu të ngarkuar me detyrë të rëndësishme. Dukej që i njihte shtigjet mirë, se asgjekundi nuk hezitoi, në asnjë udhëkryq nuk u step.

Pas pak nisën të dëgjoheshin goditjet e sëpatave, zhurma e motosharrave dhe pastaj krisja e një druri që po rrëzohej, e shoqëruar me thirrjen e zakonshme «Ruajuu!»

Bardhoku hipi majë një shkëmbi të hirtë, vuri duart si hinkë rreth gojës dhe thirri me sa fuqi pati:

— Baca Vukë, oreee!

— Këtu, ore, këtuuu!, — iu përgjigj tjetri pas pak.

Bardhoku zbriti nga shkëmbi dhe vrapoi andej nga erdhi zëri.

Ç'të sollti me kaq nxitim!, — e pyeti Vuka disi i shqetësuar. — Mos ka ndodhur gjë në sektor?

— Jo, jo, por më çoi nëna të gjej inxhinier Bledarin!, — iu përgjigj i vogli dhe i tregoi si ishte puna.

— Këtu rreth duhet të jetë, s'ka pak që u pashë me të!, — tha Vuka, duke buzëqëshur i lehtësuar. — E kërkojmë bashkë!

Vuka përpara dhe Bardhoku pas, u nisën andej nga punonin sharrëxhinjtë e tjerë. Pyetën për inxhinierin dhe i ranë në gjurmë. Së fundi e dalluan në fundin e parcelës së shfrytëzimit, pranë rrugës, tek po grindej me Lulashin.

— Jo, rruga e traktorit s'duhet të kalojë këtej, se dëmtton rëndë filizërinë!, — po i thoshte Bledari, i zemëruar paq.

— Ej, inxhinier po s'u prish, nuk ndreqet!, — ia priti Lulashi.

— Ah, jo, jo, s'e ke mirë!, — ngulte këmbë Bledari, i zymtë. — Këta duhet t'i ruajmë si sytë e ballit, se janë vocërrakët e pyllit! — Ai kaloi pëllëmbën sipër filizave, si t'i përkëdhelte. — E, si thoni ju, malësorët, vatra pa fëmijë është vatër e shuar!

— Nga t'ia mbaj, pra, ky për hava s'kalon?! — Lula-

shi tregoi me dorë traktorin që kuqëlonte mes filizave. — Janë kaq e kaq brigada që më presin, s'mund të rri pa punë!

— Ta piketoj unë rrugën, menjëherë!, — ia priti inxhinieri.

— Ç'farë, tani do ta piketosh?!, — ndërhyri sakaq Vuka, që ishte afruar me Bardhokun pas.

— Bash tani!, — iu përgjigj Bledari i zemëruar. — Thuaj, Vukë, futet traktori këtu?! — Ai tregoi me dorë filizat.

— Mos, bre burrë, kursesi!, — tha Vuka. — Por, këtë punë e bëjmë edhe ne. Ti shko, se të pret Vjollca.

Bledari u kujtua dhe shtangu, i zënë ngushtë.

— Hajt, pra, shko, se si zot shtëpie të takon të përgatitesh disi!, — vazhdoi Vuka, duke i rrahur shpatullat. — E rregullojmë vetë punën e rrugës. Kemi nxjerrë kaq e kaq vija uji, jo më një shteg traktori. Ajo mos është më nazeli se uji ky traktori yt, Lulash?

— Jo, jo!, — u përgjigj ai, duke ulur kokën i penduar.

— Ki besim se s'i prishim filizat, inxhinier!, — tha Vuka.

— Fjalë është ajo! S'ka pse të më dhimbsen më fort sesa juve!, — theksoi Bledari.

— Udhë e mbarë, atëherë!, — Vuka i zgjati dorën e djathtë, ndërsa me tjetrën i afroi Bardhokun. — Merre me vete këtë mec!

5

Ishin shtruar të gjithë rreth një sofere të sajuar rrëzë një druri të moçëm e degëshumë, në një çeltnë pylli mbi sektor. Në krye të vendit ndodhej Vuka, në njërin krah të tij Bledari dhe në tjetrin. Vjollca. Rrethi vazhdonte me Ndrecën, Sulën, Mrikën dhe mbyllej me Bardhokun.

Mbi mësallën e bardhë ishin vendosur pjata me mish, djathë sallatë e meze të tjera. Shishet e birrës e të rakisë i kishin mbështetur radhë në trungun e drurit. Rrëzë tij ndodhej edhe një pushkë.

— Qofshi gjithmonë faqebardhë, të lumtur dhe me një sofër fëmijë!, — uroi Vuka, me gotën e rakisë në dorë.

— Falemnderit e gjithmonë faqebardhë edhe ju!, — ia priti Bledari, duke trokitur gotën me të, pastaj me të tjerët.

Vjollca, si u përshëndosh me Vukën, iu kthye Mrikës:

— E paç me jetë Bardhokun dhe u bëftë që të krenohesh me të!

— Të lumtë goja e paçi ç'ju do e bardha zemër!, — ia ktheu ajo.

— Bardhokun do ta bëjmë inxhinier pyjesh!, — tha Vuka. — Të punojë në sharrë, si i ati. Të kemi inxhinierë nga bjeshkët tona.

— Pse, ne s'jua mbushim syrin?, — e ngacmoi Bledari, buzagaz,

— Qysh ta nxe goja atë fjalë, more mik?, — u ngrysu Vuka. — Por kemi edhe ne djemtë tanë. Për dy kokë dhi a për një krah pune i kemi mbajtur te shtëpia pa shkollë e kushedi sa bursa na janë djegur. Vonë na erdhën mendtë. Na i solli Partia, përndryshe... Bardhokun, që e kam si djalë, s'e dua më të mirë se ti, Bledar. S'e pata ndër mend të ta thosha, se njeriu s'lavdërohet në sy, por meqë më ngacmove...

— S'bëjmë veçse detyrën, baca Vukë!, — tha Bledari. — Pastaj, bjeshkët janë edhe tonat!

— Këta do të na e kalojnë!, — ndërhyri Sula, duke treguar me kokë të voglin.

— Kushtet i kanë, veç në s'paçin kokë!, — tha Ndreca.

— Gëzuar, Bardhok!, — e nxiti Vjollca djalin, që kish-te një gotë birrë në dorë. — Mos rri mënjanë, merre këtë copë mish!

— Ha, se je sharrëxhiu!, — iu drejtua Ndreca. — Mos na e vini ré, se ne, sharrëxhinjtë, hamë shumë!, — iu kthye pastaj Vjollcës me shaka.

— Ti je përgjegjës, s'je sharrëxhi!, — ia priti ajo.

— Që pesëmbdhjetë vjeç me sëpatë dhe capinë kam quenë!, — tha Ndreca. — Përgjegjësllekun s'e kam zanat. Ma

kanë varur shokët këtë këmborë e duhet ta tund, por, në s'e tundsha mirë... vrap e te bishti i capinës!

Të tjerët qeshën.

Mrika bëri të çohej t'u shërbente burrave, por Vjollca e ndaloi, duke e kapur për krahu.

— Më takon mua, si zonjë shtëpie!, — i tha buzagaz.

— Rri, Mrikë, në sofër të burrave, se e ke merituar me pushkë!, — bëri shaka Vuka, duke treguar me kokë armën e mbështetur rrëzë drurit.

— Nxitova t'i ndihmoja Vjollcës për përgatitjet dhe s'arrita ta dorëzoja në repart pas stërvitjes!, — u shfaqësua Mrika disi e turpëruar.

— E kemi komandante çete në sektorin e këtushëm të kooperativës!, — sqaroi Ndreca. — Shenjon aq mirë, sa mjaft burra koriten përpara saj.

— Ndoshta edhe ti?!, — qeshi Sula. — Të lumtë pushka, Mrikë, se kështu e meritojnë disa burra të rëndë! — Ai rrëmbeu gotën e rakisë dhe e trokiti me Mrikën.

— Më ngadalë më atë raki, se pastaj, ç'ka barku, ta nxjerr tubi i lastikut!, — e ngacmoi Ndreca.

— Kjo është e mirë dhe avullon shpejt!, — ia priti Sula, duke tundur lehtë përmbajtjen e gotës. — Deri në mbrëmje...

— Po makina që pret ngarkuar?!, — tha Ndreca. — Kur qëllon që të vonojmë ne pak në ngarkesë, bën namin, kurse sot. . .

— Sot ndryshon puna!... Pastaj, përditë unë e pres makinën, le të më presë një herë edhe ajo mua!

Vuka shkundi gotën e rakisë dhe zgjati dorën nga çiftelia që kishte pranë.

— A ju pëlqejnë këngët me çifteli?, — iu drejtua çiftit:

— Dikur s'i shijoja edhe aq, kurse tani s'e marr dot me mend malësinë pa çifteli!, — u përgjigj Bledari;

— Ndoshta edhe Vjollcës do t'i pëlqejnë një ditë!, — buzëqeshi Vuka dhe filloi t'i binte.

Gishtërinjtë e tij të trashë e të vrazhdë dukeshin sikur do t'i këputnin sakaq ata tela të hollë, por jo, prej tyre nisi

të buronte një melodi e gëzueshme, që dridhej bashkë me gjethet e drurëve, tretej me gurgullimën e përroit dhe këngët e zogjve, jehonte bashkë me zërat e bjeshkëve dhe ngrohte zemrat e njerëzve...

Befas, ndërmjet tingujve të çiftelisë u dëgjuan tri të shtëna pushke. Gishtat e Vukës sikur ngrinë mbi tela. Të gjithë brofën në këmbë.

— Hej-heej, zjarr, oreee, te Kunora, oreee!, — thërriste dikush andej nga sektori.

Burrat u nisën me vrap. Vjollca ngeli në këmbë si e ngrirë. Pastaj uli sytë nga sofa. Njëra nga gotat e rakisë që përmbysur, duke njomur vendin përreth. Pirunët dergjeshin andej-këndej të flakur në nxitim e sipër. Mësalla që trazuar dhe një cep i saj që futur në pjatën e mezeve.

Mrika e vështroi me keqardhje, duke i vënë dorën në sup.

— Edhe sot!, — psherëtiu Vjollca.

Mrika filloi e para të mblidhte sofrën, me lëvizje të shkathëta e të shpejta dhe me një farë padurimi. Sakaq i shkoi në ndihmë edhe i biri, ndërsa Vjollca u kujtua e fundit. Asaj vendin e gëzimit ia kishte zënë një shqetësim i thellë, që i kishte mpirë mendimet dhe gjymtyrët.

Kur ato të dyja dhe djali zbritën në sektor me duar të ngarkuara, e gjetën atë krejt të shkretë. Bile edhe dera e kuzhinës që mbyllur, kurse nga oxhaku nuk dilte asnjë fije tym.

«Vata paska shuar zjarrin dhe paska shkuar!», — mendoi Mrika, ndërsa shpejtonte hapat drejt dhomës së giftit.

— Unë po ngjitem te zjarri, ndoshta ndihmoj diçka!, — i tha Vjollcës, sapo lëshuan enët dhe shishet mbi tryezë. — Ti rri e pusho këtu, se boll u lodhe me përgatitjet... Hajde, mos u mërzit, ju e bëtë nderin. Gjithmonë, për gëzime e shtrofshi!, — vazhdoi duke dalë me nxitim.

Pas pak Vjollca e pa nga dritarja tek po i ngjitej shtegut, me një lopatë në krah. Bardhoku e ndiqte pas.

Ajo mbështeti ballin në xham dhe e treti vështrimin në një pikë të papërcaktuar. Ndiante një humbëtirë në lukth dhe tëmthat sikur ia shtrëngonte diçka.

«Po unë ç'do të bëj, qyqe, këtu, gjersa të kthehen ata?!», — mendoi dhe e ndjeu veten të humbur e të braktisur mes atyre maleve, kreshtat e të cilave ngriheshin kërcënuese rreth e qark.

«S'do të pres, do të shkoj, do ta arrij Mrikën!..», — vendosi dhe u lëshua me vrap jashtë, pa u kujtuar ta kyçte derën.

Mrika e vuri ré që larg Vjollcën dhe qëndroi ta prishte, duke e vështruar me keqardhje se si ajo nxitonte përpjetë, me pamje të trazuar.

— U lodhe, motër?, — e pyeti kur u afrua.

E kishte kuptuar gjendjen e shoqes dhe mendoi se çdo bisedë apo fjalë tjetër do të ishte pa vend. Vazhdoi në heshtje ngjitjen, duke e përmbajtur hapin, që të mos lodhej tjetra.

Kur arritën në mesin e shpatit, filloi të vinte era tym pishe. Diku më lart panë flakët. Ato herë fashiteshin, herë shpërthenin, sikur donin ta gllabëronin pyllin. Drejt qiellit ngriheshin valë-valë shtëllunga tymi të zi.

Pastaj ato dëgjuan thirrjet e njerëzve dhe kërkëllitjen kërcënuese të zjarrit. Në mënyrë të vetvetishme nxituan hapat. Era e tymit dhe e shkrumbit bëhej përherë e më e theksuar, bile së fundi panë një tis blu që po shtrihej nëpër pyll. Dhe ja, u ndodhën përballë zjarrit.

Vjollca u mbështet e llahtarisur në një trung druri dhe vështroi flakët me sy të zmadhuar. Ato çoheshin përpjetë dallgë-dallgë, përkuleshin, përdridheshin, zgjateshin, shtriheshin dhe nxitonin përpara në një ballë gjarpërues, duke iu afruar një pylli të ri.

Përballë tyre ndodheshin njerëzit. Herë shquheshin siluetat e zeza në sfondin e zjarrtë, herë skuqnin përballë flakëve, sikur po ndizeshin bashkë me pishat. Disa gërmomin një brez dheu, të tjerë qëronin shkurret dhe filizat e rrallë, duke synuar t'i prisnin rrugën zjarrit. Tehet e lopatave, kmesave e sëpatave llamburitnin, ndërsa lëviznin me shpejtësi. Dëgjoheshin urdhra e thirrje nxitëse.

Vjollca kërkonte me sy të picërruar Bledarin. Dikur

dëgjoi zërin e tij dhe e dalloi tek vraponte përballë zjarrit, me një kmesë në dorë.

— Kënde, shokë, kënde!, — thërriste ai. — Prejini filizat e rrallë, mos i kurseni, të shpëtojmë pyllin e ri!

Një turmë sharrëxhinjsh pylltarësh e malësorësh u lëshua pas tij. Edhe Vjollca hovi përpara, por sakaq iu duk i kotë gjesti i saj dhe shtangu në vend. Ç'do të bënte ajo atje, ta pengonte?! E ndjeu veten drejt të padobishme, bile të tepërt dhe u struk përsëri te trangu, si të donte të fshihej pas tij.

Ndërkohë u dëgjua uturima e një traktori, që erdhi duke u rritur, gjersa sundoi mbi kërkëllitjen e zjarrit. Sakaq përballë flakëve u shfaq traktori i Lulashit. Ai uli me shpejtësi ruspën dhe u sul përpara duke shtyrë dhë.

Flakët arritën deri te brezi, ballë për ballë me njerëzit. Ata pritnin me fytyra të tendosura dhe me veglat në gatishmëri. Vuka shtrëngonte fort nofullat, të cilat i dukeshin më të mëdha se zakonisht. Ndreca sa s'e bëri gjak buzën e poshtme, duke e shtrënguar me dhëmbë. Bledari ndihej i shqetësuar.

Flakët zgjatëshin, kërkonin të hidheshin përpara por s'arrinin, sikur një dorë vigane i kishte mbërthyer nga poshtë. Dalngadalë filluan të fashiteshin, por herë-herë shpërthenin përsëri. Megjithatë, hovet e tyre bëheshin gjithmonë e më të dobëta dhe më të rralla.

Fytyrat dhe gjymtyrët e njerëzve filluan të çliroheshin. Ata s'luanin nga vendi, si të kishin ngrirë. Veglat i kishin ulur përtokë dhe qenë rënduar mbi bishtat e tyre.

Befas, një gjuhëz dinake zjarri kapërceu me shpejtësi brezin, gjarpëroi vetëtimthi përpara dhe arriti te një grumbull filizash pishe që u ndezën sakaq. U dëgjua një klithmë dëshpërimi dhe njerëzit u sulën andej.

Vuka, që ndodhej më afër se të tjerët, u lëshua mes flakëve me sëpatë në dorë dhe u mundua t'u ndalte hovin, duke prerë gjithçka përballë tyre.

Vukë, kujdes, Vukë!, — thirrën të shqetësuar shumë shokë, kur vunë re se atë e kishin rrethuar flakët.

Vuka, me një kërcim të shkathtë doli te brezi i punuar dhe u zhgërrye në dhé, gjersa u fik. Sakaq e kishin rrethuar shokët.

— Shpëtova, s'kam gjë, kujdes zjarrin!, — thërriste Vuka.

Traktori u lëshua drejt degëzimit të zjarrit, ia preu rrugën dhe e mbyti, duke i hedhur dhé përsipër.

Më në fund, në vendim e zjarrit mbeti një njollë e madhe, e zezë, prej së cilës ngriheshin fjolla tymi të kaltër. Aty-këtu skuqte prushi. Nganjëherë ai kërciste dhe lëshonte shkëndija, të cilat i rrëmbente era. Njerëzit, me fytyra të nxira e të lodhura, ndiqnin me shqetësim rrugën e tyre dhe prisnin në gatishmëri.

Vuka qe ulur në një skaj dhe nuk ua vinte veshin lutejeve të shokëve, që i thoshin të shkonte sa më parë në qendrën shëndetësore.

— Boll u morët me mua, bre burra!, — bubulloi dikur ai. — Këqyrni zjarrin, se është i pabesë. Besomëni, s'kam ndonjë gjë të madhe. Ja, mbasi të çlodhem pak, nisem vetë. S'kam nevojë për shoqëruese!

— Mos na nxirr edhe ti punë!, — ia preu Ndreca. — Nisu! Lleshi e Lulashi do të vijnë me ty. Çova Mirashin të lajmërojë Bardhën, se qëlloi e diel e ndoshta është në shtëpi.

— Mirë pra, u bëftë siç thoni ju!, — u dorëzua Vuka. Mbështeti pëllëmbët në tokë dhe u çua ngadalë, duke u munduar ta duronte dhimbjen. Provoi të ecte vetëm, por hoqi dorë shpejt dhe u mbështet në krahët e shokëve. Ndreca, Bledari dhe Staka shkuan ta përcillnin një copë rrugë.

Ndërsa zbrisnin, Bledari vuri ré me habi Vjollcën, e cila qëndronte te trungu, si ndonjë shtatore. Rendi drejt saj.

— Këtu paske qenë?!, — i tha duke e zënë për dore.

— Oh, Bledar!, — psherëtiu thellë ajo dhe u struk në krahët e tij. — Këto pyje, që duken kaq të bukura nga jashtë, fshihkan gjithë këtë egërsi!

— Vështirësi do të thuash?!, — e korrigjoi ai duke bu-

zëqeshur. — Eh, moj Vjollcë, s'do të ishte keq ta mësonin të gjithë se druri s'prodhohet vetëm me djersë, por edhe me sakrificat!... Më prit edhe pak!

Ai u shkëput prej saj dhe nxitoi të bashkohej me grupin që përshëndoshej me Vukën.

6

Kur Vuka me shokët arritën në qendrën shëndetësore, Bardha i priste te dera. Dukej që kishte nxituar, se ende ishte e skuqur në fytyrë dhe balli i bulëzonte djersë.

E çoi Vukën në dhomën e vogël të ambulancës, e vendosi në shtratin e vizitave dhe filloi t'ia pastronte me kujdes vendet e djegura.

Vuka, që të mos e shfaqte dhimbjen, shtirej sikur vështronte me kureshtje raftin e barnave dhe dritaren me perde të bardha garze, përtej të cilave dukej një degë qershie.

— Ke shpëtuar lehtë!, — i tha Bardha pas pak. — Në përgjithësi ke djegie të lehta e vetëm në disa vende janë të shkallës së dytë.

— Të lumtë goja!, — u gëzua Lulashi.

Të dy shoqëruesit e ngatërronin Bardhën, që shkonte e vinte te tryeza e mjekimit.

— A të vjen keq të presësh jashtë ti, Lulash?!, — i tha atij Bardha. — Baca Llesh, si më i vjetër që është, le të qëndrojë!

— Si urdhëron, shoqja ndihmësmjeke!, — ia bëri Lulashi me ton thumbues, duke u zmbropsur drejt derës.

— Shko drejt ti, Lulash, se mjaft është Lleshi!, — i tha Vuka. — Shtëpitë i kemi në po atë krah, kurse ti je larg.

— Jo, jo, po të pres në korridor!, — kundërshtoi Lulashi.

— Shko, pra, a s'e dëgjove se s'kam gjë të madhe?!

— Mirë atëherë!, — u bind ai. — Qofshin të shkuara, pra!

— Falemnderit!

— Dhe ti, shoqja Bardhë, na fal për bezdinë! — Lulashi i hodhi asaj një vështrim çapkën dhe doli buzagaz.

Lleshi u ul në stolim e vogël te koka e shtratit dhe ndoqi me kureshtje e një farë habie veprimet e Bardhës. Nxori nga xhepi llullën, e mbushi ngadalë me duhan dhe u mat ta ndizte.

— Baca Llesh, të lutem shumë, lëre atë duhan!, — iu kthye Bardha sjellshëm, po rreptë.

— Aaa?!... S'ke ç'i bën, duhet me t'u bindë!, — tha ai, disi i fyer, duke e rrasur çibukun në xhep.

— A ndihesh më lehtë tani?!, — iu kthye vajza Vukës, ndërsa po përfundonte mjekimin.

— Burri s'pyet për kaq!, — u mundua të buzëqeshte Vuka.

— Tani pusho pak e mandej mund të nisesh. Mbas tri ditësh duhet përsëritur mjekimi!, — tha Bardha. — Unë po shkoj të të gjej një palë pantallona te Currajt, këtu afër. S'ke si del me këto zhele!

— Ç'gjuhëbrisk kjo Bardha e Mirash Palit!, — tha Lleshi, sapo ajo mbylli derën pas vetes.

— Duarshkathët, veç!, — ia priti Vuka.

— Po, po... Veç qysh kur është kthyer nga shkolla, ngjan më tepër si qytetare, sesa si cucë malësie.

— Helbete, mësojnë njerëzit!... Ta ka marrë mendja ndonjëherë se cuca si Bardha do të na i mjekojnë plagët kaq mirë?!

— S'e pata aty fjalën!, — tha Lleshi. — S'e vure re si u panë me Lulashin qëparë?!

— Unë s'pata atë hall, o Llesh!, — buzëqeshi Vuka.

— Ah, po, po!... Unë i pashë, veç, dhe jo vetëm një herë. Cucave të fejuara s'u kanë hije këto punë! — Lleshi tundi kokën i pakënaqur.

7

Si përditë, Bardha doli nga shtëpia dhe u nis për në punë pa rënë dielli. Ishte e veshur me një fund të gjerë

fanellate ngjyrë gështenjë dhe me një triko të leshtë, të bardhë. Në dorë mbante një rrjetë plastike, prej së cilës dilte gryka e një shisheje.

Këmbët e saj sa i çiknin gurët e shtegut të njohur e ajo zbriste mëteposhtë e lehtë, pupël. Ndiente një ngazëllim të thellë.

— La mbrapa shtëpitë prej guri të fshatit, që dukeshin aty në shpatin e malit si copa të rrëzuara prej kreshtës së tij shkëmbore. Kaloi një arë me misër dhe doli në një livadh të blertë, të qëndisur me lule të bardha. Që aty dukej lugina, nëpër të cilën vozitnin shtëllunga mjegulle bardhoshe. Aty-këtu mes mjegullës shquhej Përroi i Kuq, si një brez gjarpërues, i argjendtë.

Përtej livadhit shtegu hynte në një pyll bredhi. Bardha, në ecje e sipër, zgjati dorën, këputi një degëz, ndrydhi halat në mes të gishtave dhe u mori erë me kënaqësi. Pastaj ia nisi lehtë e lehtë një kënge malësore.

— Të këndoftë zemra, moj cucë! — dëgjoi zërin e Lulashit.

Ajo ktheu e habitur kokën dhe e pa atë që doli nga mesi i bredhave.

— Po ti këtu, Lulash?!

— Për në punë!, — ia priti ai, duke ecur në krah të saj, megjithëse degët e bredhave i fshikullonin fytyrën.

— S'e kam ditur se ky shteg të çon edhe në sektorin e shfrytëzimit!, — e thumboi ajo buzagaz.

— Mali ka shumë shtigje dhe mund të zgjedhësh atë që të pëlqen më fort!, — ia priti ai me çapkenllëk. — Ç'ke në atë rrjetë?

— Bukën e drekës dhe një shishe dhallë!, — tha ajo, gjoja indiferente. — Ne s'kemi mensë.

— A po m'i jep disa hurba dhallë?, — iu lut ai.

— S'është verë, që të të ketë zënë vapa!, — ia priti ajo.

— Kaq dorështrënguar qenke?! S'e kam ditur!

Bardha qeshi, qëndroi dhe i zgjati shishen. Ai e mori, piu disa gllënjka me ëndje dhe etje të shtirur, pastaj ia ktheu, duke e vështruar me ngulm në sy. Ajo iu shmang

vështrimit të tij, rراسي shishen në rrjetë dhe nxitoi përpara.

Më tej, te një çelthinë, Lulashi iu mënjanua shtegut dhe diçka mbloodhi nëpër kaçuba. Pastaj vrapoi ta arrinte vajzën.

— Hape dorën, dua të të laj borxhin!, — i tha asaj.

Ja mori dorën e hapur dhe i lëshoi një grusht manaferra të mëdha e të zeza.

— A s'po më lë t'i ha?!, — e qortoi ajo me shaka, sepse ai s'po ia lëshonte dorën.

Lulashi qeshi dhe ia lëshoi.

Ajo i futi manaferrat me pëllëmbë në gojë, ndërsa buzët iu lëngështuan prej tyre. E vështronte Lulashin me ca sy që i shkëlqenin çuditërisht.

— Bardhë!, — i thirri ai, duke iu afruar aq, sa i ndjeu afshin e frymës.

Bardha fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe iku duke qeshur. Ai e arriti dhe e zuri për dorë.

... Atje ku shtegu dilte në një vend të hapur, Bardha e tërhoqi dorën dhe vështroi me druajtje rreth e qark.

— Ke frikë se po e merr vesh Marash Martini dhe po të ndan?!, — e ngacmoi Lulashi, gjoja me shaka, por sytë iu errën.

— Edhe kjo duhet pasur parasysh!, — ia ktheu ajo mendueshëm. — Unë jam ende e fejuara e tij.

— Ç'pret, pra, pse nuk e ndan? — Në zërin e Lulashit ndihej një zemërim i thellë. — Kështu ka rrezik që ndonjë ditë të dalim të pabesë, qoftë karshi atij, qoftë karshi babës tënd, si dhe karshi gjithkujt!

— Ti je vetë malësor, Lulash dhe e di se s'është e lehtë, sidomos me babën që kam unë!, — ia priti Bardha duke psherëtirë.

Ata u ndanë aty ku fillonte shtegu i ri i qendrës shëndetësore. Bardha qëndroi një copë herë te kryqëzimi, duke ndjekur me sy djaloshin, që i ngjitej shpatit kundruall. Ajo ndjeu një si boshllëk. Kur ai s'shihej më, ajo zbriti drejt godinës së re me hapa të ngadaltë e mendueshëm. Kishte mbërritur e pora. Çeli derën kryesore, hyri në dhomën e

ambulancës dhe mbeti një hop në këmbë. Pastaj lëshoi në një cep të tryezës rrjetën. Sakaq i vajtën sytë te shishja e dhallit. E mori, e mbajti një çast në dorë, ia hoqi tapën me kujdes, pastaj e vuri ngadalë në buzë dhe piu një gllënjë, vetëm një gllënjë, ndërsa sytë i shprehnin dashuri të thellë.

U ul pranë tryezës dhe e treti vështrimin jashtë. De-ga e qershisë kuqëloi nga drita e diellit që po lindte, kurse bryma, që kishte mbuluar kopshtin, vezulloi si pluhur i artë. Nga djersa e xhamit u sajua një bulëzë uji, që rrodhi mëteposhtë si një lot.

«I duhet dhënë fund kësaj gjendjeje!, — mendoi. — Do të flas me babën!»

Dera e jashtme krisi dhe u dëgjuan disa hapa të njohur. Pastaj te pragu u shfaq një vajzë e imtë, faqekuqe dhe me hundë të vockël e të kthyer përpjetë.

— Mirëmëngjesi, Bardhë!, — përshëndeti ajo.

— Mirëmëngjesi, Davë!, — Ajo brofi në këmbë, sikur u përmend.

— Takova Lulashin në rrugë! — tha e porsaardhura. — U pe me të?

— Po!

— Hej, kur do të shpëtosh nga kjo ngatërresë, moj motër! — psherëtiu Dava dhe shkoi të merrte bluzën e bardhë.

«S'do ta vonoj këtë punë, jo!», — vendosi me vete Bardha.

8

Megjithëse kishte menduar të pushonte atë të diel, Mirash Pali punoi më shumë se çdo ditë tjetër. Paradite shkoi bashkë me shokët dhe ndihmoi për vjeljen e rrushit të kooperativës, pastaj, si u kthye në shtëpi, hëngri disa kafshata dhe iu përvesh qilizmës në oborr.

Në disa orë kishte bërë një copë të mirë dhe ngutej që deri në të ngrysur ta përfundonte pjesën që kishte ven-

dosur. Punonte me ngulm, duke i mëshuar fort dhe shpejt belit. Ndërsa përmbyste plisat e butë, nuhaste me kënaqësi erën e dheut të freskët dhe mendonte se ajo tokë mund t'i jepte prodhim të mirë, po të arrinte t'i shërbente siç duhej. Bardha, më e madhja e fëmijëve s'qe për atë punë, kurse të tjerët pak mundnin. Më fort punonte Lena, e shoqja.

«Ajo, punë në kooperativë e punë në shtëpi!, mendoi Mirashi. — Më takon ta ndihmoj më fort, sidomos tani që kemi Bardhën për të nxjerrë nuse e na dalin disa halle!»

Pas një copë here ai nguli belin në tokë dhe u mbështet me pëllëmbët kryq mbi bishtin e tij, që të çlodhej një grimë. Sytë i vajtën te shtëpia e re prej guri, që zbardhonte midis pemëve e pjergullave në krye të oborrit dhe iu kujtua ajo kasollja e vjetër e Palajve. Vuri ré fëmijët e shëndetshëm që luanin me klithma gazmore përpara saj dhe i erdhi ndër mend koha kur ai fëmijë, dilte te Qafa e Dhive dhe priste të atin të kthehej nga Shëngjini, ku shkante të fitonte ndonjë lek si hamall.

Lodhja, që i kishte mpirë gjymtyrët, sikur i rrodhi nga trupi në tokë, e ndjeu veten përsëri të fortë dhe rroku me gjallëri bishtin e belit. Sakaq vuri re Bardhën që po vinte drejt tij me një broke në dorë.

— Të solla pak dhallë për të njomur buzët!, — i tha ajo, duke e vështruar me dashuri. — U lodhe sot, bacë!

Mirashi e mori brokën dhe piu me ëndje.

— Bëji hyzmet edhe pak babës, se po të vjen koha të shkosh në shtëpinë tënde!, — i tha pastaj së bijës duke buzëqeshur.

— Unë në shtëpinë time jam!, — vërejti Bardha, befas e pezmatuar.

— Shtëpia e gruas është gjithmonë ajo e të shoqit!, — tha Mirashi, me një farë solemniteti dhe u mat të vazhdonte punën.

— Nuk na ngut gjë, bacë!, — vazhdoi Bardha.

— Kërkon të më bësh qejfin, he, se gjoja të ardhka keq të ikësh nga shtëpia e babës?!, — buzëqeshi ai duke i mëshuar belit.

— Jo, ta them me gjithë zemër!, — ia priti ajo.
— Thua kam menduar keq për ty?!, — u vrenjt Mirashi, duke ndërprerë punën. — Të fejuarit tënd s'i gjendet lehtë çifti në këto anë!

— Mundet, por unë s'e njoh!, — tha Bardha prerë, por me ngut, sikur druhej se mos i shterrte guximi.

— Ç'farë?!, — iu çor i habitur ai, ndërsa bishti i belit i shpëtoi nga dora. E vështroi një copë herë rreptë e me qortim të bijën, pastaj u përkul, e kapi veglën dhe e mbajti pezull, sikur i kërcënohej me të. — Shiko, cucë, mos të dëgjoj më prej gojës sate të tilla marrëzira!

— Babë, — nguli këmbë e bija, por ai e vështroi aq egër, sa asaj i mbeti fjala në gojë.

Mirashi vazhdoi qilizmën, megjithëse i kishte ikur sakaq vlaga e punës. «Unë po rropatem për të mirën e saj kurse kjo hedh vicka!, — mendonte me zemërim. — Mos vallë ia ka prishur mendjen ndokush andej nga qyteti?!... Ec e besoj femrave, mandej!...»

Bardha kishte mbetur përballë tij si ndonjë shtatore dhe e vështronte si me frikë, me ca sy të zmadhuar nga brenga e shqetësimi.

Ndërmjet atyre të dyve zgjatej kufiri që ndante tokën e punuar nga ajo e papunuar.

Vetëm kur i ati nguli belin bash përpara këmbëve të saj, sikur deshi ta shkulte me gjithë rrënjë, ajo u kthye dhe iku, në fillim duke i hequr zvarrë hapat, pastaj gjithmonë e më shpejt.

Sapo kaloi portën e shtëpisë, u ndesh ballë për ballë me të ëmën, Lenin dhe sa s'u shkreh në vaj.

— Ç'ke, moj bijë?!, — u shqetësua e ëma.

— Ç'të mos kem, moj loke?!, — shpërtheu Bardha. — S'po më bëhet kush krah në këtë shtëpi, që të më shpëtojë nga çarku që vetë më ngritët!... Ah, kur s'e kam makar një vëlla të rritur, ndoshta ai...

— Lokja ta kupton zemrën, moj bijë, e ndoshta do të të ndihmojë disi, me aq sa shkon fjala e gruas të Mirash Pali!, — tha e ëma.

Vjollca, veshur me një bluzë të leshtë dhe me xhaketën e Bledarit hedhur supeve, vështronte e shqetësuar dhe e mërzhitur nga dritarja e dhomës së tyre.

Sheshi i sektorit dergjej i qetë në dritën e mekët të buzëmbremjes. Te dera e kuzhinës u duk një hop kuzhinier Vata, i shkurtër e rrumbullak, me kësulë e përparësë të bardhë, por edhe ai u zhduk sakaq.

Vjollcës iu duk sikur muzgu i mbrëmjes po shtrihej dalngadalë edhe në brendësinë e saj dhe u largua nga dritarja me një lëvizje të vrullshme. Orenditë e dhomës iu dukën si disa silueta të çuditshme, pa kuptim. Shkoi dhe çeli dritën. Tani jashtë dukej më errët.

«...Kurse Bledari ende s'po vjen!», — mendoi ajo.

Ndiente të ftohtë. Rrëqethje të lehta, por të bezidisshme i përshkonin valë-valë trupin. Shkoi te soba prej llamarine, çeli deriçkën e saj, pa se brenda kishte vetëm hi dhe u largua, duke e lënë të çelur. Rrëmbeu një libër, u kuspullos pranë tryezës dhe provoi të lexonte po qe e kotë.

Brofi në këmbë dhe filloi të sillej nëpër dhomë. Diku rregullonte një orendi, diku prekte diçka, por vepronte në mënyrë mekanike, me mendjen gjetiu. Sytë i kishte të ftohtë, si prej qelqi.

E ndiente veten bosh, fare bosh. Për një çast gjithçka iu duk ireale, si në një ëndërr. Pastaj boshllëkun filloi t'ia mbushte një mërzi e trishtim i thellë, që i rritej si ortek.

Vështroi indiferente tufën e vizatimeve që dergjeshin mbi tryezë. Iu kujtuan ditët që kishte qenë me Bledarin atje lart, tek punonin sharrëxhinjtë. Në fillim i qe dukur shumë bukur, interesante, por pastaj filloi t'i venitej entuziazmi. Kur kthehej në sektor i dhembnin pulpët nga ngjitjet dhe zbritjet dhe sado që të lahej, i dukej sikur humusi i pyllit i qe futur nën lëkurë dhe rrëshina e pishës vazhdonte t'i ngjiste në gishtërinj. Njerëzit i dukeshin njësorj, vërtet të sjellshëm e të fortë, por disi të ftohtë,

krenarë dhe të ashpër. Vetëm Mrika dhe Vuka... Kurse Bledari, shkonte a s'shkonte ajo me të, kthehej vonë. Gjithmonë gjente ndonjë arsye. E asaj i takonte ta priste, të shumtën e herës vetëm, në këtë kthinë të vogël, të ftohtë, duke vështruar nga dritarja po atë shesh, zakonisht të shkretë, po atë mal, të heshtur e të rëndë, duke dëgjuar po atë gurgullimë të Përroit të Kuq, që nisi t'i acaronte nervat...

Vjollcës iu duk sikur portretet e sharrëxhinjve vështronin tani ftohtë dhe ashpër, me qortim. I lëshoi përmbys mbi tryezë, siç lëshohet diçka që të djeg dorën.

Ndërkaq u fik drita. Katrorja e dritares, nga e zeza që ishte, u bë kaltëroshe, e ndriçuar zbehtë. Vjollca u afërua pranë saj dhe mbështeti ballin në xham. Ftohtësia e tij e rrëqethi. Kur iu mësuan sytë, dalloi konturet e stërnjohura të sheshit. Pas pak atje u shfaq një dritë që iu afërua godinës së fjetores dhe pastaj humbi në të.

Në korridor u dëgjuan hapa. Ishin hapa të njohur, sigurisht të atij. Sakaq u çel dera dhe vërshoi brenda drita e një elektriku dore.

— Mirëmbrema, Vjollcë!, — tha Bledari.

Ajo ktheu nga drita një fytyrë të lodhur, të trishtuar dhe qortuese.

— Qenke mërzitur shumë, më sa duket!, — vërejti si me keqardhje.

— U fik edhe drita!, — tha ajo, sa për të thënë diçka dhe bëri disa hapa hezitues drejt tij.

— Rrëzoi era një shtyllë te Qafa e Keqe!, — sqaroi ai — E ngritën dhe shkuan të takonin çelësin... Por, pse nuk ndeze një qiri?

— S'desha të dilja të kërkoja. Prisja se po vjen nga çasti në çast!, — tha ajo me një ton qortues.

— Kishe qirinj këtu! — Bledari shkoi drejt raftit, zgjati dorën mbi të dhe mori një.

— S'e dija... Si duket ndodhka shpesh kjo?!

— Shpesh jo, por edhe ndodh... Helbete, as dhitë e egra s'kalojnë dot nga kanë kaluar telat elektrikë!

Ai e ndezi qiriun, e vendosi mbi tryezë dhe u ul pranë saj.

— Shkuam me Ndrecën të caktonim një zonë të re shfrytëzimi! — tha. — Kur u kthyem nga pylli, kishte ikur makina e fundit nga vendi i ngarkimit dhe na u desh të ktheheshim në këmbë.

— Se mos është hera e parë!, — u mundua të buzëqeshte ajo.

— Paske ftohtë, më duket?!, — tha ai, duke vërejtur xhaketën mbi supet e saj dhe i mori dorën ndërmjet të tijave, si të donte ta ngrohte.

— Më dhemb pak edhe fyti!, — u ankua ajo duke ulur sytë. — Kështu më ndodh kur ftohet përnjëherësh moti...

Atij i shkuan sytë te dera e çelur e sobës dhe brofi në këmbë.

— Po shkoj të sjell disa dru!, — tha, duke marrë elektrikun e dorës.

— Të lutem, mos u vono, boll ndenja vetëm!, — e porositi me zë lutës.

Sapo u kthye Bledari, me një krah dru nën sqetull, erdhën dritat.

— Shpejt e takuan!, — u habit ai. — E pra, është një copë rrugë e mirë nga shtylla e rrëzuar deri në kabinë!

— Dru pishe?!, — vërejti ajo dhe i fryu qiriut.

— Ne më shumë të tilla djegim... Bëjnë ca tym, po jemi mësuar. Mbajnë erë të mirë kur digjen. Të pëlqen era e pishës?

Ajo buzëqeshi dhe nisi të mblidhte vizatimet e veta nga tryeza. Ai futi një pishë të ndezur mes druve, mbylli deriçkën e sobës dhe u afrua, duke vështruar vizatimet përmbi supin e saj.

— Punove ndopak sot?, — pyeti.

— Diçka!, — iu përgjigj ajo e pakënaqur. — S'po ma mbushin syrin këto që po bëj. Ndoshta i kam dalë për zot një teme tepër të vështirë...

— Nuk mendoj ashtu. Po të vish më shpesh me mua atje lart, shumë hezitime do të të davariten dhe do të bësh një tablo të mirë.

— Ashtu thua?!, — dyshoi ajo. — Sidoqoftë, ndoshta duhet të konsultohem njëherë me pedagogët... A ka ndonjë rrugë Sula për Tiranë këto ditë?, — pyeti pastaj, duke ulur sytë me druajtje.

— Dashke të ikësh?!, — u habit ai dhe i doli përballë, duke u mundur të ndeshte me vështrimin e saj.

Ajo rrudhi supet pa u përgjigjur.

— Mendon se në Tiranë do ta gjesh më lehtë zgjidhjen sesa këtu?!, — vazhdoi Bledari.

— Sidoqoftë, pedagogët tanë janë piktorë me përvojë dhe, përsa i përket kompozimit..

— Unë s'i di mirë këto punë, por s'më mbushet mendja. Ti je ende në fillim të punës!, — tha ai, me një hije dyshimi në fytyrë.

— Të ardhka keq të rrish disa kohë pa mua?!, — foli ajo me një buzëqeshje të sforcuar. — Po qe kështu, mund ta shtyj...

— Jo, jo për këtë, po s'ma merr mendja të jetë kjo arsyeja!, — tha ai.

— S'më besoke, pra?!, — u zemërua ajo. — Atëherë...

— Nuk dua të veprosh kundër dëshirave të tua, cili do goftë shkaku, prandaj të shkosh!, — e ndërpreu ai duke brofur në këmbë. — Më duket se Sula ndodhet në mënsë, po shkoj t'i them!

— Bledar!, — hezitoi ajo, por sakaq ai kishte dalë.

...Ata, qysh kur ishin njohur, s'kishin kaluar ndonjë mbrëmje kaq të zymtë së bashku. Mundoheshin të tregoheshin të sjellshëm ndaj njëri-tjetrit, por ndihej diçka e ftohtë dhe e shtirur në gjithçka.

Vjollca e solli disa herë fjalën rreth konsultimeve, që do të mundohej t'i përfundonte sa më shpejt, por Bledari iu shmang kësaj bisede. Kur erdhi koha e darkës, ajo tha se nuk i hahej prej fytit, prandaj nuk donte të shkonte në mënsë. Atij i erdhi përshtat kjo, se nuk donte ta kuptonin të tjerët shqetësimin e tij. Ai s'ishte i zoti të shtirej.

Shkoi te Staka, bleu bukë dhe dy kavanoza me komposto pjeshke, por edhe ata nuk i përfunduan. Vetëm cigare ai piu shumë, aq sa iu desh të dilte rishtas për paqetë.

Ranë të flinin herët, me arsyetimin se të nesërmen ajo do të udhëtonte. Megjithatë, nuk i zinte gjumi.

Vjollca shikonte dritëzën e kuqe të cigares së Bledarit, dëgjonte qysh vërtitej ai në shtrat dhe ndiente për të parën herë sa e rëndë qenka për dy shokë jete ftohtësia ndër-mjet tyre. Mendonte sa e tmerrshme do të ishte sikur kjo gjendje të vazhdonte me ditë, me muaj, me vite...

Një herë asaj i erdhi të hovte nga shtrati, të shkonte tek ai, t'i tregonte të vërtetën pse desh të ikte, ta shante pse nuk ishte treguar më i vëmendshëm karshi saj, pastaj të zbraste valixhen, që priste mbrapa derës, por që i dukej sikur e mbante mbi kraharor dhe i zinte frymën. S'e kuptonte pse nuk e bënte vërtet këtë, nga frika se ai nuk do të pranonte apo pse i trembej jetës në atë sektor.

«...Është e qartë se u mërzit, prandaj do të ikë!, — mendonte Bledari. — Bile, ndoshta është penduar që kërkoi ta bënte stazhin këtu. Pse, vallë?! Unë e prita dhe u solla me të si me shoqen e jetës. Vërtet, ndonjë përkujdesje të veçantë për të nuk kam treguar, po përse do të duhej diçka e tillë?! A s'do të ishte kjo hipokrizi, gënjeshtëri dhe a s'është më mirë që ajo ta njohë jetën tonë të ardhshme siç do të jetë. Po, edhe vetëm ka mbetur kur s'vinte lart në pyll, edhe më ka pritur, po ç'faj kam unë?! S'jam me pushime, por me punë dhe s'qe fjala për një ditë, dy!... Pastaj, edhe ajo s'ka qenë pa punë... As me kushtet e jetesës s'kemi qenë keq. Shokët s'na kanë lënë gjë mangut, sigurisht, me aq sa ç'mundet në një sektor sharrëxhinjsh. Dihet, këtu nuk është Tiranë!... Ajo erdhi këtu të gjente atë çka s'e kishte në Tiranë, sigurisht edhe për mua. Kjo s'është ndonjë sakrificë. Dikur thoshte se edhe në majë të malit do të ishte e lumtur pranë meje, kurse për dy javë u mërzit!... Po për një jetë të tërë?!...»

Bledarit i dogjën gishtërinjtë nga bishti i cigares dhe nxitoi ta shuante. Pastaj përgjoi frymëmarrjen e saj. Jo, as atë nuk e kishte zënë gjumi. U mat t'i thërriste, por, ç't'i thoshte?!...

Rrezet e diellit ende s'kishin zbritur në sektor kur Sula frenoi te rruga përmbi të dhe i ra gjatë borisë. Nga porta e fjetores dolën sakaq Vjollca dhe Bledari, i cili i mban-te valixhen. Te pragu u bashkua me ta edhe Mrika. Ata ecnin të heshtur nëpër shtegun që dilte te rruga. Kishte diçka të zymtë e të trishtuar në ecjen e këtij grupi.

— Po ikën, teta Vjollca?!, — thirri Bardhoku, duke rendur drejt saj dhe iu hodh në qafë. — Kur do të kthehesh përsëri?

— Pse, do të të marrë malli për mua?, — i dredhoi përgjigjes ajo, duke i përkëdhelur flokët me dhembshuri.

— Po, por më tepër për inxhinier Bledarin!, — ia priti Bardhoku me zë të ulët, që të mos dëgjonte Bledari, i cili vinte pas, bashkë me Mrikën. — Ai do të mërzitet pa ty.

Vjollca u pre në fytyrë dhe uli kokën.

Sapo arriti pranë makinës grupi i vogël, Sula çeli derën dhe u zgjat t'i merrte Bledarit valixhen. Ndryshe nga zakonisht, edhe shoferi s'dukej në qejf atë ditë.

Bledari dhe Vjollca mbetën një çast ballë për ballë. Ajo s'i qëndroi dot vështrimit të tij qortues dhe u kthye shpejt nga Mrika. Sakaq e lëshoi veten dhe sytë iu njo-mën.

— Eh, moj Vjollcë, kujtova se u bëra me motër!, — psherëtiu Mrika duke e përqaftuar.

— Teta Vjollca, merre këtë!, — iu lut pastaj Bardhoku, duke i zgjatur një lule të sajuar me luspa nga boçet e pishave. — Ma ka bërë baca Vukë dhe kam qejf të ta dhuroj ty, që të na kujtosh e të kthehesh sa më shpejt!

Vjollca e mori, e përqafoi me përmallim Bardhokun, pastaj ktheu kokën mënjane, që të fshihte lotët. Ndeshi përsëri sytë e Bledarit.

— Do të mundohem të mbaroj punë sa më parë!, — i tha, me një pamje fajto-reje.

— Kthehu vetëm kur ta ndiesh të arsyeshme dhe të domosdoshme për ty!, — ia priti ai dhe i zgjati dorën, që ta ndihmonte të hipte. — Udhë e mbarë!

— Mos u bën merak, do t'ia çojë nënë Margaritës për bukuri — u mundua të bënte shaka Sula, duke i përshëndetur.

Makina u nis. Bledari luajti disa herë dorën dhe pastaj ajo e pa tek zbriste kokulur drejt sektorit. Ndjeu sikur iu thye diçka përbrenda. Mbështeti ballin në pëllëmbë dhe vështroi rrugën, si një gjarpër vigan, që rrëshqiste nën rrotat e makinës. Përtej saj shtriheshin kreshtat e ashpra e të larta të maleve.

Deri në rrugën nacionale ata nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Ai u mat disa herë t'i fliste, por përmbahej kur e shihte ashtu të tretur në mendime.

— Si dukesh, mos të zuri gjë?, — e pyeti dikur.

— Jo, jo!, — iu përgjigj ajo e zënë në befasi.

— Atëherë, qenke mërzitur që u ndave nga Bledari!... Mua mos më mbaj mëri veç, se s'të mora me pahir!, — bëri shaka ai, por jo me harenë e zakonshme.

Vjollca u mundua të vinte buzën në gaz. Pastaj u nder heshtja përsëri. Rruga vazhdonte me disa kthesa të dendura e të forta. Sula e vërtiste timonin sa në njërin krah në tjetrin dhe shpesh i vinte bllokazhin motorit.

— Uf, shyqyr që mbaruan!, — tha ai, sapo dolën në një rrugë më të drejtë. — Ta kisha në kabinë atë inxhinierin projektues, do t'ia shkelja një herë që, ja t'i vinin mendtë në vend, ja t'i dilnin fare!... Të matej tjetërherë, kur të vinte lapsin në letër!

— Djali i vogël, — pyeti Vjollca, duke treguar një fotografi të vendosur përballë tij, sipër xhamit.

— I madhi dhe i vogli bashkë, — buzëqeshi Sula. — Fëmija i parë pas dhjetë vjet martesë... Por, siç thuhet, më mirë vonë se hiç!... Shtëpia pa fëmijë është si gjella pa kripë, moj nuse. Pastaj gjeta rehat nga ime shoqe. Sa ishim pa të, ngulte këmbë të vinte me mua, s'i rrihej vetëm... Përralla, merret gruaja në Skodë, sikur të ishte autobus i «Albturizmit»! He-he, të qe kështu, s'ia kishin vënë krevatin tek!... Kurse tani, ajo e ka më mirë se unë!

— Pse?!, — u habit Vjollca.

— Sepse, edhe në e marrtë malli, atë e merr për një, kurse mua për dy!

Pas një kthese u duk një makinë me rimorkjo që kishte ndalur buzë rrugës. Shoferi diçka vështronte, i përkulur nën të. Sula mbajti krahun, frenoi dhe zgjati kokën nga dritarja.

— He, Ali Grenxa, ç'të paska gjetur, të paska ngecur thumbi, bre?!, — e pyeti me shaka shoferin tjetër.

— Nafta s'më qarkullon mirë, do të jetë zënë ndonjë tub!, — iu përgjigj ai duke e përshëndetur me dorë. — Ti, o brumbull, mos u pengo, se s'ke ç'më ndihmon. Veç, po pate vend, merrmi ato dy pasagjerët deri në Dushkakuq, se janë arsimitare fshati dhe nxitojnë të arrijnë në orar.

Sula zbriti, çeli derën e kabinës dhe u tha arsimitareve:

— Shoqe, a po vini me në?

Ato u gjallëruan menjëherë dhe nxituan të zbrisnin, duke ulur një turrë me bohçe dhe pako.

— Sa paskeni marrë!, — u habit Sula, duke i ndihmuar.

— Ç't'u bësh nënave!, — u përgjigj arsimitarja e parë, një zeshkane e gjatë. — Rrallë e tek shkojmë në shtëpi dhe na përcjellin me gjithë të mirat!

— Hajt, mirë ardhsh, pra!, — e përshëndeti Sula shoferin dhe pas pak makina gllabëronte përsëri shiritin e murmë të rrugës. Në krahun e djathtë ngrihej pothuaj pingul shpati shkëmbor, kurse në krahun tjetër ndodhej lugina, një luginë humnerë, së cilës nuk i dukej fundi. Përtej xhamave dukej qielli gri, i zyrtë, kërcënues.

— Nga gjuha s'më dukeni vendase!, — iu drejtua Sula arsimitareve.

— Unë jam nga Tirana, kurse kjo, korçare! — u përgjigj arsimitarja e parë. — Arritëm vonë mbrëmë dhe fjetëm në qytezë, te disa shoqe. S'bëhen natën dy orë shtegtim në mal.

— E paskeni larg!, — vërejti Sula.

— Disa nga shoqet tona e kanë edhe më larg!, — theksoi arsimitarja e dytë, e cila dukej më e heshtur.

— Prej sa kohe shërbeni këndeje?, — pyeti Vjollca.

— Prej pesë vjetësh!, — u përgjigj thjesht arsimitar-

ja e parë. — Kurse kjo shoqja ime ka vetëm tre, por ka vendosur të rrijë përgjithmonë... Sivjet u martua me një arsimitar vendas.

— Ama edhe ti!, — u zemërua e dyta. — Si s'pushove një herë?!

— Qofshi të lumtur!, — e uroi Sula.

Jashtë filloi të qëmtonte shi, një shi i imtë, i dendur. Xhamat e parë të makinës u veshën sakaq me pikla dhe Sula vuri në lëvizje fshirëset.

— Sa keq, filloi shiu!, — tha arsimitarja e dytë duke vështruar orën.

— Ndoshta pushon sa të zbrisni ju!, — tha Vjollca.

— S'e kam për vete, po për nxënësit!, — sqaroi arsimitarja. — Është tamam ora kur ata nisen për në shkollë. Do të lagen vocërrakët, se këndeje shtëpitë ndodhen larg njëra-tjetrës.

— Po ju, ku ishit?, — e pyeti Vjollcën arsimitarja e parë.

— Tek im shoq. Është inxhinier pyjesh në Qafë Bredh.

— Aha, te inxhinier Bledari?!

— E njihni?!

— Vetëm në të parë, por kemi dëgjuar shumë për të nga fëmijët e sharrëxhinjve. Me sa duket, ata e duan shumë... Erdhët sa për ta parë?

— Njëherë për njëherë provizorisht!, — u përgjigj Vjollca e ngatërruar dhe fshiu me dorë avullin në xham, duke u shtirur sikur vështronte jashtë.

Shiu vazhdonte.

Bledari, me një pamje të menduar e disi të zymtë, sodiste nga dritarja e dhomës shiun që binte shtruar, duke cikërritur monoton në xhama dhe në llamarinën e çatisë. Pastaj u largua andej dhe ktheu sytë nga dhoma.

Vuri ré mbi tryezë kavanozin me lu'e mali. Ato

... Sidoqof-

shin filluar të vyshkeshin. Me një buzëqeshje të hidhur i preku lehtë me gishta, sikur donte t'i çonte, por, sa i lëshonte, ato vareshin përsëri.

Mendoj të lexonte diçka dhe shkoi drejt komodinës. Sakaq i shkuan sytë te fotografia me kornizë të gdhendur. E hoqi nga vendi dhe e vështroi gjatë. Me të në dorë u ul buzë shtratit dhe kujtoi me nostalgji ditën e parë të njohjes së tij me Vjollcën.

...Ai pushoi së notuari dhe lëshoi këmbët, gjersa ndjeu prekjen e butë të rërës. Uji i arrinte gjer në gjoks. Sipërfaqja e tij përkundej lehtë dhe vezullonte me ngjyra të panumërta, të argjendta, kaltëroshë, të arta, të blerta. Flladi i lehtë ishte i ngarkuar me kundërmimin e veçantë të detit.

Duke ecur ngadalë drejt bregut, ai ndiente me ëndje tek i përvëlonte shpinën dielli i nxehhtë i korrikut dhe tek i lëpihej uji në trup, ndërsa dilte dalngadalë prej tij.

Vështronte atë mori njerëzish me trupa të nxirë që zhyteshin, dilnin sipër, kërcenin përpjetë, luanin me top; vozisnin. Bashkë me llapashitjen e ujit, dëgjonte fragmente bisedash, klithma gazmore, të qeshura. Ndihej pak i lodhur, por ishte një lodhje e këndshme, prehëse, që e bente ta ndiente gjallë çdo muskul të trupit të vet.

Befas e goditi në zverk një top llastiku, që ra sakaq pranë tij, duke lodruar mbi ujë, sikur qeshte për çapkënllëkun që bëri. Ai ktheu kokën dhe pa fytyrën e një vajze, sytë e së cilës vezullonin si stërkalat e ujit.

— Më falni, padashur!, — tha ajo.

— S'ka gjë, ndodhi e zakonshme në det! — Ai ia hodhi topin dhe vazhdoi rrugën. Pas pak ndjeu përsëri një goditje në shpinë. Mbi ujë lodronte i njëjti top.

— Përsëri pa dashje?, — u zemërua ai.

— Si ndryshe?!... Ndodhi e zakonshme në det!

Bashkë me gojën dhe sytë bojë deti, asaj sikur i qeshte edhe hunda pak e rrjepur nga dielli.

— Nga i njëjti top?!

— Nuk kemi tjetër. Me këtë rast ju paralajmërojmë sa të ndodhëni brenda ujërave tona territoriale, ju kër-

cënon i njëjti rrezik. Po bëjmë qitje dhe ndodh që gabojmë në shenjë. Prandaj, të mos kemi keqkuptime!

— Unë s'e besoj të gabo! Sapo kam mbaruar stërvitjen gjashtëmujore!

Ai mori shenjë dhe goditi, por vajza u zhyt krejt dhe topi kaloi përtej, duke kërcyer disa herë mbi ujë. Ajo doli mbi sipërfaqe dhe qeshi me të madhe, ndërsa bulëzat e ujit i vezullonin në vetulla e në qerpikët e gjatë.

— Ja që gabuat!, — tha ajo. — Doni të provoni përsëri, që të lani edhe hakun?

Atij jo vetëm që i kishte kaluar inati, por tani i vinte keq të largohej.

— Jo, falemnderit, nuk jam hakmarrës, sidomos karshi femrave!, — u përgjigj buzagaz.

— Ngaqë keni respekt për to, apo i nënvleftësoni?, — e ngacmoi ajo.

— Preferoj arsyen e parë!... Sidoqoftë, do t'jua provoj aftësitë e mia, në më pranofshi në lojë.

— Unë jam dakord. Bëhemi katër dhe ndahemi në dy skuadra! — Ajo u kthye nga të tjerët dhe thirri: — Entela, Fatmir, a jeni dakord ta pranojmë?

— Po, po, ju të dy e ne të dy!, — u përgjigj Fatmiri.

— Gati, fillojmë?, — thirri Entela.

Dhe ata nisën të luanin me shkathtësinë dhe hovin që u diktonte moshën dhe ajo ditë dehëse plazhi, gjatë së cilës shpërthenin bashkë drita dhe hareja, stërkalat dhe forca, nxehtësia dhe gëzimi...

Dolën nga uji vetëm kur ndien të rrëqethura dhe gjymtyrët të mpira. Kapërcyen gardhin lëvizës të shëtitoreve të buzëdetit dhe u lëshuan me ëndje në rërën përvëluese.

— ...Uh, tani e ndiej lodhjen!, — tha ajo, ndërsa gjoksi vazhdonte t'i hovte dendur dhe piklat e ujit i rridhnin mbi lëkurën ngjyrë bronzi. — Thatë se jeni inxhinier pyjesh?

— Po.

— A është shumë larg stacioni pyjor ku punoni?

— Jo aq sa ç'e kujtojnë ata që s'kanë qenë. Sidoqoftë

të, pyjet janë në malësi... Ju thatë se vazhdoni vitin e fundit në arte, po në ç'degë?

— Në të pikturës.

— Aha, qenkeni piktore!

— Dëshiroj të bëhem... A janë të bukura ato pyjet tuaja?

— Të bukura janë, por ju, si piktore, do t'i vlerësonit më mirë!

— S'kam parë asnjëherë pyje të vërteta, pyje të lasha, ku edhe qielli mezi duket!, — tha ajo, duke picërruar sytë, sikur deshi t'i merrte me mend. — Atje duhet të ketë një larmi të pafundme ngjyrash... E blerta e aheve, jeshilja e mbyllur e bredhave, e kuqja e luleshtrydheve, grija e murme e shkëmbinjve, e bardha e luledeleve, dhe e reve, e kaltra e fortë e qiellit... Dhe të gjitha këto në një atmosferë të pastër transparente...

— Pse nuk vini t'i shikoni atëherë pyjet?, — pyeti Bledari.

— Mezi pres rastin!, — iu përgjigj ajo.

— Po të jetoje mes pyjeve, a do të të pëlqente?, — e pyeti Fatmiri.

— E pse jo?!

— Atëherë, martohu me një inxhinier pyjesh!, — bëri shaka Entela.

Vjollca e vështrroi me qortim.

— Ku e lë nënë Margarita këtë që të shkojë aq larg!, — ia priti nga ana tjetër Fatmiri.

Vjollca mbushi grushtat me rërë dhe u mat që t'u binte atyre të dyve, ndërsa Bledari qeshte me të madhe.

Ndërkohë që afruar pa u vënë re një fotograf. Ai zgjodhi këndin e përshtatshëm, i fotografoi, pastaj u afrua duke buzëqeshur.

— Nuk kërkoj parapagim, se s'më porositët, por ishit aq bukur!, — tha dhe u zgjati numrin...

...Bledari e vendosi me kujdes mbi komodinë kornizën, buzëqeshi me nostalgji, pastaj u çua dhe doli nga dhoma. Përshkoi me hapa të shpejtë sheshin e sektorit, për t'i shpëtuar shiut dhe hyri në mensë.

Ishte koha kur sharrëxhinjtë ktheheshin nga puna dhe tryezat po ziheshin njëra pas tjetrës. Bledari zgjodhi një vend të veçuar, në skaj të banakut e pranë dritares, u lëshua në karrige dhe nisi të ndiqte me sy piklat e shiut. Gjithçka ishte e qullur, gri dhe drita sa vinte pakësohej.

— Inxhinier, po më dukesh i mërzitur sot!, — i foli Vuka, që po vinte drejt tij bashkë me Ndreçën dhe me Lleshin.

— Njeriu s'është gjithmonë njëlloj, baca Vukë!, — ia priti Bledari, duke i ftuar të uleshin.

— Po, po edhe qielli s'është gjithmonë i kthjellët!, — vërejti Vuka buzagaz. Pastaj ktheu kokën nga banaku dhe i bëri disa shenja Stakës.

— Më duket u mërzite për Vjollcën!, — tha Lleshi. — Mos, bre burrë, se dikush tjetër po ua sheh më rëndë sherrin femrave!

— Mos fol ashtu, Llesh, se edhe ty një femër të ka nxjerrë në dritë!, — e qortoi Ndreca.

— Vjollca do të kthehet shpejt!, — tha Vuka.

— Kur ka Tiranën, ç'i duhen bjeshkët asaj, more Vukë?!, — ia priti Lleshi me dyshim. — Ua piu lëngun boll!

— Edhe bjeshkët copë e këtij vendi janë, bre Llesh, e, besa, jo copë e keqe!, — tha Vuka. — Mandej, ajo ka Bledarin këtu, që besoj se i hyn në sy më fort sesa Tirana...

— Urdhëroni rakitë!, — i ndërpreu Staka. Ai i vendosi gotën Bledarit, pastaj Vukës, por ky ia kaloi sakaq Ndreçës.

— Në tavolinë, mbas mikut nderohet mosha!, — u justifikua banakieri.

— Nderon brigadierin e dikurshëm ti, lëri ato!, — tha Lleshi me shaka.

— Po mua, akoma për mik më mbani?!, — buzëqeshi Bledari. — Kujtoja se pas kaq kohe jam bërë i shtëpisë.

— Për punën po, kurse për të tjerat, mik do të ngelesh, sa të qëndrosh në bjeshkët tona!, — ia priti Ndreca.

— Mezet jua sjell Mrika, e kam porositur!, — tha Staka.

— I paske sjellë të mëdha, pale!, — vërejti Bledari, duke marrë në dorë gotën e rakisë.

— Mbrëmja është e gjatë, pastaj ftohtë, shi... Durim shokë, erdha!, — Staka u largua drejt banakut, ku ishin grumbulluar mjaft klientë, që jepnin shenja padurimi.

— Po, ia behu dimri!, — tha Vuka, duke mbërthyer gotën me dorën e tij të madhe. — Vera është e shkurtër këtu, në bjeshkë. Por ne s'i trembemi dimrit, apo jo, inxhiner? As ne të vjetrit, pale ju të rinjtë, që e keni gjithmonë pranverë... Hajde, shëndet!

— Shëndet paçi, — ia ktheu Bledari, duke çuar gotën e vet.

Sytë e tij kishin marrë shkëlqimin dhe gjallërinë e zakonshme.

Nga radioja mbi banak dëgjohej një këngë malësore.

— Stakë, çoje pak, se qenka e bukur!, — i thërriti Ndreca.

Banakieri ia plotësoi dëshirën dhe sakaq kënga buçiti fort.

12

Vjollca zgjati dorën drejt çelësit të radios dhe e mbylli. Pastaj u largua nga bufeja e madhe me rimeso arre, e cila zinte pothuaj njërin faqe të dhomës së bukës dhe shkoi e u ul në kolltuk, me pamje të mërzhitur e të lodhur.

Me t'u bërë qetësi, nga aneksi, hyrjen e të cilit e mbulonte një perde e bukur damasku, u dëgjuan zhurma enësh.

Përballë Vjollcës, në divan, ndodhej i ati, një burrë i thinjur, me pamje të rreptë, i cili po vështronte një nga një vizatimet e saj. I mbante gjatë para syve, i afronte, i largonte, rrudhte vetullat, pastaj i vendoste mbi tryezë.

Kur i përfundoi, ai i mori edhe një herë të gjitha në dorë, i tundi lehtë, sikur i peshonte dhe iu drejtua Vjollcës:

— Këto janë gjithë «korrjet» e tua vajzë?

— Po, baba!, — iu përgjigj ajo si e turpëruar.

— Për to more gjithë këtë rrugë?!, — buzëqeshi ai, ndërsa në zë i ndihej një tallje e lehtë.

— Ama edhe ti, Miço, nuk thua shpyqyr që na u kthye vajza!, — u dëgjua një zë gruaje nga aneksi dhe sakaq që prapa perdes u shfaq nënë Margarita. Ishte trupmadhe, e shëndoshë, e mbajtur mirë dhe me një pamje energjike. Erdhi përballë Miços, me duart të zhyera me miell dhe vazhdoi me një ton qortues: — Nuk shikon ç'shi po bie dhe sa u ftoh moti?!... Ta zinte ndonjë borë andej!

— Shiu bie për të gjithë, edhe për Bledarin me shokë!, — ia ktheu Miçoja, gjithmonë ironik. — Kurse ti, Margaritë, ke hak që gëzohe, se u kthye më shpejt nga ç'ta priste mendja edhe ty!

— Mos u mërzit, moj, bijë, se kështu e ka ky!, — iu kthye e ëma Vjollcës. — Do të të bëjë një byrek mamaja që...

— Si ai që i çove në aksion?, — buzëqeshi Miçoja.

— Më të mirë, se atëherë ma pati fajin miellit!, — tha nënë Margarita që prapa perdes, duke vazhduar punën.

— Të paktën mësoje t'i gatujë vetë, — që t'i zërë dhëmbi diçka edhe Bledarit, kur të kthehet tek ai, se... s'ka nga t'ia mbajë! — Ai u mëshoi fort fjalëve të fundit. — S'ia dërgon dot gjer atje, se është rrugë e largët dhe thartohet pa arritur...

Vjollca, flakë e kuqe në fytyrë, kishte kapur skajin e rripit të fustanit dhe po e përdridhte me nervozizëm. I ati i vendosi mirë e mirë fletët e vizatimeve mbi tryezë, pastaj iu kthye së bijës me një vështrim disi të zbutur.

— Sharrëxhinjtë nuk i njoh, por njoh malësorët! Kam qenë partizan në ato anë. Këta të tutë, — ai tregoi me dorë nga vizatimet, — malësorë s'më ngjajnë... Më tepër si qytetarë të veshur me peliç!

Ajo brofi, i rrëmbeu vizatimet, gati sa s'i zhubrosi në dorë dhe doli me rrëmbim. Me të hyrë në dhomën e saj, sikur ngriu në këmbë. Gjoksi i hovte dendur. Dukej sikur nga çasti në çast do të shpërthente në vaj. Por sytë i mbetën të thatë, iu zmadhuan dhe i pasqyronin një tallaz të

madh të brendshëm. Ajo vështronte si e huaj dhomën e vet.

Drita e abazhurit binte butë mbi shtratin e saj, të mbuluar me një kuvertë ngjyrë ari. Pranë tij qe shtruar një sixhade e vogël që tregonte një luan në shkretëtirë. Në faqet e murit shquanin vizatime dhe piktura të shumta, të vendosura në lartësi dhe pozicione të ndryshme. Ndërmjet tyre dallohej një fotografi e madhe e Vjollcës. Në të ajo qeshte, qeshte e shkujdesur.

Ajri ishte i vakët, i ngopur me erën e rrobave e të orendive, si dhe të parfumit të saj të preferuar. Nga korridori vinte zhurma e lehtë e elektromotorit të frigoriferit. Në xhama cikërinte shiu.

Vjollca u lëshua përmbys mbi shtrat dhe kishte dëshirë të qante, por lotët s'i vinin. S'i shqitëshin nga mendja sytë e Bledarit, ca sy qortues. I dukej sikur sharrëxhinjtë që kishte vizatuar në ato fletë të bardha befas do të dilnin prej tyre, do të fitonin përmasa të natyrshme dhe zë e do ta qortonin reptë. I dukej sikur Mrika e vështronte me keqardhje, kurse Bardhoku i përsëriste pareshtur «Kur do të kthehesh?... Kur do të kthehesh? Kur do të kthehesh?».

13

Vukë Marashi e lidhi mirë trupin në vagonetën e teleferikut, pastaj dha shenjë. Pas pak kavoja tërheqëse u tendos dhe vagoneta me trupin të varur nën të nisi të shkonte më të lartë, nëpër kavon mbajtëse, duke kërkëllitur lehtë.

— Hej, ç'lehtësira që kemi sot!, — u tha Vuka shokëve tek po rrokullisnin trupa drejt luginës. — Dikur, shëndoshë krahët dhe capina!

— Kam dëgjuar se keni transportuar me krahë edhe pilota njëzetmetroshe!, — tha Frroku.

— Posi!, — iu përgjigj Vuka, duke u ulur të dridhte një cigare. — Në vitet e para të Çlirimit. Nevojiteshin për rindërtimin e urave. Ndërmarrja jonë sapo qe ngritur dhe

bësheshim gjithë e gjithë nja njëqind e pesëdhjetë sharrë-xhinj. Që kur zbardhte dita e gjersa errësohej, i mëshonim sharrës e sëpatës, se i duhej vendit shumë druri. Ushqeheshim me bukë misri, qepë e kripë. Natën njëri mban-te zjarrin ndezur dhe na ruante, të tjerët flinin mbi shtroje gjethesh, me shpinë nga flakët. Nën kokë mbanim pushkët, se bjeshkët gëlonin nga bandat e armiqve dhe të diversantëve. Veç, asnjëri s'ankohej. Ishte e para herë që punonim për vete... Një ditë na erdhi një shok i qeverisë. Na tha se për rindërtimin e urave që kishin shkatërruar gjermanët duheshin kaq e aq pilota njëzetmetroshe. «A do të na i çoni?», — pyeti. Ne u menduam gjatë, pastaj i kërkuam disa makara dore, kavo çeliku dhe dy makina me bilik. Shoku i qeverisë nxori shkrepësen nga xhepi, mori disa kunjja dhe na tha buzagaz: «Ja makaratë, ja kavoja, tek i keni edhe makinat me biliko!» Ndërkohë na jepte nga një kunj për çdo kërkesë. «Tani bëni si të bëni dhe na çoni pilotat, — tha pastaj seriozisht. Ndryshe s'ka si rindërtohet ura, s'ka nga t'i sjellë qeveria bukën dhe kripën për popullin». Ne s'e çuam më tej, por i thamë: «Do t'i çojmë pilotat!» Dhe i çuam.

— Si mundët?!, — u çudit Frroku.

— Kur do, gjithçka bën njeriu!... Ja, u bëmë dhjetë burra për çdo pilotë, i lidhëm me litarë dhe, ku s'punonte capina, o burra, me krahë! Na gjakosej supi nga litari, por s'ankohej kush... E për kë rindërtoheshin urat, për kë do të vinin buka e kripa?!...

— He, më ju lumshin krahët!, — uroi Frroku me admirim.

— Makar, a ju paguan mirë?, — pyeti Lleshi.

— Ty të përpiftë Përroi i Zi me gjithë pare!, — iu shkreh Frroku.

— Kemi pak trupa në vijë të teleferikut!, — tha Vuka. — S'na erdhi Mirashi, të bëheshim dy çifte dhe të sillnim disa.

— Eh, i ngrati Mirash, në ç'ngushticë ndodhet, — ia qau hallin Lleshi.

— Ç'i ka ndodhur?, — pyeti Frroku.

— Është në hall të madh!, — ia priti Lleshi, duke vështruar me bisht të syrit Vukën.

— Pse s'na ka treguar? Ndoshta e ndihmojmë, — tha Frroku.

— Jo, jo, nuk kemi si ta ndihmojmë!, — tundi kokën Lleshi.

— Fol, bre burrë!, — e nguti me padurim i riu.

— Thonë se Bardha nuk dashka të martohet me atë që e ka fejuar Mirashi dhe se paska filluar ta luajë bish-tin me traktoristin tonë, Lulashin. Ja ç'hall i madh e ka zënë shokun tonë! Të ndodhte kjo dikur, kishte krisur...

— E këputën qafën përgjithmonë ato kohë, Lleshi!, — tha Vuka.

— Hm!, — kërciti dhëmbët Lleshi, — Duhet gishti i pushkës për të tilla!

— Sot as traktori i Lulashit nuk është i zoti ta tërheqë gishtin e pushkës për këto punë!, — vërejti Frroku. — Meqë paska ndodhur kështu, le ta prishin fejesën e parë!

— Ashtu thua ti, jo more?!, — iu ngërdhesh Lleshi. — Po fjala e dhënë, po turpi?!

— Është më turp të marrësh jetën e vajzës nëpër këmbë, prandaj, në mendoftë se i takon ndonjë turp, i paftë hajrin!

— S'është kaq thjesht, Frok!, — arsyetoi Vuka. — Ti je vetë malësor dhe i di si janë këto punë. Mirashi është shoku ynë dhe do ndihmuar disi, se as ai nuk e ka të lehtë...

Ndërkaq u dëgjua sinjali dhe vagoneta e teleferikut filloi të zbriste bash mëtëposhtë, nëpër kavon që dukej sikur çante më dysh qiellin.

Mirash Pali po përgatiste trastën e udhëtimit, pranë raftit me tel, në kthinën e vatrës së shtëpisë së vet.

Ishte një dhomë e gjerë, me dritare të vogla në të dyja anët e vatrës, prej të cilave hynte drita ende e pakët e

mëngjesit. Në vatër kuqëlonte zjarri i sapondezur. Pranë saj ishin disa shilte, të mbuluara me lëkurë dhensh e disa jastëkë, të mbështetur përgjatë murit. Në njërin brinjë të dhomës dallohej një sënduk i madh, i vjetër, prej dru pa nje të gdhendur. Kundruall, në anën tjetër, ndodhej një tryezë e re, me radion sipër dhe disa karrige pranë. Dyshe-meja ishte prej dërrasash të ngrëna e të nxira nga vitet, kurse tavani krejt i ri. Gjithë pamja e asaj dhome ishte një shartim i së vjetrës me të renë.

Ndërkaq hyri në dhomë Bardha, me xhezven e kafesë në dorë. Nxitoi drejt vatrës, u ul në gjunjë pranë zjarrit dhe vendosi xhezven në prush, pa i ngritur sytë. I ati e ndoqi me vështrim të vëngër dhe pastaj e pyeti:

— Ç'qenë ato fjalë që më tha mbrëmë jot ëmë, ende s'hoqe dorë?!

— Unë t'i kam thënë vetë, babë, por ti s'ma ke vënë veshin!, — iu përgjigj e bija urtë, pa i hequr sytë nga xhezvja.

— E pse të ta vë veshin?, — bubulloi Mirashi: — Të kemi dalë borxhit, të pyetëm kur dhamë fjalën!

— Atëherë unë isha fëmijë!, — buzëqeshi hidhur ajo.
— Sapo pata kryer klasën e gjashtë e në atë moshë...

— Në atë moshë gjyshja jote ka qenë te burri!, — e ndërpreu ai me zemërim.

— Ishin të tjera kohë ato, babë!, — vërejti ajo përsëri urtë, por disi qortuese.

— Njeriu, e sidomos burri, duhet t'i mbahet fjalës së vet në çdo kohë!, — ia preu ai. — Çka nxirret nga goja, s'merret mbrapsht!

— Tek e fundit, po i çoj vetë fjalë Marash Martinit e ndoshta ai, si i ri që është, më kupton drejt e rregullohet kjo punë.....

— Ti je bija ime, e Mirash Pali s'lejon kurrsesi që cucat të kthejnë mbrapsht fjalën e tij!, — bubulloi ai.

— Babë, unë po të them gjithsesi të gjejmë mënyrën qysh ta zgjidhim këtë nyje të mbrapshtë, kurse ti...

— Sikur të ishte vërtet nyje, kisha për të ta shtrën-

guar në fyt me duart e mia, se të çova në qytet për të marrë mend, por më duket se paske lënë dhe ato që kishel,
— thirri Mirashi, duke e përmbajtur me zor veten.

— Babë, s'bën të shkelësh mbi zemrën dhe jetën e sat bije vetëm e vetëm për një fjalë goje!, — nguli këmbë ajo, lutëse dhe qortuese njëherësh.

— Unë fjalën s'e kthej, edhe në u ktheftë kulla me themele përpjetë!, — shpërtheu ai, duke rrahur grushtin mbi raft.

Bardha hoqi xhezven dhe ngriti sytë nga i ati. Mirashi, me vështrim të çakërdisur dhe grushta të shtrënguar, dukej sikur nga çasti në çast do të vërsulej përmbi të.

Ajo u çua me xhezve në dorë, përballoi pa iu dredhur qerpiku vështrimin e tij dhe i tha urtë, po prerë:

— Më vjen keq, babë, por kësaj radhe nuk mund të të bindem! S'mund të veprojmë ndryshe nga ç'më thotë mendja e zemra, se është në lojë jeta ime, jo e tjetërkujt!

— A e di ç'i pret cucat e malësisë kur marrin nëpër këmbë zakonet e të parëve?!, — e kërcënoi ai, ndërsa fjalët i dilnin si të shtëna pushke.

— Ka edhe zakone të mbrapshta!, — tha ajo përsëri urtë.

— S'të takon ty t'i gjykosh, madje askurrkujt!

— Partisë po!, — tha Bardha, duke zbrazur kafënë në filxhan.

Si e vendosi filxhanin në tabaka, ia çoi pranë me dorën në zemër.

Mirashi, që ishte stepur si i goditur nga rrufeja, sa pa filxhanin pranë, i ra me dorë dhe e flaku në dysheme, duke bërtitur:

— Boll ma poqe një kafe të hidhur sot!...

Ai doli me rrëmbim, me hapa të rëndë dhe i kërrusur, sikur mbante mbi shpatulla gjithë kullën e vet të gurtë.

Bardha e ndoqi me sy, me keqardhje e shqetësim dhe psherëtiu.

— ...Pastaj iku si i tërbuar!, — përfundoi së treguari Bardha, ndërsa ecte përbri Lulashit në shtegun e pyllit. — Nuk di ç'qëndrim do të mbajë më tej, por unë jam e vendosur të mos bëj mbrapa... S'ta tregoj dot si kam qenë këto ditë!

— Ke pasur të drejtë!, — tha Lulashi, mendueshëm e i shqetësuar. — I duhet dhënë fund kësaj pune, sa më parë, bile. Me këmbë në të dy brigjet e përroit s'qëndrohet... E di që s'e ke të lehtë, por ti do t'i bësh ballë. Mrika e Frok Gjeloshit ia doli vite më parë, jo më sot!

Ata shtegtonin mes një pylli të dendur dhe legusha kërciste nën këmbët e tyre. Degët e drurëve dhe të shkurreve zgjateshin sipër dhe buzë shtegut, sikur donin t'i fshihnin e t'i mbronin dy të rinjtë.

— Boll u mundova t'ia mbushja mendjen me të urtë!, — tha Bardha. — Këto ditë do t'i çoj vetë lajm Marash Martinit. Por, derisa të kryhet kjo punë, ne s'duhet të takohe mi, Lulash!

— Ke të drejtë!, — miratoi ai.

Ajo mbështeti lehtë kokën në supin e tij, e vështroi me dashuri dhe tha:

— Do të më marrë malli, Lulash!

Ai i hodhi dorën rreth supeve dhe e afroi lehtë nga vetja.

Diku u hapën ngadalë disa degë. Mes tyre u shfaq fytyra e Lleshit, që i vështroi i habitur, pastaj, i ngrysur dhe i zemëruar.

— Eheeej, Bardheee!, — u dëgjua një thirrje femre.

— Është Dava!, — tha ajo, duke u shkëputur prej Lulashit. — Për hatrim tim erdhi. Në paçim gjë të ngutshme, me anën e saj do të merremi vesh.

Ajo i zgjati dorën, duke e vështruar përmallshëm në sy. Ai ia kapri dhe vonoi t'ia lëshonte.

— Do të jem e fortë, Lu'ash, mos ki merak!, — i tha ajo, duke e tërhequr dorën me butësi. — Veç, do më duken shumë të gjata këto ditë!...

Bardha nxitoi nëpër shteg, me hap të shkathët, duke kthyer kokën aty-këtu. Ai priti gjersa ajo humbi nëpër pyll, pastaj u kthye mbrapsht nëpër të njëjtin shteg.

Ndërsa po ecte mendueshëm buzë një përroske, dëgjoi goditjen e mbytur të turnit të sëpatës në metal. Ngri-ti sytë, por s'pa njeri. Aty- këtu dukeshin stiva me dru zjarri, degë voze dhe trupa të sapoprodhuar.

«Mua më presin këta!, — mendoi Lulashi, duke kapër-cyer disa prej tyre, që dergjeshin mu në shteg.

Pak më tej ai ndeshi Lleshin i cili, sapo dëgjoi hapa, brofi i trembur, po, kur pa se ishte Lulashi, rifilloi punën.

Lleshi rrihte një pykë metalike në kokën e një trupi të bukur ahu. Druri kishte marrë të çarë dhe kërciste sikur rënkonte, ndërsa e çara zgjerohej dhe zgjatej. Aty pranë ndodhej edhe një trup tjetër i çarë.

— Po i bëke degë vozash këta farë trupash?!, — i tha Lulashi me keqardhje, duke qëndruar përballë tij.

— S'ka burrë që i nxjerr të paçarë te rruga e trakto-rit!, — iu përgjigj ai, pa e ndërprerë punën. — Ti s'vjen t'i marrësh deri këtu.

— Traktori s'është lepur, bre Llesh, po i kishim nxje-rrë me kavo!, — vërejti Lulashi.

— Punë e gjatë!... Mandej, jemi keq edhe me planin e degëve.

— E thotë vetë emri, ato duhen nxjerrë prej degësh, jo duke prishur trupa!; — vazhdoi Lulashi qortues. — S'e besoj ta dijë Vuka këtë punë!

— Pse u dashka ta dijë?!, — u zemërua Lleshi, duke ndërprerë punën. — Planin e brigadës s'e bën vetëm Vu-ka!

— Po përmend shpesh planin, por më duket se hallin e ke më fort te paret!, — ia përplasi Lulashi.

— Paret i fitoj me djersë, s'e shtrij dorën në hise të tjetërkujt, — tha Lleshi me ironi, duke e vështruar me ca sy tallës e zhbirues.

— Mos u përziej në punët e të tjerëve, Llesh! — u ze-mërua Lulashi, por sakaq e përmbloodhi veten. «Ka dë-

gjuar ndonjë thashetheme, apo mos na ka parë sot?,» — mendoi.

— Besa, ti po përzihesh!, — ia priti Lleshi, me dy kup-time.

— Kjo është punë e të gjithëve!, — tha Lulashi, duke treguar me dorë trupat e çarë, — Të prishësh për hatër të xhepit tënd këta trupa qindvjeçarë...

— Paskë mësuar të flasësh si inxhinier Bledari, hë?!, — ia priti Lleshi me shpoti.

— Pse, vetëm inxhinieri me një grusht pylltarësh u dashka t'i mbrojnë pyjet?!, — vazhdoi djaloshi.

Lleshi i ktheu shpinën me mospërfillje dhe vazhdoi punën.

— Meqë s'po të pëlqekan e s'po të hykan në vesh fjalët e mia, po e shtroj me shokët këtë problem!, — tha Lulashi dhe u largua.

— Shko më padit edhe tek inxhinier Bledari, po deshe, veç do të lodhesh për ta gjetur, se është larg, në Tiranë!, — i thirri Lleshi tërë mllef.

16

Bledarin e zgjoi herët në mëngjes zilja e sahatit. Ai u shtriq, fërkoi sytë me pëllëmbë, pastaj flaku mbulesat dhe brofi në këmbë. Shkoi te dritarja, i çeli të dy karnatet e saj dhe dihati me ëndje ajrin e freskët, pastaj nisi të bënte disa lëvizje energjike të gjymtyrëve.

Para syve të tij shtrihej rruga aq e njohur, së cilës i dinte çdo skutë dhe që i ndillte aq e aq kujtime, qysh nga koha më e largët e fëmijnisë. Çdo ndryshim që kish-te ndodhur në atë rrugë, piketonte një ngjarje në jetën e tij. Ja, apartamenti katërkatësh bojë bizele që ndëntuar në sheshin ku ata luanin me top atë vit që mbaroi shtatëvjeçaren. U pat ardhur keq atëherë... Kurse panjat buzë rrugës qenë mbjellë kur priste t'i dilte e drejta e studimit. Tani po ngrihej një godinë me kontribut vullnetar.

Ajo do t'i kujtojë... Çfarë, ikjen e Vjollcës nga sektori, apo kthimin e saj?...

Bledari u largua nga dritarja, duke buzëqeshur me kujtimet dhe mendimet e veta. E ndiente veten të gjallëruar e të freskët. U la dhe u vesh me nxitim, pastaj hyri në dhomën e bukës, ku e ëma po i bënte gati çantën e udhëtimit.

Ajo ishte një grua e hollë dhe e imtë, me flokë të thijnur, të krehur shtrënguar pas kokës, me sy larushë, të mëdhenj e të ngrohtë.

— Mirëmëngjes, nënë!, — e përshëndeti Bledari, duke i vënë dorën me dhëmbshuri mbi supe. — Do të kesh hequr shumë me ato ndërresa. Qenë shumë të ndotura nga tymi i druve të pishës.

— Ç'do të heqë Vjollca, thuaj, pa unë jam mësuar me të babait tënd të ngratë!, — iu përgjigj ajo buzagaz. — Kur vinte nga shërbimi, i sillte më zi se ti... .

Bledari vuri re se ajo ia kishte bërë gati mëngjesin dhe u ul të hante. Ngjyente bukën në vezët e skuqura dhe kafshonte copa të mëdha, duke i shtyrë me qumësht.

— Ç'po ngutesh kaq shumë, biro, po të shkon në kurrriz ajo që ha!, — e qortoi nëna.

— Do të kaloj pak edhe nga Vjollca!, — iu përgjigj ai.

— Ah, po, harrova fare!, — tha ajo. — Edhe këtë pak kohë që vjen, të duhet ta ndash më dysh. Sa të mbarojë shkollën dhe të bashkoheni, biro! Ndryshe, ç'kuptim ka martesë dhe familja?!... Unë i thosha tim shoqi, — ajo ktheu sytë nga një portret oficeri, varur në murin kundruall, — merrmë me gjithë fëmijë atje ku ke punën! S'do të të kisha lënë, më thoshte, por ja që duhet të bredh sa andej-këtej.

— Ke të drejtë, nënë!, — miratoi Bledari dhe u çua.

— Këtë radhë s'u çmalla fare, sa erdhe, ike!, — tha ajo, me një farë keqardhjeje, duke i dhënë çantën e udhëtimit... . — Edhe ai kështu shkonte e vinte përherë!, — vërejti ajo, — gjersa një ditë s'u kthye më... .

Nënë e bir dolën në korridor. Bledari çeli me kujdes derën e dhomës së gjumit, iu afrua në majë të gishtave

shtratit të vëllait të vogël, e puthi lehtë në faqe dhe doli.

— Nuk pata kohë të pyesja në shkollë për të!, — iu drejtua së ëmës.

— Mos ki merak, pyeta unë pardje, më thanë se shkon mirë!, — tha ajo. — Ti vështro veten, biri i nënës, se për të tjerat...

Ata zbritën shkallët e hyrjes. Ajo qëndroi te pragu i jashtëm, e përqafoi dhe e porositi t'i thoshte Vjollcës që t'i shkonte më shpesh.

Si zakonisht, para se të merrte kthesën e rrugës, Bledari ktheu kokën dhe e përshëndeti edhe një herë t'ëmën, pastaj nxitoi hapat dhe humbi mes kalimtarëve.

Ishte një mëngjes plot dritë. Rrezet e diellit sapo kishin zbritur mbi kurorat e panjave buzë rrugës dhe gjetet e tyre verdhonin gëzueshëm. Disa prej tyre i zvarriste era mbi pllakat e trotuarit. Para bar-bufesë së lagjes që ndaluar kamionçina e furnizimit të tregtisë dhe po shkarkonte simite, byrekë dhe petulla të nxehta.

Ca më tej, Bledari u kryqëzua me klientët që dilnin nga bulmetorja, me shishe qumështi në çanta e në duar. Pastaj i kaloi pranë shpërndarësi i gazetave. Ai ndiente nostalgjinë e ndarjes nga këto pamje kaq familjare, por ishte një nostalgji optimiste.

Arriti përballë godinës ku banonte Vjollca dhe ngriti sytë nga dritarja e saj. E dalloi tek e priste prapa xhamit. Sapo e vuri ré, ajo ia bëri me dorë, u largua dhe pas pak u shfaq te hyrja e apartamentit. Dukej e gëzuar, por, me t'u afruar, gëzimi iu venit.

— Domethënë, po ikën!, — belbëzoi dhe uli kokën. Fjalët e veta iu dukën pa kuptim, banale. Nuk guxonte të ngrinte sytë. Kishte frikë se do të ndeshte vështrimin e tij qortues.

«Po sikur të më pyesë kur do t'i mbaroj konsultimet, ç't'i përgjigjem?, — mendoi. — Apo ka kuptuar gjithçka, prandaj nuk pyet. Të që, do më kishte pyetur mbrëmë. Ndoshta ai më përbuz...»

— Nëna s'të priti dot, shkoi të blejë qumështin dhe

harxhet e mëngjesit!, — tha me ngut, që t'i shpëtonte ankthit.

— Ja tek po kthehet!, — vërejtji Bledari.

Ai e kishte vënë re shqetësimin e saj dhe e kishte kuptuar se nuk shkaktohej vetëm nga nisja e tij.

Vjollca ngriti kokën. Nënë Margarita po vinte drejt tyre me trasta në duar, duke u buzëqeshur së largu.

— Pse kaq me ngut, Bledar?, — tha ajo.

I mblodhi të gjitha trastat në dorën e majtë dhe i zgjati të djathtën.

— Mbas pak niset treni!, — iu përgjigj ai.

— Ehu, trenat shkojnë e vijnë! Të ishe nisur makar me atë të pasditës. Kisha ndërmend të bëja një byrek me mish e me spinaq, siç të pëlqen ty. Apo s'është një miell i bardhë që... ke për të lëpirë gishtërinjtë.

— S'mund të vonohem, kam një punë të ngutshme!, — tha Bledari. Pastaj shtoi në mënyrë therrëse: — Byrek le të hajë Vjollca edhe për mua.

Vjollca ndjeu se po skuqej në fytyrë dhe ktheu kokën në anën tjetër.

— Eh, kjo punë, hajde — ik gjithmonë!, — psherëtiu nënë Margarita, duke u shtirur sikur nuk e vuri re ironinë e tij. — Vallë, kur do të mbarojnë këto kusure për ne?

— Ndoshta asnjëherë, se dhëndrin e keni zgjedhur inxhinier pyjesh!, — buzëqeshi me nënkuptim Bledari.

— Dhëndrin e kemi goxha djalë dhe nuk është e thënë të bredhë gjithmonë pyjeve sepse është inxhinier pyjesh. Edhe i biri i Mihalit zanatin tënd ka, por i dhënë goxha vend, në fakultet. Se mos është më i zoti se ti!

— Kjo u takon të tjerëve ta gjykojnë!, — vërejtji ai.

— Ti mbushe pesë vjet bjeshkëve, mjaft më, e lave borxhin, le të çojnë të tjerë tani!, — vazhdoi nënë Margarita.

— Borxhin s'e lajmë asnjëherë!, — ia priti Bledari. — Pastaj, pse shqetësoheni ju? Vajzën në shtëpi e keni!

Vjollca uli kokën përsëri dhe filloi të shtypte me majën e këpucës një gjethe panje që ishte rrëzuar mbi trotuar.

— Ç'e do që e kemi në shtëpi, kur e shohim si e zhurit malli për ty!, — buzëqeshi nënë Margarita, duke e vësh-truar të bijën me dhembshuri.

— Ju ju do më shumë, rasti i fundit e provoi!, — tha ai.

Vjollca ngriti kokën me rrëmbim dhe u mat të kundërshtonte, por i shterri fjala në buzë dhe uli kokën përsëri.

— Ndoshta do t'i duhet të kthehet përsëri atje, për atë të shkretët diplomë?!, — vazhdoi nënë Margarita, pa ia vënë veshin ironisë së tij.

— Për diplomën është kollaj, se e ndërron temën, po ç't'i bësh Bledarit!, — buzëqeshi ai.

— Nënë, do të vonohemi!, — tha Vjollca me padurim.

— Ka të drejtë!, — miratoi Bledari, duke i zgjatur dorën së vjehrrës. — Mirë mbetshi, pra dhe amanet Vjollcën, mos ma lini të mërzhitet!

Vjollca, flakë e kuqe në fytyrë, u nis përpara. Bledari shkoi pas saj, i kënaqur që ajo ishte prekur.

— Vjollcë, çupë e nënës, mos u vono gjëkund!, — i thirri nga pas e ëma, ndërsa ata po nxitonin në drejtim të stacionit të trenit.

Ca nga ca Vjollca e përmblodhi veten, por brejtja e ndërgjegjes dhe shqetësimi i mbetën. Që një natë më parë, pasi u nda me Bledarin, ajo nuk e ndiente veten mirë. Gjatë takimit ai ishte treguar i sjellshëm dhe i vëmendshëm si gjithmonë, por pas kësaj përzemërsie ajo kishte ndier ftohtësi dhe ironi.

Ndërsa po kalonin pranë pasticërisë «Tirana», ajo ktheu kokën anej dhe tha me nostalgji:

— Bledar, të kujtohen sa çaste të bukura kemi kaluar këtu?

— Si s'më kujtohen!, — ia priti ai.

— Sa gëzoheshim kur e gjenim lirë tavolinën tonë të preferuar!, — vazhdoi ajo. — Nuk ngopeshim duke biseduar me njëri-tjetrin, harronim ku ishim, na ftohej kafeja, na shkrinte akullorja në kupë, harronim orën dhe endërronim për të ardhmen, për kohën kur do të ishim

gjithmonë bashkë dhe nuk do t'u ruheshim syve kureshtarë. Ja, tani jemi bashkë, por...

Asaj iu shterr përsëri fjala në buzë dhe uli sytë. Ndjeu se po i mbusheshin me lotë.

— Të gjitha më kujtohen!, — tha ai me një buzëqeshje të hidhur. — Ti thoshe atëherë se do të ishe e lumtur me mua edhe në majë të malit. Mezi prisje të mbaroje fakultetin që të bridhje ngado, pyjeve, kantiereve, ugareve, të njihje njerëzit, jetën dhe të frymëzohesh për piktura të bukura...

— Kujton se kam hequr dorë nga këto?, — shpërtheu ajo, duke e vështruar me ca sy të zmadhuar, plot shqetësim.

Ai ngriti supet, me dyshim dhe uli kokën. Ndërkohë u dëgjua sirena e trenit. Asaj i ngjau si një paralajmërim. Nxituan hapat të heshtur.

Platforma e stacionit gëlonte nga pasagjerët, një mori njerëzish nxitonin drejt trenit me valixhe, çanta, bohçe dhe fëmijë në duar. Dikush vështronte me shqetësim nga hyrja e stacionit. Disa të tjerë nxitonin të blinin petulla dhe byrekë në qoshkun e njësisë tregtare. Një plakë e imtë po u jepte porositë e fundit atyre që përcillte. Disa të rinj të gëzuar po nxitonin drejt vagonave të parë.

Ngado ndihej ai shqetësimi karakteristik i nisjes. Vetëm konduktorët e trenit prisnin të qeta pranë vagonave të tyre.

Vjollca e shtrëngonte fort për krahu Bledarin dhe ngadalësoi hapat, sikur desh të vononte çastin e ndarjes.

— Ndarja e sotme po m'u dukërka më e vështirë se çdo herë tjetër!, — belbëzoi, me një pamje të trishtuar. — E kam të rëndë të mbetem me mendimin se ndërmjet nesh ka lindur një e çarë.

— Çështja është ta mbyllim pa u thelluar, siç biseduam mbrëmë!, — tha Bledari. — Unë kam besim...

— Qysh ditën e parë të ikjes s'e ndjeva veten mirë, më beso!, — tha Vjollca me një vështrim lutës.

— Megjithatë, akoma je e lëkundur, — ia priti ai.

— S'më besoke, pra?! — Një keqardhje e thellë u pasqyrua në sytë e saj.

— Sepse, po ta kishe kuptuar thellë, — vazhdoi ai — butë, por me qortim, — s'do t'i kishe bërë tërkuzë ato konsultimet.

Sakaq u dëgjua fishkëllima e sirenës së trenit dhe altoparlanti i stacionit lajmëroi nisjen e tij. Bledari i zgjati dorën. Ajo ia shtrëngoi fort dhe s'po ia lëshonte.

— Bledar, unë për ty... — nisi të thoshte e shqetësuar.

— Jo për mua, ky do të ishte një kuptim i cekët, po për veten tënde në radhë të parë! — e ndërpreu ai.

— Bledar, më thuaj të vërtetën, a më do?, — gati sa s'shpërtheu në lotë Vjollca, duke e kapur me dëshpërim për krahu.

— Pse të dua të flas kështu!, — iu përgjigj ai me dhembshuri, e shtrëngoi për pak kohë në gjoks dhe pastaj hipi në tren në çastin e fundit.

U dëgjua edhe një herë sinjali i nisjes, pastaj treni lëvizti nga vendi dhe filloi të largohej, në fillim ngadalë, pastaj gjithmonë e më shpejt. Bledari përshëndeste me dorë nga dritarja.

Vjollca i përgjigjej nga platforma, duke ecur përbrri trenit. Buzëqeshte, por ishte një buzëqeshje e dhimbshme. Megjithatë, sytë e saj ishin plot dashuri dhe në ta pasqyrohej një premtim.

Treni largohej dhe shinat prapa tij zgjateshin e zgjateshin, sikur donin të theksonin ndarjen e tyre. Platforma pothuaj u boshatis, por Vjollca eci deri të fundi i saj, duke përcjellë me sy trenin, e krehur në mendime. Pastaj u kthye me vrull dhe u largua me hap të shpejtë.

Nga pamjet që parakalnin në dritaren e vagonit, inxhinier Bledari, që e bënte shpesh atë udhëtim, e dinte se pas pesë minutash treni do të arrinte në stacionin e

fundit. E kishte bezdi dyndjen e pasagjerëve me plaçka dhe fëmijë gjatë zbritjes, prandaj u çua, mori çantën e zezë sportive nga varësja dhe shkoi drejt daljes.

Përtej xhamit të derës pa të parakalonin grumbuj tullash, hekurishtesh, një tabelë me mbishkrimin «Stacioni i mallrave», pastaj stiva dërrasash.

Treni ngadalësoi ecjen, u dëgjua fishkëllima e sirenës, zhurma karakteristike e frenave, u ndie lëkundja e lehtë e stopimit, pastaj vagonistja çeli derën. Bledari kërcëu në platformë menjëherë pas saj dhe nxitoi drejt derës së stacionit, i shoqëruar nga gumëzhitja në rritje e pasagjerëve që po zbrisnin.

Ora e stacionit tregonte nëntë e tridhjetë e pesë. Bledari pa instinktivisht edhe orën e vet. Po të gjente makinë shpejt, do të arrinte në kohë për mbledhjen, sido që e dinte se do ta prisnin. Te bufeja e stacionit bleu një paketë cigare rezervë dhe preu shkurt, drejt stacionit të mallrave, ku shkarkonin makinat që vinin nga sektorët e pyjeve.

Në atë qytet fryn rëndom erë, por atë ditë frynte më shumë dhe bënte ftohtë. Bledari ngriti jakën e palltos së zezë dhe vështrroi nga qielli. Iu duk sikur retë e murme që po vinin andej nga jugu, po depërtonin edhe në bren-dësinë e tij. Prej kohë nuk e kishte ndier veten aq të shqetësuar.

S'kishte bërë as gjysmën e rrugës, kur e arriti dhe frenoi pranë tij një Skodë. Bledari ndjeu një grimcë kënaqësie kur pa targën e njohur të Sulës.

— Mirdita, inxhinier! Në sektor, apo jo?, — i thirri shoferi duke buzëqeshur.

— Mirdita, Sulë! Në bjeshkë, ku gjetiu?!

— Hip, pra, ç'pret?

Bledari kaloi nga dera tjetër dhe hipi me një shkathësi që tregonte se kishte udhëtuar shpesh me automjete të tilla. Brenda nuk kishte pasagjerë të tjerë. U rregullua në sedilien e parë dhe i zgjati dorën Sulës përmbi kapakun e motorit që i ndante.

— E paske humbur pusullën më duket, mezi e njohe

makinën!, — bëri shaka shoferi, duke futur marshin e parë.
— Kam fjetur pak, m'u desh të çohesha herët sot, pastaj udhëtimi!... — deshi të justifikohet Bledari. — Po ti, si i ke nga shtëpia, djali ç'thotë?

— U rrit, ka filluar të mëndojë për nuse, qerratai!, — qeshi Sula. — Mbrëmë, tek po shikonim një koncert në televizor, ia vuri syrin njëres dhe i tha së ëmës «Këtë do ta marr nuse!», ha-ha-ha!

Bledari vuri buzën në gaz, pastaj treti vështrimin jashtë dhe u krodh në mendime. Deri tek ura e Matit udhëtuuan të heshtur. Sula e vështronte hera-herë me bisht të syrit, habitej me të, por nuk e trazoi. Sapo kaluan urën dhe kthyen përprjetë, s'iu durua më.

— Inxhinier, u bukose fare!, — i thirri. — Apo të vjen keq që u ndave nga Vjollca?... I shkretë!

— Nuk është hera e parë që ndahem, ti e di!, — ia priti Bledari duke buzëqeshur.

— Hajde, mos më trego përralla, se i kam ngjitur para teje ato serpentina!, — bubulloi Sula. — Kurrë ndahesh nga e fejuara, qoftë edhe për të njëqindtën herë, je frenato!

— Po kur ndahesh nga gruaja?, — e ngacmoi Bledari.

— Varet. Ka grua dhe grua, burrë dhe burrë.

— Kjo nuk është përgjigje, por dredhi!

— Në daç të dish, unë, megjithëse kam stazh të gjatë, kur ndahem prej saj jam frenato me të gjitha tamburot, kur kthehem, fluturoj me të pestin!

— Harxhoke shumë ferrota frenash!, — bëri shaka Bledari. — Po jot shoqe?

— Ajo nuk harxhon, se qëndron në vend, por ujë të kripur... bollëk!

— E dashkeni shumë njëri-tjetrin!

— Ta merr mendja, jemi marrë me dashuri të madhe, ti e di!... Sido që ndonjëri shtrembëroi hundët se, helbete, unë shofer, ajo arsimitare... E ke të qartë ç'mendime kanë disa karafila për në, shoferët. Por, kjo Parti ua ndërroon vajin njerëzve, more vëlla!

Makina rigiste serpentina në një peisazh të ashpër

malor buzë një lugine të thellë. Motori gumëzhinte. Era fshikullonte drurët dhe shkurret buzë rrugës. Një gjethe e zvedhur shkoi e u ngjit një çast në xham.

— Erdhi dimri!, — tha Bledari.

— Pastaj bora!, — vazhdoi Sula. — Kanë mall për të në Tiranë, mezi e presin, po këtej... ne e dimë!

Në kthesë ata u shkëmbyen me një makinë të ngarkuar me trupa. Pak më tej me një të dytë. Në serpentinat përballë dukeshin të tjera, shumica të ngarkuara me lëndë druri.

— Duket që po i afrohem qytezës së Sharrës!, — tha Sula, duke ulur shpejtësinë.

— Aha, po trembesh më duket!, — e ngacmoi Bledari.

— Unë s'eci kurrë shpejt, një herë ndodh e keqja!, — ia priti Sula. — Bylmezat ia shkelin, u duket vetja pilotë kur ngjiten në timon dhe harrojnë se makina s'ka krahë... Pastaj, unë kam fëmijë për të rritur, more pëllumb! — Ai tregoi me kokë fotografinë e të birit në xhamin përballë.

— E rrite tashmë, a the se ju kërkoi nuse?!, — buzëqeshi Bledari.

— Eh, sa sytliac e sa bidona qumësht i duhen gjer atë herë!, — psherëtiu Sula.

Përtej një kthese ngriti dorën një burrë me treçerekëshe lëkure, me shenjë të kuqe në krah. Sula mbajti krahun, frenoi dhe çeli derën. Kontrollori u afrua dhe përshëndeti thatë. Kishte një fytyrë të rrumbullakët të kuqe dhe sy të vegjël, të vrenjtur.

— Fletudhëtimin dhe biletën, ju lutem!

Bledari nxori nga xhepi i vogël biletën dhe ia shtoi fletudhëtimin të Sulës. Kontrollori i shqyrtoi me vëmendje dhe më gjatë nga ç'ishte e nevojshme, pastaj ua ktheu, duke mermëritur:

— Në rregull, kaloni!

Përshëndeti me dorë dhe u tërhoq në pritë.

— Ky njeri sikur pezmatohet kur të gjen në rregull!, — tha Sula me mllef, ndërsa Skoda rifilloi udhëtimin.

— Të duket ty, se do kesh inat!, — e ngau Bledari.

— Jo, se unë ndeshem me plot të tillë rrugëve, por ky ha bukë veç. Për gjendjen teknike dhe rregullat e qarkullimit, që kanë të bëjnë me jetën, s'para bëhet merak, letrat dhe biletat i shikon me xham zmadhues. Një shkëlqe e vogël dhe... procesverbal!

— Mos duhet të bëjë lëshimet, që të jetë i mirë?!

— Jo, more vëlla, nuk them ashtu, por gjelja me kri-pë dhe kripa me karar. Ja, dëgjo një rast. Një mbrëmje mora dy arsimitare në Majën e Keqe. S'kisha bileta me vete, po a lihen dy femra në mes të rrugës, natën? Pa mendoje si për motrën, apo për gruan tënde! E hoqi dreqi dhe më doli përpara ky. Si zakonisht: biletat! Ato të ngratat ia treguan si që puna, po hante arsye ky, se! Procesverbal!... Se mos vetëm ai ka ndërgjegje socialiste.

— Gjynah që nuk ka ndonjë matës të ndërgjegjes!, — bëri shaka Bledari. — Atëherë do të mënjanoheshin këto keqkuptime.

...Tani rruga ishte në zbritje, kthesat, të rralla e të hapura, prandaj Sula i kishte futur të pestin dhe po fishkëllente lehtë këngën «*Jeta ndarje ka*», duke vështruar me çapkënllek Bledarin, që përsëri ishte kredhur në mendime.

Në krahun e Bledarit parakalonte një luginë e thellë, gati humnerë, në fundin e së cilës gjanpëronte si shirit metalik lumi. Aty-këtu buzë tij, dukej ndonjë shtëpi e veçuar, si kuti shkrepëse. Në të dy anët e luginës ngriheshin faqe të thepisura shkëmbore të murme, me njolla të rralla gjelbërimi. Shtyllat e tensionit të lartë, të rreshtuara tërthorazi luginës, të kujtonin përbindshat e lashtësisë.

«Si kanë mundur t'i ngjitin këto maja?!» — mendoi Bledari.

— Po, po, *jeta ndarje ka!*, — tha Sula, duke i dhënë fund këngës. — Ndarje, pastaj takime. Edhe kjo ka bukurinë e saj. Nganjëherë i them Katrinës me shaka: më mirë që s'më ke vazhdimisht pranë, se do të të isha mërzhitur dhe s'do më doje kaq shumë. Ajo zemërohet, e ngrata!... Ndryshe është puna jote me Vjollcën, se ju s'keni mbaruar ako-

ma muajin e mjaftit... He, si duket, kur do të vijë përsëri në sektor!?

— Sa të përfundojë konsultimet!, — iu përgjigj Bledari, i zënë ngushtë.

— Do të vijë, shpejt bile, mos u mërzit!, — tha Sula me mirëdashje.

«Edhe ky e paska kuptuar!», — mendoi Bledari.

— Ku do të hamë drekë, në qytezë apo në sektor?, — pyeti Sula.

— Të thashë që kam mbledhje. Do të më presësh?

— Ta merr mendja!

— Në mbarofshim shpejt, më mirë në sektor. Na bën Vata nga një biftek të mirë, marrim edhe një raki të voc-kël te Staka...

— Ishalla s'vonoheni!, — uroi Sula. — Se janë disa që flasin e flasin e po ato thonë, i binte përçark, si autobusët e unazës në Tiranë!

Përtej xhamave u duk karburanti, pastaj godina e vogël e agjencisë.

— Arritëm!, — tha Bledari, duke hovur me kënaqësi në sedilje.

Në të dyja anët parakalonin apartamentet e reja të qytezës. Trotuari gëlonte nga nxënësit që po dilnin nga shkolla.

— Të paktën t'i hedhim serbatorit nga një kafe! — tha Sula, duke mbajtur krahun përballë klubit.

Ata hynë në sallë dhe shkuan drejt banakut, duke u përshëndetur me të njohurit e shumë.

— Dy kafe; për inxhinierin ekspres me pak!, — porosi Sula.

— E di para teje!, — buzëqeshi banakierja.

Ndërsa ata po pinin kafënë, ia behu Ndreca, përgjegjësi i sektorit të shfrytëzimit të pyjeve.

— E more telegramin?, — e pyeti ai Bledarin, pasi u përshëndosh me të.

— Po, prandaj u ktheva pa arritur mirë!, — buzëqeshi Bledari.

— Keq të takoi, ti edhe kështu shkon rrallë në familje!, — u pezmatua Ndreca. — Për besë, s'ta kisha bërë kollaj atë telegram, por s'pata nga t'ia mbaja.

— Si është puna?, — pyeti Bledari.

— Ndërtuesit e hidrocentralit të Fierzës kërkojnë një sasi lëndë druri me dimensione të caktuara, e cila u ka dalë e domosdoshme për shpejtimin e punimeve!, — sqaroi Ndreca. — E shtruar me shokët e sektorit këtë problem dhe sharrëxhinjtë u zotuan ta prodhojnë, megjithëse plani ynë është i ngjeshur edhe pa këtë shtesë. Por, doli se i paskemi bërë llogaritë pa hanxhinë! — buzëqeshi ai, duke ia bërë me kokë nga Bledari. — Drejtori i ndërmarrjes nuk e jep fjalën pa ju pyetur ju të pyjeve dhe përfaqësuesi i Fierzës po pret këtu. Kuptohet, duhen bërë damkime të veçanta për këtë lëndë.

— Meqë është kaq e nevojshme, do ta zgjidhim pa dëmtuar pyllin!, — tha Bledari. — Kemi ruajtur një rezervë për ditë halli.

— Hë, të lumtë goja!, — tha Ndreca, pastaj vështroi i shqetësuar orën.

— Shkojmë!, — tha Bledari, duke i dhënë fund kafesë. — Sulë, mos u mërzit, nuk vonohemi, s'kemi pse e tjerrim gjatë këtë punë!

— Eh, mor vëlla, më mirë shofer, s'ta zënë kafenë në fyt me probleme!, — bëri shaka Sula, ndërsa ata të dy brofën në këmbë.

Ishte një ditë e vakët nëntori. S'frynte aspak erë dhe drurët e pyllit dukeshin si të ngurtësuar. Rrallë e tek shkoqej së larti ndonjë gjethe e zverdhur, që vinte e binte me përtim pranë morisë së shoqeve. Prej tyre dukej sikur toka e pyllit kishte zënë ndryshk.

Vukë Marashi po qëronte degët e një druri të saporëzuar, por mendjen e kishte gjetiu. Ai jetonte akoma me

kujtimet e vizitës që i kishte bërë familjes së të bijës, nga ku ishte kthyer atë mëngjes. Jeta e kishte sjellë që Vuka s'kishte askënd përveç asaj dhe nipave, të cilët i donte fort, si çdo gjysh. Çdo dy-tri javë shkonte për vizitë tek ata, që e prisnin krahëhapur. Te kulla e vet shkonte rrallë, sa për t'i bërë ndonjë meremetim e sa për t'u kujdesur që të mos egërsoheshin pemët e oborrit dhe të mos zinte bar shtegu.

— Edhe pak drurë të damkosur na kanë mbetur!, — tha Frroku, që po punonte bashkë me Vukën.

— Na u sëmur edhe inxhinieri!, — vërejt i Vuka, duke u shkëputur nga mendimet.

— E si të mos sëmurej!, — ndërhyri Lleshi, që erdhi të grumbullonte mbeturinat. — S'na e vuri veshin, damkosi gjithë ditën nëpër shi!

— Për hatër të punës e bëri!, tha Frroku.

— Po, po, veç ja puna tani!

— Nuk po më pëlqejnë ato ré!, — vërejt i Vuka, duke treguar me gisht nga çeltina që kishte lënë druri i rrëzuar.

— Rrezik të prishet moti.

— Veç të mos e kthejë në dëborë!, — u shqetësua Frroku. — Makar të përfundonim lëndën e Fierzës.

— Ishalla jo!, — tha Lleshi. — Kam gjithë ato halle andej nga kulla.

— Si s'mbaruan një herë ato hallet e tua, thua se ajo kulla jote është kështjellë!, — tha Frroku me inat.

— Ke hak ti, se ka tjetër zot ajo shtëpia jote!, — bulloj Lleshi.

— S'po na vjen Lulashi, të afronim në skelën e ngarkimit këto që kemi prodhuar!, — tha Vuka.

— Ka ditën e shërbimit sot!, — sqaroi Frroku.

— Ndoshta e ka kryer. Llesh, a po shkon të pyesësh një herë?

— Posi! — Ai lëshoi degët në stivën e mbeturinave dhe u nis mëteposhtë, duke trazuar legëshën me opingat e veta të mëdha.

«Sa gabim bëra që nuk i afrova me kohë ato gjethe për bagëtinë!, — mendontë. — Ishalla ka mbaruar diçka Lezja, megjithëse zor t'i ketë dalë koha!»

Pas një copë rruge e dalloj traktorin që kuqëlonte buzë variantit pyjor. Lulashi jepte e merrte me disa vegla të hallakatura mbi llamarinën e kofnës.

«Aha, s'kemi gjë, e paska ende me zorrë jashtë!», — tha Lleshi me vete, por vendosi të mos kthehej pa e pyetur një herë.

Lulashi iu përgjigj përsëritjes së tij pa e ndërpreur punën. Dukej mjaft i lodhur e bile i shqetësuar.

— S'po të shkoka mbarë, ë?, — pyeti Lleshi.

— Dua t'i provoj hidraulikun, se nuk i dihet motit!, — iu përgjigj Lulashi. — Tubat e manikotave i kam qysh të vitit të kaluar dhe s'di a do të mbajnë.

— Domethënë, s'bëhet për sot?

— Nuk e besoj.

— Por pesëmbëdhjetëditëshi sot mbyllet!, — vërejti Lleshi, zymtë.

— S'do t'u kenë mbetur shumë, para tri ditësh isha në brigadën tuaj!

— Pak, shumë, duhen transportuar. Ku e lë Vuka lëndën e hidrocentralit në pyll! Me siguri që do të vendoset t'i transportojmë me krahë, po s'erdhe ti.

— Edhe ashtu mund ta bëni, s'është gjë e madhe!, — ia priti Lulashi, disi i bezdisur.

— Normën e kemi me traktor, se!, — kërceu Lleshi.

— Paret se paret!, — buzëqeshi Lulashi, duke shtrënguar një dado.

— Meqë s'pyetke për parë, na e paguan ti dëmin, pra?, — u acarua Lleshi.

— Ç'borxh ju kam? Edhe unë me normë jam e, kur s'punon ky... — Ai tregoi me kokë traktorin.

— Eh, more trim, ai s'ndreqet vetiu!, — e ndërpreu Lleshi me shpoti.

— Kam qysh kur doli drita që po lodhem me të, shpirt s'i jap dot!, — ia ktheu Lulashi, duke u munduar ta përmbante zemërimin.

— Ndoshta, po kur s'i ke mendtë në të!..., — vazhdoi Lleshi me po atë ton.

— Ç'do të thuash?!, — shpërtheu Lulashi, duke flakur

çelësin nga dora dhe iu afrua kërcënues. — S'është e para herë që më lëshon kësi thumbash, më mirë bjeri drejt, si burrat!

— Ti s'je budallë dhe më kupton fort mirë!, — e përballoi Lleshi, pa luajtur nga vendi.

— Mos u merr me thashetheme, se s'të del mirë, ore Llesh Gjoni!, — gati sa s'ulëriu Lulashi dhe u mat ta mbërthente për jake, por u përmbajt sakaq.

— Thashethemeve s'u besoj, por syve të mi, po!, — tha Lleshi shkoqur, me një buzëqeshje idhnake. — Veç, ki mendjen, lum trimi, se faqen e zezë s'e duron kush!, — pastaj u kthye në vend dhe u nis përpjetë pa përshëndetur.

«Mos më ndodhtë si Mirashit, se, për besë...», — mendonte Lleshi, duke vluar përbrenda nga zemërimi dhe i ngjitej shpatit më shpejt se zakonisht, sikur deshi t'i ikte diçkaje të ligë.

— E, si duket puna?, — e pyeti Vuka.

— Nuk vjen!, — ia priti Lleshi thatë.

— Kapni capinat, atëherë!

— Me krahë se me krahë!, — murmuriti Lleshi. — Të mbrapshtit s'ia sheh kush hajrin.

— Pse po mërzitesh, Llesh?!, — e ngacmoi Frroku.

Apo s'të punon capina, se ke ditë pa ia mprehur majën të kovaçi?!

— Ore mec, si shumë po më bie në qafë!, — u zemërua Lleshi.

— Boll, se fjalët s'i luajnë trupat prej vendit!, — i qortoi Vuka, duke ia ngulur capinën trupit më të afërt.

— Po Mirashi ku na humbi, vallë?

— Po punon vetëm në skajin e parcelës!, — u përgjigj Lleshi. — Sa s'po i pikon shpirti prej hundësh, të ngratit! S'ka faj, hall i madh është...

Ishte buzëmbremje, koha kur kthehen zakonisht sharrëxhinjtë nga puna. Ata zbrisnin vargan nëpër shtegun

që të çonte në sektor, duke biseduar e duke bërë shaka me njëri-tjetrin.

Shpati ku dredhonte shtegu ishte pothuaj i zhveshur, zhurishtë, me shkurre të rralla boshtrë e dëllinje, por anash dhe karshi ngriheshin pishnaja të moçme. Në kulme dhe brinjë pishat e mëdha dukeshin, në sfondin e plumbtë të qiellit me rë, si çadra gjigante. Poshtë, aty ku përroi që shkumëzonte rrëzë shpatit bënte bërryl dhe lugina zgjerohej pak, dukeshin si në maket barakat e sektorit.

— Punove vetëm sot, Mirash!, — iu drejtua Vuka shokut përbri.

— Thashë t'i kryeja ato shtyllat e minierës që na nge-lën dje!, — ia priti ai disi indiferent.

— I kishim kryer bashkë!, — ndërhyri Frroku.

— Nuk e pata me hile!, — u vrenjt Mirashi. — Nesër këni për ta parë sa kam punuar.

— As që e mendon kush këtë!, — i tha Vuka me qortim. — Por, na erdhi keq që punove vetëm.

— Nganjëherë duhet kuvenduar edhe me veten!, — tha Mirashi.

— Sa më shumë shokë të jenë në kuvend, aq më i frytshëm është ai e aq më të urta janë përfundimet e tij!, vërejti Vuka.

— Nuk shtrohet gjithçka në kuvend shokësh!, — ia ktheu Mirashi, me një ton që tregonte se s'i pëlqente ajo sedë.

Në fundin e shpatinës ata dalluan dikë që i priste.

— Më duket se është Ndreca!, — tha Lleshi, duke përrruar sytë në atë anë.

Ndreca ishte. Ai u përshëndosh me të gjithë dhe vazhdoi rrugën bashkë me ta.

— Sot shëtita mjaft skele ku zbresin prodhimet brigadat, te ju s'arrita dot, — iu drejtua ai Vukës. — Por, besoj se...

— Planin me diçka përtelj!, — ia priti Vuka me krenari. — Megjithëse sot na u desh të transportonim me krahë.

— Nuk e përfundoi traktorin Lulashi?!, — u shqetësua Ndreca.

— Ende jo. I nxorën punë tubat e manikotave të hidraulikut. E lamë duke punuar, bashkë me ndihmësin.

Ndërsa po i afroreshin sektorit, barakat po rriteshin në sytë e tyre, gjersa arritën përmasat e vërteta. Sheshi mes tyre dukej i shkretë, por u gjallërua me të arritur ata. Në godinën e madhe të fjetores nisën sakaq të llamburitnin dritaret. Disa shkuan drejt e në mensë. Ndër ta ishin Ndreca, Vuka dhe shokët e tij të brigadës.

Me të hyrë në sallën e gjatë, me tryeza të shtruara gati për shërbim, i mbështolli një afsh i vakët, i ngarkuar me kundërmime gjellësh dhe me erë pishe të djegur. Në mes të sallës bubullonte zjarri në një fuçi-sobë. Nga deriçka e saj dilte një fjollë tymi i zi. Mrika po sistemonte drutë pranë saj. Staka u gjallërua sa pa sharrëxhinjtë dhe nisi të vërtitej pas banakut, sikur bënte nxehjen, që t'u shërbente atyre sa më shpejt.

Vuka shkoi e zuri yend pranë sobës, duke i kthyer asaj shpinën. Pelicja e lagur filloi të lëshonte avull. Ca nga ca u afruan edhe të tjerë. Dikush ndërte nga soba duart, dikush këmbët, një tjetër afronte kutinë e duhanit për ta tharë.

— Hej, ç'po thahemi si caragat!, — bëri shaka Vuka. — Stakë, a po ma mbush një gotë? Na bezditi ajo veza sot, më duket sikur më janë lagur edhe eshtrat prej saj.

— Sa t'i çoj supën inxhinier Bledarit!, — ia priti Staka, duke nxituar drejt sportelit të kuzhinës.

— Hej, ç'gjellë që ka dalë prej asaj pulës që solle nga jot bijë, Vukë, të lëpish gishtat!, — foli kuzhinier Vata, duke nxjerrë në sportel pjatën dhe pas saj, kokën e vet rrumbullake.

— I paske futur gishtat në të, si duket!, — qeshi Vuka.

— Sa për ta provuar për kripë!, — ia ktheu Vata me shaka. — Veç, këmbët i ka të dyja... Merre, Stakë, kjo deri nesër e çon Bledarin në këmbë!

— Të lumtë goja, unë për atë e solla!, — tha Vuka.

Staka doli me tabaka në dorë, duke mbyllur me kujdes derën pas vetes.

— A u kënaqe me nipat, Vukë?, — e pyeti Ndreca.

— Boll, besa!, — buzëqeshi ai përmallshëm. — Gjynah që i kam larg e s'mund të shkoj më shpesh... Eh, more shokë, kur ngela vetëm me atë cucë, kujtova se ngela fillikat në këtë botë. Bijat janë për njerëzit e burrit, mendoja, por s'paskësh qenë ashtu. Shikoni ç'nipa kam! — Ai nxori nga xhepi një fotografi dhe ua zgjati shokëve, me krenari prej gjyshi. — Si tre diva! Ai i dyti më ka dhënë fjalën se, si të kryejë ushtrinë, do të vijë te kulla ime dhe Vuka do të bëhet përsëri me familje. Deri atëherë, ja tek e kam familjen! Ai zgjati krahët drejt shokëve, sikur deshë të përqafohte me ta gjithë sallën.

Frroku në një skaj po provonte t'i binte çiftelisë, po tingujt dilnin të ashpër, të ngathët dhe me vështirësi bashkoheshin në melodi.

— Boll, se na gërmove veshët!, — iu kthye Lleshi.

— Jepja më mirë Vukës, ai ia di!, — tha një sharrëxhi.

— Merre, baca Vukë!, — iu drejtua Frroku duke buzëqeshur.

Ai flaku në sobë bishtin e cigares së dredhur dhe e mori. Çiftelia dukej si lodër në duart e tij të mëdha. Gish-tërinjtë e gjatë u dergjën një çast mbi tela, pastaj filluan të lëviznin, të rendnin mbi ta.

Si orteku, që duke zbritur mëtëposhtë shpatit mbledh borën, ajo melodi, e zbritur nga lashtësia, kishte mbledhur ndjenjat dhe mendimet e malësorëve. Sharrëxhinjtë dëgjonin si të magjepsur dhe dukeshin si një galeri shtatorësh. Vetëm tymi që çohet nga llullat e cigaret e tyre dhe shkëlqimi i ngrohtë i syve, tregonin se s'qenë të tillë. Ata dëgjonin, dhe ndjenjat e mendimet e tyre dridheshin bashkë me telat e çiftelisë së Vukës.

— E ktheu në dëborë!, — tha Staka duke hyrë.

Çiftelia heshti përnjëherësh. Sharrëxhinjtë kthyen sytë nga dritaret, të shqetësuar, por ishte bërë natë dhe

s'dallohej gjë. Ndreca nxitoi te dera, vështroi një hop, pastaj u kthye.

— Pak bie, por ka rrezik të shtohet!, — tha i zymtë. — Kujt ia priste mendja se do të fillonte kaq herët!

— Në malësi s'është kurrë herët a vonë për borën!, — vërejti Vuka.

— S'dimë ç'bëri Lulashi me traktorin!, — tha Ndreca me shenja padurimi.

— Meqë u vonua, ndoshta e rregullon!, — arsyetoi Frroku.

— Ej, posi!, — tundi kokën Lleshi.

Disa kthyen kokën dhe e vështruan me inat. Zhurma e mensës ishte fashitur. Sharrëxhinjtë hanin të heshtur ose qëndronin me fytyrë të tendosura rreth sobës. Dëgjohesh bubullitja e zjarrit dhe tingëllima e enëve të palara që po mblidhte Mrika me Bardhokun.

Pas një copë here dera e mensës u çel me vrull dhe në prag të saj u shfaq dikush, me shall të lidhur në kokë dhe i zbardhur nga bora.

— Lulash?!, — brofi Ndreca.

Ai iu afrua zjarrit me pamje të dëshpëruar.

— Tubi i manikotës u ça!, — tha, duke kafshuar buzën e poshtme.

Të tjerët, në heshtje, i bënë vend pranë zjarrit. Atij i rridhnin pikla uji prej borës së porsashkrirë. Fytyrën e kishte të kuqe dhe duart mezi i bindeshin.

— Ka zënë shumë atje lart?, — pyeti Vuka.

— Nja pesë gisht, po vazhdon të bjerë.

— Si na gjeti në këtë hall!, — ziente Ndreca, duke kthyer gishtërinjtë me shqetësim. — Bash tash, që kemi edhe detyrën e hidrocentralit. Lihet Fierza?!

— Nesër, pa dalë drita, nisem vetë për në qytezë, megjithëse i kam lajmëruar ata të ndërmarrjes për tuba të rinj!, — tha Lulashi.

— E gjersa të kthehesh?!, — u hodh Lleshi.

— Se mos kemi lindur shpinë për shpinë me traktorin!, — turfulloi Vuka. — Me krahë!

Për disa çaste u nder heshtja. Vuka shëtiti vështrimin

nëpër sallë, me një shkujdesje të shtirur. Dalloi Mrikën dhe të birin, që po e ndihmonte.

— Bardhok!, — ia bëri me dorë djalit.

Ai erdhi me nxitim dhe qëndroi përballë tij.

— Ai i ke përgatitur mësimet?

— Po, baca Vukë!

— Ty të lumtë! Tani rri e ngrohu këtu. Ej, ju të rinjtë, Frrok, Sali, çohuni dhe ndihmojeni Mrikën. As ujqit s'lënë kaq mbeturina, s'do të na i pastrojë veç Mrika!

Ata të dy iu bindën. Vuka e uli pranë vetes Bardhokun dhe i përkëdheli flokët me dhembshuri.

— Kemi qëlluar edhe më ngushtë e ia kemi dalë!, — tha pastaj me bindje. — Mandej, jo çdo borë që bie e mbush!

Sharrëxhinjtë zunë të dilnin një nga një dhe tryezat po boshatiseshin. Edhe grumbulli rreth sobës po rrallohej. Staka s'kishte më kërkesa dhe merrej me përgatitjet e banakut për të nesërmen. Mrika çonte te sporteli i kuzhinës stivat e fundit me enë të palara.

Mirash Pali qëndronte i vetmuar në një tryezë të skajit, me një gotë raki përpara. S'kishte futur gjë në gojë atë darkë, veç llullën e vjetër prej bushi s'e kishte lënë të shuhej. Ballin e kishte më të rrudhur se zakonisht dhe vetullat e trasha e të rrëzuara thujse ia fshihnin sytë. Dikur ai gëlltiti me një gllënjë ç'i kishte mbetur në gotë, brofi në këmbë dhe doli rëndë-rëndë, pa përshëndetur njeri.

Lleshi, që e kishte vënë rë me kohë, e përcolli me sy dhe tundi kokën me keqardhje. Një herë u mat të shkonte pas tij, por ndërroi mendje. Vendosi të priste rastin që t'i kërkonte lejë Ndrecës për të nesërmen. Qëndronte si në pritë pranë sobës dhe ndiqte me sy hyrje-daljet e përgjegjësit, të cilin s'po e zinte vendi.

«Më lehtë zihet gjeli i egër në ahishtë, se Ndreca son-te!, — i dha karar më në fund Lleshi dhe vendosi ta linte për të nesërmen atë punë. — Ditë e re, nafakë e re!»

U çua ngadalë, duke fërkuar mesin me dorë, murmuriti një përshëndetje dhe doli. Sa kaloi pragun, ndjeu në fytyrë prekjen e ftohtë të flokëve të borës. Ajo binte e rra-

llë, e imtë, duke sajuar një tis të hollë e të ndritshëm përpara dritareve të ndriçuara të fjetores.

Mirashin e gjeti të gërmuqur pranë sobës, duke u munduar të ndizte zjarrin. Dukej që e bënte atë punë sa për t'u marrë me diçka. Nga sytë kuptohej se gjetiu e kishte mendjen.

Lleshi shkoi te shtrati i vet, u shtrua këmbëkryq mbi të dhe nisi të mbushte llullën, duke vështruar me keqardhje shokun. Një herë u mat t'i fliste, por u pendua sa çeli gojën dhe fjala doli gjysmake, si e një memeci.

— Diç u mate të më thuash, o Llesh!, — iu kthye dyshues Mirashi, që e kishte ndjekur me bisht të syrit.

— Jo, jo, s'pata gjë!, — murmuriti Lleshi, duke ulur sytë dhe psherëtiu thellë.

— Më duket se diçka po më fsheh!, — nguli këmbë Mirashi, duke u çuar në këmbë, me një vështrim të ashpër e lutës bashkë. — Fol, pra!, — bubulloi pastaj, kur vuri rë hezitimin e tjetrit.

— Më kanë ardhur në vesh disa fjalë të mbrapshta për Bardhën!, — tha zvarrisur Lleshi.

Ato fjalë iu dukën Mirashit si plumba.

— Çfarë?, — pyeti me padurim.

— Ti s'ke sy e veshë, bre burrë!!

— Mos më mundo, o Llesh!, — shtrëngoi grushtet Mirashi.

— Ja, pra, thonë se nuk i pëlqen i fejuari që i ke zgjedhur, se ka ndër mend ta prishë fejesën...

— Vetëm kaq?!, — e ndërpreu Mirashi me një fije shprese.

— Dhe se të gjitha këto i bëka për hatër të Lulashit tonë, me të cilin...

— Me Lulashin?!, — Mirashi u shemb në stolin pranë sobës; sikur i kishte rënë tavani mbi kokë.

— Ishalla s'është e vërtetë!, — vazhdoi ngushëllues Lleshi. — Por, sidoqoftë, bubullimë pa shkretimë s'ka... Ja, edhe unë diçka kam parë! — Ai uli sytë, për t'iu shtëmangur vështrimit të çakërdisur të shokut.

— Çfarë?, — sa s'ulëriu Mirashi, duke brofur përsëri në këmbë.

— Ajo po bisedonte diku me të, në pyll, por jo siç mund të bisedojë një cucë malësie me një mashkull. Të paktën, ashtu m'u duk mua... Isha larg dhe s'dëgjova ç'thoshin.

— Më mirë një rrufe në kullë e kurrkush gjallë mbas saj, sesa kjo!, — shpërtheu Mirashi, duke tundur grushtet i shpërfytyruar.

20

Vjollca ishte ulur në cepin e shtratit të vet, pranë abazhurit të komodinës dhe po rilexonte për të tretën herë letrën e Bledarit, që ia kishte sjellë Sula atë mbrëmje.

Ishte një letër e shkurtër, e shkruar me ngut. I tregonte se ishte disi i sëmurë, por në përmirësimin e sipër. Të mos bëheshin merak për të, i ishin gjendur shokët e sektorit, Mrika, Bardha. Nuk kishte nevojë për asgjë. Nënës të mos i tregonte, se shqetësohej, por të shkonte sa më shpesh tek ajo. I uronte mbarëvajtjen në përpunimin e materialeve të diplomës. Prindërve të saj dhe gjithë të njohurve u çonte të fala, përqaftime...

Frazat dukeshin të zakonshme, bile të ngrohta, por ajo ndiente ndërmjet tyre një thëllim therës, një qortim të heshtur. Asnjë pyetje, asnjë fjalë për rikthimin e saj në sektor!

«...Kthehu vetëm kur ta ndiesh të arsyeshme dhe të domosdoshme për ty... Jo për mua, kjo s'do të mjaftonte, po për veten tënde në radhë të parë...», i kumboi në veshë zëri i tij.

«E pse të më shkruante për këtë çështje, ç'do të më thoshte tjetër?», — mendoi dhe brofi në këmbë, duke e lëshuar letrën mbi komodinë.

Rrotulloi vështrimin si e hutuar nëpër dhomën e saj të ngrohtë, të bukur, me mobilje prej rimesoje arre, me llambadar kristali dhe perde damasku përmbi ato prej tyli. Pikturat e saj të zgjedhura, me korniza elegante,

të vendosura në faqet e mureve në lartësi dhe pozicione të ndryshme, iu dukën si shkarravina pa vlerë. Befas dalloi në një skaj lulen prej luspash të boçeve të pishës, që sikur kishte mbirë aty, siç mbin bari në asfalt. Iu duk sikur dëgjoi zërin e Bardhokut:

«... Që të na kujtosh dhe të kthehesh sa më shpejt!»

Ajo ndjeu se si po i mblidhej në gjoks një mall zhuritës për Bledarin, por edhe për Bardhokun, Mrikën, Vukën, Stakën, bile edhe për atë malin e lartë përballë dritares së tyre, që i qe dukur aq ndrydhës ato ditët e fundit. Mori në dorë kornizën me portretin e Bledarit dhe e vështrroi gjatë. Ai i buzëqeshte së andejmi çiltër, thjesht, ashtu siç ishte në jetë. I buzëqeshnin edhe sytë, por asaj iu duk sikur e vështronte me qortim, sikur e pyeste «akoma, Vjollcë?!»

E la me kujdes portretin në vend dhe shkoi drejt bibliotekës së saj. Aty dergjeshin vizatimet e bëra në sektor, portretet e Vukës, Bardhokut, Mrikës së dashur... Zgjati dorën drejt tyre, por u pendua sakaq. U druajt se mos i zbeheshin kujtimet, që tani i kishte kaq të gjalla, kaq të fuqishme.

Nuk ua kishte treguar pedagogëve ato vizatime. Ditën që shkoi me to në institut, rastisi të shihte përpara disa nga punimet e të tjerëve. Karshi tyre, të sajat iu dukën të zbehta, të thata, pa frymëzim. Qe kthyer në shtëpi zemërvrarë, qe munduar ditë të tëra t'i ripunonte, por pa dobi. Dhe tani dergjeshin në bibliotekë, kurse ajo hezitonte akoma!

Vjollca shkoi ngadalë drejt dritares, largoi perdet, mbështeti ballin në xham dhe vështrroi jashtë e trishtuar. Në katrorin e ndriçuar prej dritës rendnin e rendnin pikla të dendura shiu që çonin stërkala në asfaltin e lagur, ku reflektohej drita e llambave neon. Frynin gulshe ere, degëzat lakuriqe të rrepeve buzë rrugëz përpëliteshin dhe prej tyre shkoqeshin gjethet e fundme, të cilat vërtiteshin disa çaste në ajër, pastaj binin mbi asfalt, zvarriseshin një copë dhe ngjiteshin të lagura në ndonjë skaj.

Vjollcës iu duk sikur ajo stuhi po shtrihej edhe në brendësinë e saj. Çeli me vrull dritaren, sikur kishte etje për ajër. Sakaq vërshoi brenda një rrymë e fortë ere, që trazoi perdet prej tyli dhe i shpupurishi flokët. Pas pak ajo ngriti kokën, me një lëvizje energjike, sytë iu mbushën me dritë, një dorë e padukshme ia zhguli nga gjoksi atë lëmshin ndrydhës dhe ajo e ndjeu veten përnjëherësh të lehtë dhe të gëzueshme.

Û kthye me vrull nga rafti, mori sipër tij valixhen e saj të udhëtimit, e vendosi të çelur mbi dysHEME dhe filloi të rendiste ndërresat.

— Vjollcë, a ke ndër mend të hash darkë sonte?, — i thirri e ëma, duke çelur derën. Sakaq ajo u step dhe tha me zë të habitur e qortues: — Përsëri ti, ne sikur e biseduam një herë këtë punë?!

— Jo një herë, po disa herë, nënë!, — iu përgjigj Vjollca, pa e ndërprerë punën. — Por unë jam treguar e dobët, ose kam qenë e dobët, më saktë!

— Sula të tha që është më mirë, ç'ishte nevoja pra...

— Sula s'mund të thoshte ndryshe, por kjo s'është kryesorja!, — e ndërpreu Vjollca. — Bledari do të shërohet edhe pa mua, bile mund të jetojë edhe pa mua... po s'dita të ecja krah tij. Por unë...

— Ç'janë këto fjalë, vajzë?!, — u tmerrua e ëma

— Unë s'mund të rri duarkryq në shtëpi, nënë!, — tha Vjollca.

— Ti s'po rri, moj bijë, pikove përditë mbi ato të shkreta vizatime.

— Po gjendem në punë, thuaj! Puna ime e vërtetë është atje! — Ajo tregoi me dorë diku, përtej mureve, pastaj diçka kërkoi në raft.

Nënë Margarita mbeti si e shastisur përballë saj, me duart e kryqëzuara mbi kraharor. Nga dhoma tjetër dëgjohej zëri i spikerit të buletinit meteorologjik:

... Në të gjithë vendin do të ketë reshje, të cilat në zonat malore do të shoqërohen me reshje dëbore, që vende-vende do të marri formë shtrëngate... »

— E dëgjon? Të çelet moti të paktën, s'bëhet kia-

meti edhe për disa ditë!, — provoi me të butë, gati me lutje, nënë Margarita.

— Nesër do të nisem me Sulën, edhe gurë sikur të bien prej qiellit!, — tha me vendosmëri Vjollca.

— Dëgjomë, moj vajzë...

— Lëre, Margaritë, mos e trazo!, — e ndërpreu i shoqi duke hyrë në dhomë. — Ajo e ka mirë.

— Je në vete, Miço, nëpër borë?!

— Bora bie edhe për Bledarin, edhe për Agimin...

— Në këtë shtëpi paskan humbur mendtë njerëzit!, — shfryu Margarita dhe u largua e mposhtur.

— Në këtë shtëpi dikujt po i vijnë mendtë, dikujt akoma jo!, — tha Miçoja rreptë.

Vjollca buzëqeshi dhe shkoi të merrte vizatimet në bibliotekë, por sakaq ndërroi mendje.

«Do t'i filloj nga e para!, — vendosi. — Këto le të mbeten si dëshmi e dështimit. Qoftë i pari dhe i fundit!»

U largua prej tyre pa keqardhje. Një optimizëm i thellë, i gjerë kishte mbushur tërë qenien e saj. Iu afërua përsëri dritares. Jashtë shiu vazhdonte me rrëmbim dhe gjethet e rrapeve shtilleshin në vorbujt e erës, por tani kjo pamje iu duk diçka e bukur, e madhërishme, si një jehonë e largët e bjeshkëve.

Staka u zgjua pa rënë zilja e orës që mbante në komodinë. Në dhomë ishte errësirë. Zgjati dorën me kujdes, shtypi sustën e ndalimit të ziles, që ajo të mos shqetësonte shokët, flaku batanijet dhe brofi në këmbë. Bënte shumë ftohtë, megjithëse në sobë ndritnin akoma disa thëngjij.

I tërhoqi vëmendjen zbardhëllimi i dritares, nxitoi atje, fshiu me dorë djersën e ftohtë të xhamave dhe u mundua të shquante jashtë. Para syve të tij shtrihej një pamje e bardhë-kaltëroshe.

«Do të ketë rënë shumë dëborë!, — mendoi i shqetësuar dhe nxitoi të vishej.

Dera e jashtme e fjetores u çel më lehtë se zakonisht, sikur e shtyu njeri nga jashtë dhe sakaq u rrëzua në prag një tog i shkrifët dëbore. Staka shkeli në dëborë dhe ajo i arriti pothuaj te qafa e çizmes. Përtej pragut shtrihej errësira, por ishte një errësi e ndryshme nga e përditshmja: kaltëroshe, qumështore, disi e ndritshme. Ajri ishte i palëvizshëm, i ftohtë, i thatë, pa kundërmimet karakteristike të malit. Zhurmat ishin më të fashitura se zakonisht. Bile, edhe përroi aty pranë dëgjohej më pak. Borë nuk binte.

«Druaj se do të bjerë përsëri! — mendoi Staka, duke ecur më hamendje drejt hyrjes së mensës. Gjetej me të prekur drynin, mezi e tereziti çelësin në vrimë dhe shtyu me forcë derën e rëndë. Iu desh ta pastronte me lopatë pragun që ta mbyllte përsëri. Pastaj trokiti në sportelin e kuzhinës.

— Hej, Vatë, o Vatë, bre!

Krisi llozi i sportelit dhe sakaq u shfaq në të koka rrumbullake e kuzhinierit e një afsh i ngrohtë, i lagësht e plot kundërmime gjellësh.

— Dëborë e madhe, dreqi e marrtë!, — tha Staka.

— Pse truan, ajo këtu ka shtëpinë e vet!, — ia priti Vata.

— Na zuri pisk kësaj radhe.

— Mos u bëj merak, plani i xhiros së banakut do të realizohet!, — buzëqeshi kuzhinieri.

— Dreqi e marrtë planin e xhiros, kam hallin e sharrës!, — ia priti Staka i shqetësuar. — Rruga me siguri është bllokuar, traktori ndodhet i prishur... A çelen me krahë dhjetë kilometra?! E duhen çelur pa tjetër, dëgjon? S'lihet Fierza pa lëndë!

— Hej, more Stakë, sado që kanë kaluar dhjetë vjet, sharrëxhi se sharrëxhi ngele, mendjen te druri e ke.

— Pa të, as unë e as ti nuk duhemi gjë këtu. Më jep një lopatë prush të ndez zjarrin. Ç'ka për mëngjes?

— Të zakonshmet!, — Vata ia nxori lopatën me prush.

— Shto edhe hallvë. Në kohë bore hallva duhet, se të jep fuqi.

Staka hodhi prushin në sobën-fuçi, e mbushi me dru, çau një copë pishë dhe e nderi. Nga deriçka e sobës dolën ca gulshe tymi, pastaj zjarri nisi të bubullonte.

Dera krisi dhe te pragu u shfaq Mrika. Tha «më-rëmëngjes» dhe nisi e heshtur punën e përditshme. Sytë e mëdhenj e të zinj, futur thellë mes mollëzave të theksuara dhe harqeve të gjata të vetullave, i dukeshin të ftohtë e të qetë. Tiparet e fytyrës i kishte të palëvizshme, të ngurta. Staka, që e njihte prej kohë, he-toi një dhembje të thellë pas kësaj dukjeje të qetë.

— Mrikë, a s'po vjen të nxehësh pak duart?!, — i tha.

— Jo, s'kam ftohtë!, — iu përgjigj ajo dhe vazhdoi punën. Ecte ngadalë mes rreshtave të tryezave, ndërsa mendimi e çonte larg...

...Atëherë ruante dhinë e familjes te Mrizi i Lisave. Aty kishte livadhe të bukura, plot bar. Në pranverë çelnin lule të panumërta, të vockla, me të gjitha ngjy-rat e ylberit. Ajo bënte kurora me to. Stoliste flokët e saj, stoliste edhe kecat. Hidhërohej kur ata i shkundnin e i prishnin. Ishte e re, në mos e vogël.

Tek ai mriz kalonte shtegu nëpër të cilin, të shtu-nave pasdite ktheheshin në fshat burrat dhe djemtë që punonin në sharrë. Vërtet ishin të shpërndara shtë-pitë e tyre, por ai që i vetmi shteg për në sektor.

Kur i shihte që vinin, i mënjanohej shtegut, fshihej dhe i kundronte së largu. Shumicën i njihte. Ata kishin një të ecur ndryshe nga djemtë e tjerë të fshatit, diçka më krenare. Vinin e shkonin me rrobat e tyre më të mira dhe dukej sikur thoshin «shikonani ne, jemi sha-rrexhinj!»

Në atë mriz u lidh me Frrokun. Ai banonte jo fort larg kullës së saj e dikur patën luajtur bashkë. Një të shtunë pasdite po kthehej me një deng të madh në shpinë. Si duket kishte blerë dyshkë për shtëpinë. Ishte i lodhur e i djersitur. U ul të pushonte te Livadhi i

Madh e i kërkoi ujë. Ajo rendi te burimi, mbushi sapllaken e druntjë dhe ia çoi, pa guxuar të ngrinte sytë. Ai-buzëqeshi, e falënderoi dhe iku.

Kështu filloi. Ajo e njihte prej kohe, por si fëmijë, kurse tani po i dukej ndryshe. Filloi të trembej nga ndjenjat e saj. Ishte e fejuar qysh dymbëdhjetë vjeçe. Nuk e njihte fare të fejuarin, por i qe nënshtruar këtij zakoni si edhe shoqet e saj.

Fejesa me atë të panjohurin nisi t'i dukej si diçka e frikshme, e ftohtë dhe kërcënuese, si tehu i mprehtë i sëpatës së madhe të babës. U mundua t'i ndrydhte ndjenjat, por s'mundi. Ato u ngjanin luleve të egra të Livadhit të Madh, që nxirrnin kryet në të çarat e shkëmbinjve e përmes borës së vonshme.

E priste më ankth e gëzim të shtunën, kur ai dukej te Qafa e Arushës. Të hënën, kur ai ngjitej përpjetë dhe zhdukej përtej qafës, i bëhej një boshllëk mu në lukth. Në fillim fshihej në kaçuba, pastaj guxoi të kulloste dhinë pranë shtegut. I përgjigjej përsëritjes së tij kryeulur dhe ndiente se skuqej në fytyrë. Ia ngulte sytë pasi kalonte dhe prandaj e njihte më mirë nga shpina: shpatulla të gjera, krahë të bëshëm, që i tundte me ritmin e hapit, këmbë të gjata e të forta, që shkelnin në shteg me shkathësinë e dhive të saj.

Pastaj filluan ta kërkonin njëri-tjetrin. Ai e linte shtegun dhe bënte sikur kishte nevojë të çlodhej a të pinte ujë. Atëherë ajo sillej pas dhive me një kujdes të tepruar. Një ditë e kuturisi dhe u ul disa hapa larg tij. Më shumë heshtën, se folën. Vonë ajo guxoi ta vështronte në sy. Dhe, që atë ditë, folën më shumë me sy për ndjenjat e tyre, që u rritën bashkë me lulet e egra të Livadhit të Madh e me kecat e tufës së vockël të bareshës.

Kaluan ditët. Kecat u bënë dhi. Ajo i bëri mullarët e saj të gjethit. Gjethet e lisave filluan të ashpërsoheshin, të zverdheshin. Prindërit e saj caktuan ditën e dasmës me atë tjetrin. Filluan përgatitjet. Asaj i dukej sikur zemra i tkurrej përditë. Dikur s'duroi dot. I

tregoi Frrokut. Ai uli kokën. Sytë iu errësuan. Shtren-
gonte nofullat dhe gjuante me guraleca një shenjë të
paqenë. Më në fund tha: «A dëshiron të vish me mua?»
Ajo, si në prush, tundi kokën në shenjë pohimi, pastaj
i shpëtuan lotë dhe iku me vrap. As tani nuk e dinte
pse kishte qarë, nga gëzimi, nga frika, apo nga të
dyja bashkë?

Ai erdhi të shtunën, i tha të bëhej gati për të hë-
nën dhe atë ditë e mori me vete në sektor. Për herë
të parë ajo i pa në sup sëpatën e rëndë të sharrëxhiut.
Ndërsa ecnin, ai hetonte me kujdes shtigjet. Prindërit
e tyre nuk kishin pranuar të shkeleshin zakonet e
kanunit.

Në sektor i përkrahën shokët e Partisë. U dhanë
së pari një të ndarë që shërbente si magazinë veglash.
Frroku e rregulloi sa munda, por era hynte se hynte.
Kur bënte shtrëngatë, gdhieshin me borë mbi mbule-
sa. Megjithatë, qe dimri më i butë për ta.

Në fillim disa sharrëxhinj, sidomos të vjetrit, i
shikonin shtrembër, por ca nga ca ndryshuan mendim.
Ajo hyri në punën që ka sot. Dalngadalë e rregulluan
shtëpinë. Vetëm të shtunave, kur të tjerët ktheheshin
pranë familjeve dhe sektori shkretohej, ata ndienin një
farë trishtimi. Qysh asaj së hëne nuk e kishin kapërcyer
Qafën e Arushës dhe i merrte malli për kullat, njerëzit
e gjithçka përtej saj.

Kur ra bora e fundit, ajo lindi djalë. Frroku u
gëzua sa s'bëhet dhe atë mbrëmje i gostiti të gjithë sho-
kët në mensë. Aty i gjetën edhe emrin. Bardhoku pati
kumbarë gjithë sharrëxhinjtë e sektorit.

Frroku, ndryshe nga burrat e zakonit të vjetër të
malësisë, e përkundte Bardhokun, i këndonte, e merrte
në krahë dhe në ditët me diell e shëtiste buzë Përroit
të Kuq, që kalonte mes për mes sektorit.

Zhurrmave të vjetra e të njohura të sektorit iu shtua
për herë të parë guisja dhe të qarët e një foshnje. Kur
e dëgjonin sharrëxhinjtë, vinin buzën në gaz dhe sek-
tori u dukej më familjar e më i dashur.

Për herë të fundit ajo e pa Frrokun të gjallë mëngjesin e atij gjashtëmbëdhjetë nëntori, dhjetë vjet më parë... Ai gëlltiti kafshatën e fundit dhe brofi në këmbë. Në dhomën e tyre të vogël ai dukej i madh si një lis i fuqishëm. Sytë e tij të larmë ishin plot dritë. Ata dukeshin sikur vazhdimisht buzëqeshnin. Si çdo ditë, ai veshi pelicën e sharrëxhinjve dhe shkoi drejt djepit të foshnjës. E vështroi një hop me dashuri, i preku lehtë fytyrën me gisht, u përkul me kujdes mbi të dhe e puthi. Pastaj u kthye nga ajo. Fytyra e tij, me tipare të ashpra por të bukura, sikur kishte marrë diçka prej kthjelltësisë së foshnjës. Përkëdheli të shoqen, rrëmbeu bukën e drekës dhe doli. Ajo e përcolli si zakonisht, deri te pragu. Ai u nis përpjetë, nëpër shtegun e vjetër të sektorit. Diku ndaloi një çast, përshëndeti me dorë, pastaj iku... Dhe u kthye pas disa orësh në vig, mbi supet e shokëve që qanin...

— Mrikë, ç'ke?, — dëgjoi zërin e Stakës.

Ajo ktheu kokën, e zënë në befasi. Ai po e vështronte me ngulm, i shqetësuar.

— Eh, more Stakë, harrove pra?!, — psherëtiu ajo.
— Sot është gjashtëmbëdhjetë nëntor e bëhen plot dhjetë vjet...

Staka iu afrua Mrikës, pa e fshehur këtë radhë gjymtimin e vet. I vuri lehtë dorën në sup dhe i tha me zë të ngrohtë:

— Mrikë, Frrokun nuk e kemi harruar!

— Unë e di që s'e keni harruar. Unë dhe voci i tij e dimë. Po ju... — Sytë e saj u ngrohën, u mjegulluan pak dhe ajo, e trembur nga vërshimi i ndjenjave, ktheu vështrimin gjetiu.

Krisi dera dhe në pragun e saj u shfaq Lleshi. Ai vështroi hetues rreth e qark, pastaj pyeti:

— Mos ka qenë shoku Ndrecë këtu?

— Jo, ata janë në mbledhjen — rrufe të organizatës-bazë!, — iu përgjigj Staka.

Në këndin e kuq të sektorit sapo kishte mbaruar mbledhja e organizatës bazë të Partisë dhe komunistët po dilnin duke biseduar të preokupuar. Tani kishte dalë drita dhe anembanë shtrihej një bardhësi e butë. Bora kishte mbuluar e rrumbullosur gjithçka. Sheshi i sektorit dukej i rrafshët, i pastër, i brazduar vetëm nga dy shtigje të thella, që lidhnin fjetoren dhe këndin e kuq me mensën. Aty-këtu nxinte përroi, uji i të cilit rridhte si i druajtur përmes shtresës së dëborës. Nga strehët e godinave vreshin pirunë të gjatë akulli.

Ndreca dhe Vuka ecnin krah njëri-tjetrit. Meqë shtegu nuk i zinte, detyroheshin të shkelnin edhe anash tij, duke lënë pas gjurmë të thella.

— Pra, e ke të qartë?!, — i thoshte Ndreca shokut. — Brigada juaj e përforcuar, bëheni gjithsej nja dymbëdhjetë burra, do të vazhdojë prodhimin e lëndës së hidrocentralit. Pre e transporto në skelë, kuptohet që me krahë. Kur të arrijnë makinat, ta gjejnë skelën plot. Gjithë ne të tjerët do të hidhemi në çeljen e rrugës. Ju do të keni mangut vetëm Mirashin, që do të shoqërojë traktoristin në...

— Pse të mos çojmë Frrokun?!, — e ndërpreu Vuka i shqetësuar.

— Përsëri ti, sikur s'ta sqarova!, — shtoi Ndreca, i habitur nga këmbëngulja e shokut. — Ke ndonjë arsye që ngul këmbë kështu?

— Shoku Ndreca, pata një hall!, — i ndërpreu Lleshi, që i priste diku buzë shtegut.

— Urdhëro, Llesh!

Ndreca u ndal përballë tij, ndërsa Vuka bëri disa hapa më tej dhe priti.

— Kam nevojë të ngutshme për nja dy-tri ditë lejë!, — tha Lleshi, me një pamje shumë të shqetësuar.

— Lejë në këtë hall që gjendemi?!, — u habit Ndreca.

— Jam shumë ngushtë andej nga kulla. S'e kanë një shkop për zjarr, bagëtia është pa ushqim...

— Ti s'e ke shtëpinë shkretë! Mandej, secili e ka një hall në ditë bore, por ky halli i punës është përmbi to.

— Shoku Ndreca, duhet të shkoj pa tjetër!, — nguli këmbë Lleshi.

— Të kemi dhënë lejë më shumë se askujt, megjithëse ndonjëherë bën sikur të pret gjëma edhe për vocërri-ma, por sot nuk mundem!, — ia preu Ndreca, duke u matur të largohej.

— Mos ma shtrëngo lakun në fyt, bre burrë!, — thirri Lleshi, disi i zemëruar, duke e kapur për krahu.

— Më gjatë s'ta kam kohën, Lleshi!, — u acarua Ndreca, tërhoqi krahun dhe vazhdoi rrugën.

— Ashtu, ë? Atëherë po më detyroni...

— Lidhur s'të mbajmë, por ma'u mirë!, — e paralajmëroi Ndreca, pa e ndalur hapin dhe shkoi u bashkua me Vukën.

Lleshi i ndoqi me sy, i zemëruar. Një hop s'diti nga t'ia mbante, pastaj shkoi drejt mensës, kryeulur dhe i menduar. Qysh një natë më parë atij i qe mbushur mendja të shkonte në shtëpi, edhe po të mos i jepnin lejë, por e mbante shpresa se do t'i jepnin. Tahi që kjo shpresë u pre, hezitonte.

Në mensë ishte një hyre-dalje e pandërprerë dhe dera qëndronte pothuaj e hapur. Soba bubullonte e nxirrte tym nga korentet e ajrit, por asnjëri s'kujtohej për të. Disa hanin bukë me ngut, në këmbë; të tjerë e mbësh-tillnin racionin e mëngjesit, e futnin në trastë dhe dilnin sakaq. Staka mezi u bënte ballë kërkesave, duke nxituar andej-këtej mbrapa banakut. Dëgjoheshin thirrje dhe biseda të shkurtra e të nxituara. Në fytyrat, zërat, hapat dhe në gjithçka ndihej tendosja dhe ngutja.

Lleshi e ndjeu veten keq në atë vorbull. Hezitimi iu shtua dhe s'diti ç'të bënte. Po pengonte edhe lëvizjen e të tjerëve. Pa Mirashin që po pinte kafe në një tryezë të

veçuar, pranë banakut dhe shkoi drejt tij. Ai dukej i zymtë, i ngurtë si ndonjë shtatore, me sy të skuqur e idhnakë. Lleshi porositi një kafe dhe u afrua.

— A u çove, Mirash, a?, — e pyeti duke zënë vend pranë tij.

— Ma mirë të mos isha çue!, — ia priti tjetri.

— Heee!, — rënkoi gjatë Lleshi duke tundur kokën. Pastaj ktheu sytë nga banaku të shihte a po ia sillnin kafënë.

— Ndreca nuk më dha lejë!, — çau hall pastaj, ndërsa Staka po i sillte kafënë. — S'mund ta marrësh me mend sa pisk e kam...

— S'kish si të të jepte!, — ia ktheu Mirashi, disi indiferent për hallin e tjetrit. — Rruga e bllokuar, traktor jo, Fierza pret!

— Punës së shtetit i del zot shumëkush, punëve të mia askush veç meje!, — shpërtheu Lleshi.

— S'po flet mbarë, or mik!, — tha Mirashi.

— Kujtova se po më lejojnë të shkoj me faqe të bardhë, por, tek e fundit...

— Mos bën ndonjë marrësi, se jemi burra të vjetër e s'na ka hije t'i bëjmë bisht!, — e këshilloi Mirashi duke gjerbur fundin e kafesë.

— Mirash!, — u dëgjua zëri i Ndreces.

Mirashi ktheu kokën. Ndreca, që ndodhej pranë banakut, po ia bënte me dorë. Pak më tej ishte edhe Lulashi, me shpinë, duke blerë diçka në banak. Mirashi u vrenjt, u çua ngadalë, flaku cigaren përdhé, e shkeli me nervozizëm dhe eci rëndë-rëndë drejt Ndreces, me parandjenjen se atje e priste diçka e papëlqyeshme.

— Mirash!, — i tha Ndreca duke i vënë dorën në sup. — Shtegu për në qytezë kalon përbri shtëpisë sate, ti i njuh me pëllëmbë ato anë, prandaj menduam të shoqërosh Lulashin, i cili...

— Shoku Ndrece!, — e ndërpreu Mirashi zymtë, duke shtëmangur supin nga dora e tij.

— Prit të mbaroj, bre burrë!, — tha Ndreca disi i habitur. — Duhet lajmëruar edhe Bardha të vijë në sektor, se ditë bore është e gjithçka mund të ndodhë. Ndoshta ajo është nisur por, sidoqoftë, s'është keq të sigurohemi. Pra, një rrugë e dy punë!, Gjithë të tjerëve ua kemi ndarë detyrat, kurse ty të lamë për këtë punë.

— Shoku Ndreca, unë s'e kam pasë zakon të kundërshtoj detyrat, por..., — tha Mirashi, si i zënë në lak.

— Shkoj vetë, s'kam nevojë për shoqërues!, — kërcëu Lulashi, që deri atëherë qe vonuar enkas me pagesën e harxheve.

Ndreca vuri re me habi shqetësimin e madh të të dyve, e kuptoi se ata diçka kishin ndërmjet tyre dhe u gjend ngushtë.

— Po më habitni, bre burra!, — tha. — Hë, Mirash, si do ta këpusim këtë punë?

«Si t'ia bëj?, — punonte me shpejtësi dhe në panik mendja e Mirashit. — Të shoqëroj atë që po më merr fytyrën? Ç'do të mendojnë shokët?... Të mos shkoj, të kthej fjalën sot, në këtë ditë?... Duhet marrë një vendim, se nuk pret koha. Ja, Ndreca po e humbet durimin dhe po më vështron i habitur. S'dika gjë si duket. Kurse ai, Llesh Gjoni, pse më vështron ashtu? Edhe disa të tjerë po më vështrojnë. Presin... I duhet dhënë karar, po si?»

Lleshi u çua nga vendi dhe erdhi drejt tyre pa ua ndarë sytë. Mirashi e kuptoi vetëtimthi qëllimin e tij dhe u tmerrua. Tani do ta merrnin vesh edhe Ndreca, edhe të tjerët! U mundua t'ia bënte me shenjë Lleshit që të heshte, po s'arriti.

— Shoku Ndreca, pata një fjalë veças!, — iu drejtua atij Lleshi, duke e zënë për krahu. — Jo, jo për çështjen e lejës!, — shtoi, kur pa grimasën e padurimit tek ai.

— Mirë, po shkoj pra, — vendosi Mirashi, duke hyrë ndërmjet atyre të dyve.

— Mos u vononi pra!, — i nguti Ndreca.

Lleshi ngeli i habitur, pastaj bëri një gjest përçmues me dorë dhe u largua.

Mirashi hovi supet, sikur deshi të rregullonte një barrë të rëndë në shpinë dhe eci drejt derës me hapa të gjatë, pa ngritur sytë. Lulashi shkoi pas tij, i kuq në fytyrë dhe me rrudhën më të theksuar se zakonisht midis vetullave.

Mirashi s'i ngriti sytë edhe pasi e kaloi pragun e mensës. Vështronte majat e çizmeve të tij të mëdha tek çapiteshin në borë dhe i dukeshin si të tjetërkujt. Kokën e ndiente të rëndë, të turbullt, i buçisnin veshët dhe e mundonin disa mendime të errëta, që i përziheshin me njëri-tjetrin. Kur arriti në kryqëzimin e shtigjeve, u kthye në drejtim të fjetores me mendimin e turbullt se diçka duhej të merrte. Ktheu kokën dhe e vështroi shtrembër Lulashin, sikur deshi t'i thoshte «pritmë aty!», pastaj vazhdoi rrugën. Te pragu i dhomës shtangu. Ç'duhej të merrte? Iu kujtua sëpata e vogël me bisht të shkurtër dhe e kërkoi në qoshen ku mbanin veglat. E mori dhe doli me të në dorë. Kur u gjend jashtë u kujtua ta fuste në brez.

Lulashi e priste në kryqëzim, kokulur, duke gërmuar gjithë duf dëborën me majën e çizmes. Mirashi, me një lëvizje të zemëruar e përçmuese, mbërtheu pelicën dhe kaloi përpara.

«Si më vështroi!, — tha me vete Lulashi, duke pritur që tjetri të largohej pak. — Duket që ka marrë vesh gjithçka. Thua t'ia ketë thënë Bardha, megjithëse në të tilla raste gjendet dikush që ta thotë... Ç'ngatërresë! Pse nuk u çova pak më herët? Ndoshta Ndreca do të caktonte tjetërkënd, ose isha nisur vetëm... A kalohet gjithë kjo rrugë së bashku? Vështrë për të e vështrë për mua!...»

Mirashi i ngjitej shpatit me ngut. Ngjeshte me inat çizmet në borën e shkrifët dhe gulçonte. Rrudhat e fytyrës i qenë thelluar, vetullat e rrudhura e të rrëzuara mbi zgavrat e syve sikur donin të fshihnin vuajtjen që pasqyrohej në ta. Hera-herë ngrinte kokën dhe

vështronte përpjetë. Pylli po afrohej. Atje punonin shokët.

«Më mirë të më ndiqte vdekja se ky njeri!, — mendonte. — Qysh të kaloj tani mes shokëve, me këtë pas?!... Shtegut s'i shmangem dot, se atëherë do të bin-te më fort në sy... Të mos kisha pranuar, të dilte ku të dilte! Në mos sot, nesër ka për t'i dalë tymi. Tymi e turpi s'fshihen dot në gji... Ah, Bardhë, që mos pafsh ditë të bardhë, në ç'ditë të zezë më solle!...»

Dëgjoheshin goditje sëpatash. Mirashit i dukej sikur ato binin mbi kokën e tij. Vështroi nga shokët me bisht të syrit, u gërmuq më fort, sikur deshi të fshihte kokën ndërmjet supeve dhe shpejtoi hapat.

«Ruajuuu!», — u dëgjua një thirrje, e ndjekur nga krisma e drurit që po rrëzohej.

23

— E pat edhe ky, hə?, — tha Vuka, duke iu afruar drurit të saporrezuar, të cilit po i lëkundeshin akoma degët dhe që spikaste fort mbi shtresën e bardhë të dëborës.

— Po, veç s'kemi të tjerë!, — iu përgjigj Frroku. — Damka përfundoi!

— Këq shpejt?, — u çudit Vuka.

— Harrove se jemi dymbëdhjetë burra sot?

— Si t'ia bëjmë, pra?, — pyeti Vuka i zënë ngushtë.

— Po sikur të presim aty-këtu ndonjë pa damkë?, — propozoi një sharrëxhi që punonte aty pranë. — S'bëhet kiameti. Puna s'pret.

— Në asnjë mënyrë!, — ia preu Vuka rreptë.

— Ç'të bëjmë pra, të presim duarkryq mos rrëzojë ndonjë era, apo të shkojmë të heqim borë me shokët?, — u acarua sharrëxhiu.

— Të vazhdoni prodhimin nga drurët e prerë, ja ç'të

bëni! Ndërkohë unë po shkoj të bisedoj me inxhinier Bledarin! — Vuka nguli sëpatën në një cung dhe u nis.

— Bjeri nga shtegu, përdryshe do të fundosesh ndokund në borë!, — i thirri Frroku.

— Mos ma qaj hallin, neve të vjetërve, ç'na ka fiuar në fuqi, na është shtuar në përvojë!, — ia priti Vuka, duke vazhduar mëteposhtë si ortek.

Inxhinier Bledarin e gjeti duke pirë çaj në nxehtë në dhomën e vet.

— E kisha këtë hall qysh mbrëmë, por, meqë s'bëtë zë, kujtova se ju ka tepruar diçka për sot!, — tha ai pasi e dëgjoi deri në fund.

— Të çojmë dikë të thërresë rojtarin e pyjeve?, — pyeti Vuka i ngatërruar.

— Jo, ai nuk e ka të drejtën e damkës!, — iu përgjigj Bledari, duke kërkuar diçka në raft. — Do të vij vetë!

— Kurrsesi!, — brofi Vuka. — Ti akoma s'e ke marrë veten!

— S'ka zgjidhje tjetër!, — Bledari nxori nga rafti një bluzë të leshtë. — Mandej, sot s'jam keq.

— Ti nuk do të luash nga kjo dhomë!, — u acarua Vuka. — Ne vërtet jemi ngushtë, por për hir të shëndetit të shokut...

— Hë, çfarë?, — ndërpreu Bledari, duke buzëqeshur. — Do të prisni pa damkë?

— Ç'është ajo fjalë?!

— Do të rrini pa punë, atëherë? Apo mos do t'ju jap damkën juve... t'i var ujkut mëlçinë në qafë?!, — qeshi Bledari.

— Ta dija se do vendosje kështu, nuk...

— Mos u pezmato kështu, Vukë, s'u bë kiameti!, — vazhdoi me zë pajtues inxhinieri. — Jam kockë e fortë unë, kot s'kam pirë ujë bjeshke kaq vjet!

Pas pak ata të dy i ngjiteshin shtegut të dëborës së rrahur. Pas gjithë atyre ditëve që kishte qëndruar brenda, Bledarin sikur e dehën bora dhe ajri i freskët.

Megjithatë, bënte përpara në shtegun e thellë, të mbrujtur, që dukej si një plagë e freskët në atë shpat të bardhë, plaga e parë që kishte marrë bora në betejën e sapofilluar.

Lleshi doli nga fjetorja me t'u larguar Bledari me Vukën, hetoi me kujdes rreth e qark, pastaj shkoi drejt mensës. Pa Stakën që po i vinte drynin derës së jashtme dhe nxitoi hapat.

— Po e mbyll, a?, — iu drejtua banakierit me keqardhje.

— Pse, ç'deshe?, — e pyeti ai, pa e kthyer kokën.
— E çelim përsëri, po qe nevoja.

— Ja, thashë mos të kanë tepruar nja dy bukë... Desha edhe dy kile sheqer, një makarona dhe disa kaushë duhan!, — tha Lleshi me të lutur, duke hequr torbën nga supi.

— Ç'të duhen gjithë këto?, — pyeti Staka, duke e vështruar me dyshim.

— Mora lejë të shkoj në shtëpi dhe...

— Do të ikësh pa lejë!, — e ndërpreu Staka me inat.
— Të dëgjova me këta veshë kur iu ankove Mirashit se s'të dhanë lejë. Je edhe burrë i vjetër! Shokët po luftojnë me borën, kurse ti...

— Mos mu hakërrro ashtu, se jemi burra malësie!,
— u zemërua Lleshi.

— Burrat i tregojnë veprat!, — ia priti Staka.

— Mos ma merr fytyrën, se durimi ka karar! — Lleshi bëri një hap përpara, kërcënues. — Fundja, ty s'të duhet ku shkoj unë. Detyra jote është të shesësh!

— Çfarë, të të jap ty bukë që të ikësh nga fronti?!, — bubulloi Staka. — Të ishte luftë, do të të kishim dhënë një plumb ballit, si dezertor!

Ndërkaq u dëgjuan hapa që shkelnin me nxitim borën dhe ia behu Frroku.

— Këtu paske qenë, Llesh, a?!, — iu drejtua me zemërim dhe ironi. — Ditë për të bredhur pas teje është sot?!

Lleshi s'diti ç'të përgjigjej dhe mbeti në këmbë, si i ngrirë. Torba që mbante në dorë iu var gjer për-dhé.

— S'jam as fëmijë dhe as keqbërës, që më ndiqni kështu!, — shpërtheu pastaj, duke ngritur ca sy të çakërdisur.

— Kujton se s'ia dalim dot pa ty, prandaj vijmë mbas teje?!, — ia priti Frroku. — Jo, bre! Për ato thinja, të takojnë më shumë mend. Veç, kam një porosi nga shokët: në iksh e në mbërrifsh gjallë në shtëpi, mos u kthe më në brigadën tonë!

Frroku iku me po atë nxitim që erdhi. Staka hoqi çelësin nga dryni, e siguroi në xhep, rrëmbeu sëpatën që e kishte mbështetur aty pranë, e vështroi Lleshin me përbuzje dhe i ktheu shpinën. U nis përpjetë, pas Frrokut.

Lleshi mbeti një copë herë i shtangur. Nuk dinte nga t'ia mbante. Vështronte rreth e qark, sikur kërkonte rrugën e humbur. Së fundi, lëvizti nga vendi dhe iu vu shtegut të rrahur, më i kërrusur se zakonisht, duke zvarrisur këmbët dhe torbën.

Pas pak dalloj përpara vetes Mrikën me të birin. Ajo mbante një lopatë në sup, ai kishte një bohçe në dorë.

— Kalo, Llesh, se qenke vonë!, — i tha Mrika sa e pa dhe i liroi shtegun.

Ai e vështroi rreptë dhe hetues, se mos po e tallte, pastaj e pyeti:

— Për ku kështu?

— Lart, ku tjetërkund sot?

— Po u çon ndonjë send për të ngrënë?, — Ai bëri me kokë nga bohçja që mbante Bardhoku.

— Jo, është një triko e inxhinierit. Shkova sot t'ia

çoja po nuk e gjeta. Ka shkuar me Vukën përpjetë, se s'paska damkë, thanë. Kjo ja i duhet sot, ja s'i duhet tjetër ditë.

— Edhe inxhinieri, i sëmurë, paska dalë?! — u habit Lleshi. — Po Bardhokun ç'e mundon?

— U rrit tashmë, u bë t'i prijë nënës në mal!, — buzëqeshi Mrika me përmallim, duke i përkëdhelur supet të birit. — Hej, të rronte Frroku dhe ta shihte!

Lleshi kaloi përpara dhe nxitoi më i trazuar nga ç'kishte qenë. I dukej sikur vështrimi i atyre të dyve i digjte shpinën. Diku iu shtëmang shtegut të rrahur dhe eci tërthorazi një shpati, nëpër borën e pashkelur. Çizmet i fundoseshin në dëborë, herë-herë përmbi qafa, dhe ndjeu se po i lageshin e po i ngrinin këmbët, por ai vazhdonte udhëtimin me duf. Më në fund qëndroi pas një kaçubeje të madhe, z bathi e shkundi çizmet, pastaj i nguli sytë diku poshtë.

Rrëzë shpatit dukeshin sharrëxhinjtë që po punonin për çeljen e rrugës. Një dru i rrëzuar tërthorazi trasesë dhe i mbuluar me borë kishte ngatërruar gjithë punën. Ata provuan ta largonin me cepina, por s'gjenin dot pikëmbështetje të qëndrueshme dhe orvatjet u dështuan. Atëherë dikush solli një litar, e lidhën fort te rrëza e tringut, e hodhën në sup dhe filluan ta tërhiqnin nga dhjetë burra, ndërsa të tjerët ndihmonin me capina e lopata. Dëgjoheshin thirrjet e tyre «hooo-hop, hooo-hop!». Litari tendosej, druri tronditej, trupat e njerëzve përkuleshin fort përpara, krahët e tyre shtriheshin një me litarin, këmbët u rrëshqisnin në dëborë, por ata s'jepe-shin. . .

Lleshin e tërhoqi ajo pamje, e përpiu. Ndiqte me ankth veprimet e tyre, bile një herë sa s'u thirri, t'u jepte një mendim, por u kujtua sakaq dhe i ngeci thirrja në fyt.

Dikur druri lëvizi, filloi të rrëshqiste ngadalë përpara, gjersa u rrokullis nën skarpatë. Mbrapa tij ngeli në dëborë një vrragë e thellë. Sharrëxhinjtë rrëmbyen lopatat dhe rifilluan çeljen e trasesë.

Lleshi u largua nga kaçubja, hezitoi disa çaste, pastaj vazhdoi rrugën me hap të plogët, pa e ditur as vetë ku shkonte. Mbrapa tij ngeleshin gjurmë të thella, të vetmuara. Së larti filloi të qëmtonte dëborë.

— Filloi përsëri bora!, — tha inxhinier Bledari, duke shënuar me damkë një dru pishë.

— Nuk i trembemi ore, jo!, — ia priti Staka, i cili po qëronte degët e një trungu.

Ai i kishte shtrënguar shputat e këmbëve mbi trung si kthetra. Pantallonat prej shajaku dukeshin të ngushta për pulpët e tij, që tkurrreshin dhe bymeheshin në çdo goditje të sëpatës. Gishtërinjtë e tij të gjatë e me nyje të mëdha shtrëngonin fort bishtin e saj, ndërsa llërët e fuqishme dukeshin si një vazhdim i gjallë i veglës. Lëvizjet e sharrëxhiut të vjetër ishin të kursyera, të shkathëta, të sakta e ritmike, por njëkohësisht të fuqishme e gati të egra. Bashkë me sëpatën, lëvizte çdo pejzë e muskujve të tij. Edhe sytë larushë e të ndritshëm merrnin pjesë, duke shoqëruar tehun e çeliktë gjatë lëvizjes. Nga trungu rrëzoheshin radhazi degët me hala të gjelbra. Ato binin mbi borë si gjymtyrë të prera dhe dergjeshin atje, në mes të ashklave verdhoshe.

— Të paska marrë malli për sëpatë, ë?, — buzëqeshi Bledari, duke e vështruar me admirim.

— Helbete, kisha disa kohë pa punuar kështu!, — iu përgjigj Staka pa e ndërprerë punën.

— A do të damkosësh të tjerë, inxhinier?, — pyeti Vuka, i cili kishte filluar luspitjen e trungut.

— Po, këtej, përgjatë shpatit do t'i gjeni! — Bledari tregoi me dorë dhe u nis në atë drejtim.

— Frrok, shoqëroje inxhinierin!, — i thirri Vuka.

— Jo, jo, s'është nevoja!, — kundërshtoi Bledari. — Sot është i çmueshëm çdo krah pune. Unë këtej pari jam.

— Mos u largo shumë, se nuk i dihet kohës!, — e këshilloi Vuka.

Bledari vazhdoi rrugën me sytë përpjetë, duke studiuar kurorët e drurëve. Ndërmjet degëve depërtonin flokë bore që zbrisnin poshtë duke u përdredhur.

E ndiente veten pak të lodhur. Gjunjët dhe pulpët i kishte si të mpira, i merreshin mendtë dhe nuk ngopej mirë me frymë, por mendoi se kjo ishte e natyrshme pas ditëve që kishte kaluar në shtrat. Shkoi pa merak më tej.

Iu afrua një bredhi të moçëm, i cili ishte aq i madh, sa e ndjeu veten të vockël karshi tij. Ndoqi me sy trungun me lëvore të ashpër e të plasaritur thellë, që ngrinhej i madhërishtëm, qiri përpjetë dhe diku lart shtrinte anësh degë të stërmëdha, në trajtën e një çadre vigane. Ndërmjet tyre nuk shihej asnjë copë qiell, veçse një rrjetë e dendur degësh e degëzash të murme dhe reflekset e gjelbra të halave. Bora kishte mbetur diku në katet e sipërme të kurorës.

«Thua ta shënoj për ta prerë?», — hezitoi Bledari. — Kushedi sa breza kalimtarësh janë strehuar këtu!»

Uli kokën dhe vështroi rreth e qark. Nën kurorën e bredhit toka ishte shkretë. Vetëm anësh vuri ré disa bredha të rinj, të cilët ishin shtrembëruar në drejtim të dritës, si të donin t'u shpëtonin kthetrave të viganit. I erdhi keq për ta dhe vendosi. Zbuloi nga bora një cep të rrënjëve të drurit të moçëm, gdhendi pak lëvoren, pastaj goditi fort me çekiçin e damkës. Kumbimi i drurit iu duk si një rënkim. U largua pa e kthyer kokën, duke ndier një farë keqardhjeje.

«Në mos qoftë i kalbur në zemër, do të dalin prej tij nja dhjetë metra kub dërrasë speciale!», — mendoi, si për të ngushëlluar veten.

Flokët e borës filluan të dendësoheshin. Pylli, që gjer atëherë sikur kishte dremitur nën gunën e bardhë, nisi të gjallërohej. Degët e drunjve u drodhën, lëvizën, filluan të shkundeshin nga bora. Ajo shkëputej prej tyre në copa të mëdha, thërmohej nëpër degët e mëposhtme

dhe binte në truallin e pyllit në trajtë copëzash e pluhuri të bardhë, duke bërë «puf, prrrsh...»

Bledari ndihej gjithnjë më i lodhur. Veriu i fshikullonte fytyrën e i vështirësonte frymëmarrjen dhe ai ecte duke mbajtur krahun para fytyrës. Filloi të mërdhinte. Ishte një e mardhur që s'e kishte provuar ndonjëherë. I dukej sikur po i mpiheshin gjymtyrët, sikur po i shtrëngonte tëmthat.

«Duhet të kthehem sa më parë te shokët!, — mendoj, duke kërkuar me sy gjurmët e veta.

Ato të afërtat dukeshin mirë, më tej ngjanin si gropëza të vogla vezake, pastaj humbisnin fare. Era me dëborë po shtohet. Pylli uturinte. Degët e pishave, të kapërthyera me njëra-tjetrën, lëkundeshin furishëm. Bashkë me borën shkundeshin që lart copa degësh të thata e boçe të vjetra. Hera-herë formoheshin ca vorbuj të bardhë, përtej të cilëve s'dukej asgjë.

Bledari pushoi pak pas një trangu, u mundua të ngopej me frymë, fërkoj fytyrën, u përpoq të ngrohte duart me avullin e gojës, pastaj hovi përsëri përpara. Këmbët i zhyteshin thellë në dëborë dhe mezi i nxirrte. Një lodhje kapitëse po i mbërthente gjymtyrët.

...Degët e drunjve i lëvizte era, po trungjet pse lëviznin? Ja, ato përkuleshin të gjitha së bashku herë majtas, herë djathtas. Pluhuri i borës ia mjegullonte aq shumë pamjen?... Pse i rëndonin aq shumë qepallat?... Trualli i bardhë i pyllit i ngjante një dysheku të butë, të butë... Sikur të shtrihej e të pushonte në të!... Vërtet, pse lëviznin trungjet?! Sikur s'po mërdhinte më aq shumë... Sikur ta dinte nëna në ç'hall ishte!...

I doli para syve fytyra e saj e hequr, me rrudha të imta dhe me flokët e thinjur, shtrënguar pas tëmthatave. Iu duk sikur sytë e saj të butë e laramanë e vështronin me dhembshuri të thellë, sikur buzët e saj të holla lëvizën dhe i thanë «mos u jep, të keqen nëna, forca, ec, ec, ec...»

Ai u mundua të shpejtonte hapat drejt një trangu të madh, por trangu largohej, largohej dhe ai s'e arrinte

dot. Zgjati duart ta kapte, ja, po e arrinte, e arriti, por duart i rëshqitën gjatë tij dhe ai e pa veten të shtrirë në dëborë. Përmblodhi të gjitha forcat dhe bëri të ngrihej. Sakaq ndjeu se dikush e kapi për krahu dhe po e ndihmonte. Ktheu kokën i habitur. Vërtet dikush ndodhej pranë tij. Si nëpër mjegull fytyrën e shqoi.

— Llesh, ti qenke?!, — tha me një fije zëri.

— Qëndro, bre burrë!, — e nxiti ai.

E ndihmoi të mbështetej në trung, nxori nga mesi një thikë të madhe, preu me nxitim disa degë bredhi, ia shtroi mbi borë, pastaj i tha:

— Pusho, edhe pak, pusho!

— Si u ndodhe në këto anë?, — pyeti Bledari, që po e mernte veten.

— Të pashë që larg, e kuptova se ishe i lodhur, por s'arrita dot më parë!, — i dredhoi përgjigjes Lleshi. — Borë e madhe!

— Vërtet, borë e madhe!, — tha Bledari, duke vështruar si i habitur rreth e qark.

— Të thirrë sa munda, por s'më dëgjovë!, — vazhdoi Lleshi.

— S'kisha si të të dëgjoja, gjithë kjo erë!, — tha Bledari.

— Po, po, ulërin si një lukuni ujqish. Po ti, ç'bën këtu?

— Po damkosja. S'i dëgjova shokët. U largova vetëm. Mirë që erdhe, se e pashë veten ngushtë. Po më mërreshin mendtë.

— Po tani, si je?

— Diçka më i fortë!, — buzëqeshi Bledari.

— Ku janë ata?, — pyeti Lleshi si i druajtur.

— Përtej proskës së madhe!

— S'qenkan larg!

Lleshi vështrroi në atë anë i shqetësuar. Deri atë çast pat lëkmuar një shkak që ta kthente te shokët, kurse tani që bashkimi me ta ishte bërë i pashmangshëm, filloi ta ndiente veten ngushtë.

«Qysh do t'u dal përpara?!» — mendonte.

Ndërkaq, ndërmjet gulsheve të erës u dëgjua diçka si vikatje.

— Prit!... Më duket se dikush po thërret!, — vërejti Bledari.

— Të bëjnë veshët, inxhinier, nga dobësia!, — buzëqeshi me keqardhje Lleshi.

Thirrja u dëgjua më qartë.

— Paske pasur të drejtë!, — tha Lleshi.

Brofi në këmbë, vuri duart si hinkë rreth gojës dhe u përgjigj me sa fuqi pati: «he-he-heeej, këtu, ore, këtuu!»

«He-he-heeej, këtej, ore, këteeej!», — u dëgjua përsëri thirrja.

— A mund të ecësh ngadalë, inxhinier?, — pyeti Lleshi.

— Mundem!, — u përgjigj Bledari, që e kishte marrë disi veten dhe u çua në këmbë.

— Mbështetu në krahun tim!, — i tha Lleshi.

Ai doli përpara dhe nisi të çante borën. E mbronte Bledarin nga era me trupin e vet dhe e ndihmonte të ecte në vendet e vështira. Hërë pas here qëndronte dhe u përgjigjej thirrjeve.

Sapo arritën buzë prroskës së madhe, vunë ré tre njerëz që po nxitonin drejt tyre. Nga larg nuk njihehin. Dukeshin si dordolecë bore. Vetëm kur ishin nja pesëdhjetë hapa larg, Bledari njohu Vukën, Frrokun dhe Stakën. Atyre dëbora u kishte mbushur gjithë skutat e rrobave e të kokoreve dhe u kishte ngrirë në vetulla. Bledari buzëqeshi me vete, se Vuka i ngjasoi me plakun e Vitit të Ri. Sakaq ndjeu krahët e tij të fuqishëm që po e përqafonin.

— Ku je, bre burrë?, — bubullonte ai me gëzim.
— Bora s'mundi, por ti na e ngrive gjakun, bre!

Pastaj e përqafuan Frroku dhe Staka, të cilët e vunë në mes dhe sa s'po e merrnin në krahë.

— Pse nuk na dëgjove, bre?, — e qortoi Vuka.

— E dija se do të më gjendeshit në rast nevoje!,

— u përgjigj Bledari buzagaz. — Ja! — Ai tregoi me dorë Lleshin.

Lleshi uli kokën dhe u shtir sikur nuk e kishte mendjen aty.

— Të lumtë, Llesh, na solle dy gëzime njëherësh!,
— e përgëzoi Vuka duke i rrahur shpatullat.

Bledari vështroi pyllin e ngarkuar me borë, avujt e bardhë që sajonte era, kurorat e pishave që ngjasonin si tallazet e gjelbra të një deti në furtunë, zjarrin që kuqëlonte mbrapa një shkëmbi dhe mendoi se asnjëherë s'kishte parë diçka të tillë, kaq të egër dhe të bukur njëherësh. Iu kujtua vepra e diplomës së Vjollcës.

«Ti duhet të ishe këtu, t'i shikoje të gjitha këto!,
— mendoi, ndërsa ecnin drejt zjarrit, për në strehishtë.

26

Vjollca kishte mbetur e vetme në kabinën e makinës, sepse Sula kishte shkuar në PTT-në e qytezës, që t'i telefononte familjes. Ajo që kuspullosur në sedilien e parë dhe po vështronte me kureshtje jetën e qytezës së struktur nën dëborë.

Jashtë frynte dhe binte, megjithatë jeta vazhdonte rrjedhën e vet të përditshme. Njerëzit, shumica të veshur me pambukore ose peliçe sharrëxhinsh, shkonin dhe vinin nga drejtime të ndryshme, duke shkelur pa teklif në dëborë. Një djalë me kokore të madhe dhe me një bukë nën sqetull, vraponte dhe aty-këtu lëshohej rrëshqitazi plot siguri. Disa punëtorë me lopata në sup nxitonin për diku. Vetëm një grua me fëmijë në krahë, të mbështjellë pothuaj krejtësisht me batanije, ecte si mbi vezë.

Vjollca buzëqeshi. Tani nuk e trembte dhe nuk e shqetësonte aq shumë kjo mundësi. Kishte pasur mjaft kohë që t'i mendonte të gjitha.

Jashtë fryu një gulsh ere dhe u çuan vorbuj të bardhë. Pluhuri i dëborës cikëriti në llamarinën e ka-

binës. Njerëzit shpejtuan instinktivisht hapat. Pastaj era pushoi dhe bora vazhdoi të binte shtruar, me flokë të rrallë e të mëdhenj. Askush nuk luante me topa bore, askush nuk gëzohej dhe nuk habitej pas saj. Më tepër vërehej një farë shqetësimi.

«Këta njerëz janë familjarizuar me borën, si ne me shiun dhe, kur bie, mendojnë më fort për vështirësitë që mund t'u sjellë!», — mendoi Vjollca.

... Ajo ishte nisur me Sulën nga Tirana pa dalë drita. Megjithëse kishte rënë për të fjetur vonë dhe qe çuar herët, e kishte ndier veten më të lehtë e më të gëzuar se çdo herë. Tani e kuptonte sa ta prishin lumturinë e jetës lëkundjet dhe ngacmimet e brendshme.

Për herë të parë i qe dukur i tepruar dhe disi qesharak shqetësimi i s'emës. Për herë të parë, pas shumë ditësh, pat guxuar ta vështronte në sy të atin. Qe ndarë prej tyre thjesht, sikur do të shkonte në leksione.

Gjithë rrugës kishte rënë shi, një shi i imtë, i ftohtë. Vetëm pasi kaluan urën e Matit dhe kthyen përpjetë, shiu u shndërrua në borë. Flokët e saj në fillim dukeshin të druajtur por, sa më lart ngjiteshin, aq më shumë dendësoheshin. Së pari, panoramat që parakalonin përtej xhamave të makinës dukeshin si të thinjura, pastaj u bënë gjithmonë e më të bardha e kur arritën në qytezë, gjetën tri pëllëmbë borë.

Qyteza i ishte dukur Vjollcës më e bukur se herën e parë. Bora kishte mbuluar dhe hijeshuar çdo gjë të vogël dhe të vjetër. Spikatnin më mirë godinat e reja shumëkatëshe, që lartësoheshin mbi skarpatin e majtë të rrugës.

Sapo arritën, ajo mësoi me shqetësim se rruga për në sektorin e pyjeve ishin bllokuar dhe se ndërlihdja telefonike me të qe ndërprerë. Sula shkoi të merrte vesh hollësisht në drejtorinë e sharrave. Kur u kthye i tha të mos mërzhitej, se ishin marrë të gjitha masat që rruga të hapej sa më parë dhe se do të nisej menjëherë një autokolonë në atë drejtim. Si shofer i vjetër dhe me eksperiencë i kishin propozuar të merrte pjesë në autoko-

lonë dhe ai kishte pranuar. Ai mendonte që Vjollca të rrinte në qytezë derisa të çelej rruga, se nuk i dihej asaj pune, mund t'u takonte të flinin rrugës, por ajo nuk pranoi. Ishte e vendosur të shkonte...

Tani po bëheshin përgatitjet e fundit të autokolonës. Para makinës së Sulës ndodhej një vinç i ndezur, skapamentoja e të cilit nxirrte tym në mënyrë ritmike. Ai do ta çante borën. Me këtë rast Vjollca mësoi se vinçi vlente edhe për atë punë, mbasi ishte makinë e rëndë dhe e kishte peshën përpara. Atje ku të mos mundej vinçi, do të përdornin traktorin DT me ruspë, të cilin ia kishin ngarkuar makinës së Sulës.

Nëpërmjet pasqyrës anësore Vjollca vuri re qysh erdhën e iu shtruan nga bishti autokolonës edhe dy makina të tjera, kështu që u bënë gjithsej gjashtë. Shofërët kontrollonin dhe përforconin zinxhirët. Disa punëtorë me lopata kishin zënë vend nëpër kabina.

Ndërkaq u çel dera në krahun e shoferit dhe Sula u fut përgjysmë në kabinë.

— Mos u mërzit, Vjollcë, se ja, po nisemi!, — tha buzagaz.

Në dorë kishte një pako. E çeli dhe nxori një ari të vogël prej gëzofi, me sy të kuq xhami.

— Ia kisha premtuar prej kohësh djalit!, — tha, duke ia zgjatur Vjollcës. — Të lutem, ma vendos diku bukur!

Arrite t'i marrësh në telefon? Si u bë djali?, — u interesua ajo.

— Vazhdon të ketë temperaturë!, — iu përgjigj Sula, duke zbritur nga kabina.

— Pse nuk na tregove që ke djalin sëmurë, kishim kërkuar ndonjë tjetër për andej nga sektori!, — e qortoi drejtori i sharrave, i cili qëlloi aty pranë.

— Se mos vetëm unë jam hallexhi sot!, — tha Sula, duke ia bërë me dorë. Pastaj e ktheu me shaka: — I kemi ndarë punët me gruan, shoku drejtor, ajo përgjigjet për djalin, unë për makinën!

Ndërkohë ia behu duke nxituar një djalosh i gjatë dhe i hollë, me pamje energjike.

— Gjithçka është gati, shoku drejtor!, — raportoi. — A mund të nisemi?

Drejtori e zuri për krahu dhe eci bashkë me të për-gjatë autokolonës, sikur deshi të bindej së vërtet gjith-çka ishte në rregull.

— Ju duhet të veproni me shpejtësi!, — e këshilloi djaloshin. — Vërtet po punojnë edhe ata të sektorit, por me krahe. Pastaj, të mos harrojmë se i janë hequr kaq burra prodhimit. Shokët e ministrisë më pyetën qysh në mëngjes në telefon për gjendjen. I sigurova se do t'ia dalim me forcat tona.

— Pa dyshim!, — tha tjetri.

— Nuk është kaq e lehtë, Prengë!

— E lehtë s'është, por edhe hera e parë s'është!, — buzëqeshi me besim në vetvete Prenga.

— Sidoqoftë, duhet mobilizim i fortë. A morët pjesë ndërrimi me vete?

— Kemi marrë karroofiçinën dhe pjesë ndërrimi si për makinat ashtu edhe për traktorët.

— Bukuri. Nisuni atëherë dhe dalshi faqebardhë!

— Drejtori i shtrëngoi dorën. — Si të organizojmë punën edhe për sektorët e tjerë, do të nisem mbas jush!

— Në kabina, burra!, — thirri Prenga dhe vrapoi te vinçi.

Sula u ngjiti në timon, fshiu duart me një shuk lec-kash dhe ndezi makinën, duke i buzëqeshur ariut prej gëzofi që Vjollca e kishte varur pranë xhamit.

U dëgjua boria e vinçit, ai u shkul nga vendi dhe çau ngadalë përpara, duke u përkundur e duke lënë pas në dëborë dy vrraga të thella, që sikur çmbështilleshin nga rrotat e tij. Nga buza e rrugës disa njerëz përshëndetnin me dorë. Kishte diçka solemne në nisjen e auto-kolonës së vogël, e cila doli nga qyteti duke parakaluar një varg makinash, të cilat dergjeshin të kallkanosura nën shtrojën e borës, disa në pozicione të çuditshme. Zhurma dhe lëvizja e autokolonës, si edhe një fjollë ty-mi që dilte nga oxhaku i një shtëpie, qenë të vetmet

shenja të dukshme gjallërie në atë pamje të bardhë, të qetë e të ngurtë.

Pas pak autokolona e la rrugën kryesore, kaloi një urë dërrase dhe filloi të ngjitej në një shpat të thepisur. Kjo rrugë ishte më e ngushtë e vende-vende me pjerresi të madhe. Nën të gjarpëronte përroi i Skabinës. Motorët filluan të zhurmonin fort. Ecej me marshet më të ulëta.

Gomat e pasme të vinçit gjithmonë e më shpesh xhironin në vend. Shoferi mundohej ta nxirrte makinën, duke bërë mbrapa-para dhe duke e shkelur gazin deri në fund. Motori zhurmonte fort, skapamentoja çirrej e shfrynte, rrotat mundoheshin të dilnin nga djepi prej akulli, spostoheshin majtas e djathtas dhe duke iu afruar herë-herë buzës së greminës, arrinin më në fund të dilnin, por më tej përsëritej e njëjta gjë.

Makinat, për t'iu shtëmangur çdo së papriture, e rritën largësinë ndërmjet tyre. Edhe ato xhironin, rrëshqisnin dhe spostoheshin, por secili shikonte rrezikun e makinës që kishte përpara, jo të vetin.

Sula, me muskuj e nerva të tendosura, ishte shkrirë e bërë një me makinën. Kishte harruar sëmundjen e djalit, vetën, bashkudhëtarët e gjithçka e me reflekset e fituara nga përvoja mundohej t'u përgjigjej të papriturave. Gjymtyrët e tij, sikur të ishin pjesë të gjalla të timonit dhe të levave të ndryshme, lëviznin me shkathësi.

Vjollca shtrëngonte fort mbajtësen dhe ndiqte e përqëndruar udhëtimin. Ishte e para herë që provonte emocione të tilla dhe në çdo të papritur zemra i rrihte fort. Që ta hiqte mendjen nga rreziqet e udhëtimit, u mundua të përfytyronte takimin me Bledarin.

Ajo nuk do të trokiste. Do të çelte derën me vrull dhe do të vërshonte brenda, bile pa shkundur as borën. Ai do të habitej. Ndoshta do të ishte duke pirë çaj. Ndoshta do të ishte rënë dhe do të fërkonte sytë se mos po shihte ëndërr. Pastaj do të flakte mbulesat dhe do të brofte në këmbë. Ajo do ta përqafonte fort...

Duke menduar kështu, Vjollca vështronte diku larg dhe buzëqeshte.

— Më duket se ti ke arritur në sektor!, — bëri shaka Sula.

Ajo ktheu kokën dhe qeshi.

— Kështu e ka mendja, gjithmonë arrin e para!, — tha pastaj.

Shtresa e dëborës sa vinte e bëhej më e trashë. Autokolona përparonte shumë ngadalë. Më në fund vinçi ngeci. Përpiqej të bënte përpara, duke ulërirë me të madhe, si ndonjë bishë e zënë në çark, por s'shkulej dot nga vendi. Rreth tij u grumbulluan punëtorët dhe shoferët. Sollën skorie me lopata, i futën degë nën rrota, pastaj filuan ta shtynin, duke thirrur njëzëri «hooohop, hooohop!» Dukej sikur rrotat do të zinin, por sakaq vërtitëshin bosh, duke flakur borë të ndotur me skorie. Copat e saj qëllonin njerëzit në rroba, në fytyrë, por askush nuk largohej.

Dikujt i rrëshqitën këmbët në gjurmët e rrotave, u rrëzua përmbys, por sakaq brofi në këmbë dhe nxitoi në vendin e vet. Një tjetri i ra mu në mes të syve një copë borë e fëlliqur. Ai u fshi me mëngën e peliçes, pështyu anësh dhe nisi të shtynte përsëri.

Vjollca vështronte nga dritarja dhe i vinte rëndë që rrinte duarkryq aty, në kabinën e ngrohtë. Ajo kishte dëgjuar për vështirësitë e transportit dimëror, kishte parë edhe ndonjë dokumentar a telereportazh me këtë temë por, gjithë ç'kishte formuar në imagjinatën e vet i dukej tepër e zbehtë në krahasim me ç'po shikonte. Habitej në vetvete pse Bledari nuk i kishte treguar për këto gjëra, por pastaj mendoi se ai qe mësuar me to dhe nuk i bënin përshtypje. Edhe ata njerëz që vërtitëshin jashtë të shqetësuar, thërrisnin dhe vepronin në atë tufan, kur të ktheheshin pranë familjeve të tyre me siguri që nuk do të tregonin asgjë, sepse për ata të gjitha këto ishin të përhershme, të rëndomta.

Vjollca çeli derën dhe kërceu jashtë. Sakaq e theri

në fytyrë thëllimi i ftohtë i ngarkuar me borë. Ngriti jakën e palltos dhe shkoi drejt grupit të njerëzve.

— Ju thashë, të kishim ulur traktorin dhe të printe ai, se nuk e kemi sjellë për nuse!, — i thërriste Prengës një djalosh me quka në fytyrë.

Vjollca njohu shoferin e makinës me defekt, ditën që iku ajo nga sektori.

— Prit, bre Ali Grenxa!, — tha Prenga urtë.

— Çfarë, që të biem në humnerë?! Ndoshta sharra ka për ju, por në magazinën e Parkut s'ndodhen koka rezervë shoferësh!, — bubullonte Aliu.

— Po të kishte, do ta kishin ndërruar menjëherë ty, se atë që ke e ke jashtëpërdorimit!, — ndërhyri në bisedë Sula.

Ali Grenxa ktheu kokën dhe e vështroi me inat.

— Po nuk mënjanuam vinçin, nga do të kalojë traktori, që të dalë përpara, Grenxë?, — buzëqeshi Sula.

— Ke të drejtë, brumbull!, — u tërhoq Aliu i zënë ngushtë.

— Shokë, ta shtyjmë edhe një herë vinçin!, — thirri Prenga.

Njerëzit u afruan sakaq. Që të bëhëj në një farë mënyre e dobishme, Vjollca shkoi të mblidhte degë për t'ia hedhur nën rrota vinçit. Shpejt filluan t'i mërdhinin këmbët dhe t'i ngrinin duart. Era fshikullonte gjithnjë e më fort faqen e shpatit, rrëmbente borën e imtë dhe e çonte drejt honit të luginës si ndonjë re të bardhë.

— Edhe ti paske dalë?, — e qortoi Sula, me ta parë.

— S'më rrihej në kabinë!, — u justifikua ajo.

— Ta dije kështu, ndoshta s'do të kishe qardhur, ë?, — buzëqeshi ai.

— Jo, përsëri do të vij!, — iu përgjigj ajo me vendosmëri.

— Mos u mërzit, edhe gjashtë kilometra na mbetën!, — vazhdoi Sula.

— Janë gjashtë të forta, se!, — tha Vjollca, duke treguar me dorë në drejtim të malit.

— Ku pyesim ne, i hamë me dhëmbë!, — ia priti Sula me vendosmëri.

Pas disa provash të mundimshme arritën ta mënjanonin vinçin. Sula u ngjit në timon, që të manovronte për shkarkimin e traktorit. Edhe Vjollca u kthye në kabinë. Tani e kuptoi sa ngrohtë dhe sa mirë ishte aty. Dëgjohej zhurma e këndshme e kaloriferit dhe shiheshin grimcat e bardha të borës të cilat ngjiteshin pareshtur në xhamat e makinës, duke u shndërruar në bulëza të imta uji që bashkoheshin me njëra-tjetrën në rrëke të vockla gjarpëruese. Që jashtë Ali Grenxa e drejtonte Sulën me shenja.

Vjollca u frynte duarve të skuqura dhe dridhej akoma nga të ftohtët, por e ndiente veten të kënaqur.

27

Murlani vazhdonte me rrëmbim. Traseja e sapoçelur kishte zënë një cipë të re bore dhe që mbushur anash prej saj. Dukej si një lug vigan, i stërgjatë. Megjithatë puna për çeljen e rrugës vazhdonte me vull.

— Më duket se po na e çon punën dëm!, — vërejti një sharrëxhi, duke vështruar me zemërim borën që binte.

— S'do të mundet!, — ia priti Ndreca, që punonte krah tij. — Ajo bjer e ne hiq, para nesh do të lodhet!

Megjithëse ishin bërryl më bërryl, sharrëxhinjtë jo vetëm që nuk e pengonin njëri-tjetrin, por punonin shpejt, ritmikiisht, si një mekanizëm i vetëm, i gjallë. Tehet e lopatave i ngulnin thellë në borë, pastaj i ngri- nin me hov dhe hidhnin anash copa të mëdha prej saj. Bora psherëtinte kur e thernin tehet dhe rënkonte butë kur binte anash. Në një skaj, pak përtej Ndrecës, punonte edhe Mrika. Ajo kishte lënë jashtë shamisë vetëm sytë. Përpiqej të mos mbetej mbrapa burrave.

— Mjaft punove këtu, merr Bardhokun dhe zbrit në sektor t'i ndihmosh Vatës!, — i tha Ndreca.

— Do të qëndrojmë këtu!, — ia priti Mrika e vendosur. — Atje s'kam lënë ndonjë punë mangut... Bardhoku na u rrit tashmë e ndoshta të dy bashkë bëjmë sa ç'do të bënte Frroku, po të ishte sot midis jush.

— Atëherë na u kujdes për zjarrin, se po na than ky murlani e kemi nevojë për të!, — i tha Ndreca i prekur.

E ndoqi me admirim Mrikën, e cila shkoi drejt zjarrit që kuqëlonte në një vend të mbrojtur, pastaj rrëmbeu lopatën duke thirrur:

— Mbi të, burra, se s'na qëndron dot!

Te zjarri Bardhoku po shtynte urët. Ca më tej një sharrëxhi po shkundte çizmet që i ishin mbushur me borë. Këmbët i kishte të lagura. I afroi pranë zjarrit dhe sakaq çorapet filluan të lëshonin avull.

— Do të të dhembin më fort ashtu!, — i tha Mrika, nxori nga xhepi shaminë e madhe me të cilën pat lidhur trikon e Bledarit, e grisi më dysh dhe ia zgjati sharrëxhiut. — Na i lër çorapet të t'i thajmë e mbështilli këmbët me këto!

— Pse e grise, moj burrneshë?!

— Hajt, se s'u bë kiameti, veç bëji si ç'të thashë!, — nguli këmbë ajo.

Sharrëxhiu e vështroi me mirënjohje dhe u bind.

Pak më tej Bardha po i mjekonte një djaloshi pëllëmbët e përgjakura nga litari.

— Tani ruaji mos të të lagen fashat, përndryshe do të të dhembin më fort!, — e këshilloi ajo.

— Veç në shpëtofsin për mrekulli!, — buzëqeshi djaloshi duke u larguar.

— A bëjmë disa dru, Bardhë?, — iu drejtua Mrika asaj dhe rrëmbeu sëpatën.

— Posi!, — miratoi Bardha dhe nxitoi të mbyllte cantën e ndihmës së shpejtë. A ma pe gjë babën andej, nga të Vukës?, — pyeti pastaj. — Lajmin ma çoi, por s'ma zunë sytë kund.

— Ka shkuar bashkë me Lulashin në qytezë, për të marrë disa vegla për traktorin!, — iu përgjigj Mrika.

«Mirashi? — shtangu vajza, sikur nuk u
zinte besë veshëve.»

28

Mirashi dhe Lulashi po i ngjiteshin një shpati shumë të pjerrët, pothuaj krejt të zhveshur, ku fshikullohin era dhe debora. Te jendane shtrihej një bardhësi e zymtë, kërcënuese, që dukej sikur kishte pushtuar tokën dhe qiellin. Nuk dalloheshin as fundi dhe as qafa e shpatit.

Mirashi printe. Ai nxitonte e nxitonte, me zverkun të nderur përpara, me supe të rrëzuara, si një bishë e plagosur që mundohet t'u shpëtojë ndjekësve. I merrej fryma, zemra i rrihte fort, por s'e ngadalësonte hapin. Shkelte me mat dhe pasiguri. Diku rrëshqiti, ra mbi një rrëmë, por u çua sakaq, me një përpjekje të dëshpëruar dhe vazhdoi ngjijtën.

Lulashi e përbalonte më lehtë të përpjetën, por e bluanin kaq shumë mendimet, sa nuk vështronte ku shkelte dhe hërë-hërë fundosej në borë ose rrëshqiste. Ngrigësinë që e ndante nga tjetri. E shikonte me keqardhje dhe mendonte:

«Po ikën prej meje si prej një ujku të tërbuar!... Të vështirë e ka, shumë të vështirë!... Sikur Bardha të ishte motra ime, si do të gjykoja, vallë? Sa gramë kemi akoma në kokë, megjithëse kanë kaluar kaq vjet? Ah, sikur të punonte ruspa e traktorit për t'i shkullur!... Veg, rie s'do të shkelim zemrat tona për hir të zakoneve të mbrapshta!»

Lulashi shkelte me duf dhe, pa e kuptuar, kishte nxituar hapin. E shkëputi nga mendimet një frymëmarrje e shpeshtë dhe e rëndë. Ngriti sytë dhe fare afër pa shpinën e Mirashit.

«Ky i ngrati, qenka lodhur sa s'mban!, — mendoi me keqardhje si për prindët e vet. — Është e kotë t'i pro-

pozoi të pushojë, s'ka për të pranuar!» — Ngadalësoi hapin dhe largësia ndërmjet tyre filloi të rritej përsëri.

«Mirashit i qe tharë pështyma, i merreshin mendtë, i zihej fryma. Çoi dorën te gryka, zbërtheu jakën e këmishës dhe zgjeroi qaforen e bluzës së leshtë. I dukej sikur nga çasti në çast do të përmbysjej. Herë-herë i mjegullohej vështrimi. Rrëmbeu kalimthi një grusht borë, lagu buzët, e kafshoi, pastaj fërkoj me të fytyrën. Vështroi përpjetë me dëshpërim. Qafa ishte akoma larg. Diku përpara dukej një bredh i vetmuar. Vazhdoi ngjitjen, duke vështruar me ngulm majat e gizmeve të veta, që dukeshin e zhdukeshin në borë, ndërsa mendimet i gëlonin në kokë.

«...Ta përze nga shtëpia? Po në marrtë rrugë të keqe?! Kanë për ta treguar me gisht si të bijën e Mirash Palit e turpi përsëri faqen time do të nxijë! Çllok pa shpëtim! Tani e kuptoj pse të parët i zgjidhnin ashtu këto leqe!...»

Mirashi arriti te bredhi dhe u ndal rrëzë tij. Ishte i shfytyruar nga lodhja e nga brenga. Gjoksi i hovte dendur. Lëpiu buzët e përzhitura, fshiu me mëngën e pelices vetullat e ngarkuara me borë dhe vështroi me bisht të syrit Lulashin. Ai kishte mbetur prapa dhe po ngjitej ngadalë, ritmikisht.

Mirashi nxori nga brezi sëpatën. Tehu i saj vezulloi ftohtë.

Lulashi e pa dhe vazhdoi rrugën me pamje të qetë. Bile sikur buzëqeshi pak.

Mirashi u kthye nga bredhi dhe filloi të priste disa degë, me goditje të sakta e të shpeshtë. Nga degët e sipërme filloi të shkundej borë, ajo i binte në kokë e mbi supe, por ai vazhdonte punën. Pastaj zgjodhi disa nga degët e prera, i bëri rrathë dhe i lidhi në këmbë. Nisi të ngjitej, duke i hedhur këmbët në një mënyrë qesharake. Secila prej tyre bënte një hark të madh anash, pastaj shkelte përpara. Mirëpo kështu ai nuk fundosej në borë dhe ngjitej me lehtësi. Mbas një copë here arri-

ti në qafë. Kërkoi me sy rreth e qark dhe shkoi drejt një druri të vetmuar, me degë të zhvilluara në njërën anë, si flamur. Preu disa degë, i shtroi mbi borë dhe u ul të çlodhej rrëzë tij. Pas pak arriti edhe Lulashi, i cili zuri vend aty pranë. Mirashi pothuaj i ktheu krahët, me një pamje të ngrirë e të zymtë. Veçse me bisht të syrit e përgjonte, sikur diçka priste. Sapo Lulashi nxori kutinë e duhanit dhe u mat t'ia zgjaste, ai nxori me shpejtësi të vetën, duke kthyer kokën mënjane.

Ata drodhën ngadalë cigaret, secili nga kutia e vet dhe vështronin kreshtën, që dukej si një dallgë e bardhë e stërmadhe. Murlani vazhdonte duke sajuar mjegullnaja bore.

Mirashit nuk i ndizeshin shkrepëset. Lulashi i ofroi të vetën. Ai nuk e mori. Vazhdoi të provonte, duke i flakur kunjat në borë, derisa njëra u ndez. Pastaj thithi me lakmi tymin e cigares, duke e mbrojtur në grusht nga era.

Pasi flakën bishtat e cigareve, Lulashi nxori nga trasta një qese me sheqer. E mbajti një çast në dorë, sikur hezitonte, pastaj i tha bashkudhëtarit:

— Merre një grusht sheqer, baca Mirash, të jep fuqi!

Tjetri ktheu kokën vullshëm, e vështroi me inat dhe bubulloi:

— Fëmijët ëmbëlsohen me sheqer! — Hovi në vend dhe ia ktheu më fort shpinën.

Lulashi hodhi në gojë një grusht sheqer. Pastaj nxori shishen e konjakut, përsëri hezitoi një çast, por së fundi vendosi të provonte edhe një herë.

— Ndoshta pranon disa hurpa konjak!, — iu drejtua si me lutje, por krenar. — Kjo veç për burra është!

— A thua ke më në atë trastë?!, — ia priti Mirashi me shpoti, pa e kthyer kokën.

— Burri, ç'ka në trastë e ndan me shokë!, — vërejti Lulashi rreptë. — E, veç prej armikut s'merret gjë!

— Ndonjëherë është e vështirë ta dallosh armikun

prej mikut!, — tha Mirashi me nënkuptim. — Pritës së armikut i ruhesh, por ç't'i bësh thikës mbas shpine të atij që të hiqet si mik?!

— Unë s'ia kam fatur kujt thikën mbas shpine, ore Mirash Pali!, — foli djaloshi, i fyer. — E, deri ditën e sotme, s'ia kam kurrkujt borxh!

— S'kemi dalë sot në kreshtën e Majës së Keqë për të bërë llogaritë!, — bubulloi Mirashi duke brofur në këmbë. — Tjetër punë na bashkoi e njëherë për njëherë, — ai i mëshoi fort kësaj fjale, — duhet të ndahemi me faqe të bardhë!

Ata vazhduan marshimin. Tani shtegu takonte mëtopostë, në një faqe të pjerrët, me shkurre të rralla, lakuriqe. Era drithëronte degëzat e tyre. Sipërfaqja e borës kishte ngrirë dhe ata nuk fundoseshin më. Vende-vende thembrat e çizmeve nuk arrinin ta çanin koren dhe ata rrëshqisnin, rrëzoheshin, dhe vazhdonin zbritjen gjithmonë më me vështirësi.

Diku Mirashi u ul në borë dhe zbathi çizmet, i rراسi në trastë dhe vazhdoi zbritjen në çorape. I riu ndoqi shembullin e tij. Një copë herë zbritën pa rrëshqitur, por këmbët filluan t'u mërdhinin. U dukej sikur ua shponin gjilpëra të panumërta. Megjithatë, asnjëri nuk u ankua.

Flokët e borës fluturonin me shpejtësinë e veriut, pothuaj paralelisht me faqen e shpatit dhe sikur u jepnin trajtë të dukshme rrymave të erës. Vende-vende ato formonin vorbuj. Lugina nuk dallohej. Shpati i ngjante një shkretëtire të bardhë, pa anë e pa fund. Nën fshikullitjen e gulsheve të erës lastarët e kaçubeve dridheshin, përpëliteshin, përkuleshin, përplaseshin me njëri-tjetrin dhe zhurmonin.

Të dy udhëtarët e kishin gjithnjë e më të vështirë. Bora u qe ngjitur si rrodhe në jakat me gëzof, në kapuçat e leshtë, e qe grumbulluar në skutat e veshjes dhe u kishte ngrirë mbi vetulla. Sytë, sado që i mbanin të picërruar, për t'i mbrojtur nga gjilpërat e borës, u dhembnin e u lotonin. Duhej të mbanin duart para hundës ose t'i kthenin shpinën erës, që të mund të ngopeshin me

frumë. Këmbët tani nuk u mërdhinin, por u digjin, sikur shkëlqimin mbi prush. Mezi mbaheshin në këmbë, se përsëri rrëshqisnin. Çorapet kishin zënë përfund një cipë akulli. Disa herë u munduan t'i qëronin, por duart u qënë ngathtësuar dhe s'u bindeshin. Kurse cipa e akullit, sa e qëronin, formohej përsëri.

Diku Mirashi u ul mbi borë dhe i veshi përsëri çizmet. Edhe tjetri veproi ashtu. Filluan të lëshoheshin më tëposhtë me rrëshqitje, duke u kapur pas shkurreve. Por shpati bëhej gjithmonë e më i pjerrët dhe shkurret më të rralla.

Më poshtë shpati ishte krejt i zhveshur. Sipërfaqja e valëzuar e borës kishte një shkëlqim të ftohtë, metalik. Në gungat e rralla të saj mund të ishin shkurre ose gurë, por nuk dalloheshin. Vetëm ndonja dyqind metra poshtë, atje ku ishte buza e shpatit, shquhej një dëllinjë e madhe, degët e së cilës nxinin nën gunën e bardhë.

Ata të dy qëndruan. Secili mendonte të njëjtën gjë, por priste fjalën e tjetrit.

— Duhet rrëshqitur drejt saj, nuk ka rrugë tjetër!, — tha më në fund Lulashi, gjoja i qetë. Pastaj bëri të lëvizte me kujdes tërthorazi shpatit, që të dilte pingul përmbi të.

— Prit!, — e ndaloi rreptë Mirashi. — Do të lëshohem unë i pari. Pak përtej dëllinjës është humnera e Përroit të Kuq.

— Sipas zakonit të malësisë, në shtegtim burrat prijnë me radhë!, — tha Lulashi.

— Bukur i dike disa zakone të malësisë!, — vërejti me ironi Mirashi, duke i mëshuar fjalës «disa».

— Ato të mirat duhen ditur e ruajtur!, — ia priti Lulashi.

— Zakonët janë zakone, siç është baba babë!

— Edhe babës i duhen vënë në dukje të këqijat!

— Unë të solla këndeje dhe më takon të rrezikoj i pari, — i dha fund Mirashi idhnak.

Mirashi doli sakaq mbi dëllinjë, iu mat mirë, sikur u tkurr, pastaj me një lëvizje të beftë u lëshua poshtë. Rrëshqiste gjithmonë e më shpejt, duke luajtur

krahët e duke hepuar trupin sa në njërën anë, në tjetrën; dukej sikur he-he do të rrëzohej, por e mbajti drejtpeshimin deri në fund, arriti te dëllinja, u përplas në të dhe u kap fort pas degëve, pa pyetur se halat e tyre iu ngulën në mish. Pastaj mbështeti fort këmbët rrëzë shkurre, drejtoi trupin dhe fshiu në peliçe duart e përgjakura, në pritje të tjetrit.

Lulashi u lëshua pa ngurruar. Një copë herë rrëshqiti mirë, por diku e humbi drejtpeshimin, u rrëzua dhe filloi të rrëshqiste herë me kokë e herë me këmbë përpara. U mundua të kthehej përmbys dhe ta frenonte shpejtësinë, duke ngulur në borë thonjtë, bërrylat, majat e çizmeve, por më kot. Dëllinja po afrohej me shpejtësi diku në të djathtë.

Në sytë e Mirashit vetëtiu një shkëndijë keqdashëse, por u shua sakaq. Ai lidhi fort këmbët pas dëllinjës dhe, kur pa se Lulashi po afrohej, u hodh me duart të zgjatura drejt tij.

Lulashi ndjeu se diçka e mbërtheu për dore, ai bëri një hark dhe u ndalua pranë dëllinjës, bash në buzë të greminës. Një hop nuk e kuptoi ç'ndodhi. Ngriti kokën. Pa dëllinjën që nxinte sipër tij dhe Mirashin që shtrihej prej saj, deri tek ai e që ia shtrëngonte fort krahun. Fytyra mezi i dallohej, sepse e kishte pothuaj të zhytur në borë.

— Kujdes, ngadalë!, — thirri ai mbyturazi. — Mendo-hu të kapesht pas rrobave të mia dhe tërhiqu lart.

Lulashi ia dëgjoji këshillën dhe, duke mos kursyer bërrylat, thonjtë e madje mjekrën, u zvarris ngadalë dhe arriti të kapte një degë të dëllinjës. Halat iu ngulën në pëllëmbë, por e shtrëngoi sikur të ishte e veshur me pambuk.

Pas pak ata qëndronin pranë njëri-tjetrit, me këmbë të mbështetura fort në anën e sipërme të dëllinjës.

— Rrezikove shumë, baca Mirash!, — tha Lulashi, me zë të ngrohtë e mirënjohës, duke vështruar greminën që shtrihej përtej dëllinjës.

Mirashi heshti një hop, pastaj e vështroi me bisht

të syrit, buzëqeshi pak me krenari dhe tha duke u mëshuar fjalëve:

— Ishe në besën time! E, Mirash Pali s'e pret në besë Partinë... ore mec!

Ata vazhduan rrugën tërthorazi shpatit. Mirashi bën-te shkallina me sëpatë në vendet e rrezikshme. Dalngadalë, ku duke u zvarrisur e ku duke prerë shkallina, arritën në një vend më të rrafshët. Aty era kishte grumbulluar shumë borë, por atyre u dukej sikur shkelnin në pambuk. I ranë qark e qark humnerës dhe dolën në anën tjetër.

— Po vjen autokolona!, — thirri me gëzim Lulashi, duke treguar me dorë drejt qafës karshi.

Mirashi vuri dorën strehë mbi vetulla dhe dalloi varganin e makinave që përparonin ngadalë. Në krye ndodhej traktori dhe bora sikur shkumbëzonte përballë tij.

— T'i biem andej, ndoshta na i kanë sjellë tubat e hidraulikut!, — tha Lulashi.

29

Autokolona ishte ndalur nja dyqind metra nën qafë, ndërsa traktori pothuaj e kishte çelur trasenë deri atje. Pritej që ai ta kapërcente qafën e pastaj makinat do ta merrnin të përpjetën me vrull.

Në kabina pothuaj s'kishte mbetur njeri. Tek-tuk futej ndonjëri, sa për t'u ngrohur pak, ose për të thithur me ngut një cigare, se jashtë nuk të linte era ta pije. Edhe Vjollca, sado që i kishin thënë disa herë të kthehej në kabinë, mendohej të ndihmonte me diçka. Njerëzit shkonin e vinin nëpër trasenë e sapoçelur, duke shpërndarë skorie me lopata.

Shpati që ngrihej në të majtë të rrugës ishte shumë i pjerrët dhe pothuaj i zhveshur. Afër majës, në një skërkë shkëmbore ngrihej një kullë e vjetër dykatëshe, dritaret e vogla të së cilës vrojtonin qetësisht përmbi

luginat, humnerat, shkëmbinjtë dhe qafat rreth e qark. Që andej kishte zbritur ai malësori plak, me shami të kuqe lidhur përmbi veshë, i cili sillej mes njerëzve të autokolonës me një pagure me raki në dorë.

— Pijeni nga një hurpë, bre burra!, — i nxiste ai njerëzit, duke u zgjatur paguren e drunjtë. — Po punoni përbri shtëpisë sime dhe nuk urdhëruat makar për një kafe!

— Ti po e shef vetë, bacë!, — tha Sula duke marrë paguren.

— Po, po, valë e madhe sot!, — tundi kokën malësori.

Ndërkaq traktori e kishte kaluar qafën. Vazhdonte të binte borë dhe përmbi skorie po shtrohej një cipë e re.

— O burra, të kapim qafën, përndryshe do të na shkojë mundimi kot!, — dha kushtrim Prenga.

Shoferët nxituan drejt kabinave. Të tjerë u nisën në këmbë. Vjollca ecte buzë trasesë dhe sodiste me një farë ankthi humnerën e bardhë që shtrihej nën të. Vorbujt e borës e fshihnin fundin e saj dhe të bënin të mendojë se ajo ishte shumë e thellë. Ndërkaq u dëgjua uturima e motorëve, që po ndizeshin njëri pas tjetrit.

Vinçi u nis duke shtuar shpejtësinë. Diku rrëshqiti, diku u spostua, por ia arriti ta kapërcente qafën. I dyti vinte Sula. Edhe ai e nisi makinën përpjetë, duke shkelur gazin deri në dërrasë. Fillimi shkoi mbarë, por pak pa arritur qafën shpejtësia ra dhe rrotat nisën të xhironin. Sula shkeli freksionin, i futi me shpejtësi marshin mbrapa, shtyu levën e bllokazhit të motorit dhe u zmbraps me kujdes te vendi i nisjes.

— Mos rrëziko kot!, — i thirri Aliu, kur Sula po matej të nisej rishtazi. — Më mirë të sillnim traktorin!

— Çudi, si mund të dalin mendime kaq të ndritura nga një kokë grenxe!, — bëri shaka Sula. — Hajde, luaj pra!

Pas pak traktori u afrua së prapthi. Lidhën kavon, e siguruan mirë, pastaj Aliu dha shenjën e nisjes.

Sula ndezi makinën dhe i futi marshin. Traktori u nis, kavoja u tendos, Skoda u shkul nga vendi me kolpo dhe filloi të ngjitej dalngadalë, por me siguri. Rrotat vërtiteshin herë-herë bosh, por ndërkaq e tërhiqte traktori dhe ato zinin përsëri.

Diku makina përparoi vetë një copë dhe kavoja u li-rua, sado që traktori e shtoi shpejtësinë. Në atë kohë makina rrëshqiti përnjëherësh, kavoja u tendos me kolpo dhe u këput, duke fshikulluar ajrin. Skoda nisi të shkonte mëtëposhtë, duke u spostuar herë nga shpati dhe herë nga gremina.

Vjollca klithi dhe mbylli sytë. Prenga thirri «nga shpati, Sulë!» Aliu flaku nën rrota peliçen e vet. Disa vrapuan me lopata plot skorie.

Sula manovroi me timon, frena dhe marshe, ndër-sa shikonte në pasqyrën përballë si afrohej herë shpati dhe herë gremina. Arriti ta mbante drejtimin dhe ta pakësonte shpejtësinë. Më në fund makina u ndalua bash përmbi greminë.

Njerëzit arritën pothuaj bashkë me të. Fytyrat e tyre ishin akoma të tronditura. Një shofer solli me nxitim krikun e vet dhe ia ngjeshi në gomën e pasme, në vend të gurit.

Sula karikoi frenat e dorës, pastaj u vonua pak në kabinë që të përmblihte veten. I shkuan sytë tek ariu i vogël prej gëzofi që ishte përmbysur te këmbët e tij. E ngriti, e fshiu me kujdes dhe e vendosi në vendin e vet me një buzëqeshje të lodhur. Pastaj çeli derën dhe zbriti.

Prenga e kapi nga njëra dorë, Aliu nga tjetra. Vjollca sa s'iu hodh në qafë. Të tjerët i rrihnin shpatullat, i zgjatnin dorën, e kapnin nga peliçja dhe e uro- nin të gëzuar.

— Hë, ç'më prekni e ç'më vështroni kështu?!, — i qortoi Sula me shaka. — S'jam hija, por bash Sula, me gjithë lecka! Jemi kockë e fortë ne, jo greminës, por edhe dreqit i ngecim në fyt!

— Rrezik i madh qe, bre burra!, — tundte kokën malësori plak.

— Qofshin të shkuara!, — tha një punëtor.

— Sulë, e paske pasur të gjatë, orel!, — bënte shaka Ali Grenxa.

Sula bashkë me të tjerët shkuan dhe kontrolluan më imtësi pozicionin e makinës, e siguruan mirë, pastaj e lidhën me kavo dyfish pas traktorit. Pas pak Skoda e kishte kapërcyer qafën dhe traktori u kthye të merrte makinën tjetër.

Kur dolën përtej qafës të gjitha makinat, ata të autokolonës e falënderuan malësorin plak dhe e këshilluan të kthehej në kullën e vet, se bënte shumë ftohtë dhe ai ishte burrë i vjetër. Malësori nuk pranoi. Tha se do t'i shoqëronte deri te qafa tjetër, sipas zakonit të malësisë.

— Na trego të drejtën, bacë, a beson zot?, — e pyeti Ali Grenxa, ndërsa po ngjiteshin të gjithë bashkë drejt qafës.

— Pse po më pyet?!, — u vrenjt ai.

— Sepse kur rrëshqiti makina, m'u duk sikur ia përmende emrin!, — buzëqeshi Aliu.

Plaku futi gishtërinjtë nën shami dhe kroi kokën mendueshëm.

— Paske pasur veshë të hollë!, — vërejti. — Po, është e vërtetë, ia përmenda emrin. Më ndodh shpesh kështu, sidomos në rreziqe, megjithëse nuk e besoj.

— Sinqerisht e ke?, — e ngacmoi Sula.

— Krejt pa hile!, — tha malësori. — Bile, së pari ma ka nxjerrë nga zemra zotin ish-prifti i fshatit, një farë dom Shtjefni.

— Prifti?!, — u çudit Vjollca.

— Po, po, bash prifti!

— Si është e mundur kjo?

— Po jua tregoj unë si. Atëherë na e kishin mbushur mendjen se fara e pabekuar nuk jep prodhim të mbarë, prandaj para mbjelljeve, ditën e caktuar nga prifti, mblihdeshim në oborrin e kishës gjithë kryefa-

miljarët, me nga një grusht prej çdo lloj fare lidhur në shami. Prifti nxirrte te dera një tryezë, shtronte mbi të defterët dhe nuk na i bekonte farërat po të mos kishim shlyer hakun e kishës, një lloj takse nga ajo mori taksash që paguanim. Lëshonte pe vetëm kur hynte ndonjë dorëzënës nga ata me gjendje të mirë. Në vitin tridhjetë e shtatë, ndërmjet kryefamiljarëve qëllloi edhe një grua. Quhej Marë. Ia kishin vrrarë të shoqin për punë gjaku dhe ajo përpushej t'i rriste vocërrakët me krahët e vet. Nuk e kishte shlyer hakun e kishës, se s'i dilte misri as për bukën e kalamajve. Iu lut priftit t'ia bekonte farën, se do t'ia shlyente të gjitha mbas korrjeve të atij viti, por ai nuk pranoi pa dorëzënës. U kthye nga kryefamiljarët dhe u lut që të hynte dikush dorëzënës për të, por ata të kullave të para s'deshën, kurse në të tjerët ishim në hall për vete. Iu lut përsëri priftit, i tha se zoti duhej t'u jepte e jo t'u merrte jetimëve të saj, por ai e kërcënoi me mallkim për ato fjalë. Atëherë Mara u zemërua keq, çoi kokën dhe me sytë prush i bubulliu priftit: «Kurrë mos i bekofsh! Hambarët e Ali Agës s'kanë mbetur asnjëherë bosh, megjithëse nuk i bekon farërat në kishë. E pra, në më punofshin krahët, vocërrakët e mi do të kenë misër edhe prej farërash të pabekuara!» — Qysh atë ditë prifti dhe zoti i tij u thyen në zemrën time, si një xham që e zë plumbi. Por copat ngelën. Këto po na i heq dora e Partisë, megjithëse nuk qenka e lehtë të pastrosh të gjitha skutat. Kështu, bre burra!

— Vërtet, kohë të errëta kanë jetuar bjeshkët tona!,
— vërejtji Prenga, duke tundur kokën mendueshëm.

Duke biseduar, pa e kuptuar arritën në qafë. Atje gjetën makinat, të renditura njëra pas tjetrës. Në pritje që traktori të çelte trase të re, shoferët se ku kishin gjetur ca shkarpa dhe po ndiznin zjarr në një vend të mbrojtur. Traktori përparonte mirë, se rruga vazhdonte mëtëposhtë.

— Po ngjiten drejt nesh dy njerëz!, — tha Sula, duke treguar me dorë në drejtim të traktorit.

— Me siguri vijnë nga sektori!, — vërejtjti Prenga.

— Ndoshta për manikotën e hidraulikut!, — tha njëri nga të karroofiginës. — Nga ecja, ai i majti më duket si Lulashi.

— Ai është!, — e përforcoi Prenga. — Kurse tjetri më ngjan si Mirash Pali.

Pas pak ata të dy arritën te zjarri. U përqafuan me shokët, sikur të kishin vite pa u parë.

— A mërdhiehët, shokët, a u lodhët shumë?

— Diçka!

Ata të autokolonës u grumbulluan kokë më kokë rreth Mirashit e Lulashit, të cilët mezi ua dilnin pyetjeve të shumta.

— Për manikotat e hidraulikut mos u bëni merak!, — i qetësoi Prenga. — Jua kemi sjellë fringo të reja.

— Hë, më ju lumtë!, — u gëzua Lulashi. — A po na i jepni?

— Prit njëherë, bre burrë! Pushoni pak, ndizni nga një cigare prej nesh, pastaj...

— Jo, jo, do të nisemi, se shokët punojnë me krahë!, — nguli këmbë Lulashi.

— Si të duash, veç baca Mirash do të qëndrojë me ne!, — tha Prenga.

— S'kam sesi, më kanë caktuar ta shoqëroj, s'mund të kthehet vetëm!, — kundërshtoi Mirashi.

— Atë do ta shoqërojë një nga xhenerikët e karroofiginës, se prandaj kanë ardhur!, — tha Prenga. — Ty të takon të qëndrosh me ne, si zot shtëpie, se kemi hyrë në kufirin tuaj.

— Kanë të drejtë, o Mirash Pali, zakoni kështu e kërkon!, — tha malësori me shami të kuqe.

Mirashi ngriti supet i çarmatosur.

— Vjollcë, më mirë shoqëroje bacën Mirash në kabinën tuaj, se ky zjarri i shoferëve u fik para se të ndizej!, — bëri shaka Prenga.

Mirashi u kthye dhe pa me habi vajzën, që nuk e kishte vënë re deri atëherë. Sakaq Prenga zuri për kra-

hu Lulashin dhe shkoi me të drejt karroofiçinës, duke vazhduar ta pyeste për andej, nga sektori.

— Po ti, moj bijë, me këtë e gjete të ktheheshe?!, — e pyeti Mirashi, ndërsa po i afroheshin makinës.

— Për të ardhur kisha, pastaj, meqë Bledari është i sëmurë...

— Bledari s'është vetëm, moj nuse!, — vërejti ai.

30

— Inxhinier, ndërroji çorapet!, — iu drejtua atij Frroku, duke i zgjatur një palë çorape të leshta, të qëndisura me ngjyra të ndezura. — Merri, të lutem, janë të reja!

Bledari, që po thante këmbët pranë zjarrit i mori duke e vështruar me mirënjohje. Frroku vendosi trastën në vendin e mëparshëm dhe vazhdoi qërimin e degëve të drurit të rrëzuar. Këmbët i kishte mbështetur aq fort mbi trung, sa dukej si ndonjë degë e gjallë e tij. Gjoksi i zgjerohej kur ngrinte sëpatën lart, i tkurrej dhe i nxirrte një ofshamje fishkëlluese, kur tehu vërsulej më tëposhtë. Dukej sikur fishkëllente ajri nga shpejtësia e goditjes. Sa herë godiste, kafshonte buzën e poshtme, ndërsa dhëmbët i zbardhnin kërcënueshëm. Flokët i hovnin ritmikisht mbi ballë. Sytë i shkëlqenin si të ndezur nga një flakë e brendshme.

«Njerëz të mirë, njerëz të fortë!, — mendonte Bledari duke e admiruar. — Pse thonë, i fortë si guri? Pse thonë, i mirë si buka e nxehtë? Do të ishte më e drejtë të thuhej, i fortë si njeriu, i mirë si njeriu, si njeriu i vërtetë!...»

Vuka dhe Lleshi po zvarrisnin me mundim një trup të qëruar drejt qafës. Që aty fillonte një lug bore, i cili zbriste më tëposhtë shpatit të zhveshur, në drejtimin e pjerrësisë më të madhe, deri te skelja e ngarkimit. Përbri saj dukej traseja e sapoçelur, si një lug vigan.

Bledari dëgjonte thirrjet e tyre «hooo-hop, hooop-

-hop!» shikonte se si tendoseshin krahët e sharrëxhinjve, si zhyteshin çizmet e tyre në borë, ndërsa trangu lëvizte ngadalë përpara, vende-vende, me pëllëmbë. Vukës herë pas here i rrëshqiste capina nga dora. Dukej se nuk i urdhëronte gishtërinjtë. Ai zemërohej, provonte përsëri, por pa dobi. Dikur iu bind Lleshit, që diçka po i thoshte dhe erdhën të dy drejt zjarrit.

Fryu një gulsh i fortë ere. Kurorat e drurëve filluan të lëkundeshin. Së larti u shkundën disa copa bore. Njëra prej tyre ra në zjarr, ai u fashit një çast, pastaj flakët morën hov përsëri. Bledari vështroi me shqetësim përpjetë.

— Mos ki merak, këtu nuk rrëzohen drurët, se mbështesin njëri-tjetrin!, — i tha Vuka, duke afruar te zjarri duart e skuqura e të enjtura nga të ftohtët.

— Po, edhe drurët mbajnë njëri-tjetrin!, — vërejti Bledari, duke buzëqeshur. — Të rrepta këto bjeshkë, Vukë, ë?, — tha pastaj.

— Të rrepta, por s'i ndërroj të më falësh botën!, — u përgjigj ai dhe vështroi përçark, si të donte të përçafonte me vështtrim atë mori kreshtash, luginash e pyjesh që zbardhëllonin tejdanë. — Llesh, a kthehemi në punë, së më gjatë zjarri na zbut e na plogështon?!, — iu kthye pastaj shokut.

Ata zbritën pranë trungut, rrokën capinat dhe u dëgjuan përsëri thirrjet e tyre «hooo-hop, hooo-hop!». Druuri zvarrisej tani më shpejt dhe pas pak e nxorën te gryka e lugut. E shtynë një copë më tëposhtë, gjersa mori shpejtësi, pastaj qëndruan dhe e ndoqën me sy, tek shkante si shigjetë nëpër lug.

— Hajt, udhë mbarë!, — buzëqeshi Vuka. — Tjetrin! Sakaq u dëgjua një zhurmë traktori. Ata u vunë të përgjonin, por zhurma u ndërpre. Një hop u bë heshtje. Dëgjohej vetëm kërkëllitja e degëve që lëkundeshin nga era. Pastaj zhurma e traktorit filloi të dëgjohej përsëri, më e fortë dhe pa ndërprerje. Atyre u qeshi fytyra.

— U kthye Lulashi!, — tha Vuka me gëzim.

Traktori ngjeshte ruspën në ballin e borës, e shtyn-te dhe ajo qërohej si lëvore e trashë, rrëshqitëse në llamarinën e çeliktë, kthehej e mbështillej në trajtë ruli, i cili vinte duke u rritur, i shoqëruar me rritjen e uturimës së motorrit. Kur zinxhirët fillonin e bluanin në vend, Lulashi e zmbrapste traktorin, pastaj e lëshonte përpara, me shpejtësi.

Mbrapa traktorit çmbështillej rruga e çelur, si një llogore e stërgjatë, me faqe të larta, të bardha dhe me rrafshin të vijëzuar prej thikave të zinxhirëve. Gjatë saj punonin grupe-grupe sharrëxhinjtë. Ata rregullonin me lopata skarpatet, vendet e ndërrimit dhe skelet e ngarkesës.

Tehet e çelikta nguleshin me shpejtësi në borë, duke bërë «fësh-fësh», dhe e flaknin me shpejtësi anash. Fytyrat e njerëzve ishin të skuqura. Sytë u shkëlqenin. Nga gojët u dilnin gulshe avulli.

— Forca Lulash, se ngelëm pa front pune!, — i thirri Ndreca në çastin që ai po ndërronte marshin. — Ti me ruspë, ne me lopata dhe të arritëm!

— Unë jam një, ju shumë!, — ia priti Lulashi, duke treguar me dorë morinë e sharrëxhinjve.

Ai e kishte dorën të lidhur me një pece të murme.

— Por ti ke shaluar pesëdhjetë e katër kuaj!, — tha dikush.

— Ç'e paske mbështjellë dorën me ato zhele?, — pyeti Ndreca.

— E preva pak kur po montonim ruspën!, — iu përgjigj Lulashi dhe u mat të fuste marshin.

— Shko mjekoje, se do të të infektohet!, — i tha Ndreca. — Kemi Bardhën këtu.

— S'ia kemi vaktin tani!, — kundërshtoi Lulashi.

— Tek e ke ortakun, lërja atij traktorin!, — nguli këmbë Ndreca, duke treguar me dorë xhenerikun e traktorëve, që ndodhej bashkë me Lulashin në kabinë.

— Duart s'na duhen vetëm për sot!

Lulashi s'pati nga t'ia mbante, ia lëshoi vendin shokut dhe kërceu nga zinxhirët, i ngatërruar. Kërkoj me sy rreth e qark, e gjeti Bardhën dhe shkoi drejt saj, me një pamje gjoja të qetë dhe indiferente.

— Lulash, ku ma le babën?, — pyeti ajo me ankth, ndërsa po i pastronte plagën.

— Është mirë!, — ia priti ai. — Mbeti me autokolonën. Kur të bashkohen frontet do ta takosh.

Ajo sikur u tkurr nga druajtja. Uli kokën dhe nisi t'ia lidhte plagën me fashë.

— Po u trembke, hë?, — buzëqeshi Lulashi.

— Baba është malësor i vjetër dhe e ka të vështirë!, — tha ajo, me zë të ulët. — Unë nuk i trembem, por më vjen keq për të. E dua fort, se, megjithatë, ai është shpirt njeriu.

— E di!, — miratoi Lulashi me kokë. — Te humnera e Përroit të Kuq më shpëtoi jetën.

Bardha ngriti kokën me vrull dhe e vështroi me ca sy të zmadhuar nga habia. Skajet e fashës i shpëtuan nga dora. Lulashi e lidhi vetë nyjen e dytë dhe u largua duke buzëqeshur.

32

Autokolona iu afrua përsëri traktorit që çante borën dhe sikur e nxiti. Ai hovi përpara me vrull dhe grumbulli përpara ruspës u rrit e u rrit, pastaj u shemb diku, nën skarpatë.

Stuhia që fashitur disi dhe uturima e motorëve jehonte më fort. Nga diku përballë vinte valë-valë edhe zhurma e traktorit të frontit tjetër.

Vjollca la për një çast punën, u mbështet në bishtin e lopatës dhe vështroi andej.

— S'po t'u pritka ë!?, — buzëqeshi Mirashi, i cili po çante një cung pishe aty pranë. — Ke të drejtë, moj bijë, Bledari është për t'u dashur! Yt atë paska qenë burrë me mend që të gjeti të tillë burrë!

— Jemi njohur vetë!, — e korrigoji Vjollca buza-gaz.

— Ashtu, ë?, — sikur u zhgënjye Mirashi. — Sido-
qoftë, ju jeni njerëz me shkollë dhe dini të zgjidhni.

— Në këto punë s'hyn shkolla, po zemra, baca Mi-
rash!, — tha Vjollca.

— Zemra pa kokën s'vlen një grosh!, — e mbylli
bisedën Mirashi dhe vazhdoi të çante me inat cungun e
pishës.

— Për të ndezur zjarrin po i bën?, — e pyeti Vjoll-
ca, më fort që ta pajtonte.

— Jo, për pishtarë, për të bërë dritë!, — sqaroi Mi-
rashi i vrenjtur. — Ndonjëherë hyn në punë edhe men-
dja e të parëve!

— S'thotë kush jo, more baca Mirash!, — buzëqeshi
Vjollca.

Moti ishte qetësuar. Dëgjohej bora që ndrydhej e kër-
ciste nën hapat e njerëzve. Në masën e hirtë të reve
ishin krijuar disa të çara, ku dukej qielli me një ngjy-
rë të errët të plumbtë. Drurët buzë rrugës dukeshin të
lodhur, të dremitur, sikur përgatiteshin të flinin, me
kokët të mbështetura te njëri-tjetri. Drita nuk ishte
më e ashpër, e bardhë-verbuese, por e butë, disi kaltë-
roshe. Hijet ishin dendësuar. Hollësitë po fshiheshin pas
tyre. Shquanin mirë vetëm trajtat e mëdha, të rrumbul-
losura. Ngjyrat po treteshin me njëra-tjetrën. Po binte
muzgu.

Pas një copë here në ballin kundruall kuqëluan di-
sa drita dhe Vjollca vështroi përsëri andej.

— U ndezën pishtarët!, — sqaroi Mirashi.

— Qenkemi fare afër!, — vërejti Vjollca.

— Ashtu duket, por është edhe një copë deri atje!,
— tha Mirashi.

Bashkë me errësirën po shtohet edhe të ftohtët.
Vjollca ngjeshi mirë përmbi veshë kapuçin dhe shtrën-
goi shallin. Bashkë me uturimën e traktorëve, era sillte
me vete edhe zhurmat e veçanta të natës së bjeshkëve.

Vuka dhe të tjerët, që e kishin kryer detyrën dhe po nguteshin të bashkoheshin me shokët e sektorit, dolën në majën e kodrës, përmbi rrugë. Nga lart të dy frontet dukeshin si në pëllëmbë të dorës. Kishte mbetur vetëm një copë e vogël ndërmjet tyre. Kjo dukej qartë nga pishtarët që kuqelonin me shumicë në të dy krahet. Dëgjoheshin uturima traktorësh e makinash, si edhe britma e thirrje.

— Nxitoni, burra, të arrijmë para se të kërcasë pushka e ngadhnjimit!, — tha Vuka dhe u turr i pari më tëposhtë kodrës, me pishtar në dorë.

Staka lëshoi një piskamë kushtrimi dhe shkoi pas tij. I kishte harruar të dhjetë vjetët e banakut dhe e ndiente veten përsëri sharrëxhi.

Lleshi nuk mendonte më për gjethet e bagëtisë, as për ndodhinë e mëngjesit, që e kishte djegur përbrenda gjithë ditën. Nuk ia vinte veshin dhimbjes së mesit dhe mudohej të mos ngelej mbrapa shokëve.

Bledarit gjithçka i dukej si një ëndërr magjepsëse. Vështronte kreshtat e zeza të bjeshkëve, profilet si dantellë të pyjeve, dritat e lëvizshme të pishtarëve dhe ndiente dëshirën të fluturonte përmbi të gjitha këto. Ngri-ti lart pishtarin e vet dhe hovi përpara, i shtyrë prej një ngazëllimi të madh të brendshëm, sikur vërtet do të ngrihej në fluturim.

Lulashi i futi marshin traktorit dhe e lëshoi drejt ballit të borës, me ruspën poshtë, si ndonjë dem që mësyn me brirë. Megjithëse të ftohtët hynte nga dritarja, ai kishte vapë. Manovronte me shpejtësi dhe i dukej sikur traktori ishte pjesë e trupit të vet.

E kishte gozhduar borën me vështrim, si të ishte ndonjë armik dhe i vërsulej me traktor, duke shtrënguar nofullat e duke kafshuar buzën e poshtme. Mudohej

të mos humbiste kot asnjë çast, si të donte të mos e linte armikun të merrte veten. Zemërohej dhe i jepte gaz traktorit kur ndiente se bora, që grumbullohej si shkumë kaltëroshe përballë ruspës, ia frenonte shpejtësinë. Kënaqej pa masë kur ajo shembej përnjëherësh në humnerën e zezë.

Vjollca vështronte përherë e më shpesh matanë. Sula i kishte hedhur një peliçe sharrëxhinjsh dhe ajo nuk dallonte aspak nga moria e njerëzve që e rrethonin. Mirashi e ndiqte me buzëqeshje atërore, tek mundohej ta përdorte shpejt dhe mirë lopatën.

Vjollca kishte parë manifestime me pishtarë dhe gjithmonë ato i kishin ngjallur një ndjenjë ekzaltimi por, këto që po shihte sonte, pishtarët mes pishnajës, pishtarët në ato duar të ashpra, pishtarët që ndriçonin atë llogore vigane prej bore dhe fytyrat e atyre njerëzve të fortë, i ngjallnin një emocion të fuqishëm, si asnjëherë tjetër, që e bënte të vibronte përbrenda. Në ato çaste e ndiente thellë se sa e vështirë ishte që me çelësin e saj t'i bënte të tjerët të ndienin dhe të kuptonin ato që po ndiente dhe po kuptonte më së fundi ajo.

Kishin mbetur metrat e fundit. Njerëzve sikur u ishte zhdukur lodhja. Fytyrat i kishin të tendosura. Sytë u shkëlqenin, sikur kishin rrëmbyer diçka prej flakës së pishtarëve.

Lopatat lëviznin shpejt dhe flaknin tej ré dëbore. Në skarpate ishin ngulur dhjetëra pishtarë që lëshonin dritë të kuqërreme, kundërmim rrëshine dhe tym të zi. Ishte një lëvizje energjike, e pandërprerë. Hijet zgjateshin, shkurttoheshin, ndërpriteshin dhe merrnin trajta të çuditshme.

Traktorët punonin ballë për ballë. Uturimat e tyre

ngjanin si një bashkëbisedim kërcënues dhe dritat sikur kërkonin njëra-tjetrën. Thikat e çelikta përpiqeshin t'ia kalonin shoqja-shoqes dhe muri i borës hollohej pareshtur.

Shoferët e autokolonës ndezën të gjitha dritat dhe projektorët. Pylli buzë rrugës, ku i ndriçuar fort e ku i kredhur në errësirë, dukej si dekor i një ndodhie legjendare.

U dëgjuan dyert e makinave që u çelën dhe u mbyllën. Shoferët nxituan te balli i punës. Sula ia rrëmbeu si me shaka lopatën Vjollcës, por Aliu s'ia mori dot as Mirashit dhe as Prengës.

Në shpatin buzë rrugës u dukën disa pishtarë, që po vinin mëtëposhtë si ndonjë ortek drite. Ndreca ndërpreu një çast punën dhe vështroi andej, duke buzëqeshur i kënaqur. Kjo tregonte se Vuka me shokë e kishin kryer detyrën. Pëndryshe ata nuk do të ktheheshin.

Mrika mezi arriti t'i rregullonte shallin Bardhokut. Ai u turr t'u dilte përpara bacës Vukë, xhaxhi Bledarit dhe shokëve të tyre.

Bardha, me çantën e ndihmës së shpejtë krahaqafë, i mëshonte lopatës përbri traktorit të Lulashit dhe nuk mendonte më me ankth takimin me të atin.

Befas njerëzit heshtën, me vështrimet të mbërthyer në një vend. Ndërmjet traktorëve kishte mbetur vetëm një mur i hollë bore dhe ata qëndronin të ndezur ballë për ballë, sikur i kanoseshin njëri-tjetrit. Tani njëri prej tyre duhej të tërhiqej, por traktoristët mundeshin me sy dhe prisnin.

— Mbi të, burra, me lopata!, — lëshoi kushtrimin Ndreca.

Sakaq shpërtheu një britmë që tundi bjeshkët. Nga të dyja anët u lëshuan njerëzit me lopata në dorë. Traktorët u tërhoqën.

Tehet e lopatave shkëlqenin si jataganët e një përleshjeje legjendare. Dëgjoheshin ofshamjet e punës, thirrjet nxitëse dhe britmat e gëzimit. Bora flakej si plu-

hur anash dhe muri hollohej e hollohej, gjersa prej tij s'mbeti asgjë.

Shpërtheu një brohoritje ngadhnjimi. Dikush shtiu me armë. Ushtuan bjeshkët. Lopatat u çuan përpjetë, si armët e fitores. Njerëzit përqafoheshin, shtrëngonin duart, i rrihnin shpatullat shoku-shokut.

Vjollca nxitonte mes-turmës dhe kërkonte me sy në morinë e njerëzve me peliçe. I dukej sikur notonte në atë rrymë entuziaste, në atë kacafytje të gëzueshme hijesh dhe dritash.

Bledari, me pishtarin lart, nxitonte mes shokëve, duke vështruar në të gjitha anët. Befas sytë e tij u zmadhuan dhe shkëlqyen akoma më shumë. Kishte parë Vjollcën që po vraponte drejt tij. Ajo mezi u shtëmangej njerëzve. Erdhi e i ra në gjoks, duke thirrur:

— Bledar! Zëri dhe vështrimi i saj thoshin shumë. Ai e kuptoi. I përkëdheli flokët me dashuri, pastaj i kaloi krahun mbi supë dhe vazhduan të ecnin krah njëri-tjetrit, me sytë plot dritë.

Mirash Pali, që e kishte vënë re takimin e tyre, ndjeu diçka ta simbiste në kraharor. Ndërkaq dy krahë të fuqishëm e rrokën fort dhe ai dalloj Vukën, që po e përgëzonte me gjallëri. Pastaj toku duart edhe me shokë të tjerë.

— Befas u gjend përballë Lulashit. Ai i kishte zgjatur dorën dhe po e vështronte me mirëdashje e buzagaz. Mirashi ngurroi, dora e të riut mbeti një çast pezull, por i dha fund shpejt hezitimit, e toku me Lulashin, pastaj shkoi më tej. Gëzimi i përgjithshëm ia rrafshoi shpejt rrudhën që i qe sajuar ndërmjet vetullave.

Njerëzit e të dy balleve marshonin krah për krah në rrugën e porsaçelur. Në duar mbanin pishtarë. Duart i kishin hedhur në supet e njëri-tjetrit.

— Bora deshi të na ndante, por na bashkoi më fort!, — tha Vuka, duke vështruar shokët me krenari dhe dashuri.

PASQYRA E LËNDËS

	Page
Jetë <i>jeta</i>	7
Vështrim i kthjellët <i>Vështrim i kthjellët</i>	139
Borë në bjeshkë <i>Borë në bjeshkë</i>	269